


# zhanret e gazetarisë



**Bajram Kosumi**

zhanret  
e gazetarisë

Tetor, 2019  
PRISHTINË



Bajram Kosumi  
ZHANRET E GAZETARISË

Recensentë:  
Prof. asoc. dr. Milazim KRASNIQI  
Arber Vllahiu

Redaktor gjuhësor:  
Berat ARMAGEDONI

Faqosja:  
Osman D. GASHI

Kopertina:  
Yllkë Kosumi

Shtypi:  
Shtypshkronja “Prograf”, Prishtinë

Botues:  
Botime Artini  
[www.librariaartini.com](http://www.librariaartini.com)

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

© Autori

659.3(075.8)  
070(075.8)

Kosumi, Bajram  
Zhanret e gazetarisë / Bajram Kosumi. – Prishtinë :  
Artini, 2019. – 260 f. : ilustr. ; 24 cm.

**ISBN 978-9951-766-48-7**



# PËRMBAJTJA

Parathënie. . . . . 13

## *Pjesa e 1-rë – Teoria e zhanrit gazetar*

<b>I. Teori, po. Pyetja është: çfarë teorie?</b> . . . . .	23
I.1. Një teori tipologjike . . . . .	26
I.2. Tipologjia sipas faktorëve të jashtëm tipologjikë . . . . .	27
I.2.a. Tipologjia sipas mediumit. . . . .	28
I.2.b. Tipologjia sipas kohës së botimit . . . . .	33
Përfshirja nga kjo tipologji . . . . .	36
I.2.c. Tipologjia sipas profilit social, politik dhe profesional . . . . .	37
I.2.d. Gazeta Zyrtare dhe Fletë të verdha (të arta etj.) . . . . .	40
<b>II. Tipologjia zhanrore: faktorët e brendshëm tipologjikë</b> . . . . .	41
II.1. Një shikim në retrovizor për teorinë e zhanrit . . . . .	44
II.2. Teoria e zhanrit në gazetari . . . . .	46
II.3. Zhanri i tekstit gazetar: struktura dhe qëllimi përmbajtjesor i tekstit gazetar . . . . .	47
II.3.a. Struktura e tekstit gazetar . . . . .	50
II.3.b. Qëllimi përmbajtjesor i tekstit gazetar. . . . .	53
<b>III. Katër zhanre në gazetari.</b> . . . . .	59
III.1. Përfundime për zhanrin e tekstit gazetar . . . . .	59
III.2. Gazetaria informative . . . . .	60
III.3. Gazetaria analitike . . . . .	62
III.4. Gazetaria publicistike . . . . .	63
III.5. Gazetaria argëtuese . . . . .	64
<b>IV. Lëvizje kah zhanri</b> . . . . .	67
IV.1. Gazetaria e pavarur, gazetaria për dhe kundër qeverisë dhe gazetaria profesionale . . . . .	67
IV.2. Gazetaria e lirë dhe gazetaria e censuruar . . . . .	69
IV.3. Gazetaria hulumtuese (investiguese) . . . . .	70
IV.4. Gazetaria e saktë . . . . .	72
IV.5. Korporatat - forma të reja të oligarkisë gazetare . . . . .	73
IV.6. Fotozhurnalizmi (fotogazetaria) . . . . .	76
IV.7. "Fjalimi për liderin" - gazetaria dhe oratoria . . . . .	77
IV.8. Gazetaria globale . . . . .	78
IV.9. Gazetaria digjitale. . . . .	79

## Pjesa e 2-të – Gazetaria informative

<b>Gazetaria informative . . . . .</b>	<b>93</b>
<b>V. Lajmi . . . . .</b>	<b>95</b>
V.1. Koncepti lajm . . . . .	95
V.2. Qëllimi përmbajtjesor dhe struktura tekstore e lajmit . . .	98
V.2.1. Qëllimi përmbajtjesor i lajmit . . . . .	98
V.2.2. Lajmi e përcakton orientimin e gazetës. . . . .	98
V.2.3. Struktura tekstore e lajmit. . . . .	99
V.2.4. Struktura e lajmit me dy tema sipas Mencher-it . . . . .	101
V.2.5. Superstruktura e lajmit sipas Teun van Dijk-ut. . . . .	103
V.2.6. Struktura tematike e lajmit . . . . .	107
V.2.7. Analiza tematike sipas koncepteve të Van Dijkut e strukturës kuptimore të tekstit të lajmit . . . . .	111
V.2.8. Prirje të reja në strukturën tekstore të lajmit . . . . .	113
V.3. Elementet e strukturës tekstore të lajmit sipas përshkrimit tradicional në gazetarinë amerikane (Mensher) . . . . .	117
V.3.1. Titulli . . . . .	117
V.3.2. Llojet e titujve . . . . .	119
V.3.3. Kreu . . . . .	120
V.3.4. Tipa të hyrjeve . . . . .	124
V.3.4.a. Kreu i drejtpërdrejtë: parimi i piramidës së përmbysur. . . . .	124
V.3.4.b. Kreu i vonuar: prirje për ndryshimin e strukturës së lajmit . . . . .	126
V.3.5. Materiali që shpjegon kreun . . . . .	128
V.3.6. Sfondi i lajmit (prapavija, "background") . . . . .	129
V.3.7. Materiale të dorës së dytë, ose më pak të rëndësishme . . . . .	130
V.4. Elemente të tjera strukturore të lajmit . . . . .	131
V.4.1. Vendi dhe koha . . . . .	131
V.4.2. Citati dhe vendi i tij në strukturën e tekstit lajmor. . . . .	131
V.4.3. Komentet në lajm . . . . .	132
<b>VI. Nënloje të lajmit . . . . .</b>	<b>135</b>
VI.1. Fleshlajmi . . . . .	135
VI.2. Antërfajlli . . . . .	137
VI.3. Fotolajmi . . . . .	141
VI.4. Lajmi protokollar . . . . .	142
VI.5. Lajmi i titruar . . . . .	145
<b>VII. Lajmi në gazetë dhe lajmi në radiotelevizion . . . . .</b>	<b>147</b>
VII.1. Ana teknike e teknologjike e lajmit radioteleviziv . . . . .	148
VII.2. Struktura tekstore e lajmit radioteleviziv . . . . .	148
VII.3. Çështje të stilit . . . . .	150

<b>VIII. Raporti . . . . .</b>	<b>151</b>
VIII.1. Qëllimi përmbajtjesor i raportit . . . . .	151
VIII.2. Elemente strukturore të raportit . . . . .	151
VIII.3. Lloje të raporteve sipas gjatësisë së tekstit dhe temës që trajtojnë . . . . .	154
VIII.3.1. Raporti i gjatë dhe raporti i shkurtë . . . . .	154
VIII.3.2. Raporti nga konferenca e shtypit. . . . .	157
VIII.3.3. Raporti për krimet . . . . .	158
VIII.3.4. Raporti nga gjykata . . . . .	158
VIII.3.5. Raporti nga mbledhjet, nga tubimet, nga Kuvendi e Qeveria, nga konferencat shkencore etj. . . . .	160
VIII.3.5.a. Llojet e raporteve sipas mënyrës së informimit . . . . .	160
VIII.3.5.b. Lloje tradicionale të raportit . . . . .	164
<b>IX. Kronika . . . . .</b>	<b>167</b>
IX.1. Çështje të nocionit . . . . .	167
IX.2. Qëllimi përmbajtjesor i kronikës dhe struktura tekstore	168
<b>X. Artikulli i veçantë (fiçëri) . . . . .</b>	<b>173</b>
X.1. Çështje të përkufizimit . . . . .	173
X.2. Lloje të artikullit të veçantë (fiçërit) . . . . .	176
X.2.1. Artikulli shkencor-popullarizues . . . . .	176
X.2.2. Artikulli për përditshmërinë (Lifestyle feature) . . . . .	177
X.2.3. Artikulli sensacional. . . . .	180
X.2.4. Artikulli i sfondit (backraunder) . . . . .	181
X.2.5. Artikulli për fatet njerëzore (Human interest Story). . . . .	182
<b>XI. Nekrologjia dhe përkujtimi . . . . .</b>	<b>185</b>
XI.1. Nekrologjia . . . . .	185
XI.2. Përkujtimi (In Memoriam). . . . .	189

### *Pjesa e 3-të – Gazetaria analitike*

<b>XII. Gazetaria analitike (opinioniste). . . . .</b>	<b>197</b>
XII.1. Qëllimi përmbajtjesor i gazetarisë analitike . . . . .	197
XII.2. Struktura tekstore e zhanrit analitik. . . . .	198
XII.3. Gjuha konative dhe stili i zhanrit analitik . . . . .	201
<b>XIII. Editoriali . . . . .</b>	<b>203</b>
XIII.1. Nocioni dhe qëllimi përmbajtjesor . . . . .	203
XIII.2. Tema e editorialit . . . . .	204
XIII.3. Ngjyra politike e gazetës . . . . .	206
XIII.4. Struktura e editorialit . . . . .	207
XIII.5. Llojet e editorialëve . . . . .	210
XIII.5.1. Editoriali operativ. . . . .	210

XIII.5.2. Editoriali i përgjithshëm politik . . . . .	210
XIII.5.3. Editoriali popullarizues . . . . .	211
XIII.5.4. Editoriali i temës . . . . .	212
XIII.5.5. Editoriali që s'është editorial . . . . .	214
XIII.6. Çështje të stilit. . . . .	215
XIII.7. Nga historia e editorialit shqip . . . . .	215
<b>XIV. Komenti . . . . .</b>	<b>217</b>
XIV.1. Qëllimi përmbajtjesor. . . . .	217
XIV.2. Tema e komentit. . . . .	219
XIV.3. Elementet strukturore të komentit . . . . .	220
XIV.3.1. Titulli . . . . .	220
XIV.3.2. Hyrja: Paraqitja e temës dhe llojet e hyrjes. . . . .	221
XIV.3.3. Argumentet e temës . . . . .	225
XIV.3.4. Kundër-argumentet . . . . .	226
XIV.3.5. Interpretimet dhe përfundimet . . . . .	227
XIV.4. Një strukturë tjetër e komentit . . . . .	228
XIV.5. Ligjërimi konativ dhe çështje të tjera të stilit. . . . .	229
XIV.6. Nga historia e gazetarisë shqiptare . . . . .	230
XIV.7. Një shembull metodik për studentët: . . . . .	231
XIV.8. Analiza strukturore e një komentit: . . . . .	232
<b>XV. Artikulli analitik (analiza) . . . . .</b>	<b>233</b>
XV.1. Qëllimi përmbajtjesor . . . . .	233
XV.2. Tema dhe analizimi i saj . . . . .	235
XV.3. Struktura e artikullit analitik. . . . .	237
XV.4. Lloje të artikullit analitik. . . . .	243
XV.4.1. Analiza pasqyruese. . . . .	244
XV.4.2. Analiza problemore . . . . .	246
XV.5. Një shembull metodik për analizën dhe vendin e saj në gazetari (ushtrim për studentët) . . . . .	247
XV.6. Përgatitja teknike e artikullit. . . . .	249
XV.7. Nga historia e artikullit analitik shqip . . . . .	250
<b>XVI. Kryeartikulli . . . . .</b>	<b>251</b>
XVI.1. Çështje të identitetit zhanror . . . . .	251
XVI.2. Vendi i kryeartikullit në gazetë . . . . .	254
XVI.3. Rëndësia e temës . . . . .	255
XVI.4. Aktualiteti i temës . . . . .	256
XVI.5. Kryeartikulli e krijon gazetën . . . . .	257
XVI.6. Gjerësia e trajtimit të temës. . . . .	257
XVI.7. Struktura e kryeartikullit . . . . .	258
XVI.8. Shkrimi i kryeartikullit . . . . .	260
XVI.9. Nga historia e gazetarisë shqiptare . . . . .	260

<b>XVII. Kolumna</b> . . . . .	<b>261</b>
XVII.1. Çështje të nocionit dhe të identitetit zhanror. . . . .	261
XVII.2. Personalja dhe publikja (statusi i tekstit dhe qëllimi përmbajtjesor). . . . .	263
XVII.3. Konstatime personale . . . . .	264
XVII.4. Hapja e temave dhe zbulimi i temave të reja . . . . .	267
XVII.5. Tekst i afërt me publicistikën . . . . .	268
XVII.6. Përfundime subjektive dhe konceptuale . . . . .	269
XVII.7. Lidhja me emrin e autorit . . . . .	270
XVII.8. Çështje teknike . . . . .	271

<b>XVIII. Intervista</b> . . . . .	<b>273</b>
XVIII.1. Nocioni dhe qëllimi përmbajtjesor. . . . .	273
XVIII.2. Tema . . . . .	274
XVIII.3. Struktura e intervistës . . . . .	275
XVIII.3.1. Hyrja . . . . .	275
XVIII.3.2. Pyetjet . . . . .	277
XVIII.3.3. Lloje të pyetjeve . . . . .	278
XVIII.4. Përmbyllja e intervistës . . . . .	284
XVIII.5. Lloje të intervistave . . . . .	285
XVIII.5.1. Llojet e intervistave sipas mënyrës së realizimit të tyre . . . . .	285
XVIII.5.2. Llojet e intervistave sipas qëllimit përmbajtjesor dhe qëllimit hulmues . . . . .	289
XVIII.6. Përgatitja e gazetarit për intervistë . . . . .	298
XVIII.7. Tri parakushte për një intervistë të suksesshme . . . . .	299
XVIII.8. Autorizimi i tekstit. . . . .	299
Përfundim për intervistën . . . . .	300

<b>XIX. Anketa (Wox Pop)</b> . . . . .	<b>303</b>
--	------------

<b>XX. Dosja</b> . . . . .	<b>305</b>
XX.1. Nocioni dhe qëllimi përmbajtjesor . . . . .	305
XX.2. Struktura e përbërë (mozaik) dhe teksti bazik i dosjes. . . . .	306
XX.3. Faktografia . . . . .	308
XX.4. Tema e dosjes. . . . .	310
XX.5. Komentë të autorit. . . . .	311
XX.6. Planifikimi i dosjes. . . . .	312
XX.7. Autori apo autorët? Gazetari apo gazetarët? . . . . .	313

<b>XXI. Letra nga lexuesit</b> . . . . .	<b>315</b>
XXI.1. Letrat e lexuesve . . . . .	315
XXI.2. Letra e hapur . . . . .	316

*Pjesa e 4-t – Gazetaria letrare*

<b>XXII. Gazetaria letrare (publicistika)</b> . . . . .	327
XXII.1. Gazetaria, publicistika dhe letërsia . . . . .	327
XXII.2. Gazetaria dhe publicistika: qëllimi përmbajtjesor i publicistikës . . . . .	329
XXII.3. Arti i faktit . . . . .	330
XXII.4. Elementet që gazetaria i merr prej letërsisë . . . . .	332
XXII.5. Struktura tekstore e gazetarisë letrare . . . . .	335
XXII.6. Imagjinata dhe e vërteta (fiction dhe faction) . . . . .	335
XXII.7. Origjinaliteti . . . . .	337
XXII.8. Publicistika dhe nonfiction literature . . . . .	337
XXII.9. Tendenca e tekstit publicistik . . . . .	338
XXII.10. Tipikja dhe e veçanta . . . . .	339
XXII.11. Përfundim . . . . .	339
<b>XXIII. Reportazhi (raporti letrar)</b> . . . . .	341
XXIII.1. Qëllimi përmbajtjesor i reportazhit . . . . .	341
XXIII.2. Gazetari në vendin e ngjarjes: përjetimi subjektiv . . . . .	342
XXIII.3. Detaji është shpirti i reportazhit . . . . .	343
XXIII.4. Dramaciteti: pa dramë nuk ka reportazh! . . . . .	344
XXIII.5. Tema e reportazhit. . . . .	344
XXIII.6. Ndërtimi strukturor i reportazhit. . . . .	344
XXIII.7. Nata e parë. . . . .	345
XXIII.8. Reportazhi shqip . . . . .	346
<b>XXIV. Fotoreportazhi</b> . . . . .	347
<b>XXV. Karikatura</b> . . . . .	349
<b>XXVI. Udhëpërshkrimi</b> . . . . .	351
XXVI.1. Qëllimi përmbajtjesor i udhëpërshkrimit . . . . .	352
XXVI.2. Faktet dhe udhëpërshkrimi . . . . .	353
XXVI.3. Literariteti i udhëpërshkrimit . . . . .	354
XXVI.4. Udhëpërshkrimi shqip . . . . .	355
<b>XXVII. Udhërrëfyese (guida).</b> . . . . .	357
XXVII.1. Lindja e udhërrëfyesit dhe qëllimi përmbajtjesor i tij	358
XXVII.2. Tipa të udhërrëfyesve . . . . .	358
<b>XXVIII. Polemika</b> . . . . .	361
XXVIII.1. Qëllimi përmbajtjesor i polemikës . . . . .	362
XXVIII.2. Struktura tekstore . . . . .	363
XXVIII.3. Fakte të tjera të rëndësishme për polemikën . . . . .	364
XXVIII.4. Polemika shqip . . . . .	365

<b>XXXIX. Pamfleti</b> . . . . .	<b>367</b>
XXXIX.1. Qëllimi përmbajtjesor i pamfletit . . . . .	368
XXXIX.2. Karakteristika strukturore e gjuhësore e pamfletit . . . . .	368
XXXIX.3. Letërsia pamfletiste . . . . .	369
XXXIX.4. Pamfleti shqip . . . . .	370
<b>XXX. Fejtoni (nënfletra)</b> . . . . .	<b>371</b>
XXX.1. Qëllimi përmbajtjesor i fejtonit . . . . .	371
XXX.2. Tema e fejtonit . . . . .	372
XXX.3. Çështje të strukturës së fejtonit . . . . .	373
XXX.4. Çështje të stilit të fejtonit . . . . .	374
XXX.5. Fejtoni shqip . . . . .	374
<b>XXXI. Kozeria</b> . . . . .	<b>375</b>
<b>XXXII. Recensionit</b> . . . . .	<b>379</b>
<b>XXXIII. Bibliografia</b> . . . . .	<b>381</b>
<b>XXXIV. Eseja</b> . . . . .	<b>383</b>
XXXIV.1. Qëllimi përmbajtjesor i esesë . . . . .	384
XXXIV.2. Struktura tekstore e esesë . . . . .	385
XXXIV.3. Temat e esesë . . . . .	386
<b>XXXV. Skica</b> . . . . .	<b>387</b>
<b>XXXVI. Portreti (profili)</b> . . . . .	<b>389</b>
<b>XXXVII. Shënimi</b> . . . . .	<b>393</b>

*Pjesa e 5-të – Gazetaria argëtuese*

<b>XXXVIII. Gazetaria argëtuese</b> . . . . .	<b>403</b>
XXXVIII.1. Një përkufizim teorik . . . . .	403
XXXVIII.2. Entertainment . . . . .	405
XXXVIII.3. Publiku . . . . .	406
XXXVIII.4. Qëllimi përmbajtjesor i gazetarisë argëtuese . . . . .	407
XXXVIII.5. Infotainment . . . . .	409
XXXVIII.6. Gazetaria argëtuese në gazetatat e shtypura . . . . .	410
XXXVIII.7. Entertainment dhe infotainment . . . . .	412

<b>Në vend të përmbylljes</b> . . . . .	<b>415</b>
---	------------





## PARATHËNIE E BOTIMIT TË DYTË

**P**ër vetëm tre vjet Libraria Artini, ku mbahej libri *Zhanret e gazetarisë* (2016), mbeti me disa ekzemplarë të fundit të librit. As vetë nuk e kisha pritur kaq shpejt përgatitjen e botimit të dytë. Fatkeqësisht, libri nuk u promovua e nuk u shit as në Tiranë e as në Tetovë, thjeshtë për arsye të çakordimit doganor, kulturor dhe biznesor. Më vjen keq që nuk kisha përgjigje për shumë studentë që më shkruanin në Facebook Page, si Arnela nga Tirana:

*"Përshëndetje,  
Si jeni?"*

*Ku mund ta gjej librin tuaj Zhanret e gazetarisë, në Tiranë,  
pasi më duhet për punimin e diplomës?"*

Ndryshe, studentët e Departamentit të Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës e përjetuan librin si ngjarje të rëndësishme. Ajo u pa që në promovim, në të cilin rolin kryesor e patën ata. Më vinte mirë kur shihja gjatë ligjëratave studentët të kishin markuar fjalë e rreshta të librit me kujdes dhe ndaleshin për diskutim. Një ditë njëra më tha: "Profesor, në faqen 343, rreshti i tetë, në vend të fshat keni shkruar fashat." Pastaj ata filluan gjahun për gabime. Për çdo gjetje më shkruanin. Ndjeja kënaqësi në gabimet e librit tim, sepse kjo vërtetonte se studentët e lexonin për çdo fjalë e për çdo shkronjë atë! Edhe sot i ruaj emailat e tyre për këto gabime. Ua premtova një notë më shumë për një gabim të gjetur.

Falënderoj të gjithë ata, si Jehona, Adnita, Orhidea, Gresa, Viola, Brigita, Meridiana, Erëza, Erleta, Mërgime, Blendrita, Qëndresa, Mediana, Agnesa, Saranda e shumë të tjerë, për lexim të vëmendshëm dhe mundësinë që më dhanë të përmirësoj disa gabime, teknike dhe përmbajtjesore.

Në këtë botim kam mënjeluar ato gabime, por nuk ka ndryshime të tjera të ndjeshme. Shpresoj që edhe ky botim do ta kryejë misionin e vet.

*Autori, 2019*

# PARATHËNIE

## ZANAFILLA E LIBRIT ZHANRET E GAZETARISË

**K**y libër është rezultat i punës sime me studentët e gazetarisë të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 2008, pasi isha larguar nga Qeveria e Kosovës, më ftoi profesori Milazim Krasniqi atëherë shef i Degës së Gazetarisë në UP, që t'i mbaja disa kurse për studentët e gazetarisë. Kurrë më parë nuk e kisha bërë atë punë dhe kisha drojë nëse e kisha vullnetin e duhur për të. Mbas fazës idealiste të politikës në Kosovën e çliruar, thuajse kishte filluar faza e një politike të egër e pa asnjë rregull, me aktorë të pangopur e të paskrupuj. Ajo ishte e tepërt dhe e papranueshme për një njeri me përvojë të gjatë idealisti në revolucionin e Kosovës. Ishte mbushur kupa ime politike. Kur u gjenda përballë studentëve, kur pashë se si ata i mbanin sytë tejet të hapur, sikur donin të përpinin me sy ato që ligjëroja, kur kuptova dallimin e madh midis një fjalimi politik dhe të një ligjëratae për studentët, atëherë u binda përfundimisht se kjo marrëdhënie ia vlente një mijë herë më shumë se marrëdhënia me politikën e egër. Aty e gjeta veten borxhli ndaj studentëve për një libër të mirë dhe u nisa pas fjalisë nistore të Kuintilianit "...pas njëzet vjet përkushtuar ushtrimit të të rinjve dhe kohës së bollshme të studimit, më lutën disa nga miqtë e mi të vërtetë që të shkruaja diçka për artin e të folurit" (*Institutio Oratoria*).

Nga ligjëratat e para me këta studentë ka filluar ngjizja e këtij libri. Konceptin e parë të ligjëratave ua pata shpërndarë studentëve në vitin 2008 (fatkeqësisht, edhe në vitin 2016 ka shumë studentë që shërbehen me to!), por pastaj çdo dy vjet kam përditësuar tekstin me shënime të reja, me venerime shtesë e, shumë herë, me përgjigjet në pyetjet që m'i bënin studentët. Në vitin 2012 e kam shkruar tekstin tërësisht të ri, duke u bazuar në konceptin e vitit 2008. Duke parë se varianti i ri i tekstit po zgjerohej shumë, dhe kapitulli i parë i cili trajtonte aspektin teorik të zhanrit ishte fryrë tej mase, vendosa që atë kapitull ta shkëpus nga tërësia dhe ta publikoj si libër më vete. Kështu është krijuar libri *Tipologji dhe zhanër (2013)*, libër tërësisht i orientuar në çështjen e zhanrit të tekstit gazetar. Ky libër i kënaqte në masë të madhe interesimet e mia, por edhe kërkesat e studentëve për teorinë e zhanrit. Pavarësisht nga kjo, asnjëherë nuk kam menduar se e kam kryer borxhin tim ndaj studentëve të gazetarisë: *Tipologji dhe zhanër* është një libër teorik, i përshtatshëm vetëm për ata studentë të cilët duan të thellohen në studimet e tekstit gazetar dhe të gjinisë së tekstit, por jo edhe për secilin student që synon të bëhet gazetar. Libri parak i konceptuar që nga viti 2008 nuk ishte teori e pastër, por një teori e vogël me një pjesë praktike të madhe. Këtë libër ende nuk e kisha përfunduar, e duhej ta bëja patjetër.

Në vitin 2015 ndërhyrjet, përmirësimet, shtesat, mballomat, anëshkrimet, paratekstet dhe plotë e përplot venerime të reja me të cilat kisha mbushur tekstin e vitit 2012 ishin bërë aq të shumta sa që edhe vetë ngatërrohesha në to. Vendosa përfundimisht t'ia filloja shkrimit të variantit të fundit. Në mes të vitit 2016 e përfundova këtë variant, ky që lexuesi e ka tash në dorë.

### OBJEKTIVAT E LIBRIT

Librit qëllimisht ia lashë titullin pragmatik *Zhanret e gazetarisë*, sepse kështu quhet kursi kryesor për zhanrin në Departamentin e Gazetarisë të Universitetit të Prishtinës. Libri synon që, parësisht, studentëve të gazetarisë t'ua shkoqisë ligjësitë teorike dhe praktike të zhanrit të tekstit gazetar. Pra, objekt i studimit të kësaj shkence, teorisë së zhanrit, është vetë teksti gazetar. Pavarësisht se në çfarë forme dhe statusi ekziston gazetaria, pavarësisht në është gazetë apo portal "online", teksti gazetar ende vazhdon dhe për një kohë të gjatë do të vazhdojë të jetë procesi themelor i formësimit dhe jetësimit të informatës. Prandaj mësimi i tij, mësimi i parimeve themelore teorike e praktike të tij dhe mësimi i trajtave e i formave të ekzistimit të tij, është çështje parësore për studentin e gazetarisë. Tashmë ka kaluar koha kur gazetari ka lindur nga çasti në çast (edhe pse për atë që e ka këtë talent kurrë nuk kalon koha), sepse mbushullimi i shkollave të gazetarisë e të komunikimit anembanë botës është një tregues i qartë i zhvillimeve të reja në këtë fushë. Me zhvillimet e reja teknologjike në fushën e informacionit e të komunikimit, jo vetëm është shtuar interesimi për të gjitha këto, për më shumë, teknologjia informative, mediet dhe komunikimi janë shndërruar në gjeneratorë të zhvillimit të përgjithshëm social e ekonomik të shoqërisë moderne. Për këto arsye, mësimi i zhanrit të tekstit gazetar është çështje parësore për secilin student të gazetarisë. Ky libër e ka atë qëllim: duke shpjeguar ligjësitë e përgjithshme dhe të veçanta të ekzistimit të një tekstit gazetar, i cili dallon prej një tekstit tjetër gazetar, studenti jo vetëm mëson ta dallojë një tekst nga tjetri, por edhe ta shkruajë ndryshe një tekst nga një tekst i llojit tjetër zhanror.

### STRUKTURA E LIBRIT

Libri është i organizuar në pesë kapituj. Secili kapitull ka një tërësi tematike, i cili ndahet në nënkapituj, në të cilët trajtohen çështje të mëvetësishme brenda tërësisë tematike të kapitullit.

Në kapitullin e parë *Teoria e zhanrit gazetar* flitet për ekzistimin e teorisë së gazetarisë në përgjithësi dhe për teorinë e zhanrit gazetar në veçanti. Fillimisht flitet për tipologjinë gazetare dhe ndarjet e gazetarisë në tipa, si gazetari e shkruar apo "online", gazetari ditore apo javore, gazetari ekonomike apo informative etj. Të gjithë këta

tipa gazetarie dhe të tjerë i takojnë një tipi dhe ndahen nga një tjetër mbi bazën e një faktori tipizues. Këta faktorë mund të jenë të jashtëm dhe të brendshëm.

Faktorët e jashtëm janë trajtuar sipërfaqësisht, ndërsa ata të brendshëm janë trajtuar më gjerësisht. Ata janë dy: qëllimi përmbajtjesor dhe struktura tekstore e tekstit gazetar. Mbi këta dy faktorë ndërtohet tipologjia zhanrore e gazetarisë. Mbi këta dy faktorë çdo tekst gazetar dallon nga një tekst tjetër gazetar, prandaj në kapitull u kushtohet më shumë rëndësi dhe janë bërë disa analiza për ta kuptuar imtësisht rolin e këtyre dy faktorëve në zhanrin gazetar. Në rrjedhë të këtyre dy faktorëve ndahen dhe flitet veç e veç për katër zhanre të tekstit gazetar: zhanrin informativ, zhanrin analitik, zhanrin letrar (publicistik) dhe zhanrin argëtues. Aty është e vendosur edhe një tabelë krahasuese e parimeve dhe e elementeve më të rëndësishme zhanrore të katër zhanreve gazetare, në atë mënyrë që lexuesi t'i dallojë qartë.

Në kapitullin e dytë *Gazetaria informative* shtjellohen llojet dhe nënlojet zhanrore informative: lajmi, llojet e shkurtra të lajmit (flashlajmi, antërfajlli, fotolajmi, lajmi i titruar), raporti, kronika, artikulli i veçantë (fiçëri), nekrologjia etj. Lajmi është trajtuar më gjerësisht për shkak të rëndësisë parësore të tij në gazetari. Janë trajtuar struktura të ndryshme tekstore të lajmit, si: struktura të hershme, struktura sipas modelit të Melvin Mensherit, struktura ligjërimore sipas Teun van Dijkut dhe struktura të reja lajmore në gazetarinë digjitale. Në vazhdim flitet për raportin, po ashtu gjerësisht, pasi shtjellohen qëllimi përmbajtjesor dhe struktura tekstore e tij. Pas krahasimeve të raportit me lajmin, flitet për llojet e ndryshme të raporteve: sipas gjatësisë së tekstit (raporti i gjatë dhe raporti i shkurtër); sipas temës që trajtojnë (raporti nga konferenca e shtypit, raporti për krimet, raporti nga gjykata, raporti nga mbledhjet, nga tubimet, nga Kuvendi e Qeveria, nga konferencat shkencore; sipas mënyrës së informimit (raporti i thjeshtë informativ, raporti përshkruar, raporti analitik (interpretues, komentues), raporti me tezë).

Për herë të parë, më gjerësisht, në teorinë e gazetarisë shqiptare flitet për fiçërin apo artikullin e veçantë, i cili është dominues në gazetarinë anglishtfolëse. Në gazetarinë evropiane, rrjedhimisht edhe në atë shqipe, një numër i llojeve të fiçërit mbajnë të tjerë emra dhe janë të njohur si lloje të pavarura zhanrore. Flitet për disa prej këtyre artikujve të veçantë, si: artikullin shkencor-popularizues, artikullin për përditshmërinë (Lifestyle feature), artikullin sensacional, artikullin e sfondit (Backgraunder), artikullin për fatet njerëzore (Human interest Story).

Në kapitullin e tretë *Gazetaria analitike (opinioniste)* flitet veç e veç për lloje të ndryshme zhanrore të kësaj gazetarie, ato që janë më të përhapura jo vetëm në gazetarinë shqiptare por edhe më

gjerë. Shtjellohen gjerësisht editorialet, komentet, analiza (artikulli analitik), kryeartikulli, kolumna, intervista, "vox pop"-i, dosja, letrat e lexuesve etj. Për secilin prej këtyre llojeve zhanrore flitet në dy aspekte: cili është qëllimi përmbajtësor i tij dhe cila është struktura tekstuale e tij. Për secilin janë marrë shembuj të mjaftueshëm për t'i dëshmuar parimet e ekzistimit të tyre si lloji zhanror, por edhe që të shërbejnë si modele për studentët se si të shkruhet ai lloj zhanror. Po ashtu, për secilin lloj zhanror janë shtjelluar edhe forma të ndryshme të llojit zhanror si dhe nënlojet zhanrore.

Në kapitullin e katërt *Gazetaria letrare (publicistika)* shtjellohet zhanri publicistik ose gazetaria letrare. Në fillim diskutohet për marrëdhënien gazetaria-publicistika-letërsia, e pastaj takimi i gazetarisë me letërsinë, arti i faktit. Më tej shtjellohen elementet letrare të cilat gazetaria i merr prej letërsisë, si dhe çështje të tjera si: originaliteti në publicistikë, imagjinata dhe e vërteta, gazetaria letrare dhe letërsia dokumentare, tendenca dhe tipikja në gazetarinë letrare. Në fund të këtij diskutimi teorik për gazetarinë letrare është vënë një tabelë krahasuese, në pikat më të rëndësishme, midis shkencave humaniste (filozofia, sociologjia...) - publicistikës-letërsisë.

Në vazhdim shtjellohen lloje të veçanta zhanrore të kësaj gazetarie, si: reportazhi (raporti letrar), fotoreportazhi, karikatúra, udhëpërshkrimi, udhërrëfyesi (guida), polemika, pamfleti, fejtuni (nënflota), kozeria, recensionit, bibliografia, eseja, skica, portreti (profili) dhe shënimi.

Në kapitullin e pestë *Gazetaria argëtuese* shtjellohet, po ashtu për herë të parë në mendimin gazetar shqip, përdorimi i gazetarisë për argëtim. Kjo është e rëndësishme sidomos në fillim të shekullit XXI, kur në shumë vende të botës ka shumë televizione ose medime të tjera të cilat deri në 90 % të kohës së tyre ia kushtojnë argëtimit. Emisionet më të shikuara në botë janë pikërisht këto emisione argëtimi. Në këtë kapitull janë shtjelluar dy format kryesore të argëtimit përmes gazetarisë: entertainment dhe infotainment. Sado ky kapitull në aspektin sasior, por edhe në atë cilësor, nuk mund të krahasohet me kapitujt e tjerë të këtij libri dhe me tematikat e tyre, fakti që gazetaria argëtuese është trajtuar si zhanër i mëvetëshëm e ka rëndësinë e vet. Pikërisht në këtë kapitull u mbetet studiuesve të tjerë të gazetarisë, të medias dhe të tekstit gazetar, të hulumtojnë dhe të shkoqisin aspekte e parime të rëndësishme të gazetarisë argëtuese.

## FALËNDERIME

Të parët që duhen falënderuar për këtë libër janë studentët e gazetarisë të Universitetit të Prishtinës. Natyrisht se unë kam bërë një punë të gjatë, me vullnet të pashuar, si çdo punë akademike, nganjëherë shumë e lodhshme, mirëpo studentët me të vërtetë kanë

qenë gjeneratori i mirëfilltë i këtij libri. Edhe atëherë kur durimi nuk më lejonte ta vazhdoja punën në një projekt kaq të gjatë, kanë qenë studentët ata të cilët me pyetjet, me kureshtjen dhe me nxitjet e tyre më kanë dhënë kurajë ta vazhdoj punën. Po ashtu, i falënderoj edhe studentët e gazetarisë në Universitetin Shtetëror të Tetovës, me të cilët e kam mbajtur këtë kurs për disa vjet, si dhe studentët e gazetarisë të Kolegjit UBT me të cilët e kam mbajtur këtë kurs për pak vjet. Disa prej këtyre studentëve, si në rastin e Kuintilianit të cituar, më nxisnin drejtpërdrejt me pyetjen se kur do ta kenë në duar librin tim për zhanret gazetare? Edhe pse do të doja shumë, tash nuk mund t'i përmend emrat e atyre studentëve të shkëlqyeshëm, qoftë për shkak se janë shumë, qoftë për shkak se ata kanë ndikuar tek unë edhe si grup e jo vetëm si individë, por jam gjithsesi i kënaqur që ata tashmë janë aktorët kryesorë të gazetarisë kosovare dhe dalëngadalë po bëhen aktorët kryesorë edhe të zyrave të shtypit të institucioneve të ndryshme, personat kyçë në krijimin e marrëdhënieve me publikun etj.

Disa prej këtyre studentëve kanë dhënë ndihmesë në këtë libër, prandaj dua t'i falënderoj me emër: Osman Gashin për faqosjen e mrekullueshme të tekstit dhe për kujdesin për ilustrime; Faton Ismajlin për leximin e tekstit dhe për gjetjen e disa shembujve të përshtatshëm; Berat Dakajn për lekturimin e kujdesshëm të tekstit. Po ashtu, dua t'i falënderoj edhe dy miqtë e mi, gazetarët e njohur, Arbër Vllahiun dhe Besim Abazin, për leximin e kujdesshëm të tekstit dhe për sugjerimet e tyre. Sugjerimet e Arbërit më kanë ndihmuar që kapitullin e parë, *Teoria e zhanrit gazetar*, ta thjeshtësoj dhe ta largoj e ta dalloj sa më shumë nga libri *Tipologji dhe zhanër*, pra ta përshtati për nevojat e studentëve. Fatoni dhe Besimi më ndihmuan në gjetjen e disa shembujve më të përshtatshëm, si raportin e shkurtër Dyzetedy milionë euro për hekurudhat e Kosovës, raportin e gjatë Kerry: Dhuna është e papranueshme—debatin në parlament, artikullin për fatet njerëzore Nëna e Farkundas: "Mizori përtej imagjinatës". Asistentin tim Faton Ismajlin e falënderoj edhe për diskutimet rreth zhanrit të gazetarisë argëtuese, me të cilat më ka ndihmuar ta qartësoj më shumë këtë zhanër gazetar. E falënderoj veçanërisht edhe kolegun tim, profesor Milazim Krasniqin, jo vetëm për ftesën e vitit 2008, me të cilën e krijoi parakushtin për shkrimin e këtij libri, por edhe për diskutimet e përbashkëta për çështje të ndryshme të gazetarisë, e të cilat më kanë ndihmuar në qartësimin e shumë çështjeve.

### PËRKUSHTIM

Këtë libër ua kushtoj të gjithë studentëve të cilëve u kam ligjruar tema të diskutuara në këtë libër. Ky është libri i tyre.

*Prishtinë, maj 2016*

I. Teori, po. Pyetja është: çfarë teorie?

II. Tipologjia zhanrore: faktorët e brendshëm tipologjikë

III. Katër zhanre në gazetari

IV. Lëvizje kah zhanri

## Teoria e zhanrit gazetar

1  
PJESA





## PËRMBLEDHJE

**N**ë këtë kapitull flitet për ekzistimin e teorisë së gazetarisë në përgjithësi dhe për teorinë e zhanrit gazetar në veçanti. Fillimisht flitet për tipologjinë gazetare dhe ndarjet e gazetarisë në tipa, si: gazetari e shkruar apo “on line”, gazetari ditore apo javore, gazetari ekonomike apo informative etj. Të gjitha këto tipa gazetare dhe të tjerë, i takojnë një tipi dhe ndahen nga një tjetër mbi bazën e një faktori tipizues. Këta faktorë mund të jenë të jashtëm dhe të brendshëm. Duke u bazuar në faktorët e jashtëm do të mësohen disa tipa të gazetarisë, si: tipizimi sipas mediumit, tipizimi sipas kohës së botimit dhe tipizimi sipas faktorit social, politik e profesional. Për secilin prej këtyre tre tipave do të mësohen tipa dhe forma të veçanta të gazetarisë.

Faktorët e brendshëm do të mësohen më gjerësisht. Ata janë dy: qëllimi përmbajtjesor dhe struktura tekstore e tekstit gazetar. Mbi këta dy faktorë ndërtohet tipologjia zhanrore e gazetarisë. Mbi këta dy faktorë çdo tekst gazetar dallon nga një tekst tjetër gazetar, prandaj në kapitull u kushtohet më shumë rëndësi dhe janë bërë disa analiza për ta kuptuar imtësisht rolin e këtyre dy faktorëve në zhanrin gazetar. Në rrjedhë të këtyre dy faktorëve ndahen dhe flitet veç e veç për katër zhanre të tekstit gazetar: zhanri informativ, zhanri analitik, zhanri letrar (publicistik) dhe zhanri argëtues.

Në pjesën e fundit të kapitullit flitet për disa prirje në gazetari të cilat lëvizin kah zhanri gazetar, ose kah një tip i gazetarisë, por në të shumtën e rasteve nuk e arrijnë atë shkallë. Kështu, flitet për gazetari të pavarur, gazetari për dhe kundër qeverisë dhe gazetari profesionale; për gazetari të lirë dhe gazetari të censuruar; për gazetari hulumtuese, të saktë, për korporatat - si forma të reja të oligarkisë gazetare; për foto-gazetarinë, për marrëdhënien gazetaria-oratoria, për gazetarinë globale dhe për gazetarinë digjitale.

Qëllimi ynë në këtë kapitull është shtjellimi i një hyrjeje teorike në praktikën e zhanrit gazetar.



## I. TEORI - PO. PYETJA ËSHTË: ÇFARË TEORIE?

**P**rej natyrës së saj gazetaria është jashtëzakonisht dinamike. Nuk ka edhe një aktivitet tjetër social, përveç vetë të folurit, që është më dinamike se gazetaria. Fillimisht, në shekullin XVI e këndej jeta dinamike e gazetës është matur me muaj, ndërsa nga shekulli XIX jetëgjatësia e gazetës matej me ditë. Mbas shpikjes së radios e të televizorit jetëgjatësia e lajmit matej me orë, ndërsa mbas teknologjisë digjitale jetëgjatësia e lajmit matet me minuta. Ka një prirje, e përcjell me frikë e dyshime, se ajo që quhet gazetari personale ose qytetare (*civil journalism*, apo *civic journalism*), falë zhvillimit të shpejtë të teknologjisë digjitale, mund ta bëjë lajmin gjithmonë live (drejtpërdrejt), ose pothuajse live, me një vonesë prej disa pak minutave. Në protestat antiqeveritare në Tiranë, më 21 janar 2011, të cilat përfunduan me vrasjen e tre protestuesve, nuk u deshën më shumë se disa minuta për t'u lansuar në uebportalin e famshëm [www.youtube.com](http://www.youtube.com) incizimi i vrasjes së protestuesve. Miliona shikues mund ta shihnin *live* këtë incizim, ndërsa televizionet shqiptare e jepnin pamjen të ngadalësuar për t'i parë hollësitë e vrasjes. Këto incizime u përdoren më vonë edhe nga hetuesit policorë për të kuptuar se si ka ndodhur vrasja.

Përmendja e emërtimeve *teoria tipologjike e gazetarisë*, *teoria e zhanrit*, *teoria e tekstit gazetar* etj. krijon dyshimin se teoricienët po përpiqen ta kalërojnë gazetarinë dhe t'ia vënë një herë e mirë frerët. Frika e skeptikëve të teorisë gazetarë është e arsyeshme. Një teori normative gazetarë vetëm mund ta pengojë gazetarinë e jo ta ndihmojë.<sup>1</sup> Natyra dinamike e gazetarisë nuk mund të durojë asnjë teori normative. Edhe po të provojmë ta bëjmë një të tillë, derisa ne do ta shkruajmë, ajo veçse do të jetë e vjetruar. Por, ky përfundim nuk e mohon nevojën për një teori të gazetarisë. Tërë ky zhvillim i gazetarisë, vetë fakti që teknologjia e re digjitale, më shumë se në asnjë fushë, aplikohet në gazetari dhe komunikim - e ne ende jemi duke e jetuar revolucionin teknologjik informativ - fakti se strukturat tekstore, semantike e diskursive të gazetarisë janë zgjeruar mjaft shumë në sasi etj., kërkojnë një teori për t'i shpjeguar këto shfaqje të çuditshme të shoqërisë moderne, për të kuptuar se cila është baza dhe cili është interesi social për këtë shfaqje. Në anën tjetër, fakti që kudo në botë fakultetet e gazetarisë dhe të komunikimit janë në shpërthim, kërkon një qasje shkencore për nevoja akademike. Pra, një teori për gazetarinë është e nevojshme dhe e domosdoshme. Kjo tashmë po ndodh dhe, edhe ai më skeptiku duhet të pajtohet.

### PËRMBAJTJA

I. Teori, po. Pyetja është: çfarë teorie? . . . . .	21
I.1. Një teori tipologjike	24
I.2. Tipologjia sipas faktorëve të jashtëm tipologjikë. . . . .	25
I.2.a. Tipologjia sipas mediumit . . . . .	27
I.2.b. Tipologjia sipas kohës së botimit . . . . .	30
Përrjashtimi nga kjo tipologji . . . . .	33
I.2.c. Tipologjia sipas profilit social, politik dhe profesional. . . . .	36
I.2.d. Gazeta Zyrtare dhe Fletë të verdha (të arta etj.) . . . . .	38

Natyrë dinamike e gazetarisë nuk mund të durojë asnjë teori normative. Edhe po të provojmë ta bëjmë një të tillë, derisa ne do ta shkruajmë, ajo veçse do të jetë e vjetruar. Por, ky përfundim nuk e mohon nevojën për një teori të gazetarisë.

Kjo teori për gazetarinë nuk mund të jetë normative, në kuptimin e zbulimit të rregullave të përhershme e të përsëritshme, mbi të cilat ndodh fenomeni gazetari, e të cilat duhet të ndiqen. Mirëpo, teoria që zbulon ligjësitë e ndodhjes së shfaqjeve dhe i përkufizon ato, s'ka se si të mos e ketë një përmasë normative. Kështu, zbulimi i Kurt Langut dhe Gladys Engel Langut nga Shkolla Sociologjike e Çikagos, se televizioni krijon një realitet të ri në raport me ngjarjen lajmore për të cilin raporton, dhe se ky realitet televiziv shndërrohet në histori e jo realiteti objektiv (ngjarja lajmore)<sup>2</sup>, nuk mund të kuptohet si normë absolute, por prej të gjithëve pranohet si një natyrë ontologjike e televizionit. Ose, mënyra e shkrimit të titullit të lajmit nuk është parë gjithnjë njëjtë: fillimisht nuk ka pasur fare tituj, mandej ka ekzistuar vetëm një titull, ndërsa pas studimeve diskursive në gazetari, mbititulli, titulli dhe nëntitulli (i cili shpesh është edhe kreu i lajmit) trajtohen si një tërësi. Këta dy shembuj dëshmojnë se normativiteti në teorinë e gazetarisë nuk shihet si një normë e fizikës ose matematikës, por si një normë dinamike, në proces të ndryshimit dhe në përshtatje të përhershme me zhvillimin e tekstit gazetar dhe të faktorëve të tjerë të ndërlidhur me tekstin gazetar.

Njëjtë mund të thuhet edhe për teorinë tipologjike të gazetarisë dhe për teorinë zhanrore. Nuk mund të pranohet një teori zhanrore normative, aq më pak një taksonomi dogmatike: pra, nuk mund të krijojmë një rend zhanror i cili do të ketë jetë të gjatë. Zhanri i cilitdo tekst, e këtu hyn edhe teksti gazetar, nuk është një e dhënë e përhershme, përkundrazi, ndryshon dhe evoluon, varësisht prej faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Por ky mohim nuk e mōhon edhe nevojën e pasjes së një teorie zhanrore përshkruese për gazetarinë. Nuk mund të pranohet një teori e ngurtësuar tipologjike nëse ne jemi dëshmitarë të gjallë të lindjes së një tipi të ri të gazetarisë, asaj që quhet gazetari qytetare (gazetaria personale), e cila varet prej sjelljes *ad hoc* të secilit individ që merret me të, dhe nuk ka teori apo taksonomi që mund të përkufizojë se si do të raportojë një qytetar nga Kina, Afrika e Jugut apo nga Kanada nëpërmjet telefonit të tij digjital. Por, ka një teori që mund të përkufizojë dhe ta vendosë diku në rendin taksonomik vetë veprimin e atij qytetari, duke e quajtur atë gazetari qytetare dhe duke e trajtuar si tip të veçantë të gazetarisë. Teoria përshkruese e gazetarisë, nga kjo edhe e tipologjisë dhe teorisë zhanrore, synon t'i përshkruajë ligjësitë mbi të cilat ndodh shfaqja gazetari.


Edhe diskutimet në këtë libër, të cilat synojnë konsolidimin e një teorie të zhanrit gazetar, duhet të kuptohen paraprakisht nga ky prizëm: çdo ndarje, çdo tipologji, çdo rregull ka një histori të ndryshimeve, prandaj as tash nuk mund të merren si norma statike e të pandryshueshme. Fundja, karakteristikë e shkencave human-

Nuk mund të pranohet një teori zhanrore normative, aq më pak një taksonomi dogmatike: pra, nuk mund të krijojmë një rend zhanror i cili do të ketë jetë të gjatë. Zhanri i cilitdo tekst, e këtu hyn edhe teksti gazetar, nuk është një e dhënë e përhershme, përkundrazi, ndryshon dhe evoluon, varësisht prej faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Por ky mohim nuk e mōhon edhe nevojën e pasjes së një teorie zhanrore përshkruese për gazetarinë.

iste është pikërisht ndryshueshmëria. Në përputhje me natyrën e saj dinamike, proceset, format dhe stilet në gazetari janë shumë të ndryshueshme. Është vështirë, në mos e pamundshme, të saktësohet një teori tipologjike e gazetarisë derisa ajo lëviz e ndryshon edhe në çastin kur e saktësojmë teorinë tipologjike të saj.

Çdo ndarje, çdo tipologji, çdo rregull ka një histori të ndryshimeve, prandaj as tash nuk mund të merren si norma statike e të pandryshueshme.

Pavarësisht nga kjo, teoria e gazetarisë mund t'i përkufizojë disa prej faktorëve, priirjeve dhe shfaqjeve themelore të gazetarisë, disa prej strukturave, formave dhe modeleve të tekstit gazetar, dhe disa prej proceseve themelore në fushën e gazetarisë, pa i përmendur çështjet e deontologjisë. Një teori e gazetarisë mund t'i përkufizojë dhe t'i normojë disa prej formave të tekstit gazetar, të cilat, para se të normohen nga teoria, janë fiksuar nga praktika. Koncepti i piramidës së përmbysur, koncepti i kreut të drejtpërdrejtë dhe kreut të vonuar, koncepti i gjashtë pyetjeve themelore në gazetari (5W and 1H) etj., janë fiksuar nga praktika gazetare dhe teoria vetëm mund t'i përshkruajë si normë e asgjë më shumë. Pra, një teori përshkruese, me një përmasë normuese, e cila ka gjithnjë parasysh dy esencat e gazetarisë - jetën dinamike dhe procesin e pandërprerë të ndryshimit - e ndihmon gazetarinë. Këtë do të mundohemi ta bëjmë në këtë libër.



Philosophia et septem artes liberales.

Shtatë artet liberale

Hortus deliciarum i Herradit të Landsbergut (shek. XII)

## I.1. NJË TEORI TIPOLOGJIKE

Shkenca tipologjike është e vjetër. Vetë fjala tipologji vjen nga kuptimet e vjetra të fjalëve helenike: *tipos* - shenjë, vulë dhe *logos* - dije, shkencë. Është zhvilluar në shumë fusha të dijes si, për shembull, taksonomia, degë e biologjisë, e cila merret me klasifikimin e qenieve të gjalla sipas ngjashmërisë dhe llojeve të ndryshme. Tipologjia, në interpretim të lirë e të përgjithshëm, është: *Klasifikimi i qenieve, i sendeve, i gjuhëve dhe i dukurive të ndryshme sipas tipareve thelbësore të përbashkëta, ndarja e tyre në tipa*.<sup>3</sup> Në shkencat humaniste tipologjia ka luajtur një rol të madh në klasifikimin e dijeve, të proceseve, të shfaqjeve dhe të teksteve. I tërë sistemi i dijeve i zhvilluar në Mesjetë, për shembull, ka qenë i zhvilluar në kuadër të një tipologjie të rreptë të arteve, të ndara në dy grupe të mëdha. Njësoj, edhe në shkencën bashkëkohore humaniste tipologjia vazhdon të luajë një rol të madh. Mjafton ta përmendim vërshimin e studimeve për tipologjinë e tekstit.<sup>4</sup>

Në gazetari ekzistojnë disa ngjashmëri dhe ndryshime midis tipave e llojeve të ndryshme të gazetarisë (p.sh. ngjashmëria dhe dallimi midis një gazete ditore dhe Gazetës Zyrtare), janë krijuar disa forma fikse të tekstit gazetar (p.sh. ndryshe shkruhet lajmi për gazetën ditore nga lajmi për gazetën apo revistën javore, e krejt ndryshe për televizionin e portalin digjital), pastaj një fiksion i disa formave tekstore dhe i disa strukturave tematike (p.sh. forma tekstore e editorialit dhe e kryeartikullit; struktura tematike e lajmit dhe e analizës etj.), janë krijuar disa shfaqje dhe disa ndërlidhje ko-ekzistenciale midis gazetarisë dhe një mediumi të caktuar (p.sh. reklama dhe TV, spoti dhe TV etj.). Pra, janë krijuar një varg veçantish të gazetarisë e të cilat e mundësojnë tipologjinë e saj. Ka disa elemente të gazetarisë, të cilët janë të përbashkëta për një tip, por jo edhe për të tjerët. Këta faktorë po i quajmë **faktorë tipologjikë**, për shkak të rolit që kanë në krijimin e një forme, një zhanri, një lloji apo tipi të tekstit gazetar, apo të gazetarisë në përgjithësi. Duke qenë se këto veçanti nuk kanë të bëjnë me një klasë faktorësh, por me klasë të ndryshme, atëherë edhe tipologjia e gazetarisë duhet bërë në nivele të ndryshme dhe mbi faktorë të ndryshëm. Sipas tipologjistëve, faktorët tipologjikë mund të jenë të jashtëm dhe të brendshëm.<sup>5</sup> Radioja dhe televizioni janë medime, mirëpo gazetaria që zhvillohet në këto dy medime është tipizuar si zhanër i veçantë dhe quhet gazetari radiotelevizive, përkatësisht radiogazetari dhe gazetari televizive. Po ashtu, ka edhe gazetari të digjitalizuar, e shtypit etj. Në këtë rast mediumi, radioja, televizioni, interneti, shtypshkronja etj. janë faktorë të jashtëm që kanë ndikuar në tipologjinë e gazetarisë. Ndërsa një lajm i gazetës së shtypur dhe

*Tipos* - shenjë, vulë; *logos* - dije, shkencë. Tipologjia, në interpretim të lirë e të përgjithshëm, është: *Klasifikimi i qenieve, i sendeve, i gjuhëve dhe i dukurive të ndryshme sipas tipareve thelbësore të përbashkëta, ndarja e tyre në tipa*.

**Faktorë tipologjikë:** disa elemente të gazetarisë, të cilat janë të përbashkëta për një tip, por jo edhe për të tjerët, të cilat kanë rol në krijimin e një forme, një zhanri, një lloji apo tipi të tekstit gazetar, apo të gazetarisë në përgjithësi.

Faktorët tipologjikë mund të jenë të jashtëm dhe të brendshëm.

Medime si: radioja, televizioni, interneti, shtypshkronja etj. janë faktorë të jashtëm që kanë ndikuar në tipologjinë e gazetarisë, prandaj ka radiogazetari, gazetari televizive, gazetari digjital, gazetari të shtypur etj.

një editorial i po asaj gazete janë të ndryshëm, por tash për shkak të një faktori të brendshëm: strukturës tekstore të njërit e të tjetrit. Struktura tekstore e lajmit është e ndryshme nga struktura tekstore editorialit, e ky fakt i bënë ata tërësisht të ndryshëm nga aspekti tipologjik, pavarësisht faktit se që të dy janë tekste të shkruara në gazetë. Mund të përfundojmë se ekzistojnë dy tipologji të mëdha të gazetarisë të cilat bëhen mbi dy lloje të faktorëve: të jashtëm dhe të brendshëm.

Ekzistojnë dy tipologji të mëdha të gazetarisë të cilat bëhen mbi dy lloje të faktorëve: të jashtëm dhe të brendshëm.

Faktorët e jashtëm tipologjikë janë të thjeshtë, si rrjedhojë, tipologjia e gazetarisë mbi këta faktorë është më e thjeshtë. Komplikimet fillojnë me faktorët e brendshëm tipologjikë. Këta kanë të bëjnë me gjuhën apo me diskursin dhe me përmbajtjen e tekstit gazetar. Struktura tekstore e një teksti gazetar, si do të shohim më vonë, është një faktor i brendshëm, që qenëson brenda vetë tekstit gazetar, mirëpo i jep formë atij teksti. Mbi këta faktorë të brendshëm tipologjikë mund të ndërtohet teoria e zhanrit gazetar, sepse zhanri ka të bëjë me gjuhën e diskursin dhe me përmbajtjen e tekstit gazetar. Pikërisht kjo tipologji e dytë është më me interes në teorinë e gazetarisë. Mbi këtë klasifikim të teorisë tipologjike ne do ta tipizojmë edhe gazetarinë, duke u mbështetur në të dy faktorët, të brendshëm dhe të jashtëm. Në këtë tipologji të gazetarisë nuk do të përfshijmë çdo tip, çdo zhanër dhe çdo lloj të gazetarisë, por do të përzgjedhim vetëm disa tipologji kryesore, sa për ta provuar teorinë tipologjike të gazetarisë.

## 1.2. TIPOLOGJIA SIPAS FAKTORËVE TË JASHTËM TIPOLOGJIKË

Si u tha më lart, disa faktorë të jashtëm ndikojnë thelbësisht në procesin e gazetarisë. Disa më shumë e disa më pak por, të gjithë, sipas forcës së ndikimit, e ndikojnë edhe vetë natyrën e gazetarisë. Në dekadat e fundit po diskutohet, nën presionin e një frike të arsyeshme, ndikimi i tregut në natyrën e gazetës. Nëse gazeta është mall tregu sikurse çdo mall tjetër, e kështu trajtohet, ajo parësisht u nënshtrohet ligjeve të tregut, e vetëm çka mund të shpëtohet nga kërkesat e tregut i përkushtohet vetë natyrës së gazetarisë. Prandaj redaktorët e gazetave u kërkojnë gazetarëve, ose e fusin vetë në përdorim tastin *delete*, për t'i shkurtuar tekstet që t'u bëjnë hapësirë të mjaftueshme reklamave. Në këto rrethana reklama e mbisundon gazetën. Kjo është një e keqe pa të cilën nuk mund të mbijetojë gazetaria. E vetmja mundësi që i ka mbetur gazetarisë është menaxhimi i mirë i kësaj të keqeje.



Pak dekada më herët, Harold Innis dhe Marshall McLuhan vërejtën rolin e madh të mediumit në zhvillimin e përgjithshëm të njeriut. E shndërruar në gazetari, kjo teori na përballë me ndryshimet radikale që ka sjellë teknologjia informative. Ekziston një kufi i madh midis gazetarisë para internetit dhe pas internetit. Po kështu ka ekzistuar një kufi i madh midis gazetarisë para zbulimit të telegrafit dhe asaj pas zbulimit të tij. Këta janë të njëjtat kufij, sikurse kufiri para dhe pas zbulimit të shtypshkronjës së Gutenbergut, apo më larg, kufiri para dhe pas shpikjes së alfabetit fonetik etj. Këto dallime në gazetari nuk janë të vogla dhe vetëm sasiore, por në radhë të parë cilësore. Gazeta e shtypur dhe ajo digjitale janë në një luftë të rreptë që vetëm një dhjetëvjetësh. Dhe, gazeta e shtypur është duke e humbur betejën. Sado që ka teoricienë që besojnë se gazeta digjitale nuk mund ta zëvendësojë asnjëherë gazetën e shtypur, një prej gazetave më të famshme në botë, *The Financial Times*, e ka botuar një analizë-nekrologji për veten: “Pas një beteje të gjatë me rënien e publicitetit, moshën e lexuesve gjithmonë e më të lartë, konkurrencën e internetit, nivelin e lartë të borxheve, kostot e mëdha, ambiciet e zgjeruara dhe stresin, industria e gazetave ndërroi jetë”.<sup>6</sup>

Tekstet gazetares po i përshtaten çdo ditë e më shumë natyrës së mediumit digjital, poende edhe vetë lexuesi po krijon një mënyrë të re të leximit të tekstit digjital. Përfundimisht, sado mediumi është një faktor i jashtëm ndaj gazetarisë, ai ka ndikuar fuqishëm në natyrën e saj, duke krijuar tipa e zhanre të ndryshme prej saj.

Ne trajtuam vetëm faktorin treg dhe faktorin medium, si shembuj, për ta parë rolin e faktorëve të jashtëm në natyrën e gazetarisë. Klasifikimi i gazetarisë sipas këtyre faktorëve ndihmon studimet shkollore për gazetarinë dhe i orienton studentët e gazetarisë më mirë në studimet dhe në punën e ardhshme të tyre.

### I.2.A. TIPOLOGJIA SIPAS MEDIUMIT

Prej të gjithë faktorëve të jashtëm, mediumi është më i rëndësishmi, më i gjëri dhe më ndikuesi në gazetari. Ekonomisti kanadez Harold Innis, duke studiuar zhvillimin ekonomik të Kanadës, në librin e tij *The Teaching of Economic History in Canada (1958)* e vërejtë rolin e hekurudhës transatlantike të Kanadasë në zhvillimin ekonomik të Kanadasë. Ai konsiderohet si mendimtari i parë<sup>7</sup> në mendimin modern i cili kuptoi rëndësinë e mediumit në një proces social, edhe pse afër një shekull para tij Karl Marks ka zbuluar rolin vendimtar të mullirit me ujë në zhvillimin e shoqërisë evropiane në shekujt e Mesjetës, apo edhe rolin e industrisë së lehtë të tekstilit në



jetën e përgjithshme të shoqërisë evropiane të Kohës së Re. Pasuesi i Innisit, Marshall McLuhan, në librin *Instrumentat e komunikimit: media si një zgjatim i njeriut* (1964) krijoi teorinë e mediumit dhe përkufizoi rolin e madh të medimeve në jetën e njeriut (mediumi si zgjatim i njeriut) dhe rolin e madh të mediumit në gazetari. McLuhani shkoi aq larg sa që tha se *mediumi është mesazhi*.<sup>8</sup> Shumë kundërshtarë të tij e sulmuan McLuhanin për papjekuri teorike dhe e përqeshën teorinë e tij.<sup>9</sup> Sot McLuhan është ringritur përsëri në piedestalin e studimeve mediale dhe vepra e tij përsëri ribotohet.

Mediumi është kanali nëpër të cilin bartet mesazhi gazetar, prandaj nga ky pozicion i tij ai ka forcën ndikuese në gazetari, si te dhënësi (gazetari) ashtu edhe te marrësi (audiencia, publiku). Gjithçka që shërben për bartjen e mesazhit nga dhënësi te marrësi, në rastin e gazetarisë nga gazetari deri tek audiencia, quhet medium. Kështu, vetë gjuha është një medium që shërben për bartjen e mesazheve. Një gazetar që ka parë një ngjarje lajmore dhe na rrëfen neve ndodhjen, ai përdor gjuhën si medium për bartjen e mesazhit. Shkrimi është një medium, po ashtu letra ku vendosen shkronjat është medium, lapsi është medium, pastaj makina e shkrimit, kompjuteri, televizori, radioja, telegrafi, rrjeti kabllor televiziv, rrjeti i internetit, telefoni mobil etj., të gjitha janë medime që bartin mesazhin (lajmin) nga dhënësi te marrësi. Në të gjitha këto raste mediumi qëndron midis dhënësit (gazetarit) dhe marrësit (audiencia). Nga ky aspekt, mediumi komunikon me të dy anët: me dhënësin dhe me marrësin. Komunikimi i tij është përsëri i dyanshëm: ai ndikohet nga të dy anët dhe ndikon të dy anët. Ai ndikohet dhe e ndikon dhënësin (gazetarin) sepse gazetari i jep formë dhe kuptim mediumit, duke dërguar mesazhin nëpërmjet tij (pa mesazhin e gazetarit mediumi nuk do të kishte kurrfarë rëndësie), por po ashtu gazetari detyrohet ta përshtatë mesazhin e tij për një medium të caktuar (ndryshe e shkruan lajmin për gazetë e ndryshe për televizion). Në anën tjetër, mediumi ndikon dhe ndikohet nga marrësi (audiencia), sepse duke bartur mesazhin mediumi e ndikon audiencën, por audiencia mund ta pranojë apo të mos e pranojë mesazhin, apo thjesht e shkyç mediumin dhe nuk komunikon me të. Ky ndikim i dyfishtë dhe i dyanshëm i mediumit në procesin e komunikimit gazetar i jep atij forcën e ndikimit në krijimin e një tipologjie të veçantë të gazetarisë. Tipologjia e gazetarisë, sipas mediumit nëpërmjet të cilit bartet lajmi, është tipologjia më e lehtë, më e pranueshme dhe më e thjeshtë. Sipas kësaj tipologjie, gazetaria ndahet në:

- gazetarinë e shtypur (teksti i shkruar si medium + letra) - gazeta në letër;
- gazetarinë e folur (fjala e folur si medium + aparati radio) - radiogazetaria;

Harold Innis dhe Marshall McLuhan vërejtën rolin e madh të mediumit në zhvillimin e përgjithshëm të njeriut.

McLuhani e ngre mediumin në kulm: *mediumi është mesazhi*.

Gjithçka që shërben për bartjen e mesazhit nga dhënësi te marrësi, në rastin e gazetarisë nga gazetari deri tek audiencia, quhet medium.

- gazetarinë e shtypur  
- gazetarinë e folur - radiogazetaria;  
- gazetarinë e shikuar - gazetaria televizive;  
- gazetarinë "on line" - gazetaria digjitale.

- gazetarinë e shikuar (fjala dhe fotografia si medium + televizori) - gazetaria televizive;
- gazetarinë "on line" (shkrimi digjital + kompjuteri) - gazetaria digjitale.



Ballina e gazetës Shqip

Historia në disa pika e gazetarisë së shtypur, pas vitit 1830:

Revolucioni i parë informativ

- Shpikja e telegrafit (1830)
- Shpikja e makinerive që prodhohin gazeta shumë: 1830 R. Hoe and Company ndërtoi makineri me qymyr që shtypte 4 000 kopje në orë.
- Masa e njerëzve që dinin të shkruanin e të lexonin.
- Gazetat masive: gazetat e qindarkave (një cent, një peni, një pëning)
- Benjamin Day, The New York Sun (1833), nga 6 centë sa ishte, çmimin e zbriti në 1 cent
- NY Sun filloi të botonte lajme lokale, sidomos ato të dhunës, të seksit.
- Në Evropë po ashtu botohet deri në një milion tirazhi i gazetave të qindarkave.
- Gazetarët fitojnë para të mira. Shembulli i Aleksandër Dyma Plakut.

**Gazetaria e shtypur** realizohet nëpërmjet tekstit të shkruar (me dorë, me makinë shkrimi, me kompjuter) dhe gazetës, apo revistës apo një forme tjetër gaztare, ku botohet ai tekst i shkruar. Lajmi i këtij tipi të gazetarisë lexohet prej marrësit në gazetën letër. Gazetari dhe audienca qëndrojnë në distancën më të largët në procesin e komunikimit gazetar.



Gazetaria e folur

**Gazetaria e folur** realizohet nëpërmjet fjalës së folur dhe radiovalëve. Gazetari flet me fjalë lajmin, apo kërkon nga të tjerët ta tregojnë me fjalë dhe, tonin e tij e të tjerëve e bart nëpërmjet radiovalëve te marrësi. Marrësi e dëgjon lajmin. Gazetari dhe audienca qëndrojnë në distancë të largët në procesin e komunikimit gazetar: audienca e dëgjon zërin e gazetarit, por gazetari nuk komunikon në asnjë mënyrë tjetër me audiencën.

Si fituan gazetat e qindarkave?

- Reklama: Tregu i reklamës: rritja e tirazhit sjell reklama; ujla e çmimit mbulohet dhe sjell përfitime.

Tendencë drejt stabilizimit?

- 1883 Joseph Pulitzer e blen New York World dhe nga 15 000 kopje, e ngriti në 250 000.
- Formula e suksesit të Pulitzerit:
  - saktësia e informatave të lajmit;

- gazeta u bë zëdhënëse e kushteve të rënda të jetës dhe amike e politikanëve të korruptuar, dhe e keqpërdorimeve të bizneseve të mëdha.

Lindja e shtypit të verdhë

- William Hearst me San Francisco Examiner dhe New York Journal (1895).

Shekulli XX

- Makineria e re e shtypsh-kronjave e rrit koston e shtypit: ka ngritje të gazetave

- të mëdha dhe reduktim të gazetave të vogla e lokale.

Vitet 1970

- Nis beteja midis gazetave të shtypura dhe gazetave on line.
- Ka rënie të qarkullimit të gazetave.
- In memoriam i Financial Times (në fund të viteve '90)

Pronësia e gazetave sot

- Korporatat e mëdha: Gan-net Company, R. Murdock etj.

**Gazetaria audio-vizuale** realizohet nëpërmjet imazhit filmik të kombinuar me tonin në një televizion e, kohët e fundit, edhe në portalet digjitale. Gazetari filmon ngjarje, i komenton ato dhe jep informacione zanore apo kërkon nga të tjerët që t'i komentojnë a të informojnë zëshëm, i incizon këto në celuloid apo në kamerë digjitale dhe e bart lajmin (fotografi e ton bashkërisht) në televizor. Marrësi e shikon dhe e dëgjon lajmin njëkohësisht. Gazetari dhe audienca qëndrojnë në distancën relativisht të afërt në procesin e komunikimit gazetar: audienca e dëgjon dhe e shikon imazhin e gazetarit, mund ta vlerësojë procesin e komunikimit edhe në bazë të dukjes së gazetarit (dukja e bukur dhe të folurit bukur të folësve në televizion është njëri prej parimeve të gazetarisë së televizionit). Teoritë më të reja argumentojnë se audienca ndikohet edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë nga folësi në televizion.

170 kanale (me pagesë). Në vitin 2007 XK kishte 8 milionë abonues  
 - Audienca jostabile: në 2005-n XM pësoi humbje të mëdha financiare për shkak të mosabonimeve të rregullta  
 • Radiointerneti: ka rreth 50 milionë dëgjues në javë. Problemi më i madh i këtyre radiove janë financat: radiot duhet t'ua paguajnë autorëve të drejtën e emetimit 0,8 cent për çdo këngë.  
 • Formatet e radiostacioneve (programet apo rubrikat):  
 - Formatet rrethor për detajizimin e programeve: një rreth (si një CD) i ndarë në

shumë pjesë, për një orë program në një format.  
 - Formatet Top 40  
 - Formatet Lajmet-biseda  
 - Formatet i programeve të gatshme për radio  
 • Ndërlidhja në të njëjtat programe e disa radiove: Radio Kosova+Radio Tirana+Radio Shkupi ndërlidhen vetë, pjesëmarrësit e tyre dhe audienat në të njëjtat programe.  
 - Radioja jo komerciale:  
 - Institucionet edukative financojnë radiot e tyre.

#### **Historia e televizionit në disa pika:**

• 1939 transmetimi i parë televiziv (ShBA)  
 • 1945 në ShBA kishte 8 stacione TV dhe 8 000 shtëpi me aparate TV  
 • 1955 100 kanale TV dhe 35 milionë shtëpi me TV aparate (67 % e amerikanëve)  
 • Marshall McLuhani dhe qëndrimi i tij ndaj TV-së  
 • Programet e viteve '50 përbëheshin nga:  
 - Lojërat televizive  
 - Ngjarjet sportive  
 - Intervistat  
 - Disa komedi dhe drama  
 • Në fund të viteve '50 u prezantua TV me ngjyra. Vetëm rrjetet e forta transmetonin program 2-3 orë me ngjyra  
 • 1953 - dy Langët dhe transmetimi direkt TV.  
 • Në fillim të viteve '60 rreth 95 % e amerikanëve kishin televizorë shtëpiakë  
 • Në vitet '60 shfaqet gazetaria televizive  
 • Në vitet '70 rritet shqetësimi i publikut për ndikimin negativ të TV-së te audienca, kryesisht te fëmijët. Hulumtimet

rezultojnë me një ndërlidhje midis TV-së dhe kimit të rinjve  
 • Në fillim të viteve '90 u shfaq TV satelitorë  
 • Në fund të viteve '90 u shfaqen TV kabllorë: në vitin 2000, 68% e amerikanëve ndiqnin TV kabllorët.  
 • **TV në epokën digjitale:**  
 - 17 shkurt 2009 në SHBA kalohet nga transmetimi analog në atë digjital;  
 - Përpërësitë e transmetimit digjital;  
 - Në vitin 2015 në Kosovë kalohet nga transmetimi analog në atë digjital.  
 • TV interneti  
 • TV celular  
 • Stacionet komerciale dhe stacionet jo-komerciale  
 • Televizionet publike  
**Pronësia**  
 • NBC Universal (pjesë e General Electric)  
 • ABC (zotërohet nga Walt Disney Company)  
 • Fox (News Corporation e Rupert Murdokut)  
 • Bertelsman Grup në Europë.

Histori në disa pika e radios që nga zbulimi i saj:  
 • 1887 Heinrich Hertz zbuloi emetimin e valëve  
 • LPB-Marina Amerikane bleu të gjitha licencat e radiove dhe i përdori për qëllime ushtarake  
 • Rreth viteve të '20-ave radiostacionet u popullarizuan te audienat  
 • 1926 radioja punon me energji elektrike dhe stacionet gjenden me dy butona  
 • 1926 emetimi i programit në rrjet e bëri më të famshme radion. (Rrjeti i parë: National Broadcasting Company, NBC)  
 • 1925-1930 u shitën në SHBA 17 milionë radio-aparate. Radio u bë medium masiv  
 • 1937 NBC kishte 111 radiostacione, ndërsa CBS kishte 105 radiostacione  
 • Shpikja e FM- ngritja e cilësisë së zërit (AM kishte hapësirë më të gjerë, por cilësi më të dobët)  
 • Radioja digjitale:  
 - Radioja në uebsajt  
 - Radioja high definicion (hd)  
 - Radioja satelitore: radioja XM ka ofruar shërbime digjitale të radios për makinë me




Gazetaria audio-vizuale

#### Regjistrimi i tingullit

- 1877 Tomas Edisoni regjistroi fjalinë: "Meri ka një qengj të vogël" - fonografi
- Chinchester Bell e avancoi këtë teknologji - grafoni
- Emile Berliner shpiku diskun dhe e quajti aparatën gramafon
- Në fillim regjistroheshin vetëm fjalimet. Kur u zbulua regjistrimi i muzikës, biznesi i gramafonave u rrit
- 1890 kishte në treg pajisje që regjistronin zërin dhe kishin teknologjinë play back (kthim prapa të shiritit)
- "Gramafoni një peni": Nickelodeons (jukebox i parë)
- 1914: 27 milionë regjistrime në disqet e gramafonit
- 1919: 107 milionë regjistrime disqesh
- 1926: doli në treg një përzierje radio-gramafon.
- Perëndimi i disqeve të gramafonave me zbulimin e CD-ve, MP3-ve, muzikës në telefona etj

Teknologjia si zgjatim i vetvetës



**Gazetaria digjitale** është shpikje e gjysmës së dytë të shekullit XX. As emri i saj nuk është i stabilizuar: përveç gazetari digjitale, përdoren edhe emërtime si gazetari on line, gazetari 2.0, gazetari e internetit etj. Ajo realizohet nëpërmjet shkrimit digjital (në kompjuter, kamerë, telefonat e mençur mobilë) dhe internetit. Audiencia e merr lajmin nëpërmjet shkrimit digjital, në uebfaqe apo në adresën e tyre elektronike. Ky është më shumë lajm interneti, edhe pse edhe televizionet japin lajme digjitale, në teletext ose në fund të ekranit televiziv, në një shirit të kufizuar. Kohët e fundit lajmet e internetit shoqërohen edhe me fotografi apo edhe me film. Gazetari dhe audiencia qëndrojnë në distancën më të afërt të mundshme në procesin e komunikimit gazetar: audiencia e dëgjon dhe e shikon imazhin e lajmit dhe të gazetarit, mund të shkruajë komente të tij mbi lajmin, mbi gazetarin apo mbi diçka që ndërlidhet me lajmin, e në disa raste mund të bëhet bashkautor i lajmit duke shtuar diçka në të apo duke dhënë një informatë më të re të rëndësishme për lajmin, madje mund t'i presë dhe komentet e marrësve të tjerë apo edhe të vet gazetarit autor. Kështu, gazetari dhe audiencia krijojnë një rreth të komunikimit me qendër lajmin e dërguar, ku ata i dërgojnë njëri-tjetrit, apo duke përfshirë në këtë rreth një numër të madh të marrësve, ata të gjithë mund t'u dërgojnë të gjithëve komente apo mesazhe të ndryshme.

Kjo është shkalla e bashkëveprimit në procesin e komunikimit gazetar, në të cilën gazetari-mediumi-audiencia bëhen bashkëveprues në të njëjtin qëllim: lajmin.



### I.2.B. TIPOLOGJIA SIPAS KOHËS SË BOTIMIT

Koha kur botohet një gazetë është një faktor tjetër i jashtëm që ka ndikuar në tipologjinë e gazetarisë. Koha kur botohet një gazetë, në mëngjes apo në mbrëmje, një herë në ditë apo një herë në javë, një herë në muaj apo një herë në vit, sado duket se nuk është ndonjë faktor me rëndësi, përsëri ka një ndikim të madh në profilin e gazetës dhe në aspekte të tjera veçuese të saj. Të marrim shembullin e një gazete ditore dhe një javoreje: gazeta ditore interesohet për lajmet e fundit, për atë që ndodh në 24 orë, ndërsa revista javore për zhvillimet javore; gazeta ditore mbizotërohet prej lajmeve e raporteve, ndërsa revista javore mbizotërohet prej analizave, komenteve dhe disa llojeve të tjera zhanrore si: reportazhi, dosja, udhëpërshkrimi etj.; gazeta ditore interesohet edhe për tema të vogla, sidomos gazetat lokale, edhe për tema efemere (si është, p.sh., një pusët e pambuluar në rrugë), ndërsa revistat javore interesohen vetëm për tema të mëdha e të rëndësishme. Dallimet midis këtyre dy llojeve të gazetave shkojnë edhe më tej, deri në gjuhën, stilin dhe diskursin e përdorur. Kështu, koha kur botohet një gazetë nuk është një çështje e thjeshtë, por një faktor që ndikon në profilin e, deri edhe në strukturat e tekstit dhe të diskursit gazetar.

Nuk mund të botohen tekstet e njëjta apo të ngjashme në një gazetë ditore dhe në një gazetë javore. Në ditore botohen lajme, raporte, artikuj etj., pra shkrime që anojnë kah lajmi, ndërsa në një javore apo në një mujore botohen shkrime që anojnë kah analizat, reportazhet, fejtoret, esetë etj. Kjo tipologji imponon një klasifikim të temave dhe një klasifikim të zhanreve e të llojeve gazetare që do të prezantohen. Jo vetëm kaq. Le të marrim shembull një lloj të shkrimit: kryeartikullin. Gazetat ditore gjithmonë kanë një kryeartikull, i cili është shkrimi kryesor i numrit dhe i cili i jep ngjyrën dhe tonin gazetës. Statusi i këtij kryeartikulli lëviz ndërmjet rubrikës dhe zhanrit, por ai mund të jetë edhe një lajm, një raport, një analizë e, shumë rrallë, edhe një lloj tjetër zhanror. Teksti i kryeartikullit është një i tërë e shumë rrallë, vetëm kur ka ngjarje të jashtëzakonshme, si zgjedhjet kombëtare, ndonjë festë e madhe kombëtare etj., ai mund të jetë tërësi e dy e më shumë artikujve. Ndërsa në revistat (gazetat javore

Koha kur botohet një gazetë, në mëngjes apo në mbrëmje, një herë në ditë apo një herë në javë, një herë në muaj apo një herë në vit... ka një ndikim të madh në profilin e gazetës dhe në aspekte të tjera veçuese të saj.

#### Histori e revistave në disa pika:

- Kuptimi i fjalës "revistë" në periudhën koloniale në Amerikë: një objekt shtëpiak, një depozitë me materiale të ndryshme të mbledhura nga libra a nga gazeta, të cilave u kthehesh kohë pas kohe për lexim.

- 1741 - dy revistat e para amerikane: **American Magazine** dhe **General Magazine**.

- 1824 - në periudhën e shtypit të lirë revista **Gray's Magazine**, nën drejtimin e Edgar Allan Poes, arriti tirazhin 40 000

#### Koha e lulëzimit të revistave dhe krijimi i modeleve

- 1860 - në ShBA kishte 260 revista

- 1900 - në ShBA kishte 1800 revista

- 1881 Ladie's Home Journal e Cyrus Curtis, në 8 faqe, kishte këta artikuj:

- Tregim i shkurtër i ilustruar
- Artikull për mirëritjen e luleve

- Shkrime për modën
- Këshilla për mbarëritjen e fëmijëve

- Modele për punime dore
- Receta gatimi.

- 1970 revistat digjitale
- Revistat e specializuara (për një fushë të caktuar, p.sh., për automobilat, për teknologjinë informative, për turizmin e një vendi etj.)
- Revistat akademike dhe të kritikës letrare



*Foreign Policy*, versioni shqip  
(ISSN 0015-7228, September-Oktober 2009, Iss. No. 174)

Fotoreportazhi "Eyewitness/  
Kosovo" (Dëshmi okulare:  
Kosova), përgatitur nga  
Alexandra Boulat

apo mujore), të cilat, po ashtu, kanë kryeartikullin, ky i fundit pothuajse gjithmonë është një tërësi e dy e më shumë artikujve gazetarë. Te revista kryeartikulli është një temë bosht, zakonisht është tema bosht e numrit. Çdo numër i revistës synon ta ketë një temë bosht (ose më shumë tema bosht), e cila trajtohet nga disa aspekte. Revista *Foreign Policy*, versioni shqip (ISSN 0015-7228, September-Oktober 2009, Iss. No. 174), ka për temë bosht naftën dhe kjo temë është trajtuar nga disa artikuj e në disa aspekte. Në ballinën e revistës është shkruar titulli i temës (me shkronja më të mëdha se emri i revistës):

## NAFTA

### Lamtumira e gjatë

Në paravijën e një fotografie paraqitet një tërësi gypash të naftës në vendosje. Gypat janë made in shtetet perëndimore, ndërsa natyra është një shkretëtirë, e cila asocion në vendet arabe, të pasura me naftë. Brenda revistës janë këta artikuj që trajtojnë temën e naftës:

1. fq. 1: "Epoka e naftës, prej 150 vjetësh" (editorial i redaktorëve)
2. fq. 2-3: paraqitet përmbajtja me temat për naftën, shoqëruar me një fotografi
3. fq. 25: fillon seria e shkrimeve për naftën.
4. fq. 26-35: "Është ende numri një!"
5. fq. 36-39: "Mbyllja e rubinetit"
6. fq. 40-41: "Mos u bëj i vrazhdë"
7. fq. 42: "Kushtet e lojës" (nga Valerie Marcel)
8. fq. 43: "Karburanti në ngushticë" (nga Eugen Gholz)
9. fq. 43: "Krizat e ardhshme të furnizimit" (nga Fatih Biro)
10. fq. 44-52: "Opera e naftës-jellësit të madh" (nga Daniel Freifeld)
11. fq. 54-63: "Çfarë vjen pas? Le ta përfytyrojmë një botë pa naftë". Ky titull është parafjalë e dy artikujve:
  - "Shtatë mite rreth energjisë alternative" (nga Michael Grunwald)
  - "A është një botë më e gjelbër më e sigurt? Jo domosdoshmërisht" (nga David J. Rothkopf)
12. fq. 64-73: "Jashtëqitjet e Djallit" (nga Moises Naim, kryeredaktor)

Prej 74 faqeve të këtij numri të FP, 39 faqe i kushtohen temës bosht, pa e llogaritur ballinën, 6 faqe janë reklamë e plotë, kurse 29 faqet e mbetura u kushtohen temave të tjera të numrit. Ndërsa revista e famshme *National Geografik* (vol. 197, no 2, February 2000), përveç kryetemes (*Orphan Gorillas/Fighting to survive in the Wild*), ka edhe një temë kryesore të numrit për shqiptarët, Shqipërinë dhe Kosovën. Kjo temë paralajmërohet në ballinë, ndërsa është vendosur në faqet 52-83. Artikulli i parë është *Albanians: a People undone* (Shqiptarët: një popull i pabërë), përgatitur nga Priit J. Vesilind

(teksti) dhe Alexandra Boulat (fotografia). Ndërsa artikulli i dytë është një fotoreportazh me titull *Eyewitness: Kosovo* (Dëshmi okulare: Kosova), përgatitur nga Alexandra Boulat. Kësaj teme i është bashkëngjitur edhe një shtojcë me titull *The Balkans*, e ku është një hartë e madhe etnike e politike e Ballkanit, e shoqëruar me tri harta të tjera të Ballkanit: në Perandorinë Otomane, në Luftën e Parë Botërore dhe në Luftën e Dytë Botërore. Të gjitha hartat janë të plotësuara anash me shënime për përbërjen etnike të Ballkanit në periudhat e përmendura. Në anën e pasme të shtojcës është dhënë një tablo e gjerë e problemit të refugjatëve në botë (*Plight of the Refugees*), me shënime statistikore.

Herë të tjera revistat ia kushtojnë gjithë numrin temës bosht. Kjo ndodh zakonisht në ndonjë përvjetor, apo nëse tema vërtet paraqet interes global. Revista *National Geografik* (vol. 195, no 2, February 1999) tërë numrin ia kushton vetëm temës së biodiversitetit në Tokë, me rastin e vitit të mileniumit 2000. Në ballinë është paralajmëruar tema me titullin *Biodiversity: The Fragile Web* dhe kësaj teme i kushtohen 145 faqe (pa llogaritur reklamat dhe ballinën), me dhjetëra tema të ndryshme të ndërlidhura drejtpërdrejt me temën bosht. Revista e ka edhe një shtojcë me titullin *Diversity: Milenium in Maps*.

Në përfundim të shqyrtimit të rolit të kohës kur botohet gazeta në vetë natyrën e teksteve gazetare dhe të gazetarisë, duhet të konstatojmë se, sado nuk e ka rëndësinë e tipologjisë sipas faktorit medium, tipologjia gazetare sipas kohës kur botohen gazetat paraqet një qasje me interes në studimet e gazetarisë.

Mbi këtë faktor tipologjik dallohen:

- gazeta ditore (shqip quhet edhe *ditore*; në traditën shqip janë quajtur edhe *fletore*)
- gazeta e mbrëmjes
- gazeta javore (shqip quhet edhe *javore*, por edhe *revistë*), me variantet (njëjavore, dyjavore etj.)
- gazeta mujore (shqip quhet edhe *mujore* apo *revistë*), me variantet (dymujore, tremujore etj.)
- gazeta vjetore (shqip *vjetar*).

Në bazë të emërtimit të tipit të gazetës, i cili tregon kohën, këta tipa të gazetave dallojnë parësisht për shkak të kohës kur botohen. Ditoret botohen çdo ditë dhe mund ta kenë versionin e mëngjesit (botohen në mëngjes) dhe atë të mbrëmjes (botohen në mbrëmje), javoret dhe mujoret (quhen edhe revista) botohen në javë apo në muaj, e ka të atilla që botohen edhe në çdo 15 ditë, ndërsa vjetoret janë zakonisht vjetarët e institucioneve të ndryshme të shkencës e të kulturës. Këta të fundit, vjetarët, janë dy llojesh. I pari është revistë

*National Geografik* (vol. 195, no 2, February 1999) tërë numrin ia kushton vetëm temës së biodiversitetit në Tokë, me rastin e vitit të mileniumit 2000

- gazeta ditore  
- gazeta e mbrëmjes  
- gazeta javore  
- gazeta mujore  
- gazeta vjetore

Revista "Gjurmime  
albanologjike"



Revista "Media"



shkencore (i njohur si *journal*). Institucionet shkencore dhe akademike kanë revistat e tyre vjetore shkencore në të cilat botojnë të arriturat shkencore të anëtarëve të tyre apo edhe të të tjerëve. E tillë është revista *Media*, të cilën e boton Dega e Gazetarisë e Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, revista *Gjurmime albanologjike* e Institutit Albanologjik të Prishtinës etj. Shumica e këtyre revistave, edhe pse quhen vjetarë (si trashëgimi), dalin më shumë se një herë në vit. Tipi i dytë i vjetarëve janë revista të institucioneve të ndryshme të cilat përmbledhin punën e tyre vjetore dhe e botojnë në një revistë.

## PËRJASHTIMI NGA KJO TIPOLOGJI

Ndryshe nga gazetaret, një tipologji e tillë e gazetarisë nuk vlen edhe për gazetarinë radiotelevizive, sidomos jo për atë "on line". Edhe në gazetarinë televizive ka lajme të mëngjesit, të mesditës e të mbrëmjes, por ato janë rubrika lajmesh e emisionesh të ndryshme, po jo edhe tipa të veçantë gazetarie, prandaj edhe nuk duhen trajtuar si të tillë. Ndërsa në gazetarinë digjitale njeriu e ka mundur konceptin kohë të gazetarisë: aty lajmet redaktohen çdo çast, më e shumta çdo orë. Thjesht, nuk ka kohë të lajmit: lajmi është i minutës së fundit dhe gara midis agjencive të ndryshme të lajmeve dhe medieve të fuqishme nuk është ora, por minuta. Lajmi i një agjencie mund të jetë një minutë apo disa minuta para agjencive të tjera dhe kjo është fitorja e agjencisë së parë. Si shihet, faktori kohë në gazetarinë e shtypur luan rol tipizues, ndërsa në gazetarinë e folur, të shikuar dhe atë digjitale, vetëm merr pjesë si element (shpejtësia e lajmit) në procesin e komunikimit gazetar.



### I.2.C. TIPOLOGJIA SIPAS PROFILIT SOCIAL, POLITIK DHE PROFESIONAL

Një faktor tjetër tipizues për gazetarinë është profili social, politik e profesional i gazetës. Meqenëse emërtimi “profil social, politik e profesional” nuk është togfjalësh standard, duhet ta sqarojmë. Në rrethin social të komunikimit gazetar, si do të shohim më tej, audiencia, edhe nëse nuk është faktori më i rëndësishëm, mban pozitën e mbretit: gjithë procesi i komunikimit gazetar bëhet për audiencën. Çdo element i gazetarisë moderne bëhet për audiencën. Nga ky prizëm dhënësi dhe marrësi, sipas modelit të procesit të komunikimit Shannon-Weaver (1947-'49)<sup>10</sup> nuk janë të barabartë, sepse dhënësi, mediumi, tregu dhe të gjithë faktorët e tjerë i nënshtrohen mbretit - marrësit (audiencës). Por, në çastin kur gazeta vendos ta zgjedhë audiencën, e kjo do të thotë të përcaktojë se cila audiencë është e gazetës e cila jo, cili grup social a grup profesional është audiencia e saj, apo së pakut gazeta i përkushtohet atij grupi social e profesional, atëherë krijohet ajo që quajtmë profil social, politik e profesional i gazetës.

Si e zgjedh gazeta audiencën? Në fakt, ky është një proces i dyanshëm: një gazetë trajton tema që janë me interes të madh për një grup social a profesional, ose një grup social apo profesional nxjerrin gazetën e cila trajton temat që janë me interes për ta. Në të dy rastet përfundimi është i njëjtë, nga aspekti gazetar: një gazetë, në vend se t'i shërbejë audiencës së gjerë, i shërben një audiencie të specializuar, qoftë ajo sociale, politike apo profesionale. Një shkollë e mesme e ka gazetën e saj në të cilën nxënësit, arsimtarët dhe ekspertët e tjerë që punojnë në shkollë apo me shkollën, botojnë tekste të natyrave të ndryshme, por që janë të lidhura veçanërisht me shkollën që nxjerr gazetën. Po kështu, grupi i poetëve të rinj ka vendosur ta ketë gazetën e tij, në të cilën boton tekstet letrare të anëtarëve dhe të rrethit të tyre. Në të dy rastet, gazeta është e një profilit të caktuar: në rastin e shkollës, gazeta është e profilit shkollor, ndërsa në rastin e poetëve, gazeta është e profilit të ngushtë letrar të një grupi të poetëve. Zakonisht profili social, politik e profesional i gazetës afishohet në ballinë, menjëherë mbas emrit të gazetës, por edhe nëse nuk afishohet, vetë përmbajtja e gazetës e profilizon atë në aspektin social e profesional. Edhe gazetatat e profilit politik e theksojnë orientimin e tyre, ndërsa është shumë keq kur ato e shpallin veten të pavarura ndërsa bëjnë punën e një grupimi politik.


Mbi këtë faktor tipologjik ka shumë tipa të gazetarisë dhe është e panevojshme t'i përmendim të gjitha (nëse mund t'i përmendim të gjitha!), po përmendim vetëm disa tipa sa për ta kuptuar thelbin e kësaj tipologjie:

Audiencia, edhe nëse nuk është faktori më i rëndësishëm, mban pozitën e mbretit: gjithë procesi i komunikimit gazetar bëhet për audiencë

Si e zgjedh gazeta audiencën?

Gazetat partiake? Disa e theksojnë përkatësinë e tyre partiake (dhe kjo është në përputhje me etikën gazetare), por ajo që nuk është në përputhje me etikën gazetare është fshehja e përkatësisë partiake e një gazete!

*Bujqësia shqiptare*, revistë e Ministrisë së Bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit e Republikës së Shqipërisë.



- Grupimet e ndryshme politike botojnë gazetat e tyre dhe ato mbrojnë interesat politike të grupimit. Në këto raste interesi parësor për informim i nënshtrohet interesit politik të grupimit. Kjo vërehet shumë jo vetëm në editorialët, por edhe te kryeartikujt dhe te politikat e zgjedhjes së lajmeve. Në shqip më të njohura janë *Zëri i popullit* (organ i Partisë Socialiste të Shqipërisë) dhe *Rilindja demokratike* (organ i Partisë Demokratike të Shqipërisë). Këto gazeta janë të dy grupimeve kryesore politike: e majta dhe e djathta. Ka disa gazeta në Kosovë të cilat nuk e theksojnë partishmërinë e tyre si: *Express*, *Epoka e re*, *Tribuna shqiptare*, *Infopress*, por që këmbë e krye mbrojnë interesin e Partisë Demokratike të Kosovës dhe të qeverisë kur ajo udhëhiqet nga kjo parti. Fati i *Infopress*-it është më ilustrues: derisa pronarët e saj ishin në vijë me PDK-në dhe qeverinë e saj, gazeta ishte një fanatike e pashoqe e partisë dhe e qeverisë, ndërsa kur pronarët e saj i ngatërruan marrëdhëniet me partinë dhe qeverinë, gazeta u bë një kritikuese e partisë dhe qeverisë. Gazeta të tjera ndjekin agjendat politike të individëve, si *Koha ditore* dhe *Grupi Koha*, që ndjekin agjendën politike të pronarit të tyre, Veton Surroit.
- Sindikatat kanë zhvilluar gazetat e tyre, të cilat, pavarësisht nga emri, nëntitullohen “gazetë sindikale”. Këto gazeta mbrojnë interesin sindikalist dhe afishojnë të drejtat e punëtorisë.
- Bujqit (fermerët) kanë gazeta të tyre që nëntitullohen “gazeta bujqësie”. Ato trajtojnë tema nga bujqësia, nga përvojat individuale të bujqve apo tema shkencore teorike të bujqësisë, ndërsa në aspektin politik mbrojnë interesat e bujqve. Në shqip është e njohur revista *Agmia*, të cilën e boton Ministria e Bujqësisë, Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural dhe mbron politikat e Ministrisë së Bujqësisë.
- Ka gazeta që trajtojnë vetëm çështje ushtarake dhe të teknikës luftarake dhe ato nënquhen “gazeta ushtarake”.
- Ka gazeta që botohen vetëm për nevojat e një lokaliteti dhe ato nënquhen “gazeta lokale”. Në çdo shoqëri të zhvilluar, në shekullin XX, ka përplot gazeta të tilla lokale, në të cilat grupet më marginale të shoqërisë afishojnë prirjet dhe jetën e tyre të përditshme dhe mbrojnë interesat e tyre.
- Mbi këtë parim tipologjik mund të përmendim: gazeta urbane, gazeta për shëndetësi, gazeta shkencore, gazeta për matematikë, gazeta për kuzhinë, gazeta për femra, gazeta për muzikë, gazeta zbavitëse etj.



"Zëri i popullit", gazetë e Partisë Socialiste të Shqipërisë

Nga tipologjia e mësipërme shihet se përcaktimi i një gazete për një gamë të kufizuar temash që dëshiron të trajtojë ndikon përfundimisht në tipizimin e saj social, politik e profesional. Nëse një gazetë përcaktohet të merret vetëm me tema nga jeta urbane atëherë ajo ka një profil social urban

dhe është gazetë urbane. Nëse një gazetë përcaktohet që më parë të trajtojë vetëm tema të jetës së njeriut e të natyrës kudo në botë, si është *National Geographic*, atëherë ajo është profilizuar në aspektin profesional dhe është gazetë shkencore.

Një problem më vete, të cilin nuk do ta diskutojmë këtu, por nuk duhet të kalohet pa u theksuar, është fakti se nuk mund të përcaktohet saktësisht në është profili social, politik e profesional një faktor i jashtëm apo i brendshëm tipologjik, apo është një ngjizje e dyanshme. Nëse një medie përcaktohet të ketë një profil të caktuar social, politik apo profesional, atëherë ky do të vepronte si faktor i jashtëm. Por, ky faktor i jashtëm tipologjik a mund t'i paragjykojë dhe t'i kushtëzojë esencat e gazetarisë? Një gazetë e tillë detyrohet t'i afishojë dhe t'i mbrojë interesat e grupimit për të cilin është përcaktuar dhe interesit të grupimit duhet t'ia përshtatë edhe politikat redaktuese, tekstet gazetarë etj. Si pasojë, tekstet gazetarë i përshtaten interesit të këtij faktori të jashtëm tipologjik dhe shkruhen kryesisht për temat apo nga prizmi i profilit identifikues. Në fund, gazeta jo vetëm që afishon profilin e saj social, politik apo profesional, por edhe vetë esencat e gazetarisë në atë gazetë i nënshtrohen atij faktori tipologjik. Kështu, nuk mund të thuhet me siguri të plotë se profili social, politik e profesional në gazetari është vetëm faktor i jashtëm tipologjik.




"Rilindja Demokratike", gazetë e Partisë Demokratike të Shqipërisë

## 1.2.D. GAZETA ZYRTARE DHE FLETË TË VERDHA (TË ARTA ETJ.)



Fletë të verdha të Auckland-it (Islanda Veriore në Zelandë të Re), 2004



Një grupim më vete, sado i ndërlidhur me këtë faktor tipologjik, janë edhe dy tipa të gazetave: Fletë të verdha dhe Gazeta Zyrtare. Gazeta e tipit *Fletë të verdha* (në disa vende quhet edhe me emra

të tjerë, si Fletë të Artat) është tip i gazetës informuese (jo lajm, vetëm informacion) për një qytet, për një shtet apo për një strukturë të caktuar sociale, për shembull për biznes. Këto nuk janë gazeta të rregullta, më shumë i ngjajnë një libri të informacioneve që botohet një herë në vit dhe në çdo botim përditësohet, e vitet e fundit botohet edhe në versione elektronike. Kështu, kemi *Fletë të verdha të Prishtinës*, *Fletë të verdha të Tiranës*, *Fletë të arta të Shkupit etj.* Në këto gazeta futet gjithçka që ekziston (nëse mundet!) në qytetin apo në profilin e caktuar për të cilin shkruhet e që është me interes për publikun. Gazeta priret të jetë një lloj adresari: aty jepen të dhëna që mund ta orientojnë një qytetar se si të gjendet në qytetin apo në strukturën e caktuar sociale.

Shihni këto uebfaqe:  
[www.faqeteverdha.biz](http://www.faqeteverdha.biz)  
[albanianyellowpages.com](http://albanianyellowpages.com)  
[www.fletetearata.com](http://www.fletetearata.com)

Secilin ligj, akt nënligjor a vendim të Presidentit të Kosovës, të Kuvendit të Kosovës dhe të qeverisë apo të agjencive qeveritare e gjeni në Gazetën Zyrtare:  
<http://gzk.rks-gov.net/>



Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës (ballina, letër). Të njëjtën mund ta gjeni edhe në adresën elektronike (burimi: <http://gzk.rks-gov.net/>)

Gazeta Zyrtare është një tip krejt i ndryshëm nga të tjerat, sepse ajo shërben jo vetëm si një medium ku qeveria boton ligjet, nënligjet dhe vendimet e veta, por në shumë shtete shërben edhe si mekanizëm kushtetues për fuqizimin e ligjeve apo të akteve nënligjore. Kështu është edhe në Republikën e Kosovës: neni 80, pika 6 e Kushtetutës së Kosovës e rregullon këtë çështje. Si shihet, Gazeta Zyrtare është një lloj gazete-dokument zyrtar i një shteti.

## II. TIPOLOGJIA ZHANRORE: FAKTORËT E BRENDSHËM TIPOLOGJIKË

**T**eorja e zhanrit gazetar qëndron në dy degë: si pjesë e teorisë së gazetarisë dhe si pjesë e teorisë së zhanrit. Kjo nuk e komplikon atë, përkundrazi e qartëson më shumë. Shumë parime e elemente të teorisë së gazetarisë vlejné edhe për teorinë e zhanrit gazetar. Për shembull, dilemat midis një teorie përshkruese apo normative janë të njohura në teorinë e gazetarisë. Edhe në teorinë e zhanrit gazetar nuk mund të krijohet një teori normative sepse, për shkak të ndryshimeve të shpejta në procesin e komunikimit gazetar, cilat do qofshin ato, asnjë teori normative nuk do t'i mbushte dhjetë vjet. Ose, qasja a posteriore në teorinë e gazetarisë është kuptimplote në teorinë e zhanrit gazetar: teoria e zhanrit ecën prapa tekstit apo diskursit gazetar dhe synon t'i përshkruajë e t'i përkufizojë ato. Në anën tjetër, shumë parime e elemente të teorisë së zhanrit vlejné edhe për teorinë e zhanrit gazetar. Për shembull, qasja taksonomike në teorinë e zhanrit. Kjo qasje ka qenë aq e fuqishme jo vetëm në teorinë e zhanrit, po në të gjitha shkencat humaniste, saqë gjithë dija akademike në Mesjetë e deri te romantizmi është mësuar dhe trashëguar vetëm brenda kornizave taksonomike. Kjo është një prej qasjeve më të padëshiruara në teorinë moderne të zhanrit dhe e njëjta vlen edhe për teorinë e zhanrit gazetar.

Njëjtë është edhe me parimin e *dinamizmit* në teorinë e zhanrit dhe e njëjta vlen edhe për zhanrin gazetar. Nacionin dinamizëm mund ta përafrojmë me nocionin më të njohur në shkencat humaniste, *historizmi*, të cilin e ka përkufizuar esteti i romantizmit, Fridrih Shlegel. Historizmi ka hapur perspektivën e të shikuarit të shfaqjeve sociale në mënyrë diferenciale. Një fakt kulturor është prodhim i një situate të caktuar sociale dhe nuk është absolut dhe për të gjitha situatat, si mendohej në klasicizëm. Nga këtu kanë lindur teoritë moderne që e vënë në qendër të vëmendjes lexuesin (teoritë e recepcionit), sepse lexuesi i përket një situate të caktuar historike dhe ai e interpreton një tekst të dhënë jo domosdo njësoj me një lexues tjetër. Këtë kuptim të përafërt ka edhe nocioni i dinamizmit: zhanri është prodhim i një situate të caktuar sociale dhe zhanri nuk është një shfaqje statike, por një shfaqje historike. Kjo e fundit do të thotë se zhanri zhvillohet, ndryshon dhe format e dhëna të një zhanri nuk janë absolute, por transformohen dhe krijohen zhanre të tjera.

Edhe teoria e zhanrit gazetar duhet të kuptohet brenda këtyre kornizave: zhanri gazetar është prodhim i një situate të caktuar historike dhe sociale, nuk është një shfaqje absolute. Zhanri gazetar

### PËRMBAJTJA

II. Tipologjia zhanrore: faktorët e brendshëm tipologjikë. . . . .	41
II.1. Një shikim në retrovizor për teorinë e zhanrit . . .	44
II.2. Teoria e zhanrit në gazetar . . . . .	46
II.3. Zhanri i tekstit gazetar: struktura dhe qëllimi përmbajtjesor i tekstit gazetar . . . . .	47
II.3.a. Struktura e tekstit gazetar . . . . .	50
II.3.b. Qëllimi përmbajtjesor i tekstit gazetar. . .	53

Parimi i dinamizmit të zhanreve

është një shfaqje që lëviz, ndryshon formë dhe brendi, transformohet e, në anën tjetër, edhe teoria e tij duhet t'i shohë nga ky aspekt dhe nuk mund t'i përkufizojë njëherë e mirë, por duhet ta ndjekë tekstin gazetar dhe t'i përkufizojë zhanret në secilën situatë të dhënë, varësisht nga diskursi dhe rrethi social ku krijohet ai zhanër. Kjo është një qasje moderne në teorinë e zhanrit gazetar, e cila e ndihmon gazetarinë, gazetarin apo pjesën akademike, studentët dhe profesorët, por asnjëherë nuk mëton të jetë një kornizë që konservon proceset zhanrore. Megjithatë, duke qenë një shkencë që duam ta përshtatim në gazetari, teoria e zhanrit gazetar merr disa veçanti dhe tipare, dy prej të cilave duhet t'i diskutojmë tashti.

Dallon zhanri nga rubrika

Çështja e parë ka të bëjë me **zhanrin** dhe **rubrikën**. Në praktikën dhe në librat teorikë e akademikë të gazetarisë shfaqet një ngatërrim i zhanrit me rubrikën. Kështu, Angela Phillips, në librin e saj *Good writing for Journalists*<sup>11</sup>, brenda tipologjisë zhanrore fut edhe gazetarinë e artit, sportit dhe muzikës. Gazetaria e artit, ajo e sportit dhe e muzikës mund të klasifikohen sipas faktorit të profilit social, politik e profesional, por nuk mund të qëndrojnë në të njëjtën shkallë klasifikimi me raportin, i cili tipizohet si i tillë mbi kritere të tjera, përkatësisht në bazë të strukturës së tekstit dhe qëllimit përmbajtjesor. Gazetaria për artin dhe kulturën, ashtu sikurse çdo gazetar, përbëhet prej lajmit, raportit, komentit, editorialit, fejttonit, esesë etj. Mund të ketë gazetar që informon për artin e kulturën, apo gazetar që komenton për artin e kulturën, njësoj sikurse në çdo gazetar. Gazetaria për artin e kulturën është si çdo gazetar tjetër, me të vetmin dallim se është e profilizuar për një fushë të caktuar sociale, për artin e kulturën. Njëjtë është edhe me gazetarinë e sportit dhe atë të muzikës, mund të shtojmë ne, edhe me gazetarinë ekonomike, me gazetarinë feministe, me gazetarinë sindikaliste etj., të cilat tashmë i kemi trajtuar në pjesën për profilin social, politik e profesional të gazetarisë. Në të gjitha rastet, pra, kemi të bëjmë me një profil të gazetës, por jo me një zhanër. Po ashtu, pjesa e gazetës informative që boton faqe të sportit, të artit e të muzikës, nuk jep bazë për t'i quajtur këto faqe zhanër. Faqet e sportit, të artit e të muzikës, mund t'i shtojmë ne edhe faqet e ekonomisë, faqet për femrat, faqet për teknikën digjitale e shumë e shumë faqe të tjera, janë rubrika të gazetës por, jo zhanre. Me këto konstatime nuk duam t'i mohojmë aspak proceset dinamike (historizmi i diskutuar më lart) të krijimit të zhanreve nga rubrikat.

Fejtoni si zhanër është krijuar nga një rubrikë, një e ndarë brenda një faqeje të gazetës, e ndarë me një vijë të trashë, që botohej në gazetën *Le Journal des Debats*, mu në fillim të shekullit XIX, që quhej fejtton, e ku përfshiheshin kronika të ndryshme si ato teatrore, të modës, të shërbimeve publike etj., të shkruara nga kritikë teatror

Historia e fejttonit nga rubrika në *Le Journal des Debats* e deri te zhanri sot



francez Zhofro (1743-1814). I njëjti proces i transformimit është duke ndodhur edhe në kohët e sotme me një rubrikë-zhanër: me kolumnën. Deri në vitet e fundit as që është vënë në pyetje se kolumna është rubrikë. Kolumna, në përshkrimin teorik të fjalës, është një rubrikë e rezervuar për një autor të caktuar, i cili boton në të periodikisht tekstet e tij. Kolumna ishte zakonisht një koment, por mund të ishte edhe ndonjë formë më e shkurtër gazetare, si një skicë, një portret etj. Mirëpo, duke qenë për një kohë të gjatë një rubrikë më vete e lidhur ngushtë me individin dhe stilin e tij, kolumna ka fituar veçanti dhe tipare të një zhanri gazetar. Kolumnën, nga ky prizëm, mund ta përkufizojmë si llojin më personal të shkrimit gazetar, që dallon nga komentit etj., mu për shkak të kësaj qasjeje tejet personale të argumentimit. Sot mund të gjesh mendime të ndryshme, të kundërta dhe polemizuese për këtë çështje. Kështu, Đorđe Obradović boton artikullin *Kolumnet nuk janë zhanër gazetar*<sup>12</sup>, në të cilin argumenton se kolumna është rubrikë e jo zhanër. Kështu ka ndodhur edhe me gazetarinë argëtuese: nga disa faqe argëtimi në gazetë është duke u zhvilluar një lloj i veçantë i gazetarisë, mjaft e përhapur dhe e pranueshme për audiencat.

Pavarësisht nga këta shembuj, zhanri dhe rubrika nuk mund të njëjtësohen në asnjë rast. Rubrika ka të bëjë me një pjesë të faqes së gazetës, me formën grafike dhe tekstore të faqeve të gazetës apo me një hapësirë kohore të një medie audio-vizuale të veçuar për një formë të tekstit gazetar, ndërsa zhanri është rezultat i faktorëve brenda tekstit, të ndërlidhur me faktorët socialë.

Çështja e dytë është marrëdhënia **zhanër** dhe **formë**. Nacioni forma gazetar është mjaft i përhapur, por nuk është shumë i qartësuar se çka nënkupton. Mungon një përkufizim i termit nga aspekti gazetar. Ky nocion është përkufizuar në letërsi nga formalistët rusë dhe është vënë në qendër të studimit të veprës letrare. Formë, sipas formalistëve rusë, nënkuptonte gjithçka që nuk ishte përmbajtje, pra, në radhë të parë, mënyrën se si gjuhësisht e strukturalisht është ndërtuar një vepër letrare.<sup>13</sup> Mbi këtë bazë, duke kuptuar formën si një strukturë e organizuar e një ligjërimi, me nocionin *forma gazetare* nënkuptojmë formën që merr një tekst gazetar në gazetë. Elementet e formës mund të jenë gjatësia e tekstit, vendi i titullit apo i pjesëve të tjera të tekstit në hierarkinë e tekstit, tipografia e tekstit (me çfarë shkronja është shkruar) apo edhe grafia e tekstit (disa tituj shkruhen mbi tekst e disa anash, disa gazeta e shkruajnë në font shumë të madh shkronjën nistore të tekstit, e disa shkronjën nistore të paragrafit e disa asnjërën nga këto etj.). Pavarësisht nga ky mosqartësim i termit formë, ai është mjaft i përhapur.

Zhanri dhe forma e tekstit gazetar nuk janë të njëjtë. Forma tregon mënyrën e organizimit fizik të një teksti, ndërsa zhanri tregon edhe mënyrën e organizimit strukturor, dhe më shumë se kaq

Kështu, pesëmbëdhjetë teoricienë të gazetarisë, të historisë së medieeve, të mediologjisë, nga vende të ndryshme, nën redaktimin e Marcel Broersmas, botuan librin *Form and Style in journalism. European Newspapers and the Representation of News, 1880-2005*, si pjesë e një projekti më të gjerë me emrin *Cultural Change: Dynamics and Diagnosis*, duke i dhënë nocionit formë së paku në dy kuptime: një, si formë teksti ("genre are textual forms or patterns which organize story" - zhanri është formë apo model tekstual që e organizon ngjarjen) dhe dy, kuptim edhe më të gjerë, që nënkupton format gazetares në përgjithësi, duke përfshirë edhe formatin e profilit e një gazete.<sup>14</sup> Kështu bën edhe Daniel Chandler në *An Introduction to Genre Theory (1997)*<sup>15</sup>, duke i quajtur me nocionin forma një tërësi të caktuar zhanrore (format fikse në gazetari, p.sh.), edhe pse ai e dallon, në vijë me formalistët rusë, përmbajtjen nga forma. Mirëpo, edhe nga ky prizëm, edhe nga prizmi formalist rus, nocioni formë nuk është i njëjtë me nocionin zhanër. Formalistët rusë as që e kanë bërë këtë njëjtësim. Forma ka të bëjë me gjuhën dhe strukturimin e saj dhe me disa elemente tekstuale jashtëgjuhësore, poende mund të thuhet se është një term jashtë përdorimit në teorinë e gazetarisë, përveç rasteve kur përdoret për t'i shënuar format praktike të gazetave dhe profilet e tyre.

## II.1. NJË SHIKIM NË RETROVIZOR PËR TEORINË E ZHANRIT<sup>16</sup>

Esenë e tij *Origjina e zhanreve* (1976) Cvetan Todorov e fillon me mohime dhe pohime ironike të zhanrit:

*Të ngulmosh duke iu dhënë rëndësi të madhe zhanreve, në ditët e sotme, mund të të shkojë mendja se je duke u marrë me diçka të së kaluarës e, ndoshta, edhe me diçka që mund të cilësohet si e padobishme. Në të gjithë e dimë se zhanret tashmë ekzistojnë: që në ditët më të hershme të klasicizmit kanë qenë baladat, odat, sonetet, tragjeditë dhe komeditë, por a thua a ekzistojnë këto edhe sot?*<sup>17</sup>

Në këtë fjali thelbësore Todorovi paralajmëron tri elemente të çështjes zhanër: një, zhanri mund të konsiderohet si një çështje e klasicizmit, që s'ka të bëjë me modernitetin në kulturë e në letërsi, dhe se marrja me të duket si punë e padobishme; dy, pavarësisht nga kjo qasje, zhanri ekziston, u pajtuam apo jo ne, ai zhvillohet edhe sot, sado modernistë që të paraqitemi, prandaj qasja mohuese ndaj zhanrit duket e papjekur dhe; tre, zhanri është dinamik, ai ndryshon, ajo që ka qenë dje nuk është sot, as kjo që është sot nuk

Todorovi paralajmëron tri elemente të çështjes zhanër:  
- një, zhanri mund të konsiderohet si një çështje e klasicizmit;  
- dy, pavarësisht nga kjo qasje, zhanri ekziston, u pajtuam apo jo ne, ai zhvillohet edhe sot;  
- tre, zhanri është dinamik, ai ndryshon, ajo që ka qenë dje nuk është sot, as kjo që është sot nuk do të jetë nesër etj.





Tri elementet që i thekson për zhanrin Cvetan Todorovit

do të jetë nesër etj. Todorovi e nis me këtë fjalë esenë e tij për ta përlligjur në aspektin kulturor marrjen me çështje të zhanrit, edhe pse koha kur teoria e zhanrit ka dominuar në kulturën evropiane, koha e klasicizmit dhe, më herët, e Mesjetës e deri në Antikë, ka përfunduar me romantizmin, sidomos me modernizmin e post-modernizmin. Përfundimisht, zhanret ekzistojnë edhe sot, sado teoria e zhanrit nuk e ka atë rol që kishte më parë, poeude as që mund të flitet për ndonjë taksonomi në cilëndo shkencë humaniste, mirëpo marrja me zhanrin është çështje e mendimit shkencor dhe çështje e akademizmit.

Studimet për zhanrin janë kohësisht të gjata. Zhanri dhe tipologjia zhanrore është një prej çështjeve të përhershme të mendimit teorik e filozofik në shkencat humaniste. Tipologjia, zhanri dhe taksonomia në periudhën klasike dhe skolastike kanë qenë disiplina kryesore shkencore. Prej natyrës së dijes akademike, njeriu provon që objektin e tij njohës ta klasifikojë e ta tipizojë në tipa e zhanre, në lloje e nënllloje, si dhe të krijojë taksonomi për secilin klasifikim. Një proces i tillë e ndihmon mësimin akademik dhe mbamendjen akademike njerëzore deri në atë çast kur një taksonomi e tillë bëhet dogmatike dhe, si e tillë, shndërrohet në penguese e frenuese të njohjeve e të dijeve të reja. Në kohët moderne ka pasur një periu-

dhë irritimi me zhanret, kryesisht nën ndikimin e zhvillimeve në letërsinë postmoderne, por kjo duket se ka mbetur në kufijtë e një maniri letrar, përderisa me teorinë e zhanrit janë marrë emrat më të njohur të shekullit XX në studimet humaniste si Tomashevski, Rene Velek e Ostin Voren, Keneth Burke, Mihael Bahtin, Nortrop Fraj, Zhak Derrida, Cvetan Todorov, Lloyd F. Bitzer, Michael Halliday, Carolyn R. Miller, e shumë të tjerë.<sup>18</sup>

Fjala *zhanër* (ang. *genre*) rrjedh prej frëngjishtes *genre* (kjo nga frëngjishtja e vjetër *gender*; kjo nga latinishtja *genus*) dhe do të thotë gjini. Në shkencën humaniste shqiptare mbizotëron në përdorim nocioni *gjini*, siç janë gjinitë e letërsisë. Edhe shqiptarët e kanë marrë prej latinishtes fjalën *gjini*. Ndërsa në fundshekullin XX në shqip ka hyrë edhe forma franceze *genre* e fjalës latine.

Fjala *zhanër* (ang. *genre*) rrjedh prej frëngjishtes *genre* (kjo nga frëngjishtja e vjetër *gender*; kjo nga latinishtja *genus*) dhe do të thotë gjini. Në shkencën humaniste shqiptare mbizotëron në përdorim nocioni *gjini*, si janë gjinitë e letërsisë. Edhe pse në mendimin teorik për klasifikimet letrare bëhet një dallim midis nocionit *zhanër* e *gjini*, në fakt dallimi i tillë është shumë i hollë dhe i paqartë.<sup>19</sup> Në këtë libër ne do ta përdorim nocionin e traditës franceze *zhanër* për shkak të përdorimit gjithnjë mbizotërues të këtij nocioni në literaturën botërore dhe ai ka kuptimin elementar të *gjinisë*.

## II.2. TEORIA E ZHANRIT NË GAZETARI

Në traditën e akademizmit gazetar ka dy qasje ndaj konceptit *zhanër*. E para, e ndikuar prej fenomenit postmodernist dhe prej teknologjisë informative, e redukton *zhanrin*, ndërsa e dyta çdo shfaqje të veçantë në gazetari e karakterizon si *zhanër*. Të dy qasjet janë të skajshme. Pavarësisht nga mohimi apo pohimi i skajshëm, ekzistojnë disa tekste të ndryshme gazetare, të cilat kanë disa karakteristika të përbashkëta e të veçanta, të dallueshme nga njëra-tjetra. Nuk mund të eliminohen këto dallime, por as do të ishte doli-prurëse. Përkundrazi, përkufizimi dhe mësimi i tyre i ndihmojnë gazetarin, studentin e gazetarisë dhe studiuesin e tekstit gazetar.

Në traditën e gazetarisë evropiane, e fuqishme në shekujt XVIII dhe XIX, ndryshe nga lajmet që sillnin gazetaret e para, enciklopedistët francezë, gazetarët e parë të mëdhenj evropianë, tipizuan disa lloje të para të gazetarisë publicistike, apo si quhet në traditën evropiane, gazetari opinioniste. Në këtë traditë përherë është bërë dallimi i *zhanrit* informativ dhe *zhanrit* opinionist. Baza e *zhanrit* informativ është konsideruar lajmi, ndërsa gazetaria opinioniste është ajo gazetari që synon ta ndikojë dhe ta bindë publikun. Në periudhën e revolucioneve në Evropë, që nga Revolucioni Borgjez Francez e deri në fund të shekullit XIX, lulëzoi gazetaria opinioniste. Partitë politike dhe grupime të tjera politike themeluan gazetaret e tyre me të cilat mundoheshin t'i bindnin lexuesit në drejtësinë e politikave të tyre. Kështu u krijuan shtypi i djathtë dhe i majtë, si dhe shtypi

liberal. Kjo është periudha e editorialëve, e komenteve, e pamfleteve, e polemikave, e fejtoneve dhe e romaneve popullore në gazetarinë evropiane. Në të njëjtën kohë, në gazetarinë amerikane, një gazetari e cila quhej komerciale dhe u nënshtrohej pa përjashtim kërkesave të tregut, lajmi i mbizotëronte të gjitha llojet e zhanret e tjera gazetare dhe tërhiqte pas vetes edhe studime e doracakë shkollorë, të cilët mësonin se si duhej të shkruhej lajmi. Në këtë periudhë zë fill edhe ndarja e studimeve akademike në dy qasje ndaj zhanrit gazetar, me të cilin konstatim e filluam këtë pjesë. Në këto dy tradita, amerikane dhe evropiane, fitoi gazetaria komerciale, gazetaria që u nënshtroa ligjeve të tregut, pra, fitoi tradita gazetare në ShBA. Shekulli XIX, sidomos pas zbulimit të telegrafit, është shekull i gazetarisë amerikane. Kjo gazetari filloi ta ndikojë gazetarinë evropiane në fillim të shekullit XX si në Angli, në Francë, ndërsa në disa vende të tjera, si në Gjermani, tek pas Luftës së Dytë Botërore. Modeli i gazetarisë së sotme është prodhim amerikan i shekujve XIX dhe XX.<sup>20</sup>

Tradita evropiane dhe tradita amerikane ndaj zhanrit në gazetari

### II.3. ZHANRI I TEKSTIT GAZETAR: STRUKTURA DHE QËLLIMI PËRMBAJTJESOR I TEKSTIT GAZETAR

Tipologjia më përmbledhëse dhe më e thellë e gazetarisë, njëkohësisht edhe e mbështetur në elemente e shfaqje të përhershme të gazetarisë, është tipologjia zhanrore. Faktori themelor tipologjik këtu është vetë struktura e tekstit gazetar dhe qëllimi përmbajtjesor i tij. Tipologjia zhanrore është bazë e studimeve të teorisë së tipologjisë gazetare në shumë fakultete të gazetarisë në botë. Poende, tipologjia e gazetarisë sipas strukturës dhe qëllimit përmbajtjesor të vet tekstit gazetar, si do të shohim tutje, është **më cilësori**, sepse edhe është i përgjithshëm (kap gamën më të gjerë të mundshme të tipologjisë gazetare), por edhe **është shterues** (sepse krijon mundësinë e diskutimit deri në detaje të çdo zhanri e të çdo lloji të tekstit gazetar). Kjo tipologji mbështetet mbi parime, shfaqje e elemente **më të përhershme** në gazetari. Duke pasur parasysh dinamizmin e gazetarisë dhe dinamizmin e vet zhanrit si formë e ligjërimit, asnjë parim dhe shfaqje gazetare nuk është e përhershme, përkatësisht asnjë element e shfaqje e zhanrit nuk është e përhershme, mirëpo tipologjia zhanrore e gazetarisë bazohet mbi parime, shfaqje e elemente të brendshme të gazetarisë, asi që përcaktojnë natyrën e një tekstit gazetar. Prandaj, si e tillë, kjo tipologji është edhe më shkencore, por edhe më shkollorë. Duke qenë se teoria e zhanrit është zhvilluar mjaft shumë në letërsi, për ta zberthyer qasjen ndaj



Bajram Kosumi, *Tipologji dhe zhanër* (2013), në të cilin shtjellohet gjerësisht dhe thelbësisht teoria e zhanrit e tekstit gazetar.

zhanrit gazetar duhet të mbështetemi në përvojën e letërsisë me zhanrin, edhe pse pothuajse asnjë studiues dhe asnjë kritik letrar nuk pajtohet me tjetrin në lidhje me cilëndo tipologji zhanrore letrare.

Që nga teoritë e para të tipologjisë së zhanrit, nga Aristoteli e këndeje, teksti ka qenë baza prej ku kanë filluar qasjet tipologjike. Cilat elemente të tekstit mund ta tipizojnë një shkrim se është i këtij apo atij zhanri? Nëse ndjekim tipologjinë gjinore të letërsisë, atëherë mund të japim disa përgjigje.

E para, **zhanri ka të bëjë me traditën**.<sup>21</sup> Kjo është një përgjigje e gjithëpranueshme, pra ato elemente që përcaktojnë zhanrin janë elemente të traditës, të formësuara dhe të fiksuara, të cilat i japin formë një teksti letrar dhe e shndërrojnë me kohë në model. Kështu, tradicionalisht romani është një tekst i shtrirë në tërë faqen, me ligjërim rrëfimtari, pavarësisht poezisë lirike e cila është tekst me varg të thyer, shpeshherë e strukturuar në strofa dhe me rimë. Edhe shkrimi i editorialit ka disa elemente konvencionale (rregulla shkrimi dhe përkufizime teorike) të cilave u përmbahet autori i tij, pavarësisht prej temës, vendit apo kohës kur e shkruan. Tradicionalisht, tekstet marrin forma dhe i ruajnë ato forma, duke krijuar kështu një formë të përsëritshme e të përhershme. Ky është vetëm një aspekt i zhanrit, apo edhe një element i zhanrit, mirëpo nuk e shpjegon gjithë çështjen. Transformimet e zhanrit për të cilat flet Todorovi, e vërtetojnë mangësinë e madhe të kësaj përgjigjeje.

Përgjigjia e dytë thotë se zhanri përcaktohet nga **elementet dominuese**.<sup>22</sup> Ky është një parim i formalistëve rusë, i formuluar kështu nga Boris Tomashevski, sipas të cilit, janë disa elemente që e dominojnë një lloj teksti dhe këto elemente e përcaktojnë tipologjinë zhanrore. Kështu, përdorimi i dialogut në ligjëratë të drejtpërdrejtë midis dy e më shumë personazheve e përcakton dramën, rrëfimi e përcakton romanin, ndërsa vetërrëfimi e përcakton lirikën. Në gazetari pozicionimi politik i autorit ndaj një teme e përcakton editorialin, analizimi pro-shkencor i rrjedhës së ngjarjeve në një temë e përcakton analizën, ndërsa përdorimi i gjerë i përshkrimit letrar e përcakton njërin prej llojeve të gazetarisë publicistike.

Së treti, Todorovi dhe strukturalistët e tjerë e japin përgjigjen e tyre për zhanrin duke e ndërlidhur atë me **strukturën ndërtimore të një teksti**. Problemi i zhanrit rrjedh nga struktura e ligjëratës.<sup>23</sup> Kjo do të thotë, sipas sosyrianëve dhe pasardhësve të tyre, se mënyra e organizimit struktural e një ligjërate e përcakton të qenit pjesë e një zhanri.<sup>24</sup> Pak vjet më vonë, në esenë e tij të cituar *Origjina e zhanreve* (1976), Todorovi e zgjeron konceptin strukturalist të teorisë së zhanrit duke ndërlidhur aty edhe **procesin e transformimeve** dhe, në veçanti, përsëri me ligjërimin (diskursin). Duke pohuar se

Zhanri ka të bëjë me traditën

Elementet dominuese të tekstit e bëjnë zhanrin

Struktura ndërtimore e një teksti gazetar e ndikon zhanrin e tij

Procesi i transformimeve ndërlidhet me zhanrin

kurrë nuk ka pasur letërsi pa zhanre dhe se zhanri është një sistem që i shtrohet një transformimi konstant, Todorovi, në pyetjen se nga vijnë zhanret, përgjigjet: “Një zhanër i ri gjithmonë është një transformim i një zhanri të mëparshëm, ose dhe i disa zhanreve: me anë të inversionit, me anë të zhvendosjes, me anë të kombinimeve”. (...) Zhanri, pa marrë parasysh a është letrar apo jo, nuk është kurrëgjë më shumë sesa një kodifikim i veçantive diskursive.<sup>25</sup>

Todorov: “Një zhanër i ri gjithmonë është një transformim i një zhanri të mëparshëm, ose dhe i disa zhanreve: me anë të inversionit, me anë të zhvendosjes, me anë të kombinimeve”.

Me këto dy fjali Todorovi konstaton mësimin tradicional se zhanri ka të bëjë me traditën, mirëpo ai ka një natyrë dinamike dhe transformuese: zhanret e reja rrjedhin prej të vjetrave dhe, ajo që është esenciale, teorinë e tij zhanrore e mbështet në veçantitë e ligjërimin (diskursin), të kodifikuara. Për qartësim, ai e shpjegon se çka nënkupton me diskurs: “Diskursi, ndërkaq, nuk është i përbërë nga fjalitë, por nga fjalitë e shqiptuara ose, thënë edhe më drejt, nga mënyra e të shprehurit. Prandaj, interpretimi i një të shprehure është i përcaktuar nga fjalia që shprehet, në njërën anë, dhe nga procesi i mënyrës së shqiptimit të asaj fjalie, në anën tjetër. Procesi i të shprehurit përfshinë folësin që e shqipton, adresimin se kujt i drejtohet ky shqiptim, vendin dhe kohën, diskursin që është në ecje dhe atë që e përcjell; shkurt, kemi të bëjmë me një kontekst të mënyrës së shqiptimit”.<sup>26</sup>

Me *veçantitë diskursive* Todorov kupton aspektin semantik të ligjëratës dhe aspektin sintaksor (mënyra se si pjesët janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën).

Përfundimisht, mbi këtë qasje të strukturalistëve, në radhë të parë të Cvetan Todorovit, mund t’i përshtatim parimet e teorisë së zhanrit në gazetari. Duke qenë se zhanri nuk është një kategori absolute, ai dallon nga shkencë në shkencë dhe nga fusha në fushë, prandaj ne përdorim foljen *përshtatim*, sepse në fakt këto parime teorike gjuhësore të zhanrit ne duhet t’ia përshtatim natyrës së gazetarisë. Këtu, si do të shohim më poshtë, në radhë të parë kemi parasysh funksionin e dyfishtë të ligjërimin gazetar: funksionin referencial dhe atë konativ (pa e përmendur këtu edhe funksionin estetik, si një përngjitime ndaj gazetarisë letrare).

Duke u ndërlidhur me faktorët që përcaktojnë zhanrin, parësisht në teoritë moderne, letrar apo joletrar, janë dy faktorë që përcaktojnë zhanrin gazetar:

- **struktura e tekstit gazetar.** (Si është ndërtuar një tekst gazetar? Ka aty një rregull, një model apo gazetari është i lirë ta krijojë strukturën sipas mendjes së tij? Ka një strukturë të gjerë apo të shkurtër, njëdimensionale apo shumëdimensionale? Etj.);

Janë dy faktorë që përcaktojnë zhanrin gazetar:

- struktura e tekstit gazetar
- qëllimi përmbajtësor i tekstit gazetar

- **qëllimi përmbajtësor i tekstit gazetar.** (Cili është efekti që dëshiron gazetari të arrijë me tekstin e tij? Është teksti vetëm një informatë? Një udhëzim? Një mendim i gazetarit? Një parashikim? Një analizë? Apo thjesht një rikujtim, apo një rimarrje e së kaluarës? Çfarë diskursi ka një tekst: referencial, përshkrues, rrëfyes apo argumentues? Etj.).

Çfarë strukture ligjërimore ka një tekst gazetar, çfarë qëllimi përmbajtësor ka dhe çfarë mjetesh përdor autori në tekstin e tij? Një tekst gazetar është vetëm një lajm, apo është një analizë, apo një koment i autorit për një çështje të caktuar, apo është një përvojë e tij subjektive, apo është një analizë mbi bazë të metodologjisë të shkencave humaniste? Secila prej këtyre pyetjeve, e mund të shtrohen edhe pyetje të tjera të këtilla, përkon me një strukturë dhe një qëllim përmbajtësor të tekstit gazetar. Mbi këtë bazë, pra mbi vetë strukturën dhe qëllimin përmbajtësor të tekstit gazetar, mund të bëhet tipologjia më e qëndrueshme, më gjithëpërfshirëse, më e saktë dhe më e thellë. Kjo tipologji nuk lë pa përfshirë brenda vetes asnjë zhanër e asnjë lloj të gazetarisë. Për t'i kuptuar më qartë këta dy faktorë duhet t'i diskutojmë më shumë.

### II.3.A. STRUKTURA E TEKSTIT GAZETAR

Në qendër të tipologjisë zhanrore është vetë ligjërimi gazetar, qoftë tekst, të folur, apo imazh, e kjo i jep ligjëratës gazetare statusin e objektit shkencor. Për arsye praktike, në tekstin tonë të mëtejme, në vend të fjalës *ligjëratë gazetare* ne do ta përdorim herë-herë edhe fjalën *tekst gazetar*, sepse teksti gazetar e mbulon çdo formë të shprehjes në gazetari. Teoria zhanrore ka për objekt studimi vetë tekstin gazetar, nga aspekti i strukturës ndërtimore dhe nga aspekti i qëllimit përmbajtësor. Edhe pse Van Dijku nuk është marrë me zhanrin gazetar, teoria e tij për diskursin gazetar ka ndikuar thelbësisht në studimet e tekstit gazetar. Ai e vë i pari tekstin gazetar në qendër të vëmendjes, nga aspekti i diskursit. Këtë reflektim e vërejtëm edhe te teoria e Todorovit për zhanrin. Por, përfundimet e Van Dijkut për ekzistimin e strukturave (propositions, macropropositions, macrorules, superstructures ose news schemata etj.) në një tekst të lajmit e vë në qendër të studimeve teorike vetë atë strukturë të lajmit, e kjo e determinon faktin se ky tekst, me një strukturë të veçantë, është unik dhe duhet të trajtohet si i tillë. Van Dijku, nën ndikimin e strukturalistëve, e paraqet teorinë e re interdisiplinare për studimin e lajmit në librin *News as discourse* (1988): "Tipari kryesor i përqaesjes sonë është analiza e lajmeve në radhë të parë si analizë e tekstit ose e diskursit". (...) Analiza e këtillë përqendrohet

në strukturat e diskursit, siç janë nivelet e ndryshme ose dimensionet e përshkrimeve apo njësitë dhe kategoritë të cilat përdoren për t'i karakterizuar këto nivele ose dimensione. (...) Analiza e këtillë do të duhej t'i përgjigjet pyetjes së rëndësishme për specifikat strukturore të diskursit të lajmeve kundruall llojeve të tjera të diskursit".<sup>27</sup>

Struktura e tekstit gazetar është bazë për teorinë zhanrore. Nacioni *tekst gazetar* këtu e ka të njëjtin kuptim sikur në teorinë e diskursit: nuk është lidhja e fjalëve në fjali (strukturat sintaksore), as e fjalive në një periudhë (strukturat sintaksore), por lidhja midis pjesëve më të mëdha koherente tekstore. Çdo tekst ka tërësinë e tij, e cila përbëhet prej pjesëve, ndërsa mënyra se si ndërlidhen ato pjesë paraqet strukturën e tekstit. Ky është aspekti i parë i strukturës së tekstit. Strukturën tekstore nuk duhet ngatërruar me strukturën sintaksore, por mund të bëhet një analogji midis tyre: ajo që është struktura sintaksore për fjalinë dhe periudhën, është struktura tekstore për tekstin në tërësi. Struktura e tekstit gazetar ka edhe një aspekt: ajo është edhe tematike apo semantike (*strukturat kuptimore* të Van Dijkut). Struktura tematike është mënyra se si janë ndërlidhur ndërmjet vete pjesët semantike të një teksti gazetar dhe se si organizohen temat e motivet e atij teksti. Van Dijk edhe këtu krijon tri kategori të teksteve: *Causes* (shkaku), *Antecedents* (paraprirja, ngjarja paraprijëse) dhe *Consequences* (rrjedhjet).<sup>28</sup> Strukturat tematike janë vazhdimisht të ndryshueshme, ndërsa strukturat tekstore janë më statike, më të fiksuara dhe më konvencionale. Thënë më thjesht, struktura tematike është tërësia përmbajtjesore dhe kuptimore e një teksti gazetar, e shprehur në pjesë më të mëdha se kuptimi i një fjale a një fjalie të vetme, ndërsa struktura tekstore është tërësia e kategorive të ndryshme të tekstit gazetar, e realizuar në pjesë më të mëdha se fjala a një fjali e vetme. Kuptimi i titullit, ndërlidhja e kuptimit të tij me nëntitullin apo mbititullin, si është shpërndarë kuptimi i tekstit në pjesët e tij etj., është struktura kuptimore e tekstit. Mënyra se si ndërlidhet titulli me mbititullin dhe nëntitullin, mënyra se si ndërlidhet kreu i një lajmi me materialin që shpjegon kreun, apo vetë ekzistenca e mbititullit, titullit, nëntitullit, kreut, materialit që shpjegon kreun etj., paraqet strukturën e tekstit gazetar (apo *news schemata* te Van Dijkut). Këtë strukturë të tekstit gazetar do ta përdorim si faktorin e parë për tipologjinë e zhanrit gazetar. Kështu, lajmi me një temë ekonomike dhe lajmi me një temë politike kanë një strukturë të ndryshme kuptimore, por kanë strukturë të njëjtë tekstore. Ndërsa lajmi me një temë dhe lajmi me dy tema, pavarësisht prej strukturës tematike, kanë struktura tekstore me disa ndryshime te vogla midis tyre.

Struktura e tekstit gazetar është kuptim i gjerë dhe i ngushtë. Një tekst unik, i pavarur, i tërë, paraqet një strukturë të plotë tekstore.

Struktura e tekstit gazetar ka edhe një aspekt: ajo është edhe tematike apo semantike



Struktura e tekstit gazetar është kuptim i gjerë dhe i ngushtë.

Teksti i një lajmi është strukturë e plotë dhe e gjerë tekstore. Kjo strukturë është e përbërë nga disa kategori strukturore. Kategori të strukturës së lajmit, p.sh., janë titulli i lajmit, kreu apo sfondi

Teksti i një lajmi është strukturë e plotë dhe e gjerë tekstore. Kjo strukturë është e përbërë nga disa kategori strukturore. Kategori të strukturës së lajmit, p.sh., është titulli i lajmit, kreu apo sfondi. Secila prej këtyre kategorive të strukturës tekstore është strukturë më vete por, jo e plotë, pra është e ngushtë. Kështu, sfondi i lajmit është një strukturë tekstore e tërësishme, por jo e pavarur prej lajmit, është strukturë e ngushtë. Një paragraf i tekstit, i cili përbëhet nga dy e më shumë fjali, është pjesë përbërëse e strukturës së tekstit dhe meriton interesimin e teorisë tipologjike zhanrore por, jo edhe një fjali e vetme, e cila ka një strukturë sintaksore e semantike, përveç në rastet kur ajo fjali e vetme paraqet një tërësi të mëvetësishme tekstore. Në shqyrtimet tona, sa herë që flasim për strukturën e tekstit, kemi në konsideratë si kuptimin e gjerë ashtu edhe atë të ngushtë.

Duke u nisur nga venerimet e Van Dijkut për konvencionalitetin e superstrukturës (skema strukturore), mund të përfundojmë edhe ne se struktura tekstore gazetare është konvencionale dhe deri-diku fikse (këtë konvencionalitet duhet kuptuar brenda konceptit të dinamizmit të zhanrit gazetar). Rrjedhimisht, struktura tekstore ka një rol më të madh në tipologjinë e zhanrit sesa strukturat tematike, të cilat janë më të ndryshueshme. Një lajm ka një strukturë tekstore të përsëritshme në të gjitha rastet, ndryshon vetëm tematika e tij. Një lajm për një aksident të ndodhur në Prishtinë dhe një tjetër për një aksident në Berlin dhe një tjetër për një vendim të presidentit amerikan kanë struktura tematike të ndryshme, por mund të kenë struktura tekstore të njëjta. Në anën tjetër, dhe çka është më e rëndësishme për neve këtu, kjo strukturë tekstore është e ndryshme për çdo lloj të ndryshëm të tekstit gazetar. Kështu, lajmi ka kreun, materialin që shpjegon kreun, sfondin dhe materialin e dytë që shpjegon kreun. Ndërsa komenti ka hyrjen, argumentet e temës, kundër-argumentet dhe interpretimet apo përfundimet. Dallimet në këtë superstrukturë i bëjnë të ndryshme shkrimet gazetare në aspektin zhanror. Ndryshe është i organizuar teksti i një lajmi nga ai i një raporti etj.

Kategoritë e strukturës tekstore të tekstit gazetar kanë role të ndryshme dhe hierarki të ndryshme nga teksti në tekst: një kategori që është e rëndësishme së parë për një tekst, nuk e ka atë rëndësi në tekstin tjetër. Kështu, kreu ka rëndësi të dorës së parë te lajmi e te raporti, por shumë më pak rëndësi te editoriali, komenti apo analiza. Ndërsa përmbyllja që ka rëndësi të dorës së parë te komenti, nuk ka asfale rëndësie te lajmi. Kjo shfaqje dëshmon se brenda strukturës tekstore rol të rëndësishëm në përcaktimin e zhanrit luajnë disa nga këto kategori të strukturës tekstore, në veçanti **kreu** (për të cilin do të flitet te kapitulli për gazetarinë informative) si dhe kategoria që mund të përkufizohet si **përmbyllje semantike** (për të cilën do të flitet te kapitulli për gazetarinë analitike).



### II.3.B. QËLLIMI PËRMBAJTJESOR I TEKSTIT GAZETAR

Faktori i dytë përcaktues për zhanrin, të cilin e quajtmë qëllimi përmbajtjesor i tekstit, është më kompleks se struktura e tekstit gazetar. Kjo për dy arsye: së pari, struktura e tekstit është konkrete, materiale, mund të vëzhgohet dhe të përshkruhet, ndërsa qëllimi përmbajtjesor i tekstit është një bindje e dhënësit dhe bindje e marrësit se çfarë mesazhi e deri çfarë ideologjie përcjell teksti. Së dyti, struktura e tekstit ka të bëjë vetëm me tekstin apo ligjërimin, ndërsa qëllimi përmbajtjesor i tekstit del përtej ligjërimin, ka të bëjë edhe me qëllimin e ekzistencës së një teksti gazetar, pra, përgjigjet në pyetjen: pse është shkruar ky tekst gazetar?

Çdo tekst (ligjërim, diskurs) ka një funksion të vetin. Një tekst gazetar nuk është sikurse çdo tekst letrar, sepse ka një funksion referencial, një funksion konativ dhe, nganjëherë, edhe një funksion të tretë - estetik. Një tekst i fizikës, për shembull, ka funksion referencial, një ligjërim politik ka funksion konativ (bindës), ndërsa një tekst letrar ka funksion estetik. Teksti gazetar ka, njëkohësisht, ose varësisht nga situatat e caktuara, më shumë se një funksion. Për diskutimin tonë këtu është i rëndësishëm se kur, si dhe pse një tekst i caktuar gazetar e merr një funksion të caktuar gjuhësor apo diskursiv? Përgjigja në këtë pyetje na rikthen te faktori i dytë që përcakton zhanrin gazetar.

Për t'i vërejtur funksionet që merr gjuha në tekst do të marrim tre shembuj nga tekstet gazetare.

#### Shembulli 1:

Janë 13 mijë e 937 maturantë që kanë dështuar ta kalojnë testin e maturës të përgatitur nga Ministria e Arsimit. Nga numri i përgjithshëm i atyre që i janë nënshtruar testit të maturës, rreth 54 për qind të tyre kanë dështuar. Me rezultat pozitiv në këtë testim kanë dalë 11 mijë e 656 maturantë, apo rreth 45 për qind nga numri i përgjithshëm.

(Gazeta Express, Faton Ismajli, "Matrullantët", 13 qershor 2011)



#### Shembulli 2:

Aq gjerë e gjatë ishte shtrirë "cerga e korrupsionit", sa verbëria e humbi krejt, kujdesin vetëmbrojtës të "ushtrisë së pashpirt" dhe të paskrupullit, të vjedhësve dhe korrupsionistëve. Kjo "cergë" e përfshiu edhe vetë kishën greke, institucionin e ashtuquajtur kombëtar që dikur ka dhënë prova themelore se impononte autoritarisht edhe vetë shtetin. Kisha u fut në "cergën" e korrupsionit. Hierarkët me rraso u bënë ortakë të qeverisësve dhe politikanëve të babëzitur.



Teksti gazetar ka, njëkohësisht, ose varësisht nga situatat e caktuara, më shumë se një funksion

Pronat e kishës, nisën të hipotekoheshin dhe tjetërsoheshin prej individësh me pushtet dhe lidhje, dhe anasjelltas, pasuritë publike, u tjetërsuan deri në atë masë, sa ndotja morale e politikës dhe predikuesve të tjerë institucionalë, shpërtheu në një kutërbim të padurueshëm, duke ndezur reagimin dallgëzues qytetar.

Kjo është një pjesë thelbësore e arsyeve të krizës, që po tymon dhe paralizon fqinjën jugor të Shqipërisë, Greqinë. Zjarri social u ndez padashur dhe qeverinë e kryeministrit grek Karamanlis, nuk mund ta ndihmonte as gjeneratori i politikëbërjes ballkanike, as problematikat e tejfryra gjeopolitike në rajon e, as përdorimi i laboratorit "cingërisës" me fqinjët, të cilët kurrë s'e bëjnë një krizë për Greqinë.

(Gazeta Shqip, 11 dhjetor 2008, Aleksandër Çipa, "Duhet kahu tjetër")



### Shembulli 3:

Uji i kthjellët i detit, që t'i ngacmon shqisat, i bashkohet kësaj tabloje natyrore, ku gjithçka duket perfekte. Njeriu këtu ndihet ndryshe. Përjeton kthjelltësinë e qiellit, të detit, gjelbërimin e thellë. Një fjalë e urtë e banorëve të kësaj zone, thotë se, nuk ke shijuar asgjë nga bregdeti i Himarës, nëse nuk përjeton qoftë edhe për pak çaste kënaqësinë që të sjell plazhi i Palasës, ose i Dhralesë, siç edhe emërtohet ndryshe në terminologjinë vendore. Shkëmbinjtë e prerë si me thikë, që zbresin deri në ujë, alternohen me sipërfaqe pa fund të mbuluara nga zhavorri i imët.

(ATA, "Mes mrekullive të plazhit të Palasës", 28 qershor 2011, [www.ata.gov.al](http://www.ata.gov.al))

#### Qëllimi përmbajtjesor i tekstit gazetar:

Gazetari ka një mesazh. Mesazhi realizohet përmes gjuhës, pra në tekst gazetari zgjedh funksionin e gjuhës sipas qëllimit të tij dhe pritisjes së supozuar të marrësit

Në shembullin e parë gjuha ka funksion referencial: gazetari na informon fakte konkrete nga provimi i maturës, sa dhe si kanë kaluar nxënësit etj. Në shembullin e dytë gjuha ka një funksion bindës: gazetari synon të na bindë se kriza e sapofilluar greke e ka origjinën te korrupsioni material, politik e moral që ka përfshirë shoqërinë greke që prej vitesh. Në shembullin e tretë gjuha ka një funksion estetik: gazetari synon ta krijojë, nëpërmjet gjuhës, ndjenjën estetike të bukurisë për plazhet e Palasës. Në të tre shembujt gjuha është përdorur në funksione të ndryshme, mirëpo në të tre rastet funksioni i parë i gjuhës është referencial, e vetëm më pastaj edhe konativ e estetik. Ky konstatim i fundit na mbyll shtegun e diskutimit në stilistikë, te funksionet e gjuhës, sikur të mos ishte aspekti social i gjuhës. Gazetari përdor këtë funksion të gjuhës varësisht nga qëllimi që dëshiron të arrijë nëpërmjet gjuhës: nëse dëshiron ta bartë një mesazh (nëpërmjet një lajmi) ai do ta përdorë gjuhën në funksionin referencial; nëse dëshiron ta bindë audiencën e tij ai do ta përdorë

gjuhën në funksionin referencial dhe në funksionin konativ; nëse dëshiron të na informojë duke na krijuar ndjenjën e të bukurit ai do ta përdorë gjuhën në funksionin referencial dhe në funksionin estetik. Ky qëllim i tij, që ka të bëjë me mesazhin e tij, është jashtë tekstit gazetar. Por, ky qëllim, mesazhi (apo më thjesht - i përmbajtjes), realizohet nëpërmjet gjuhës dhe ligjërimit, pra është tekst. Adresa përfundimtare e këtij qëllimi përmbajtjesor është audienca. Gazetari nuk e urdhëron audiencën, por mundohet ta kontrollojë se si duhet ta pranojë mesazhin. I gjithë ky proces paraqet atë që kemi quajtur qëllim përmbajtjesor të një teksti gazetar.

Ky qëllim përmbajtjesor i tekstit gazetar nuk mund të kuptohet pa **rrethin social të lajmit**. Gazetaria ka tre faktorë themelorë të lidhur funksionalisht:

1. dhënësi (gazetari, shkrimi i lajmit, puna intelektuale);
2. mediumi (nëpërmjet të cilit bartet lajmi);
3. marrësi (audienca, ai që lexon, dëgjon apo shikon lajmin).

Ky tresh themeltar i gazetarisë nuk ka marrëdhënie hierarkike: që të tre kanë të njëjtën rëndësi, ani pse deri vonë është menduar se dhënësi dhe mediumi janë të një rëndësie më të madhe, mirëpo në dekadat e fundit gjithnjë e më tepër po mbretëron botëkuptimi se gazetaria është për lexuesin, sidomos në gazetarinë digjitale. Por, që të tre këta faktorë kanë një pikë fillestare: ajo është ngjarja lajmore.

Një ndeshje futbollit, një mbledhje e qeverisë, një kredimarrje e një gjiganti ekonomik, një aksident, një ide a deklaratë e një politikani apo e një artisti, të gjitha këto dhe të ngjashme, paraqesin interes për publikun nga aspekti i informimit e, si të tilla, janë objekt i mundshëm i trajtimit gazetar, pra janë ngjarje të mundshme për lajmin. Ngjarja lajmore, sado në aspektin kohor është para tre të tjerëve, nuk është një Big Bang i gazetarisë. Big Bangu i gazetarisë është, megjithatë, vetë gazetari: ai e bën lajmin.

Lajmin e shkruan gazetari. Është gazetari ai që krijon dhe dërgon mesazhin. Ky është fakti i parë që e dallon gazetarin në rrethin social të lajmit. Së dyti, pasi për të njëjtën ngjarje lajmore gazetarë të ndryshëm krijojnë lajmet e tyre, pra të ndryshme, e vë rolin e gazetarit në përparësi ndaj faktorëve të tjerë në rrethin social të lajmit: gazetari me mënyrën si e krijon lajmin i ndikon proceset sociale dhe u jep rol atyre. Varfëria është një dukuri e përhershme në shoqëri, por kjo merr rol shoqëror atëherë kur një gazetar fillon të shkruajë për të. D.t.th., gazetari i jep rol një dukurie dhe duke e bërë atë temë të ditës i ndikon proceset e përgjithshme politike e sociale.

Një aksident ndodh vetvetiu, pa pjesëmarrjen e gazetarit. Ai aksident është një ngjarje lajmore, por nuk është lajm deri në çastin

#### **Rrethi social i lajmit.**

1. Dhënësi (gazetari, shkrimi i lajmit, puna intelektuale)
2. Mediumi (nëpërmjet të cilit bartet lajmi)
3. Marrësi (audienca, ai që lexon, dëgjon apo shikon lajmin)

kur gazetari e heton dhe e bart atë ngjarje lajmore te marrësi (audiencia). Midis këtyre dy poleve është një proces i parë i transformimit: nga ngjarja lajmore në idenë e lajmit. Ideja e lajmit është vetëm në kokën e gazetarit. Mirëpo, është i domosdoshëm edhe një proces tjetër i transformimit: nga ideja e lajmit te teksti i lajmit. Ky proces është ndërlidhje e gazetarit dhe mediumit ku bartet lajmi. Vetëm nëpërmjet gazetarit dhe këtij procesi të dyfishtë të transformimit ngjarja lajmore bëhet lajm. Mirëpo, lajmi ekziston vetëm në procesin e bartjes së tij. Pa këtë bartje nga dhënësi (gazetari) te marrësi (audiencia) nuk ekziston lajmi. Mund të flasim, pra, për tri procese të njëkohshme: transformimi i dyfishtë i ngjarjes lajmore në ide të lajmit, transformimi i idesë së lajmit në tekst të lajmit dhe procesi i bartjes së lajmit. Është edhe procesi i katërt, ai i perceptimit të lajmit nga audiencia, por kjo temë del jashtë rrethit social të lajmit. Pra, një ngjarje lajmore shndërrohet në lajm vetëm në një proces të transformimit të dyfishtë dhe në bartjen e tij nga gazetari te marrësi.

Procesi i bartjes dhe i transformimit të ngjarjes lajmore në lajm:

Ngjarja lajmore (fakt objektiv)  
Gazetari dhe  
Mediumi  
Marrësi




Figura paraqet rrethin social të lajmit. NL është ngjarja lajmore, MA është marrësi, GZ është gazetari dhe MD është mediumi nëpërmjet të cilit bartet lajmi. Marrëdhënia NL-MA paraqet qëllimin e ekzistimit të gazetarisë; marrëdhënia NL-GZ paraqet transformimin e parë, nga ngjarja lajmore në idenë e lajmit; marrëdhënia GZ-MD paraqet kufirin ku ndodh transformimi i dytë, nga ideja e lajmit te teksti i lajmit dhe te mediumi që transmeton atë tekst; marrëdhëniet GZ-MA dhe MD-MA paraqesin procesin e bartjes së lajmit. Këtu edhe vetë gazetari është një lloj mediumi, sepse ai po e krijon lajmin dhe po ia dërgon mesazhin marrësit. Marrëdhënia GZ-MD dhe GZ-MA është e ndërsjellë: ndikohet në dy drejtimet. Në drejtim të parë GZ-MA qëndron qëllimi përmbajtjesor i tekstit, ndërsa në drejtim të dytë MA-GZ qëndron kontrolli i audiencave mbi gazetarinë dhe përshtatja e gazetarit dhe tekstit të tij për audiencat.

Në këtë rreth social të lajmit, si thamë më sipër, subjekti numër një është gazetari. Ai krijon idenë e lajmit dhe krijon qëllimin se për

çfarë duhet ta informojë marrësin, apo çfarë duhet t'i thotë marrësit: një informatë, një bindje apo një kënaqësi estetike. Në këtë rreth social të lajmit krijohet faktori i dytë tipologjik, të cilin e quajtmë **qëllimi përmbajtjesor i lajmit**: ekziston një ngjarje lajmore, të cilën e vëren dhe e klasifikon gazetari (ka rëndësi apo nuk ka), e shkruan tekstin (për çfarë qëllimi?) duke e orientuar kah marrësi, përmes një mediumi të caktuar. Mënyra se si njerëzit, tekstet (gjuhë, akt i të folurit, diskurs) ndërveprojnë në kontekstin social është një proces i përafërt me faktorin “qëllim përmbajtjesor”. Qëllimi përmbajtjesor nënkupton një situatë sociale dhe tekstore, një tekst dhe kontekst dhe një situatë diskursive.



Grafikisht kështu paraqitet qëllimi përmbajtjesor i tekstit gazetar. Gazetari ka një qasje të qëllimshme ndaj ngjarjes lajmore, kur e shkruan tekstin e lajmit, krijon një qëllim të tekstit dhe e përdor mediumin për një mesazh të caktuar dhe të gjitha këto i orienton në raport me marrësin. Kjo marrëdhënie e gazetarit me këto elemente dhe e drejtuar kah marrësi krijon qëllimin përmbajtjesor të tekstit gazetar. Ky parim, qëllimi përmbajtjesor i tekstit gazetar, është faktori i dytë, më i rëndësishmi i tipologjisë zhanrore në gazetari. Lajmi bëhet për marrësin. Ka një varshmëri të drejtpërdrejtë midis dhënësit dhe marrësit. Çfarë mesazhi dëshiron dhënësi t’ia dërgojë marrësit? Një informacion të vetëm? Një informacion dhe një shpjegim të gjerë të rrethanave se si ka ndodhur ai informacion? Një informacion dhe një koment të tij? Një analizë se si ka ardhur deri te ndodhja e një ngjarjeje lajmore dhe si reflekton ajo ngjarje lajmore në realitetin social etj? Shihet qartë se është fjala për një përshtatje të dyanshme dhënës-marrës. Dhënësi ka një qëllim të caktuar për mënyrën se çfarë mesazhesh i dërgon marrësit, sepse marrësi pret prej tij mesazhe të caktuara dhe në kohë të caktuara. Marrësi, nga ana e tij, pret nga dhënësi që ai t’i dërgojë një lajm për gjërat e porsandodhura. Pasi ta ketë marrë lajmin, marrësi është i interesuar t’i dëgjojë rrethanat e ndodhjes së atij lajmi. Pastaj ai ka nevojë për ta dëgjuar komentin e gazetarit rreth asaj që ka ndodhur. Nëse ngjarja është shumë e rëndësishme për shoqërinë, marrësi ka nevojë për një analizë më të thellë për shkaqet e vërteta të ndodhjes dhe për pasojat e një ngjarjeje të tillë etj. Ky pozicion i marrësit ka krijuar një hierarki në zhanret e gazetarisë, të cilën e kemi quajtur shkallët e zhanrit dhe do ta trajtojmë në kapitullin vijues.

Kjo varshmëri reciproke dhënës-marrës në gazetari ka krijuar qëllimin përmbajtjesor të tekstit. Pse shkruhet ky tekst gazetar? Për çfarë qëllimi? Krahas dallimeve në strukturën e tekstit, tekstet gazetare ndryshojnë midis tyre edhe në qëllimin përmbajtjesor. Secili tekst gazetar ka një qëllim përmbajtjesor dhe mbi këtë qëllim ne mund t'i dallojmë ato. Qëllimi përmbajtjesor i tekstit zbërthet edhe në pjesë të tjera të tekstit, por është më i kondensuar në përmbylljen semantike. Cili është qëllimi përmbajtjesor i lajmit? Të bartë të marrësi një informatë për diçka që ka ndodhur, e kjo realizohet te kreu i lajmit. Cili është qëllimi përmbajtjesor i komentit? T'i japë marrësit një mendim a një opinion të gazetarit për ngjarjen lajmore, një koment për ngjarjen lajmore, e kjo realizohet te përmbyllja semantike.

A njëjtësohet qëllimi përmbajtjesor me kuptimin e tekstit apo me përmbajtjen e tij? Po të ndodhte kjo, atëherë humbet kursi i shqyrtimit dhe rezultati del i papajtueshëm. Edhe një fjali e vetme në një tekst gazetar ka një kuptim, një përmbajtje, poende edhe një qëllim përmbajtjesor. Kur i themi dikujt "Kthehuni nga keni ardhë!", fjalia ka një kuptim dhe një qëllim përmbajtjesor, i cili dërgohet nga dhënësi të marrësi, në atë mënyrë që marrësi ta kuptojë saktësisht mesazhin. Në teorinë zhanrore qëllimi përmbajtjesor i një fjalie të vetme nuk merret në shqyrtim, sepse do të krijoheshin kakofoni brenda të njëjtit tekst gazetar.

Qëllimi përmbajtjesor i një fjalie apo i një paragrafi, apo i disa paragrafëve, i nënshtrohet gjithmonë qëllimit përmbajtjesor të tekstit në tërësi dhe ky i fundit mund të ndikohet, por nuk mund të ndërrohet nën ndikimin e qëllimit përmbajtjesor të të parave. Prandaj, në shqyrtimin tonë, sa herë që përdorim nocionin qëllim përmbajtjesor kemi parasysh qëllimin përmbajtjesor të një teksti në tërësi, e jo atë të pjesëve të ndryshme të tij, edhe pse qëllimi përmbajtjesor, si pamë më lart, dendësohet në një paragraf ose në më shumë (përmbyllja semantike).

## III. KATËR ZHANRE NË GAZETARI

### III.1. PËRFUNDIME PËR ZHANRIN E TEKSTIT GAZETAR

**D**uke pasur për bazë strukturën e tekstit gazetar dhe qëllimin përmbajtjesor të atij teksti, si kriter tipizues, gazetaria ndahet në katër zhanre: zhanri informativ, zhanri analitik, zhanri publicistik (letrar) dhe zhanri argëtues. Këto zhanre të gazetarisë mbështeten në disa shfaqje, tipare e karakteristika të veçanta për secilin veç e veç. Këto veçanti janë unike për atë kategori (pavarësisht në flasim për gazetarinë e shtypur apo për atë radiotelevizive, pavarësisht në flasim për një gazetë ditore apo për një mujore) dhe janë të ndryshme nga kategoritë e tjera. Kështu, lajmi, si lloj i tekstit gazetar i zhanrit informativ është, pak a shumë, i njëjtë si për gazetën, si për radion e si për televizionin, por nuk është aspak i ngjashëm me pamfletin si lloj i gazetarisë publicistike. Kjo do të thotë se një tekst gazetar i përket një zhanri të caktuar pavarësisht se nëpërmjet cilit medium transmetohet.

Kjo e ngrit çështjen e hierarkisë së faktorëve tipologjizues në teorinë e zhanrit gazetar. Një faktor tipizues, në këtë rast struktura e tekstit gazetar dhe qëllimi përmbajtjesor i tij, është më ndikues dhe nënshton një faktor tjetër tipologjizues, në këtë rast mediumin. Kjo i jep rëndësi më të madhe teorisë zhanrore në marrëdhënie me llojet e tjera të tipologjisë gazetare. Nga kjo mund të bëjmë një rezymë të përkufizimit të zhanrit:

***zhanri** është ndarja (klasifikimi) më e gjerë dhe më e thellë e teksteve gazetare sipas disa veçantive të strukturës së tyre tekstore dhe qëllimit përmbajtjesor që bart në vete një tekst, të cilat janë të veçanta dhe të përbashkëta për atë lloj teksti. Në situata të caktuara sociale, brenda një zhanri ka edhe nënklasa, të cilat disa teoricienë i quajnë nënzhanre, ndërsa të tjerët lloje. Variantet e një lloji quhen nënlloje.*

**Lloji** është ndarje brenda zhanrit, i cila ka, përveç veçantive të përbashkëta zhanrore, edhe disa veçanti të strukturës së tekstit dhe qëllimit përmbajtjesor të tij si dhe veçanti shprehëse e ligjërimore, të cilat nuk i kanë llojet e tjera të të njëjtut zhanër. Kështu, lajmi dalton në strukturën tekstore dhe qëllimin përmbajtjesor nga raporti, ashtu sikurse edhe në mënyrat e shkrimit (në raport ka më shumë rrefim, ndërsa në lajm ka më shumë përshkrim; në raport strukturat tematike janë më të degëzuara se në lajm etj.), ani pse lajmi e raporti

#### PËRMBAJTJA

III. Katër zhanre në gazetari. . . . .	57
III.1. Përfundime për zhanrin e tekstit gazetar. . . . .	57
III.2. Gazetaria informative . . . . .	60
III.3. Gazetaria analitike. . . . .	62
III.4. Gazetaria publicistike . . . . .	63
III.5. Gazetaria argëtuese. . . . .	64

Gazetaria ndahet në katër zhanre:

1. Zhanri informativ
2. Zhanri analitik
3. Zhanri publicistik (letrar)
4. Zhanri argëtues

Përkufizimi i zhanrit

bëjnë pjesë në gazetarinë informative. Ndërsa editoriali dhe analiza, sado bëjnë pjesë në zhanrin analitik, dallojnë si në strukturën tekstore ashtu edhe në qëllimin përmbajtjesor. Pamfleti dhe polemika, sado janë të afërta dhe i takojnë publicistikës, dallojnë midis tyre në strukturën e tekstit dhe në qëllimin përmbajtjesor.

Lloji zhanror është tekst bazik. Ai është një tekst i tërë, unik, që ka një njësi kuptimore dhe një strukturë unike tekstore. Gazetaria merr kuptim prej llojeve zhanrore. Derisa zhanri është një koncept tipologjik gjithëpërfshirës, lloji është koncept tipologjik i veçantë: ai tipizon një lloj të tekstit gazetar, i cili nuk mund të tipizohet më tutje dhe është njësia më e vogël strukturore e përmbajtjesore e cila mund të qëndrojë e pavarur nga çdo tekst tjetër gazetar, në aspektin zhanror.

**Nënlloji** ka të bëjë me format e ndryshme të një lloji, pra është formë gazetare brenda llojit dhe zhanrit. Kështu lajmi mund të jetë i shkurtër apo i gjatë, fotolajm apo antërfajll etj. Nënlloji shfaq një prirje për t'u pavarësuar si lloj më vete. Ky është një proces shumë i mundshëm, duke pasur për bazë historinë dinamike të zhvillimit të zhanreve në gazetari. Kështu, fotolajmi, sado të trajtohet si nënllajm i lajmit, me zhvillimin e hovshëm në dekadat e fundit, me arritjen e një pozite të lakmueshme në gazetatat moderne (shumë gazeta botojnë në ballinë, çdo ditë, nga një fotolajm; nga gazetatat shqip, *Koha ditore* e bën këtë përditë; këtu duhet shtuar edhe disa fotolajme që botohen në brendi të gazetave) sot mund të qëndrojë lirshëm si një lloj zhanror më vete: një zhanër hibrid i fotografisë dhe fjalës. Nga ana tjetër, antërfajlli lufton për ekzistencë: a është një nënllajm i lajmit apo thjesht një truk i redaktorit teknik (disenjatori) për ta tërhequr vëmendjen e lexuesit më shumë në një pjesë të tekstit? Antërfajlli, kështu, vazhdon të gjëllojë midis nënllajmit dhe një elementi grafik. Ai mund të stabilizohet vetëm nëse e njëjtësojmë me lajmin e shkurtër. Edhe lajmi i shkurtër apo i gjatë nuk paraqet një bazë për klasifikim nënzhanror. Sado në gazetarinë moderne janë shumë të kërkuara lajmet e shkurtra (me dy-tre fjali), ai përsëri është lajmi, pra lajmi i shkurtër, asgjë më shumë. Prandaj, fati i nënllajmeve zhanrore në gazetari nuk është shumë i ndriçuar dhe i sigurt, por këtu nuk do të vazhdojmë të merremi më tej me të.

### III.2. GAZETARIA INFORMATIVE

Gazetaria informative përfshinë ato lloje gazetare që kanë për qëllim përmbajtjesor informimin e audiencës me ngjarjen lajmore, me rrethanat e ndodhjes dhe me prapavijat e saj. Teksti, pra, bart

Lloji zhanror është ndarje brenda zhanrit

Nënllajmi zhanror ka të bëjë me format e ndryshme të një lloji



një informatë nga dhënësi të marrësi, ndërsa gjuha ka vetëm funksion referencial. Në aspektin strukturor teksti është i shkurtër, të shumtën e herëve rrëfim njëdimensional, ndërsa vetë strukturimi dhe ndërlidhja e tekstit u nënshtrohen rregullave të krijuara nga përvoja gazetare, pothuajse të kodifikuara. Në aspektin stilistik, gjuha dhe shprehësia nuk kanë përmasë konotative, nuk ka gjuhë figurative e të mjegulluar, përkundrazi, gjuha dhe teksti kanë vetëm një qëllim: të bartin sa më thjesht dhe sa më saktë një informatë të marrësi. Rrjedhimisht, foljet përdoren në vetën e tretë njëjës, përdoret vetëm mënyra dëftore, ka ligjëratë të drejtë dhe të zhdrejtë, nuk lejohen digresionet etj. Rrëfimi në vetën e parë mund të bëhet vetëm në raste të transmetimeve të drejtpërdrejta në radio e në televizion, ose edhe në raporte, atëherë kur gazetari është personazh i raportit.

Ndikimi i përvojës dhe kodifikimi i shkrimit të lajmit, për shembull, e le të hapur çështjen se cila është marrëdhënia e autorit me tekstin e tij, ose më ndryshe, a ka teksti në këtë zhanër ngjyrë personale? Thjesht, mbizotëron shablloni në shkrimin e një lajmi apo mbizotëron invencioni i gazetarit? Sado që ka rregulla që përcaktojnë shkrimin e tij, lajmi i njëjtë trajtohet ndryshe nga dy e më shumë gazetarë dhe, kjo “ndryshe” është ngjyra personale (autoriale) e lajmit. Kjo “ndryshe” nuk ka të bëjë vetëm me stilin apo shprehësinë gjuhësore, por me mënyrën e rrëfimit të ngjarjes lajmore. Përfundimisht, ka rregulla që duhet t’i ndjekë gazetari në shkrimin e një lajmi por, sikurse çdo krijese, edhe lajmit ia jep shpirtin krijuesi i tij (gazetari). Llojet kryesore të këtij zhanri janë lajmi, raporti dhe kronika. Ky zhanër përbën gazetarinë bazike, sepse përbëhet vetëm prej një qëllimi përmbajtësor: të informojë për një ngjarje lajmore. Gazetaria pa këtë zhanër zbeh kuptimin gazetar dhe merr të tjera kuptime (propagandë, p.sh.). David Randall nuk heziton aspak, poende është i njëanshëm në rolin e gazetarisë informative dhe të asaj analitike e publicistike: “Heroi i gazetarisë nuk është analisti, opinionisti apo komentuesi bythëpambuk, po reporteri që nxjerr në shesh gjëra të panjohura dhe kryeredaktori i guximshëm që i boton. Po të shohësh historinë e shtypit, disa blloqe lajmërimesh e kanë nxitur ndryshimin e rrjedhës së ngjarjeve më shumë se çdo editorial, koment, opinion apo analizë, të marra këto së bashku. (...) ... sepse është gjithnjë njoftimi ai me të cilin gazetarët ndreqin abuzimet dhe stigmatizojnë moskokëçarjen”.<sup>29</sup>

Por, nuk ka qenë gjithmonë kështu: në gazetarinë evropiane të shekullit XIX lajmi nuk e ka mbizotëruar gazetarinë, por gazetaria publicistike. Ndërsa po në këtë shekull, në ShBA, duke qenë gazetaria një veprimtari që u nënshtrohet ligjeve të tregut, ajo ndiqte vetëm interesin e audiencave, u përshtatej atyre, e ata, nga ana e tyre, lakmonin për informacione (lajme) dhe jo për bindjet sociale

Gazetaria informative përfshinë ato lloje gazetare që kanë për qëllim përmbajtësor informimin e audiencës me ngjarjen lajmore, me rrethanat e ndodhjes dhe me prapavijat e saj

apo politike të gazetarëve. Kështu, nën diktimin e tregut, lajmi u bë zhanri kryesor dhe i pa konkurrencë në gazetarinë amerikane. Vetëm në dekadat e para të shekullit XX ky proces i hierarkizimit të lajmit ndikoi edhe në gazetarinë evropiane.<sup>30</sup> Marrëdhënia dhënës-marrës në gazetarinë informative është e thjeshtë: dhënësi ia jep informatën marrësit. Dhënësi nuk mund t'i japë informatën asnjë ngjyrim subjektiv, kjo do të thotë se lajmi nuk mund të ketë edhe një qëllim tjetër përmbajtësor. Lajmi vetëm informon për ndodhjen e një ngjarjeje lajmore.

### III.3. GAZETARIA ANALITIKE

Gazetaria analitike përfshin të gjitha ato lloje gazetare të cilat mëtojnë jo vetëm të informojnë, por edhe të analizojnë, të shpjegojnë e të interpretojnë përfundime nga ato analiza e shpjegime

Gazetaria analitike përfshin të gjitha ato lloje gazetare të cilat mëtojnë jo vetëm të informojnë, por edhe të analizojnë, të shpjegojnë e të interpretojnë përfundime nga ato analiza e shpjegime. Marrëdhënia dhënës-marrës në këtë gazetari është më e komplikuar: dhënësi ndihmon marrësin të krijojë një pikëpamje (mendim etj.) për temën e trajtuar. Marrësi, përveç informacionit të pastër të cilin dëshiron ta dijë, është i interesuar edhe për analizën, interpretimin dhe shpjegimin e atij informacioni. Edhe analiza, edhe interpretimi e shpjegimi i informacionit nënkuptojnë një thellim në kuptimin e rrethanave dhe të arsyeve të ndodhjes së një ngjarjeje lajmore. Marrësi natyrisht se ka një pikëpamje të tijën pse ndodh një ngjarje lajmore (fakt objektiv), por ai nuk mund të jetë plotësisht i sigurt për atë pikëpamje (ai nuk është specialist i asaj fushe, nuk ka informacione të tjera për t'i kuptuar arsyet e ndodhjes, apo thjesht nuk ka kohë për t'u thelluar në analiza të tilla), prandaj i duhet një pikë mbështetjeje për të parë se çka mendon një i tretë për atë çështje. Ky i tretë është gazetari apo autori që bën një analizë, në cilëndo formë gazetare qoftë (artikull analitik, intervistë etj.). Pra, në këtë zhanër ka një prirje të theksuar kah teksti konativ: gazetari ka një pikëpamje apo një qëndrim për temën që e trajton dhe dëshiron që atë ta pranojë (ose më drejt, ta njohë) marrësi. Por, nuk imponohet më shumë: konativiteti i këtij teksti nuk kërkon bindje, por vetëm një dritare më shumë për marrësin, që ai të ketë disa alternativa të vlerësimit për ngjarjen lajmore.

Në aspektin strukturor kjo gazetari është komplekse, teksti është i gjatë, shumëdimensional dhe është ndërthurje e temave të ndryshme me një kryetemë. Struktura e ligjërimit anon kah ligjërimit shkencor (pra, ka një tezë të temës, ka argumente të njohura edhe para tekstit, ka argumente të autorit të tekstit dhe në fund ka përfundime), por me prirje shumë të fuqishme autoriale (kjo do të thotë se te ky tekst

ka disa rregulla të cilave u përmbahet autori, por edhe në ato raste teksti merr ngjyrën personale, ose autoriale). Në aspektin stilistik, gjuha është informacion, por e ndërthurur me gjuhën figurative dhe me konotacionin. Ligjërimi bëhet në vetën e tretë dhe në pavetore, përveç mënyrës dëftore mund të përdoren edhe mënyra të tjera të foljes (habitorja, lidhorja apo urdhërorja), kryesisht ka ligjëratë të zhdrejtë etj. Në disa lloje, si në koment e në kolumnë, ligjërimi zhvillohet edhe në vetën e parë.

Llojet kryesore të këtij zhanri janë: artikulli analitik (analiza), komenti, kryeartikulli, editoriali, intervista, kolumna, anketa, dosja etj.

### III.4. GAZETARIA PUBLICISTIKE

Gazetaria publicistike (apo letrare, apo vetëm publicistika) përfshinë të gjitha ato lloje gazetare të cilat, jo vetëm informojnë dhe bëjnë analiza, por edhe informimin dhe argumentimin e bëjnë me mjete letrare dhe në formë letrare. Duhet bërë dallimi i qartë me letërsinë: parësisht, teksti është gazetari (pra, i vërtetë, jo fiktiv, jo i sajuar, si në letërsi), por trajtimi i temave gazetare bëhet me mjete letrare. Këto mjete letrare kryesisht kanë të bëjnë me aspektin stilistik dhe me funksionin gjuhësor të tekstit.

Gazetaria publicistike (apo letrare, apo vetëm publicistika) përfshinë të gjitha ato lloje gazetare të cilat, jo vetëm informojnë dhe bëjnë analiza, por edhe informimin dhe argumentimin e bëjnë me mjete letrare dhe në formë letrare

Në aspektin strukturor teksti është shumëdimensional, nuk i nënshtrohet asnjë rregulle të mëhershme, pra autori është sovrani i strukturës së tekstit të tij. Teksti ka karakter krejt personal (autorial). Marrëdhënia dhënës-marrës në këtë gazetari është mjaft e mpleksur: dhënësi mundohet ta bindë marrësin me përfundimet e tij, poende mundohet që kënaqësinë e tij estetike ta bartë edhe te marrësi. Konativiteti i gjuhës këtu mbërrin kulmimin e vet: shkrimi publicistik kërkon bindje nga lexuesi. Polemisti, për shembull, nuk interesohet për “një dritare më shumë” të gazetarit, komentues apo kolumnist, por ai kërkon bindje të plotë, ai synon t’ia mbushë mendjen plotësisht marrësit. Nga aspekti stilistik, si u tha, kjo gazetari është shumë e afërt me letërsinë: gjuha ka funksion referencial dhe estetik; thënia bartet nëpërmjet të gjitha formave të mundshme gjuhësore, duke nënkuptuar edhe figuracionin, rrëfimin ezopik, aluzionin etj. Teksti në ligjërimin e tij mund të jetë rrëfim në vetën e parë ose në të tretën, mund të jetë ligjëratë e drejtë apo e zhdrejtë, mund të jetë përshkrim, por edhe monolog e dialog, mund të jetë dinamik, por mund të ketë digresione të shumta etj.

Llojet kryesore të këtij zhanri janë: reportazhi, udhëpërshkrimi, eseja, polemika, fejtoni, pamfleti, kozeria etj.

### III.5. GAZETARIA ARGËTUESE

Gazetaria argëtuese përfshinë të gjitha ato tekste gazetare, qëllimi përmbajtjesor i të cilave, krahas informimit, është edhe argëtimi dhe zbavitja e audiencave

Gazetaria argëtuese përfshinë të gjitha ato tekste gazetare, qëllimi përmbajtjesor i të cilave, krahas informimit, është edhe argëtimi dhe zbavitja e audiencave. Tradicionalisht, fjalëkryqi ka pasur këtë qëllim përmbajtjesor: informon (përmes pyetjeve dhe përgjigjeve) dhe argëton (është tekst i lehtë, i pranueshëm në çfarëdo situatë që të jetë lexuesi, e mbush kohën e lirë të audiencës etj.). Po kështu, karikatūra i ka të theksuara të dy elementet e qëllimit përmbajtjesor: bart një mesazh (informacioni i ngjarjes lajmore) dhe argëton e zbavit. E njëjta mund të thuhet edhe për disa zhanre të kësaj gazetarie të cilat njihen tradicionalisht: barsoletat dhe mahitë e ndryshme, lojërat për aftësimin e trurit dhe lojëra të tjera zbavitëse etj. Nuk duhet ngatërruar me këtë zhanër disa lloje të gazetarisë letrare, si me kozerinë, të cilat, për shkak të diskursit të tyre ironik, mund edhe të argëtojnë, por qëllimi përmbajtjesor i tyre është informimi dhe kënaqësia estetike. Struktura tekstore e kësaj gazetarie është e thjeshtë: disa prej tyre kanë strukturën tekstore tërësisht fikse (të pandryshueshme), si për shembull fjalëkryqi, karikatūra etj., ndërsa disa të tjera kanë strukturë të tyre të mëvetësishme si, p.sh., barsoleta, humoreska etj.

Deri te gazetaria moderne ndarjet midis gazetarisë argëtuese dhe pjesës tjetër të gazetarisë kanë qenë të rrepta dhe të pakalueshme: edhe faqet e rubrikat ku është botuar gazetaria argëtuese kanë qenë të ndara dhe të dallueshme prej faqeve të "lajmeve të forta". Në gazetarinë moderne ka dy prirje dhe dy praktika gazetare që burojnë nga kjo gazetari argëtuese.

E para është përdorimi i medieve për argëtim. Kjo është një prirje e gjerë dhe përmban në vete edhe faktorë e elemente të cilat nuk kanë të bëjnë me gazetarinë. Kompjuteri dhe telefonat e mençur mobilë ofrojnë për përdoruesit lojëra të ndryshme argëtuese e zbavitëse, të cilat nuk anë të bëjnë asgjë me gazetarinë. Përdorimi i mediumeve për argëtim është një shfaqje krejt e natyrshme për natyrën e njeriut dhe të mediumit, deri në atë masë sa që të ndryshohet funksioni primar i mediumit: kompjuteri mund të përdoret për argëtim, por nëse ai përdoret ekskluzivisht për argëtim si, p.sh., nëpër kazino, atëherë ai ka argëtimin funksion primar dhe kjo është e përputhshme me natyrën e tij, por nuk është e përputhshme me kompjuterin që e keni në tavolinën tuaj në shtëpi. Videolojërat janë shembulli më i mirë i përdorimit të mediumit për argëtim. Teoricienët këtu fusin edhe shumë forma e zhanre të tjera kulturore-gazetare: spotet muzikore, filmat horrorë, pornografikë (seksi) e shumë e shumë zhanre të tjera multimediale, të cilat po marrin rol gjithnjë e më të

madh në kulturën modern. Ka plotë formate të emisioneve të këtij zhanri të cilat janë bërë të famshme dhe globale: *Kush do të bëhet milioner?*, *X Factor*, *Amerikans Idol*, *America's Funniest Home Videos*, *Dance with the Stars* etj.

Prirja e dytë është e ndërlidhur drejtpërdrejt me gazetarinë: është ndërthurje (apo ngatërrim?) i lajmit me argëtimin. Kjo praktikë e shndërruar në prirje synon ta informojë audiencën me lajmet kryesore duke e argëtuar njëkohësisht. Si shihet, tashmë nuk është fjala për një zhanër të tekstit gazetar që është argëtues, por për gazetarinë informative të ndërthurur me argëtim dhe zbavitje. Kjo ndërthurje e ka origjinën te "lajmet e buta" si janë quajtur në zhargonin gazetar lajmet me informata gjysmë të vërteta, lajmet për skandale, ato me thashetheme etj., të cilat edhe më parë janë publikuar (për të përfituara audiencat), por të ndara qartë nga "lajmet e forta". Në gazetarinë moderne kjo ndarje midis "lajmeve të forta" dhe "lajmeve të buta" po shembet, në favor të krijimit të një zhanri të ri argëtues i cili është lajm dhe argëtim. TV "Klan Kosova" e praktikon një zhanër të tillë të informimit: në edicionin qendror të lajmeve, informatat kryesore i transmeton të mbështjellë me një diskurs të lehtë humori e ironie.

Se a ndikon pozitivisht apo negativisht ky model i informimit, ka mendime të ndara: një numër i teoricienëve dhe i gazetarëve e mbrojnë këtë prirje me argumentin se media po e humbet audiencën, prandaj duhet shpikur mënyra për ta mbajtur atë, e një nga mënyrat më të përkryera është argëtimi. Të tjerë teoricienë vazhdojnë të besojnë se informimi i vijës së parë nuk duhet të ndërthuret me argëtim e zbavitje (ato të jenë rubrika e zhanre të mëvetësishme). Besimi i audiencave mund të ruhet në rrugë me mënyra të tjera, si në librin e Bill Kovaçit e Tom Rosenstielit, *Elementët e gazetarisë* (2001).

Zhanri informativ: Informim + analizë, komentim, opinion, pozicionim...  
Zhanri letrar: Informim + kënaqësi estetike  
Zhanri argëtues: Informim + argëtim

Zhanri informativ	Zhanri analitik	Zhanri publicistik	Zhanri argëtues
<p>1. Qëllimi përmbajtjesor: informim.</p> <p>2. Përmbajtja: fakt.</p> <p>3. Strukturë e ngurtë teksti.</p> <p>4. Rregulla të forta shkrimi.</p> <p>5. Mbizotërim i një numri të caktuar fjalësh.</p> <p>6. Mbizotëron modelin.</p> <p>7. Tekst i shkurtër.</p> <p>8. Tekst me një temë.</p> <p>9. Tekst njëdimensional.</p> <p>10. Tekst neutral, pa tendencë.</p> <p>11. S'ka ngjyrim personal as ngarkesë emocionale.</p> <p>12. Stil ligjërimi bisedimor.</p> <p>13. Fjali e thjeshtë dhe e shkurtër.</p> <p>14. Mbizotërim i foljes.</p> <p>15. Mënyra dëftore; e klyera e thjeshtë dhe e tashmja; veta e tretë.</p> <p>16. Gjuhë jo figurative.</p> <p>17. Mbizotëron titulli dhe kreu i parë.</p> <p>18. Transmetim sa më i shpejtë.</p> <p>19. Jetëgjatësia: 24 h.</p> <p>20. Marrësi neutral.</p>	<p>1. Qëllimi përmbajtjesor: informim, analizë dhe interpretim.</p> <p>2. Përmbajtja: fakt dhe komentim i tyre.</p> <p>3. Strukturë jo shumë e ngurtë teksti.</p> <p>4. Rregulla të lira shkrimi.</p> <p>5. Mbizotërim i një numri të gjere fjalësh.</p> <p>6. Ka modele por nuk mbizotërojnë.</p> <p>7. Tekst mesatar.</p> <p>8. Tekst me një ose më shumë tema.</p> <p>9. Tekst shumëdimensional.</p> <p>10. Tekst me prirje konative, me tendencë.</p> <p>11. Ka pjesërisht ngjyrim personal dhe ngarkesë emocionale.</p> <p>12. Stil ligjërimi bisedimor-shkencor.</p> <p>13. Fjali dhe periudhë e shkurtër.</p> <p>14. Mbizotërim i foljes dhe i emrit.</p> <p>15. Mënyra dëftore edhe ndonjë tjetër; tri kohër; veta e tretë dhe pavetore.</p> <p>16. Gjuhë edhe me figura.</p> <p>17. Mbizotëron interpretimi [pjesa përmyllëse].</p> <p>18. Transmetim i shpejtë.</p> <p>19. Jetëgjatësia: më gjatë se 24 h.</p> <p>20. Marrësi jo neutral.</p>	<p>1. Qëllimi përmbajtjesor: informim dhe qëllim estetik.</p> <p>2. Përmbajtja: art i faktit.</p> <p>3. Strukturë e lirë teksti.</p> <p>4. Rregulla të zgjedhura apo të krijuara nga autori.</p> <p>5. Nuk ka mbizotërim të fjalëve të caktuara.</p> <p>6. Nuk ka modele që ndiqen.</p> <p>7. Tekst i gjatë dhe i shkurtër.</p> <p>8. Tekst me shumë tema.</p> <p>9. Tekst shumë dimensional.</p> <p>10. Tekst konativ dhe me tendencë.</p> <p>11. Ka ngjyrim personal dhe ngarkesë emocionale [tendencë e fortë].</p> <p>12. Stil ligjërimi bisedimor-letrar.</p> <p>13. Fjali e gjatë ose e shkurtër.</p> <p>14. Pa mbizotërim të një pjesë të ligjeratës.</p> <p>15. Mënyra dëftore dhe mënyrat e tjera të foljes; tri kohër; të gjitha vetat e foljes.</p> <p>16. Gjuhë me figura.</p> <p>17. Mbizotërim i tërë tekstit.</p> <p>18. Transmetim i ngadalhtë.</p> <p>19. Jetëgjatësia: pa kufi.</p> <p>20. Marrësi tendencioz.</p>	<p>1. Qëllimi përmbajtjesor: informim dhe argëtim.</p> <p>2. Përmbajtja: fakt dhe lojë.</p> <p>3. Strukturë e ndryshueshme e tekstit; nganjëherë shabllon i vizatuar dhe tekst i konstruktuar.</p> <p>4. Rregulla të saka shkrimi.</p> <p>5. Nuk ka koncentrik të fjalëve: ato ndryshojnë nga rasti në rast.</p> <p>6. Ka modele: herë ndiqen e herë jo.</p> <p>7. tekst i shkurtër; tekst eliptik; tekst i sinkronizuar me një graf tjetër.</p> <p>8. Nuk ka rregull.</p> <p>9. Nuk ka rregull.</p> <p>10. Tekst neutral dhe tekst konativ.</p> <p>11. Në disa lloje teksti ka një kohërencë të brishtë, në disa nuk ka fare kohërencë.</p> <p>12. S'ka ngjyrim personal, as ngarkesë emocionale.</p> <p>13. Stil ligjërimit bisedor.</p> <p>14. Fjali e thjeshtë dhe e shkurtër; fjali e shkëputur.</p> <p>15. Nuk ka rregull.</p> <p>16. Nuk ka rregull.</p> <p>17. Gjuhë edhe me figura.</p> <p>18. Mbizotëron titulli; nuk ka fare tituj.</p> <p>19. Transmetim i ngadalhtë.</p> <p>20. Jetëgjatësia pa kufi.</p> <p>21. Marrësi jo neutral.</p> <p>22. Distanca dhënës-marrës nuk ekziston.</p>

## IV. LËVIZJE KAH ZHANRI

**N**ë praktikën dhe në teorinë e gazetarisë janë krijuar edhe disa forma të veçanta të gazetarisë, të cilat nuk paraqesin zhanër gazetar, por prirje të gazetarisë dhe tendencë për të krijuar zhanër. Po i trajtojmë në një kapitull të veçantë për arsye praktike të librit. Këtu do të trajtojmë edhe një tip të gazetarisë: gazetarinë digjitale, për arsye të hapësirës dhe ndikimit të madh që po fiton kjo gazetari në fillim të këtij shekulli. Format e tjera të cilat do t'i trajtojmë janë shfaqje të përhershme në historinë e gazetarisë, të përsëritshme edhe sot.

### IV.1. GAZETARIA E PAVARUR, GAZETARIA PËR DHE KUNDËR QEVERISË DHE GAZETARIA PROFESIONALE

Ka gazetari që është e prirë të jetë oponencë e qeverisë, ashtu sikurse ka gazetari që është e prirë më pak të jetë oponencë e qeverisë dhe ka gazetari që është në shërbim të qeverisë (kjo e fundit është thjesht një devijim nga gazetaria). Riçard A. Bamsted thotë se është në natyrën e gazetarisë kundërshtia me qeverinë: "Marrëdhënia ndërmjet qeverisë dhe shtypit është marrëdhënie kundërshtie, dhe shumë reporterë e preferojnë këtë mënyrë".<sup>31</sup>

Mirëpo kjo nuk është një rregull, sepse po të kuptohet si rregull atëherë gazetaria do të krijojë keqkuptime të mëdha. Llorens K. Boprej duke folur për paanshmërinë e gazetës dhe besueshmërinë e saj thotë: "Një gazetë e mirë pasqyron komunitetin të cilit ajo i drejtohet, me të mirat dhe të këqijat e tij, prandaj mos u përpiq të vësh në dukje vetëm njërën anë. Ai që qëmton vetëm gabimet është njësoj si ai që di vetëm të mburret".<sup>32</sup>

Të jetë një gazetari kundërshtar e qeverisë, mburrëse e saj apo e paanshme, sado qoftë kjo ndarje e theksuar, sidomos në vendet "në tranzicion", megjithatë nuk paraqet një tip të gazetarisë, por një prirje apo një kahe të saj.

Historia e marrëdhënieve të gazetarisë me qeverinë është mjaft e turpshme në disa raste. Është e njohur forma brutale e kancelarit gjerman Bismark për financimin e gazetave<sup>33</sup>, e të mos flasim për marrëdhënien e gazetarisë me qeverinë në sistemet fashiste, në ato komuniste dhe në demokracitë brutale moderne.

### PËRMBAJTJA

IV. Lëvizje kah zhanri . . .	67
IV.1. Gazetaria e pavarur, gazetaria për dhe kundër qeverisë dhe gazetaria profesionale . . . . .	67
IV.2. Gazetaria e lirë dhe gazetaria e censuruar . . .	69
IV.3. Gazetaria hulumtuese (investiguese) . . . . .	70
IV.4. Gazetaria e saktë . . . . .	72
IV.5. Korporatat - forma të reja të oligarkisë gazetare . . . . .	73
IV.6. Fotozhurnalizmi (fotogazetaria) . . . . .	76
IV.7. "Fjalimi për liderin" - gazetaria dhe oratoria . . .	77
IV.8. Gazetaria globale . . . . .	78
IV.9. Gazetaria digjitale . . . . .	79



Jashtë të qenit gazetaria për apo kundër qeverisë zhvillohet një parim tjetër që duket jo vetëm më stabil, po edhe më tërheqës: kjo është **gazetaria e pavarur**. Kjo gazetari merr kuptim nga të qenët i pavarur në raport me qeverinë (në vendet në tranzicion) dhe në raport me bizneset (në vendet kapitaliste). Nuk do të thotë se është apriori kundër qeverisë, por aspak nuk është afër saj, është larg ndikimit të saj. Ajo herë e kritikon qeverinë e herë e lavdëron. Në fakt, ky është koncepti ideal se si Llorens K. Boprej e përkufizon gazetarinë. Ndërsa në gazetarinë me traditë të fortë tregu, gjithmonë ka një rezistencë të fshehtë ndaj bizneseve që reklamojnë në media, pasi ekziston droja që ato reklamime janë mbulesë për ndikime në politikat redaktuese të gazetës.

Sa herë që përmendet gazetaria, njeriut i shkon mendja te gazetaria e lirë, te liria e fjalës, te shtypi sovran, një vlerë kjo e kulturës perëndimore e arritur jo lehtësisht. Fatkeqësisht, sot kjo është vetëm një ëndërr e idealistëve. Liria e shtypit i përket romantizmit gazetar. Binomi *shtyp i lirë* i përket së kaluarës. Fundi i shekullit XX përmbysi shpresat për gazetarinë e lirë. Gazetaria u gllabërua nga oligarkët financiarë e politikë, u bë mjet i luftës dhe i përfitimit si çdo mjet tjetër: si paraja, si arma, si fabrika, si një agjenci udhëtimesh. Nocioni pavarësi e medieve duhet të shikohet tash jo vetëm në raport me qeverinë, por edhe në raport me këtë oligarki, qoftë ai individ apo grup.

*“Tashti lirinë e medieve nuk e rrezikon shumë politika, sa interesat e politikanëve biznesmenë. Liria i nënshtrohet jo më kufizimeve të ideologjive dhe të politikës, por vetëm fitimit dhe biznesit”.*<sup>34</sup>

Vetëm aty-këtu ndjehet zëri i ndonjë idealisti, i ndonjë qendre mediale, të cilët si në makth vështrojnë se ç’po ngjet dhe as nuk pajtohen me atë çka ngjet po as nuk mund ta ndalojnë atë. Ndoshta filmi *The Last Samurai* (2003) i Edward Zwickut është figura më e përshtatshme për ithtarët e gazetarisë së lirë. Nisur nga kjo pavarësi e kushtëzuar e gazetarisë, gjithnjë e më shumë ka teoricienë që besojnë se nocioni pavarësi e gazetarisë është më shumë i shtirur sesa real. Më shumë anohet kah nocioni **gazetari profesionale** sesa gazetari e pavarur.<sup>35</sup> Gazetaria profesionale është një binom i ri, ose së pakut që merr kuptim të ri. Në këtë binom gazetaria është në marrëdhënie korrekte (as mbështetëse e as refuzuese) ndaj shumë faktorëve: ndaj marrësis, ndaj bizneseve duke përfshirë edhe vetë biznesin e medias së tij, ndaj qeverisë dhe ndaj çfarëdo qendre të fortë politike dhe financiare dhe ndaj deontologjisë së medieve. Bill Kovach dhe Tom Rosenstiell merren gjerësisht me këto parime të gazetarisë, në librin *Elementët e gazetarisë* (2001). Detyrimi i parë i gazetarisë, thonë ata, është ndaj së vërtetës, ndërsa gazetaria duhet t’u japë përgjegjësi vetëm qytetarëve dhe askujt tjetër.<sup>36</sup>



## IV.2. GAZETARIA E LIRË DHE GAZETARIA E CENSURUAR

Një tjetër shfaqje në gazetari është censura: ka gazetari të lirë dhe gazetari të censuruar. Me gazetarinë e lirë nënkuptohet e drejta e gazetarit për të informuar lirshëm marrësin dhe e drejta e marrësit për të ditur. E drejta e shtypit të lirë dhe e drejta e qytetarit për t'u informuar është kodifikuar në shumë vende të botës me kushtetutë. Në Kushtetutën e ShBA-së (1787) një amendament thotë se Kongresi nuk mund të aprovojë një ligj i cili mund ta pengojë lirinë e shprehjes apo të shtypit.<sup>37</sup> Po ashtu, të drejtën për të marrë e përhapur informata e sanksionon edhe Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948), në nenin 19. Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (2008) liria e medias përkufizohet kështu: "Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshinë të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush".<sup>38</sup>

Por, në vende të ndryshme jodemokratike media censurohet nga ana e qeverisë apo nga mekanizma të krijuar nga ajo. Kështu, në vendet ish-socialiste kushtetutat dhe ligjet e tyre penale kanë sanksionuar shprehjen e lirë të mendimit, duke e vlerësuar atë si "propagandë armiqësore". Neni 133 i *Ligjit Penal* të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë sanksiononte me dënim me burg për ata që përhapnin ide, mendime e informacione "armiqësore dhe kundër shtetit". Në praktikë kjo edhe ka ndodhur shumë shpesh. Edhe sot, në shtetet me demokraci të brishtë apo në shtetet autoritare, si në shumë vende latino-amerikane, afrikane, arabe dhe aziatike, gazetaria është e censuruar arbitrarisht dhe brutalisht. Është e njohur praktika shtetërore në Kinë për censurimin e uebfaqeve dhe rrjeteve sociale të famshme të botës, ose pengimi i qasjes së qytetarëve kinezë në pjesë të ndryshme të teksteve digjitale të internetit.

Ekziston edhe një lloj censure që bëhet nga vetë gazetari apo redaksia e që quhet *autocensura*. Kjo ndodh kur gazetari me apo pa ndërgjegje i bishtnon shkrimin të fakteve reale dhe qenësore, për të fshehur apo heshtur një ngjarje lajmore të rëndësishme. Zakonisht kjo ndodh në periudha të pazakonshme të një vendi siç është koha e luftërave apo koha e pas konflikteve. Kjo përlligjet zakonisht "me interesin e shtetit". Kështu, gjatë luftës amerikano-irakiane janë mbajtur të heshtura torturat ndaj të burgosurve irakianë nga autoritetet amerikane në burgun e Guantenamos dhe në burgje të tjera deri me zbulimin e këtyre fakteve nga gazeta angleze *The Guardian* (2006). Në vendet ish-socialiste dhe në vendet ish-diktatoriale autocensura vepron edhe si një proces i pandërgjegjshëm për shkak

Gjatë luftës amerikano-irakiane janë mbajtur të heshtura torturat ndaj të burgosurve irakianë nga autoritetet amerikane në burgun e Guantenamos dhe në burgje të tjera deri me zbulimin e këtyre fakteve nga gazeta angleze *The Guardian* (2006)

të kohës së gjatë të aplikimit të censurës dhe “akomodimit” me të. Ky faktor reflekton edhe sot në Kosovë si pasojë e dhunës dhe e trysnisë disa dekadëshe në gazetarinë e Kosovës që nga fillimet, ani pse ka më shumë se dhjetë vjet që ajo trysni më nuk ekziston: gazetarët kosovarë edhe sot përmendin autocensurën si një faktor të rëndësishëm negativ në gazetari.<sup>39</sup> Autocensura në gazetarinë e Kosovës nuk lidhet vetëm me të kaluarën: ajo po e cenon rëndë edhe gazetarinë e sotme. Qoftë prej faktorëve politikë apo parapolitikë, qoftë prej faktorëve biznesorë apo edhe prej faktorëve të jashtëm që kanë një ndikim të madh në jetën e brendshme në Kosovë, apo së fundit, qoftë edhe për shkak të interesave personale, gazetarët në Kosovë sot janë më shumë të prirë t’i heshtin temat e faktet që janë të rëndësishme për opinionin publik. Heshtja e temave të tilla, poende kur ato dihen gjysmë publikisht, është autocensurë në shërbim të faktorëve politikë, biznesorë apo në shërbim të interesit personal të gazetarit.

### **IV.3. GAZETARIA HULUMTUESE (INVESTIGUESE)**

Një prirje tjetër e gazetarisë është gazetaria hulumtuese. Të qenit hetues për gazetarinë do të thotë të hetohen ngjarje, procese e veprimet, kryesisht të qeverisë, të agjencive qeveritare, po edhe të botës së biznesit, të cilat paraqesin shkelje apo varg shkeljesh ligjore për të realizuar një qëllim politik, moral apo biznesor, e të cilat procese mbahen larg syrit të opinionit publik. Gazetaria e përditshme, ajo informative, sado informon për procese të ndryshme, nuk mund të depërtojë në thellësi dhe në prapavijë të atyre proceseve. Aty ku nuk mund të depërtojë një gazetar i lajmit a i raportit, apo një analist tjetër, aty synon gazetari hetues. Hetimi i gazetarit merr shumë kohë, mu për arsye se depërtimi në prapavijë të një lajmi nuk është i lehtë.

Në vitet e fundit në gazetarinë e vendeve në tranzicion shprehja “gazetari hulumtuese” duket mjaft tunduese, por realizimi i një gazetarie të tillë në të vërtetë kërkon traditë, mjedis demokratik, zhbirim, guxim dhe vullnet të gazetarit. Rezultatet e kësaj gazetarie janë të rëndësishme për shoqërinë dhe opinionin publik. Gazetari hulumtues në fakt bën një farë hetimi të gjatë për një çështje, si kurse gjyqtari hetues, por efekti i hetimit gazetar është publikimi i të dhënave që janë mbajtur larg syrit të opinionit publik, e jo një seancë gjyqësore.

Gazetaria e mirë hulumtuese krijon një pasojë zinxhirore politike dhe ligjore. Të zbulosh një varg faktesh e veprimesh joligjore që bën një zyrtar apo një biznesmen do të thotë të hasësh një numër të madh kundërshtarësh në rrugë e sipër. Zakonisht, këta kundërshtarë janë të fuqishëm dhe të rrezikshëm. Në vendet pa mjedis demokratik gazetarët këtë zbulim e paguajnë me jetën e tyre. Ka shumë raste të tilla. Gazetarja ruse dhe aktivistja e të drejtave të njeriut, Ana Politkovskaja, u vra në vitin 2006, sepse ajo kishte raportuar për krimet e luftës në Çeçeni dhe kishte kritikuar presidentin e atëhershëm rus, Vladimir Putin.

Vrasjet e gazetarëve nuk janë raste të rralla, poende është shtuar dukshëm numri i vrasjeve në fillim të shekullit XXI. Vetëm në vitin 2004 janë vrarë 56 gazetarë, duke shënuar numrin më të madh të vrasjeve brenda një viti, që nga viti 1994. Ndërsa brenda këtij dhjetëvjetëshi janë vrarë 337 gazetarë, pa i numëruar këtu punëtorët e tjerë medialë, si përkthyes, shoqërues etj., të cilët kanë humbur jetën bashkë me gazetarët. Ky numër është rritur nga viti në vit:

Viti	Gazetarë të vrarë
1994-2004	337
2005	146
2006	168
2007	172
2008	109
2009	133

Cituar sipas: [www.newssafety.org](http://www.newssafety.org) (shikimi i fundit 18 shkurt 2010)


Të gjithë këta gazetarë nuk janë vrarë për shkak të gazetarisë hulumtuese, një pjesë e tyre janë vrarë në zona të luftës. Një prej tyre është Daniel Pearl, i cili është ekzekutuar në një zonë lufte (Pakistan), sepse ai kishte filluar ta zbulonte rrjetin e grupeve të ekstremistëve islamistë.<sup>40</sup> Në hapësirën shqiptare bënë famë emisionet televizive të *Fiks Fare* (moderator Sajmir Kodra dhe Gent Pjetri) të televizionit *Top Channel*, gazetarët e të cilit shumë herë arritën të filmojnë drejtpërdrejt veprime të paligjshme të qeveritarëve apo të njerëzve të botës së biznesit. Disa prej këtyre emisioneve kanë nxitur procedura gjyqësore (si në rastin e rryshfjetmarrësve në Prizren) dhe shkarkime qeveritare (si në rastin e ministrit Ylli Pango). Ndërsa në botë është e famshme *Afera e Watergate* në Uashington në vitin 1972, me ç'rast gazetarët Carl Bernstein dhe Bob Woodward zbuluan një varg veprimesh kriminale të presidentit amerikan Richard Nikson dhe të njerëzve të tij. Pas publikimit të këtyre veprimeve presidenti Nikson dha dorëheqje. I gjithë ky proces gazetar-politik-juridik



67 gazetarë janë vrarë në botë në vitin 2015, ndërsa një vit më parë, më 2014, janë vrarë 66 gazetarë. Numrin më të madh të gazetarëve të vrarë në vitin 2015 e kanë vendet si: Iraku dhe Siria, pasuar nga Franca (viktimat e sulmit xhihadist kundër *Charlie Hebdo* më 7 janar), Jemeni, Sudani i Jugut, India, Meksika dhe Filipinet. Që prej vitit 2005, të paktën 787 gazetarë janë vrarë për shkak të profesionit të tyre.

Reporterët pa Kufi (RSF)  
Burimi: <https://index.rsf.org/#!/presentation>

filloi nga një informatë “e çuditshme”. Ja si e kujtoi më vonë këtë fillim Bob Woodwardi:



Afera e Watergate (1972)  
Carl Bernstein dhe Bob  
Woodward shkruan librin *All  
The President's Men* (1974)

“Një muaj më vonë, të shtunën e 17 qershorit, supervizori i FBI-së i telefoni zotit Felt (Mark Felt, zëvendës drejtor i FBI-së, B. K.) në shtëpi. Pesë burra, veshur me kostum, me xhepat e mbushur me kartëmonedha 100 dollarësh dhe pajisje përgjimi dhe fotografike, ishin arrestuar brenda shtabit kombëtar të demokratëve në ndërtesat e zyrave të Watergate-it, në orën 2:30 të natës.

Në orën 8:30 të mëngjesit zoti Felt u fut në zyrën e tij të FBI-së dhe filloi të kërkonte më shumë detaje. Pothuajse në të njëjtën kohë, redaktori i kronikës së Washington Post-it më zgjoi në shtëpi dhe më kërkoi të mbuloja një vjedhje paksa të çuditshme. Paragrafi i parë i artikullit në faqen e parë të Post-it thoshte: “Pesë burra, një prej të cilëve tha se kishte qenë punonjës i CIA-s, u arrestuan në 2:30 të natës së ditës së djeshme në një përpjekje që autoritetet e cilësuan si komplot të sofistikuar për të instaluar aparatura përgjimi në zyrat e Komitetit Kombëtar Demokrat.

Ditën tjetër Carl Bernstein-i dhe unë shkruam artikullin tonë të parë së bashku dhe identifikua njërin prej vjedhësve, James W. McCord Junior.”<sup>41</sup>

Në vitin 1974 dy gazetarët shkruan librin *All The President's Men*.

Por, pavarësisht rreziqeve të mëdha, rezultati i gazetarisë hulumtuese është shumë i madh. Ato mund të nisnin ndryshime qeverish, procese gjyqësore, por ndikojnë edhe si masë parandaluese ndaj së keqes. Në anën tjetër, bashkë me famën e mirë është rritur edhe fama e keqe e kësaj gazetarie. Shumë artikuj investigativë bëhen me qëllim të shantazhimit të individëve apo të grupeve të zëna jashtë ligjit, për të nxjerrë prej tyre përfitime të ndryshme. Në rastet e tilla gazetaria investiguese nuk është etike, poende shantazhimi nëpërmjet saj është i jashtëligjshëm. Gazetaria hulumtuese është dobiprurëse vetëm nëse është në interes të qytetarëve, jo në interes të gazetës apo ndonjë grupi të interesit që rri pas gazetës.

#### IV.4. GAZETARIA E SAKTË

Gazetaria e saktë është një nocion i ri në gazetari, pra i dekadave të fundit të shekullit XX. Një prej nismëtarëve të saj, Philip Meyer, e fillon kështu librin e tij *Gazetaria e saktë: Hyrje për gazetarët në metodat e shkencës shoqërore* (2002): “Ishte një kohë kur gjithçka që kishit nevojë ishte përkushtimi ndaj së vërtetës, shumë energji dhe

pak talent për të shkruar. Ju ende keni nevojë për këto gjëra, por ato nuk janë më të mjaftueshme. Bota është bërë kaq e ndërlikuar, rritja e informacionit të pranishëm kaq shpërthyes, saqë gazetari duhet të jetë një filtër aq sa edhe transmetues, një organizues aq sa edhe interpretues, krejt si edhe ai që mbledh e shpërndan fakte. Përveç aftësisë për të gjetur informacionin në shtyp, “on line” apo në transmetim, ai gjithashtu duhet të dijë se si ta fusë atë në kokën e marrësit. Shkurt, një gazetar duhet të jetë menaxher, përpunues dhe analizues të dhënash”.<sup>42</sup>

Më tutje, Meyeri shqyrton se çka do të thotë për gazetarin të jetë përpunues dhe analizues i të dhënave dhe kjo e çon te metodologjia e shkencave humaniste, d.t.th. një gazetari që përdor një metodë shkencore për analizën e fakteve, që ka një saktësi matematikore për përdorimin e numrave etj., e këtë gazetari e quan **gazetari e saktë**. Meyer, duke nisur nga ideja se një gazetar duhet të jetë i përsosur në një fushë të gazetarisë, kalon te krijimi i një metode shkencore të aplikueshme në gazetarinë praktike. Kjo metodë shkencore ka të bëjë me numrat dhe me hulumtimet, ose thënë me gjuhën e tij, jo me mënyrën e mbledhjes së fakteve dhe të informacioneve, por me mënyrën e analizës së tyre. Në fakt, kjo metodë e Meyerit është në përputhje të plotë me prirjet e gazetarisë moderne për ta tejkaluar “objektivitetin” dhe “neutralitetin” e gazetarit, sepse objektiviteti dhe neutraliteti janë vetëm njëra anë e së vërtetës, por jo e vërteta e plotë, prandaj gazetari duhet të ketë obligim parësor ndaj së vërtetës, pra ai vetë duhet ta mbledhë fakte e informacione, t’i analizojë dhe t’i kuptojë ato, vetëm pastaj ta bartë të vërtetën te marrësi. Nuk mjafton për të vërtetën vetëm sjellja e deklaratave të dy palëve, sepse ky lloj objektiviteti nuk është garanci e së vërtetës. Ndaj së vërtetës gazetari ka obligimin parësor, si thonë Bill Kovach dhe Tom Rosenstiehl në librin *Elementët e gazetarisë* (2001).<sup>43</sup>

Matematika në gazetari?  
PO.

## IV.5. KORPORATAT - FORMA TË REJA TË OLIGARKISË GAZETARE

Në gjysmën e dytë të shekullit XX e këndeje në botën e gazetarisë është duke ndodhur një shfaqje që mund ta përmbysë gjithë konceptin për gazetarinë e lirë e të pavarur dhe për gazetarinë profesionale. Ky proces është përqendrimi i shumë gazetave, rrjeteve televizive, radiostacioneve dhe rrjetave elektronike në duar të një individi apo të një grupi individësh. Kështu krijohet monopol mbi një strukturë të gjerë mediale, e kjo e krijon mundësinë që një qendër e vogël të kontrollojë një numër jashtëzakonisht të madh të

medieve, e në këtë mënyrë “kontrollon” informacionin që pranon një pjesë e madhe e botës. Shembulli më i mirë i këtij monopoli mbi gazetarinë është karriera e magnatit të sotëm të medieve, Rupert Murdoch, këtij pronari të një gazete të vogël australiane në vitet '60 të shekullit XX, e i cili sot kontrollon rrjetin më të madh medial në botë nëpërmjet kompanisë së tij News Corporation.

Mediet e familjes Murdoch, si *The Sun*-i, *Sky Television* britanik apo *Fox*-i amerikan janë të lira vetëm nga ndikimi i qeverive, por jo edhe nga interesat komerciale e politike të Murdochut dhe grupit të njerëzve rreth tij. Tashmë dihet edhe për ndërlidhjet e Rupert Murdochut me politikën. Murdoch është nga Australia dhe drejtimin e parë të gazetës *Adelajde* e mori nga i ati, pronar, në vitin 1953. Ai ndryshoi titullin dhe konceptin e gazetës, duke e bërë “më popullore”, që dmth. më bulevardeske, duke u marrë me thashetheme dhe me dokra të tjera kureshtarë dhe kështu e bëri të fuqishme gazetën e tij. Kjo i solli fitime dhe i mundësoi të blejë gazeta të tjera, duke i shndërruar edhe ato sipas të njëjtit koncept, për të përfunduar në njërin prej tre magnatëve të mëdhenj të medias australiane. Kjo i mundësoi shtrirjen e investimeve në televizion dhe në aviacion. Pastaj ai kaloi investimet edhe në tregun botëror, sidomos në Angli, në fund të viteve '60, duke shndërruar gazeta e televizione të ndryshme botërore në gazeta e televizione bulevardeske. Kështu, nga një gazetë social-demokrate angleze, *The Sun*, ai bëri gazetë bulevardeske që merret me thashethemet e pallatit mbretëror britanik. Nëpërmjet uljes së çmimeve të gazetës (duke shtuar tirazhin dhe duke krijuar monopol), nëpërmes publikimit të rregullt të thashethemeve, me botimin e fotografive pin-up, me femra gjysmë të zhveshura, ai arriti ta kontrollojë një pjesë të madhe të shtypit anglez.

Në vitet '80 Murdoch pushton televizionet: së pari *Sky Television* në Angli dhe pak më vonë *Fox* në ShBA. Në ShBA blenë edhe fondin e filmave të *XX-Century Fox* në Hollivud. Duhet theksuar se këto televizione kanë shtrirje shumë të gjerë: *Sky* transmeton në gjashtë kanale, ndërsa *Fox* transmetohet në 98 % të territorit amerikan dhe është një nga tre televizionet më të fuqishëm amerikanë. Edhe në televizione, si në gazeta, ai realizoi të njëjtin koncept: zhduku emisionet informative dhe i zëvendësoi me filma, filma vizatimorë, me reality-show etj.

Në vitin 1993 Murdoch, në bashkëpunim me pronarët Bertelsmann të *Vox TV* të Gjermanisë, u hodhën në tregun e lindjes: blenë në Hong Kong për një miliard dollarë amerikanë kanalën satelitor *Star TV* nga pronari Richard Li, i cili transmeton deri në 60 kanale televizive. Në fund të shekullit Murdoch prin edhe në gazetarinë digitale. Sot kompania e Murdochut quhet *News Corporation*. Ka



një pasuri prej disa miliardë dollarësh, shpërndanë çdo ditë rreth 60 milionë kopje të gazetave dhe furnizon çerekun e njerëzimit me emisione televizive. Tash është mjaft e fuqishme sa të mos pranojë asnjë ndërhyrje të asnjë qeverie derisa ka takime me liderët botërorë. Ai sot trajtohet si oligark i medias dhe mbisundon në gazetarinë e shtypur, në televizion, në film dhe në gazetarinë digjitale.<sup>44</sup>

Në vitin 2011 në Angli plasi skandali i revistës *News of the World*, pjesë e dinastisë mediale Murdoch, e cila ka përgjuar telefonat e fëmijëve të zhdukur, pastaj të familjeve të viktimave të sulmeve terroriste më 7 korrik 2005 dhe të familjeve të ushtarëve të vrarë në Afganistan. Revista ka përgjuar telefonin e 13-vjeçares Milly Dowler, e cila u vra në vitin 2002. Telefoni i saj u përgjua në kohën që familja dhe policia kërkonin pa pushim për të. Thuhet se punonjës të gazetës *News of the World* zhdukën disa mesazhe nga telefoni i saj, duke krijuar shpresa të kota tek prindërit e saj se ajo ishte ende gjallë.<sup>45</sup> Tabloidi britanik u mbyll më 10 korrik 2011, pas 168 vjetësh ekzistencë, ndërsa kryeredaktorja e tij dhe pronari Murdoch u hodhën në gjyq.

Ndërlidhja e këtyre individëve dhe e këtyre grupeve të magnatëve medialë me politikën paraqet një rrezik edhe më të madh për shtypin e lirë e për vetë politikën dhe stabilitetin e shteteve e më gjerë. Shembulli më i mirë i kësaj ndërlidhjeje është karriera mediale e politike e Silvio Berlusconi, kryeministrit të Italisë. Ai fillimisht kontrolloi mbretërinë mediale të Italisë dhe duke e përdorur atë mbretëri siguroi majën e piramidës së pushtetit italian: dy herë u bë kryeministër. Në anën tjetër, ai përdori politikën për ta mbështetur mbretërinë e tij mediale (ka dështuar më herët një gjykim i tij për korrupsion në këtë drejtim, ndërsa tash kërcënohet me gjykime të reja për afera të ndryshme, me ç'rast Gjykata e Lartë ia hoqi imunitetin ndaj ndjekjeve penale në fund të vitit 2009). Ai ka arritur të krijojë një kandar midis politikës e medias: peshoret i zhvendos nga njëri te tjetri tas i kandarit, varësisht nga interesat. Duhet vënuar se diçka e tillë është provuar edhe në gazetarinë e Kosovës, jo vetëm në një rast. Por, Kosova është treg shumë i vogël për të krijuar mbretëri mediale, prandaj ndërmarrësit kanë dështuar në të gjitha rastet.



Më 19 korrik 2011 Parlamenti Britanik e mori në pyetje Rupert Murdochun, pronar i News Corporation, James Murdochun, kryetar dhe drejtor ekzekutiv i News Corporation (International), dhe Rebekah Brooks, ish-kryeredaktore e News International, për skandalin e përgjimit të telefonave



Një prej librave gjithnjë e më të shpeshtë: zëri kundërshtues kundër korporatave hegjemoniste mediale.

## IV.6. FOTOZHURNALIZMI (FOTOGAZETARIA)

Në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX fotografia shfaqet në gazetari. Në vitin 1904 *Daily Illustrated Mirror* bëhet gazeta e parë britanike e cila e shfrytëzon fotografinë në vend të grafikës për ta ilustruar një artikull.<sup>46</sup> Në vitin 1910 del në Paris e përditshmja *Excelsior* në 12 faqe, 3 prej të cilave i kishte vetëm fotografi.<sup>47</sup> Kah mesi i shekullit XX fotografia merr një rol të rëndësishëm në gazetari.



Një prej ballinave të "The Daily Illustrated Mirror", ilustruar me fotografi

Një prej ballinave të "Excelsior", ilustruar me fotografi

"Për varrimin e Uinston Çerçillit në vitin 1965, *Sunday Times* ka angazhuar 21 fotografë që të mbanin 25 pozicione të ndryshme, që ta mbulojnë edhe ceremoninë edhe përjetimet e personave prezentë. Çdo detaj ka qenë i planifikuar shumë më herët. Redaktorët e fotografisë Xhek Hallam (Jack Hallam) dhe Kris Angeloglu (Chris Angeloglou) janë pajtuar për pozitat e fotografimit nga kulla e kishës, banka dhe dritaret e zyrave, shumë para vdekjes së Çerçillit".<sup>48</sup>


Fotozhurnalizmi (fotogazetaria) krijohet si koncept në gjysmën e dytë të shekullit XX. Ajo është prirje për mbizotërimin e fotografisë mbi tekstin gazetar. Fotografia është më besnike ndaj ngjarjes lajmore se çdo shkrim tjetër gazetar, pohojnë apologetët e fotozhurnalizmit.

"Fotogazetaria pretendon neutralitetin dhe objektivitetin, që nënkupton se 'lexuesit' e fotografive të tilla me të drejtë mund të parashtronjë pyetje mbi vërtetësinë fotografike".<sup>49</sup>

Krahas këtij informimi tejpërtej të vërtetë, gjatë gjithë kohës fotozhurnalizmi ka ecur edhe në një vijë tjetër: publikimi i fotografisë



për argëtim. Që nga mesi i shekullit XX, sidomos kah fundi i atij shekulli dhe fillimshekulli XXI, plot revista të ndryshme nëpër botë, që botohen në glace (letër e kualitetit më të lartë) mbizotërohen pothuajse qind për qind nga fotografia me temë të ndryshme argëtuese: mode, fotografitë pin-up, fotografi nga jeta e artistëve apo nga mundësitë e mëdha që krijon jeta etj. Dy llojet më të famshme të kësaj gazetarie janë fotolajmi dhe fotoreportazhi.



Ballina e librit të Kenet Kobre, Zhurnalizmi / qasja profesionale

## IV.7. “FJALIMI PËR LIDERIN” - GAZETARIA DHE ORATORIA

Në kulturën antike greke dhe romake gojëtaria si praktikë (bashkë me teorinë e retorikën) ka qenë një formë shprehëse e lartë dhe e çmueshme. Edhe sot përmenden fjalimet e zjarra të Demostenit, të Ciceronit etj. Retorika, shkencë për mjeshtërinë e fjalimit, pra të gojëtarisë (lat. *oratoria*), ka qenë një prej shkencave më të rëndësishme dhe më me ndikim. Sot gojëtaria nuk ka atë funksion dhe atë rol publik si në botën antike, në radhë të parë për shkak zhvillimit të medieeve. Por, edhe sot gojëtaria luan një rol të rëndësishëm në jetën politike dhe juridike. Edhe sot teoricienët e fjalimeve, të cilët bëjnë punën e retorëve të vjetër, krijojnë rregulla se si duhet të formulohet një fjalim. Gjithsesi puna e këtyre teoricienëve sot është pothuajse e pahetueshme, sepse mjeshtëria e hartimit të fjalimeve i është lënë aftësisë individuale të fituar gjatë shkollimit dhe përvojës letrare e gazetare.

Politikanët e lartë nuk i shkruajnë vetë fjalimet. Ata vetëm i konceptojnë, japin një apo disa ide themelore se çka duhet të përmbajë fjalimi i tyre dhe, janë të tjerët që bëjnë punën e mëpastajme. Kjo gjë nuk pranohet me plot gojën, prandaj gjenden eufemizma për të shprehur këtë punë të “të tjerëve” në fjalimet e politikanëve. Jon Favreua ua “jep dorën e fundit” fjalimeve të presidentit amerikan Barak Obama.<sup>50</sup>


Një fjalim në parlament, një fjalim në fushatë zgjedhore, një fjalim për këtë apo atë rast, festiv apo mortor, nuk është i njëjtë me një shkrim publicistik, po gjithsesi është i afërt me të. Teknika

e hartimit të një fjalimi gjithsesi nuk është e ngjashme me atë të shkrimit të një komenti, apo të një pamfleti. As qëllimi përmbajtjesor i fjalimit nuk është i ngjashëm me atë të një lajmi, reportazhi apo të një fejtoni. Por, fakti që edhe fjalimi, sikur shkrimi gazetar, bart mesazhe, ide, informacione, kumte etj. tek opinioni publik, e afron atë me shkrimin gazetar. Qëllimi i fjalimit është me karakter propagandistik, pra ai synon t'i bindë dëgjuesit për një çështje. Struktura e ligjërimit ndërtohet në atë mënyrë që të tingëllojë si bindje. Bile folësit i lejohet edhe të shprehë fjalë sigurie e garancie për ato që thotë, si: *besoni se..., ju garantoj...* etj. Teknikat e ndërtimit të një fjalimi janë të shumta dhe ato përshtaten nga rasti në rast, varësisht nga dëgjuesi, nga numri i tyre, nga niveli kulturor, nga interesimi i tyre etj.

## IV. 8. GAZETARIA GLOBALE

Nga prirjet e gazetarisë moderne vlen të veçohet gazetaria globale. Që nga gjysma e dytë e shekullit XX, sidomos me zbulimin e valëve të radios e të televizionit, është forcuar prirja për krijimin e medieve, që kanë ndikim në tërë globin tokësor. Në të vërtetë, kjo ishte një ëndërr e adhuruesve të telegrafit të shekullit XIX, por e perealizuar atëherë. Vetëm në revolucionin e dytë të gazetarisë, në epokën elektronike, po krijohet gjithnjë e më shpejt gazetaria globale. Kështu, CNN, BBC etj. kanë pasur dhe vazhdojnë ta kenë një ndikim të madh në katër anët e globit. Kjo prirje për gazetari globale u bë e zakonshme pas revolucionit të fundit teknologjik, zbulimit të postës elektronike. Korporatat e forta mediale nuk mund të paramendohen jashtë konceptit

gazetari globale. Gazetaria ka ecur përpara politikës në këtë proces të globalizimit. Kanali i lajmeve i CNN International emetohet në më shumë se 210 shtete. Kaherë teoricienët e gazetarisë kanë krijuar nocionet përkatëse për këtë prirje globaliste: *Fshati global* i MaLuhanit (monolitizimi i kulturave në tërë botën) dhe *Metropolis global* (bashkëjetesa e shumë kulturave, multikulturalizmi)<sup>51</sup> janë dy togëfjalësh që paraqesin botën në tërësinë e saj të vogël, si një fshat apo një qytet, e deri te *glokalizmi*, që paraqet një kuptim të ri nga kompozita e fjalëve lokale+globale.




## IV.9. GAZETARIA DIGJITALE

Edhe pse ende nuk ka filluar periudha e vërtetë e gazetarisë digjitale, ajo tashmë ka një histori disaveqëare. Vetë emri ende nuk është i stabilizuar. Përdoren edhe emërtime të tjera si gazetaria digjitale, uebgazetaria, gazetaria elektronike etj. Historia e saj, sado është e shkurtër, është mbresëlënëse, e bujshme dhe me plot prirje për të ardhmen.

Gazetaria digjitale e fillon jetën e saj në vitet '90 të shekullit XX. Parakushti i lindjes së saj, natyrisht, ishte kompjuteri dhe posta elektronike me gjithë rrjetin. Në vitin 1992 kompjuteri kishte depërtuar mjaft shumë në familjet evropiane dhe amerikane: 20 % e familjeve amerikane tashmë kishin në shtëpi kompjuterë. Në këtë vit, nga 1 570 të përditshme amerikane, vetëm 13 ofronin ndonjë lloj të edicionit digjital, për të arritur në 3 100 në vitin 2000.<sup>52</sup> Fillimisht, gazetat përgatisnin pjesë elektronike të variantit letër dhe i vendosnin në ueb. Gazeta e parë që doli e plotë në uebfaqe qe *News & Observer*, në Karolinën e Veriut, por edhe ky ishte vetëm varianti elektronik i gazetës në letër. Vetëm në vitin 1995 David Talbot la pozitën e redaktorit të kulturës në një gazetë dhe nxori revistën *Salon*, botim i veçantë për ueb.<sup>53</sup> Kjo është gazeta e parë e përgatitur ekskluzivisht për uebfaqe.

**WANTED** 107 PEOPLE WITH HEARING LOSS | Visit [www.AccuQuest.com](http://www.AccuQuest.com)



71°  
Sign In | Subscribe

FULL MENU LOCAL NEWS SPORTS LIVING CLASSIFIEDS

**\$1.99 for 4 weeks** **UNLIMITED DIGITAL ACCESS**

Voters Guide: NC June 7 primary



**Best-Kept Secrets: For beer lovers** 00:54

Facebook Twitter Email Share

**LATEST NEWS**

**Officials: Motorcyclist hit 125 mph in Raleigh chase**  
5:38 AM

**Rare militant attack on Jordan security compound kills 5**  
6:34 AM

**Tropical Storm Colin heading toward Florida's Gulf coast**  
5:24 AM

**NPR journalist David Gilkey, translator killed on assignment**  
12:33 AM

**Warriors whip Cavaliers 110-77 to take 2-0 NBA Finals lead**  
10:41 AM

[VIEW ALL](#)

**BEST-KEPT SECRETS**

**Wilmington catches the NC craft beer wave**  
12:32 AM

**HIGHLIGHTS**

Years ago, as the craft beer wave swept the Triangle, Asheville and Charlotte, the Port City missed the tide. Now, after years with a lone brewery and a couple of bottle shops, Wilmington is awash.



**JOSH SHAFFER**  
NC Elvis impersonator dies after six King-ly decades  
8:10 AM



**WAKE COUNTY**  
In Ironman competition it's all about gumption  
7:01 PM



**LUKE DECOCK**  
NC State needs answers against Coastal Carolina, not once but twice

**dealsaver**  
Brewery Tour Club Card!



June 7-12, 2016  
Seats start at \$25  
Get Tickets

**\$65 \$25** [Get the Deal](#)

Portali News & Observer sot (2016)

Kështu fillon historia e gazetarisë digjitale, e cila pati periudha ngritjeje marramendëse dhe rënie të mëdha vetëm në pak vjet. Sot kjo gazetari vazhdon të jetë edhe si partnere, por edhe si armike e gazetarisë në letër. Përfundimisht, në fund të shekullit XX gazetaria u nda përgjithnjë prej letrës, ani pse ende gazetaria digjitale nuk mund ta zëvendësojë gazetarinë në letër, por fakti se ajo tashmë jeton edhe vetëm në formën digjitale, është një fakt revolucionar. Shumë gazeta e revista në botë kanë vetëm versionin digjital. Ato kanë faqet e tyre (*web site*) apo mund të jenë sajte brenda ndonjë kompanie më të madhe që ofron shërbime informimi. Fillimisht fitimet ishin të mëdha por, jo gjithnjë, se ka pasur edhe dështime. Gazetat shërbehen falas për përdorim, ndërsa mbijetojnë prej marketingut. Disa herë pronarët janë munduar që shërbimet t'i bëjnë me para, por nuk kanë pasur sukses. Përfundimisht, në vitin 2009 magnatët medialë paralajmëruan se sërish do të ofrojnë shërbime me para.

Gazetaria digjitale ka dallime thelbësore nga gazetaria në letër. Zhanret dhe llojet e tekstit në gazetarinë tradicionale këtu reduktohen vetëm në disa prej tyre. Po ashtu, gjatësia e tekstit është thelbësisht e ndryshme. Gazetari tradicional duhet të ushtrojë një kohë, apo gjatë studimeve të bëjë kurse, për t'u aftësuar për gazetarinë digjitale. Dallimet nuk janë vetëm në zhanret e në gjatësinë e tekstit, por edhe në stilin e shkrimit e deri edhe në "çështje teknike". Këto të fundit nuk janë thjesht "çështje teknike, por janë njohuri të konsiderueshme për kompjuterin dhe gjithçka që lidhet me të dhe teknologjinë elektronike-informative. Pa njohjen e kësaj teknologjie gazetari nuk mund të jetë uebgazetar. Është njëlloj sikur për kameramanin të mos dijë ta përdorë kamerën. Kompjuteri për uebgazetarin nuk paraqet vetëm një mjet pune, si për çdo person tjetër, por mediumin ku ekziston prodhimi i tij, uebgazetaria. Stili i shkrimit është një hap më larg. Ja çfarë thotë një teoricien i kësaj gazetarie, duke komentuar përfundimin e Jakob Nielsenit<sup>54</sup>, se "njerëzit rrallë i lexojnë fjalë për fjalë faqet ueb, më tepër i hedhin një sy faqes, duke kapur fjalë apo fjali aty këtu": "Kjo e dhënë bën të ndryshojë kryekëput mënyra e të shkruarit për rrjetin. Për ta tërhequr vëmendjen e një lexuesi kaq të nxituar, që kalon diagonalisht nëpër tekste dhe nuk i lexon ato në mënyrë lineare, rresht për rresht, duhet shpikur një sintaksë e re dhe një estetikë krejt tjetër".<sup>55</sup>

Gazetaria digjitale ka disa përparësi thelbësore ndaj gazetarisë tradicionale:

- ka më pak shpenzime si për botuesin ashtu edhe për lexuesin;
- merr më pak kohë për t'i lexuar gjërat që dëshiron lexuesi;

- azhurnohet gjatë 24 orëve, pra çdo orë mund t'i rifreskojë lajmet me të dhëna të reja;
- lexuesi mund ta përdorë tekstin e gazetës edhe për nevojat e tij (mund ta kopjojë dhe ta ruajë në arkivin e tij);
- lexuesi ka qasje në arkivin e gazetës, pra ka në përdorim jo vetëm në një numër të gazetës, por gazetat e një muaji, apo të disa vjetëve;
- gazeta e udhëzon lexuesin të lidhet edhe me linçe të tjerë, ku ka artikuj të njëjtë apo të afërt me artikullin e porsalexuar;
- gazeta e lidh lexuesin edhe me gazeta apo agjenci të tjera, për të parë se si ato kanë shkruar për të njëjtën çështje;
- gazeta krijon mundësinë që edhe vetë lexuesi t'i komentojë artikujt e gazetës, ta bëjë pikësimin e tyre, po edhe të komenteve të lexuesve. Pikësimi bëhet nga 1 (dobët) deri në 5 (shkëlqyeshëm) dhe disa gazeta i rangojnë artikujt, bile edhe komentet, në bazë të këtij pikësimi. Kështu, disa teoricienë të gazetarisë këtë bashkëpunim të gazetës me lexuesin e quajnë bashkautorësi.<sup>56</sup> Disa e kanë quajtur këtë "demokratizim të medias", ndërsa cinikët "popullizëm të medias".

Ja si e parafrazon Stagliano fjalën e hyrjes së faqes [www.plastic.com](http://www.plastic.com) të Joey Anuff:

*"Në gazetarinë 2.0 kryeredaktori është njëshi, askush, ose njëqind mijë vetë bashkë. Janë lexuesit ata që kanë rëndësi dhe nuk është fjala thjesht për një parullë. Të gjithë kanë të drejtën e fjalës, por vetëm atij që thotë gjëra të zgjuara do t'i dëgjohet zëri dhe do të ketë privilegjin të lexohet nga shumë njerëz. Mirëserdhët në Plastic, gjysmërevistë e gjysmëgrup diskutimi, e ardhmja e mënyrës se si të bësh informacione digjitale që, edhe pse embrionet e veta, kanë ngjallur fantazinë e ithtarëve të rrugës internetiane dhe gazetarisë demokratike."<sup>57</sup>*

Një përmasë tjetër e gazetarisë digjitale është fakti se ajo është mjet i shkëlqyeshëm i ndikimit në masë dhe, si e tillë, gjithnjë i nënshtrohet rrezikut të keqpërdorimit. Në të dy aspektet ka shembuj kardinalë. Në rastin e parë është lufta e Kosovës, e cila është përcjellë prej miliona njerëzve nëpër botë nëpërmjet internetit. Jim Hall, sipas Staglianos, thotë se lufta e Kosovës është konflikti i parë ndërkombëtar i përcjellë nëpërmjet internetit.

*"Të nesërmen e bombardimeve të NATO-s faqet që sajti i CNN-it ua kushtoi ngjarjeve u vizituan 31 milionë herë, numër që deri në fund të javës arriti në 154 milionë."<sup>58</sup>*

Në rastin e dytë, shembulli më eklatant është terrori i ekstremistëve islamistë, prej deklaratave të liderëve të Al Qaeda-s e deri tek ekzekutimi i gazetarëve apo njerëzve të tjerë joarabë, të cilat ekzekutime disa herë janë shpërndarë në rrjetin e internetit, si është rasti i gazetarit amerikan Daniel Pearl (1963 - 2002), shef i Zyrës në Azinë Lindore i *Wall Street Journal*-it, i cili u kidnapua, u torturua dhe u ekzekutua në Karachi të Pakistanit nga ekstremistët islamistë.

Gazetaria digjitale ka krijuar, në fund të shekullit XX, edhe disa prirje të fuqishme gazetare: gazetarinë e blogut, me-zin gazetarinë dhe gazetarinë qytetare ose personale (anglisht: personal journalism, civil journalism).

**Blog-u.** Fjala vjen prej *web log*, të cilën Peter Merholz e ndau me shaka në vitin 1999 në *we blog* dhe prej atëherë u fut në përdorim vetëm pjesa **blog**, e cila nuk ka kurrfarë kuptimi. Në aspektin e qenësimit blogu është i ngjashëm me uebsajtin, vetëm se është i përmasave më të vogla dhe ofron mundësi më të vogla: blogu është një faqe e madhe, pronë e një personi, e cila lidhet me linçe të ndryshme të mëdha, në të cilën pronari vendos shkrime të tij për t'ia bërë të ditura botës. Provajderë të ndryshëm ofrojnë edhe shërbime falas për individët që të krijojnë blogë, sepse kjo e shumëfishon numrin e vizitorëve. Më e njohura është [www.blogger.com](http://www.blogger.com).

Blogje kanë krijuar me miliona njerëz anembanë botës. Blogu është thjesht një lloj ditari i një individi, i cili shkruan mendimet apo komentet e tij për gjëra të ditës dhe i bën publike nëpërmjet internetit. Njëkohësisht është edhe një arkivë e personit e hapur ndaj botës. Zakonisht, ato më të mirat, zgjojnë debate në rrethe të caktuar.



Ironizimi i thënies së famshme të Hamletit të Shekspir: "Të rrosh a mos të rrosh, kjo është çështja?"



**Me-zine gazetaria.** Fjalën e ka përdorur Alex Kuczynski në një shkrim të botuar në *New York Times* në vitin 2001.<sup>59</sup> Është një variant i blogut, vetëm se tash pronari i faqes ueb është një gazetar, i cili i boton aty gjithë ato që shkruan dhe kështu komunikon me lexuesin. Kjo gazetari i krijon gazetarit vështirësi financiare (sidomos nëse nuk është i angazhuar edhe në ndonjë gazetë tjetër), por edhe disa lehtësi (ai është i lirë, nuk ka asnjë redaktor mbi kokë, nuk është i detyruar të bëjë vetëm lajme, por edhe komente rreth lajmeve etj.). Përparësi e kësaj gazetarie është edhe fakti se mund të keni në një vend gjithë veprën e gazetarit. Ky fakt e ngre gazetarin në rang me autorët e librave, edhe pse secili artikull gazetarie lexohet veçmas nga tjetri, gjë që nuk mund të thuhet për kapitujt e një libri letërsie. Ana e errët është fakti se artikujt e me-zine gazetarisë humbin diçka nga aktualiteti: lexuesi kërkon lajmin dhe jo komentin e gazetarit. Prandaj me-zine gazetaria është sikur një jehonë gazetarie. Megjithatë, nuk është gjithmonë kështu.

Me-zine gazetaria lidhet shumë me emrin e Matt Drudge dhe faqen e tij të internetit, jo për shkak të cilësisë, por për shkak se ai “zbuloi” i pari aferën Levinski. Drudge, pasi nuk kishte pasur sukses në asnjë lëmë të jetës, bënte një tregti të vogël në një skaj të rrugës dhe aty dëgjonte thashethemet e mëdha të Amerikës. Edhe kur dësh-tonte (botonte informata të rrejshme) ai mjaftohej me një kërkim falje. Ai i botoi në faqen e tij thashethemet për skandalin seksual të presidentit Clinton, i cili e lëvizi krejt opinionin amerikan, madje edhe atë botëror. Sipas vetë autorit, faqja e tij në këtë kohë arriti numrin rekord prej 90 milionë vizitorëve.<sup>60</sup>

Pavarësisht nga vizitorët rekordë, mënyra e punës së Drudgit ka irrituar dhe inkurajuar njëkohësisht shumë gazetarë dhe teoricienë të gazetarisë. Ja si e përshkruan këtë fakt Riccardo Stagliano: “Janë quajtur të papërshtatshëm, madje diletantë të rrezikshëm të gazetarisë, janë konsideruar të gjithë ata që, me Matt Drudge në krye, pa pasur një kurrikulum profesional tradicional, pra një formim akademik, apo përvojë praktike në redaksi, s’kanë dashur t’ia dinë dhe kanë dalë më vete me sajte-gazetë, që herë-herë kanë një sukses të jashtëzakonshëm”.<sup>61</sup>

**Gazetaria personale (qytetare).** Ky është trendi më i ri i gazetarisë. Disa e quajnë edhe gazetari qytetare, gazetari individuale, gazetari participuese etj. Derisa teknologjia informative ka arritur këtë shkallë që ka sot, derisa kompjuteri, kamera, telefoni digjital me kamerë dhe rrjeti postar elektronik kanë depërtuar në të katër anët e botës dhe mund të depërtojnë në çdo skutë, edhe atje ku nuk ka energji elektrike (nëpërmjet PC-ve), derisa secili prej tetë miliardë njerëzve të botës mund të incizojë pamje të drejtpërdrejta

me telefonin e tij digjital dhe brenda vetëm disa sekondave t'i postojë në rrjetin elektronik, po ashtu vetëm brenda disa sekondave miliardat e tjerë të njerëzve mund t'i shohin ato pamje, atëherë cili është roli i gazetarit në këtë rrjet të informacionit? Stagliano pyet me ironi: "...përse, në vend që t'i ulim rangjet, nuk i heqim fare, ose pothuajse fare, gazetarët?"<sup>62</sup>

OhmyNews.com

**OhmyNews.com** është një prej gazetave "on line" më me ndikim në Korenë Jugore, atraktive dhe ka arritur besimin e rreth dy milionë lexuesve në ditë. Ajo çka është e pazakonshme në këtë gazetë "on line" është fakti se këta lexues jo vetëm lexojnë lajmet e gazetës, por ata edhe i shkruajnë ato. Ajo ka të regjistruar rreth 26 000 qytetarë-gazetarë që dëshirojnë të marrin pjesë në shkrimin e lajmeve.<sup>63</sup>

Tashmë edhe në shqip janë krijuar faqe të tilla. Hapeni <http://laj.me> dhe do të gjeni këtë shënim:

Lajmi është ne dorën tuaj! Me ane te portalit **Laj.me** ju mund te bëheni autor lajmesh, duke i treguar botes se çfarë po ndodh. Tashme nuk janë vetëm TV e gazetatat qe japin lajme...

Në krye e keni direktoriumin *Jep lajme*, dhe kur ta hapni atë, ju do të shihni se kërkohet *username* dhe *password* për të hyrë e për të krijuar lajme. Natyrisht, *username* e *password* janë për qytetarët-gazetarë të zgjedhur në mesin e autorëve të lajmeve. Kjo gazetari, aq sa ofron shansin e madh, po aq edhe krijon frikën e madhe, sepse mundësitë e keqpërdorimit janë shumë më të mëdha se në çdo zhanër apo medium tjetër gazetar. Edhe këtu mund të përmendim dy shembuj krejtësisht të kundërt. I pari ka të bëjë me incizimin anonim, nëpërmjet telefonit digjital, i rrahjes së një nxënësi nga arsimtari i tij në një klasë të një shkolle publike në Prishtinë. Incizimi u shpërmda në internet dhe RTK e mori nga aty dhe e dha në lajmet qendrore. I dyti ka të bëjë me ekzekutimin gjyqësor të ish-presidentit irakian, Sadam Husein. Incizimi i fshehtë i varjes së Sadam Huseinit, po ashtu me një telefon digjital, dhe shpërmdarja e tij në rrjetin digjital e irritoi pa masë publikun botëror.

Shayne Bowman dhe Chris Willis e kanë thënë bukur me një fjali:

*Personalizimi më i madh domosdoshmërisht e nënkupton të kuptuarit më të madh të demokracisë?*<sup>64</sup>

Pastaj, një pikë e dobët e kësaj gazetarie është edhe besimi i marrësit. Si mund të jetë marrësi i besueshëm në ato që shkruan njëri prej 26 000 qytetarëve-gazetarë të **OhmyNews.com**? Ekziston deontologjia e gazetarisë, dhe në secilin vend ekzistojnë rregulla që e përkufizojnë të drejtën dhe përgjegjësinë e gazetarit në shoqëri, dhe ato e obligojnë gazetarin. Marrësi e beson një lajm të tillë sepse



ai është i vetëdijshëm paraprakisht se janë disa filtra moralë, por edhe juridikë nëpër të cilët duhet të matet vërtetësia e shkrimit të një gazetari. Ndërsa në gazetarinë personale nuk ka filtra të tillë. Mirëpo, kjo gazetari është një vizion për të ardhmen, të cilën ne sot nuk mund ta paragjykojmë. Ende nuk mund të flitet për të. Fakti është se gjithnjë e më shumë, sidomos në ngjarje tronditëse, në çastet kur gazetarët nuk mund të arrijnë, individë të ndryshëm bëjnë incizime, me kamera digjitale, me telefona digjitalë dhe i postojnë në faqet e tyre në internet dhe i shpërndajnë në gjithë botën.



Një prej karikaturave për gazetarinë qytetare. Burimi: maichimai2611.wordpress.com

**Gazeta për Mua.** Partecipimi i qytetarëve në bërjen e lajmit është vetëm njëra faqe e gazetarisë personale. Faqja e dytë është ajo që Nicholas Negroponte në librin e tij *Being Digital* (1995) e quan *The Daily Me* (Gazeta për Mua). Negroponte thotë se gazeta "on line" në të ardhmen do t'i japë mundësi lexuesit t'i zgjedhë vetëm temat dhe burimet që atij i interesojnë.<sup>65</sup> Miliona përdorues të faqes [www.yahoo.com](http://www.yahoo.com) shërbehen më me dëshirë me portalin *My Yahoo personal news*, në të cilin gjejnë lajme telegrafike të zgjedhur nga redaktorët prej gazetave të ndryshme botërore. Ka edhe më shumë: faqet e lajmeve të [www.google.com](http://www.google.com) e përdorin algoritmin e kompjuterit për të selektuar mijëra tituj nga gazetat e ndryshme botërore dhe nga sajtet "on line". Kështu, marrësi i lajmit ka mundësi nga gjithë ajo mori lajmesh, të mira e të këqija, t'i zgjedhë vetëm ato që atij i interesojnë, e kjo do të thotë se ai në çdo orë të ditës ta ketë në kompjuterin e tij "gazetën" që atij i intereson. Kjo është *Gazeta për Mua* e Negropontes.

Gazeta për Mua

## Shënime

1. Për teoritë normative në gazetari shih artikullin e Rodney Bensonit, *Normative Theories of Journalism*, The Blackwell International Encyclopedia of Communication, (Wolfgang Donsbach, ed., 2008), pp 2591-2597. Shih edhe në: <http://steinhardt.nyu.edu/scmsAdmin/uploads/006/246/Benson%20Normative%20Theories.pdf>
2. Kurt Lang and Gladys Engel Lang, *The Unique Perspective of Television and its Effects: A Pilot Study*, in *American Sociological Review*, 18, 1952, Pp. 3-12.
3. *Fjalor i shqipës së sotme*, ASH e RPSSH, Tiranë, 1984. Këtë kuptim e japin, pak a shumë, të gjitha enciklopeditë dhe fjalorët e huaj.
4. Shih, për shembull, studiuesin anglez Dauglas Biber dhe librin e tij *A typology of English texts*, Amsterdam: Mouton de Gruyter, (1989).
5. Shih raportin *Preliminary Recommendations on Text Typology*, EAGLES/Version of Jun 1996, në adresën <http://www.ilc.cnr.it/EAGLES96/browse.html>
6. Cituar sipas gazetës *Zëri*, 20 mars 2009. Sipas së njëjtës analizë, *Financial Times* ka shitur në vitin 2009 2.5 % kopje më pak se një vit më herët; *The New York Times* u detyrua ta shiste selinë e re për t'i paguar borxhet; *Philadelphia Enquirer*, e cila dilte prej 180 vjetëve, falimento; *San Francisco Chronicle* është në prag të mbylljes etj.
7. Cituar sipas Elihu Katz ect., *Tekste kanonike të kërkimit në media*, ISHM, Tiranë, 2009, fq. 260-316.
8. Marshall McLuhan, *Instrumentat e komunikimit: media si një zgjatim i njeriut*, Instituti i Dialogut & Komunikimit, Tiranë, 2008.
9. Shih për këtë përqeshje një pasqyrë të autorëve e të librave në Elihu Katz ect., *Tekste kanonike të kërkimit në media*, ISHM, Tiranë, 2009, fq. 332-341.
10. Cituar nga Joseph R. Dominick, *Dinamika e komunikimit masiv: Media në periudhën digjitale*, UET Press, Tiranë, 2010, fq. 34-39.
11. Angela Phillips, *Good writing for Journalists*, SAGE Publications Ltd, 2007, pp. 185-195.
12. Đorđe Obradović, *Kolumne nisu novinski rod*, në *Medianali*, Vol. 2, No. 3, 2008, fq. 13-37 ([http://hrcak.srce.hr/index.php?show=clanak&id\\_clanak\\_jezik=66268](http://hrcak.srce.hr/index.php?show=clanak&id_clanak_jezik=66268)).
13. Ann Jefferson & Davi Robey, *Teoria letrare moderne: një paraqitje krahasuese*, Albas, 2004, përkthyer nga Floresha Dado, botim i parë në anglisht 1982, fq. 42-69.
14. Aa, Nn, *Form and Style in journalism. Evropan Newspapers and the Representation of News, 1880-2005*, nën redaktimin e Marcel Broersmas, Peeters, Leuven-Paris..., 2007, p. XXV.
15. Daniel Chandler në *An Introduction to Genre Theory*, 1997, <http://www.aber.ac.uk/media/Documents/intgenre/intgenre.html>
16. Figura e shikimit në retrovizor është marrë nga Marshall McLuhan.
17. Cvetan Todorov, *Origjina e zhanreve*, cituar sipas përkthimit të Nysret Krasniqit, në librin *Teori dhe kritikë moderne*, Rozafa, Prishtinë, 2010, fq. 313-342.
18. Për një literaturë më të gjerë për teorinë e zhanrit shih Rebecca Moore Howard, *Genre Theory*, në <http://www.rebeccamoorehoward.com/bibliographies/genre-theory>.
19. Në këtë çështje hapet një problem i identifikuar në teorinë e letërsisë. Vlen të përmendet vetëm sa për plotësim fakti se Zejnullah Rrahmani në përkthim të *Teorisë së letërsisë së Velek Vorenit* e përdor nocionin zhanër, ndërsa në librin e tij *Teoria e letërsisë* po ky autor përdor nocionin gjini e jo zhanër. Shih më tej: Milivoj Solar, *Književni leksikon*, Matica Hrvatska, 2007; Zejnullah Rrahmani, *Teoria e letërsisë*, Prishtinë, 2008; *Rečnik književnih termina*, Beograd, 1992.

20. Aa, Nn, *Form and Style in journalism. Evropian Newspapers and the Representation of News, 1880-2005*, nën redaktimin e Marcel Broersma-s, Peeters, Leuven-Paris..., 2007, p. 51.
21. Rečnik književnih termina, fq. 947.
22. Boris Tomaševski, *Teorija književnosti*, Književna Misao, Beograd, 1972, fq. 228.
23. O. Dykro; C. Todorov, *Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimit*, Rilindja, Prishtinë, 1984, fq. 213.
24. Ferdinand de Sosyr e quan sistem organizimin e brendshëm të një ligjërimi, ndërsa pasardhësit e tij i japin një nuancë dhe e quajnë strukturë.
25. Cvetan Todorov, *Origjina e zhanreve*, cituar sipas përkthimit të Nysret Krasniqit, në librin *Teori dhe kritikë moderne*, Rozafa, Prishtinë, 2010, fq. 313-342.
26. Po aty fq. 313-342.
27. Shih për këtë te: Teun A. Van Dijk, *News Analysis: case studies of International and National News in the Press*, Lawrence Erlbaum Associates, New Jersey Hove and London, 1988. Teun A. Van Dijk, *News as Discourse*, Lawrence Erlbaum Associates, New Jersey Hove and London, 1988, p. 1.
28. Teun A. Van Dijk, *News as Discourse*, Lawrence Erlbaum Associates, New Jersey Hove and London, 1988, p. 41.
29. David Randall, *Gazetari universal*, ISHM, Tiranë, 2003, fq. 11.
30. Aa, Nn, *Form and Style in journalism. Evropian Newspapers and the Representation of News, 1880-2005*, nën redaktimin e Marcel Broersmas, Peeters, Leuven-Paris..., 2007, p. XVII.
31. Një shtyp i lirë, USIS, Vienna, fq. 17.
32. *Manual për gazetarët e Europës Qendrore dhe Lindore*, "Dituria", 2003, grup autorësh, edituar nga Mallcolm F. Mallete, fq. 66.
33. Barbier & Lavenir, *Historia e medias nga Dideroi te interneti*, fq. 166.
34. Ibrahim Berisha, *Media-agjensët e komunikimeve*, AAB, Prishtinë, 2007, fq. 167-168.
35. Po aty fq. 33.
36. Bill Kovach, Tom Rosenstiel, *Elementët e gazetarisë*, ISHM, Tiranë, 2009, fq. 47 e tutje.
37. Amendamenti I-rë i Kushtetutës së ShBA-së, i miratuar në vitin 1791.
38. *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, Neni 40.
39. *Television across Europe: regulation, policy and independence/ Monitoring Report 2009/Kosovo*, by Vjollca Krasniqi. Published by Open Society Institute, New York. [www.eumap.org](http://www.eumap.org). [www.mediapolicy.org](http://www.mediapolicy.org). Shih edhe Reporters without Borders, Kosovo, në [www.rsf.org](http://www.rsf.org).
40. Lista e shteteve me vrasjet më mëdha:

Shtetet	Vrasje të konfirmuara 1995-2004	Shtetet	Vrasje të konfirmuara 1995-2004
Irak	36	Sierra Leone	15
Algjeri	33	Brazil	12
Kolumbi	30	Afganistan	10
Rusi	29	Bangladesh	10
Filipine	22	Meksiko	9
Indi	16		

Cituar sipas: Ian Hargreaves, *Journalism, A Very Short Introduction* (2005), versioni elektronik.

41. Cituar sipas Aa, Nn., *Gazetaria investigative*, ISHM, Tiranë, 2005, artikulli i Bob Woodward, *Si u bë drejtuesi i FBI-së 'gryka e thellë' e Watergatiit?*

42. Ph. Meyer, *Gazetaria e saktë: Hyrje për gazetarët në metodat e shkencës shoqërore*, Botimet Koçi, Tiranë, 2006, fq. 7.
43. Bill Kovach, Tom Rosenstiel, *Elementët e gazetarisë*, ISHM, Tiranë, 2009, fq. 46-66.
44. F. Barbier, C. Berho Lavenier, *Historia e medias nga Dideroi te interneti*, ISHM, Tiranë, 2004, fq. 288.
45. Zëri i Amerikës, përditësuar më 11.07.2011, në <http://www.zeriamerikes.com/content/mbyllet-gazeta-news-of-the-world-ndersa-skandali-ne-britani-perhapet-125350758/467180.html>
46. Patrisha Holland, *Fotografia e gazetarisë*, artikull i botuar në revistën kërkimore *Media*, nr. 2, UP, FF, Dega e Gazetarisë, 2010, fq.
47. Barbier & Lavenir, *Historia e medias nga Dideroi te interneti*, ISHM, Tiranë, 2004, fq. 159.
48. Patrisha Holland, *Fotografia e gazetarisë*, artikull i botuar në revistën kërkimore *Media*, nr. 2, UP, FF, Dega e Gazetarisë, 2010, fq.
49. Po aty fq.
50. *What would Obama say?*, New York Times, by Ashley Parker, Published: January 20, 2008
51. Ibrahim Berisha, *Media-agjensët e komunikimeve*, AAB, Prishtinë, 2007, fq. 38-39.
52. Cituar sipas Riccardo Stagliano, *Gazetaria 2.0*, ISHM, Tiranë, 2004, fq. 17-20.
53. Po aty fq. 20-22.
54. Ja hyrja e tekstit të Jakob Nielsenit në artikullin *How Users Read on the Web?*  
Ata nuk e bëjnë.  
Njerëzit zakonisht nuk i lexojnë uebfaqet fjalë për fjalë, ata në fakt e skanojnë faqen, e lexojnë në shpejtësi duke i përzgjedhur fjalët dhe fjalitë e veçanta. Hulumtimet për mënyrën se si lexohen uebfaqet tregojnë se 79 për qind të lexuesve gjithmonë e lexojnë shpejt faqen e re dhe vetëm 16 për qind i lexojnë të gjitha fjalët. (Plotësim: një studim i ri dëshmon se letrat në postën virtuale lexohen edhe më sipërfaqësisht se uebfaqet).  
Shih më gjerësisht në: [www.useit.com](http://www.useit.com).
55. Riccardo Stagliano, *Gazetaria 2.0*, ISHM, Tiranë, 2004, fq. 63.
56. Po aty fq. 118.
57. Po aty fq. 172.
58. Riccardo Stagliano, *Gazetaria 2.0*, ISHM, Tiranë, 2004, fq. 33.
59. Alex Kuczynski, *Me-Zine Journalism for Fun and (Sometimes) Profit*, New York Times, July 9, 2001.
60. Cituar sipas Riccardo Stagliano, *Gazetaria 2.0*, fq. 127-130.
61. Po aty fq. 129-130.
62. Po aty fq. 171.
63. Cituar sipas Shayne Bowman and Chris Willis, *Introduction to participatory journalism*, [www.hypergene.net/wemedia/weblog.php](http://www.hypergene.net/wemedia/weblog.php).
64. Cituar sipas: Shayne Bowman and Chris Willis, *Introduction to participatory journalism*, [www.hypergene.net/wemedia/weblog.php](http://www.hypergene.net/wemedia/weblog.php). *Does greater personalization necessarily mean greater understanding for a democracy?*
65. Cituar sipas: Shayne Bowman and Chris Willis, *Introduction to participatory journalism*, [www.hypergene.net/wemedia/weblog.php](http://www.hypergene.net/wemedia/weblog.php)

V. Lajmi

VI. Nënloje të lajmit

VII. Lajmi në gazetë dhe lajmi në radiotelevizion

VIII. Raporti

IX. Kronika

X. Artikulli i veçantë (Fiçëri)

XI. Nekrologjia dhe përkujtimi

## Gazetaria informative



PJESA



## PËRMBLEDHJE

**N**ë fillim të kapitullit shtjellohen disa përkufizime teorike, fillimisht qëllimi përmbajtësor dhe struktura e tekstit gazetar informativ, pastaj llojet dhe nënlojet zhanrore informative.

Lajmi është trajtuar më gjerësisht për shkak të rëndësisë parësore të tij në gazetari. Po ashtu, janë trajtuar struktura të ndryshme të lajmit, si: strukturat e hershme, struktura sipas modelit të Melvin Mensherit, struktura ligjërimore sipas Teun van Dijkut, dhe struktura të reja lajmore në gazetarinë digjitale. Për secilën prej këtyre strukturave tekstore janë marrë shembuj dhe janë analizuar tekste të ndryshme lajmore në mënyrë që studenti ta kuptojë imtësisht organizimin strukturor të tekstit të lajmit.

Më pastaj janë shtjelluar veç e veç elementet strukturore të lajmit tradicional sipas modelit të piramidës së përmbysur. Po ashtu, janë shtjelluar strukturat tekstore të lajmeve me dy tema dhe me tri tema.

Në vazhdim janë shtjelluar nënlojet e lajmit: fleshlajmi, antërfajlli, fotolajmi, lajmi protokollar dhe lajmi i titruar.

Është bërë një krahasim midis lajmit në gazetë dhe lajmit në radiotelevizion.

Në vazhdim flitet për raportin, po ashtu gjerësisht, pasi shtjellohen qëllimi përmbajtësor dhe struktura tekstore e tij. Pas krahasimeve të raportit me lajmin, flitet për llojet e ndryshme të raporteve: sipas gjatësisë së tekstit (raporti i gjatë dhe raporti i shkurtër); sipas temës që trajtojnë (raporti nga konferenca e shtypit, raporti për krimet, raporti nga gjykatat, raporti nga mbledhjet, nga tubimet, nga Kuvendi e Qeveria, nga konferencat shkencore; sipas mënyrës së informimit (raporti i thjeshtë informativ, raporti përshkruar, raporti analitik (interpretues, komentues, raporti me tezë).

Pas raportit flitet edhe për një lloj zhanror, kronikën, i cili vështirë dallohet prej raportit. Gazetarët, sidomos në televizion, gjithnjë e më

shpesh po e identifikojnë një tekst gazetar si kronikë, prandaj flitet për marrëdhënien e kronikës me raportin, afërsinë dhe dallimet.

Për herë të parë, më gjerësisht, në gazetarinë shqiptare flitet për fiçërin apo artikullin e veçantë, i cili është dominues në gazetarinë anglishtfolëse, por në gazetarinë evropiane ende pa një dominim. Në gazetarinë evropiane, rrjedhimisht edhe në atë shqipe, një numër i llojeve të fiçërit mbajnë të tjerë emra dhe janë të njohur si lloje të pavarura zhanrore. Në kapitull flitet për disa prej këtyre artikujve të veçantë, si: artikulli shkencor-popullarizues, artikulli për përditshmërinë (lifestyle feature), artikulli sensacional, artikulli i sfondit (backraunder), artikulli për fatet njerëzore (human interest story).

Në fund të kapitullit flitet edhe për dy lloje zhanrore informative: nekrologjinë dhe përkujtimin.



## GAZETARIA INFORMATIVE

### NJË PËRKUFIZIM TEORIK

**G**azetaria informative, ose zhanri informativ i gazetarisë, është themeli i gazetarisë moderne. Por nuk ka qenë kështu gjithnjë: gazetaria evropiane që nga lindja ka qenë më shumë e orientuar kah gazetaria analitike apo, si është quajtur, gazetaria opinioniste. Mirëpo, duke e fituar tregun amerikan, sidomos pas revolucionit të parë të teknologjisë informative në vitet e tridhjeta të shekullit XIX, gazetaria e modelit amerikan e fitoi edhe supremacinë globale mbi gazetarinë. Gjithë shekullit XX për gazetarinë evropiane ka qenë vetëm një shekull i përshtatjes dhe imitimit të gazetarisë amerikane. Me këtë supremaci lajmi, raporti, fleshlajmi triumfon mbi çdo zhanër të gazetarisë dhe gazetaria informative bëhet themeli i gazetarisë. Gazetaria moderne rri mbi lajmin. Të gjitha zhanret, sa do të duken fisnike dhe të rëndësishme, i nënshtrohen lajmit. Pa lajm nuk ka gazetari. Aq e thellë është kjo ndarje sa që në shumicën e doracakëve të gazetarisë, të udhëzuesve për studentët e gazetarisë dhe për gazetarët e rinj, flitet kryesisht për shkrimin e lajmit dhe të fiçërit (artikullit të veçantë), pa përmendur zhanre të tjera. Natyrisht që kjo nuk është e mjaftueshme e as korrekte ndaj gazetarisë dhe me përhapjen e gjerë të shkollave të gazetarisë në gjysmën e dytë të shekullit XX dhe në shekullin XXI studentët mësojnë më gjerësisht edhe për zhanre të tjera të tekstit gazetar.

#### 1. QËLLIMI PËRMBAJTJESOR

Qëllimi përmbajtjesor i gazetarisë informative është informimi i publikut me ngjarjet lajmore, pra bartja e informatës nga vendi i ngjarjes, përmes gazetarit dhe mediumit deri te marrësi. Ky është rrethi social tradicional, përndryshe në botën bashkëkohore informimi po merr një kuptim më të gjerë: secili qytetar merr njëkohësisht edhe rolin e gazetarit edhe rolin e marrësit. Kjo po ndodh me atë që quhet gazetari qytetare në rrjetet sociale etj. Kjo është një prirje në rritje. Pavarësisht nga forma e realizimit, qëllimi përmbajtjesor i gazetarisë informative nuk ndryshon: informimi. Kjo do të thotë se në këtë zhanër informata jo vetëm e mbizotëron çdo prirje tjetër të tekstit, por edhe e pamundëson që të ketë elemente të tjera personale, emocionale ose anime ndaj palëve. Kjo bëhet përmes rregullave dhe me ndihmën e deontologjisë gazetare. Gazetari nuk mund ta

Qëllimi përmbajtjesor i gazetarisë informative: informimi i publikut me ngjarjet lajmore.

shprehë veten, t'i shprehë emocionet, bindjet apo animet e tij. Ai thjesht shërben si një medium i vetëdijshëm, i cili ka informacione më shumë se marrësi për çfarë po ndodh dhe mundohet t'i shërbejë marrësit duke ia bartur informatat se çfarë po ndodh.

Përmbajtja e tekstit gazetar informativ është fakti. Pjesa më e rëndësishme e lajmeve dhe raporteve janë faktet apo, si thuhet në teorinë e gazetarisë, përgjigjet në pyetjet e parimit 5W dhe 1H. Teksti është maksimalisht neutral dhe pa tendencë, i shprehur me gjuhë afër stilit bisedor, pa ngarkesa stilistike. Fjalitë janë të thjeshta dhe të shkurtra dhe ka mbizotërim të një numri të vogël fjalësh, në përputhje me stilin bisedor.

## 2. STRUKTURA TEKSTORE

Struktura tekstore e zhanrit informativ është e thjeshtë, me prirje kah skematizimi (shabllonizimi). Shumë rregulla nga praktika e shkrimit të lajmit me kohë kanë kodifikuar strukturën tekstore të tij. Për shembull, struktura tekstore e lajmit është shumë e ngurtë, aq sa mund të përdoret një shabllon për më shumë lajme të tematikës së ngjashme ose të afërt. Parimi i piramidës së përmbysur e dëshmon këtë: dihet fare mirë për secilin gazetar se çfarë do të thotë në aspektin strukturor dhe tematik kreu i lajmit. Këtu mbizotërojnë rregulla të forta shkrimi, ndryshe nga, ta zëmë, gazetaria letrare, ku nuk ka rregulla shkrimi, por rregullat i krijon vetë autori sa herë që shkruan. Teksti në këtë zhanër zakonisht është i shkurtër: ka lajme të përbëra vetëm prej një fjalie (lajmi i titruar), ndërsa teksti më i gjerë është raporti dhe kronika, të cilët në shumicën e rasteve mund të shkojnë deri në gjysmë faqe gazete. Teksti është njëdimensional edhe atëherë kur trajton më shumë se një temë. Thelbësore në këtë zhanër është se tekstin e mbizotërojnë: hyrja, mbititulli, titulli, nëntitulli dhe kreu. Të gjitha këto bashkërisht e bartin informatën kryesore, ndërsa elementet e tjera të strukturës tekstore janë në shërbim të kësaj pjese.

## V. LAJMI

### V.1. KONCEPTI LAJMI

Lajmi është lloji themelor i tekstit gazetar, vetë themeli i gazetarisë. “Në gazetari gjithçka fillon me dhënien e lajmit”, - kjo është fjalia nistore e, pothuajse, çdo libri për gazetarinë.<sup>1</sup> Mësimi për lajmin *de facto* është mësim për gazetarinë. Nuk është foddulle po të thuhet se e gjithë gazetaria është zhvilluar mbi bazën e lajmit, po aq sa nuk është e drejtë të mohohet roli edhe i llojeve të tjera gazetare, si komenti, reportazhi, polemika etj. Përfundimisht, edhe pse gazetaria është një proces shumë i gjerë, i ndikuar dhe i parajgykuar prej shumë faktorëve të jashtëm e të brendshëm, teknologjikë e socialë, në thelbin e gjithë këtij procesi qëndron lajmi. E lajmi, në anën tjetër, është një tekst i shkurtër gazetar apo disa pak fjali të folura në televizion ose, më në fund, një fjali e vetme që sjell një informatë. Ky tekst i shkurtër dhe këta disa pak paragrafë kanë gjeneruar dhe gjenerojnë një prej aktiviteteve më të gjëra dhe më të gjithanshme të njeriut modern. Në shekullin XIX pjesërisht, por në shekullin XX tërësisht ka mbizotëruar komunikimi gazetar mbi çdo lloj tjetër të komunikimit social në kulturat moderne. Ndërsa në shekullin XXI komunikimi gazetar dhe teknologjia informative janë shndërruar në gjenerues të jetës publike e sociale.

Sipas teoricienëve, lajmi i jep marrësit një informacion kryesor dhe (ndoshta!) disa informacione të dorës së dytë. Ky informacion që jep lajmi është një fakt (një ngjarje, një njoftim, një deklaratë, një aksident, një vdekje etj.), jo secili fakt, por vetëm ai që merr një vlerë në kushte të caktuara, si do të shohim më poshtë. Lajmi jep një informacion të ri, lajmi kumton diçka, e cila është interesante edhe për **dhënësin** (kumtuesin, gazetarin) edhe për **marrësin**. Ky është rrethi i parë social e logjik që e krijon lajmi: dhënësi dhe marrësi janë të lidhur midis tyre me interesin e përbashkët për të kumtuar dhe për të mësuar një të re. Në këtë rreth hyn automatikisht faktori tjetër që, për dallim nga dy të parët, është objekt, pra është **mediumi** përmes të cilit dhënësi jep informatën e marrësi merr informatën. Ashtu si edhe e ka emrin, faktori i tretë është vetëm një ndërmjetësues, derisa lidhja e dhënësit dhe e marrësit është e motivuar nga shumë aspekte: kulturore, politike, sociale, informative, zbavitëse etj. Kështu, nga aspekti teorik i interpretimit lajmi është një kumt i risive nga njëmendësia aktuale, që i lidh përmes disa shkallëve të interesit të përbashkët dhënësin dhe marrësin. Pra, lajmi ekziston vetëm në interesin e përbashkët të

### PËRMBAJTJA

V. Lajmi . . . . .	95
V.1. Koncepti lajm . . . . .	95
V.2. Qëllimi përmbajtjesor dhe struktura tekstore e lajmit . . . . .	98
V.2.1. Qëllimi përmbajtjesor i lajmit . . . . .	98
V.2.2. Lajmi e përcakton orientimin e gazetës . . . . .	98
V.2.3. Struktura tekstore e lajmit . . . . .	99
V.2.4. Struktura e lajmit me dy tema sipas Mencher-it . . . . .	101
V.2.5. Superstruktura e lajmit sipas Teun van Dijk-ut . . . . .	103
V.2.6. Struktura tematike e lajmit . . . . .	107
V.2.7. Analiza tematike sipas koncepteve të Van Dijkut e strukturës kuptimore të tekstit të lajmit. . . . .	111
V.2.8. Prije të reja në strukturën tekstore të lajmit . . . . .	113
V.3. Elementet e strukturës tekstore të lajmit sipas përshkrimit tradicional në gazetarinë amerikane (Mensher) . . . . .	117
V.3.1. Titulli . . . . .	117
V.3.2. Llojet e titujve . . . . .	119
V.3.3. Kreu . . . . .	120
V.3.4. Tipa të hyrjeve. . . . .	124
V.3.4.a. Kreu i drejtpërdrejtë: parimi i piramidës së përmbysur . . . . .	124
V.3.4.b. Kreu i vonuar: prije për ndryshimin e strukturës së lajmit . . . . .	126
V.3.5. Materiali që shpërgon kreun. . . . .	128
V.3.6. Sfondi i lajmit (prapavija, “back-ground”) . . . . .	129
V.3.7. Materiale të dorës së dytë, ose më pak të rëndësishme . . . . .	130
V.4. Elemente të tjera strukturore të lajmit. . . . .	131
V.4.1. Vendi dhe koha. . . . .	131
V.4.2. Citati dhe vendi i tij në strukturën e tekstit lajmor. . . . .	131
V.4.3. Komentet në lajm . . . . .	132

"Në gazetari gjithçka fillon me dhënien e lajmit".  
Po, por ku përfundon?

dhënësit e të marrësit. Cili është më i rëndësishëm në këtë mes? Vetë informacioni që bartë lajmi apo marrëdhënia midis dhënësit e marrësit? Vetë informacioni mund të ekzistojë vetëm për vete (të mbetet te dhënësi, të mos transmetohet etj.), ndërsa marrëdhënia midis dhënësit dhe marrësit krijohet vetëm përmes atij informacioni, pra informacioni merr rëndësinë e vet vetëm nëse ekziston në marrëdhënien dhënës-marrës. Përfundimisht dhe themelisht: kur flasim **për gazetarinë**, ekzistimi në vetvete i faktit (të rejtat që ndodhin) nuk është i rëndësishëm së parë (ai mund të jetë i rëndësishëm së parë për fushat e tjera, p.sh. për sociologjinë, për politikën, për jetën publike etj.), por vetëm krijimi i marrëdhënies dhënës (gazetar, kumtues) dhe marrës i jep rëndësinë faktit objektiv, tash të shndërruar në lajm, sepse kjo marrëdhënie i jep lajmit formën e ekzistimit. Ky është parimi i parë që duhet ta ketë parasysh secili gazetar: ai shkruan lajmin (dhe çdo tekst tjetër gazetarie) për marrësin e jo për veten e tij.

Kështu, për shembull, një aksident në komunikacion (një fakt) nuk do të ishte lajm përderisa nuk transmetohet te marrësi dhe, përderisa nuk transmetohet, ai është i rëndësishëm vetëm për aktorët e aksidentit, ndërsa në momentin ku fakti transmetohet te marrësi, ai fakt shndërrohet në lajm dhe merr vlerë të re sociale (e mund të marrë edhe vlera të tjera sociologjike, politike, psikologjike, financiare etj.).

Në traditën e gazetarisë ky dhënës është zakonisht gazetari, ndërsa ky marrës është zakonisht publiku. Mirëpo, me zhvillimin e teknologjisë informative në shekullin XXI, sidomos me shpikjen e telefonisë mobile, si Aple dhe Android, si dhe e kompjuterit mobil, si Ipad, si dhe e rrjetit WAP (Wireless Application Protocol), është bërë shumë i lehtë dërgimi dhe marrja e informatave masive, në çfarëdo situatë të mundshme dhe në cilindo vend të mundshëm të botës, e ka lehtësuar aq shumë qasjen në informata sa që njeriu modern në çdo minutë kyçet në këtë rrjedhë të informatave. Kjo ka relativizuar marrëdhënien tradicionale gazetar (dhënës)-publiku (marrës), sepse tashmë, përmes uebportaleve, rrjeteve sociale apo "You Tube" secili qytetar i botës mund t'i dërgojë informata secilit qytetar tjetër. Sipas Artan Fugës, nga informimi "from one to many" komunikimi masiv ka kaluar në fazën "from one to one", si e thotë Artan Fuga<sup>2</sup>, pra komunikimi masiv kryesor në disa vitet e fundit bëhet përmes rrjeteve sociale më shumë se përmes medieve klasike masive (gazetë, radio dhe TV), ndërsa dhënësi e marrësi janë secili qytetar.

Lajmi nuk shkruhet nga fantazia e autorit, si poezia. Nuk shkruhet as si historia mbi argumente për ngjarje të rëndësishme që përcaktojnë rrjedhën njerëzore, edhe pse edhe ngjarjet historike janë

Artan Fuga  
...nga informimi "from one to many" komunikimi masiv ka kaluar në fazën "from one to one"

objekt i lajmit. Nuk shkruhet për të eksperimentuar me fakte apo të dhëna, sepse lajmi nuk është eksperiment. Lajmi detyrimisht rrjedh nga diçka objektive, nga një fakt, nga një ngjarje, veprim, deklaratë, aksident, a të ngjashme. Ky burim i lajmit quhet **ngjarja lajmore**<sup>3</sup>, pra diçka që ekziston dhe ndodh si dhe ka një rëndësi për publikun. Ngjarja lajmore mund të jetë një ngjarje që ka ndodhur, një deklaratë e personave të rëndësishëm shoqërorë, apo një ndodhje çfarëdo po që paraqet interes për shoqërinë. Kjo ngjarje lajmore është faktori tjetër që i bashkohet procesit të krijimit të lajmit.

Nuk mund të ketë lajm pa një ngjarje lajmore, sepse lajmi, si thamë, nuk është poezi. Nuk mund të ketë lajm nëse ngjarja lajmore tashmë është e mirënjohur prej publikut, sepse lajmi thamë nuk është histori. Ngjarja lajmore detyrimisht është fakt i ri, për të cilin nuk di askush, përveç gazetarit, ose një grup i vogël njerëzish, të lidhur qoftë drejtpërdrejt, qoftë profesionalisht me ngjarjen lajmore. Nuk mund të ketë lajm nëse ngjarja lajmore nuk paraqet kurrfarë interesi as për dhënësin, por sidomos për marrësin, sepse lajmi thamë nuk është eksperiment. Poetët bëjnë poezi pa ngjarje lajmore, historianët bëjnë historinë mbi ngjarjet lajmore që kanë ndodhur vite e shekuj më parë, kimistët bëjnë mijëra eksperimente derisa ta vërtetojnë tezën e tyre, ndërsa gazetarit nuk i lejohen asnjë nga këto: ai duhet ta bëjë lajmin, i cili rrjedh nga një ngjarje lajmore, e cila është ngjarje e panjohur për të tjerët dhe paraqet interes të dorës së parë për të gjithë, në radhë të parë për marrësin. Pra, paska një rreth social të lajmit, sikurse për çdo diskurs tjetër, fundja sikurse edhe për vetë gjuhën, sepse lajmi në origjinë është komunikim gjuhësor.

Të rezytojme për përbërësit social të lajmit:

- Ngjarja lajmore është burimi i lajmit (pika ku mund të fillojë lajmi, ku mund të shihet ideja për lajmin dhe që shndërrohet në generator përmbajtësor të lajmit);
- Dhënësi është gazetari (ose cilido qytetar person tjetër që merr vullnetarisht rolin e dhënësit) që atë ngjarje lajmore e shndërron në lajm (e shkruan apo e incizon; e dërgon si tekst, si pamje apo e kumton verbalisht);
- Informacioni kryesor dhe ai i dorës së dytë është përmbajtja e lajmit (risitë që përmban lajmi i gazetarit);
- marrësi është ai që e pranon lajmin.

Në teorinë e gazetarisë nuk ka një nocion të stabilizuar për të emërtuar këtë fakt që ne po e quajmë fakt objektiv. Disa gazetarë e përdorin nocionin ngjarje (që është vetëm një aspekt i faktit objektiv), subjekti i lajmit (subjekti i lajmit është brendia e strukturuar e një lajmi, po jo vetë fakti objektiv para se të shkruhet në lajm) etj. Një herë kam provuar të quhej fakt objektiv, por edhe ky emërtim krijon probleme, sepse fakte objektive në filozofi janë të gjitha ato që ekzistojnë jashtë ndërgjegjes njerëzore, pra edhe hëna është fakt objektiv.

- Ngjarja lajmore është burimi i lajmit
- Dhënësi është gazetari (ose cilido qytetar person tjetër që merr vullnetarisht rolin e dhënësit)
- Informacioni kryesor dhe ai i dorës së dytë është përmbajtja e lajmit
- Transmetimi apo kumtimi është proces që ndodh midis gazetarit dhe marrësit
- Marrësi e pranon lajmin.

## V.2. QËLLIMI PËRMBAJTJESOR DHE STRUKTURA TEKSTORE E LAJMIT

### V.2.1. QËLLIMI PËRMBAJTJESOR I LAJMIT

Duke qenë lajmi vetëm një informacion, cili është qëllimi përmbajtjesor i tij?

Lajmi vetëm informon.

Lajmi vetëm informon. Ky është qëllimi i parë dhe i fundit i tij. Gazetari nuk jep mendimin e tij për temën e lajmit, po ende as nuk e pasqyron gjerësisht opinionin e subjekteve që nuk përfshihen në temën e lajmit. Nëse, ta zëmë, tema e lajmit është një aksident trafiku, nuk mund të citohet në lajm mendimi i arsimtarëve për trafikun. Por nëse tema e lajmit është huliganizmi në shkollë, atëherë mendimi i arsimtarëve është i domosdoshëm.

Rrjedhimisht, qëllimi përmbajtjesor i lajmit është informimi i marrësit me të rejat. Marrësi pajiset vetëm me informacionet kryesore, duke i shmangur informacionet e dorës së dytë apo më pak të rëndësishme. Informacioni kryesor theksohet që në titull, pastaj në kreun e lajmit ai jepet i tëri. Në pjesët e tjera të lajmit gazetari jep vetëm aq informacion sa për ta kuptuar marrësi kreun e lajmit, por gjithmonë duke u kujdesur që të mos e ngarkojë lajmin me informacion të tepërt.

### V.2.2. LAJMI E PËRCAKTON ORIENTIMIN E GAZETËS

Duke qenë themeli i gazetarisë, lajmi e përcakton edhe prirjen e gazetës. Varësisht nga prania e lajmit në një gazetë në mund t'i konstatojmë prirjet programore të gazetës. Një prerje e përgjithshme tradicionale është midis gazetave informative dhe atyre që quhen opinioniste. Të parat kanë më shumë lajme ndërsa të dytat më pak. Po ashtu, varësisht nga llojet tematike të lajmeve gazeta merr profilin e caktuar. Në tabelën e mëposhtme po japim llojet tematike të lajmeve në gazetën *Infopress* (Kosovë) në periudhën njëmuajore 1-31 maj 2010<sup>4</sup>:

Lloji tematik i lajmit	Sasia e lajmit	% e hapësirës lajmore
Lajme politike	140	9.32
Lajme ekonomike	73	4.86
Lajme sociale	71	4.73

Lajme sigurie	112	7.46
Lajme nga arsimi dhe për të rinjtë	49	3.26
Lajme nga kryeqyteti	19	1.26
Lajme nga komunat e Kosovës	137	9.12
Lajme info-kult	69	4.59
Lajme nga rajoni dhe bota	188	12.50
Lajme nga "mesi i artë" (faqe bulevardeske)	358	23.83
Lajme sportive	286	19.04
<i>E përgjithshme</i>	1502	100

Si shihet nga lloji tematik i lajmit, gazetën e mbizotëron bindshëm lajmi nga rubrika "Mesi i artë" e që janë shkrime që trajtojnë kryesisht jetën e përditshme të artistëve, thashethemet e elitave nga bota e filmit dhe estradës etj. Pas këtij lloji vjen lajmi sportiv, ndërsa lajmi politik është i pranishëm me vetëm 9.32 % të hapësirës lajmore, e që është gati tri herë më pak se lajmet bulevardeske.

### V.2.3. STRUKTURA TEKSTORE E LAJMIT

Lajmi ka një strukturë tekstore, e cili përbëhet nga paragrafët dhe pjesë më të gjëra të tekstit. Struktura e tekstit nuk është e njëjta me strukturën sintaksore: këtë të fundit e përbëjnë fjalitë dhe tërësia e tyre është periudha, ndërsa strukturën tekstore e përbëjnë paragrafët dhe tërësia e tyre është i gjithë teksti. Përveç strukturës tekstore (të cilën Van Dijku e quan **superstrukturë**), lajmi ka edhe temën apo temat që trajton, të cilën e quajmë temë e lajmit. Ndërlidhja e temave të lajmit brenda të së njëjtit lajm krijon strukturën tematike të lajmit (sipas Van Dijkut). Struktura tekstore dhe struktura tematike kanë një qëllim jashtëtekstor: sikur çdo tekst gazetar që shkruhet për një qëllim të caktuar ndërmjet dhënësit dhe marrësit, edhe lajmi ka një qëllim të tillë të cilin e quajmë qëllimi përmbajtjesor i lajmit. Në këtë kapitull, para se gjithash, në do t'i trajtojmë strukturën tekstore, strukturën tematike dhe qëllimin përmbajtjesor të lajmit.

**Struktura të hershme të tekstit lajmor.** Më herët, në shekullin XVIII e tutje, lajmi është shkruar thjesht sipas një rendi logjik e kronologjik të ngjarjes.

Struktura tekstore dhe struktura tematike kanë një qëllim jashtëtekstor: sikur çdo tekst gazetar që shkruhet për një qëllim të caktuar ndërmjet dhënësit dhe marrësit, edhe lajmi ka një qëllim të tillë të cilin e quajmë qëllimi përmbajtjesor i lajmit.

**Struktura të hershme të tekstit lajmor.**

*“Dikur lajmet shkruheshin sipas rendit logjik të ngjarjeve, tamam si çdo tregim tjetër, por ndryshimi i vazhdueshëm ka sjellë një formë të re, aq të ndryshme dhe individuale sa çdo formë tjetër e shprehjes.”<sup>5</sup>*

Me kohë, mënyrat dhe format strukturore të shkrimit janë përsosur, sipas qëllimit përmbajtësor të lajmit.

Në gazetarinë moderne, që nga zbulimi i telegrafit e këndeje, struktura tekstore e lajmit është skematizuar, duke marrë edhe emrin metaforik **piramidë e përmbysur**. Kjo strukturë e lajmit është zakonisht kështu:

- Titulli/nëntitulli
- Kreu
- Materiali që shpjegon kreun
- Sfondi i lajmit
- Materiale të dorës së dytë ose më pak të rëndësishme (nëse ka).

Një teknikë e re e raportimit lindi gjatë Luftës Civile në SHBA, ndërsa njoftimet që vinin nga zonat e luftës u shndërruan në lajme kryesore. Duke qenë se telegrafi ndonjëherë prishej dhe nuk mund të përcillej i tërë lajmi, gazetarët u detyruan që faktet kryesore të lajmit t'i transmetonin në paragrafët e parë të lajmit. Nëse linja dështonte gjatë transmetimit të lajmit, të paktën gjëja më e rëndësishme nuk do të humbte. Si rrjedhojë u zhvillua stili i piramidës së përmbysur.

Josef Dominik, *Dinamika e komunikimit masiv*

Kjo është struktura më e thjeshtë e një lajmi. Në këtë strukturë, dy elementët e parë, titulli/nëntitulli dhe kreu paraqesin pjesën më të rëndësishme të lajmit, sepse ato bartin informatën kryesore të atij lajmi. Të gjitha elementet e tjera të strukturës i nënshtrohen kësaj pjese, e cila, me një fjalë, quhet kreu i lajmit. Një lajm i gjatë në gazetë i përmban të gjitha këto pjesë, por i njëjti lajm në uebportal apo në televizion mund të emetohet pa dy elementet e fundit (sfondi i lajmit, materiale të dorës së dytë), ndërsa i njëjti lajm i titruar mund të emetohet vetëm me kreun. Kjo do të thotë që në këtë skemë strukturore nuk janë të barabarta të gjitha elementët e strukturës dhe ka një renditje hierarkike: nga lart poshtë, ose nga më të rëndësishmet kah ato më pak të rëndësishme. Këtë teori e vërteton me punën e vet secili gazetar çdo ditë: nëse redaktori i thotë gazetarit ta shkurttojë lajmin për një të tretën e tekstit, gazetari nuk nis shkurtimet nga kreu, por nga elementi i fundit i strukturës, pra nga elementet më pak të rëndësishme.

Ky konstatim i fundit e ngre edhe një çështje: nga aspekti fizik lajmi ka një fund, por nga aspekti strukturor i tekstit lajmi nuk ka një përfundim, në kuptimin nuk ka një element strukturor që ka funksion për ta përfunduar lajmin. Lajmi thjesht përfundon ose pas kreut, ose pas materialit që shpjegon kreun, ose pas sfondit ose pas materialit të dytë që shpjegon kreun.



Ahtisari: Nuk do të ndërroja asnjë presje të Planit për Kosovën	Titulli Modeli i titullit: citat
Londër, 17 tetor 2008 (FoNet). Ish kryetari i Finlandës dhe fituesi i sivjetmë i Çmimit Nobel për paqe, Marti Ahtisaari, ka thënë të premtën në Londër se nuk do të ndërronte asnjë pjesë të Planit të tij për statusin e Kosovës.	Vendi dhe koha Kreu i lajmit
“Ai është një plan konkret dhe sipas të gjitha gjasave një ndër zgjidhjet më të mira, tek të cilat kemi mundur të vijmë, pasi që dërgon një mesazh të qartë që asnjë diktator në botë nuk mund të trajtojë qytetarët e tij ashtu si kanë bërë liderët e dikurshëm serbë, e të mos kenë pasoja”, ka thënë Ahtisaari.	Materiali që e shpjegon kreun e lajmit.
“Nëse nuk mund të besojmë në vlera të tilla, çfarë jemi ne atëherë? Nuk kam pasur mundësi të bëja asgjë tjetër, pasi që në të kundërtën nuk do të mund të flija i qetë”, ka thënë Ahtisaari.	Paragrafi që lidhë kreun e lajmit me sfondin.
Vendet e Perëndimit dhe institucionet si Kombet e Bashkuara duhet të respektojnë vlerat e krijuara nga vetë ata nëse dëshirojnë që të respektohen nga të tjerët, ka thënë ai. Ahtisaari ka vlerësuar që është e mundshme të zgjidhen të gjitha mosmarrëveshjet në botë dhe të ndikohet tek shefat e të gjitha shteteve botërore në bashkësinë ndërkombëtare “nëse kenë mjaft vetëbesim”.	Sfondi (prapavija) e lajmit.
<i>Marrë nga KOHA DITORE, 18 tetor 2008</i>	

Ka struktura edhe më të gjëra të lajmit. Një lajm i skemës tradicionale, sipas M. Mencherit, ndërtohet kështu në strukturë:

- Kreu
- Materiali shpjegues
- Materiali dytësor
- Sfondi i lajmit (nëse është i nevojshëm)
- Zgjerim i mëtejshëm i materialit shpjegues<sup>6</sup>

#### V.2.4. STRUKTURA E LAJMIT ME DY TEMA SIPAS MENCHER-IT

Struktura për të cilën folëm deri tash i përket lajmit që ka një temë. Por, ka lajme që kanë më shumë se një temë, kanë dy tema, po shumë rrallë tri tema. Edhe në këto lajme vlejshëm pak a shumë të njëjtat rregulla: edhe ky lajm ka një informacion kryesor, por që ndërlikohet edhe me ndonjë informacion tjetër, i cili, po ashtu, është i panjohur për marrësin dhe shndërrohet në informacion kryesor. Pra, dy e më shumë informacione përfshihen brenda një kreu.

Çfarë strukture tekstore ka lajmi me dy apo edhe me tri tema?

<b>Panairi i librit çelet me zhurmë <sup>7</sup></b> <b>Në Frankfurt u hap të mërkurën Panari i Librit, që është edhe më i madhi në botë.</b>	<b>Tema 1: hapja e panairit;</b> <b>Tema 2: zhurma në hapje</b>
<p>Në të marrin pjesë rreth 7000 mijë ekspozues që prezantojnë 400 000 libra. Por pa hapur ende dyert panairi shkaktoi zhurmë me zgjedhjen e Kinës si të ftuarën e nderit.</p>	<p>Vazhdohet linearisht me dy temat:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. numri i librave të ekspozuar;</li> <li>2. zhurma rreth pjesëmarrjes së Kinës</li> </ol>
<p>Çdo vit panairi i Librit në Frankfurt zgjedh një temë speciale dhe këtë vit kjo është Kina. Qindra botues dhe tregtarë të librit nga Kina marrin pjesë në këtë eveniment pesëditor, përmes prezantimit të letërsisë dhe kulturës së vendit. Zgjedhja e Kinës si e ftuar nderi ka shkaktuar kritika nga grupet për të drejtat e njeriut që i akuzojnë autoritetet në Pekin se kufizojnë lirinë në literaturë.</p>	<p>Sfondi i temës së parë (fjalja e parë). Sfondi i temës së dytë</p>
<p>Zëvendëspresidenti i Kinës, Xi Jinping mori pjesë në hapjen zyrtare të panairit. Ai tha se vendi i tij ishte i hapur ndaj elementeve prej jashtë, por vetëm mbi bazat kulturore të Kinës. Kancelarja Merkel premtoi se në bisedimet e saj me zyrtarin kinez nuk do të kishte tabu. Ky parim, tha ajo, ishte thelbi i lirisë së shprehjes. Jo të gjitha prezantimet janë sanksionuar nga Pekini. Disidentëve dhe kritikëve kinezë u është dhënë hapësirë për të eskpozuar punët e tyre.</p>	<p>Materiali shpjegues për temën e dytë të kreu</p>

#### Struktura drejtvizore e lajmit

Disa pjesë të strukturës tekstore të lajmit, si: titulli, kreu dhe materiali që shpjegon kreun janë pjesë më të qëndrueshme dhe më të fiksuara të lajmit, ndërsa sfondi i lajmit dhe materiali dytësor që shpjegon kreun, apo zgjerimi i mëtejshëm i materialit që shpjegon kreun janë pjesë të ndryshueshme dhe të paqëndrueshme të lajmit.

Edhe në modelin e parë edhe në të dytin, struktura e tekstit është drejtvizore. Kjo do të thotë ka një informacion qendror i cili bartet në lajm dhe i cili jepet që në fjalinë e parë të lajmit, si dhe ka disa pjesë të tjera të tekstit që i shërbejnë informacionit qendror dhe që jepen në vazhdim të lajmit. Pa pjesën kryesore (kreu i lajmit) nuk mund të ketë lajm, ndërsa pa pjesët ndihmëse të tekstit lajmi edhe mund të funksionojë si lajm.

Në të dy rastet tri pjesë të strukturës, titulli, kreu dhe materiali që shpjegon kreun janë pjesë më të qëndrueshme dhe më të fiksuara të lajmit. Ndërsa sfondi i lajmit dhe materiali dytësor që shpjegon kreun, apo zgjerimi i mëtejshëm i materialit që shpjegon kreun, janë pjesë të ndryshueshme dhe të paqëndrueshme të lajmit. Një lajm me një strukturë deri në fund të reduktuar mund të qëndrojë vetëm me titullin, me kreun dhe me materialin që e shpjegon kreun. Madje, një prej mënyrave që kanë krijuar redaktorët për të vlerësuar një lajm është pikërisht lëvizja e këtyre strukturave tekstore: nëse një lajmi

i heq të gjitha pjesët dhe e lë vetëm titullin, kreun dhe materialin që shpjegon kreun, dhe ai lajm funksionon mirë si lajm, atëherë lajmi është mirë i shkruar. Si shihet, lajmi ka strukturë tekstore të organizuar mirë dhe saktë, shumë unike dhe drejtvizore (lineare). Ato që në teorinë e ligjërimit quhen digresione e degëzime, në lajm nuk kanë vend ose kanë hapësirë shumë pak. Kjo është strukturë mjaft shumë e skematizuar, aq sa studentët e gazetarisë mund ta eksperimentojnë krijimin e një shablloni të lajmit, psh. për aksidentet e trafikut dhe, brenda atij shablloni të shkruajnë lajme të ndryshme, duke ndryshuar vetëm faktet, shifrat e të dhënat e tjera, por duke mos i lëvizur fjalitë e tjera. Ky fakt e ofron shkrimin e lajmit me punën e zanatçiu, por vetëm e përafro, por assesi nuk është ashtu. Përndryshe, pse një lajm i një gazetari apo i një gazete është më i mirë se lajmi i një gazetari apo i një gazete tjetër për të njëjtën temë? Kjo të bindë përfundimisht se, sado që është shabllonizuar struktura e lajmit, shkrimi i tij gjithnjë është i ri dhe gjithnjë kërkon punë intelektuale të re.

### V.2.5. SUPERSTRUKTURA E LAJMIT SIPAS TEUN VAN DIJK-UT

Studiuesi i diskursit Teun van Dijk ka përshkruar një strukturë më të hollësishme të tekstit të lajmit, duke ndërlidhur strukturat kuptimore me strukturat gjuhësore, e të cilën formë e quan superstrukturë. Sipas tij, makrostruktura (apo strukturat tematike, pra elementet tematike të lajmit) ka nevojë për tekstin dhe zërin. Organizimi i përgjithshëm i saj në tekst [apo verbalisht] quhet skemë [schemata]. Secili diskurs ka skemën e tij:

- tregimi ka një skemë narrative, e cila përbëhet prej disa kategorive konvencionale, si: hyrja, thurja, kulminacioni, shthurja etj.;
- eseja ka një skemë tjetër: hyrja me tezën, argumentimi dhe përmbyllja etj.;
- edhe bisedat e përditshme kanë një skemë të tyre.

Këto skema të diskursit quhen superstrukturë.<sup>8</sup> Në vazhdim ai thotë se edhe lajmi ka një skemë të veten, e përbërë prej disa kategorive të tekstit, të cilat kur ndërlidhen me makrostrukturat e krijojnë superstrukturën e tekstit të lajmit, atë që ne e kemi quajtur struktura tekstore e lajmit.

**Kategoritë e skemës së lajmit**

[pg 52-56]

**Kategoria Summary [përmbledhje, hyrje]**

Titulli + Kreu

- nuk duhet të identifikohet vetëm me titullin fizik. Titulli mund të përbëhet prej disa pjesëve, si: mbititulli, titulli, nëntitulli, mund të ketë edhe ndonjë grafi tjetër, ledhorja etj.

- titulli i paraprin semantikisht kreut, ndërsa që të dy e paraqesin temën e lajmit dhe i paraprijnë pjesës tjetër të tekstit.

**Kategoria Epizode**

Main Events [Ngjarjet kryesore] + Context + Background

- ngjarjet kryesore paraqesin temat kryesore të tekstit

- ngjarjet kryesore mund të nguliten edhe brenda kontekstit. Konteksti nuk duhet të ngatërrohet me "background"-in. Konteksti është një ngjarje tjetër e cila është e ndërlidhur ngushtë me ngjarjet kryesore, ndërsa "backgroundi" është prapavija e ngjarjes dhe e konteksti, historia e tyre.

**Kategoria Consequences [Konsekuenca]**

- konsekuenca është një rrjedhim tjetër si pasojë e temës së lajmit

- vlefshmëria sociale dhe politike e lajmit përcaktohen nga konsekuencat që rrjedhin prej tij

- ndodh që temat e konsekuencave, për shkak të rëndësisë së tyre, qëndrojnë në hierarki të njëjtë me ngjarjet kryesore.

**Kategoria Verbal Reaction [Reaksioni verbal]**

- mund të shikohet edhe si pjesë e konsekuencave

- lajmet e rëndësishme e fillojnë një proces social të komentimit, të pyetjeve e të reagimit të pjesëmarrësve kryesorë

- kjo kategori vjen pas Main Events, Context dhe Background.


**Comment (koment)**

- janë komentet e gazetarëve, opinionet dhe vlerësimet e tyre për ngjarjet në diskursin medial

- kjo kategori ka dy nënkategori: 1. Evaluation [vlerësimi] dhe 2. Expectations [parashikimi]

**RENDI I KATEGORIVE TË TEKSTIT NË SUPERSTRUKTURËN E LAJMIT**

Vetëm *summary* [titulli+kreu] dhe *main events* janë obligativë në një diskurs të mirëformuar lajmor. Kategoritë e tjera janë me zgjedhje. Kategoritë e skemës nuk janë tërësi unike, por mund të shkapërderdhen. Kështu kategoria *main events* mund të shfaqet në pjesë të ndryshme të tekstit [ngjashëm me temën].



Burimi: Teun A. Van Dijk, "News Schemata", në *Studying Writing*, pg. 155-185.

Figure 5.1 Superstructure Schema of News Discourse

<p>FITUESI I SIVJETMË PËRGATITET PËR SPEKTAKLIN EVROPIAN TË KËNGËS NË MOT</p> <p><b>Azerbajxhani rrënon shtëpi për t'i bërë vend sallës për "Eurosong 2012"</b><sup>9</sup></p> <p>Organizata "Human Right Watch" ka paralajmëruar se prishjet e paligjshme të shtëpive që janë bërë në Baku i kanë lënë pa shtëpi qindra familje.</p> <p>LONDËR, 20 DHJETOR (THE TELEGRAPH)- Autoritetet e Azerbajxhanit janë akuzuar për dëbimin e qindra familjeve, për të liru hapësirën për ndërtimin e sallës së re të koncerteve, e cila do të jetë nikoqire e edicionit të vitit të ardhshëm të garës evropiane të këngës.</p>	<p>Abstrakti / Summary / [Përmbledhje, hyrje]: Titulli + Kreu <i>Informacionet kryesore</i></p> <p>Kategoria Epizode + Main Events [Ngjarjet kryesore] + Context + Background Ngjarja kryesore</p>
--	--

<p>Azerbajxhani do të jetë nikoqir i Evropizionit, për herë të parë në histori, pasi ka fituar garën e vitit 2011 të mbajtur në Gjermani, falë performancës së duetit Ell dhe Nikki, me këngën "Running Scared". Ky shtet shpreson se organizimi i garës do të ndihmojë përmirësimin e imazhit të ish republikës sovjetike dhe të presidentit Ilham Aliyev.</p>	<p>} Konteksti - ngjarja e dytë kryesore</p> <p>} Comment</p>
<p>Megjithatë, autoritetet janë akuzuar se kanë ndërprerë rrymën, gazin dhe ujin për disa familje, në përpjekje për t'i detyruar njerëzit të largohen nga vendi i tyre, në mënyrë që të krijohet hapësira për të ndërtuar sallën e re në kryeqytetin Baku.</p>	<p>} Ngjarja kryesore - vazhdim</p>
<p>Organizata "Human Right Watch" ka paralajmëruar se prishjet e paligjshme të shtëpive që janë bërë në Baku u kanë kush-tuar qindra familjeve.</p>	<p>} Reagim</p>
<p>Natayla Alibekova, e cila ka jetuar për 11 vjet në shtëpinë e saj, beson se kjo është pjesë e taktikës që ajo dhe familja e saj të lirojnë rrugën për ndërtimin e sallës së koncerteve. Asaj i kanë thënë që duhet të largohet nga shtëpia para Vitit të Ri.</p>	<p>} Konsekuenca</p>
<p>"Ata më kanë thënë se nuk mund të ngrihem kundër qeverisë, nuk kam të drejtë dhe nuk kam shtëpi më", i ka thënë ajo BBC-së. "Është e tmerrshme. Të gjithë jemi të bren-gosur dhe asnjëri nga ne nuk po mundemi të flemë rehat. Ndërtimi i sallës nënkupton se shtëpia do të dridhet. Është sikur një tërmet. Dhe kamionët e vinçat janë duke punuar gjatë gjithë natës, kështu që e kemi të pamundur të flemë", ka thënë ajo.</p>	<p>} Kategoria Verbal Reaction (Reaksioni verbal)</p>
<p>Edicioni i vitit 2011 i garës evropiane të këngës edhe një herë ka qenë dështim për Britaninë Bendi "Blue", që ka përfaqësuar shtetin britanik, ka përfunduar i njëmbëdhjeti.</p>	<p>} Kontekst historik i parëndësishëm</p>

### V.2.6. STRUKTURA TEMATIKE E LAJMIT

Lajmi ka një temë kryesore, apo edhe dy deri në tri tema. Lajmi sjell informacionin për një ndodhi, por ajo ndodhi mund të ndërlidhet me një apo dy deri në tri tema. Mençeri e quan lajmin njëelementësh, dylelementësh dhe trelementësh. Fjala “element” nuk është në përputhje me të shënjuarin. Van Dijku i quan tema. Van Dijku<sup>10</sup> flet së pari për strukturat tematike (topika; ai përdor relativisht që të dy nocionet: temë dhe topikë).

Lajmi sjell informacionin për një ndodhi, por ajo ndodhi mund të ndërlidhet me një apo dy deri në tri tema.

*“Ndoshta edhe më shumë se për llojet e tjera ligjërimore, organizimi tematik i diskursit të lajmeve luan një rol vendimtar.”*


Strukturat tematike nuk kanë të bëjnë me kuptimin e fjalëve, po me kuptimin e tekstit në përgjithësi, e për këtë Van Dijk e përdor nocionin “semantic macrostructures”. Ai dallon *propositions* dhe *macro propositions*:

*“Propozicionet janë ndërtimet më të vogla, të pavarura të gjuhës dhe mendimit. (...) Propozicionet në mënyrë tipike shprehen nga fjali të vetme ose klauzola, si në - “Sandra shkarkoi menaxherin e saj dje”.*

“Makropropozicionet: dhe tash e tutje ne do të supozojmë se çdo temë e një teksti mund të përfaqësohet si një makropropozicion i tillë.”

Kur një tekst përbëhet nga disa *macropropositione* (secili prej tyre ka disa propositione), atëherë këtë strukturë Van Dijku e quan *makrostrukturë*: “...kështu që e tërë makrostrukturë ka një organizim hierarkik, në të cilin çdo sekuencë e makropropozicioneve mund të përfshihet nën një nivel më të lartë makropropozicioni”.

Këto struktura tematike janë të ndërlidhura ndërmjet tyre sipas një hierarkie. Van Dijku e paraqet grafikiisht kështu:



Paraqitja skematike e makrostrukturës semantike të një teksti.

P-propozicion  
M-makropropozicion

P-proposition  
M-macroproposition  
macrostructures.



Nisur nga konceptet e Van Dijkut, strukturat më të vogla kup-timore të cilat mund të qëndrojnë të pavarura-*propozicionet*, krijojnë një tërësi tematike-*makropropozicionet*, e tërësia e disa makropropozicioneve krijojnë *macrostructures*.

Të shohim një shembull të lajmit të ndarë në propozicione dhe në makropropozicione:



*Propozicionet*

<p>FITUESI I SIVJETMË PËRGATTET PËR SPEKTAKLIN EVROPIAN TË KËNGËS NË MOT</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. fituesi i sivjetmë përgatitet</li> <li>2. për spektaklin evropian të këngës në mot</li> </ol>
<p>Azerbajxhani rrënon shtëpi për t'i bërë vend sallës për "Eurosong 2012"<sup>11</sup></p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>3. Azerbajxhani rrënon shtëpi</li> <li>4. për t'i bërë vend sallës për "Eurosong 2012"</li> </ol>
<p>Organizata "Human Right Watch" ka paralajmëruar se prishjet e paligjshme të shtëpive që janë bërë në Baku i kanë lënë pa shtëpi qindra familje.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>5. Organizata "Human Right Watch" ka paralajmëruar</li> <li>6. se prishjet e paligjshme të shtëpive që janë bërë në Baku</li> <li>7. i kanë lënë pa shtëpi qindra familje.</li> </ol>
<p>LONDËR, 20 DHJETOR (THE TELEGRAPH)- Autoritetet e Azerbajxhanit janë akuzuar për dëbimin e qindra familjeve, për të liruar hapësirën për ndërtimin e sallës së re të koncerteve, e cila do të jetë nikoqire e edicionit të vitit të ardhshëm të garës evropiane të këngës. Azerbajxhani do të jetë nikoqir i Evrovizionit, për herë të parë në histori, pasi ka fituar garën e vitit 2011 të mbajtur në Gjermani, falë performancës së duetit Ell dhe Nikki, me këngën "Running Scared". Ky shtet shpreson se organizimi i garës do të ndihmojë përmirësimin e imazhit të ish republikës sovjetike dhe të presidentit Ilham Aliyev. Megjithatë, autoritetet janë akuzuar se kanë ndërprerë rrymën, gazin dhe ujin për disa familje, në përpjekje për t'i detyruar njerëzit të largohen nga vendi i tyre, në mënyrë që të krijohet hapësira për të ndërtuar sallën e re në kryeqytetin Baku.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>8. Autoritetet e Azerbajxhanit janë akuzuar për dëbimin e qindra familjeve</li> <li>9. për të liruar hapësirën për ndërtimin e sallës së re të koncerteve</li> <li>10. e cila do të jetë nikoqire e edicionit të vitit të ardhshëm të garës evropiane të këngës.</li> <li>11. Azerbajxhani do të jetë nikoqir i Evrovizionit</li> <li>12. për herë të parë në histori</li> <li>13. pasi ka fituar garën e vitit 2011 të mbajtur në Gjermani</li> <li>14. falë performancës së duetit Ell dhe Nikki, me këngën "Running Scared".</li> <li>15. Ky shtet shpreson</li> <li>16. se organizimi i garës do të ndihmojë përmirësimin e imazhit të ish republikës sovjetike dhe të presidentit Ilham Aliyev.</li> <li>17. egjithatë, autoritetet janë akuzuar se kanë ndërprerë rrymën, gazin dhe ujin për disa familje</li> <li>18. në përpjekje për t'i detyruar njerëzit të largohen nga vendi i tyre</li> <li>19. në mënyrë që të krijohet hapësira për të ndërtuar sallën e re në kryeqytetin Baku.</li> </ol>

<p>Organizata "Human Right Watch" ka paralajmëruar se prishjet e paligjshme të shtëpive që janë bërë në Baku u kanë kushtuar qindra familjeve. Natayla Alibekova, e cila ka jetuar për 11 vjet në shtëpinë e saj, beson se kjo është pjesë e taktikës që ajo dhe familja e saj të lirojnë rrugën për ndërtimin e sallës së koncerteve. Asaj i kanë thënë që duhet të largohet nga shtëpia para Vitit të Ri.</p> <p>"Ata më kanë thënë se nuk mund të ngrihem kundër qeverisë, nuk kam të drejtë dhe nuk kam shtëpi më", i ka thënë ajo BBC-së. "Është e tmerrshme. Të gjithë jemi të brengosur dhe asnjëri nga ne nuk po mundemi të flemë rehat. Ndërtimi i sallës nënkupton se shtëpia do të dridhet. Është sikur një tërmet. Dhe kamionët e vinçat janë duke punuar gjatë gjithë natës, kështu që e kemi të pamundur të flemë", ka thënë ajo. Edicioni i vitit 2011 i garës evropiane të këngës edhe një herë ka qenë dështim për Britaninë Bendi "Blue", që ka përfaqësuar shtetin britanik, ka përfunduar i njëmbëdhjeti.</p>	<p>20. Organizata "Human Right Watch" ka paralajmëruar</p> <p>21. se prishjet e paligjshme të shtëpive që janë bërë në Baku</p> <p>22. u kanë kushtuar qindra familjeve.</p> <p>23. Natayla Alibekova, e cila ka jetuar për 11 vjet në shtëpinë e saj,</p> <p>24. beson se kjo është pjesë e taktikës</p> <p>25. që ajo dhe familja e saj të lirojnë rrugën</p> <p>26. për ndërtimin e sallës së koncerteve.</p> <p>27. Asaj i kanë thënë që duhet të largohet nga shtëpia</p> <p>28. para Vitit të Ri.</p> <p>29. "Ata më kanë thënë</p> <p>30. se nuk mund të ngrihem kundër qeverisë,</p> <p>31. nuk kam të drejtë</p> <p>32. dhe nuk kam shtëpi më",</p> <p>33. i ka thënë ajo BBC-së.</p> <p>34. "Është e tmerrshme.</p> <p>35. Të gjithë jemi të brengosur</p> <p>36. dhe asnjëri nga ne nuk po mundemi të flemë rehat.</p> <p>37. Ndërtimi i sallës nënkupton</p> <p>38. se shtëpia do të dridhet.</p> <p>39. Është sikur një tërmet.</p> <p>40. Dhe kamionët e vinçat janë duke punuar gjatë gjithë natës,</p> <p>41. kështu që e kemi të pamundur të flemë",</p> <p>42. ka thënë ajo.</p> <p>43. Edicioni i vitit 2011 i garës evropiane të këngës edhe një herë ka qenë dështim për Britaninë.</p> <p>44. Bendi "Blue", (që ka përfaqësuar shtetin britanik),</p> <p>45. ka përfunduar i njëmbëdhjeti.</p>
---	--

*Makropropozicionet*

<ol style="list-style-type: none"> <li>1. fituesi i sivjetmë përgatitet</li> <li>2. për spektaklin evropian të këngës në mot</li> <li>3. Azerbajxhani rrënon shtëpi</li> <li>4. për t'i bërë vend sallës për "Eurosong 2012"</li> <li>5. Autoritetet e Azerbajxhanit janë akuzuar për dëbimin e qindra familjeve</li> <li>6. për të liruar hapësirën për ndërtimin e sallës së re të koncerteve</li> <li>7. e cila do të jetë nikoqire e edicionit të vitit të ardhshëm të garës evropiane të këngës.</li> <li>8. Megjithatë, autoritetet janë akuzuar se kanë ndërprerë rrymën, gazin dhe ujin për disa familje</li> <li>9. në përpjekje për t'i detyruar njerëzit të largohen nga vendi i tyre</li> <li>10. në mënyrë që të krijohet hapësira për të ndërtuar sallën e re në kryeqytetin Baku.</li> </ol>	<p>Propozicionet 1-10 paraqesin një tërësi kup- timore dhe kështu= një MakroPropozicion</p>
<ol style="list-style-type: none"> <li>11. Organizata "Human Right Watch" ka paralajmëruar</li> <li>12. se prishjet e paligjshme të shtëpive që janë bërë në Baku</li> <li>13. i kanë lënë pa shtëpi qindra familje.</li> <li>14. Organizata "Human Right Watch" ka paralajmëruar</li> <li>15. se prishjet e paligjshme të shtëpive që janë bërë në Baku</li> <li>16. u kanë kushtuar qindra familjeve.</li> </ol>	<p>Propozicionet 11-16 / MacroPropozicion</p>
<ol style="list-style-type: none"> <li>17. Azerbajxhani do të jetë nikoqir i Evropizionit</li> <li>18. për herë të parë në histori</li> <li>19. pasi ka fituar garën e vitit 2011 të mbajtur në Gjermani</li> <li>20. falë performancës së duetit Ell dhe Nikki, me këngën "Running Scared".</li> <li>21. Ky shtet shpreson</li> <li>22. se organizimi i garës do të ndihmojë përmirësimin e imazhit të ish republikës sovjetike dhe të presidentit Ilham Aliyev.</li> </ol>	<p>Propozicionet 17-22 / MacroPropozicion</p>

<p>23. Natayla Alibekova, e cila ka jetuar për 11 vjet në shtëpinë e saj,  24. beson se kjo është pjesë e taktikës  25. që ajo dhe familja e saj të lirojnë rrugën  26. për ndërtimin e sallës së koncerteve.  27. Asaj i kanë thënë që duhet të largohet nga shtëpia  28. para Vitit të Ri.  29. "Ata më kanë thënë  30. se nuk mund të ngrihem kundër qeverisë,  31. nuk kam të drejtë  32. dhe nuk kam shtëpi më",  33. i ka thënë ajo BBC-së.  34. "Është e tmerrshme.  35. Të gjithë jemi të brengosur  36. dhe asnjëri nga ne nuk po mundemi të flemë rehat.  37. Ndërtimi i sallës nënkupton  38. se shtëpia do të dridhet.  39. Është sikur një tërmet.  40. Dhe kamionët e vinçat janë duke punuar gjatë  gjithë natës,  41. kështu që e kemi të pamundur të flemë",  42. ka thënë ajo.</p>	 <p>Propozicionet 23-42/ MacroPropozicion</p>
<p>43. Edicioni i vitit 2011 i garës evropiane të këngës edhe  një herë ka qenë dështim për Britaninë.  44. Bendi "Blue", (që ka përfaqësuar shtetin britanik),  45. ka përfunduar i njëmbëdhjeti.</p>	 <p>Propozicionet 43-45/ MacroPropozicion</p>

### V.2.7. ANALIZA TEMATIKE SIPAS KONCEPTVE TË VAN DIJKUT E STRUKTURËS KUPTIMORE TË TEKSTIT TË LAJMIT

Nëse Van Dijk u përkufizon propozicionin si "...ndërtimet më të vogla, të pavarura të gjuhës dhe mendimit. (...) Propozicionet në mënyrë tipike shprehen nga fjali të vetme ose klauzola, si në - Sandra shkarkoi menaxherin e saj dje", atëherë ai nuk shkon më tej një fjalie të thjeshtë e që mund të qëndrojë e pavarur semantikisht dhe sintaksisht ("Sandra shkarkoi menaxherin e saj dje"). Mirëpo, nëse analizojmë një tekst gazetar edhe më tej, do të vërejmë se struktura tematike është e përbërë edhe me njësi më të vogla kuptimore, të cilat kanë një koncept tematik, po nuk mund të qëndrojnë të pavarura në aspektin sintaksor. Kështu, për shembull, fjalia:

*Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara do të diskutojë të mërkurën (4) raportin e sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki Moon, për Kosovën (1), i cili përmban planin e ri-konfigurimit të UNMIK-ut (2) dhe aranzhimet e posaçme për serbët e Kosovës (3).*

Është një tërësi semantike dhe sintaksore (propositioni i Van Dijkut), por brenda vetes ka disa njësi më të vogla, të cilat kanë një koncept kuptimor po nuk mund të qëndrojnë të pavarura sintaksisht. Kjo fjali përmban katër koncepte tematike:

1. Mbledhjen e KS të OKB të mërkurën
2. Raportin e Ban Ki Moonit për Kosovën
3. Rikonfigurimin e UNMIK-ut
4. Aranzhimet e posaçme për serbët e Kosovës.

Le ta shohim lajmin e mësipërm në tërësi:

Këshilli i Sigurimit diskuton sot për Kosovën <sup>12</sup>	koncepte tematike: -Këshilli i Sigurimit diskuton sot -diskuton për Kosovën
Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara do të diskutojë të mërkurën (2) raportin e sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki Moon, për Kosovën (1), i cili përmban planin e ri-konfigurimit të UNMIK-ut (3) dhe aranzhimet e posaçme për serbët e Kosovës (4).	4 koncepte tematik
"Mbledhja e KS të OKB është caktuar për të mërkurën pasdite" (2), ka bërë të ditur të martën Mauricio Artinano, përfaqësues në OKB i Costa Ricas (13), vendi që kryeson KS-në në muajin nëntor (14). Diplomatat e këtij trupi pesëmbëdhjetë anëtarësh (15) do t'i definojnë hollësitë e Deklaratës Presidenciale (7), e cila, nëse miratohet, do të shënojë fillimin e vendosjes së EULEX-it. (8) Sipas diplomatëve në selinë e OKB-së, gjatë ditës do të mbahet një seri takimesh në të cilat (9), përveç për kohën e mbajtjes së mbledhjes, do të arrihet pajtimi edhe për tekstin e deklaratës Presidenciale, në të cilën KS do ta "përsëritë" raportin e ri të Ban Ki Moonit, udhëzimet e tij për ri-konfigurimin që nga qershori (3 dhe 4), dhe bashkëpunimin mes OKB, BE dhe faktorëve rajonalë (6).	9 koncepte tematike
Në New York ka udhëtuar edhe ministri kosovar i Punëve të Jashtme, Skënder Hyseni (10), i cili ka bërë kërkesë që t'i jepet fjala në mbledhjen e KS-së (11), në mënyrë që ta paraqesë qëndrimin refuzues të Prishtinës për planin gjashtë-pikësh të Ban Ki-moonit. (12)	3 koncepte tematike

Nëse e zërthejmë lajmin vetëm në koncepte kuptimore, duke i renditur ato sipas rëndësisë që kanë, atëherë tabela do të dukej kështu:

- raportin e sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki Moon, për Kosovën (1)
- Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara do të diskutojë të mërkurën (2)
- i cili përmban planin e ri-konfigurimit të UNMIK-ut (3)
- udhëzimet e tij për ri-konfigurimin që nga qershori (4)
- dhe aranzhimet e posaçme për serbët e Kosovës (5)
- dhe bashkëpunimin mes OKB-së, BE-së dhe faktorëve rajonalë (6)
- do t'i definojnë hollësitë e Deklaratës Presidenciale (7)
- e cila, nëse miratohet, do të shënojë fillimin e vendosjes së EU-LEX-it (8)
- Sipas diplomatëve në selinë e OKB-së, gjatë ditës do të mbahet një seri takimesh (9)
- Në New York ka udhëtuar edhe ministri kosovar i Punëve të Jashtme, Skënder Hyseni (10)
- i cili ka bërë kërkesë që t'i jepet fjala në mbledhjen e KS-së (11)
- në mënyrë që ta paraqesë qëndrimin refuzues të Prishtinës për planin gjashtëpikësh të Ban Ki-Moonit (12)
- ka bërë të ditur të martën Mauricio Artinano, përfaqësues në OKB i Costa Ricas (13)
- vendi që kryeson KS-në në muajin nëntor (14)
- Diplomatët e këtij trupi pesëmbëdhjetë anëtarësh (15)

Lajmet, dhe në përgjithësi teksti gazetar, është i ndërtuar mbi këto koncepte tematike. Sa më shumë këso koncepte tematike lajmi është më i mirë dhe ka më shumë informacionin e duhur dhe e kundërta, sa më pak këso konceptesh tematike teksti aq më shumë teksti gazetar është subjektiv dhe komentues.

### V.2.8. PRIRJE TË REJA NË STRUKTURËN TEKSTORE TË LAJMIT

Struktura tekstore e lajmit digjital (teksti digjital) ndryshon nga këto struktura që analizuam dhe ka prirje për përshtatje të reja. Janë dy faktorë që e përcaktojnë këtë transformim të lajmit: shpejtësia e të lexuarit të lajmit digjital nga përdoruesit e medieve "on line" dhe shpejtësia për të dhënë lajmin sa më parë. Faktori i parë ka të bëjë me përdoruesit: ata i "shfletojnë" tekstet digjitale shpejt e shpejt, i lexojnë sipërfaqësisht, lexojnë vetëm informatën kryesore dhe kalojnë te lajmi tjetër, nganjëherë lexojnë vetëm titujt, pak a shumë ngjashëm me shfletimin e gazetës në letër, veçse tash me

një dinamikë të shtuar. Kjo ka ndikuar që lajmi digjital të shkurtohet, të ekzistojë vetëm në strukturat e domosdoshme tekstore të lajmit, pra me titull, kre dhe material që e shpjegon kreun. Ja një shembull i tillë:

### 799 vërtetime për azil në 24 orët e fundit

Publikuar: 14:16 / 20.02.2016

Në 24 orët e kaluara 799 shtetasve të huaj u janë dhënë vërtetime për shtrimin e kërkesës për pranimin e të drejtës së azilit. Prej tyre, siç kumtoi MPB, 333 janë të gjinisë mashkullore, 164 të gjinisë femërore, 295 fëmijë të cilët e shoqërojnë bartësin e vërtetimit dhe shtatë fëmijë të cilët kanë udhëtuar pa prindër. Në 24 orët e kaluara deri te Sektori për azil nuk janë shtruar kërkesa për njohjen e së drejtës për azil në bazë të vërtetimit të lëshuar paraprakisht për shprehjen e qëllimit për shtrimin e kërkesës për njohjen e të drejtës për azil, informon MPB.



Lajmi digjital shkurtohet, ekziston vetëm në strukturat e domosdoshme tekstore të lajmit, pra me titull, kre dhe material që e shpjegon kreun.

Ky është një lajm tipik digjital i portaleve “on-line” shqiptare. Ka një titull që jep informatën kryesore, e cila përsëritet në nëntitull pa informatë të re, dhe ka materialin që e shpjegon titullin e nëntitullin. Këtu titulli dhe nëntitulli luajnë rolin e kreut të lajmit. Por, mund të hetohet menjëherë pengun e shpejtësisë: lajmi nuk thotë se për cilin vend bëhet fjalë.

Për shkak të kriterit të shpejtësisë struktura e lajmit digjital po e krijon, ta quajmë, strukturën sasiore të lajmit. Kjo strukturë sasiore përbëhet prej një elementi bazik: informata kryesore (mund të jetë ky lajm klasik) dhe prej disa elementeve shtesë, të cilat shtresohen mbi elementin bazik, me shenjimin “e plotësuar”. Këto elemente shtesë, edhe pse qëndrojnë mbi informatën kryesore, nuk e kanë rolin parësor, pra nuk paraqesin informatë kryesore, por informatë ndihmëse. Po të ndiqej struktura tradicionale e lajmit, këto elemente shtesë mund ta kishin vendin pas materialit që shpjegon kreun, ndërsa në lajmet digjitale dalin mbi kreun, por jo për shkak të rëndësisë së tyre, por vetëm për shkak të kohës, momentit të fundit të shkrimit të tyre. Uebportali i kursen marrësit kohë për të hulumtuar elemente të reja shtesë brenda tekstit të lajmit, prandaj i jep të ndara, mbi kreun e lajmit, në mënyrë që marrësi sapo ta hapë lajmin t’i shohë të dhënat e fundit për atë lajm, e vetëm nëse është i interesuar më tej ai vazhdon edhe leximin e lajmit të shkruar më herët.

Ja një shembull i strukturës sasiore të lajmit digjital:





### Arrestohet deputeti i VV-së, Faton Topalli

8 Dhjetor 2015 - 12:56

**[E plotësuar] - Policia e Kosovës ka arrestuar në ambientet e Kuvendit të Kosovës, deputetin e Vetëvendosjes, Faton Topalli.**

Ndaj tij ka pasur një fletarrest të lëshuar nga organet e rendit për shkak të veprimeve në Kuvend, ku është hedhur gaz lotsjellës, sprej e vezë.

Lajmi i plotësuar  
(i përditësuar)

### Policia bllokoi në Kuvend Faton Topallin

Pas arrestimit të Albulena Haxhiut, Policia e Kosovës po mban të bllokuar edhe deputetin tjetër në arrati të Vetëvendosjes, Faton Topalli.

Lajmin e ka bërë me dije vetë Topalli, që ka thënë se Policia po e mban të bllokuar në Kuvendin e Kosovës, transmeton Koha.net.

"Para gjysmë ore hyra në Kuvend për t'i kryer detyrat që më takojnë si deputet. Tani policia nuk më lë të dal nga Kuvendi. Nuk më thanë asnjë arsye pse nuk mund të dal. Momentalisht jam i arrestuar brenda Kuvendit. Kryeministri Mustafa po feston një vjetorin e pushtetit të tij përmes arrestimit të deputetëve të opozitës. Po në rrugën tonë për Republikën e Kosovës nuk mund të na ndal askush", ka shkruar Topalli. Për një kohë, Topalli kishte qëndruar në Zvicër, meqë ka nënshtetësi të shtetit helvetik. Për Interaktiv të KTV-së kishte thënë se atje ka shkuar për disa punë të tij private e për takime të ndryshme, por jo për t'u fshehur.

Topalli është në mesin e deputetëve që kanë hedhur gaz lotsjellës në Kuvendin e Kosovës, për të kundërshtuar marrëveshjen për Asociacionin e Komunave me shumicë serbe me Serbinë dhe atë për demarkacionin me Malin e Zi.

<http://koha.net/?id=27&l=87937>



### Policia zbardh detaje të reja për sulmin ndaj zyrës së Presidencës (Foto)

12 mars 2016 - 10:09

**(I plotësuar)**- Policia e Kosovës në raportin 24 orësh ka zbuluar detaje të reja për sulmin e mbrëmshëm ndaj objektit të Kuvendit të Kosovës, përkatësisht ndaj zyrës së Presidencës. "Me datën 12.03.2016 rreth orës 04:00 është raportuar se disa persona të dyshuar të maskuar kanë hedhur koktejt molotov në drejtim të ndërtesës Presidenciale. Personat e dyshuar pas hedhjes së koktejt molotovit dyshohet se janë larguar në drejtim të rrugës Agim Ramadani me një veturë ngjyrë të bardhë. Fillimisht dyshohet se me gurë e kanë thyer xhamin e dritarës ku kanë tentuar që ta hedhin shishen e molotovit, çka nuk kanë arritur pasi që shishja është goditur në muri ku shihet një sipërfaqe e murit rreth një metër e nxirë me rastin

e thyerjes së shishes, ku derivatet janë djegur në atë pjesë të murit. Njësia policore ka dalë menjëherë në vendngjarje, mirëpo nuk është arritur të hasen të dyshimtit", thuhet në raport.

Në vendngjarje kanë dalë të gjitha njësitet policore relevante, duke përfshirë edhe njësinë e hetimeve dhe krim-teknikën rajonale për të kryer ekzaminimin e vendit të ngjarjes, duke përfshirë dëshmitë në vendngjarje.

Nuk raportohet për persona të lënduar. Rasti është iniciuar dhe dedikuar njësisë së hetimeve për procedura të mëtutjeshme dhe kryerje të hetimeve intensive, për zbulimin dhe arrestimin e personave të dyshuar.

.....

**(I plotësuar)**- Policia e Kosovës ka konfirmuar për Indeksonline sulmin në objektin e Kuvendit të Kosovës.

Zëdhënësja e policisë, Flora Ahmeti ka thënë se ngjarja ka ndodhur rreth orës 04:00 të mëngjesit të sotëm.

"Po, rreth orës 4 katër të mëngjesit kemi marrë informacionin për një rast të shkakut të rrezikut të përgjithshëm, asgjësimi apo dëmtim i pasurisë. Rasti ka ndodhur në rrugën "Agim Ramadani" në Prishtinë. Menjëherë pasi kemi marrë informacioni e kemi bërë ekzaminimin në vendin e ngjarjes dhe njësitet kanë dal aty. Po ashtu për rastin në fjalë e kemi njoftuar prokurorinë. Policia është duke punuar në këtë drejtim të identifikimit të personave që kanë kryer këtë vepër", ka thënë Ahmeti./Indeksonline/

### **Persona të maskuar sulmuan Kuvendin me kokteje molotovi (Foto)**

**(I plotësuar)**- Në orët e hershme të mëngjesit të sotëm objekti i Kuvendit të Kosovës është sulmuar me kokteje molotovi, nga persona të maskuar.

Të paktën kështu ka thënë një person për lajmi.net që e ka parë ngjarjen nga një banesë aty përballë Kuvendit të Kosovës, e që ka arritur më pas të bëjë edhe fotografi.

Për sulmin në drejtim të objektit të Kuvendit e ka konfirmuar edhe sekretari i Kuvendit të Kosovës, Ismet Krasniqi.

"Po ka pasur gjuajtje në objektin e Kuvendit , kati i Presidencës", ka thënë Krasniqi për Indeksonline.

Ndërkaq Indeksonline ka provuar të kontaktojë me Policinë e Kosovës dhe Zyrën e Presidentes por kontakti me ta ka qenë i pamundur./Indeksonline/

## V.3. ELEMENTET E STRUKTURËS TEKSTORE TË LAJMIT SIPAS PËRSHKRIMIT TRADICIONAL NË GAZETARINË AMERIKANE (MENSHER)

### V.3.1. TITULLI

Titulli i tekstit gazetar, lajmit apo raportit (por edhe i zhanrit apo llojit tjetër) është një pikë kulmore e shkrimit. Ai duhet ta përmbajë temën e tekstit dhe ta thotë në atë mënyrë që ta tërheqë vëmendjen e marrësit.

- Paralajmërohen 30 njohje - është titulli i lajmit për pritjet që Republikën e Kosovës ta njohin edhe 30 shtete të tjera.
- Akademia e Maqedonisë tërheq Enciklopedinë nga shitja - është titulli i lajmit që tregon për vendimin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë për tërheqjen nga shitja e Enciklopedisë së Maqedonisë.
- Ik edhe kompania CEZ nga projekti "Kosova e Re" - është titulli i lajmit për tërheqjen e kompanisë çeke CEZ nga konkurrenca për ndërtimin e termocentralit të ri në Kosovë.

Në të tre shembujt titulli shpreh bindshëm temën e lajmit.

Titulli është i rëndësishëm sepse në katër-pesë fjalë duhet të përmbledhet tema e lajmit dhe, po ashtu, titulli përmban edhe tonin e shkrimit. Po ashtu, vendi i titullit dhe gjerësia e tij e paragjykojnë edhe rëndësinë që redaksia e gazetës i jep shkrimit, e kjo ndikon te lexuesi. Në gazetarinë bashkëkohore, për shkak se titujt shkruhen me shkronja të mëdha dhe zënë hapësira të mëdha të faqes së gazetës (e kjo nuk ka qenë gjithmonë kështu), tentohet që titulli të jepet me sa më pak fjalë, mundësisht me një fjalë të vetme. Kjo për arsye se kur bëhet mirë, titulli me një fjalë godet më shumë marrësin, jehon më shumë dhe mbahet mend më shumë. Kështu, nëse një lajm ka për temë një vrasje, titulli me vetëm një fjalë "Vrasje!" është më goditës se çfarëdo titulli tjetër. Nëse këtij titulli i shtohen edhe tri pikë çuditëse (Vrasje!!!), goditja e tij është edhe më e fuqishme. Por, nëse titullit i bashkëngjitet edhe një fjalë "pse" dhe një pikëpyetje (Vrasje! Pse?), atëherë e keni tërhequr lexuesin edhe më shumë, sepse pyetja "pse?" e nxit atë të mendojë për një vrasje tepër të pazakontë (edhe pse asnjë vrasje nuk është e zakonshme).

Shkrimi i titullit me vetëm një fjalë, sa do të jetë e synueshme për çdo gazetar, është vështirë të arrihet gjithmonë me sukses dhe me saktësi. Jo gjithmonë një fjalë mund ta japë idenë themelore të një lajmi. David Randall ka vërejtur rreziqet që sjell titulli me

Në shekullin XVIII e më herët lajmet shkruheshin pa tituj. Pas shpikjes së telegrafit, në vitin 1830 dhe makinerive të tjera për shtypje të shpejtë, u bë i mundur krijimi i shtypit masiv, apo si njihet shtypi i qindarkave. Shtypi i qindarkave i vuri në majë të lajmit titullin dhe kreun.

#### Çka solli shtypi i qindarkave në gazetarë?

Gazetat e qindarkave riformatizuan tekstin gazetar:

- Titujt morën rol
- U krijua Piramida e përmbysur (për shkak se telegrafët shpesh prisheshin, kështu që ne kreun e lajmit jepeshin informatat kryesore, edhe nëse prishej telegrafi lajmi kryesor ishte marrë);
- U krijuan reporterët që mbulonin fusha të caktuar lajmesh: policia, tregu, gjykatat, kultura etj.;
- U krijuan gazetarët që vrapojnë pas lajmit;
- Shitja e gazetës kaloi nga modeli i pajtimtarëve të shitja në rrugë me anë të kolporterëve;
- Vrapim pas lajmeve sensacionale.
- Gazetaria informative e mundi gazetarinë opinioniste.

vetëm një fjalë. Nëse dy veta, thotë ai, diskutojnë për një çështje dhe nuk mund të pajtohen, ndërsa gazetari dëshiron të bëjë një titull me vetëm një fjalë, cilën fjalë do ta përdorte: grindje? polemikë? çarje? sulm? etj. Asnjë prej këtyre fjalëve nuk e shpreh diskutimin e papajtueshëm midis dy personave. Për pasojë, këto fjalë nuk paraqesin plotësisht përmbajtjen e lajmit. Randall i quan këta tituj "çorientues" duke i bërë një analogji: "...është njësoj sikur një njeri i zemëruar e me fjalor të varfër ta përkthejë një tregim nga një gjuhë tjetër".<sup>13</sup>

Për shkak të përmbledhjes së lajmit në mënyrë të reduktuar në titull marrësi mund ta pranojë vetëm titullin dhe asgjë më tepër nga lajmi. Ky fakt bëhet shkas për një abuzim gazetar, i shprehur mjaft shumë edhe në gazetarinë në Kosovë. Jo rrallë, sidomos në gazetarinë e paformësuar, në tituj jepen përmbajtje që nuk janë plotësisht në përputhje me brendinë e lajmit. Në këto raste zakonisht përdoren shprehje skandaloze, ato që e nxitin kureshtjen e lexuesit, vetëm sa për ta futur edhe në brendi të lajmit. Kështu, në vend se "dyshohet për keq-menaxhim të tenderit për dhurata të fëmijëve", në titull vihet: "përvetësoi dhuratat e fëmijëve". Në vend se "do të dalë para gjykatës nën dyshimin për vrasje", në titull i bihet shkurt "krimineli" etj. Pavarësisht nga efekti ditor, kjo mënyrë e ndërrimit të fjalëve dhe të kuptimeve është në kundërshtim me kodin e gazetarit, poende krijon mosbesim dhe dyshim në paanësinë e gazetarit në procesin e informimit.

Titulli nuk duhet të përmbajë elemente që nuk janë esenciale për shkrimin. Nuk duhet që për hir të tërheqjes së vëmendjes së marrësit, të marrë natyrë sensacionale, për dallim nga përmbajtja. Po ashtu, titulli, sikurse krejt lajmi, nuk duhet të jetë paragjykim. Duhet ta mbitheksojmë këtë fakt se në vitet e fundit në gazetarinë shqiptare, sidomos në Kosovë, disa gazeta gjithnjë vënë tituj paragjykes. Kështu *Express* me tituj *Gjahtari i femrave* apo *Abdullah Pango jep "lajmin"* duke gjykuar aktorët e lajmit: në rastin e parë presidentin e Kosovës sipas disa thashethemeve, ndërsa në rastin e dytë një kandidat për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, duke i dhënë atij mbiemrin e ish-ministrit të Shqipërisë, Ylli Pango, i njohur për skandalin seksual, për çka u shkarkua nga qeveria, e i cili më vonë u shfajësua nga një gjykatë.

Paragjykimi dhe gjykimi nga ana e gazetarit e shndërron tekstin gazetar në propagandë. Mjafton të shikohen titujt e lajmeve të gazetave të Kosovës të cilat kanë informuar për dorëheqjen e presidentit të Kosovës, Fatmir Sejdiut, të bërë më 27 shtator 2010. Të nesërmen gazetaret shqipe informuan dhe komentuan në mënyra të ndryshme:

Emri i gazetës	Titulli i lajmit për dorëheqjen e presidentit	Statusi i tekstit
Koha ditore	(Lajm): Sejdiu ua qel rrugën zgjedhjeve të hershme (Fotolajm): Sejdiu jep dorëheqje	Paragjykim dhe koment Informim
Kosova sot	Sejdiu jep dorëheqje Negociohet për koalicionin dhe presidentin e ri	Informim
Infopress	Rrëshqiti në Kushtetutë	Koment (ironi; pezhorativ)
Express	Kaq ishte	Koment (ironi; pezhorativ)
Epoka e re	E dha	Koment (ironi; pezhorativ)
Zëri	Shkrihet Sejdiu	Koment (ironi; pezhorativ)
Lajm	Presidenti shkrihet në LDK	Koment (ironi; pezhorativ)
Tribuna shqiptare	Presidenti i ri apo zgjedhje?	Koment
Prishtina post	Vazhdojmë...	Koment (lavdërim)

Një analizë edhe vetëm sipërfaqësore e kuptimit të këtyre titujve krijon një farë njohje për orientimet politike të gazetave, me përjashtim të dy gazetave, *Kohës ditore* dhe *Kosova sot*. Gazetaria e këtyre nuk është informative por komentuese dhe ky shembull dëshmon se si nuk duhet të jenë titujt e lajmeve, edhe atëherë kur duken pikantë, si disa prej titujve të mësipërm.

### V.3.2. LLOJET E TITUJVE

Nëse kreu i lajmit është thelbi i lajmit, titulli i lajmit është thelbi i thelbit të lajmit. Me shumë më pak fjalë titulli duhet ta japë informacionin kryesor të lajmit dhe të kreut. Shkrimi i titujve është shkathtësi më vete, prandaj gazetarët në fillim të karrierës së tyre nuk shkruajnë vetë tituj. Disa gazeta e praktikojnë që gazetarët fare të mos shkruajnë tituj: ato i shkruajnë redaktorët me përvojë. Varësisht nga zhanri gazetar edhe titujt ndërrojnë format: kështu, në gazetarinë informative përdoren kryesisht titujt informues; në gazetarinë analitike përdoren tituj komentues apo vlerësues; në gazetarinë publicistike përdoren edhe tituj figurativë. Duke pasur një rëndësi të tillë edhe titulli i lajmit është formësuar në disa tipa, varësisht nga qëllimi i shkruarit të tij. Këtu po japim disa tipa titujsh të lajmeve që përdoren më së shpeshti në gazetatat shqipe:

- Titulli informativ: është titulli më i shpeshtë dhe më i praktikuari në gazetarinë informative (*Zjarr në një shtëpi në lagjen Mat të Prishtinës*);
- Titulli vlerësues (*Fitore e madhe e Kosovës*);

titull informues  
titull komentues  
titull vlerësues  
titull figurativ  
titull numërues  
titull alternativ

- Titull numërues (*Një viktimë dhe tre të lënduar*);
- Titull mohues (*Thaçi: Askush tjetër s'do ta marrë mandatin për qeverinë*);
- Titull alternativ (*Shkupi mes qeverisë kalimtare dhe zgjedhjeve të përgjithshme*);
- Titull komentues (*Dallaveret me mobil*).

Shpesh studentët e gazetarisë po edhe gazetarët e rinj pyesin: çfarë titulli t'i vëmë lajmit? Përgjigjja është e thjeshtë: vendoseni informatën kryesore të lajmit në titull, në mënyrë sa më të përmblëdhur dhe sa më të shkurtër. Të lexojmë disa tituj të lajmeve për të parë se si ata bartin informatën kryesore të lajmit:

- *Presidenti dekreton Sali Berishën kryeministër.*
- *Prokuroria pushoi hetimet ndaj Fazliç-it.*
- *Fillimi i pjesës së dytë: Shqipëria barazon me Danimarkën.*
- *Shkupi dhe Prishtina vendosin marrëdhënie diplomatike.*
- *Socialistët do të bojkotojnë zgjedhjet lokale të 15 nëntorit.*
- *Nga 400 bletarë, vetëm 13 pjesëmarrës në panairin e mjaltit.*
- *Në lokal me armë në brez.*
- *I dënuari sërish në bankë të zezë.*
- *12 policë kufitarë arrestohen për korrupsion.*
- *Nafta shtrenjtohet sërish, shkon në 79 dollarë.*
- *Digjet transmetuesi i televizionit lokal Puls.*
- *Debëlldehasit sot protestojnë kundër marrëveshjes kufitare me Maqedoninë.*
- *Asfaltimi i rrugës Rashinicë-Gllavicë-Koshare.*
- *Shuhet shkrimtari Dhimitër Xhuvani.*
- *Panairi i librit çelet me zhurmë.*
- *Ekspozitë për Galileon në Vatikan.*

### V.3.3. KREU

Kreu quhet paragrafi i parë në lajm. Për lajmin paragrafi i parë është i rëndësishëm themelore. Ai duhet të përmblëdhë temën (apo temat) kryesore të lajmit. Ai duhet të jetë mishërim i tërësisë së lajmit deri në atë masë sa redaktorët i pyesin gazetarët anglishtfolës: "Cili është kreu i lajmit tuaj?", ose edhe gazetari i thotë redaktorit: "E kam një lid (nga anglishtja: *li:d*-hyrje, prirje, udhëheqje) të ri për ju". Në të dy rastet kreu (lid-i) nënkupton tërësinë e lajmit.

Kreu e jep thelbin e lajmit. Ai duhet të shkruhet në atë mënyrë që t'i theksojë të gjitha elementet themelore të një lajmi. P.sh.:

Kreu-koka-krye

Kreu përmblëdh temën (apo temat) kryesore të lajmit



### Presidenti dekreton Sali Berishën kryeministër

Shekulli | 09/09/2009 |

TIRANË- Presidenti i Republikës, Bamir Topi ka dekretuar sot rreth orës 15.00 kryeministrin e vendit, Sali Berisha. Përmes një dekreti, kreu i shtetit Bamir Topi, në mbështetje të nenit 93 dhe 96, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim shumicës parlamentare, ka dekretuar Sali Berishën, Kryeministër të Republikës së Shqipërisë. Dekreti hyn në fuqi menjëherë.

Kreu, pra, duke përmbajtur informacionin kryesor të lajmit, i përshtatet detyrimisht ngjarjes lajmore, apo temës së lajmit:

- nëse tema e lajmit është një zjarr, zjarri duhet të jetë në kreun e lajmit;
- por nëse në atë zjarr është rrënuar shtëpia e një familjeje, atëherë rrënimi i shtëpisë nga zjarri duhet të jetë në kreun e lajmit;
- por nëse zjarri dhe rrënimi kanë mbytur një njeri, vdekja e tij duhet të jetë në krye.

Ose më thjeshtë:

- kur dikush pëson aksident trafiku, pyetja e parë që ia bëni është: kanë shpëtuar njerëzit? Kreu i një lajmi të tillë patjetër duhet të përmbajë faktet që kanë të bëjnë me vdekjen e të aksidentuarve;
- Nëse njerëzit kanë shpëtuar ju do të pyesni: po a ka të lënduar? Kreu i një lajmi të tillë patjetër duhet të përmbajë faktet për të lënduarit.
- Dhe nëse nuk ka të lënduar ju do të pyesni: po makina është dëmtuar? Kreu i një lajmi të tillë patjetër duhet të përmbajë faktet për dëmet materiale.

Kështu, atë hierarki të rëndësisë së gjërave që bën logjika e secilit njeri duhet ta shfrytëzojë edhe gazetari në shkrimin e kreut të parë. Se çka do të përmbledhë në kreun e lajmit, kjo është punë e gazetarit. Prej perceptimit të tij logjik varet gjithçka. Nëse lajmi ka dy tema, kreu i tij duhet ta përmbledhë informacionin themelor për dy temat; nëse lajmi ka tri tema kreu i tij duhet t'i përmbledhë tri temat. Kështu, nëse në aksidentin e mësipërm policia rrugore është vonuar dhe kjo ka krijuar bllokim të komunikacionit për disa orë, e gazetari dëshiron ta trajtojë edhe këtë temë në lajm, atëherë kreu, përveç fakteve për pasojat, duhet ta përmbajë edhe vonesën e policisë rrugore dhe bllokimin e komunikacionit.

Por nëse gazetari dështon ta bëjë kreun e mirë? Atëherë nuk ka lajm të mirë. Mencheri e quan këtë krye, "kreu i fshehur" dhe "kreu



i varrosur”: “Gabimi më i rëndomtë i fillestarëve është varrosja e kreut, fshehja e tij në morinë e fjalëve të tregimit”.<sup>14</sup>

Dështimi në bërjen e kreut të mirë është dështim i gjithë lajmit. Ja një hyrje e tillë:



Kolegjet e akredituara në korrik kanë të drejtë të organizojnë studime master

### Vetëm një kolegji aplikon për master

“Ne i kemi njoftuar bartësit e kolegjeve që deri më 15 shtator të na sjellin aplikacionet dhe dokumentet e nevojshme për riaplikim për master. Pas kësaj kohe bordi do t’i rishqyrtojë aplikacionet dhe do të vendosë se cilat kolegje i plotësojnë kushtet për organizim të studimeve master e cilat jo”, ka sqaruar drejtori Muja.

Sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës të gjitha kolegjet e akredituara në korrik të këtij viti kanë të drejtë të organizojnë studime master në vitin akademik 2009-2010. Mirëpo numri i studentëve të cilët do të pranohen në këtë vit akademik në master nuk do të jetë më i lartë se 50 studentë. Në përputhje me vendimet e KKC të AAK-së emrin kolegji e bartin këto IAPL: “Fama”, “UBT-ja”, Instituti për Studime të Menaxhimit Institucional- “ISME”, “Viktori” dhe “Iliria”.<sup>15</sup>

Hyrja e këtij lajmi është një kaos i vërtetë. Nuk kuptohet asgjë! Ja gabimet:

- të gjitha kolegjet apo vetëm njëri organizojnë master-in?
- fillon me një citat, të cilin marrësi nuk e di se i kujt është derisa t’i bjerë në fund paragrafit të parë (nëse i bie deri në fund?!)
- folësi i citatit është drejtori Muja. Kush është ky drejtori Muja?
- citati është krejt pa vend! Drejtori Muja tregon se si i kanë informuar kolegjet, por nuk thotë asgjë për informacionin e mbititullit e të titullit.
- as paragrafi i dytë nuk flet se cili apo cilat kolegje do të organizojnë master.
- gazetari shkruan gjëra të paqarta: “vendimet e KKC të AAK-së”. Çka janë këto shkurtesa? A duhet lexuesi t’i kërkojë në internet? Por nëse ai është duke e lexuar lajmin në autobus, si do ta kuptojë se çka është “KKC i AAK-së”?
- paragrafi i dytë i lajmit mund të jetë kreu, ndërsa paragrafi i parë të bëhet material që shpjegon kreun.

Kreu ka edhe një rol tjetër: ai duhet ta tërheqë lexuesin në brendinë e lajmit.<sup>16</sup> Marrësi e lexon kreun (shumë prej tyre vetëm kreun e lexojnë) dhe, nëse kreu nxit interesimin e tij, ai do të vazhdojë ta lexojë tërë lajmin.

Është një masë matëse për cilësinë e kreut: nëse lajmit tuaj ia hiqni paragrafët e tjerë dhe mbetet vetëm kreu, a kuptohet esenca e lajmit tuaj? Nëse po, kreu është i mirë; nëse jo, kreu nuk është në rregull.

Kreu i lajmit duhet gjetur para se të fillohet shkrimi i lajmit. Zakonisht ai gjendet gjatë fazës së mbledhjes së fakteve. Duke qenë se kreu përmban esencën e lajmit, pra informacionin kryesor, atëherë në momentin kur gazetari vetë kupton esencën e lajmit të tij, aty ai e ka idenë edhe për kreun. Melvin Mencheri thotë se momenti më i keq për ta gjetur kreun është kur uleni para tastierës së kompjuterit dhe filloni të shkruani.<sup>17</sup> Nëse deri atëherë nuk e keni gjetur kreun, jeni vonuar dhe bëni një plan të ri të lajmit.

Se si duhet shkruar hyrjen e lajmit ia vlen të përmendim këtu këshillën që i kanë dhënë David Randallit, e që quhet "Parabola e mikut në kodër": "Zëre se ke në kokë gjithë informacionin e ngjarjes dhe je duke ecur në fshat. Papritur, në majë të kodrës, sheh një mikun tënd, që me siguri mezi pret të dëgjojë për ngjarjen. Sulesh përpjetë e vrap dhe kur arrin të ka mbetur aq frymë sa për të thënë një frazë. Po ç'ishte ajo që the ashtu me ngut? Pikërisht hyrja".<sup>18</sup>

Ndoshta një shembull shumë i përshtatshëm për kreun e lajmit mund të merret nga historia antike, pikërisht nga beteja e Termopileve midis helenëve dhe persëve. Lajmësi i betejës, Marathonaku, vrapon dyzet kilometra për ta shpënë në Athinë lajmin e fitores, e kur arrin ai mund të thotë vetëm një fjalë. Ai zgjedh fjalën: e fituam! Dhe vdes. Kjo "e fituam" është kreu i lajmit të tij.

Në aspektin sintaksor kreu përbëhet nga tri gjymtyrë kryesore: kryefjala+kallëzuesi+rrethor (?) +kundrina. Fjalja e parë e lajmit të mësipërm ka këtë strukturë:

Presidenti i Republikës, Bamir Topi ka dekretuar sot rreth orës 15.00 kryeministrin e vendit, Sali Berisha.

- Presidenti i Republikës, Bamir Topi-kryefjala;
- Ka dekretuar-kallëzuesi;
- Sot rreth orës 15.00-rrethor kohe;
- Kryeministrin e vendit, Sali Berisha-kundrinor.

Rrethorori, prapa të cilit është vënë një pikëpyetje, nuk është gjithherë i pranishëm:

Presidenti i Republikës, Bamir Topi ka dekretuar kryeministrin e vendit, Sali Berisha.

Kreu ka edhe një rol tjetër: ai duhet ta tërheqë lexuesin në brendinë e lajmit

Edhe atëherë kur kreu është i përbërë nga më shumë se një fjali, apo nga një periudhë, baza sintaksore e fjalisë mbetet e njëjtë. Ka raste, sidomos te kreu përshkrues, kur sintaksa e fjalisë ndërron duke u bërë më komplekse:

"Fytyra e shtangur e ministrit të jashtëm të Serbisë, Vuk Jeremiç, në momentin kur kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, Hisashi Owada, lexoi fjalinë "magjike" se "Deklarata e Pavarësisë së Kosovës nuk ka shkelur asnjë normë aplikuese të së drejtës ndërkombëtare" ishte ilustrim i mirë i faktit se Serbia humbi tërësisht një betejë të cilën vetë e kishte nisur, ndërsa Kosova më shumë se sa që optimistët kishin parashikuar, mori një shtytje për shtimin e numrit të njohjes së pavarësisë së saj."<sup>19</sup>

Njëjtë është edhe me krerët vlerësues. Psh.: *Fitore e madhe e Kosovës.*

### V.3.4. TIPA TË HYRJEVE

Në traditën e shkrimit gazetar njihen dy lloje të hyrjeve:

- kreu i drejtpërdrejtë
- kreu i vonuar.


Mirëpo ka edhe tipologji të tjera më të hollësishme të kreut, e që kanë të bëjnë me përmbajtjen apo stilin. Melvin Mencheri përkufizon edhe dy lloje të tjera të kreut, si kreu i verbër (kreu i mjegulluar) dhe kreu kombo (kombinimi i kreut të drejtpërdrejtë dhe kreut të vonuar).<sup>20</sup> David Randalli dallon hyrjen rrëfim, hyrjen anekdotë, hyrjen e vonuar, hyrjen plumb, hyrjen përmbledhëse, hyrjen e thënies së çuditshme, hyrjen turbulluese, hyrjen skenografike, hyrjen pyetëse, hyrjen hokatare, hyrjen filozofike, hyrjen historike dhe hyrjen false.<sup>21</sup> Dr. Milazim Krasniqi dallon kreun rezymues (përmbledhës), kreun përshkrues dhe kreun alternativ.<sup>22</sup> Por, si shihet, që të gjithë këta krerë përkufizohen dhe tipizohen nga aspekti stilistik e jo nga aspekti strukturor. Prandaj, ne do të flasim për kreun e drejtpërdrejtë dhe kreun e vonuar, sepse kanë të bëjnë me strukturën e lajmit, e pikërisht zberthimi i strukturës së lajmit është synimi ynë.

#### V.3.4.A. KREU I DREJTPËRDREJTË: PARIMI I PIRAMIDËS SË PËRMBYSUR

Kreu i drejtpërdrejtë është ajo hyrje në të cilën gazetari në fjalinë e parë e thotë informacionin e lajmit. Të gjitha pjesët e tjera të lajmit

David Randall dallon disa tipa të krerëve (hyrjeve):  
 hyrjen rrëfim  
 hyrjen anekdotë  
 hyrjen e vonuar  
 hyrjen plumb  
 hyrjen përmbledhëse  
 hyrjen e thënies së çuditshme  
 hyrjen turbulluese  
 hyrjen skenografike  
 hyrjen pyetëse  
 hyrjen hokatare  
 hyrjen filozofike  
 hyrjen historike  
 hyrjen false.

Milazim Krasniqi, përveç kreut të drejtpërdrejtë dhe atij të vonuar, dallon edhe:  
 kreun rezymues (përmbledhës)  
 kreun përshkrues  
 kreun alternativ



Piramida e përmbysur

janë sqarim i kësaj fjalie. Kjo strukturë e lajmit është e përshtatshme me një prej parimeve më të njohura në gazetari, parimin e piramidës së përmbysur. Kjo do të thotë: baza e piramidës nuk është në fund, por në krye (baza ngrihet lart e maja në tokë), e që ka kuptimin se informatat me peshë shkojnë në krye e ato me pak peshë në fund të lajmit, d.t.th., baza (tema) e lajmit shkon në krye, ndërsa materiali tjetër më pastaj. Çdo lajm ka një lajtmotiv, një kryefjalë. Lajtmotivi i lajmit duhet të shkojë në fillim (ndodhi diçka; çka ndodhi?) ndërsa materiali tjetër më pastaj. Marrësit duhet që në fjalinë e parë t'i jepet kumti. Kumti duhet të godet.

Ja kreu i drejtpërdrejt i lajmit:

### Korrupsioni la Bullgarinë pa fonde të BE-së

Bruksel, 25 Nëntor (ROUTERS). Anëtarja e re e Bashkimit Evropian, Bullgaria, të martën i ka humbur 220 milion euro nga fondet e Bashkimit Evropian, pasi që nuk ka luftuar korrupsionin.

Në këtë krye janë tri informacione themelore për temën e lajmit:

- Bullgaria është anëtare e re e BE;
- Ajo ka humbur 220 milion €;
- Bullgaria po dështon në luftimin e korrupsionit.

Humbja e 220 milionë € është një fakt tronditës që godet në mendjen e marrësit. Nga ky kumt varet nëse marrësi ka interes për pjesën tjetër të lajmit. Shumë herë marrësi vetëm këtë kumt e merr dhe, nuk ka kohë apo nuk dëshiron të vazhdojë më tutje. Pra, nëse kumti është i dorës së parë, keni fituar shansin që marrësi

ta pranojë tërë lajmin, ose ta pranojë vetëm kumtin dhe jo pjesën tjetër të lajmit (por edhe në këtë rast ju keni arritur qëllimin: ai ka pranuar kumtin). Kjo është arsyeja pse shumica e lajmeve mbajnë që në titull lajtmotivin apo kryefjalën.

#### **V.3.4.B. KREU I VONUAR: PRIRJE PËR NDRYSHIMIN E STRUKTURËS SË LAJMIT**

Në kundërshtim me parimin e piramidës së përmbysur dhe me rolin e kreut në lajm, është i njohur edhe një model i shkrimit të lajmit, sipas parimit të hyrjes së vonuar. Në këtë strukturë lajmi gazetari nuk fillon me thelbin e lajmit në kreun e parë, por fillon me rrethana që kanë sjellë deri te tema e lajmit, për të ardhur më vonë deri te esenca. Kjo bëhet për ta tërhequr lexuesin në brendi të lajmit.

Ky parim lidhet me tekstin letrar dhe është si reagim ndaj rolit të kreut të lajmit dhe ndaj parimit të piramidës së përmbysur. Nëse gazetari gjen një fjali figurative, anekdotike, apo një fjalë të urtë që i përgjigjet mirë temës së lajmit dhe e vë atë në krye të lajmit, efekti do të jetë pozitiv për lexuesin.

Ja një strukturë ndryshe e lajmit, sipas parimit të hyrjes së vonuar:

#### **E vrau për tradhti**

Nexhmije Ahmeti

[nexhmije.ahmeti@gazetaexpress.com](mailto:nexhmije.ahmeti@gazetaexpress.com)

Petrovë, Shtime, 5 nëntor. – Për 27 vjet e ndanë shtratin bashkë. Krijuan familje dhe gjithçka po iu shkonte për mrekulli. Puna prej ruajtësit të rendit publik i kishte krijuar shumë benefite Bajrushit nga Petrova e Shtimës. Por, gjithçka që kishte bërë për 47 vjet Bajrush Rexhaj, u shua mbrëmjen e së dielës.

Bashkëshortja Lejla Rexhaj ia mori jetën. Dhe atë me armën e tij zyrtare. Krejt kjo besohet se ndodhi pasi që Lejla kishte mësuar se burri po e tradhtonte me një femër tjetër, edhe ajo pjesëtare e Policisë. Nga gjuajtja me dy plumba Bajrushit nuk arriti t'i përballojë plagët e marra dhe vdiq rrugës për spital. Në përpjekje për të ndalur konfliktin mes nënës dhe babait është plagosur lehtë edhe Valon Rexhaj, 26 vjeçar, djali i madh i këtij çifti. Lejla Rexhaj është arrestuar nga policia dhe po mbahet në paraburgim, ndërkaq Bajrush Rexhaj u varros të hënën pasdite në fshatin e tij të lindjes. Në familjen Rexhaj nuk flasin shumë për atë që ka ndodhur vetëm një natë më parë.

Vëllai i policit të vrarë, Agushi tregon për Express se nuk di ndonjë detaj pse vëllai i tij u vra nga gruaja. Ai nuk sqaron asgjë më shumë prej asaj çka ka parë pasi që ka ndodhur akti i vrasjes. Pasi që ka jetuar ndaras me të vëllanë, Agushi thotë të jetë lajmëruar nga nipi Valoni për ngjarjen. "Më ka thirr në telefon dhe më thënë 'hajde shpejt se baba është plagos', tregon Agushi. Kur kishte shkuar në shtëpinë e vëllait, kishte gjetur Bajrushin e plagosur e po ashtu edhe Valonin që i rridhte gjak nga dora. Po ashtu ai në kuzhinë e kishte parë edhe kumatën e tij Lejlën, por që nuk ka ndërruar asnjë fjalë (...)

*Express, E martë, 6 nëntor 2012*

Hyrja e vonuar nuk mund të përdoret suksesshëm në lajmet që sjellin të reja me rëndësi të madhe. Të shohim një lajm me hyrje të drejtpërdrejtë, i cili flet për ngjarje të rëndësishme të madhe se a mund të përdoret në të hyrja e vonuar:

Hyrja e drejtpërdrejtë:

### Shkupi dhe Prishtina vendosin marrëdhënie diplomatike

#### Ministria e Jashtme e Maqedonisë ka bërë të ditur se Shkupi dhe Prishtina kanë vendosur marrëdhënie diplomatike.

Në një komunikatë për shtyp thuhet se dokumenti është firmosur mbrëmë vonë.

Vendosja e marrëdhënies diplomatike erdhi pasi parlamentet e dy vendeve ratifikuan një marrëveshje për shënimin e vijës të ndërsjellë kufitare.

Ndërkohë që parlamenti i Maqedonisë votonte për marrëveshjen për shënimin e kufirit, duket se janë zhvilluar edhe procedurat për vendosjen e marrëdhënies diplomatike mes Kosovës dhe Maqedonisë.

Në një komunikatë për shtyp, Ministria e Jashtme e Maqedonisë thotë se të shtunën vonë, Ministrat e jashtëm të dy vendeve, Antonio Milloshovski në Shkup dhe më pas Skënder Hyseni në Prishtinë kanë firmosur dokumentin që shënon vendosjen e marrëdhënies diplomatike. Në komunikatë thuhet se dy vendet do të angazhohen për përfortimin e lidhjeve miqësore, mbi bazën e respektimit të sovranitetit kombëtar, pavarësisë dhe integritetit territorial.

Hapat për lidhje diplomatike mes Prishtinës dhe Shkupit, vinë pasi dy parlamentet ratifikuan marrëveshjen për shënimin e vijës kufitare. Ligjvënësi në Maqedoni, u përfshi në debate të forta mes maxhorancës dhe opozitës, ku kjo e fundit akuzoi se me marrëveshjen për kufirin Maqedonia i kishte dhënë territore Kosovës.

Ajo paralajmëroi se do të nisë procedurë në Gjykatën Kushtetuese. Por qeveria i hodhi poshtë akuzat e opozitës.<sup>23</sup>

Në më pak se katër kilometra, Joseph L. Jody III kapërcëu tre shenja STOP, ndërroi korsënë, kaloi një semafor të kuq dhe ia shkeli me 100 km në orë, në një zonë 50 kilometrash. Dy ditë më vonë ai ishte përsëri në rrugë, pa patentë. Kësaj radhe ai nuk u ndal përpara tabelës STOP dhe vazhdoi me 120 km në një zonë 60 kilometërshe. Për 16 shkelje të rregullave-13 të parat të shkelura në 20 shtator 1982- Jody-t i vunë 1.795 dollarë gjobë. Gjopa s'u pagua kurrë. Policia thotë se ka ikur në Houston. Afro 30.000 deri në 40.000 gjopa janë të pa paguara ende në stacionin e policisë, por kjo e Jody-t është më e madhja. Megjithatë, borxhi i Jody-t është fare i vogël përpara borxhit të përgjithshëm prej 500.000 dollarësh që i kanë bashkisë ata që shkelin rregullat e qarkullimit rrugor. Në shkurt kryetari i Bashkisë Jonathan Rogers ka filluar një fushatë për të tërhequr sa më shumë nga gjobat e pa paguara që atëherë shkonin deri në 828.000 dollarë. Në mes të marsit ai kishte mundur të mblihte vetëm 368.465 dollarë.

*Melvin Mencher, Raportimi dhe shkrimi i lajmeve, fq. 134.*

A mundet të fillojë ky lajme me një hyrje të vonuar, si:

*Ndërkohë që parlamenti i Maqedonisë votonte për marrëveshjen për shënimin e kufirit, duket se janë zhvilluar edhe procedurat për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike mes Kosovës dhe Maqedonisë.*

*Në një komunikatë për shtyp, Ministria e Jashtme e Maqedonisë thotë se të shtunën vonë, Ministrat e jashtëm të dy vendeve, Antonio Milloshovski në Shkup dhe më pas Skënder Hyseni në Prishtinë kanë firmosur dokumentin që shënon vendosjen e marrëdhënieve diplomatike.*

Natyrisht që jo, sepse ngjarja e rëndësisë së veçantë duhet të dëgjohet menjëherë. Marrësi pret lajmin dhe jo figurat letrare.

### V.3.5. MATERIALI QË SHPJEGON KREUN

Pjesa e dytë në strukturën e lajmit është materiali (informacioni, teksti, paragrafi) që shpjegon kreun e lajmit. Mund të jenë dy apo tre paragrafë që përmbushin kuptimin e plotë të informacionit që është dhënë në krye. Në një farë mënyre kjo pjesë e lajmit është vazhdimësi e kreut, vetëm se pa tensionet, pa unitetin e pa fuqinë goditëse të kreut. Nëse në krye është thënë se personi X është takuar me personin Y, në materialin shpjegues ju duhet të tregoni se ku është mbajtur takimi, kur është mbajtur, çka është biseduar në takim, kush kanë qenë të pranishëm, a kanë bërë ndonjë deklaratë pas takimit personat në fjalë dhe gjëra të lidhura drejtpërdrejt me takimin. Do të thotë, materiali shpjegues ka të bëjë me detajet e informacionit të dhënë në krye. Atë që thuhet në krye ju duhet ta sqaroni në dy-tre paragrafë të tjerë. Ja shembulli i lajmit të mësipërm:



#### **Korrupsioni la Bullgarinë pa fonde të BE-së**

Bruksel, 25 Nëntor (ROUTERS). Anëtarja e re e Bashkimit Evropian, Bullgaria, të martën i ka humbur 220 milion euro nga fondet e Bashkimit Evropian, pasi që nuk ka luftuar korrupsionin.

Është kjo hera e parë që ekzekutivi i BE-së lë një shtet anëtar pa fonde në këtë mënyrë. Bashkimi Evropian e ka nxitur Bullgarinë-e cilësuar këtë vit nga organizata "Transparency International" si shteti më i korruptuar i BE-së-që të ndërmarrë masa urgjente, apo në të kundërtën do të humbë edhe shumë miliona euro në të ardhmen.

### V.3.6. SFONDI I LAJMIT (PRAPAVIJA, BACKGROUND)

Lajmi është maja e ajsbergut. Nën atë që duket në lajm ka një mori faktesh të tjera objektive që kanë sjellë deri te ai lajm, po që nuk janë të dorës së parë për të, ose nuk duken. Ato fakte dhe ai material paraqesin prapavijën (sfondin, "background"-in) e lajmit. Nëse takimi i X me Y paraqet lajm, marrësi duhet ta kuptojë shumë qartë se takimi është i natyrës shoqërore, politike, profesionale, biznesi, kriminaliteti etj., si dhe ku ndërlidhet ky takim me interesin e shoqërisë.

Ja një lajm me sfond të gjerë:



#### **Ekspozitë për Galileon në Vatikan**

##### **Një ekspozitë e re që shënon 400 vjetorin e punës së Galileo Galileit hapet të enjten në Vatikan.**

Kisha Katolike e denoncoi si heretik shkencëtarin kur Galileo deklaroi se Toka rrotullohet rreth Diellit Galileo vlerësohet babai i astronomisë.

Megjithëse një shkencëtar më i hershëm, Koperniku bëri zbulimet kryesore në punën për gjetjen e lidhjes mes Tokës dhe Diellit, Galileo ishte më i përgatitur për të provuar këtë lidhje. Në vitin 1633 Kisha Katolike e cilësoi atë si heretik.

Ai u gjykua se kishte sfiduar teorinë që shumë besonin asokohe se Dielli rrotullohej rreth Tokës.

Galileo tha se kishte prova se Toka rrotullohej rreth Diellit.

Në vitin 1992, Papa Gjon Pali i dytë deklaroi se Kisha kishte marrë një vendim të gabuar për këtë rast dhe se katolikët nuk ishin armiq të shkencës.

Një përzgjedhje e veglave të Galileos janë ekspozuar në Vatikan. Atje do të ketë edhe disa dokumente origjinale ku ai me shumë entuziazëm shkroi zbulimet e tij të para.

Ekspozita do të jetë e hapur deri në muajin janar.<sup>24</sup>

I gjithë ky lajm në fakt është një sfond i gjerë. Lajmi është vetëm kreu.

Sfondi i lajmit mund të përmbajë edhe më shumë sesa thuhet aty. Këtu është e rëndësishme të kihet parasysh se sfondi nuk është pjesa më e rëndësishme e lajmit, prandaj nuk duhet futur sa më shumë informacione, sepse kjo e prish homogjenitetin e strukturës së lajmit. Prapavija e lajmit nuk thuhet e tëra në lajm, por marrësi duhet ta kuptojë atë, aq sa për ta kuptuar thelbin e lajmit të kreu.





### V.3.7. MATERIALE TË DORËS SË DYTË, OSE MË PAK TË RËNDËSISHME

Këto janë materiale që shkojnë në fund të lajmit. Është pjesa më e pa rëndësishme e lajmit. Prandaj, kjo pjesë shkruhet vetëm nëse gazetari ka mbledhur informacione që ia vlen të shkruhen, sepse ose e përmbushin kuptimin e prapavijës së lajmit, ose paralajmërojnë zhvillime të reja në lidhje me temën e lajmit. Në strukturën e lajmit kjo pjesë nuk luan ndonjë rol të rëndësishëm, prandaj edhe redaktorët sa herë e shkurtojnë lajmin, fillojnë nga kjo pjesë. Nëse nga takimi i X me Y ka një histori dhe priten zhvillime të reja, atëherë kjo duhet të thuhet në këtë pjesë të lajmit. Por, mjeshtrit e mirë të gazetarisë mundën që mu në këtë pjesë, qoftë edhe me vetëm një gjysminformacion, ta lënë të hapur në mendjen e marrësit një dritare dyshimi për zhvillimet e ardhshme. Ta shohim fundin e lajmit të mësipërm për dekretimin e kryeministrit Sali Berisha:

[Berisha pritet të përfundojë qeverinë vetëm brenda dy ditëve, ndërkohe që nga kjo përbërje, padyshim pritet që të shfaqen edhe pakënaqësi, të cilat Kryeministri Berisha do t'i justifikojë me faktin se nuk ka vend për të gjithë.](#)

Nëse këtë lajm ia dërgoni redaktorit dhe ai ju kërkon që ta shkurtoni lajmin, nga do t'ia filloni?

Nga kreu? Nga mesi? Nga fundi?

Apo të gjitha fjalitë do t'i shkurtoni nga pak?

## Titulli i lajmit

### Nëntitulli (nëse ka)

Kreu Kreu Kreu Kreu Kreu Kreu Kreu Kreu Kreu Kreu Kreu Kreu Kreu Kreu

Materiali që e shpjegon kreun Materiali që e shpjegon kreun Materiali që e shpjegon kreun Materiali që e shpjegon kreun Materiali që e shpjegon kreun Materiali që e shpjegon kreun Materiali që e shpjegon kreun

Sfondi Sfondi Sfondi Sfondi Sfondi Sfondi Sfondi Sfondi Sfondi Sfondi Sfondi Sfondi Sfondi Sfondi Sfondi Sfondi Sfondi Sfondi Sfondi Sfondi

Materiali i dytë që e shpjegon kreun Materiali i dytë që e shpjegon kreun Materiali i dytë që e shpjegon kreun Materiali i dytë që e shpjegon kreun Materiali i dytë që e shpjegon kreun

Nënvizimi i fjalëve nuk është i gazetarit, por yni. Në këto fjalë sinjalizohet një problem i mundshëm shumë i madh: pakënaqësitë e ministrave të vjetër të qeverisë nga radhët e Partisë Demokratike, të cilët duhet të mbesin jashtë qeverisë, për t'ua lëshuar vendin ministrave të ri të Lëvizjes Socialiste për Integrim. Gazetari vetëm sinjalizon dhe anticipon zhvillime në të ardhmen dhe kjo e përmbyll plotësisht interesin e marrësit ndaj kreut të lajmit dhe ndaj sfondit të tij. Ky përfundim i lajmit është një lloj sfondi, vetëm në të ardhmen e jo në të shkuarën.

Supozoni që katërkëndëshi i mëposhtëm është fleta A4 në të cilën ju shkruani lajmin. Ndajeni hapësirën e faqes si më poshtë për të pasur një lajm të strukturuar mirë:

## V.4. ELEMENTE TË TJERA STRUKTURE TË LAJMIT

### V.4.1. VENDI DHE KOHA

Secili lajm ka një vend të caktuar për ku flet, ka një kohë të caktuar për kur flet dhe ka faktin objektiv për të cilin flet. Kjo e fundit është përmbajtja dhe shtjellohet në tekst të lajmit (tema e lajmit), ndërsa dy të parat jepen si të dhëna në fillim të lajmit:

Prishtinë (Kosovë). *Sot në mëngjes...*

Paris (Francë), 17 Dhjetor 2005. *Mbrëmë vonë në Paris...*

Disa gazeta nuk e praktikojnë këtë tekst, duke u nisur nga fakti se lajmi është gjithnjë i ri, pra botohet brenda ditës, prandaj nuk ka nevojë t'i shkruhet vendi dhe koha. Ky tekst nuk është pjesë integrale e lajmit (pra, lajmi bën edhe pa të), prandaj mund ta quajmë **paratekst**. Gazetat dhe agjencitë e lajmeve të fuqishme ndërkombëtare e praktikojnë këtë paratekst.

### V.4.2. CITATI DHE VENDI I TIJ NË STRUKTURËN E TEKSTIT LAJMOR

**Citimi.** Deri ssa lajmi ka të bëjë me njerëz të tjerë (pra, jo me vetë gazetarin), atëherë citimet në lajm janë burime të dorës së parë dhe një teknikë e rëndësishme shkrimi. Citimi nuk është tregim i gazetarit, apo mesazh i gazetarit për marrësin, por është tregim i vet aktorëve apo i dëshmitarëve të lajmit, është mesazh i drejtpërdrejtë, pa ndërmjetës. Si i tillë, ai është më i besueshëm se çdo tregim i gazetarit. Citimi në lajm është i natyrës së veçantë: aty mund të citohen vetëm aktorët e lajmit apo edhe deklaratat e personit përgjegjës zyrtar dhe dëshmitarëve të rastit. Nëse takimi i X me Y paraqet lajm, mund të citohen vetëm deklaratat e njërit apo të dyve. Por nëse lajmi trajton një aksident apo një krim, mund të citohet edhe deklaratat e oficerit policor, e gjykatësit hetues apo e dëshmitarëve të rastit.

Citimi bëhet në dy forma:

- citim i drejtpërdrejtë (ligjërata e drejtë; Ai tha: "Sot ne bëmë një punë të madhe...")
- citim i përfolur (ligjërata e zhdrejtë; ai tha se do të...).

- citim i drejtpërdrejtë = ligjërata e drejtë (Ai tha: "Sot ne bëmë një punë të madhe");

- citim i përfolur = ligjërata e zhdrejtë (Ai tha se sot ne kemi bërë një punë të madhe...).

Shembull i citimit të drejtpërdrejtë:

“Nëse nuk mund të besojmë në vlera të tilla, çfarë jemi ne atëherë? Nuk kam pasur mundësi të bëja asgjë tjetër, pasi që në të kundërtën nuk do të mund të flija i qetë”, ka thënë Ahtisaari.

Shembull i citimit të përfolur:

Trajneri Kuzhe është shprehur se kërkon një rezultat pozitiv kundër Danimarkës.

Nga aspekti i praktikës gazetare citimi i drejtpërdrejtë është më pak tërheqës, por më besnik, ndërsa citimi i përfolur mund të jetë më tërheqës (sepse mendimin e dikujt e riformulon me fjalë të zgjedhura gazetari), por mund të krijojë probleme me besueshmërinë. Kështu, Koha ditore boton raportin “Tërnavë: udhëheqësit kosovarë me mbetje ateiste-komuniste”, ndaj të cilit, pas tri ditëve, reagon Bashkësia Islame e Kosovës me artikullin me titull “Myftiu nuk ka përmendur ‘udhëheqësit kosovarë’ e as strukturat politike që drejtojnë vendin”. Ndërsa redaksia ka bërë sqarimin ndaj reagimit me titull “Për kë e kishte fjalën myftiu, nëse jo për udhëheqësit kosovarë?” Si shihet nga reagimi i redaksisë, gazetari ka supozuar se z. Tërnavë ka folur për një grup të caktuar politikanësh. Por, gazetari nuk mund të supozojë në raportim. Prandaj citimi i drejtpërdrejtë krijon besueshmëri më të madhe se ai i përfolur.

Në aspektin strukturor citati mund të vendoset në cilëndo pjesë të lajmit, por ka disa rregulla se ku mund të jetë dhe ku jo i pranishëm. Në titull të lajmit është e parapëlqyer të mos ketë citate, përveç në raste të rralla: atëherë kur citati e thotë saktësisht dhe përmbledhtas informatën kryesore të lajmit - edhe mund të vendoset në titull, por kjo ndodh zakonisht tepër rrallë. Në shumicën e rasteve një citat nuk e përmbledh gjithë informatën, prandaj edhe nuk do të ishte titull i mirë ai që përmban atë citat. Edhe te kreu i lajmit nuk është e parapëlqyer të ketë citate, për të njëjtat arsye që përmendëm më sipër. Ndërsa në elementët e tjerë strukturorë mund të ketë citate, poeunde ata janë të nevojshëm dhe të domosdoshëm sepse argumentojnë drejtpërdrejt ngjarjet për të cilat flet lajmi dhe shtojnë besueshmërinë e lajmit.

### V.4.3. KOMENTET NË LAJM

Në lajm dhe në raport gazetari nuk shfaq mendimet, bindjet, supozimet apo komentet e tij. Në një artikull analitik (analizë, koment, kolumnë, editorial etj.) është e natyrës së tij që gazetari ta shfaqë edhe komentimin e tij. Por, në lajm e në raport detyra e gazetarit

është t'ia sjellë marrësit një informacion si dhe shkaqet e rrethanat e ndodhjes së tij dhe asgjë më shumë.

Edhe midis lajmit e raportit duhet bërë një dallim: në raport mund të lejohet një komentim i gazetarit, ndërsa në lajm jo. Ky është një parim në gazetari por, si çdo parim, praktika është më ndryshe. Edhe në lajm e në raport ka komente të gazetarit. David Randall dallon tre lloje të komenteve, të cilët do t'i përflasin shkurt.

**Komenti i hapur** është atëherë kur gazetari shfaq hapur komentin dhe opinionin e tij për ndonjë çështje të lajmit a raportit. Në shumë vende kjo praktikë është e ndaluar. Në ShBA dhe Britani të Madhe ai merret si një gabim i madh. Por, ka përjashtime, thotë Randall: "Një reporter me përvojë që mbulon një subjekt të ndjekur prej kohësh, duhet të lejohet që me gjykimin e tij të ndriçojë ngjarjen e, si rrjedhim, lexuesin. Të njëjtën liri duhet ta gëzojnë edhe specialistët ose korrespondentët e jashtëm që e bëjnë këtë punë prej një kohe të gjatë. Komenti i tyre nuk duhet të shfaqet në formën e opinionit me tamtame, si 'Po mirë, ai mund ta thotë këtë, por unë mendoj se...', por të kalojë anash, si vërejtje e lehtë e me bërryl, që jep kontekstin e ngjarjes ose të aspekteve të saj. Dhe, para së gjithash, të jetë *i dallueshëm*".<sup>26</sup>

Nga të gjitha komentet në lajm, më i keqi është ai pa paramendim.  
David Randall

**Komenti i maskuar** është koment i fshehur i gazetarit. Gazetari mëton ta ndikojë lexuesin me komentin e tij për subjektin e lajmit, por këtë e bën nën maskë. Bëhet kishe vetëm po informon e, në fakt, ai gjykon ndonjë aspekt të subjektit të lajmit. Nëse gazetari thotë: ai pranoi, ai u rrëfye (në vend të foljes ai tregoi), atëherë gazetari është duke bërë komente të qëllimshme, por të maskuara. Përshkrimi i masave të një qeverie kundër demonstruesve mund të jetë:

- gjueti shtrigash, dhunë e tmerrshme, sjellje barbare e policisë, kryqëzatë, dorë e hekurt e qeverisë etj.; ose
- masa të domosdoshme për mbrojtjen e rendit e të qetësisë publike.

Në të dy rastet ka një koment të maskuar. Se a janë të domosdoshme apo barbare sjelljet e policisë, lëreni marrësin të gjykojë vetë. Këtu e keqja më e madhe është fakti se koment i është i fshehur, i maskuar dhe, si i tillë, dy herë i gabueshëm.

**Komenti pa paramendim** është koment jo i qëllimshëm. Përshkrimi i koncepteve politike të dikujt (ai ka koncepte radikale, është i moderuar, është reformator etj.) është një lloj koment por që bëhet pa paramendim. Lajmet që fillojnë me fjali si "ekziston frika se...", ose "ka shpresa që..." janë komente pa paramendim, i cili është po ashtu i gabueshëm, sepse nuk bëhet me qëllim dhe mbetet i fshehur, pavarësisht nga mos-paramendimi i gazetarit.



## VI. NËNLOJE TË LAJMIT

### VI.1. FLESH LAJMI

**N**ë gazetarinë bashkëkohore është krijuar edhe një nënloj i lajmit i cili zakonisht quhet fleshlajm, ose vetëm flesh (nga anglishtja: *flash* - shkëndijë, xixë, strall). Fleshlajmi është më i shkurtër se lajmi, duke dhënë vetëm informacionin kryesor dhe duke shpjeguar kreun e lajmit, pra duke u përgjigjur shkurt në pyetjet: kush? kur? ku? Pra, fleshlajmi ka vetëm kreun e lajmit, ndoshta edhe një fjali shpjeguese për kreun, por pa dhënë materiale të tjera që shpjegojnë kreun.

Fleshlajmi është origjinalisht lajm i radios, i televizionit dhe, së fundit, edhe i internetit. Vetë emri i tij lidhet me teknologjinë e maskomunikimit, me aparatën fotografik. Kuptimi origjinal i fleshit si tekst gazetar është ndërlidhur me radion dhe televizionin: fleshlajm ka qenë lajm i shkurtër i cili është transmetuar aty për aty, duke u dhënë vetëm informacionin kryesor. Emisionet e radios apo të televizionit janë ndërprerë në orë të caktuar për të transmetuar fleshlajmet dhe pastaj për të vazhduar përsëri me emisionin e rregullt.

Nga gazetaria audio-vizuale fleshlajmi ka hyrë edhe në gazetarinë e shtypur. Është i përshtatshëm vetëm për gazeta ditore e jo për të tjera. Botohet zakonisht në bashkësi, dmth. disa lajme flesh botohen së bashku në një rubrikë, të kufizuar nga pjesa tjetër e faqes, vertikalisht, me mbititull *Flesh*, ose *Shkurt*. Kështu, gazeta Zëri e 25 qershorit 2010 boton në një kolonë tre fleshlajme: *Arrestohet instruktori, Kosovari me euro false, Plagosje me thika*, në të njëjtën faqe, në kolonën tjetër, edhe tre fleshlajme të tjera: *Suspendohen katër zyrtarë policorë, Dy aksidente, nëntë të lënduar, Pa hollësi për vrasjet në Viti*. Si shihet, të gjitha janë lajme me një apo dy informata, ose pjesë të ndërlidhura me lajme të mëhershme.

Ajo që e dallon fleshlajmin nga lajmi është mungesa e sfondit dhe materialit të dytë shpjegues në strukturën e tij. Zakonisht, fleshlajmi jep vetëm kreun dhe materialin që shpjegon kreun. Bile, në versionet audio-vizuale dhe në ato të internetit mjaftohet edhe vetëm me një krye të zgjeruar.

### PËRMBAJTJA

VI. Nënloje të lajmit . . . . .	135
VI.1. Fleshlajmi . . . . .	135
VI.2. Antërfajlli . . . . .	137
VI.3. Fotolajmi . . . . .	141
VI.4. Lajmi protokollar . . . . .	142
VI.5. Lajmi i titruar . . . . .	145



Ja një fletshajm:



### Zbulohen substanca narkotike në Vërmicë

Prizren, 2 shtator

Sot, në orën 8 e 10, në pikën kufitare të Vërmicës ekipi i specializuar i Doganës së Kosovës ka selektuar për kontrollë detale automjetin e tipit "Citroen HDZ", me ngjyrë hiri metalike, me tabela të Kosovës, të cilin e drejtonte një shtetas kosovar nga Gjilani.

Gjatë kontrollimit detal në mbështetësit e ulëseve të para policia ka gjetur gjashtë paketime me substancë narkotike, pohon zëdhënësi i doganave të Kosovës, Adriatik Stavileci. Pas kontrollimit janë zbuluar edhe dy paketime të tjera në gomën rezerve të automjetit. Sasia ende nuk është verifikuar dhe atë do ta bëjë policia. Vozitësi është prangosur nga policia kufitare e Vërmicës, kurse rasti do të kalojë në hetime të tjera të policisë.

Zëdhënësi Stavileci pohon se kjo pikë e doganës, si dhe të tjerat në Kosovë, janë mjaft aktive dhe kjo ka bërë që të zbrësë kontrabanda.<sup>27</sup>

Variant i redaktuar:

<p><b>Zbulohen substanca narkotike në Vërmicë</b></p> <p>Prizren, 2 shtator</p> <p>Sot policia kufitare ka gjetur tetë paketime me substanca narkotike, tha zëdhënësi i doganave të Kosovës, Adriatik Stavileci.</p>	<p>Kreu</p>
<p>Ngjarja ka ndodhur në orën 8 e 10, në pikën kufitare të Vërmicës, gjatë kontrollimit të automjetit të tipit "Citroen HDZ", me ngjyrë hiri metalike, me tabela të Kosovës, të cilin e drejtonte një shtetas kosovar nga Gjilani. Ekipi i specializuar i Doganës së Kosovës ka selektuar për kontroll detal automjetin në fjalë dhe aty ka gjetur tetë paketime me substancë narkotike. Gjashtë prej tyre ishin të fshehura në mbështetësit e ulëseve të para, ndërsa dy të tjera në gomën rezerve.</p>	<p>Materiali që shpjegon kreun</p>
<p>Vozitësi është prangosur nga policia kufitare e Vërmicës, kurse rasti do të kalojë në hetime të tjera të policisë.</p>	<p>Pjesë e përbashkët e kreut</p>

Pra, fletshajmi ka vetëm kreun dhe materialin që e shpjegon kreun. Edhe në strukturën tematike ai nuk mund të ketë dy tema. Gjithmonë ka vetëm një temë. Fletshajmi në radio, në televizion dhe në formën digjitale është edhe më i shkurtër. Disa gazeta e praktikojnë që ato fletshajme të shkurtra t'i publikojnë në faqet e tyre:



### Arrestohen për armë

Prishtinë, 2 shkurt. Raportohet se janë arrestuar dy meshkuj, pasi që gjatë një kontrole në veturën e tyre është gjetur dhe konfiskuar një armë automatike AK-47, kal. 7.62 mm, një karikator me 20 fishekë të kal. 7.62 mm dhe një kapekë e zezë me dy vrima për sy.

Të dyshuarit, pas intervistës, me vendim të prokurorit, dërgohen në mbajtje.<sup>28</sup>

- Duke e transmetuar lajmin shpejt, gabimet janë thuajse të paevitueshme, veçanërisht kur gazetari është i papërvojë, si në rastin e shembullit të mësipërm, i cili ka një varg gabimesh:
- dy meshkuj nuk është kurrfarë përcaktimi i informacionit;
- nuk thuhet as vendi e as koha kur ndodh ngjarja;
- jepen detaje, poende përsëriten dy herë, si kalibri i armës dhe fishekëve;
- prokurori nuk sjell vendim për arrestim, por gjykatësi hetues;
- nuk ekziston nocioni “mbajtje” në terminologjinë juridike.

## VI.2. ANTËRFJALLI

Një nënloj tjetër i lajmit është antërfajlli. Ai është një lajm më vete, por i ndërlidhur me një tekst më të gjerë gazetar, brenda të cilit rri. Teksti më i gjerë ku qëndron antërfajlli mund të jetë raport, analizë, reportazh, dosje, kronikë etj., po më rrallë mund të jetë lajm. Karakteristika e tij themelore është fakti se ai bashkëjeton me një tekst më të gjerë. Pa një tekst bazik e më të gjerë, ai s’do të kishte kuptim. Pra, nuk ka antërfajll të pavarur tërësisht dhe, në rastet kur ndonjë antërfajll mund të qëndrojë i pavarur, ai është lajm e jo antërfajll. Si rrjedhojë, antërfajlli praktikohet vetëm në gazetarinë e shtypur, por jo edhe në radio apo në televizion.

Pyetja themelore, e cila e përcakton esencën e antërfajllit, është se në çfarë marrëdhënie të lidhjes rri antërfajlli me tekstin ku bashkekziston? Shkalla e varshmërisë së antërfajllit prej tekstit të gjerë gazetar krijon tri forma të tij:

1. në disa raste antërfajlli është i lidhur drejtpërdrejt me temën e tekstit ku qëndron, rrjedhimisht ai nuk mund të qëndrojë assesi më vete (i shkëputur nga teksti i gjerë gazetar);
2. në disa raste antërfajlli është i lidhur tërthorazi me temën e tekstit ku qëndron dhe mund të shkëputet e të qëndrojë më vete, por në atë rast informacioni që ai sjell humbet diçka nga peshja dhe rëndësia e tij dhe si i shkëputur ai tekst pushon së qeni antërfajll.



3. Në disa raste redaktorët bashkojnë në një tërësi të tekstit gazetar, si lajm, intervistë të shkurtër, fotolajm etj., duke i vënë ata në varshmëri nga një tekst më i gjerë (mund të jetë një raport i gjerë). Në këtë rast vetëm formalisht këto tekste janë antërfajlla dhe ata, edhe po të shkëputen nga teksti bazik, mund të bëjnë jetë të pavarur.

Antërfajlli trajton një detaj a një ide të tekstit gazetar ku qëndron, apo një derivat të temës së tekstit, apo një paraide të tekstit gazetar; ai mund të krijojë një imazh për temat e tekstit ku rri, të paraqesë një skenë dytësore apo të krijojë idenë se si përjetohet ajo që po ndodh. Në të gjitha rastet, antërfajlli është në shërbim të tekstit më të gjerë gazetar dhe, kjo është karakteristika e tij e dytë themelore.

Lidhja e antërfajllit me tekstin gazetar ku qëndron bëhet në dy mënyra:

- në botim ai ndahet fizikisht nga tërësia e tekstit ku rri me një vijë rrethuese apo me një ngjyrë. Në praktikën gazetare zakonisht quhet boks (nga anglishtja *box-kuti*);
- por lidhja kryesore është ajo tematike. Antërfajlli trajton një detaj të temës së llojit gazetar ku rri, ose mund të trajtojë edhe një temë që nuk ka një lidhje të drejtpërdrejtë me temën e tekstit ku rri, por në një mënyrë ajo duhet të lidhet me temën e tekstit ku rri. Kjo lidhje e tij me tekstin e gjerë duhet të jetë një lidhmëni logjike apo lidhshmëri shkakësore. Nëse tema e antërfajllit nuk lidhet me temën e tekstit ku rri, ai nuk është antërfajll.

Në artikullin e mëposhtëm "Si kaloi nata e parë pas kiametit", që rrëfen për pasojat e tërmetit që goditi në fillim të shtatorit 2009 zonën e Dibrës, ka disa antërfajlla. I pari, "Zhdukja e kryqit të kuq" është lajm më vete, por që ndërlidhet drejtpërdrejt me artikullin.



### Zhdukja e kryqit të kuq

Kryqi i Kuq Shqiptar, një organizatë humanitare që ndihmohej drejtpërdrejt me fonde edhe nga shteti, ka qenë krejtësisht inaktiv në zonën e dëmtuar nga tërmeti i së dielës. Organizata në fjalë, pjesë e rrjetit botëror më të njohur në veprimtaritë humanitare, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim, qoftë edhe verifikues këto ditë, ndërkohë që synimi kryesor i ekzistencës së kësaj strukture është dhënie e ndihmës për njerëzit në nevojë.

Kryqi i Kuq Shqiptar, në ndryshim nga shumë organizata homologe në botë, ndihmohet me ligj që të krijojë të ardhura për aktivitetin humanitar. Me një vendim të posaçëm të qeverisë, kjo organizatë gëzon të drejtën ekskluzive për organizimin e kursit të ndihmës së shpejtë për personat që duan të pajisen me leje drejtimi automjetesh.

Ky antërfajll nuk do të mund të qëndronte i shkëputur nga teksti ku bashkëjeton. Qëllimi i tij përmbajtjesor është i drejtuar tërësisht kah qëllimi përmbajtjesor i tekstit ku bashkëjeton dhe është tërësisht vetëm në shërbim të tij. I ngjashëm me këtë është edhe antërfajlli “Banorët: Tërmeti i së dielës, më i frikshëm se ai i ‘67-s”, i cili është tekst më vete, por që ndërlidhet dhe kushtëzohet nga teksti më i gjerë ku rri. Ndryshe është me antërfajllin “Dëmet e tërmetit, edhe në Zallë të Krujës”, në po të njëjtin tekst, e i cili është lajm më vete që korrespondon me tekstin, por mund të jetojë edhe krejt më vete.



### Dëmet e tërmetit edhe në Zallë të Krujës

Lëkundjet e tërmetit të fuqishëm që goditi pak minuta para mesnatës së të dielës Peshkopinë, janë ndjerë edhe në fshatin Zallë të Rrethit të Krujës. Dridhjet e forta të tokës kanë dëmtuar dhjetëra banesa të këtij fshati të vogël. Banesat kanë pësuar çarje dhe plasaritje nëpër mure, duke e bërë të rrezikshme jetesën brenda tyre. Banorët e këtij fshati thonë se janë rreth 12 banesa që kanë pësuar dëmtime serioze dhe se ndihen të rrezikuar nën çatitë e tyre.

Për më tepër ata ankohen se deri më tani askush nuk është interesuar për të parë gjendjen, si dhe për të vierësuar dëmet e shkaktuara. Banorët i kanë bërë apel shtetit që me anë të instancave përkatëse t'i ndihmojë për evidentimin dhe përballimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore. Tërmeti i fuqishëm u regjistrua pak minuta para mesnatës të datës 6 shtator, në juglindje të Peshkopisë. Lëkundjet që patën për epiqendër fshatin Gjoricë, u ndjenë të forta dhe në disa zona të tjera të vendit, madje dhe në disa treva në Maqedoni dhe Kosovë. Dëmet materiale kanë qenë të konsiderueshme dhe mjaft banorë të zonës së prekur kanë kaluar tre netët e fundit në qiell të hapur, nga frika e shembjes së banesave të tyre.

Ky antërfajll është lajm tipik. Ka kreun, materialet që ndërlidhen me kreun dhe një sfond të lehtë në paragrafin e fundit. Raporti (teksti i gjerë ku bashkëjetojnë këta antërfajlla) rrëfen për tërmetin, dëmet dhe përjetimet e njerëzve në Dibër, ku ishte epiqendra e tërmetit. Ndërsa antërfajlli i mësipërm njofton se dridhjet e tokës janë ndjerë edhe në Krujë. Filli që lidh këtë antërfajll me tekstin e gjerë është tema e tij: dridhja e tokës.

shqip PER ME SHPREH  
 9 SHKURTOR 2008 www.gazeta-shqip.com



“Zhdhaket”  
 Kryqi i Kuq  
 Kryqi i Kuq Shqipëri, një organizatë humanitare dhe sociale, ka qendër të punës në zonat kryesore të shqiptarëve të detyruar të largohen nga vendet e tyre. Organizata punon për të siguruar nevojat themelore të këtyre familjeve të shqiptarëve, të cilët kanë arritur të largohen nga vendet e tyre të shtetit të tyre dhe të vendosur në vende të tjera të shteteve të huaja. Organizata ka qendër të punës në Tiranë, në bashkëpunim me bashkëpunëtorët lokalë të shteteve të huaja. Organizata ka qendër të punës në Tiranë, në bashkëpunim me bashkëpunëtorët lokalë të shteteve të huaja. Organizata ka qendër të punës në Tiranë, në bashkëpunim me bashkëpunëtorët lokalë të shteteve të huaja.

# Si kaloi nata e parë pas “kiametit”

Në oborret e shtëpive të shkatërruara, ku fëmijë e pleq flenë nën qiell të hapur

**Dëmet e tërmetit, edhe në Zallë të Krujës**



Shkatërrimet e tërmetit të fuqishëm që goditi pak orë më parë zonën e Krujës, kanë shprehur dëmet edhe në Zallë të Krujës. Në këtë fshat, si dhe në tërësi të fshatit, dëmet janë të mëdha. Shkatërrimet janë të mëdha, si dhe në tërësi të fshatit, dëmet janë të mëdha.

Në ditën e ditës, dëmet janë të mëdha. Shkatërrimet janë të mëdha, si dhe në tërësi të fshatit, dëmet janë të mëdha. Shkatërrimet janë të mëdha, si dhe në tërësi të fshatit, dëmet janë të mëdha.



Historie e dy familjeve në fshatin Çeneç, të goditura nga dy tërmetet  
**Banorët: Tërmeti i së dielës, më i frikshëm se ai i ‘67-ës**

Në fshatin Çeneç, të goditura nga dy tërmetet, banorët tregojnë se tërmeti i së dielës është më i frikshëm se ai i vitit 1967. Banorët tregojnë se tërmeti i së dielës është më i frikshëm se ai i vitit 1967.



Familja Nusha, krahmbërës e Subotin, ka qendër të punës në Zallë të Krujës.

Shëmbull i antërfajllit në gazetën “Shqip”

Në gazetën e shtypura redaktorët praktikojnë një lojë box-i që nuk është antërfajll. Teksti i gazetës, aty ku redaktori shpreh një mendim të madhe, e veçon nga pjesa tjetër e tekstit me një vijë rrethuese, apo e shkruan me tip (font) tjetër të shkronjave, përmes stileve të tjera të shkronjave, përmes radhës ndryshe etj. Në këto raste vetëm është theksuar apo është ndryshuar në pamje teksti i gazetës po nuk kemi të bëjmë fare me lloj apo nënloj gazetës.

## VI.3. FOTOLAJMI

Në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX fotografia shfaqet në gazetari. Në vitin 1904 *Daily Illustrated Mirror* bëhet gazeta e parë britanike e cila e shfrytëzon fotografinë në vend të grafikës për ta ilustruar një artikull.<sup>29</sup> Në vitin 1910 del në Paris e përditshmja *Excelsior* në 12 faqe, 3 prej të cilave i kishte vetëm fotografi.<sup>30</sup> Kah mesi i shekullit XX fotografia merr një rol të rëndësishëm në gazetari. Në teorinë e gazetarisë sot përdoret nocioni foto-zhurnalizëm, me prirje për ta krijuar zhanrin gazetar ku fotografia mbizotëron tekstin.<sup>31</sup>



Shembull i të përditshmes "Daily Illustrated Mirror"

Fotolajmi është krijuar si lajm më vete. Ai është një lloj i ri i lajmit, i cili përbëhet detyrimisht prej dy elementeve: fotografisë dhe tekstit. Fotografia e mbizotëron tekstin dhe informacioni lajmor bartet përmes fotografisë e jo përmes tekstit. Këtu teksti është në shërbim të fotografisë e jo e kundërta, si ndodh me fotografinë në marrëdhënie me llojet e tjera gazetare. Në një lajm të zakonshëm, në një raport, analizë, reportazh etj. fotografia është në shërbim të tekstit dhe ilustron ndonjë informatë të tekstit. Në fotolajm është e kundërta: fotografia ka primatin, ndërsa teksti është në shërbim të saj.

Fotografia paraqet një ngjarje lajmore të rëndësishme për marrësin, ndërsa teksti nën fotografi i kalon caqet e diçiturës (tekstit nën fotografi), pra është një tekst më i gjerë i cili komenton fotografinë. Fotolajmi lidhet me të rejat e ditës dhe ka të njëjtin rol dhe efekt si kurse lajmi.



Autor i fotografisë: Xhemajll Sllavinja. Pamje nga salla e Kuvendit të Kosovës, 2015



Për dallim nga lajmi, fotolajmi ka më vete një element të fortë artistik. Vetë efekti i fotografisë i jep atë natyrë artistike: një fotolajm është i mirë nëse fotografia është e mirë, e realizuar mirë dhe nëse ka kapur çastin interesant të jetës. Elementi i dytë, po ashtu me aspekt arti, është kuptimi i bartur (figurativ) i diçiturs. Teksti përcjellës i fotografisë mund të thuhet edhe në kuptim figurativ dhe, bashkimi i këtij teksti figurativ me fotografinë me prirje artistike, krijon një imazh mbresëlënës të marrësi me efekte estetike. Ndoshta nga kjo strukturë e fotolajmit ky shumë mirë do të qëndronte edhe te gazetaria letrare, mirëpo për shkak të qëllimit të tij përmbajtjesor të lidhur me lajmin, rri këtu te gazetaria informative. Fotolajmi në gazetarinë moderne është një prej formave më të adhuruara gazetare. Ai është gjithnjë e më i pranishëm në gazeta të shtypura dhe është duke u përshtatur shumë mirë edhe me gazetarinë digjitale.



Photographer Yannis Behrakis, Location LESBOS, Greece, Reuters / Thursday, September 17, 2015

Një vendas ndihmon një refugjat sirian i cili ka kërcyer prej varkës përderisa noton i lodhur në bregun e ishullit grek të Lesbos-it, 17 shtator 2015.

## VI.4. LAJMI PROTOKOLLAR

Është lloj i lajmit, me formë dhe përmbajtje të klishezuar. Ai informon për një takim protokollar të prijësve të shtetit apo të institucioneve të tjera politike e jopolitike. Struktura tekstore e këtij lajmi dallon nga struktura e zakonshme e lajmit. Ky lajm ka tri elemente tekstore:

- titulli (përmbledh temën e lajmit);
- kreu (në kreun e lajmit protokollar zakonisht jepet vendi, koha dhe subjektet e takimit protokollar);
- paragrafi i dytë (këtu jepet një apo dy nga temat e bisedës së takimit).

Lajmi protokollar zakonisht përgatitet nga institucioni ku ka ndodhur takimi dhe, si i tillë, (me ndonjë përshtatje të vogël) botohet në gazetë, apo mund të shkruhet edhe prej gazetarit, por mbi një informatë zyrtare të institucionit ku është mbajtur takimi apo edhe me pjesëmarrjen e gazetarit në konferencë shtypi që është mbajtur pas atij takimi. Si variante të lajmit protokollar mund të quhen edhe: *informatë, deklarata zyrtare dhe kumtesa* e një institucioni shtetëror apo publik, por edhe e ndonjë individi. Ato dallojnë midis tyre për shkak të qëllimit përmbajtësor të secilës.

**Informata** është lajm protokollar i cili vetëm informon për një ngjarje, një takim apo për një fakt tjetër të rëndësishëm protokollar. Teksti i informatës është neutral në marrëdhënie me institucionin që e bën informatën. P.sh.: Ministria e Punëve të Jashtme bën një informatë për udhëtimin e ministrit në Nju Jork, për të marrë pjesë në mbledhjen e radhës së Këshillit të Sigurimit.

**Deklarata** është lajm protokollar e cila, duke informuar, qartëson një pikëpamje apo një qëndrim të institucionit i cili e bën deklaratën. Teksti i deklaratës ka një ton më personal, qoftë të institucionit apo të personit zyrtar që e bën atë. Ajo deklaron një fakt. P.sh.: MPJ bën një deklaratë për të qartësuar se edhe pse nuk dihet ende nëse edhe ministri kosovar do të flasë në KS të OKB-së, një gjë është e sigurt: nuk mund të diskutohet në KS të OKB-së për Kosovën për pa folur përfaqësuesi i Kosovës.

**Kumtesa** është lajm protokollar në të cilën, krahas informimit, paraqitet një qëndrim a pikëpamje përfundimtare e institucionit që bën kumtesën. Teksti i kumtesës ka një stil më administrativ. Ajo deklaron një qëndrim të prerë të institucionit apo të personit zyrtar. P.sh.: MPJ, pasi është konsultuar me kryeministrin dhe presidentin e vendit, sqaron pozicionin e vet: Kosova nuk do të jetë më shikuese e debatit për veten e vet në KS të OKB-së. Kosova duhet ta thotë fjalën e vet.

Ja një lajm protokollar:

Ministri Basha, takim me Sorecën dhe Lohan	Mbititulli Titulli
Ministri i Brendshëm, Lulzim Basha, priti dje në një takim Shefin e Njësisë për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Zgjerimin në Drejtorinë e Përgjithshme për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë të Komisionit Evropian, Luigi Soreca, të shoqëruar nga kreu i Delegacionit të Komisionit Evropian në Shqipëri, Helmut Lohan.	Kreu

<p>Në këtë takim, ministri Basha informoi zotin Soreca për ecurinë e përbushjes së kriterëve të përcaktuara nga Bashkimi Evropian për liberalizimin e vizave me Shqipërinë. Duke u ndalur te planet e veprimit për luftën kundër krimit të organizuar dhe menaxhimin e integruar të kufirit, ministri Basha bëri të ditur në këtë takim hapat e ndjekur për instalimin e plotë të sistemit të informacionit për kontrollin kufitar TIMS, për analizën e informacionit kriminal MEMEX, si dhe për kontrollin e kufirit detar.</p>	<p>Paragrafi i dytë: thekse nga takimi</p>
--	--

Kjo është struktura e zakonshme tekstore e një lajmi protokollar. Por, ka edhe modele të tjera:

<i>Meta me ambasadorët</i>	Mbititulli Titulli
<p><b>Mbështetet integrimi evropian i Shqipërisë</b></p> <p>Zv/kryeministri Ilir Meta zhvilloi dje takime me ambasadorët e Greqisë, Italisë dhe Austrisë në Tiranë. Temë e bisedës ishin marrëdhëniet shumë të mira mes vendeve si dhe integrimi evropian i Shqipërisë.</p>	<p>Kreu</p>
<p>Ambasadori Italian theksoi se Italia është avokate dhe promotore kryesore e Shqipërisë në strukturat e BE-së. Italia mbështet fuqishëm liberalizimin e vizave dhe integrimin e Shqipërisë në BE. Ndërsa Meta theksoi se Italia është partneri ynë kryesor strategjik.</p>	<p>Paragrafi i dytë: thekse nga takimi</p>
<p>Po dje, ministri i Jashtëm Meta ka pritur në zyrë edhe ambasadorin e Greqisë në Tiranë, Nikolas Pazios.</p>	<p>Kreu</p>
<p>Gjatë bisedës, të dyja palët konfirmuan vlerësimin se mes të dy vendeve tona ka një nivel të shkëlqyer të marrëdhënieve të bashkëpunimit në të gjitha fushat, dëshmi kjo e vullnetit politik mes të dyja qeverive dhe bazë solide për të vijuar në thellimin e tyre në të ardhmen.</p>	<p>Paragrafi i dytë: thekse nga takimi</p>
<p>Gjithashtu ministri i Jashtëm priti edhe ambasadorin e Austrisë në Tiranë, Florian Raunig.</p>	<p>Kreu</p>

Në lajmin e fundit ka tre krerë dhe dy paragrafë të dytë që japin thekse nga takimet. Në një lajm janë përmbledhur tri takime protokollare të të njëjtit person zyrtar, prandaj për secilin takim ka një krye dhe nga një paragraf të dytë që jep thekse nga takimet. Në rastin tonë, kreu i tretë nuk ka paragrafë të dytë, sigurisht për shkak të ngarkesës që i është bërë lajmit duke dhënë tri takime brenda një lajmi.

Ana e keqe e lajmit protokollar, qoftë ajo informatë, deklaratë apo kumtesë, është fakti se ai paraqet vetëm njëri anë të medaljes,

pra vetëm qëndrimin, opinionin apo pikëpamjen e njëres palë, asaj që e bën informatën, deklaratën apo kumtesën. Milazim Krasniqi e bën kështu këtë dallim:

*"Dallimi ndërmjet gazetarisë dhe komunikatave është se gazetaria duhet ta paraqesë ngjarjen nga të gjitha anët, ndërsa komunikata e paraqet vetëm nga njëra anë qëndrimin e palës që e publikon komunikatën".<sup>32</sup>*



Shembull i lajmit të titruar gjatë edicionit të lajmeve

## VI.5. LAJMI I TITRUAR

Nënloji më i ri i lajmit është lajmi i titruar. Ky është shpikje e shekullit XXI dhe është krijuar në mediet digjitale dhe është i përshtatshëm vetëm për to. Lajmi i titruar është lajmi më i shkurtër që ekziston dhe që jepet si tekst lëvizës digjital në mediet digjitale informative. Në televizion, në uebportale, në agjenci të ndryshme të lajmeve lajmet e titruara jepen pandërprerë në margjina të ekranit, apo në një kënd të veçantë, të shkruara si tekst digjital. Disa nga këto medie japin lajmet e titruara me tekst që lëviz në margjinën e poshtme apo të epërme të ekranit, nga e djathta në të majtë, përshtatur me syrin e njeriut që lexon.

Lajmi i titruar në aspektin strukturor përmban vetëm një fjali e cila përmban shumë shkurt informatën kryesore. Pra, ky është një lajm që përbëhet vetëm prej titullit ose vetëm prej kreut të lajmit. Disa nga televizionet i mbajnë për kohë më të gjatë në ekranet e tyre këto lajme, të tjerë i ndërrojnë sistematikisht, ndërsa të tjerë i lëvizin pa ndërprerë duke i përsëritur sistematikisht. Një gazetar apo redaktor rri gjithë kohën në kontrollim të tyre dhe shton lajme të reja, i plotëson të vjetrat etj. Kështu, lajmi i titruar: "Mubarak thotë



se nuk do të kandidojë në zgjedhjet e ardhshme për president” ka qëndruar në ekranin e CNN-it gjatë gjithë ditës kur Hosni Mubarak, presidenti i Egjiptit, iu drejtua kombit të shqetësuar, i cili ishte ngritur në valë të madhe të protestave kundër tij. Kjo fjali ishte kryefjala e fjalimit të Mubarakut. Mund të jetë titull i lajmit apo i kryeartikullit, por ajo në ekranin e CNN-it ka luajtur rolin e lajmit, sepse vetëm edhe ajo e jepte lajmin për tërheqjen e mundshme të Mubarakut. Por, kjo fjali në aspektin strukturor nuk është lajm, as fleshlajm, por vetëm informacioni kryesor i një lajmi, ose titulli i një lajmi, të cilin po e quajmë lajm i titruar për shkak të vetive të tij fizike digjitale.

Modeli për lajmin e titruar mbase është marrë nga fusha e reklamës, e marketingut dhe e ekonomisë. Bursat ka kohë që e praktikojnë dhënien e informacioneve lëvizëse në ekranet gjigante. Tashmë kanë filluar që këta ekrane të vendosen edhe nëpër rrugë e sheshe, për nevojat e publikut të gjerë. Është e pritshme që këtë shembull ta ndjekë edhe gazetaria me lajmin e titruar: të jepen lajmet e titruara nëpër sheshe e rrugë për publikun e gjerë.



Presidenti i Egjiptit, Hosni Mubarak, kur ka dhënë lajmin që nuk do të garojë më për president në CNN

## VII. LAJMI NË GAZETË DHE LAJMI NË RADIOTELEVISION

### PËRMBAJTJA

VII. Lajmi në gazetë dhe lajmi në radiotelevizion	147
VII.1. Ana teknike e teknologjike e lajmit radioteleviziv . . . . .	148
VII.2. Struktura tekstore e lajmit radioteleviziv. . .	148
VII.3. Çështje të stilit . . . . .	150

Lajmi është lajm, si në gazetë ashtu edhe në radio e në televizion. Por, çështja s'është kaq e thjeshtë. Vetëm pjesërisht mund të jetë i vërtetë pohimi i parë. Derisa gazetaria tipizohet edhe në bazë të medimeve përmes të cilave transmetohet lajmi, atëherë lajmi i gazetës dhe lajmi i radiotelevizionit janë të ndryshëm. Ata kanë diçka të përbashkët, prandaj është lajm në të dy rastet, edhe në gazetë, edhe në radiotelevizion, por ka edhe diçka që i dallon, prandaj quhet lajm i gazetës dhe lajm i radios e lajm i televizionit. Tash do t'i shohim kryesisht ato çështje që e dallojnë lajmin e radios e të televizionit prej atij të gazetës.

Ekziston një bindje se lajmi, raporti, kronika etj., në gazeta shkruhen, ndërsa në radiotelevizion fliten. E vërteta është se gjithçka që transmetohet në radio e në televizion, para se të flitet, është shkruar në letër apo kompjuter, njësoj sikur shkrimi për gazetë. Dallim bëjnë transmetimet e drejtpërdrejta dhe jo të gjitha, por emisionet si: intervistat e drejtpërdrejta nga vendi i ngjarjes, transmetimet sportive etj. Lajmi, pasi të jetë shkruar më parë, flitet si në radio edhe në televizion. Duhet punë e madhe për gazetarin për krijimin e një lajmi për radio e televizion. Ai duhet ta shkruajë tekstin, ta lexojë me zë para incizimit, ta mësojë shqiptimin e fjalëve me diksion të vështirë, t'i kontrollojë shifrat e të dhënat e tjera nëse ka dhe, vetëm pas kësaj pune, ai fillon incizimin (pa përmend në këtë punë përgatitore kombinimin e tekstit me fotografinë). Nëse bëjmë një analogji, gazetari në radiotelevizion fillon pjesën foljore atëherë kur gazetari i gazetës ta ketë përfunduar shkrimin e lajmit dhe e dorëzon te redaktori. Në njëfarë mënyre gazetari i radiotelevizionit bën një punë të dyfishtë në një lajm, në krahasim me gazetarin e gazetës, u kuptuam, në rastet kur gazetari është edhe folës.

Dallimi i vërtetë midis lajmit në gazetë dhe atij në radiotelevizion qëndron në strukturën tekstore dhe në teknikën e përgatitjes. Tashmë kemi folur për strukturën e lajmit në gazetë. Janë disa faktorë të tjerë që e paragjykojnë formën e lajmit në radio-televizion. Xhejms G. Stoval, autor i librit *Si shkruhet për mjetet e informacionit publik*, përmend katër faktorë themelorë: koha, informimi e jo shpjegimi, efekti radiofonik e pamor dhe veçantitë e të shkruarit (stili).<sup>33</sup> Nga ky katërsh, i dyti dhe i katërti kanë të bëjnë me strukturën tekstore, ndërsa dy të tjerët me anën teknike e teknologjike të lajmit.

## VII.1. ANA TEKNIKE E TEKNOLOGJIKE E LAJMIT RADIOTELEVIZIV


**Koha.** Roli i faktorit kohë në media është duke u rritur në hap me zhvillimet teknologjike. Në kohën kur gazetat shtypeshin me makinën e Gutenbergut cikli i gazetës ka qenë java, muaji apo më shumë. Në shekullin XX e këndej cikli i gazetës është dita 24-orëshe, ndërsa në metropole edhe gjysmëdita (12-orëshi). Me zbulimin e radios e të televizionit cikli i lajmit është ora. Lajmi që jepet në televizion pas më shumë se një ore është tashmë i vjetër. Në agjencitë e lajmeve virtuale (interneti) cikli i lajmit është minuta. Detyra e parë e gazetarit të radio-televizionit është të jetë i pranishëm në vendin e ngjarjes sa më parë, ose i pari ta zbulojë faktin objektiv dhe, dy, ta krijojë dhe ta bartë lajmin sa më shpejt te marrësi. Raportet e bëra nga vendi i ngjarjeve, drejtpërdrejt, janë pjesët që ndikojnë më së shumti opinionin publik dhe mbahen mend më së gjati.

**Efkti radiofonik dhe pamor.** Përderisa lexuesi i gazetës nuk e sheh autorin se çka heq derisa e shkruan shkrimin e tij dhe në përgjithësi personi i tij fizik nuk e ndikon mendjen e lexuesit, gazetari i radiotelevizionit, jo vetëm me ato që flet, por ai influencon edhe me qëndrimin e tij, mënyrën se si flet dhe me pamjet që e shoqërojnë fjalën e tij. Lajmi radioteleviziv është i tillë që mund të dëgjohet dhe të shihet. Fjala është vetëm një e dyta pjesë e këtij lajmi: pjesa tjetër është pamja. Lajmi radioteleviziv varet njëkohësisht nga këta dy faktorë dhe s'mund të jetë i mirë nëse kjo marrëdhënie nuk funksionon.

## VII.2. STRUKTURA TEKSTORE E LAJMIT RADIOTELEVIZIV

**Informim jo shpjegim.** Në këtë faktor Xhejms G. Stoval nënkupton dy esenca: natyrën e lajmit radioteleviziv, i cili është informim dhe jo shpjegim (përkundër lajmit dhe raportit në gazetën e shtypur) dhe kohëzgjatjen e lajmit apo raportit radioteleviziv, i cili mund të zgjasë më së shumti dy minuta, por është e pëlqyeshme të zgjasë 20-30 sekonda.<sup>34</sup> Kjo kohë e shkurtër nuk mjafton për shpjegime, prandaj duhet shfrytëzuar që marrësi të marrë faktet kryesore për një ngjarje lajmore.

**Parimi i unitetit dramatik.** Derisa lajmi i gazetës së shtypur rekomandohet të shkruhet sipas parimit të piramidës së përmbytur,



lajmi në radiotelevizion shkruhet sipas parimit të "unitetit dramatik". Xhejms G. Stoval e zbërthen këtë parim në tri pjesë: kulmi, shkaku dhe efekti.<sup>35</sup>

- Kulmi është kryefjala e lajmit, ajo që është kreu i parë për lajmin e gazetës. Aty gazetari jep esencën e lajmit.
- Shkaku është arsyeja apo rrethanat e faktit objektiv: pse ka ndodh dhe si ka ndodh një ngjarje?
- Efekti është ndikimi i faktit objektiv në kuadrin e vet dhe pasojat që mund të ketë në të ardhmen.

Kjo strukturë e lajmit të radios e të televizionit e Xhejms G. Stoval-it është vetëm një model shkollor, përndryshe në praktikë lajmi radioteleviziv në të shumtën e rasteve, përveç kryefjalës (kulmit) që thuhet me një fjali, ka edhe një fjali tjetër e cila përmban shkakun e pasojën bashkërisht. Mund të ketë edhe një deklaratë që lidhet me temën e lajmit.

Ja dy shembuj të lajmit televiziv:

<b>Shtefan Leene: Fillimi i punës së EULEX-it mund të shtyhet sërish</b> <sup>36</sup>	
Drejtori për Ballkanin Perëndimor në Këshillin e Evropës, Shtefan Leene, ka tërhequr vërejtjen se fillimi i punës së EULEX-it mund të shtyhet sërish, nëse nuk arrihet marrëveshja në Këshillin e Sigurimit në takimin e javës së ardhshme në Nju Jork.	Kulmi
Shtyrja eventuale e dislokimit të misionit të BE-së, nuk është në dobi të askujt, ndërkaq përderisa nuk zgjidhet çështja e EULEX-it, Britania e Madhe dhe Gjermania nuk do të votojnë pro fillimit të procedurës që Serbia ta fitojë statusin e kandidatit për anëtarësim në Bashkimin Evropian.	Efekt dhe pasoja
<b>Protesta në Gjeorgji</b> <sup>37</sup>	
Në kryeqendrën e Gjeorgjisë, në Tbilisi, rreth 10 mijë veta kanë demonstruar kundër presidentit Mikael Shakashvili me kërkesën për zgjedhje të parakohshme parlamentare dhe presidenciale.	Kryefjala (kulmi)
Demonstrata e organizuar nga mbështetësit e opozitës është protesta e parë e madhe pas luftës së Gjeorgjisë me Rusinë në gusht të këtij viti.	Efekt dhe pasoja

### VII.3. ÇËSHTJE TË STILIT

Ligjërimi gazetar i lajmit në radiotelevizion duhet të afrohet me ligjërimin bisedor. Ai është informim i shpejtë dhe aty nuk ka vend për pompozitet, letërsi e akademizëm. Gazetari flet me publikun dhe i jap atij disa fakte, e këtë duhet ta bëjë sa më thjesht që është e mundur, në mënyrë që ta kuptojë tërë korpusi i publikut. Ky fakt e imponon edhe një karakteristikë tjetër: lajmi radioteleviziv duhet të jetë më i qartë se lajmi i gazetës së shtypur. Në gazetë lexuesi i kthehet edhe njëherë leximit aty ku nuk ka kuptuar, por në RTV shikuesi apo dëgjuesi këtë nuk mund ta bëjë. Prandaj ekzistojnë një varg rekomandimesh se si lajmi duhet të formulohet sa më thjesht, në mënyrë që të kuptohet me një të dëgjuar. Duke qenë se koha për lajmin radioteleviziv është e shkurtër, aty nuk mund të ketë vend as për një fjalë të vetme pa funksion. Prandaj ky fakt e imponon edhe një element tjetër të lajmit radioteleviziv: koncizitetin. Aty fjala duhet të jetë maksimalisht koncize, pra në përputhje me idenë dhe kuptimin që bartë.

## VIII. RAPORTI

**F**jala *raport* vjen prej anglishtes (e cila e ka marrë prej frëngjishtes): shkrim apo tregim për diçka që ka ndodhur. Raporti është lloji i dytë themelor i gazetarisë. Është i afërt me lajmin, aq sa trajtohet edhe si **lajm i zgjeruar**. Në fakt, raporti është një hap më shumë se lajmi. Pra, ai është lloj i tekstit gazetar më i gjerë se lajmi.<sup>38</sup> Të gjitha rregullat që janë përcaktuar për shkrimin e një lajmi vlejné edhe për raportin.

Po, ku qëndron dallimi midis lajmit dhe raportit, çka është “një hap më shumë se lajmi”?

### VIII.1. QËLLIMI PËRMBAJTJESOR I RAPORTIT

**Raporti shpjegon.** Dallimi i i parë qëndron në qëllimin përmbajtjesor: lajmi vetëm **informon** për ndodhjen dhe rrethanat e ndodhjes së ngjarjes lajmore, ndërsa raporti **shpjegon** më tej lajmin, shpjegon dhe komenton edhe për fakte që janë të lidhura për lajmin, ofron opinione të njerëzve që nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në lajm, por gjithsesi kanë interesin e tyre në të; ofron ngjarje, fakte apo shfaqje që lidhen me lajmin kryesor dhe në fund, në disa raste, gazetari interpreton edhe vetë këto fakte e ngjarje. Lajmi informon për rrjedhojat dhe pasojat e një ngjarje lajmore, ndërsa raporti shpjegon rrugën se si ka ardhur deri tek ajo ngjarje lajmore dhe mënyrën si ka ndodhur ajo ngjarje lajmore. Për arsye të përmbajtjes, të shpjegimeve të gjëra, të cilat mund të paraqesin bazë edhe për më shumë se një lajm, shumë gazetarë me famë thonë se raporti i mirë përmban në vete dy e më shumë lajme. Lajmi e sjell informatën, raporti ndërlihd shumë informata në tërësi.

### VIII.2. ELEMENTE STRUKTURE TË RAPORTIT

**Struktura heterogjene.** Dallimi i dytë është në strukturën e tekstit të dy llojeve: lajmi është strukturë homogjene (ose drejtvizore, lineare) e raporti ka një strukturë heterogjene. Derisa në strukturën e lajmit ka një krye që thotë thelbin, në paragrafët vijues ka një zgjerim të kreut, pastaj ka një sfond të lajmit dhe me kaq përmbillet teksti. Në raport struktura e tekstit është shumë më e zgjeruar dhe, përveç informatës qendrore, përmban edhe informata të tjera që lidhen me atë qendrore, ndërfiten në tekst deklarata të personave

#### PËRMBAJTJA

VIII. Raporti . . . . .	151
VIII.1. Qëllimi përmbajtjesor i raportit . . . . .	151
VIII.2. Elemente strukturore të raportit . . . . .	151
VIII.3. Lloje të raporteve sipas gjatësisë së tekstit dhe temës që trajtojnë	154
VIII.3.1. Raporti i gjatë dhe raporti i shkurtë . . . . .	154
VIII.3.2. Raporti nga konferenca e shtypit . . . . .	157
VIII.3.3. Raporti për krimet . . . . .	158
VIII.3.4. Raporti nga gjykata . . . . .	159
VIII.3.5. Raporti nga mbledhjet, nga tubimet, nga Kuvendi e Qeveria, nga konferencat shken-core etj. . . . .	160
VIII.3.5.a. Llojet e raporteve sipas mënyrës së informimit . . . . .	160
VIII.3.5.b. Lloje tradicionale të raportit . . . . .	164

Raporti shpjegon më tej lajmin

Lajmi është strukturë homogjene (ose drejtvizore, lineare), e raporti ka një strukturë heterogjene

të ndryshëm që kanë të bëjnë me ngjarjen lajmore, ndërthuret ai lajm me rrethin shoqëror, aty janë edhe komentet e gazetarit etj. në aspektin e elementëve përbërës, struktura tekstore e raportit është e ngjashme me atë të lajmit: kreu, materiali që shpjegon kreun, sfondi dhe materiali i dytë që shpjegon kreun. Duke qenë se raporti është tekst më i gjerë se lajmi, ai ka mbititullin, titullin dhe nëntitullin, e disa raporte kanë edhe mestituj. Nëntitulli mund të jetë edhe kre, por nuk do të thotë domosdoshmërisht.

**Një ditë më vonë.** Dallimi i tretë ndërlihet me kohën: lajmi është informata e parë që i jepet publikut dhe, nëse tema e lajmit është me interes për publikun, gazetari shkon në vendin e ngjarjes të nesërmen dhe përgatit raport më të hollësishëm e më të zgjeruar për temën e lajmit të djeshëm. Kështu, lajmi i parë për tragjedinë e Gërdecit është dhënë menjëherë pas tragjedisë, përmes telefonit apo e-majl-it. Porsa redaksitë, të radio-televizioneve apo të gazetave, kanë marrë vesh lajmin, kanë nisur në drejtim të Gërdecit gazetarët, qoftë për ta pasqyruar drejtpërdrejt përmes kamerës apo për t'i shkruar raportet. Pra, lajmi është i një minute më të hershme, por raporti e plotëson lajmin në përmbajtje, në thellësinë dhe gjerësinë e shpjegimit. Kjo thellësi dhe gjerësi e shpjegimit nënkupton analizën e fakteve e të detajeve, si dhe të ideve dytësore të raportit, e të gjitha këto në varshmëri dhe në funksion të temës themelore të raportit.

Por, nuk do të thotë që raporti gjithmonë është një ditë pas lajmit: për disa ngjarje raportohet edhe pa lajmin, atëherë kur gazetari arrin të mbledhë të gjitha informatat për të informuar dhe për të shpjeguar ngjarjen lajmore.

**Detaji është shpirti i raportit.** Dallimi i katërt midis raportit e lajmit është përshkrimi i detajit në raport. Raporti pa detajin nuk ka kurrfarë vlere. Detaji është shpirti i raportit. Nëse autori di t'i zgjedhë detajet më karakteristike, më interesante, më përfaqësuese, më drithëruese, ai ka gjetur çelësin e suksesit të raportit. Këto detaje zakonisht marrin formë shprehjeje letrare. Raporti, në fakt, shkruhet për detajet. Nëse informata kryesore e një ngjarje lajmore është dhënë në lajm, raportit nuk i mbetet tjetër veç përshkrimi i detajeve të atij lajmi dhe ndërthurja e detajeve të tjera të cilat e sqarojnë më mirë temën e raportit. Nëse lajmet e para kanë përmbajtur informimin për tragjedinë e Gërdecit, gazetarët kanë shkruar një hap më tutje: kanë hulumtuar dhe kanë gjetur detaje se si ka ndodhur ajo tragjedi, si është shkaktuar, kush e ka shkaktuar, kush e ka parë i pari, si e kanë përjetuar njerëzit tragjedinë, a ka të mbijetuar nga vatra e tragjedisë, si ndihen ata, gazetarët kanë vrapuar nëpër spitale dhe u kanë qëndruar te koka të lënduarve të shpëtuar me orë të tëra vetëm për të nxjerrë një deklaratë prej tyre, ç'thonë përgjegjësit e ministrat përkatës, madje shkohet edhe

Gazetari shkon në vendin e ngjarjes të nesërmen dhe përgatit raport më të hollësishëm e më të zgjeruar për temën e lajmit të djeshëm

Raporti pa detajin nuk ka kurrfarë vlere. Detaji është shpirti i raportit.



në rrethet fqinje për t'i pyetur njerëzit se si është përjetuar eksplodimi i fuqishëm... e kështu me radhë, janë qindra apo mijëra detaje që u kanë interesuar gazetarëve (po edhe marrësit) në lidhje me tragjedinë.

**Gazetari duhet të jetë atje.** Dallimi tjetër i raportit nga lajmi është prania e autorit në momentin e ngjarjes. Gazetari nuk mund ta shkruajë raportin pa qenë vetë i pranishëm në çastin kur ndodh ngjarja apo menjëherë pas ndodhjes. Ai duhet të rrëfejë që nga vendi i ngjarjes dhe rrëfimin ta mbështesë në teknikën e përshkrimit të atypëratyshëm. Ky element i raportit më së miri dallohet te raporti në radio apo në televizion: aty do të dëgjohet dhe shihet gazetari se si sillet në vendin e ngjarjes, se si përshkruan sa më drejtpërdrejt se çfarë po ndodh, se si i pyet të pranishmit, se si ngre pasionin e marrësit përmes përshkrimit të bukur etj. Poende, autori i raportit mund të jetë edhe vetë pjesë e raportit, të bëhet personazh i raportit të vet, të rrëfejë edhe për veten, se si po e përjeton ngjarjen, si po ndjehet kur i pyet të tjerët, ç'vështirësi po heq etj. Bile raportet më të mira nganjëherë janë pikërisht ato ku edhe autori është pjesë e ngjarjes, sepse kjo krijon edhe dramacitetin e ngjarjes, po edhe besueshmërinë. Është shumë më i besueshëm e më dramatik teksti në veten e parë: *"Tash është ora 22. Qe një orë plumba dhe predha të tjera po fluturojnë mbi hotelin ku jemi vendosur, që është në qendër të Bagdatit"* sesa teksti në pavetore: *"Në orët e mesnatës krismat e armëve të kalibrave të ndryshëm shkundën Bagdatin"*.

Gazetari nuk mund të shkruajë raportin pa qenë vetë i pranishëm në çastin kur ndodh ngjarja apo menjëherë pas ndodhjes

Ndryshe pranohet pohimi i një gazetari: "Krokodili kafshon rrufeshëm copën e mishit" nga përshkrimi i Stiv Irwinit: Po ia ofroj një copë mishi krokodilit e ta shohim sa shpejt do ta kafshojë. Natyrisht, prania e gazetarit në vendin e ngjarjes shpesh është me reziqe, jo vetëm atje ku ka luftëra, e këtë më së miri e dëshmon vdekja e aventurierit të pasionuar pas natyrës së panjohur, Stiv Irwinit.<sup>39</sup>

Një tjetër karakteristikë e raportit ka të bëjë me praktikën e shkrimit të tij, por që përket edhe strukturën e tij: ju mund të shkruani një raport dhe të bëheni gati ta dorëzoni te redaktori, por në atë kohë merrni një informatë shtesë që ka të bëjë me raportin tuaj. Ju i riktheheni edhe një herë raportit, e përmirësoni, i shtoni një a dy paragrafë, apo i hiqni disa syresh. Kjo mund të ndodhë jo vetëm një herë gjatë shkrimit të të njëjtit raport. Melvin Mencher sjell shembuj të tillë dhe i quan të rregullta këto shtesa e ndryshime të raportit të shkruar.<sup>40</sup>

Saktësia, sikurse edhe te lajmi, është karakteristika më e domosdoshme e raportit. Pasaktësitë dhe gabimet në raport nuk tolerohen. Ato jo vetëm dëmtojnë shkrimin ku bëhen, por dëmtojnë rëndë imazhin e gazetës. Melvin Mencheri është i prerë: Reporterin mund ta tolerosh nëse nuk ka ndonjë mënyrë të shprehuri të spikatur, por ai me siguri që s'ka për ta mbushur dot javën në gazetë nëse bën gabime në dorëshkrim.<sup>41</sup>

## VIII.3. LLOJE TË RAPORTEVE SIPAS TEMËS QË TRAJTOJNË DHE GJATËSISË SË TEKSTIT

Dy lloje të raportit sipas gjerësisë së trajtimit të temës:

**Raporti i gjatë dhe raporti i shkurtër**

Klasifikimi i raportit sipas gjatësisë së tekstit është sipërfaqësor: një tekst i gjatë apo më i shkurtër nuk e klasifikon vetë tekstin. Por, kjo bëhet për arsye praktike. Ndërsa klasifikimi i raportit sipas temës që trajton ka të bëjë me gjuhën e raportit dhe me disa parime strukturore dhe etike gazetare: çdo temë e përhershme e raportimit (p.sh. gjykatat, konferencat shkencore etj.) e ndikon stilin e të shkruarit raport, fjalësin e raportit apo edhe ndonjë element etj. Ky klasifikim i dytë është shumë më i rëndësishëm.

### VIII.3.1 RAPORTI I GJATË DHE RAPORTI I SHKURTËR

Dallimi i raportit të gjatë dhe të shkurtër ka të bëjë me hapësirën fizike apo kohore që zë një raport në gazetë apo në radio e në televizion. Kështu, raporti i gjatë mund të zërë një faqe, apo dy të tretat e faqes së një gazete, ndërsa raporti i shkurtër më pak se gjysmëfaqe gazete. Mirëpo, ky dallim ka të bëjë edhe me thjeshtësinë, përkatësisht kompleksitetin e strukturës së tekstit të njërit e të tjetrit raport. Raporti i shkurtër është me një ngjarje dhe me detaje për atë ngjarje, pra ka një strukturë njëdimensionale. Ndërsa raporti i gjatë ka më shumë se një ngjarje të ndërlidhur për një temë, pra ka një strukturë shumëdimensionale. Raporti në të cilin gazetari ka raportuar tragjedinë e Gërdecit, me përshkrime të gjëra për shkatërrimet, për spitalet e mbushura, për llahtarinë që ka përjetuar edhe fshati fqinj, sjell deklarata të të lënduarve, të policisë, të mjekëve etj. etj., gjithsesi është një raport i gjatë, me shumë elemente që ndërlidhen me një temë: tragjedinë.

Në anën tjetër janë disa fusha sociale të cilat gazetaret i mbulojnë në vijimësi për shkak të natyrës së atyre fushave të cilat prodhojnë ngjarje lajmore: policia, gjykatat, qeveria, bizneset, konferencat etj. ka një lidhje deri në varshmëri të dyanshme të gazetarisë me këto fusha të veprimit social. Duke qenë se ngjarjet lajmore të prodhuara në këto veprimtari kanë gjetur pasqyrim të rregullt në gazetari, raportet për këto ngjarje lajmore kanë krijuar disa karakteristika të veçanta vetëm për temën e caktuar. Kështu, raporti nga seancat parlamentare ka një diskurs të veçantë, të ndryshëm nga raportet e tjera, ndërsa raporti nga gjykatat duhet të ketë kujdes të madh për neutralitetin e trajtimit të temave, derisa raporti nga një konferencë shkencore duhet të përmbajë deri-diku leksikon e asaj shkence...e kështu me radhë.

Një raport të shkurtër



### Dyzetedy milionë euro për hekurudhat e Kosovës

Qeveria e Kosovës dhe Banka Evropiane për Investime nënshkruan të martën një marrëveshje për një kredi prej 42 milionë eurosh për ripërtëritjen e hekurudhave të Kosovës. Marrëveshja e sotme çon në mbi 80 milionë euro investimet e kësaj banke dhe Komisionit Evropian për nisjen e modernizimit të hekurudhës 148 kilometërshë në Kosovë, duke e lidhur atë me rrjetin evropian.

Ministri i Financave në qeverinë e Kosovës, Avdullah Hoti, tha se "ky projekt do të bëjë rehabilitimin dhe modernizimin e linjës hekurudhore që përshkon Kosovën nga kufiri jugor me Maqedoninë, deri në kufirin verior me Serbinë, me gjithsej 148 km. Ky projekt paraqet investimin më të madh të bërë ndonjëherë në rrjetin hekurudhor dhe pritet të kapë vlerën prej rreth 208 milionë eurosh".

Kredia e sotme i shtohet kredisë prej 39.9 milionë eurosh nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, marrëveshja me të cilën ishte nënshkruar në fillim të muajit shtator. Ministri i financave tha se kushtet e kredisë janë mjaft të volitshme, me një afat kthimi prej 25 vjetësh dhe një kamatë prej rreth 1 për qind.

Projekti për modernizimin e hekurudhës është përfshirë në pakon për investime të aprovuar në takimin për Ballkanin Perëndimor në gusht të vitit 2015, pjesë e konferencës së Berlinit, të organizuar nga kancelarja gjermane, Angela Merkel, me synim nxitjen e bashkëpunimit ekonomik në mes të vendeve të rajonit. Në konferencën e Berlinit në gusht të vitit të kaluar, i është kërkuar Bashkimit Evropian një ndarje më e favorshme e fondeve të tij për rajonin.

<http://www.zeriamerikes.com/content/article/3093268.html>

Një raport të gjatë



### Kerry: Dhuna është e papranueshme – debati në parlament

**Sekretari amerikan i Shtetit, John Kerry, tha në Prishtinë se SHBA nuk do të mbështesnin asnjë marrëveshje që do të dëmtonte sovranitetin dhe pavarësinë e Kosovës**

Sekretari amerikan i Shtetit, John Kerry, tha të mërkurën në Prishtinë se parlamenti duhet të jetë vend i debateve e jo i gazit lotsjellës dhe dhunës, ndërsa nënvizoi se Shtetet e Bashkuara nuk do të mbështesnin kurrë asnjë marrëveshje që do të dëmtonte sovranitetin dhe pavarësinë e Kosovës. Ai i bëri këto komente pas takimit me kryeministrin e Kosovës

Isa Mustafa dhe dy zëvendësit e tij Hashim Thaçi e Branimir Stojanović, me të cilët u takua në aeroportin e Prishtinës. Sekretari Kerry tha se Shtetet e Bashkuara e mbështesin procesin e bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ai tha e marrëveshjet e arritura në këtë proces ishin vendime të vështira politike. *“Mos u gaboni. Nuk do të mbështesim asnjë marrëveshje që do të kërcënojnë sovranitetin, sigurinë apo pavarësinë e Kosovës. Kemi investuar shumë së bashku që të lejojmë që e ardhmja e Kosovës të vihet në rrezik”*, tha sekretari Kerry. Ai bëri thirrje që debatet të zhvillohen në parlament që duhet të jetë tempull i demokracisë dhe jo vend i dhunës.

Parlamenti i Kosovës është bllokuar për më shumë se dy muaj nga partitë opozitare që kundërshtojnë marrëveshjen për krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe si dhe atë për shënimin e kufirit me Malin e Zi. Opozita i sheh të dyja marrëveshjet si të dëmshme për sovranitetin e Kosovës. Sekretari Kerry tha se liria e shprehjes në parlament përfshirë edhe të drejtën për protestë paqësore janë thelbësore për çdo demokraci.

*“Dhuna është e papranueshme dhe Parlamenti duhet të jetë vendi ku zhvillohen debate të mirëfillta. Ai nuk është vendi për gaz lotsjellës dhe nuk është vend për kërcënime”* tha sekretari Kerry.

Ai tha se Kosova ka shënuar përparime në procesin e integrimi euroatlantike dhe nënshkrimi i MSA-së paraqet një të arritur të rëndësishme. Ai tha se Kosova duhet të përmbushë zotimin e saj për ngritjen e Gjykatës së Posaçme, që do të trajtojë pretendimet për krime lufte. Sekretari Kerry beri thirrje që udhëheqësit e Kosovës të luftojnë korrupsionin, ndërsa u zotua se Shtetet e Bashkuara do të qëndrojnë përkrah Kosovës në të gjitha proceset. Ai tha deri tash Shtetet e Bashkuara kanë ndihmuar Kosovën me rreth një miliardë dollarë. Shtetet e Bashkuara janë mbështetësit më të fuqishëm të Kosovës e cila shpalli pavarësinë në vitin 2008. Serbia e mbështetur nga aleatja e saj Rusia vazhdon të kundërshtojë pavarësinë e Kosovës.

Zoti Kerry tha se *“Kosova ka dhënë shembull të fuqishëm në rajon me arrestimet dhe madje me ligje të forta për të luftuar ekstremizmin. Por, është e qartë se duhet të bëhet më shumë”*, tha sekretari Kerry, duke nënvizuar se *“duhet të vazhdojmë të punojmë së bashku kundër premtimeve të IS-it”*.

Kosova është përballur që në vitin 2012 me rastet e para të shkuarjes së qytetarëve të saj në Siri. Fillimisht ata u ishin bashkuar forcave opozitare që luftonin për rrëzimin e regjimit të presidentit sirian, Bashar Al Assad. Por, më vonë, shumica e tyre u bashkuan me organizatat si Al Nusra apo edhe grupi i quajtur Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë. Që atëherë rreth 300 qytetarë të Kosovës i janë bashkuar konfliktit atje

ndërsa aktualisht sipas vlerësimeve të organeve të sigurisë numri sillet nga 60 deri në 100 veta. Rreth 50 prej tyre janë të deklaruar të vdekur.

Sekretari Kerry nga Prishtina shkon në Beograd, për të marrë pjesë në takimin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, ku pritet të mbizotërojë gjendja në Siri, përballja me grupin militant Shteti Islamik dhe kriza e refugjatëve e shkaktuar nga gjendja në Lindjen e Mesme.

<http://www.zeriamerikes.com/content/ksosovo-kerry/3084375.html#hash=relatedInfoContainer>

### VIII.3.2. RAPORTI NGA KONFERENCA E SHTYPIT

Gazetarët raportojnë gjithmonë nga konferencat për shtyp që organizojnë personalitete zyrtare apo të politikës e të kulturës sepse zakonisht në këto konferenca lakohen nga disa tema, prej të cilave nuk ka se si të mos jenë interesante për gazetarin një apo dy prej tyre. Aftësia e gazetarit qëndron mu në këtë çështje: të dallojë cilat janë një, dy apo tri temat më të rëndësishme të një konference shtypi dhe raportin e tij ta mbështesë në ato tema. Gazetari nuk mund të shkruajë për të gjitha temat që flet folësi në konferencë, mund të zgjedhë pra disa prej temave, nëse ai është i bindur se ato janë më të rëndësishmet për publikun. Nëse folësi ka hapur ndonjë temë e cila paraqet interes për gazetarin, por ai nuk ka dhënë më shumë informata, gazetari mund të shtrojë pyetje për sqarim. Pyetjet në konferencë shtypi duhet të jenë të thukëta, të shkurtra, të drejtpërdrejta, sikurse në një intervistë. Mund të ketë edhe pyetje finoke, nëse gazetari beson se mund ta vërë në kurth folësin për të nxjerrë prej tij ndonjë përgjigje që ai me dëshirë nuk e jep. Atë që nuk duhet ta bëjë gazetari në një raport nga konferenca për shtyp është: të mos bëhet zëdhënës i folësit nga konferenca e shtypit. Milazim Krasniqi thotë: "Nuk është e lejueshme që konferencat e shtypit të përcillen dhe të raportohen në media, për qëllime promocio-nale të organizatorëve, sepse në atë rast media rrezikon të humbë besimin e publikut të vet".<sup>42</sup>

Ajo që duhet të mbajë mend gazetari është se, para se të shkojë në konferencë shtypi, duhet të përgatitet me të dhëna për folësin, për temën që do të flasë ai dhe për institucionin që ai përfaqëson. Po ashtu, ai nuk duhet të hutohet dhe të dembeloset e ta përshkruajë në raportin e tij deklaratën në formë të shkruar që mund t'ua japë folësi. Gazetari duhet ta bëjë raportin vetë, në bazë të asaj që ka folur folësi apo nga përgjigjet që ka dhënë në pyetjet e gazetarëve.

Struktura e raportit nga konferenca e shtypit është më e thjeshtë se ajo e raportit në përgjithësi. Aty ka shumë më pak hapësirë të

"Nuk është e lejueshme që konferencat e shtypit të përcillen dhe të raportohen në media, për qëllime promocio-nale të organizatorëve, sepse në atë rast media rrezikon të humbë besimin e publikut të vet" / Milazim Krasniqi

citohen opinione të kundërta, apo për komente të gazetarit, zakonisht mbizotërojnë ato që thotë folësi. Megjithëse, është korrekte që gazetari edhe të citojë mendime të kundërta, edhe të komentojë vetë në bazë të informacionit që ka, por ai duhet të kujdeset që në një raport të tillë të mos bëhet as zëdhënës e as kundërshtar i folësit.

### VIII.3.3. RAPORTI PËR KRIMET

Raporti për krimet është një lloj delikat i raportit, së pari për shkak se në krimet që raportohen gjithmonë është një palë që ka pësuar, e në rastet më të rënda, njerëzit kanë humbur jetën. Së dyti, raporti duhet të jetë i balancuar aq sa gazetari të mos duket si gjykatës, pra mos ta paragjykojë fajtorin. Së treti, raporti të mos jetë aq “miqësor” me fajtorin e mundshëm sa që të krijojë prej tij një viktimë për keqardhje apo një hero tërheqës për publikun. Publiku gjithmonë është i interesuar të dëgjojë edhe për gjërat e errëta të njeriut, për anën tjetër të ligjit dhe gjithmonë ekziston rreziku që ai të urrejë apo ta simpatizojë fajtorin e mundshëm. Që të dy reagimet kanë rezultuar me rrjedhoja të këqija: ka pasur raste kur masat e tërbuara nga urrejtja kanë ekzekutuar fajtorët e mundshëm por, po ashtu, plot kriminelë kanë marrë famë përmes medieve, si Al Kapone (1899-1947).

Një arsye tjetër që e bën raportin për krimet delikat është fakti se ai zakonisht botohet në ballinën e gazetës apo raportohet në pjesën qendrore të lajmeve në radio e televizion. Kjo ndodh kështu sepse vrasja e një njeriu trondit gjithë opinionin. Prandaj ai raport duhet të jetë i dorës së parë. Stili i raportit për krimin kurrë nuk mund të jetë anekdotesk apo komik.

Një çështje tjetër që duhet ta ketë parasysh gazetari kur raporton për krimin është saktësia: ai duhet të marrë informata të sakta për ata që kanë pësuar nga krimi, për fajtorët e mundshëm, rrethanat në të cilat ka ndodhur krimi; duhet të sigurojë deklarata të dëshmitarëve, të zyrtarëve të policisë e, nëse ka të bëjë me vdekje, ai duhet të sigurojë edhe informata nga spitali, nga morgu dhe informata të tjera të rëndësishme.

### VIII.3.4. RAPORTI NGA GJYKATA

Raporti nga gjykata kërkon një ekspertizë të madhe nga ana e gazetarit. “Faktikisht, gazetari duhet të specializohet për raportime të tilla...”.<sup>43</sup> Kjo do të thotë se gazetari duhet t’i njohë *Kodin Penal*

Raporti për krimet është një lloj delikat i raportit: nëse gaboni, mund ta paragjykonit fajtorin a jo fajtor, ose mund t’i krijoni imazh të mirë apo të keq personit të caktuar!

Gazetari duhet t’i njohë *Ligjin Penal*, *Ligjin e Proedurës Penale* të Republikës së Kosovës, si dhe ligje të tjera që ndërlidhen me punët e gjykatave.

dhe Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Edhe për raportin nga gjykata vlejné të njëjtat rregulla të korrektësisë dhe të balancës sikur për raportin për krimin. Gazetari nuk duhet të gjykojë, të mbajë anë e aq më pak të paragjykojë. Ai nuk duhet të harrojë për asnjë çast, pavarësisht nga emocionet e tij, se ai vetëm raporton për atë çka ndodh në gjykatë. Stili i tij i ligjërimit nuk duhet të jetë emocional dhe që ngre emocione. Duhet të jetë stil neutral e pa konotacione.

Ja një shembull i raportit nga gjykata, në të cilin gazetari nuk është tërësisht neutral:



### **GJYKATA E LARTË SHTYN GJYQIN NDAJ DAJTIT, AVOKATI PARAQET RAPORT MJEKËSOR**

17 SHT 2015

Dritan Dajti nuk heq dorë nga "zanati" i vjetër. Edhe në Gjykatën e Lartë e nis procesin me shtyrje. Pasi ia doli në Gjykatën e Krimeve të Rënda ta zvarriste për katër vite procesin ndaj tij, ndonëse në fund u dënua përjetësisht, e tashmë është në betejë të ashpër me drejtësinë, duket se po ndjek të njëjtën taktikë.

Në seancën e parashikuar për t'u zhvilluar mëngjesin e djeshëm, Gjykata e Lartë nuk ka pasur zgjidhje tjetër veçse të shtyjë për në datë 30 shtator shqyrtimin e rekursit të prokurorisë për Dritan Dajtin. Shkak për këtë është bërë pamundësia e mbrojtësit ligjor të Dajtit, Erkens Shpendi, për t'u paraqitur në proces. Avokati kishte sjellë në gjykatë një raport mjekësor, çka vërtetonte faktin se nuk mund të mbronte interesat e të pandehurit.

Procesi ndaj Dritan Dajtit është në një pikë shumë të rëndësishme. Gjykata e Krimeve të Rënda e dënoi Dritan Dajtin me burgim të përjetshëm për vrasjen e katër oficerëve të skuadrës speciale operacionale më 7 gusht 2009 në Durrës. Nuk kaloi shumë kohë dhe Apeli për Krime të Rënda e prishi këtë vendim duke kthyer dosjen "Dajti" për rigjykim. Prokuroria duke mos qenë dakord me vendimin e Apelit, bëri rekurs në Gjykatën e Lartë dhe kërkoi dënimin përjetësisht të Dajtit, për masakrën e Durrësit. Beteja është e hapur dhe Dajti do tentojë me çdo kusht që të paktën në fuqi të mbetet vendimi i Apelit, pasi në këtë mënyrë, në shkallën e parë do të nisë procesi nga e para, duke fituar kështu të drejtën për të kërkuar gjykim të shkurtuar. Dritan Dajti, përveç akuzave të rënda që ka mbi supë, do të kujtohet në drejtësi si njeriu që krijoi një precedent të jashtëzakonshëm të zvarritjes së procesit dhe "pingpongu" i tij me drejtësinë bëri që institucionet për shumë kohë të mbeteshin "jetime" dhe në pamundësi për ta zhbllokuar telenovelën "Dajti".

<http://www.balkanweb.com/gazetashiptare/gjykata-e-larte-shlyn-gjyqin-ndaj-dajtit-avokati-paraqet-raport-mjekesor/>



### VIII.3.5. RAPORTI NGA MBLEDHJET, NGA TUBIMET, NGA KUVENDI E QEVERIA, NGA KONFERENCAT SHKENCORE ETJ.

Mbledhjet dhe tubimet e tjera, sidomos politike, por edhe të natyrave të tjera, paraqesin një rëndësi për publikun, prandaj edhe gazetari gjithnjë i raportojnë në faqet e para. Gazetari duhet të zgjedhë çështjet themelore nga një mbledhje për t'i përfshirë në raportin e tij. Por, në fund të raportit mund t'i përmendë shkarazi edhe temat e tjera që janë diskutuar në mbledhje, por të cilat nuk meritojnë të trajtohen gjerësisht në raport. Edhe në këtë lloj të raportit kërkohet ekspertizë e gazetarit për disa fusha. Kështu, gazetari që raporton nga një mbledhje ku diskutohen politikat fiskale të qeverisë, detyrimisht duhet të jetë i parapërgatitur teorikisht në fushën e politikave ekonomike. Por, në rastet e përgjithshme gazetari duhet të jetë i vëmendshëm që në raportin e tij t'i japë tezat themelore të diskutuara. Është shumë e rëndësishme që në raport të jepen edhe pikëpamje të ekspertëve që nuk kanë qenë pjesë e mbledhjes, por janë ekspert të fushës për çka është diskutuar në atë mbledhje.

Një trajtim të veçantë duhet bërë në raportet për ngjarjet kulturore, të artit e të shkencës. Milazim Krasniqi e trajton edhe këtë raport si lloj të veçantë.<sup>44</sup> Edhe në këtë lloj të raportit gazetari duhet të jetë i specializuar për fushën përkatëse. Nëse raporti ka të bëjë me një manifestim kulturor, si koncert, festival etj., raporti duhet të jetë i shkruar me një stil emfatik, por nëse ka të bëjë me një takim të natyrës shkencore e akademike, si *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në Prishtinë*, atëherë raporti duhet të jetë i shkruar me gjuhë akademike, por aq sa të jetë i kuptueshëm për lexuesin.

#### VIII.3.5.A. LLOJET E RAPORTEVE SIPAS MËNYRËS SË INFORMIMIT

Një tipizim i mëtejshëm që i bëhet raportit është ai që mbështetet në mënyrën se si raportohet, pra si bartet informata dhe shpjegimi i rrethanave të ndodhjes së faktit objektiv. Disa teoricienë dallojnë tre lloje të tilla të raportit.<sup>45</sup>

**Raporti i thjeshtë informativ.** Është raporti i cili përqendrohet vetëm në shpjegimin e rrethanave të ndodhjes së lajmit. Shpjegon në detaje se si është zhvilluar ngjarja nga A në Zh.

Në raportimet për tema speciale, si është raportimi nga tubimet, apo nga Kuvendi i Kosovës, apo nga konferencat shkencore, gazetari duhet të familjarizohet me gjuhën dhe terminologjinë e fushës së caktuar.

Lloje të raporteve sipas mënyrës së informimit:

Raporti i thjeshtë informativ  
Raporti përshkrues  
Raporti analitik (interpretues, komentues)  
Raporti me tezë

## 'Venecia' miraton opinionin e reformës në drejtësi: Tani duhet të flasë politika



Komisioni i Venecia ka miratuar opinionin përfundimtar të reformës në drejtësi. Në një postim në rrjetin social "Twitter", në faqen e misionit të BE-së në Shqipëri, komisioni falënderon delegacionin e BE-së për mbështetjen dhe thekson se tashmë përgjegjësia i kalon Parlamentit shqiptar që ta finalizojë këtë proces.

"Tashmë përgjegjësi e Parlamentit të bëjë reformën historike në drejtësi që kërkojnë qytetarët shqiptarë".

Raporti përfundimtar i Venecias është 'zyrtarizim' i draftit të ndërmjetëm të bërë publik në fillim të këtij muaji. Top-Channel siguroi dokumentin prej 20 faqesh të draftit të ndërmjetëm, nga ku ekspertët e Venecias kanë renditur konkluzionet përfundimtare.

Debateve të forta politike, se cili do të jetë fati i mëtejshëm i Prokurorit të Përgjithshëm, Adriatik Llalla pas miratimit të reformës, Venecia u jep këtë verdikt:

"Nëse prokurori i përgjithshëm kalon procesin e vetingut dhe del i pastër prej tij, atëherë pyetja është se, ku qëndron justifikimi për ta larguar atë më përpara nga zyra, duke e veçuar nga mesi i të gjithë atyre zyrtarëve tek të cilët aplikohet vetingu? Në të filla kushte, Komisioni i Venecias nuk shikon asnjë arsye për përfundim të parakohshëm të mandatit", thuhet në paragrafin 81 të faqes 18 të opinionit.

Për zgjedhjen e 3 anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të cilët i zgjedh Kuvendi, Venecia rekomandon:

"Duke marrë në konsideratë krijimin e vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese, Komisioni rekomandon krijimin e një rregulli zgjedhjeje me shumicë të cilësuar për 3 anëtarët e Gjykatës Kushtetuese që zgjidhen nga Parlamenti", thuhet në paragrafin 39, faqja 9.

11 mars 2016 (gazeta-Shqip.com)

**Raporti përshkruas.** Më tepër se tregim dhe shpjegim, ky raport është rrëfim. Autori kryesisht rrëfen në vetën e parë. Esenca e këtij raporti përqendrohet te shtresa përshkruas, gati se letrare, të cilën gazetari ia jep rrëfimit të tij. Ai shpjegon rrethanat e ndodhjes së lajmit por duke bërë përshkrime të hollësishme, të gjalla e në frymë letrare.

**Raporti analitik (interpretues, komentues).** Është raporti i cili, krahas shpjegimit të rrethanave të ndodhjes së lajmit, bën edhe interpretime e komentime të atyre rrethanave. Këtu afrohet me analizën, por dallon sepse qëllimi përmbytësor i këtij raporti nuk ndryshon nga ai i raportit të përgjithshëm: shpjegon rrethanat e ndodhjes së lajmit (e nuk interesohet për shkaqet e vërteta të ndodhjes së tij, apo për pasojat e mundshme etj. me të cilat merret analiza).

Fjalimi

Deputeti: Nëse duhet të zgjedh mes Partisë dhe Shqipërisë, zgjedh Shqipërinë

## Blushi: Ideja e referendumit një marrëzi. Kërkon mandat të përjetshëm

Bën Blushi, deputeti i ri në Kuvendin e Shqipërisë, ka përfunduar në ditët e fundit të vitit të kaluar, një proces të rëndësishëm në jetën e tij si deputet. Në fillim të vitit të kaluar, Blushi ishte në krye të grupit parlamentar të PS-së në Komitetin e Përbashkët të Parlamentit Europian dhe Komitetit të Përbashkët të Parlamentit Europian. Në ditët e fundit të vitit të kaluar, Blushi është bërë pjesë e grupit parlamentar të PS-së në Komitetin e Përbashkët të Parlamentit Europian dhe Komitetit të Përbashkët të Parlamentit Europian.



**Batala me Finon** Përpjekja e Edi Ramës për të bërë mandatin e tij përjetshëm ka bërë që të përdoret edhe shprehja "batala me Finon".

Blushi është bërë pjesë e grupit parlamentar të PS-së në Komitetin e Përbashkët të Parlamentit Europian dhe Komitetit të Përbashkët të Parlamentit Europian. Në ditët e fundit të vitit të kaluar, Blushi është bërë pjesë e grupit parlamentar të PS-së në Komitetin e Përbashkët të Parlamentit Europian dhe Komitetit të Përbashkët të Parlamentit Europian.

Blushi është bërë pjesë e grupit parlamentar të PS-së në Komitetin e Përbashkët të Parlamentit Europian dhe Komitetit të Përbashkët të Parlamentit Europian. Në ditët e fundit të vitit të kaluar, Blushi është bërë pjesë e grupit parlamentar të PS-së në Komitetin e Përbashkët të Parlamentit Europian dhe Komitetit të Përbashkët të Parlamentit Europian.

Blushi është bërë pjesë e grupit parlamentar të PS-së në Komitetin e Përbashkët të Parlamentit Europian dhe Komitetit të Përbashkët të Parlamentit Europian. Në ditët e fundit të vitit të kaluar, Blushi është bërë pjesë e grupit parlamentar të PS-së në Komitetin e Përbashkët të Parlamentit Europian dhe Komitetit të Përbashkët të Parlamentit Europian.

Blushi është bërë pjesë e grupit parlamentar të PS-së në Komitetin e Përbashkët të Parlamentit Europian dhe Komitetit të Përbashkët të Parlamentit Europian. Në ditët e fundit të vitit të kaluar, Blushi është bërë pjesë e grupit parlamentar të PS-së në Komitetin e Përbashkët të Parlamentit Europian dhe Komitetit të Përbashkët të Parlamentit Europian.

Blushi është bërë pjesë e grupit parlamentar të PS-së në Komitetin e Përbashkët të Parlamentit Europian dhe Komitetit të Përbashkët të Parlamentit Europian. Në ditët e fundit të vitit të kaluar, Blushi është bërë pjesë e grupit parlamentar të PS-së në Komitetin e Përbashkët të Parlamentit Europian dhe Komitetit të Përbashkët të Parlamentit Europian.

Blushi është bërë pjesë e grupit parlamentar të PS-së në Komitetin e Përbashkët të Parlamentit Europian dhe Komitetit të Përbashkët të Parlamentit Europian. Në ditët e fundit të vitit të kaluar, Blushi është bërë pjesë e grupit parlamentar të PS-së në Komitetin e Përbashkët të Parlamentit Europian dhe Komitetit të Përbashkët të Parlamentit Europian.

Shembull i raportit analitik

**Raporti me tezë.** Raporti mund të ketë një tezë dhe një argument të saj. Gazetari, për dallim nga shkrimi i lajmit, në raport mund të parashtojë një tezë për shqyrtim, por e cila duhet të jetë në lidhje me temën e raportit dhe mund të argumentojë për edhe kundër tezës së shtruar. Në rast se e parashtron tezën, ai duhet ta përmbyllë raportin me një përfundim për tëzë e parashtruar. Kështu, për shembull, një gazetar mund të hulumtojë rastet e shpesh-ta të aksidenteve në një vendkalim hekurudhor; gazetari mund të parashtojë ndonjëherë nga tezat e shumta se kush është shkak i këtyre aksidenteve: pakujdesia e shoferëve të makinave apo e këmbësorëve; pakujdesia e makinistëve të trenit; pakujdesia e organeve kompetente të cilat nuk i kanë zëvendësuar shenjat e komunikacionit të prishura, tashmë të padukshme, e të cilat paralajmërojnë vendkalimin hekurudhor; pakujdesia e organeve kompetente të cilat nuk kanë vënë një pengesë (rampë) në vendkalimin hekurudhor; fakti që komuna ka dhënë leje për ndërtimin e një objekti banimi

fare pranë vendkalimit dhe tash ky objekt e ka zënë perspektivën e shikimit në anën e djathtë të shoferëve dhe të kalimtarëve që kalojnë vendkalimin hekurudhor... etj. Pa marrë parasysh se cilën prej këtyre tezave mund ta parashtrorë gazetari, në përfundim të raportit ai duhet ta argumentojë njëri apo disa prej tyre dhe ta rikonfirmojë si përfundim të tij.

### **Për 15 muaj janë mbajtur vetëm dy seanca në rastin e skandalit me shitblerjen e notave**

#### **Pasiviteti i gjykatës mund t'i amnistojë nga disa vepra të akuzuarit për rryshfet në UP**

10 Mars 2016 - 07:14

Prishtinë, 10 mars.- Pesëmbëdhjetë muaj prej ngritjes së aktakuzës kundër 13 asistentëve dhe studentëve të Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës, për skandalin e shitblerjes së notave, janë mbajtur vetëm dy seanca. Arsyet e mosmbajtjes së seancave kryesisht lidhen me mospjesëmarrjen e të gjithë të akuzuarve në gjykim. Në disa raste seancat janë shtyrë edhe për shkak të mospjesëmarrjes së trupit gjykues.

Zvarritja e këtij procesi mund t'i ndihmojë të akuzuarit që të lirohen nga disa pika të aktakuzës, meqë disa nga veprat penale për të cilën dyshohen këta persona e kanë arritur kohën e parashkrimit. Si pasojë e këtyre mosveprimeve, gjykatat nuk mund të ndërmarrin asnjë veprim juridik për të ndjekur penalisht të dyshuarit për veprat të cilat tashmë janë vjetruar. Grupi i përbërë nga 13 persona, disa nga ta asistentë në Fakultetin e Mjekësisë, po përballet me akuzë për marrje rryshfeti, ushtrim të ndikimit, keqpërdorim i detyrës zyrtare.

As prokuroria e as gjykata nuk kanë dhënë sqarime se pse për këtë kohë nuk janë mbajtur seancat. Me gjithë atë në seancën e cila është paraparë të mbahet më 18 mars, avokatët mbrojtës do të paraqesin para trupit gjykues kërkesën për pushim të ndjekjes për disa pika për shkak që e kanë arritur kohën e parashkrimit.

Avokati Gëzim Baloku ka thënë se ai e ka gati kërkesën për pushim të akuzave. "Do t'ia dorëzojmë gjykatës seancën e radhës... Disa vepra janë parashkruar", ka thënë ai. Baloku nuk ka pranuar të flasë më shumë me arsyetimin se veprat e parashkruara do t'i paraqiten fillimisht gjykatës.

Edhe Asdren Hoxha, i cili është avokati i të akuzuarit Kushtrim Morina, ka thënë se disa nga veprat me të cilat ngarkohen të akuzuarit janë vjetruar. Ai beson që edhe gjykata, duke u bazuar në ligj, do të pushojë akuzat për këto vepra. "Gjykata ende nuk ka marrë vendim për parashkrim të asnjë vepre për shkak që nuk kemi pasur mundësi që të parashtrorë këtë kërkesë", ka thënë Hoxha. Nga parashkrimi i lëndëve, sipas tij, do të përfitojë më shumë se një i akuzuar. Sipas Hoxhës, kërkesa për pushim të akuzave për disa vepra do të bëhet në seancën e radhës, nëse gjykata do të sigurojë kushtet që të mbahet seanca. (...)

Koha ditore, 11 mars 2016

Vetë titulli i raportit paraqet tezën: Pasiviteti i gjykatës mund t'i amnistojë nga disa vepra të akuzuarit për rryshfet në UP

Në paragrafin e dytë shtjellohet më tej teza:

Zvarritja e këtij procesi mund t'i ndihmojë të akuzuarit që të lirohen nga disa pika të aktakuzës, meqë disa nga veprat penale për të cilën dyshohen këta persona e kanë arritur kohën e parashkrimit. Si pasojë e këtyre mosveprimeve, gjykatat nuk mund të ndërmarrin asnjë veprim juridik për të ndjekur penalisht të dyshuarit për veprat të cilat tashmë janë vjetruar.

Teza e gazetarit është e qartë: duke zvarritur procedura të seancave gjyqësore (theksohet se këto zvarritje janë bërë për shkak të mungesës herë të njërit e herë të tjetrit të të akuzuar) disa nga veprat penale do të parashkruhen.

Ky qëllim është argumentuar mirë: tre avokatët të të akuzuarve kanë sqaruar se janë duke ndjekur atë strategji.

Në raportin e mësipërm të *Kohës ditore* gazetari ka një tezë: Pasiviteti i gjykatës mund t'i amnistojë nga disa vepra penale të akuzuarit për ryshfet në Universitetin e Prishtinës. Kjo tezë e tregon qartë idenë e gazetarit, pra raportit i paraprinë teza, mendimi apo ideja e gazetarit për temën. Në këto raste gazetari duhet ta argumentojë plotësisht tezën e tij, përmes fakteve të pranueshme, e nëse dështon ta bëjë këtë, atëherë raporti del të jetë propagandistik.

Ja edhe një shembull tjetër të raportit me tezë:

### **Kriteret e akreditimit vërshojnë Kosovën me doktorë nga jashtë**

Prishtinë, 21 mars- Për më pak se tre muaj në Qendrën Kombëtare për Njohje të Diplomave (NARIC-Kosova) janë drejtuar mbi 400 kërkesa për njohje ose barasvlerësim të diplomave të niveleve posdiplomike, kryesisht të doktoratave, të fituara jashtë vendit.

Kjo situatë ndërlidhet me kriterin për akreditim të Agjencisë së Akreditimit, që për secilin program të ketë tre profesorë që kanë gradën doktor shkence. Shumica e kandidatëve që kanë aplikuar për njohje ose barasvlerësim të këtyre diplomave nuk janë shtetas të Kosovës, kanë thënë për "Kohën Ditore" drejtues të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (...)

*Koha ditore, 22 mars 2016*

Vetë titulli i raportit paraqet tezën: Për shkak të kriterëve të akreditimit (më tej shihet se është fjala për shkak të kriterëve të ashpra) në Kosovë kanë vërshuar (kujdes: fjala vërshuar ka konotacion negativ!) doktorët nga jashtë.

Në paragrafin e dytë shtjellohet më tej teza:

### **VIII.3.5.B. LLOJE TRADICIONALE TË RAPORTIT**

Hamit Boriçi e njëjtëson raportin me format e vjetra të gazetarisë shqiptare: korrespondencën dhe letrën.<sup>46</sup>

**Korrespondenca** është shkruar nga shkrues të ndryshëm anembanë tokave shqiptare dhe në të ka dy vija komunikimi: informimi për ngjarje të ndryshme apo për dukuri shoqërore e politike për vendin prej nga janë shkruar dhe komentimi e analizimi i atyre ngjarjeve e dukurive. Shkruesit e korrespondencave nuk do të thotë të kenë qenë gazetarë: kanë qenë thjesht njerëz të kulturës të cilët kanë informuar opinionin publik shqiptar me të rejat. Në thelb, korrespondenca nuk dallon nga forma shumë më e preferuar e gazetarisë tradicionale shqiptare, letra, vetëm se emërtimi është i ndryshëm. Korrespondenca me titullin *Polena dhe bejlerët (Korrespondencë prej Worcesteri)*<sup>47</sup>, ka të njëjtën formë dhe të njëjtën strukturë informimi sikur cilado letër tjetër e gazetarisë shqiptare.

Por **letra** është gjithsesi një prej formave më të preferuara të gazetarisë shqiptare në periudhën e Rilindjes Kombëtare. Letra është konceptuar dhe shkruar si lajm i shkurtër, por në të shumtën e rasteve si raport, si artikull a si koment. Letra është shkruar nga shkrues jo detyrimisht gazetarë dhe kanë pasur qëllim themelor informimin dhe interpretimin e tyre për nevojat e lexuesit të gjerë.

Letrat nuk kanë tituj, por thjesht titullohen *Letër nga Mitrovica* (DRITA, Sofje, nr. 72, 15 janar 1906)<sup>48</sup>, *Letër nga Janina 1 gusht 1904* (DRITA, Sofje, nr. 49, 13 gusht 1904)<sup>49</sup>, por ka raste edhe kur kanë mbtitull, si *Letër nga Elbasani* dhe titulli: *Reforma në Elbasan!* (DRITA, Sofje, nr. 92, 14 gusht 1907, autori M. K.).<sup>50</sup>

Letrat kanë formën e një lajmi. Ja një shembull nga gazeta KOMBI:



### VEPRIMTARIA E ÇETAVE NË MYZEQE E NË VLORË

-Letër nga Vlora-

Dje më 14 Qershor erdhi një tejshkrim nga Gjirokastra mi sundimin e këtushëm i cili thotë: "Bimbashi u përpoqti me bandën e Cerçiz Topullit afro 150 vetash në Pogon 3 orë jashtë qytetit. Luftë e rrëptë ka 8 orë që bënet dhe ushtria është në dëm të math." Pas pak ditësh u shkruan hollimet e kësaj lufte me rëndësi për çështjen kombëtare.

An'e Beratit, Myzeqesë dhe e Korçës u mbushën me kryengritës shqiptarë.

Vlorë, 15 qershor 1908

Autori: Mal'i Sazanit

KOMBI, Boston, nr. 94, 24 korrik 1908.<sup>51</sup>

Shpesh letrat publikohen bashkë me një artikull apo edhe me kryeartikullin e gazetës. Një letër (në kuptimin e sotëm një lajm) bëhet shkas që redaksia ta shkruaj kryeartikullin. Kështu redaksia e gazetës DRITA në Sofje shkroi kryeartikullin Të këqijat që heq kombi Shqipëtar, me mbtitullin Letrë nga Shqipëria, ndërsa shkrimi nis me këto fjali:



Muarmë, një letër nga mez'i Shqipërisë, e cila na helmon fort tepër. Këndonjësit tanë do të kqyrin se ç'të këqija heq kombi shqipëtar nga qeveria e Turqisë. Letrën po e shtypim ashtu si na e dërguan: "Hamdi Beu, i cili ka 2 vjet q'është mbyllur në burg prej qeverisë për së dyjti, si pa që burgjet u mbushnë (...) plot, shumë herë ziheshin lesh për leshi; dhe qarje që: nukë munt të ronj më me këta njerës dhe s'munt të duronj dot në kaqë ngushtësirë të madhe e të sëmurem. Valiu me të marë këtë qarje e dërgoj në Stamboll. Urdhër erdhi nga Stamboll q' ta ngrenë nga Manastiri. Dita që do ta ngrinin Hamdi benë, hariu! Koha u shënua. Më 6 të Shkurrit e nxuar nga burgu i zi; i suallë vargjet të zesë, t'ja shien ndër këmbë dhe në qafë Hamdiut..." A munt t'i mbesën ndonjë këndonjësi pa dredhur fletët e zëmresë? A munt të mbesë nonjë Shqipëtar pa derdhur lotë të hidhur, kur dëgjon gjithë këto shtyrani? A munt të mos i dridhet zëmra, kur sheh me sy e dëgjon me veshë gjithë këto mundime që po bën qeveri e Halldupit në Shqipëri dhe në kombin Shqipëtar? S'ka njeri!...

DRITA, Sofje, nr. 21. 14 shkurt 1906, artikull i redaksisë.<sup>51</sup>

Si shihet nga citati i mësipërm, letra (si lajm) botohet brenda një kryeartikulli.





## IX. KRONIKA

## IX.1. ÇËSHTJE TË NOCIONIT

**N**ocioni kronikë ka shkaktuar një kaos kuptimesh në traditën gazetare shqiptare. Në gazetarinë e Prishtinës kronika një kohë është njëjtësuar me raportin, ose janë trajtuar si zhanre të afërta. Kështu, mbasi televizioni ka dhënë një lajm (për shembull: “Sot bora ka bllokuar Malësinë e Gollakut”), folësi ka vazhduar: “Të ndjekim tash kronikën”, dhe emisioni ka vazhduar me kronikën e gazetarit që raporton nga vendi i ngjarjes, nga Malësia e Gollakut, sjell imazhe për bllokimin e rrugëve, si pasojë edhe mbylljen e shkollave, interviston zyrtarë dhe qytetarë të rastit etj. Ky lloj i kronikës është në mos i njëjtë, i afërt shumë me raportin. Dallon vetëm në faktin se kronika nuk e ndjek gjithnjë një ngjarje të sapo ndodhur, por trajton edhe një temë të mëhershme. Krejt ndryshe e përkufizon kronikën Hamit Boriçi dhe të tjerët në librin *Gazetaria* (2004): ai e quan kronikë informacionin e parë për ndodhjen; është informatë më e shkurtër se lajmi dhe jepet para lajmit; kronistët janë të parët që vrapojnë mbas lajmit etj.<sup>53</sup> Boriçi dhe të tjerët e ngatërrojnë kronikën së pari me fletshkrimin (lajmi i parë, i shkurtër e i shpejtë, lajmi që jepet drejtpërdrejt), pastaj edhe me rubrikën e gazetës, e cila mund të quhet kronikë dhe të përmbajë disa lajme të një tematike. Për shembull: *kronika e zezë* (lajme me tematikë krimesh), *kronika universitare* (lajme me temë arsimin universitar), *kronika bankare* (lajme me temë bankat e financat) etj. Në rastin e parë gjërat janë më të qarta: nuk mund të jetë kronika “forma më e shkurtër dhe më e thjeshtë e informimit”, sepse edhe vetë emri tregon se është një shkrim që ndjek parimin kohor të informimit, pra fillon nga A deri në Zh. Në rastin e dytë problemi është më i ndërlikuar sepse nuk është ky rast i vetëm kur në gazetar ka një mospajtim midis rubrikës dhe zhanrit. Megjithatë, ne e trajtojmë kronikën si zhanër gazetar e jo si rubrikë, pra tekstin që quhet kronikë e jo rubrikën që quhet kronikë.

Në traditën anglishtfolëse nuk ka një shkrim gazetar me emrin kronikë. Por, përkufizimi që teoricienët i bëjnë llojit *News feature* (është fiçeri më i njohur dhe më i pranishëm; fillon nga lajmet e ditës dhe vazhdon duke i shpjeguar, i zgjeron me më shumë informacione, i komenton dhe i parashikon pasojat e mundshme), e bën atë të ngjashëm me kronikën.

## PËRMBAJTJA

IX. Kronika. . . . . 167

IX.1. Çështje të nocionit 167

IX.2. Qëllimi përmbajtjesor  
i kronikës dhe struktura  
teksturore . . . . . 168

Folësi televiziv: “Sot bora ka bllokuar Malësinë e Gollakut”. “Të ndjekim tash kronikën” Gazetari shfaqet në ekran nga vendi i ngjarjes dhe jep kronikën për ngjarjet e ndodhura me bllokimin e Malësisë së Gollakut nga bora e madhe.

Kronika si zhanër  
Kronika si rubrikë  
News feature

## IX.2. QËLLIMI PËRMBAJTJESOR I KRONIKËS DHE STRUKTURA TEKSTORE

Kronika është aq e ngjashme me raportin saqë duhet pyetur se a është kronika lloj më vete informativ apo nënloj i raportit?

Qëllimi përmbajtjesor i kronikës nuk është detyrimisht shpjegimi i rrethanave të ndodhjes së lajmit, por shpjegimi i rrethanave të një ngjarje të caktuar e cila paraqet interes për marrësin dhe e cila mund të mos jetë lajm i ditës, por mund të jetë një ngjarje lajmore me rëndësi për kohën dhe vendin.

Kronika ka në qendër një temë (apo më shumë)

Përveç çështjes së marrëdhënies së identifikimit të kronikës ndaras nga “lajmi i parë” i Boriçit dhe nga rubrika, çështja e dytë që duhet të zgjidhet është identiteti i saj në marrëdhënie me raportin. Kronika është aq e ngjashme me raportin saqë duhet pyetur se a është kronika lloj më vete informativ apo nënloj i raportit? Edhe në këtë rast përgjigjja është në favor të kronikës. Raporti është shkrimi i dytë në hierarkinë kohore pas lajmit. Raporti e shpjegon lajmin se si ka ndodhur. Pra, ai lidhet drejtpërdrejt me lajmin e sapo ndodhur. Pa një lajm të ndodhur paraprakisht nuk ka raport. Edhe kronika nganjëherë është shpjegim i lajmit se si ka ndodhur, por ajo dallon prej raportit se nuk është e lidhur kushtëzueshëm prej lajmit sikurse raporti. Kronika shkruhet edhe për ngjarjet që nuk janë lajme të ditës. Ajo vetëm fillon me lajmet dhe merr shkas nga lajmet, por pastaj vazhdon duke i shpjeguar, i zgjeron me më shumë informacione, i komenton dhe i parashikon pasojat e mundshme të atyre zhvillimeve. Qëllimi përmbajtjesor i kronikës nuk është detyrimisht shpjegimi i rrethanave të ndodhjes së lajmit, por shpjegimi i rrethanave të një ngjarje të caktuar e cila paraqet interes për marrësin dhe e cila mund të mos jetë lajm i ditës, por mund të jetë një ngjarje lajmore me rëndësi për kohën dhe vendin. Në kronikë gazetari mund të trajtojë cilëndo ngjarje, të tashme apo të mëhershme, e cila ka qenë apo nuk ka qenë lajm, por e cila paraqet interes për marrësin.

Në strukturë tekstore kronika, po ashtu, dallon nga raporti: kronika ka në qendër një temë (apo më shumë) dhe e njofton marrësin me rrethanat e krijimit, të zhvillimit dhe të qenësimit të asaj teme duke ndjekur parimin kohor. Teksti fillon me ngjarjen e parë dhe vazhdon me atë që ka ndodhur mbas të parës, të dytës e kështu me radhë. Prandaj edhe e ka emrin kronikë, origjinalisht histori kohore e një ngjarjeje. Në gazetën *Koha ditore* është botuar kronika me këtë titull dhe nëntitull:

*Titulli:* 35 mijë veta presin punë sipas regjistrit të Qendrës së Punësimit.<sup>54</sup>

*Nëntitulli:* Sipas drejtorit të QRP-së së Gjilanit, në evidencën e të papunëve në shërbimet e punësimit në rajonin e Gjilanit janë 35 mijë e 975 punëkërkues, ku pjesa dërmuese e tyre janë të pakualifikuar.

Teksti flet për një gjendje afatgjate të papunësisë në komunën e Gjilanit. Kjo është një temë që ekziston për një kohë të gjatë, nuk ka asnjë zhvillim të ri, pra nuk ka një lajm. Por, tema gjithsesi është

e rëndësishme për marrësin dhe gazetari ka zgjedhur një lloj të veçantë zhanror për ta shprehur këtë problem si informacion dhe për t'ia transmetuar marrësit si informacion. Do të mund ta bënte një analizë, por ai nuk ka synuar t'i zbulojë rrënjët e papunësisë apo ta analizojë problemin gjerësisht, por vetëm ta paraqesë problemin dhe ta informojë marrësin mbi papunësinë e madhe. Kjo është kronika.

Kronika, ndryshe nga raporti, mund të shkruhet edhe për një ngjarje e cila nuk ka qenë lajm

Në të njëjtën gazetë është botuar edhe kronika tjetër:

*Titulli:* Mungesa e buxhetit lë pa mjekë Qendrën e Mjekësisë Familjare të Fortesës.

*Nëntitulli:* Për mungesë të kuadrit mjekësor dhe buxhetit, në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Fortesë, prej një muaji më nuk kryhen kontrolle mjekësore.

Edhe në këtë kronikë, ngjarja e cila do të mund të ishte lajm, ka ndodhur një muaj më parë. Ose mund të mos ketë qenë fare lajm, sepse nuk paraqet lajm nacional mungesa e një mjeku në një fshat të Kosovës. Mirëpo, meqenëse mjeku ka munguar një muaj dhe ka gjasa që të mos kthehet më fare, për shkak të mungesës së buxhetit dhe për mungesë të kuadrit mjekësor (mjeku i mëparshëm ka gjetur një vend tjetër më të mirë të punës), e kjo ka krijuar vështirësi në komunitet, gazetari ka zgjedhur ta shkruajë kronikën, në të cilën tregon se si ka lindur problemi dhe se si është tash gjendja e se si mund të vazhdohet.

Njëjtë është edhe kronika tjetër, po në këtë numër të gazetës  
*Koha ditore:*

*Titulli:* Gjykata në Veri hapet solemnisht në prill

*Nëntitullin:* Gjykata e Qarkut në Mitrovicë është duke u rinovuar në kuadër të projektit të quajtur "Gjykatat model". Paratë për investim i ka dhënë qeveria amerikane. Posa të kryhen ato, në mes të muajit prill, pritet edhe kthimi i gjyqtarëve kosovarë. Për këtë është pajtuar edhe EULEX-i. Kthimi mund të jetë solemn në kuadër të investimit.

Edhe në rastin e tretë nuk ka një lajm të pastër. Gazetari ka mbledhur informacionet e gjëra rreth temës dhe ka krijuar temën me të cilën e informon marrësin për tërësinë e temës së trajtuar.

Një tekst tjetër gazetar, me titull "Opozita fton 1 milion njerëz në Kajro"<sup>55</sup>, ka këtë hyrje:

Protestat në Egjipt kundër regjimit të presidentit Hosni Mubarak të hënën kanë hyrë në ditën e shtatë. Policia e Egjiptit, e cila në 48 orët e fundit nuk ka qenë e pranishme në rrugë, të hënën u shpërnda në mbarë vendin. Helikopterët fluturonin mbi kokat e protestuesve, ndërsa tanket u pozicionuan në qendër të Kairos për t'i mbajtur makinat larg

sheshit Tahrir, i cili u bë pikë grumbullimi për demonstratat, që lanë të paktën 125 të vdekur. Një numër i kufizuar i policëve i mbështeti trupat e ushtrisë në hyrje të sheshit. Por, korrespondentët thonë se policia nuk u vërejt shumë pas lutjes së mësditës dhe nuk u konfrontua me mijëra njerëz, që po shkonin drejt sheshit.

Ky shkrim ndërtohet mbi një varg ngjarjesh që po ndodhnin në Egjipt, protesta të pandërprera kundër regjimit të Hosni Mubarakut, e të cilat tashmë nuk ishin lajme e as raporte të thjeshta. Protestat ishin të përditshme, i ngjanin njëra-tjetrës nga dita në ditë, nuk kishte asnjë “risi” të domosdoshme për lajmin, por edhe po të kishte “risi”, publiku anembanë botës merrte me interes të madh çfarëdo informate për ato ngjarje, e jo vetëm “risitë”. Shkrimi në shqyrtim është një përshkrim i atyre ngjarjeve, duke përmbledhur zhvillimet e një dite. Kjo është kronika.

Në të gjitha rastet kronika nuk ka të bëjë domosdo me një lajm të porsa raportuar. Lajmi i tillë duhet të pasohet me një raport që shpjegon rrethanat e ndodhjes së tij. Kronika mund të shkruhet edhe menjëherë pas lajmit, edhe më vonë, por edhe nëse nuk ka një lajm për ngjarjen lajmore. Veçanti e kronikës është përmbledhja e të gjitha detajeve të ndodhjes së lajmit apo të një ngjarje lajmore, duke i renditur sipas parimit kohor. Mirëpo, kjo nuk nënkupton se mund të shkruhet një kronikë pa pasur si pikë nisëse një lajm. Nuk ka një kronikë që nuk bartë informacion te marrësi dhe nuk ka një pikënisje lajmore. Në shembullin e parë pika nisëse lajmore ishte papunësia e madhe në Gjilan; në shembullin e dytë pika lajmore ishte mungesa e kuadrit mjekësor dhe e buxhetit për të në fshatin Fortesë; në shembullin e tretë pika lajmore ishte hapja e pritshme e gjykatës në Mitrovicë dhe kthimi i gjyqtarëve shqiptarë. Esenca e kronikës qëndron në faktin se ajo trajton temën në tërësinë e saj duke u nisur nga zhvillimi i parë te i dyti etj., sipas parimit kronologjik (kohor).

Kronika ka një strukturë të ngjashme me raportin, por dallon prej tij vetëm se i nënshtrohet parimit kohor të ndodhjes së gjërave dhe e përcjell këtë parim në strukturën tekstore. Një fakt tjetër dallues nga raporti është edhe ajo që kronika synon ta japë tërë panoramën e temës që e trajton, ndërsa raporti sjell vetëm ato fakte e ngjarje që lidhen ndikueshëm me lajmin kryesor.

Ja një shembull të kronikës dhe struktura tekstore e saj e analizuar:

Veçanti e kronikës është përmbledhja e të gjitha detajeve të ndodhjes së lajmit apo të një ngjarje lajmore, duke i renditur sipas parimit kohor.

Prishtinasit në krizë nga mungesa e çerdheve të fëmijëve <sup>56</sup>	
Prishtinë, 8 shkurt. – Dita B. nga Prishtina, lagja “Dardania”, kot ka pritur në fillim të vitit që t’i regjistrojë dy fëmijët e saj binjakë, M. dhe S., në një çerdhe publike, që të mos e ketë dert punën e përkujdesjes së tyre. Ajo ka thënë se punon në një institucion publik në Prishtinë. Sipas saj, kërkesën për regjistrimin e fëmijëve të saj e ka bërë në afat të rregullt, në çerdhen e fëmijëve “Luleverdha” në lagjen ku jeton, por, edhe pse në fillim i ishte premtuar, asnjëherë nuk ka arritur t’i dërgojë ata aty. Sipas saj, arsyetimi i Drejtorisë së çerdhes ka qenë se nuk ka pasur vende të lira.	Hyrije tipike për kronikën: fillohet me gjenezën e temës së trajtuar.
Dita B. ka theksuar se ka provuar edhe më tutje që t’ua sigurojë fëmijëve të saj çerdhen në lagjen e saj, porse e ka pasur të pamundur. Meqë nuk kam pasur zgjidhje tjetër, jam detyruar që për përkujdesjen e fëmijëve të paguaj punëtore të posaçme, ani pse kushtet tona të jetesës nuk na e lejojnë një luks të tillë”, ka theksuar ajo, për të shtuar se këtë e ka bërë që të mos e humbë vendin e saj të punës.	Kreu i kronikës
“Nga paga që marrë, më shumë se gjysmën jam duke e harxhuar për ta paguar punëtorin kujdestare për fëmijë”, ka treguar ajo.	Temë e re: financat
Probleme si Dita kanë edhe qindra prindër të tjerë të kryeqytetit, ndërsa Komuna e Prishtinës ende nuk ka treguar rezultat për të bërë zgjidhje në këtë plan. Shumë prej qytetarëve janë ankuar se çerdhet e fëmijëve kanë pranuar fëmijë nga komuna të tjera, si Fushë-Kosova e Obiliqi, duke i lënë anash fëmijët e qytetarëve prishtinas.	Material shpjegues për kreun
Kjo komunë vitin e shkuar pati shpallur konkurs për hapjen e çerdheve me partneritet publiko-privat, por një gjë e tillë nuk ka shkrepuar. Këtë e kanë pranuar edhe vetë zyrtarët komunalë. Në buxhetin komunal të vitit 2011 nuk janë ndarë mjete të posaçme për hapjen e çerdheve të reja, mirëpo zyrtarët e saj janë këmbëngulës që këtë ta bëjnë nëpërmjet partneritetit publiko-privat.	sfond
Aktualisht, në krejt kryeqytetin janë të hapura vetëm 11 çerdhe fëmijësh, 6 publike dhe 5 private. Për një fëmijë të dërguar në çerdhet publike duhet të paguhet 50 euro në muaj, kurse për ato private nga 80 deri në 120 euro.	Material shpjegues për kreun

<p>Gjendjen jo të mirë për çerdhet e fëmijëve në kryeqytet e ka pranuar edhe nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Avdullah Hoti, por ai ka thënë se Komuna do të mundohet që maksimalisht ta zbusë gjendjen.</p> <p>“Ne besojmë që tashti për tashti kërkesat e qytetarëve të Prishtinës për t’i dërguar fëmijët e tyre në institucione parashkollore mbulohen me vetëm 25 për qind.</p>	<p>Material shpjegues për kreun</p>
<p>“Ne kemi provuar nëpërmjet partneritetit publiko-privat që ta rrisim numrin e çerdheve të fëmijëve, por edhe pse kemi shpallur dy herë konkurse, nuk kemi parë se dikush nga konkurruesit i ka plotësuar kushtet për ta bërë një gjë të tillë”, ka thënë Hoti. Sipas tij, Komuna ka vënë kushte se cilat shtëpi private do të mund të ishin partnere në këtë plan.</p> <p>“Në asnjërin konkurs të shpallur nuk janë paraqitur qytetarë me kushte të përshtatshme për çerdhe.</p> <p>Ne kemi paraparë që çerdhet të jenë në katin e parë, me qëllim që fëmijët të mos rrezikohen shkallëve si dhe kushte të tjera, gjë që deri tashti nuk kemi pasur konkurrent të tillë”, është shprehur Hoti dhe ka shtuar se partneriteti publiko-privat do të mbetet ende zgjidhja më e përshtatshme për hapjen e çerdheve të reja.</p> <p>“Ne do të hapim prapë konkurs dhe presim që të kemi konkurrent, në mënyrë që të krijojmë mundësi për qytetarët”, ka thënë ai.</p>	<p>Zgjerim i sfondit</p>

Tema e kësaj kronike është mungesa e çerdheve në kryeqytetin e Kosovës. Kjo është një temë e përhershme, që zgjat me vite të tëra. Njëkohësisht, është temë të cilën gazetari dëshiron ta ngrehë, si informatë (ka mundur të shkruajë koment, kolumnë, analizë etj.). Mirëpo tema nuk mbështetet tërësisht te një lajm (e që do të ishte parakusht për raportin). Duke dashur të informojë për një temë të rëndësishme për marrësin, duke mos qenë ajo temë një fakt objektiv për lajm, e as një lajm i domosdoshëm për raportin, gazetari shkruan kronikën, duke u nisur nga një pikë lajmore (mungesa e çerdheve të fëmijëve parashkollore) dhe e trajton temën në tërësinë e saj.

## X. ARTIKULLI I VEÇANTË (FIÇËRI)

### X.1. ÇËSHTJE TË PËRKUFIZIMIT

**N**ë teorinë dhe në praktikën e gazetarisë në hapësirat anglisht-folëse dy format zhanrore informative më të përmendura janë lajmi dhe fiçëri (feature). Te kapitulli për tipologjinë gazetare kemi folur për vështirësinë e përkufizimit të fiçërit, megjithatë mund ta thjeshtësojmë këtë përkufizim në një interpretim të lirë si:

Fiçëri është një tekst i veçantë informativ, i afërt me raportin dhe me lajmin, po që dallon prej tyre edhe në strukturën tekstore edhe në qëllimin përmbajtësor: ka një strukturë tekstore më të ndërlikuar ndërsa qëllimi përmbajtësor i tij është informimi, iluminimi dhe argëtimi.

Një tekst në të cilin gazetari shkruan se cilat vitamina ndikojnë më shumë në parandalimin e gripit sezonal dhe cilat pemë duhet të konsumohen për t'i marrë ato vitamina etj., është i afërt me raportin (po shpjegon rrethanat rreth një ngjarje, që është gripi sezonal), por nuk është identik me të, sepse qëllimi përmbajtësor i këtij të fundit është iluminimi (njohja) i marrësit për mundësitë e parandalimit të gripit. Ky tekst është fiçër. Plot shkrime për mundësitë e jetës, për aventurat, për fatet individuale apo kolektive të grupeve të caktuara njerëzore, të gjitha këto me përshkrime letrare po mbi ngjarje të vërteta, të cilat sjellin informacione, iluminojnë dhe argëtojnë, janë shkrime të tipit fiçër. Po ashtu, shkrimet shkencore-popullore janë të të njëjtit zhanër. Duke qenë se gazetaret gjithnjë kanë botuar dhe vazhdojnë edhe sot të botojnë, këtë lloj shkrimi informativ do ta trajtojmë më gjerësisht. Para se të kalojmë te tema e tij, te struktura tekstore dhe qëllimi përmbajtësor, duhet ta shqyrtojmë edhe një herë vështirësinë emërtuese e përkufizuese të tij si dhe zhvillimin e tij historik.

Jo pa rezervë pranohet nocioni fiçër edhe në traditën anglisht-folëse. Mencheri, për shembull, i kushton një kapitull këtij lloji (përkthyesi i tij në shqip ka përdorur emërtimin *tregim i veçantë*).<sup>57</sup> Sipas tij, tregimet e veçanta synojnë të argëtojnë me anë të materialeve interesante, por jo me doemos të rëndësishme. Mandej, edhe lajmet që nuk janë shumë të rëndësishme mund të shkruhen si tregime të veçanta. Tregimet e veçanta janë shikuar me dyshime nga redaktorët: janë apo jo të denja ato të botohen? Në revolucionin e parë teknologjik në gazetari, në vitet e tridhjeta të shekullit XIX, tregimet e veçanta janë shikuar me dyshime dhe përbuzje.

### PËRMBAJTJA

X. Artikulli i veçantë (fiçëri) . . . . .	173
X.1. Çështje të përkufizimit . . . . .	173
X.2. Lloje të artikullit të veçantë (fiçërit) . . . . .	176
X.2.1. Artikulli shken- cor-popullarizues. . . . .	176
X.2.2. Artikulli për për- ditshmërinë (Lifestyle feature). . . . .	177
X.2.3. Artikulli sensacio- nal. . . . .	180
X.2.4. Artikulli i sfondit (backgrander) . . . . .	181
X.2.5. Artikulli për fatet njerëzore (Human interest Story) . . . . .	182

Emërtimin fiçër duhet ta mësojë përmendësh shqipfolësi: përveç tingëllimit të rëndë fonik, edhe vetë kuptimi i tij-tipar, nuk është i përshtatshëm për të emërtuar një objekt të veçantë, pasi që çdo objekt e çdo gjallesë ka ndonjë apo disa tipare. Prandaj, mënyra më e mirë është ose të mësohet përmendësh, ose të përdoret forma e shqipëruar dhe e përshtatur: artikulli i veçantë apo tregim i veçantë.



Tregime për krimet, sportet, shoqërinë, lajmet shkencore - të gjitha të zbuluara me detaje sensacionale, më shumë të shpikura sesa të vërteta - zinin sipërfaqe të mëdha nëpër gazeta, për të tërhequr sa më shumë lexues. Ky lloj tregimi i veçantë u bë sinonim me shprehjen Gazetari e Verdhë.<sup>58</sup> Përkundër kësaj, botimi i tyre e rriste tirazhin e gazetave, e duke qenë se në gazetarinë amerikane gazetat mbijetonin nga tregu, ky zhanër bëhej gjithnjë e më imponuese edhe për gazetat "serioze" e jo vetëm për shtypin e qindarkave.

Duke e pranuar seriozitetin e tregimeve të veçanta, bordi këshillues i çmimeve Pulitzer vendosi që në vitin 1978 të krijojë një kategori të re çmimi, për shkrimin e tregimeve të veçanta. Motivacioni është: "Për një shembull të spikatur të shkrimit të veçantë, duke i dhënë përparësi cilësisë së lartë letrare dhe origjinalitetit".<sup>59</sup>

Matthew Ricketson në librin e tij *Writing Feature Stories/how to research and to write newspaper and magazine articles* (2004) dallon 12 lloje të fiçërit.<sup>60</sup>

1. Colour Story (*rrëfim i gjallë*: tekst që sjell një skenë, një pjesë jete, atmosferën apo përjetimin nga një ngjarje);
2. Human interest Story (*rrëfim me interes njerëzor*: tekst për fatet e njerëzve, për veprimet e tyre, për aventurat e tyre);
3. News feature (*rrëfim lajmor, i afërt me kronikën*: është fiçëri më i njohur dhe më i pranishëm. Fillon nga lajmet e ditës dhe vazhdon duke i shpjeguar, i zgjeron me më shumë informacione, i komenton dhe i parashikon pasojat e mundshme);
4. Backgrounder (*rrëfim sfondi*: variant i news feature-it. Tregim që ofron njohje më të thellë e më të gjerë për prapavijën e një lajmi);
5. Lifestyle feature (*rrëfim nga jeta e përditshme*: feature-i më i pëlqyeshëm te lexuesit. Shkrim për jetën, për gjërat e rëndomta në jetë, për konformitetin dhe përparësitë e mundësitë e jetës);
6. Travels Stories (*rrëfim udhëtimi*: shkrim për rrugëtime, për anë të ndryshme të botës);
7. General feature (*rrëfim i përgjithshëm*: shkrim midis të gjitha formave të tjera të feature-it. Tregim i përgjithshëm për një temë, nga e cila dalin tema, çështje, interesa apo pasoja të tjera. Për shembull: shëndeti i një punëtori mund të dërgojë në fakte për helmet që lëshon një fabrikë);
8. Interview piece (*intervistë*);
9. Profile (profilet e njerëzve të ndryshëm);
10. Investigative feature (*rrëfim hulumtues*: shkrim që hulumton deri në thellësi një temë, kryesisht temë qeveritare apo biznesore e cila mbahet larg apo nuk njihet nga publiku);
11. Columns (shkrim i famshëm, me temë e formë të ndryshme, por që lidhet me famën e autorit);

12. Reviews (*recension*: vështrim apo shqyrtim për një vepër arti, letërsie, kulture, muzike, sporti etj.).

Ricketson, në përputhje me traditën e teorisë gazetare anglisht-folëse, nuk bën një tipizim të prerë zhanror të fiçërit (aty fut intervistën, recensionin e ndonjë tjetër), por disa prej llojeve të tij të fiçërit janë shumë të pranishëm në secilën gazetë. **Color story**, **backgrounder**, **lifestyle feature** etj. janë tekste pa të cilat gazeta moderne, në një konkurrencë tepër të madhe, as që mund të paramendohet. Ato tashmë nuk janë shkrime që duhen parë me dyshime, por të domosdoshme për secilën gazetë. Edhe gazetatat shqipe janë të stërmbushura me këto lloj fiçërash.

Në traditën e gazetarisë shqipe, as në teori e as në praktikë, nuk ka një pranim të nocionit fiçër e, po ashtu, nuk ka një nocion tjetër që shpreh atë kuptim të fiçërit. Mungon edhe vetë përkufizimi i shkrimit të tillë. Hamit Boriçi ka provuar të hapë një diskutim të ngjashëm në librin e tij *Gazetaria 2* (2004), por ajo provë ka mbetur e pavërejtur. Boriçi e përdor nocionin *përshkrim*<sup>61</sup> për një lloj të tekstit gazetar dhe provon ta përkufizojë si lloj teksti zhanror: "Përgjithësisht, përshkrimi si zhanër gazetar konceptohet si një mënyrë e paraqitjes së realitetit, pamje e saj apo tipa shoqëror me ngjyra të gjalla". Pastaj Boriçi tipizon dy lloje të përshkrimit: përshkrimin epik (rrëfyes) dhe përshkrimin problemor.

Problemi i këtij përkufizimi të Boriçit është se ai bën vetëm një përkufizim të përgjithshëm, aq sa nuk mund të kuptohet se çka është përshkrimi (paraqitje e realitetit...me ngjyra të gjalla!) dhe, së dyti, ai e trajton këtë si formë publicistike, pra si gazetari letrare, edhe pse shembujt që ai sjell dhe mënyra e përkufizimit të mëtejme na bëjnë me dije se ai është duke folur ashiqare për një lloj të tekstit gazetar që është informativ, por i shkruar me një gjuhë të gjallë e letrare. Ndoshta emërtimi që përdor përkthyesi i Mencherit në shqipe, **tregim i veçantë** (ose: **artikull i veçantë**), mund të jetë më i përshtatshmi edhe për gjuhën shqipe, por edhe më afër përmbajtjes së fiçërit anglisht. Në shqyrtimin tonë në vazhdim, duke pasur problemin e nocionit, ne do t'i përdorim dy nocionet: artikull i veçantë dhe fiçër, në mënyrë të barasvlershme. Po ashtu, do t'i hulumtojmë praktikën e shkrimit të artikujve të veçantë në gjuhën shqipe duke u shërbyer me teorinë anglishtfolëse për tipizimin e fiçërit. Disa prej këtyre llojeve, si intervista, artikulli investigativ, recensionin, profili, udhëpërshkrimi dhe pjesërisht edhe **news feature** (i cili i afrohet tërësisht përkufizimit tonë për kronikën) ne i trajtojmë si lloje të veçanta zhanrore të gazetarisë analitike dhe publicistike, prandaj nuk do t'i trajtojmë si fiçër.

Na mbetet ta diskutojmë edhe një çështje zhanrore para se t'i trajtojmë veçanërisht disa nga llojet e artikujve të veçantë: problemi

i qëllimit përmbajtjesor të artikullit të veçantë, e i cili parim edhe e përcakton zhanrin e një teksti gazetar. Të gjithë autorët që e trajtojnë fiçërin e dallojnë nga lajmi: fiçëri nuk është lajm. Dallimin e bën më të madh edhe përdorimi i gjuhës së letërsisë në artikullin e veçantë. Ricketsoni e dallon edhe në strukturë tekstore: lajmi është piramidë e përmbysur, ndërsa artikulli i veçantë është kre i vonuar. A është informim apo argëtim artikulli i veçantë? Nëse e vendosim artikullin e veçantë midis lajmit (gazetaria informative) dhe fjalëkryqit (gazetaria argëtuese), atëherë ai gjithsesi është më afër lajmit dhe gazetarisë informative dhe, gjuha artistike dhe prireja për argëtim, nuk e bën gazetari argëtuese, prandaj edhe do ta trajtojmë në kuadër të gazetarisë informative.

Artikulli shkencor-popullarizues  
 Artikulli për përditshmërinë  
 (Lifestyle feature)  
 Artikulli sensacional  
 Artikulli i sfondit (Backraunder)  
 Artikulli për fatet njerëzore  
 (Human interest Story)

## X.2. LLOJE TË ARTIKULLIT TË VEÇANTË (FIÇËRIT)

### X.2.1. ARTIKULLI SHKENCOR-POPULLARIZUES

Është një lloj shkrimi mjaft i pranishëm në gazetarinë shqipe. Qëllimi përmbajtjesor i tij është informativ dhe iluminues. Artikulli shkencor popullarizues trajton një temë shkencore duke e përshtatur për nevojat e përditshme të njerëzve ose, në rastin tjetër, trajton një temë të përditshmërisë duke e ndërlidhur me analizën shkencore. Kështu, në artikullin “Zukatja e cila nuk ndalet” trajtohet zukatja e përhershme në veshë, një sëmundje kjo që quhet tinitis, e prej së cilës vuajnë rreth 10 % e njerëzve. Autori së pari e përshkruan sëmundjen, i trajton shkaktarët e saj, mënyrën se si bëhet diagnostikimi dhe shërimi i saj. Një pjesë e artikullit është e shkruar si udhëzime se si duhet trajtuar kjo sëmundje nga personat që vuajnë prej saj.

Një tjetër lloj i artikullit shkencor popullarizues është ai që trajton një çështje nga jeta e përditshme, duke e parë atë në prizmin e shkencës. Kështu, në artikullin “Rreziqet e lëngut të freskët” gazetari shkruan për pijen e adhuruar nga “natyralistët”: lëngun e freskët, të shtrydhur nga frutat. Ekziston bindja se sa më shumë lëngje të tilla të pish i bën mirë shëndetit të njeriut. Autori i artikullit thotë ndryshe: edhe ai lëng mund të jetë i rrezikshëm për shëndetin, nëse pihet pa masë dhe pa rend. Pastaj shpjegon se ekspertët shëndetësorë tregojnë se cilët persona që kanë probleme me akëcilën sëmundje guxojnë apo nuk guxojnë ta konsumojnë akëcilin lëng frutash.

Artikuj të këtillë ka plot në gazeta. Edhe në gazetatat shqipe është duke u rritur numri i tyre. Nuk ka numër të gazetës në të cilin nuk

do të gjeni disa artikuj të këtillë. Mjafton t'i shikojmë vetëm disa nga titujt e këtyre artikujve:

- Pagjumësia ndikon keq në shëndet dhe lidhje dashurie
- Shkyçeni celularin gjatë natës
- Kafjalli i bollshëm nuk zvogëlon sasinë e kalorive
- Sa duhet të flemë?
- Shkencëtarët zbulojnë ilaç të ri kundër sëmundjes së Alzheimerit
- Pasojat e rënda të mungesës së vitaminës D
- Ju ka "shkelur" lodhja kronike? Largojeni me katër hapa!
- Perimet e ruajnë shëndetin
- Interneti- i mbushur ding
- Sony HX100V dhe HX9V
- Vaji i kokosit në shërbim të bukurisë
- Cilin do ta flakni tutje: kabllovikun, internetin apo celularin?
- Motorola Daytona në përgatitje
- HTC me Facebook Phone?

Edhe vetëm nga shikimi i këtyre titujve mund të paragjykohet prania e madhe e këtij lloji të tekstit në gazetat shqipe. Po ashtu mund të paragjykohen edhe dy llojet e tij. Vlen të theksohet se gazetarët shqiptarë nuk i shkruajnë vetë këta artikuj, por i marrin të gatshëm prej ueb faqeve të ndryshme botërore, përndryshe nuk është i lehtë shkrimi i një artikulli të tillë, si psh. Sa duhet të flemë? Për një shkrim të tillë duhet konsultuar së pakut me disa ekspertë të njohur të gjumit, të pagjumësisë dhe të ndikimit të tyre në shëndetin e njeriut. Duke qenë se në vendet e mëdha e të zhvilluara shumë ka ekspertë të fushave e të nënfushave, atje është më lehtë të kontaktohet me këta ekspertë dhe si rrjedhojë, më lehtë të shkruhet artikulli i shkencës popullore.

## X.2.2. ARTIKULLI PËR PËRDITSHMËRINË (LIFESTYLE FEATURE)

Është një prej teksteve më të dashura për lexuesin mesatar të gazetave. Por jo të gjitha gazetat botojnë këtë lloj të artikullit: ato që synojnë ta ruajnë imazhin e gazetës informative hezitojnë ndaj këtij lloji shkrimi. Kështu, derisa *Kosova sot* boton në çdo numër nga disa prej këtyre artikujve, *Koha ditore* nuk boton asnjëherë. Artikulli për përditshmërinë është shkrim për jetën, për gjërat e rëndomta në jetë, për konformitetin dhe përparësitë e mundësitë e jetës. Në përgjithësi, ky lloj trajton tema të lehta, të përditshme. Qëllimi përmbajtësor i tij është të informojë dhe të argëtojë. Artikulli "Si të zgjoheni në mëngjes dhe të filloni një ditë të suksesshme"<sup>64</sup> është fokusuar në disa këshilla se si mund të organizohet suksesshëm një

**Këto janë shenjat që ju nuk po kujdeseni për vetën tuaj**



Dinamika e jetës ju imponon që të harroni vetën tuaj. Madje ju nuk e vëreni që keni lënë vetën anash, Gazeta Express transmeton disa shenja se si ta vëreni se keni harruar vetën tuaj

**Ti nuk e pranon se kush je**

Nganjëherë shoqëria nuk na pranon ashtu siq jemi, kështu që në kemi presion të bëhemi dikush që nuk jemi. Kështu që ti nuk mund të bëhesh dikush që nuk je krenar me vetën.

**Të mungon pasioni**

Pasioni është shumë i rëndësishëm në jetë. Nuk ke nevojë të jesh i pasionuar për të ushqyer të uriturit apo për ta ruajtur botën. Mund të jesh i pasionuar pas çdo gjëje, mos u frikëso nga mendimet e tua, transmeton Gazeta Express.

Vëmëndja juaj nuk reflekton mbi idetë e tua.

**Ti ke hequr dorë nga ëndërrat e tua**

Mos hiqni dorë nga synimet dhe ëndërrat e juaja. Mos i injoro kërkesat personale.

ditë, si: zgjohuni me kohë, hani mëngjes të shëndetshëm, planifikoni ditën, reduktoni ndërprerjet, mos u humbni etj. Artikulli "Kur vëllai apo motra janë më të mirë"<sup>65</sup>, me nëntitullin "Mos mendo për veten tënde se je më i keq se motra a vëllai, vetëm pse nuk je aq i zoti sa ata". Po ashtu, trajton temën e marrëdhënieve midis vëllezërve dhe motrave në konkurrencë për të qenë më i zoti.

### Në Odensa, aty ku 5-vjeçarët shkojnë në shkollë më biçikletë



**Qyteti danez me 200 mijë banorë ka këmbëngulur fort që të inkurajojë pedalimin dhe të ndërtojë një rrjet rrugor që e bën tepër të lehtë të ngasësh një biçikletë. Nga 1 mijë kilometra rrugë në total, 545 prej tyre janë të ndara vetëm për të pedeluar**

Kur fëmijët nisin klasën e parë në Odensa të Danimarkës, gjatë janë të mëdha që ata të udhëtojnë drejt shkollës vetëm me biçikletë, dhe jo të dërgohen me makinë nga prindërit e tyre. Madje ka disa shkolla ku automjetet nuk janë fare të mirëpritura. Për drejtuesit e këtyre institucioneve edukuese është e pasigurt për qindra fëmijë të cilët zgjedhin të ecin apo të pedalojnë për të ardhur aty. Policia do të gjobisë të gjithë ata prindër të cilët kanë guximin që të parkojnë përpara shkollës. Në qytetin në të cilin banojnë rreth 200 mijë persona, katër nga pesë fëmijë pedalojnë, ecin apo shkojnë në shkollë me skejtboard. Në SHBA, e njëjta gjë ishte më se e zakonshme deri në vitin 1969, ku gati gjysma e të gjithë nxënësve të fillores dhe gjimnazit në shkollë shkonin duke ecur, apo me biçikletë. Por deri në vitin 2009, ky numër është tkurur me 13%. Edhe pse, shumë fëmijë amerikanë prapë po zgjedhin që të lëvizin me dyrrrotakë, sërish shumica e fëmijëve amerikanëve preferojnë që prindërit t'i çojnë me makinë në shkollë. Edhe në Danimarkë, shtet i cili konsiderohet si ideal për të lëvizur me biçikleta, përqindja e atyre fëmijëve që zgjedhin të lëvizin me makinat e prindërve po rritet. Shifrat thonë se në 30 vitet e fundit, kjo tendencë është shtuar 200% më shumë. Përgjatë lëvizjes ditore më shumë se 1/3-a e fëmijëve nuk bëjnë asnjë lloj stërvitjeje.

Por Odensa ka këmbëngulur fort që të inkurajojë pedalimin dhe të ndërtojë një rrjet rrugor që e bën tepër të lehtë të ngasësh një dyrrrotak.

"Ne kemi 545 kilometra të rrugëve të ndara vetëm për të pedeluar, dhe për të bërë një krahasin, ne kemi 1 mijë kilometra rrugë", tha Connie Juel Clausen, planifikuese e qytetit për trafikun. "Pra, kjo do të thotë se ne kemi mjaft rrugë, vetëm për të pedeluar në Odensa".

Madje edhe rrugët të cilat nuk kanë hapësira të ndara për çiklistët janë mjaft të sigurta për fëmijët që të lëvizin aty. Dhe kjo sepse numri i atyre që përdorin biçikleta është i madh, duke bërë që shoferët të jenë mjaft të kujdesshëm. Kur dikush

me dyrrrotak i afrohet një kryqëzimi të madh, ata zakonisht ose e kalojnë atë duke u futur në një tunel, ose përdorin një urë që i jep mundësinë të pedalojnë sipër.

"Ne nuk e konsiderojmë një kryqëzim me një semafor si të sigurt për fëmijët", vazhdoi Clausen.

Vajza e punonjës bashkiake nisi që të përdorte biçikletën për të ikur në shkollë vetë, kur ajo ishte 6 vjeçe, diçka që nuk konsiderohet e pazakontë në këtë qytet danez. "Sigurisht, kjo varet nga fakti se sa të vegjël janë fëmijët dhe gjithashtu se sa të zgjuar janë ata", shtoi ajo. "Ka të bëjë me situatën. Por në shumë shkolla ne kemi një rrjet rrugësh për të pedeluar që është aq i sigurt, sa fëmijët të shkojnë vetë në shkollë pa pasur asnjë problem".

Kur fëmijët në Danimarkë nisin kopshtin, ata mësojnë se si të ngasin biçikletën në parqet e lojërave. Bashkia gjithashtu menaxhon një program të quajtur "Shkolla e lumtur e pedalimit", ku ka bashkëpunim me institucionet edukuese fillore, për t'u mësuar ngadalë fëmijëve se si të jenë të zotë të lëvizin me biçikleta edhe në trafik.

"Sigurisht që disa prej prindërve janë të shqetësuar. Ideja në projektin 'Shkolla e lumtur e pedalimit', qëllimi, është që t'u fregohet prindërve se sa i zoti është fëmija i tyre. Nëse ai ose ajo arin që të ngasë biçikletën nëpër qytet përgjatë orëve të këtij trajnimi, ndoshta ai ose ajo mund të ikë vetë në shkollë me dyrrrotakë", shpjegoi Clausen.

Bashkia gjithashtu inkurajon vogëlushët që të pedalojnë sa më shumë nëpërmjet programit "Regjistrimi i pedalimit", ku përdoret një kontrollues elektronik në pika të veçanta, për t'u dhënë fëmijëve bileta lotarie sa herë ata kalojnë aty. Me këto bileta çiklistët e vegjël mund të fitojnë çmime si aksesorë biçikletash ose bluza.

Programi përdoret nga dhjetë shkolla të qytetit dhe deri tani ka funksionuar. Që prej vitit 2014 kur nisi, lëvizjet me biçikleta janë rritur me 28% dhe 7% e fëmijëve, të cilët shkonin në shkollë me makinat e prindërve, tani përdorin dyrrrotakët.

Në klasën e katërt apo të pestë, kur nxënësin bëjnë ekskursione, ata pedalojnë për të shkuar në vendet jashtë qytetit, duke braktisur autobusin e shkollës.

Por edhe shumë të rritur të qytetit e pëlqejnë biçikletën. Për njerëzit që jetojnë në Odensa, shkuarja në punë, mbarimi i porosive të ndryshme, ose dalja për shëtitje bëhet duke përdorur dyrrrotakun.

Qëllimi i zyrtarëve lokalë të Odensës është që të risin edhe më shumë përdorimin e këtij mjeti. Duke qenë se në qytet rritet i rrugëve për biçikleta është shumë i mirë, tani ata janë të përqendruar që ta bëjnë pedalimin si lëvizjen më të leverdishme, duke shtuar vende të posaçme parkimi për këto mjete. Odensa gjithashtu po përpiqet që ta ngrejë edhe më shumë numrin e nxënësve që përdorin biçikletat, edhe pse përqindja e fëmijëve që pedalojnë në këtë qytet është më e larta në Danimarkë.

Tani së fundmi ata thonë se 90% e fëmijëve të qytetit mund të ecin, pedalojnë apo përdorin skejtboardin a patina për të ikur në shkollë.

<http://www.gazeta-shqip.com/lajme/2016/03/07/ne-odensa-aty-ku-5-vjecaret-shkojne-ne-shkollë-me-biciklete/>

T'i shikojmë disa tituj të artikujve nga përditshmëria:

- - Me babin në rekreacion, me mamin në shopping
- - Sekretet e vogla të vajzave të pa rezistueshme
- - Sinjalet e femrave
- - Tatuazhet - një kujtim i paharruar

Në këtë lloj hyjnë edhe artikujt për modën, për jetën e personave të famshëm. Qëllimi përmbajtjesor i këtyre të fundit është informimi me mundësitë e mëdha të jetës, me fatet e njerëzve të famshëm etj. Kështu në artikullin "Mbretëreshat e stilit"<sup>66</sup> jepen katër intervista me katër yje të modës e të filmit ku flitet vetëm për stilin e veshjes (Selena Gomez: "Këpucët janë dobësia ime"; Ema Uotson: "Nuk kam nevojë për stilit!"; Piksi Lot, vajza urbane; Kristen Stjuart-e shkujdesur por e pa rezistueshme!)

- T'i shohim disa nga titujt e shkrimeve të tilla:
- Dhjetë këshillat kryesore të modës
- Dasma brilante e Arta Prekazit

Në këtë tip artikulli të veçantë mund t'i klasifikojmë edhe artikujt për thashethemet dhe për përditshmërinë e jetës së yjeve të estradës. Të këtilla janë "lajmet" e shumta nga shou "Big Brother" si, p.sh..<sup>67</sup>

- Po mënjanohem nga Petriti
- "Këtë javë dal unë"
- Ogreni dhe Jonela, bisedë ironikë
- "Ke diçka brenda teje që nuk ma shprehë"
- Ogreni i ulët
- Acarohet me Ogrenin dhe Petritin

Disa prej gazetave shqipe kanë krijuar rubrika të veçanta dhe u kushtojnë faqe të tëra këtyre teksteve. *Express* ka rubrikën Rozë, *Kosova sot* ka rubrikën VIP, *Infopress* ka rubrikën Mesi i artë etj. Këto faqe janë të mbuluara me fotografi të shumta të yjeve të filmit e të muzikës. Ja disa nga titujt e artikujve të veçantë *Lifestyle feature* të këtyre rubrikave<sup>68</sup>:

- Kristina Agilera ngatërron tekstin e himnit
- Eva Longoria është në lidhje të re?
- Lopez përpiqet të flejë tetë orë
- Sheril duhet të heq dorë nga tatuazhet
- Longoria e Parker edhe zyrtarisht të ndarë
- Eva Longoria është parë duke u puthur në park
- Portman, një shtatëzënë elegante
- Pa shkollë, por yje



### X.2.3. ARTIKULLI SENZACIONAL

#### Treni që udhëton për vetëm një pasagjer

Treni i bën vetëm dy ndalesa – një kur një nxënëse e shkollës së mesme shkon në shkollë dhe një tjetër kur ajo kthehet.

Për vite të tëra, treni në stacionin Kami-Shirataki në Japoni ndalet vetëm për një nxënëse, nxënëse kjo e cila udhëton çdo ditë për në shkollë.

Treni ndalet vetëm dy herë në ditë në këtë stacion – njëherë për ta marrë vajzën nga aty dhe herën tjetër për ta lënë atë përsëri aty kur shkolla të përfundojë, transmeton GazetaExpress.

Duket si një film i dhimbshëm, por sipas CCTV News, ky ishte një vendim që Hekurudhat Japoneze e morën – grupi i cili menaxhon rrjetin e hekurudhave në Japoni, vendim ky që u morr më shumë se tri vite më parë.

Ata dëshiruan që ta mbyllin këtë stacion për shkak të mungesës së njerëzve, por më pas e vërejtën se treni po përdorej nga një vajzë për të shkuar në shkollë. Kështu, ata vendosën që ta mbajnë stacionin të hapur derisa ajo ta përfundojë shkollën.

Kompania madje ka rregulluar orarin e ardhjes së trenit sipas kohës që ajo dëshiroi. Vajza e panjohur pritet që të diplomojë këtë mars, dhe atëherë ky stacion do të mbyllet përgjithmonë.

(<http://www.gazetaexpress.com/fun/treni-qe-udheton-per-vetem-nje-pasagjer-foto-158577/>)

Artikulli sensacional informon për një çështje të papritur, sensacionale, për diçka që marrësi nuk e pret në asnjë moment. Qëllimi përmbajtjesor i këtij artikulli është emocionimi (krijimi i habitës dhe i sensacionit) dhe informimi. Marrësi merr informacionin, por ai në vend se ta informojë për një situatë të caktuar, krijon habi dhe dyshime edhe më të mëdha. Kështu, në artikullin “Mona Lisa është mashkull?”<sup>69</sup> tregohet se Silvano Vinceti pretendon se ka zbuluar arketipin e Mona Lizës, dhe se arketipi nuk është zonja Liza Gherardini, gruaja e tregtarit të madh të mëndafshit, si e di gjithë bota, po është një mashkull me emrin Gian Giacomo Caprotti, një mjeshtër i Renesancës. Gjithë artikulli mbështetet në argumentimet e Silvano Vincetit, për të cilin thuhet se është në krye të një ekipi studimor, por nuk tregohet se çfarë specialisti është. Vetëm në fund të artikullit gazetari citon Pietro Maranin, doktor i historisë së arteve, autor i shumë librave për Leonardo Da Vinçin, i cili thotë se “Vincete nuk e di se çfarë është duke thënë. Ai mund të jetë edhe në gjumë”.

Ja një artikull sensacional i shkurtër:

#### E mbyti gjeli

Një burrë, i cili ishte duke e përcjellë një turnir të luftës së gjelave në Kaliforni, ka vdekur pasi që është çokitur nga një gjel, kanë thënë zyrtarët policorë të Kalifornisë. Gjeli ka pasur një thikë të vënë në krahë, si pjesë e luftës me hile që ei bëjnë pronarët e gjelave. Jose Luis Ochoa (36) është shpallur i vdekur nga spitali në të cilin kishte shkuar. Kjo kishte ndodhur dy orë pasi ai ishte plagosur. Sipas raportit të mjekut, ai ka vuajtur nga një “lëndim në pulpin e këmbës”. “Kurrë nuk kam parë një tip të tillë të incidentit!”, ka thënë Martin King që punon në departamentin e policisë në Kaliforni. Lufta e gjelave është e ndaluar në SHBA.<sup>70</sup>

Në artikull nuk thuhet nëse lëndimi nga gjeli ishte shkak i vërtetë apo shkak i vdekjes së personit në fjalë, sepse qëllimi i gazetarit ka qenë jo vetëm të informojë, por edhe të habitë, prandaj edhe i ka vënë titullin “E mbyti gjeli”.

Një tjetër lloj i këtij artikulli është edhe ai që nuk ka për qëllim habitjen dhe sensacionin, por nga vetë informacioni që sjell krijohet sensacioni. Një artikull i tillë është ai me titull “Qentë mund të nuhasin tumorin në fazë të hershme”<sup>71</sup>, e në të cilin tregohet për disa eksperimente të cilat dëshmojnë se disa lloje të qenve (labradori, qeni portugez i ujit etj.), përmes nuhatjes, mund ta zbulojë tumorin në fshikëz, në lëkurë, në mushkëri, në gji dhe në vezorë të njeriut.





Artikulli sensacional është më i rrallë në gazetari, ashtu edhe në gazetarinë shqipe. Edhe dhënësi edhe marrësi e dinë se ai nuk besohet por, megjithatë, botohen kohë pas kohe, mbase për ta nxitur kureshtjen e marrësve për gazetën.

#### X.2.4. ARTIKULLI I SFONDIT (BACKGRAUNDER)

Sfondi ka të bëjë me të kaluarën e lajmeve dhe mbi këtë element është krijuar artikulli i sfondit, i cili trajton tema dhe ngjarje të “sfondit” po, në fakt, atë sfond e shndërron në temë kryesore të artikullit. Këtu fjala sfond duhet të kuptohet më gjerësisht se ajo që shpreh nocioni sfond i lajmit: këtu sfond paraqet informacione të dorës së dytë në raport me një informacion të parë, por të cilat paraqesin interes të madh për lexuesin. Qëllimi përmbajtjesor i artikullit është informimi dhe shpjegimi i rrethanave të cilat janë shkak apo pasoja e lajmit kryesor. Në artikull mungon “lajmi kryesor”, sepse artikulli trajton ngjarje nga sfondi. Kështu, në margjinë të protestave në Egjipt kundër qeverisjes së Hosni Mubarakut, gazetari ka shkruar artikullin “Jeta e fshehtë e dinastisë Mubarak”<sup>72</sup>, në të cilin tregohet për mënyrën e jetës së familjes së presidentit Mubarak në Paris e në Londër. Në raport me protestat, kjo temë është sfond krejtësisht i parëndësishëm, por gazetari duke e trajtuar atë temë krijon imazhin jo vetëm për jetën, por edhe për mënyrën e qeverisjes së Mubarakut, e kjo ndërlihet shkak-pasojë me protestat.

Artikull i sfondit është edhe ai me titull “Të gjithë e nderojnë ‘vajzën lodër’ të Putinit”<sup>73</sup>. Në këtë artikull tregohet për sukseset e Ana Chapmanit, agentja ruse në ShBA, e cila u zbulua në vitin 2009, ndërsa tash, me marrëveshje amerikano-ruse, është kthyer në atdhe dhe ka marrë një post në Bankën e Ruisë, udhëheq një emision televiziv dhe suksese të tjera, të “përkrahura” nga presidenti dhe kryeministri i Ruisë. Një tjetër ish-spiune ruse, Natalia Pereverzeva, pas kthimit në atdhe, është bërë ndihmëse e presidentit të gazsjellësit Transnaft. Spiuni tjetër Andrej Bezrukovi u emërua këshilltar i drejtorit të kompanisë së naftës Rosnaft. Gazetari nuk jep asnjë përfundim të tij për tërë këtë proces, por e lë të kuptojë secili lexues në mënyrën e tij. Pavarësisht nga kuptimet personale, një gjë është e sigurt në këtë artikull: nëse Rusia i nderon kaq shumë ish-spiunët e saj në ShBA, kjo ka të bëjë parësisht me marrëdhëniet Rusi - ShBA. Ky edhe është aluzioni i artikullit.

### X.2.5. ARTIKULLI PËR FATET NJERËZORE (HUMAN INTEREST STORY)

Është lloj i artikullit që trajton fatet jetësore të individëve apo edhe të grupeve të ndryshme, e të cilat janë interesante, të pazakonshme apo edhe tragjike. Qëllimi përmbajtjesor i artikullit është emocionimi dhe informimi, me qëllim të tërheqjes së vëmendjes së opinionit në një çështje. Kështu, në artikullin “Një histori tragjike” të gazetarit Nebih Maxhuni tregohet fati tragjik i Bajram Lahut, të cilin në vitin 1984 e vret shtehtas sigurimi shtetëror serb dhe pastaj e torturon gjithë familjen e tij duke e akuzuar se ata e kanë vranë birin e tyre. Pas pesëmbëdhjetë muaj hetime dhe tortura, gjykata e liron Raif Lahun, xhaxhanë e Bajramit, si të pafajshëm. Tërë kjo ngjarje ndërldidhet me prapavijën politike, sepse Bajram Lahu ka qenë veprimtar i lëvizjes për çlirimin e Kosovës. Policia për t’i maskuar gjurmët e krimin politik inskenon gjoja hetimet se Bajrami është vranë nga familja e tij. Si shihet, në artikull tregohet për fatin e Bajram Lahut, por në prapavijë të tij është marrëdhënia e pushtetit me qytetarët e vet.



Artikull për fatet njerëzore

#### **Nëna e Farkhudas: “Mizori përtej imagjinatës”**

Nëntë muaj pasi iu vra vajza nga një turmë njerëzish në Kabul, për Hajera Bibi, emocionet janë ende të freskëta.

Farkhunda Malikzada, 27 vjeçare, u rrah për vdekje më 19 mars të këtij viti. Ajo gabimisht u akuzua për djegjen e kopjes së Kuranit ndërsa trupi i saj u marr nga një veturë dhe u dërgua për t’u djegur afër një vendi të shenjtë në kryeqytetin afgan. Hajera Bibi është zhvendosur në Tashkistanin fqinj, ku tashmë ajo jeton së bashku me familjen e saj, në një banesë të marrë me qira, në një lagje të qetë të Dushanbe.

“Ajo është gjithmonë në mendjen time, unë ende e shoh fytyrën e saj dhe më duket sikur ka ndodhur dje”, tha ajo në një intervistë, dhënë shërbimit të Tashkistanit të Radios Evropa e Lirë. Ajo tha se flokët i janë zbardhur që kur Farkhunda u vra. “Si është e mundur që në tokë të vritet një grua në mënyrën qysh është vranë ajo?”, pyet Hajera. “Ky nivel i mizorisë nuk ka ndodhur në asnjë vend të botës”.

Vrasja e Farkhunda Malikzada kishte ngjallur protesta të shumta në Afganistan, ndërsa rasti i saj ishte dënua nga mbarë bota. Teksa fshin lotët, Hajera Bibi kujton ditën kur Farkhunda u largua nga shtëpia, për të shkua në mësimet fetare, duke i thënë familjes se do të ndalej “në Universitet për të kryer disa punë formale”. “Në mesditë kam biseduar me të në telefon dhe ajo më tha: Nënë, unë jam rrugës për në shtëpi”, kujton Hajera Bibi.

Rrugës për në shtëpi, Farkhunda, një studente për fe dhe një myslimane e devotshme, sipas nënës së saj, ishte ndalur për

t'u lutur në vendin e shenjtë Shah-e Do-Shamshera. Sipad dëshmitarëve okularë, Farkhunda kishte pasur një debat me kujdestarin e tempullit, mbi disa letra që përmbanin vargje nga Kurani, e të cilat shiteshin nga disa njerëz si "letra me ndikim shërues" për të sëmurët.

### Akuzat false

"Farkhunda i cilësonte hajmalitë si joislamike", tha Hajera Bibi. Kujdestari i tempullit e akuzoi atë se e ka djegur një kopje të Kuranit, një pretendim nga ai, që nxiti sulmin dhe vrasjen e saj. Pamjet e tmerrshme të incizuara nga telefonat mobil, paraqesin Farkhundën të veshur me një mbulesë të zezë, duke u tërhequr zvarrë dhe duke i lutur sulmuesit që të ndalonin. Sulmi, i cili përfundoi me djegien e trupit të saj dhe hedhjen në lumin e Kabulit, u zhvillua në mes të ditës dhe në prani të policisë.

Familja e ka shfaqur pakënaqësinë e saj për mosveprimin e policëve, të cilët ishin në detyrë, në zonën ku ka ngjarë krimi. Por, Hajera Bibi thotë se është tronditur më shumë kur organet e policisë në natën e sulmit, e kishin udhëzuar familjen që t'u thonë të gjithëve se Farkhunda e kishte një sëmundje mendore.

### E arsimuar, inteligjente

Vajza e saj nuk vuante nga ndonjë sëmundje e fillë, por siç thotë e ëma, ajo ishte "e arsimuar, inteligjente dhe person shumë i sjellshëm". "Por unë nuk thash asgjë", thotë Hajera Bibi teksa kujton bisedën me zyrtarët e policisë në Kabul. "Unë i lutem Zotit për drjetësi". Hajrera Bibi tha se policia i kishte thënë asaj dhe familjes që për çështje të sigurisë, të largohen nga Kabul. Për tre muajt e ardhshëm, familja kishte jetuar në mes të krahinës së tyre të origjinës Kapisa dhe Kabulit, duke shikuar dhjetëra persona që kanë shkuar në gjyq për vrasjen e Farkhunda Malikzada, në mesin e të cilëve edhe 11 policë.

Një hetim i policisë zbuloi se Farkhunda Malikzada nuk kishte djegur asgjë. Videoja e incizuar me telefon dhe seancat gjyqësore janë transmetuar në televizionin kombëtar. Vrasja e vajzës, thotë Hajera Bibi, e ka kthyer në përmbys jetën e familjes së saj. Vajzat e saj më të reja janë shumë të frikësuar për të shkuar në shkollë dhe familja në përgjithësi, sipas saj, është e zhgënjyer se si njerëzit e zakonshëm i trajtojnë vajzat me një mizori të tillë. "Të gjithë fqinjët në lagje e kanë njohur Farkhundën si një vajzë shumë të mirë dhe nga një familje e respektuar", thotë Hajera Bibi. "Burri im është inxhinier, i cili ka diplomuar në Gjermani dhe po punonte si përkthyes i gjuhës gjermane në Kabul. Të gjithë djemtë dhe vajzat e mia janë të shkolluar", tha ajo

Gjatë verës, familja u zhvendos në kryeqytetin e Tashkistanit që ta rindërtojë jetën larg Kabulit, vend i cili familjes i "kujton gjithçka" rreth Farkundas, madje edhe sulmin e turmës që ia mori jetën dhe "ëndrrat për t'i përfunduar studimet, për t'u martuar e për të krijuar familjen e saj". Hajera Bibi thotë se është mirënjohëse ndaj autoriteteve në Dushanbe për dhënien e vizës së Tashkistanit tërë familjes. Por, ajo është e pavendosur për të ardhmen.

Hajera Bibi thotë se kur i sheh gratë në Dushanbe duke e jetuar jetën e tyre dhe duke punuar në paqe, mendja i shkon te trajtimi që iu bëhet grave në Afganistan. Shumë gra afgane shpesh përballen me mizori, duke përfshirë edhe dhunën në familje dhe sipas Hajera Bibit, autorët e këtyre krimeve, zakonisht nuk ndëshkohen. Ajo vë në pah vdekjen me gurë të 19 vjeçares Rukshana, në qendër të provincës Khor, në muajin tetor.

Dhe derisa Hajera Bibi mundohet t'i rikthehet jetës normale në Tashkistan, një Gjykatë e Apelit në Afganistan e ka hedhur poshtë dënimin me vdekje për vrasjen e Farkunda Malikzada, ndërsa i ka ulur disa dënime të gjata që ishin shqiptuar për të akuzuarit.

Familja e Farkunda Malikzada ende kërkon drejtësi. Bashkëshorti i Hajerës dhe vajza e saj, së fundi kanë udhëtuar në Kabul për të biseduar me avokatët dhe autoritetet afgane përkitazi me rastin.

<http://www.evropaelire.org/content/article/27433832.html>

## XI. NEKROLOGJIA DHE PËRKUJTIMI

### XI.1. NEKROLOGJIA

**N**ekrologjia është tekst që informon për vdekjen e një personi. Në epokën e komunikimit masiv ai është i lidhur ngushtë me gazetën dhe mediet e tjera informative, si radio, televizioni, uebportalet etj. Për shkak të rëndësisë së temës së saj, nekrologjia ka krijuar një zhanër edhe në letërsi: poezinë nekrologjike. Por, nekrologjia gazetareska ka një qëllim tjetër përmbajtjesor nga nekrologjia letrare: të informojnë për vdekjen e ndonjë personi me rëndësi në shoqëri apo të informojë për vdekjen dhe të shkruajë më gjerësisht për jetën e tij. Ky lloj bën pjesë të gazetaria informative, por është e lidhur shumë ngushtë me gazetarinë letrare dhe atë analitike.

Struktura tematike e nekrologjisë zakonisht përbëhet prej dy pjesëve: informata për vdekjen + sfondi. Kjo ka ndikuar edhe strukturën e teksteve: elementi i parë i nekrologjisë është një informatë kryesore (vdekja) dhe elementi i dytë është sfondi jetësor i personit të vdekur. Elemente të tjera të strukturës së teksteve janë edhe:

- të dhënat personale të të ndjerit
- koha, vendi dhe shkakut i vdekjes
- elemente të lindjes
- njerëzit që lë pas
- oraret e funeraleve, mbledhjet komemorativë (nëse ka folës edhe emrat e tyre).

Kjo strukturë tematike dhe teksteve është e zakonshme për njerëzit e rangut mesatar, ndërsa për njerëz me rol dhe përgjegjësi të mëdha publike, nekrologjitë flasin edhe më detajisht për jetën e të ndjerit dhe shkruhen edhe:

- veprimtaria dhe arritjet e shquara
- anëtarësia në organizata të ndryshme
- kujtime të miqve, apo shkrime të mëhershme për të ndjerin.

Nga aspekti i strukturës së teksteve dhe tematike nekrologjia organizohet në dy forma të cilat krijojnë dy lloje të saj.

**Nekrologjia informative.** Nëse vdekja është aksidentale, ose në rast se personi i vdekur nuk ka pasur rol dhe përgjegjësi publike, atëherë informata për këtë e mbizotëron nekrologjinë dhe kreu e përmban këtë aksident, ndërsa pjesa tjetër mbetet nën hijen e së parës. Kjo është nekrologji informative, e mbizotëruar prej lajmeve rutinore në raste të vdekjeve, prej fakteve e shifrave shpesh “zyrtare”

### PËRMBAJTJA

XI. Nekrologjia dhe përkujtimi . . . . . 185

XI.1. Nekrologjia . . . . . 185

XI.2. Përkujtimi (In Memoriam) . . . . . 189

- informata për vdekjen + sfondi
- të dhënat personale të të ndjerit
- koha, vendi dhe shkakut i vdekjes
- elemente të lindjes
- njerëzit që lë pas
- oraret e funeraleve, mbledhjet komemorativë (nëse ka folës edhe emrat e tyre)
- veprimtaria dhe arritjet e shquara
- anëtarësia në organizata të ndryshme
- kujtime të miqve, apo shkrime të mëhershme për të ndjerin

etj. Një tekst i tillë mund të shërbejë si shabllon për shumë raste të vdekjeve, vetëm se ndërrohen emrat e të ndjerëve, datat, shifrat etj. Ky format dallon prej njoftimeve publike për vdekjen e ndokujt, të cilat njoftime janë pjesë e reklamës dhe paguhen me para.

### Shuhet shkrimtari Umberto Eco



20 Shkurt 2016-01:20

Shkrimtari italian Umberto Eco ka vdekur sot në moshën 84-vjeçare.

Lajmin për vdekjen e shkrimtarit dhe filozofit të famshëm e ka konfirmuar familja e tij që ka thënë se ai ka vdekur mbrëmë rreth orës 22:30 në shtëpinë e tij.

Është autor i romanit "Emri i Trëndafilave" lindi në Alexandria më 5 janar të vitit 1932.

Eco ishte semiotist, filozof dhe shkrimtar i jashtëzakonshëm.

**Nekrologjia biografike.** Nëse vdekja është natyrale, ose në rast kur personi i vdekur ka pasur rol dhe përgjegjësi të mëdha publike, nekrologjia përqendrohet në sfondin e ngjarjes. Në këtë rast nekrologjia orientohet kah biografia e personit të vdekur dhe bën një përshkrim më thelbësor të jetës së të ndjerit. Te nekrologjitë e këtij tipi thelbësore është të nxirren çastet më të rëndësishme të të ndjerit. P.sh., nëse ka të arritura shkencore ato të theksohen; nëse ka të arritura humaniste ato theksohen; nëse ka një veprim heroik ai theksohet etj. Gjithsesi që ka devijim nga ky rregull: mund të jetë një ngjarje aksidentale, në të cilën humbet jetën një person pa ndonjë rol dhe përgjegjësi publike, por të shndërrohet në ngjarje lajmore me interes të veçantë dhe atëherë gazetarët shkruajnë edhe për të nekrologji biografike.

Nekrologjia shkruhet me kujdes sepse lexohet shumë. Ajo është monumenti i parë (për shumicën edhe i fundit) për personin e ndjerë. Nuk është e thënë që lajmi i vdekjes të jetë gjithmonë në kreun e nekrologjisë: mund të përdoren edhe krerët e vonuar. Shpesh nekrologjitë fillojnë me krerë përshkrues, në të cilët përshkruhet sfondi i të ndjerit apo edhe çaste nga aksidenti.

Një pyetje tjetër morale (që del jashtë kufijve të diskutimit për zhanrin) është se për cilët njerëz duhen shkruar nekrologjitë? Gazetat e mëdha, nacionale, rezervohen për të shkruar nekrologji vetëm për njerëzit e famshëm, ata me përgjegjësi të larta publike ose me të arritura të mëdha në një fushë, apo që kanë merita të mëdha për shtetin e njerëzimin. Ndërsa gazetat lokale kanë prirje për të shkruar nekrologji për njerëzit jo të famshëm, por që janë dalluar me diçka në shoqëri. Është humane që gazetat lokale të shkruajnë nekrologji për secilin person të vdekur, i famshëm apo jo, sepse me vetë faktin që njeriu është qenie e papërsëritshme, më e larta në këtë jetë, meriton një trajtim respektues edhe në vdekjen e tij. Nga ky aspekt, nekrologjia në bazë është një zhanër lokal i gazetarisë.

Në aspektin gjuhësor e stilistik, diskursi i nekrologjisë dallon nga gazetaria informative për shkak të ligjërimit elegjiak dhe sollemn që përdoret në të (por ka edhe përjashtime) dhe për shkak të mundësisë së përdorimit të ligjërimit emocional.

### Addio Umberto Eco

20 Shkurt 2016 - 10:00

Një nga shkrimtarët më të njohur të letërsisë bashkëkohore, Umberto Eco ka vdekur të premten mbrëma. Lajmin për vdekjen autorit të "Emri i trëndafilut" e kanë konfirmuar familjarët e tij për gazetën italiane "La Repubblica".

Eco ishte 84 vjeçar. I lindur më 5 janar 1932, ai ishte një studiues i semiotikës mesjetare, filozof, kritik letrar dhe novelist, më së shumti i njohur për romanin "Emri i trëndafilut" (Il nome della rosa) i botuar në vitin 1980. Romani është një mister intelektual që përzjen semiotikën në një vepër letrare, analizën biblike, studimet mesjetare dhe teori mbi letërsinë. Ai ka shkruar gjithashtu tekste akademike, libra për fëmijë dhe shumë ese, shkruan Koha Ditore.

Eco ishte president i Scuola Superiore di Studi Umanistici në universitetin e Bolonjës, anëtar i Accademia dei Licei dhe Bursist Nderi në kolegjin Kellogg në Universitetin e Oksfordit. Eco ka lindur në Alessandria në rajonin e Piemontes në Italinë e veriut. U arsimua pranë urdhrit Salezian. I ati i sugjeroi Umbertos të studionte për jurist por ai u regjistrua në Universitetin e Torinos për të studiuar filozofinë dhe letërsinë mesjetare. Shkroi tezën e vet të diplomës mbi Tomas D'Akuinin dhe diplomoi në letërsi në vitin 1954. Gjatë kësaj kohe, Eco u largua nga Kisha Katolike pasi pësoi një krizë besimi.

Punoi si redaktor kulture në Radio Televizionin e Italisë (RAI) dhe si profesor në Universitetin e Torinos. Një grup avangardë artistësh, piktorësh, muzikantësh dhe shkrimtarësh, me të cilët u miqësua gjatë punës te RAI, të quajtur "Grupi 63", patën një ndikim të madh te karriera e tij e ardhshme si shkrimtar. Libri i tij i parë. "Il problema estetico in San Tommaso", i cili qe



një variant i zgjeruar i tezës së tij të doktoraturës u publikua në vitin 1956. Në vitin 1962, Eco u martua me Renate Ramge, një mësuese gjermane e artit, me të cilën ka një vajzë dhe një djalë. Jetoj pjesërisht në Milano dhe pjesërisht në shtëpinë e vet të pushimeve pranë Riminit. Shquhej për bibliotekën e tij me 30 mijë libra në Milano dhe një tjetër me 20 mijë sosh në Rimini. Më 1959 ai publikoi librin e tij të dytë "Zhvillimi i Estetikës Mesjetare", "Sviluppo dell'estetica medievale", libër që bëri të ditur njohuritë e tij të thella mbi mesjetën. Pasi kreu shërbimin ushtarak, ai u largua nga RAI në vitin 1959 dhe filloi punë si redaktor i librave jofiction te shtëpia botuese "Bompiani", punë që e kreu deri në vitin 1975.

Kryevepra e tij "Emri i trëndafilit" u publikua në vitin 1980. Romani është një mister historik i vendosur në një manastir të shekullit të 15-të. Prifti françeskan William I Baskervillit, i ndihmuar nga asistenti i tij Adso, një kishtar benediktian, heton një seri vrasjesh në manastir ku po zhvillohet një debat i rëndësishëm fetar. Eco ishte veçanërisht i zoti në përkthimin e debateve të jetës fetare të mesjetës dhe herezive në një debat modern politik e ekonomik, i cili bëhet i kuptueshëm edhe për lexuesin që nuk është teolog. Romani mbart shumë referenca direkte ose indirekte, të cilat kërkojnë në vetvete një punë hetimore nga ana e lexuesit për t'u zbuluar. Vetë titulli nuk është i shpjeguar në roman por gjithsesi i bën jehonë fjalëve të Shekspereit: "Një trëndafil me çfarëdolloj emri tjetër do të mbante erë djersë". Williama i Baskervillit është një anglez i prirur nga logjika me pasion për librat dhe që më pas verbohet nga ky pasion.

Personazhi është një referencë mirënjohëse për Jorge Luis Borges, i cili ka ushtruar ndikim të madh te Eco. Borges bëri një jetë murgu dedikuar pasionit të tij për librat deri sa u verbua. Williama, personazhi i Ecos, është njëkohësisht një murg dhe një hetues dhe emri i tij i bën jehonë gjithashtu Sherlock Holmsit, veprës së Arthur Conan Doyle.

Misteri që shoqëron vrasjet në manastir është huazuar nga përrallat arabe, "Një mijë e një net". Ky roman i botuar edhe në shqip nga Botimet KOHA më 2005, u transformua si film me të njëjtin titull me aktorët Sean Connery, F. Murray Abraham dhe Christian Slater. Filmi merret me temën e misterit dhe vrasjeve pa hyrë në detajet e filozofisë dhe historisë. Eco ka publikuar edhe gjashtë romane të tjera.

"Lavjerrësi Foucault" (Foucault's Pendulum) u publikua në vitin 1988 flet për tre redaktorë që punojnë për një shtëpi të vogël botuese dhe që nuk kanë shumë punë nëpër duar. Ata fillojnë të dëftojnë veten duke shpikur një teori komploti. Komploti i titulluar "Plani" flet për një organizatë sekrete me origjinë nga Kalorësit Templarë që synon të marrë botën nën kontroll. Ndërsa loja vijon, të tre bëhen të fiksuar me detajet. Loja bëhet e rrezikshme kur dikush nga jashtë mëson mbi "Planin" dhe fillon të besojë me të vërtetë se redaktorët

kanë zbuluar sekretin e thesarit të humbur të Templarëve. Ishulli i një dite më parë, romani i tretë, është i vendosur në shekullin e shtatëmbëdhjetë dhe flet për një njeri të braktisur mbi një anije jo shumë larg një ishulli që ai beson se gjendet në anën tjetër të vijës ndërkombëtare të datës. Personazhi është në kurthin e pamundësisë së tij për të notuar dhe pjesa dërmuese e librit kalon me rikujtimin e jetës dhe aventurave të tij deri në pikën kur mbërriti te anija e prishur.

"Baudolino" u publikua në vitin 2000 dhe flet për një kalorës të Kryqëzatës së Katërt, i cili shpëton historianin bizantin Niketas Choniates gjatë bastisjes së Kostandianopojës. Duke pretenduar se mund të gënjejë më së miri, kalorësi fillon t'i rrëfejë jetën e vet historianit, që nga fëmijëria e vet prej fshatari te roli i tij si fëmijë i adoptuar i perandorit Frederic Barbarosa dhe te misioni për të vizituar mbretërinë imagjinare të Fratit Gjon. Kur i kërkohet të ripërsërisë historitë, Baudolino kalon në variante më të stërzgjatura deri sa historiani dhe lexuesi nuk e kanë të mundur të dallojnë të vërtetën nga gënjeshtra.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

## XI.2. PËRKUJTIMI (IN MEMORIAM)

Përkujtimi (In Memoriam) është një tekst nekrologjik, por që dallon thelbësisht nga nekrologjia që diskutuam më lart. Përkujtimi është tekst në të cilin përkujtohet një person i vdekur, në një përvjetor të tij. Nga aspekti i formatit ai bën pjesë te reklamat dhe paguhet me para. Kjo nuk e ndikon gjithmonë strukturën e tij: në të shumtën e rasteve teksti i saj është i thjeshtë (përkujtohet personi, shprehet malli dhe kujtimi që ka lënë pas etj.), por në raste të veçanta shkruhen edhe tekste të tjera, si frazeologji apo vargje poetike (përdorimi i stilit elegjiak dhe poetik, ku shpeshherë ky i fundit është i nëpërkëmbur). Derisa nekrologjinë e shkruan gazetari, përkujtimin zakonisht e bëjnë familjarët dhe të afërmit e të ndjerit.

Përkujtimi (In Memoriam)

### Shënime

1. *Manual për gazetarët e Europës Qendrore dhe Lindore*, fq. 9.
2. Artan Fuga, *Komunikimi në shoqërinë masive*, Papirus, Tiranë, (pa vit botimi)
3. Në teorinë e gazetarisë nuk ka një nocion të stabilizuar për ta emërtuar këtë fakt që ne po e quajmë fakt objektiv. Disa gazetarë e përdorin nocionin ngjarje (që është vetëm një aspekt i faktit objektiv), subjekti i lajmit (subjekti i lajmit është brendia e strukturuar e një lajmi, po jo vetë fakti objektiv para se të shkruhet në lajm) etj. Një herë kam provuar të quhet fakt objektiv, por edhe ky emërtim krijon probleme, sepse fakte objektive në filozofi janë të gjitha ato që ekzistojnë jashtë ndërgjegjes njerëzore, pra edhe hëna është fakt objektiv.
4. Sipas hulumtimit të Flutura Gashit në temën e diplomës "Përshkrimi i zhanreve gazetare në gazetën Infopress për periudhën 1-31 maj 2010", mbrojtur në Degën e Gazetarisë të Universitetit të Prishtinës, në tetor 2010.
5. Grant Milnor Hyde, *Newspaper Reporting and Correspondence/ A Manual for Reporters, Correspondents, and Students of Newspaper Writing* [botim 1912]; cituar sipas versionit elektronik, fq. 21.
6. Melvin Mencher, *Raportimi dhe shkrimi i lajmeve*, fq. 119. Mencheri nuk e trajton titullin e lajmit si pjesë të strukturës tekstore.
7. Steve Rosenberg, [www.bbc.albanian.com](http://www.bbc.albanian.com), (shikimi i fundit: e mërkurë, 14 tetor 2009, 07:49)
8. Teun A. Van Dijk, *News as discourse*, Lawrence Erlbaum Associates, New Jersey Hove and London, 1988, vv. 50-51.
9. *Koha ditore*, 21 dhjetor 2011.
10. Teun A. Van Dijk, *News as discourse*, Lawrence Erlbaum Associates, New Jersey Hove and London, 1988, vv. 30-32.
11. Marrë nga *Koha ditore*, 21 dhjetor 2011
12. *Koha Ditore*, 26 Nëntor 2008.
13. David Randall, *Gazetari universal*, fq. 144-145.
14. Melvin Mencher, *Raportimi dhe shkrimi i lajmeve*, fq. 129.
15. *Kosova sot*, 11 shtator 2009.
16. *Manual për gazetarët e Europës Qendrore dhe Lindore*, fq. 28.
17. Melvin Mencher, *Raportimi dhe shkrimi i lajmeve*, fq. 114.
18. David Randall, *Gazetari universal*, fq. 166.
19. *Koha ditore*, 23 korrik 2010.
20. Melvin Mencher, *Raportimi dhe shkrimi i lajmeve*, fq. 127-153.
21. David Randall, *Gazetari universal*, fq. 168-173.
22. Milazim Krasniqi, *Hyrje në gazetari*, fq. 72-73.
23. [www.BBC.albanian.com](http://www.BBC.albanian.com), E diel, 18 tetor 2009 - 18:10
24. [www.BBC.albanian.com](http://www.BBC.albanian.com), E enjte, 15 tetor 2009 - 07:39 CET
25. David Randall, *Gazetari universal*, fq. 191-194.
26. David Randall, *Gazetari universal*, fq. 192.
27. *Kosova sot*, 3 shtator 2009.
28. *Express*, 2 shkurt 2011.
29. Patrisha Holland, *Fotografia e gazetarisë*, në MEDIA, nr. 2, UP, FF, Dega e Gazetarisë, 2010.
30. Barbier & Lavenir, *Historia e medias nga Dideroi te interneti*, fq. 159.
31. *Dictionary of Media Studies*, A & C Black, London, First published in 2006.
32. Dr. Milazim Krasniqi, *Hyrje në gazetari*, fq. 132.
33. *Manual për gazetarët e Europës Qendrore dhe Lindore*, fq. 106.
34. *Manual për gazetarët e Europës Qendrore dhe Lindore*, fq. 106.
35. *Manual për gazetarët e Europës Qendrore dhe Lindore*, fq. 108.
36. RTK, 09 nëntor 2008, 12:38:5
37. RTK, 08 nëntor 2008, 11:49:13
38. Hamit Boriçi, *Gazetaria 2*, fq. 167.

39. Stiv Irwin (1962-2006), reporter nga Australia, i famshëm për reportazhet e tij me shtazë të egra. Gjatë filmimeve ai u ka qëndruar më afër se çdokush tjetër shtazëve të rrezikshme, si është krokodili. Ka vdekur më 2006 gjatë xhirimit të dokumentarit Ocean's Deadliest, i goditur për vdekje nga *stingray*.
40. Melvin Mencher, *Raportimi dhe shkrimi i lajmeve*, fq. 37-39.
41. Melvin Mencher, *Raportimi dhe shkrimi i lajmeve*, fq. 44.
42. Dr. Milazim Krasniqi, *Hyrje në gazetari*, fq. 128.
43. Milazim Krasniqi, *Hyrje në gazetari*, fq. 164.
44. Milazim Krasniqi, *Hyrje në gazetari*, fq. 171.
45. Hamit Boriçi, *Gazetaria 2*, fq. 170-171.
46. Hamit Boriçi, *Gazetaria 2*, fq. 75-76.
47. DIELLI, Boston, nr. 2, 27 shkurt 1909, autori: Kristo Çeku. Cituar nga *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare (përmbledhje artikujsh nga shtypi)*, vëllimi II, 1908-1910, fq. 47-48.
48. *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, vëllimi I, 1879-1908, fq. 54.
49. *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, vëllimi I, 1879-1908, fq. 53.
50. *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, vëllimi I, 1879-1908, fq. 73.
51. *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, vëllimi I, 1879-1908, fq. 223.
52. *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, vëllimi I, 1879-1908, fq. 43-45.
53. Hamit Boriçi, Bashkim Gjergji, Genc Tirana, Sadri Ramabaja, *Gazetaria*, Tiranë, 2000, fq. 79-82.
54. *Koha ditore*, 1 shkurt 2011.
55. *Kosova sot*, 1 shkurt 2011.
56. *Koha ditore*, 8 shkurt 2011.
57. Melvin Mencher, *Raportimi dhe shkrimi i lajmeve*, WCB, botim i pestë, fq. 190-219.
58. Melvin Mencher, *Raportimi dhe shkrimi i lajmeve*, WCB, botim i pestë, fq. 191.
59. Melvin Mencher, *Raportimi dhe shkrimi i lajmeve*, WCB, botim i pestë, fq. 193.
60. Matthew Ricketson, *Writing Feature Stories/how to research and to write newspaper and magazine articles*, Allen & Unwin, 2004, vv. 14-32.
61. Hamit Boriçi, *Gazetaria 2*, Tiranë, 2004, fq. 286-293.
62. *Koha ditore*, 8 shkurt 2011.
63. *Koha ditore*, 31 janar 2011.
64. *Koha ditore*, 31 janar 2011.
65. *Kosova sot*, 8 shkurt 2011.
66. *Kosova sot*, 8 shkurt 2011.
67. *Express*, 2 shkurt 2011.
68. *Kosova sot*, 1 shkurt dhe 8 shkurt 2011.
69. *Koha ditore*, 4 shkurt 2011 dhe *Express*, 4 shkurt 2011.
70. *Express*, 9 shkurt 2011.
71. *Koha ditore*, 4 shkurt 2011.
72. *Kosova sot*, 8 shkurt 2011.
73. *Koha ditore*, 1 shkurt 2011.



XII. Gazetaria analitike (opinioniste)

XIII. Editoriali

XIV. Komenti

XV. Artikulli analitik (analiza)

XVI. Kryeartikulli

XVII. Kolumna

XVIII. Intervista

XIX. Anketa (vox pop)

XX. Dosja

XXI. Letra nga lexuesit

## Gazetaria analitike

3  
PJESA





## PËRMBLEDHJE

**N**ë këtë kapitull, pasi trajtohen qëllimi përmbajtjesor dhe struktura tekstore e gazetarisë analitike si dhe disa veçanti të përbashkëta për tekstin e kësaj gazetarie, flitet veç e veç për lloje të ndryshme zhanrore të kësaj gazetarie, ato që janë më të përhapura jo vetëm në gazetarinë shqiptare, por dhe më gjerë. Shtjellohen gjerësisht editoriali, komenti, analiza (artikulli analitik), kryeartikulli, kolumna, intervista, “vox pop”-i, dosja, letrat e lexuesve. Për secilin prej këtyre llojeve zhanrore flitet në dy aspekte: cili është qëllimi përmbajtjesor i tij dhe cila është struktura tekstore e tij? Për secilin janë marrë shembuj të mjaftueshëm për t’i dëshmuar parimet e ekzistimit të një lloji zhanror, por edhe që të shërbejë si model për studentët se si të shkruhet ai lloj zhanror.

Po ashtu, për secilin lloj zhanror janë shtjelluar edhe forma të ndryshme të llojit zhanror si dhe nënlojet zhanrore. Te këto ndarje zhanrore të llojeve dhe nënlojeve është ndjekur ndonjë përvojë teorike apo praktike e mëhershme, kryesisht ato përvoja që janë më të afërta me gazetarinë shqiptare. Është theksuar, në këto raste, se ekzistojnë edhe ndarje të tjera. Në disa raste janë marrë edhe shembuj shkollorë të shkrimit të teksteve të llojeve të ndryshme zhanrore, si dhe është diskutuar shpeshherë afërsia e një lloji me llojin tjetër dhe dallimi i një lloji me llojin tjetër zhanror.



## XII. GAZETARIA ANALITIKE (OPINIONISTE)

### NJË PËRKUFIZIM TEORIK

**G**azetaria analitike (është quajtur edhe opinioniste) është e vjetër sa vetë gazetaria dhe ka pasur një zhvillim të vrlshëm në Evropë gjatë gjithë shekujve të kohës së re. Në periudha me trazira sociale kjo gazetari ka prekur lakoren më të lartë të ndikimit tek audienat, shpeshherë duke u shndërruar edhe në vegël të grupimeve politike, duke u larguar nga parimet e gazetarisë dhe duke u shndërruar në propagandë, si në kohën e revolucioneve, apo edhe si ka ndodhur në shekullin XX në mënyrë masive në dy raste: në periudhën e fashizmit dhe në atë të komunizmit. Sot kjo gazetari çmohet si elitare, edhe për shkak të gazetarëve dhe autorëve që e shkruajnë atë (pjesa më e zgjedhur dhe më e mirë e tyre), edhe për shkak të vështirësisë së shkrimit të saj (nuk mjafton një informatë për një ngjarje lajmore, por dhjetëra të tilla, të cilat gazetari i gjen me hulumtime e zhbirime të mëdha) e, në fund, edhe për shkak të audiencës (vetëm audienat me një shkallë më të artë akademizmi lexojnë ose ndjekin këtë zhanër të gazetarisë për shkak të kompleksitetit të trajtimit të temave, për shkak të vetë temave “të rënda” dhe për shkak të gjuhës që përdorin gazetarët në këto tekste).

### XII.1. QËLLIMI PËRMBAJTJESOR I GAZETARISË ANALITIKE

Gazetaria analitike përfshin të gjitha ato lloje gazetare të cilat mëtojnë jo vetëm të informojnë, por edhe të analizojnë, të shpjegojnë, të interpretojnë, të vlerësojnë dhe të nxjerrin përfundime nga ato analiza e shpjegime. Marrëdhënia dhënës-marrës në këtë gazetari është më e komplikuar: dhënësi ndihmon marrësin të krijojë një pikëpamje (mendim etj.) për temën e trajtuar. Marrësi, përveç informacionit të pastër të cilin dëshiron ta dijë, para së gjithash, është i interesuar edhe për analizën, interpretimin dhe shpjegimin e atij informacioni. Edhe analiza, edhe interpretimi e shpjegimi i informacionit nënkuptojnë një thellim në kuptimin e rrethanave dhe të arsyeve të ndodhjes së një ngjarjeje lajmore. Marrësi natyrisht që ka një pikëpamje të tijën pse ndodh një ngjarje lajmore, por ai nuk mund të jetë plotësisht i sigurt për atë pikëpamje (ai nuk është

#### PËRMBAJTJA


XII. Gazetaria analitike (opinioniste) . . . . . 197

XII.1. Qëllimi përmbajtjesor i gazetarisë analitike . . . . . 197

XII.2. Struktura tekstore e zhanrit analitik . . . . . 198

XII.3. Gjuha konative dhe stili i zhanrit analitik . . . . . 201

Gazetaria analitike ose gazetaria opinioniste



Gurë, gurë... bëhet mur. Kështu krijohet edhe opinionii publik.

Marrësi, përveç informacionit të pastër të cilin dëshiron ta dijë para së gjithash, është i interesuar edhe për analizën, interpretimin dhe shpjegimin e atij informacioni.

specialist i asaj fushe, nuk ka informacione të tjera për t'iu kuptuar arsyet e ndodhjes apo, thjesht, nuk ka kohë për t'iu thelluar në analiza të tilla), prandaj i duhet një pikë mbështetjeje për të parë se çfarë mendon një i tretë për atë çështje. Ky i tretë është gazetari apo një autor tjetër i cili shpreh botëkuptimin, opinionin, qëndrimin apo vlerësimin e tij për ngjarjen lajmore.


Elementi i parë i këtij zhanri është analizimi, vlerësimi, komentimi dhe interpretimi i ngjarjeve lajmore. Ky është hapi që gazetari e hedh pasi ta ketë shkruar lajmin. Fillimisht ekziston një lajm (gazetaria informative), të cilin audiencat e pranojnë dhe reagojnë ndaj tij në dy mënyra: mjaftohen me informacionin që kanë marrë (nëse lajmi nuk ka një rëndësi të madhe) apo nuk mjaftohen me informacionin që kanë marrë (kur lajmi ka rëndësi të madhe për shoqërinë) dhe kërkojnë nga gazetarët t'iu ndalin në ndihmë përmes analizimit, vlerësimit, komentimit dhe interpretimit të tij. Ky është rrethi social i këtij zhanri, i cili përmbillet me prirjen konative të gjuhës në tekstin e këtij zhanri, për të cilin do të flasim më poshtë. Por, ajo që duhet diskutuar këtu është fakti se analizimi, vlerësimi, komentimi dhe interpretimi i ngjarjeve lajmore bëhen brenda një game të gjerë metodologjike: nisin nga interpretimi krejtësisht personal i gazetarit (si në kolumnë), kalojnë nga pozicionimi politik ndaj ngjarjes lajmore (si në editorial) dhe shkojnë deri tek analiza më e thellë objektive, në të cilën përdoren edhe metodat e hulumtimit në shkencat sociale (si në artikullin analitik). Kjo gamë e gjerë e qasjes metodologjike në shkrimin e zhanrit analitik është një shpikje e mrekullueshme e gazetarëve, sepse ajo siguron hapësirë të bollshme për mendimin e lirë të gazetarit deri në aventura të ideve (si te kolumna), krijon një hapësirë të bollshme për debate publike (si te komenti) dhe siguron edhe një hapësirë të bollshme për analizë akademike të ngjarjeve lajmore (si tek artikulli analitik). Filip Majer (Philip Meyer) ka shkruar librin *Gazetaria e saktë* (2002), në të cilin trajton këtë ndërlidhje të gazetarisë me metodat e hulumtimit social (dhe përtej tyre) dhe për rëndësinë e madhe që gazetari të specializohet në një fushë të caktuar, duke provuar kështu ta ofrojë sa më shumë gazetarinë me metodat e hulumtimit shkencor.

## **XII.2. STRUKTURA TEKSTORE E ZHANRIT ANALITIK**

Në aspektin strukturor ky zhanër është kompleks, teksti është i gjatë, shumëdimensional dhe është ndërthurje e temave të ndryshme me një kryetemë. Teksti ka strukturë të krijuar mbi rregulla të cak-

tuara, por nuk është i fiksuar, pra lëviz dhe mund të ndryshohet. Për shembull, ka dy struktura të komentit: në të parën elementi më i rëndësishëm është në fund të komentit, ndërsa në të dytën elementi më i rëndësishëm është në fillim të komentit. Ose, derisa ka disa rregulla si shkruhet artikulli analitik, nuk ka fare rregulla si shkruhet kolumna: ato i krijon vetë gazetari sa herë që e shkruan kolumnën. Si rrjedhim i kësaj strukture shpjegohet edhe çështja e modeleve: ka modele tekstesh, por nuk mbizotërojnë dhe nuk ndiqen shumë nga gazetarët e tjerë.

Janë tri elemente thelbësore të strukturës tekstore në këtë zhanër të cilat ia vlen të diskutohen ndaras:



Tri elementet thelbësore të strukturës tekstore

**Përmbyllja semantike.** Pjesa përmbyllëse e tekstit (përmbyllja semantike) e mbizotëron gjithë tekstin. Te lajmi është e kundërta (kreu e mbizotëron tekstin) ndërsa këtu, interpretimi, vlerësimi, pozicionimi, shpjegimi apo edhe anticipimi (parathënia e rrjedhës së ngjarjeve lajmore) bëhen në fund të tekstit, pasi të jetë bërë më herët shkoqitja e argumenteve dhe e fakteve të ndryshme. Thënë figurativisht, gjithë teksti në këtë zhanër shkruhet për t'i argumentuar paragrafët e fundit. Këta paragrafë të fundit janë më të rëndësishmit edhe për audiencat.

Pjesa përmbyllëse e tekstit (përmbyllja semantike) e mbizotëron gjithë tekstin.

Përmbyllja semantike nuk do të thotë se njëjtësohet (edhe pse nuk është domosdo e ndryshme) me përfundimin grafik (fizik) të tekstit. Kjo përmbyllje është kategori në të cilën gazetari vendos

pjesën më të rëndësishme të tekstit gazetar. Nga ky aspekt, kjo kategori mund të quhet edhe kategoria më e rëndësishme në tekstin gazetar. Kështu, për lajmin përmbyllja semantike paraqitet në kreun e lajmit, sepse kreu bart informatën kryesore të lajmit. Lexuesi mjaftohet edhe vetëm me kreun e lajmit, përveç nëse dëshiron të dijë rrethana shtesë se si ka ndodhur një lajm. Për editorialin përmbyllja semantike vendoset ose në fund ose në hyrje të tekstit, ngjashëm edhe komenti mund ta ketë përmbylljen semantike në fillim apo në fund të tekstit etj. Dallimi midis disa llojeve zhanrore është shumë i zbehtë dhe vetëm nëpërmjet kësaj përmbylljeje semantike ne mund ta dallojmë komentin prej editorialit apo prej analizës: në koment përmbyllja semantike është një mendim i argumentuar i gazetarit, në editorial është një pozicionim politik i redaksisë apo botuesit, ndërsa në analizë është një zbërthim i hollësishëm i problemit dhe një anticipim. Në secilin rast marrësi mund ta kuptojë esencën e tekstit gazetar po ta lexojë vetëm edhe përmbylljen semantike.

Nëse bëhet një krahasim i zhanrit analitik me esenë, atëherë përmbyllja semantike mund të krahasohet me konfirmimin e tezës. Sa do i çalë, si çdo krahasim, megjithatë ky krahasim tregon një rrjedhë tematike të tekstit analitik: teksti ka një tezë, e cila duhet të argumentohet, dhe në fund konfirmohet teza.

**Teza e artikullit.** Në këtë zhanër artikujt kanë tezë, ndryshe nga zhanri informativ i cili nuk ka tezë (me një përjashtim të raportit me tezë). Gazetari e trajton një ngjarje lajmore dhe ai ka pikëpamjen e tij për të, pra ka tezën e tij, të cilën e argumenton dhe e rikonfirmon në fund të tekstit, tek interpretimet dhe përfundimet e tij. Kjo e bën tekstin analitik, nga aspekti strukturor, tekst unik, i cili ka një fillim (parashtrimi i tezës) dhe ka një përmbyllje (rikonfirmimi i tezës), ndryshe nga ç’kemi parë te gazetaria informative, në të cilën teksti nga aspekti strukturor nuk ka përmbyllje (mund ta shkurtosh lajmin duke nisur nga fundi deri te kreu, pa e dëmtuar esencën e tij).

**Marrëdhënia dhënës-marrës.** Në gazetarinë informative kjo marrëdhënie është e largët (shumica e gazetave nuk i vënë në fund të lajmeve emrat e gazetarëve që e kanë shkruar atë), nuk ndjehet prania e gazetarit në tekst (përveç në transmetimet *live*, ose të raportit me tezë). Ndërsa në zhanrin analitik kjo marrëdhënie është e shkurtuar: gazetarët e mirë kanë një audiencë të vetën dhe këto audiencia shpesh familjarizohen me temat, me stilin e gazetarit dhe e ndjekin atë nga teksti në tekst ose, thjesht, besojnë në gjykimet, interpretimet dhe vlerësimet e tij, prandaj ia lexojnë tekstet rregullisht. Po ashtu, gazetari ka qëllim të ndikojë në opinionin e audiencës dhe audiencia e di këtë dhe e pret, prandaj e lexon tekstin e tij. Gazetari është i pranishëm në tekst relativisht shumë: nga kolumna i cili është tekst

Artikulli i gazetarisë analitike ka tezë

Gazetarët e mirë kanë një audiencë të vetën dhe këto audiencia shpesh familjarizohen me temat, me stilin e gazetarit dhe e ndjekin atë nga teksti në tekst ose, thjesht, besojnë në gjykimet, interpretimet dhe vlerësimet e tij, prandaj ia lexojnë tekstet rregullisht.

tërësisht personal e deri te artikulli analitik i cili nuk është personal, por mbizotërohet nga qasjet dhe mendimet personale të gazetarit.

## XII.3. GJUHA KONATIVE DHE STILI I ZHANRIT ANALITIK

Struktura e ligjërit anon kah ligjërimi shkencor (pra, ka një tezë të temës, ka argumente të njohura edhe para tekstit, ka argumente të autorit të tekstit dhe, në fund, ka përfundime), por me prioritet shumë të fuqishme autoriale (kjo do të thotë se te ky tekst ka disa rregulla të cilave u përmbahet autori, por edhe në ato raste teksti merr ngjyrën personale, ose autoriale). Gjuha e zhanrit analitik nuk është neutrale (si në zhanrin informativ), ajo anon, ka tendencë, pra është konative. Konativiteti është shfaqje gjuhësore (njëri prej funksioneve të gjuhës, të përkufizuara nga Roman Jakobsoni), në të cilin dhënësi synon ta bindë marrësin me ato që thotë. Konativiteti, po ashtu, ka një gamë të gjerë veprimi: konativitet në formë të urdhërues (te editoriali), kah konativiteti relativ (te komentit) deri te konativiteti neutral (te artikulli analitik). Ky konativitet në tekstin gazetar shpjegohet me qëllimin përmbajtjesor të këtij zhanri: nëse qëllimi përmbajtjesor është analizimi, shpjegimi, interpretimi, pozicionimi i ngjarjeve lajmore në proces, për ta ndihmuar audiencën që t'i kuptojë më thellë dhe më drejt ato, atëherë detyrimisht edhe gjuha e këtyre teksteve do të ketë një prioritet konative: gazetari ka një pikëpamje apo një qëndrim për temën që e trajton dhe dëshiron që atë ta pranojë (ose më drejt, ta njohë) marrësi. Por, nuk imponohet më shumë: konativiteti i këtij teksti nuk kërkon bindje, por vetëm një dritare më shumë për marrësin, që ai të ketë disa alternativa të vlerësimit për ngjarjen lajmore.

Në aspektin stilistik, gjuha është informacion, por e ndërthurur me gjuhën figurative dhe me konotacionin. Sidomos titujt dhe hyrjet, por edhe përfundimet, janë të hapura shumë për figura të ndryshme stilistike, jo vetëm për ta shprehur sa më mirë idenë e gazetarit, por edhe që të imponohet si retorikë, që të mbahet në mend nga audiencat. Ja disa shembuj të titujve figurativë nga tekstet analitike:

- Baltiku vlon, Egjeu ngrin (titull i komentit të *The Economist*; përmes një antiteze të dyfishtë paraqet gjendjen e krizës në Letoni dhe në Greqi në vitin 2010);
- Drejtësi e përgjumur (titull mbi bazë të antinomisë);<sup>1</sup>
- Përmytje në KQZ (titull mbi një metonimi);<sup>2</sup>

Me **stil** nënkuptohet mënyra e veçantë e përdorimit të gjuhës.

**Konativiteti** është shfaqje gjuhësore, në të cilin dhënësi synon ta bindë marrësin me ato që thotë.

Konativitet në formë të urdhërues (te editoriali).  
Konativiteti relativ (te komentit).  
Konativiteti neutral (te artikulli analitik).

- Foret e KFOR-it (titull ironik në lidhje me qëndrimin “neutral” të KFOR-it për pavarësinë e Kosovës).<sup>3</sup>

Jetëgjatësia e teksteve të këtij zhanri është më e gjatë se 24 orë. Llojet kryesore të teksteve janë: artikulli analitik (analiza), komenti, kryeartikulli, editoriali, intervista, kolumna, anketa, dosja etj.



## XIII. EDITORIALI

## XIII.1. NOCIONI DHE QËLLIMI PËRMBAJTJESOR

**E**mërtimi është krijuar nga fjala angleze *editor* - botues, redaktor; *editorial* - tekst i bërë nga botuesi apo në emër të tij. Emërtimi është përcaktues për këtë lloj teksti: editoriali është fjala e botuesit, e shkruar prej tij, apo prej dikujt tjetër në emër të tij. Tërë përgjegjësinë morale, politike e juridike për editorialin e bart botuesi. Kjo është arsyeja pse zakonisht ky tekst botohet pa emër, por nëse botohet me emër, kjo d.t.th. se autori i tij e ka shkruar atë në pajtim me botuesin, mirëpo përgjegjësinë për tekstin e bart drejtpërsëdrejti ai, shkruesi. Qëllimi përmbajtjesor i editorialit është pozicionimi shoqëror, politik, moral apo publik i botuesit, në emër të gazetës, për një çështje të caktuar, për një ngjarje lajmore, për një proces ngjarjesh lajmore, por edhe për një proces politik, social, ekonomik, kulturor etj. Mediet kanë politikat e tyre botuese dhe ato i shpallin në programet e tyre, të cilat botohen zakonisht në numrin e parë të medias. Por, nga dita në ditë botuesi ndjen nevojën të pozicionohet ndaj kësaj apo asaj teme, çështjeje, fakti, ngjarjeje etj. dhe këtë e bën në editorialin e tij. Nga ky aspekt ideologjik, editoriali është vazhdim i programit të deklaruar të medias, është plotësim i tij dhe reagim në vijë me të ndaj ngjarjeve të reja lajmore. Kështu, editoriali është teksti në të cilin botuesi mund ta deklarojë opinionin e tij dhe pozicionin e tij ndaj proceseve të ndryshme politike, sociale, ekonomike etj., pa u frikësuar se po shkel rregullat e gazetarisë dhe etikën e saj. Ky është i vetmi tekst në të cilin ai, si pronar, apo edhe redaksia e medias si menaxherë të medias, mund t'i komentojë proceset e ndryshme pa rënë ndesh me deontologjinë e medias. Kjo ndarje e prerë e kufizon botuesin që ta përdorë medien për interesa të tij. Gazetaria moderne e shekullit XX ka insistuar në këtë pikë. Prandaj është shumë e prerë vija midis editorialit dhe lajmit: lajmi informon, prandaj duhet të jetë neutral dhe i balancuar, ndërsa editoriali pozicionohet ndaj një ngjarjeje lajmore, prandaj nuk është neutral, është tendencioz dhe bart ideologjinë e pronarit apo të redaksisë së medias. Kjo vijë nuk e mohon të drejtën e editorialistit edhe të informojë, edhe të analizojë, edhe të pozicionohet ndaj temës së trajtuar, por vetëm e paragjykon ndalesën që botuesi t'i komentojë edhe lajmet etj., nga njëra, dhe faktin se qëllimi përmbajtjesor i editorialit është pozicionimi ndaj temës së trajtuar, në anën tjetër. Këtë vijë ndarëse e shpreh mjaft qartë dhe mirë Pol Grindberg: "Është e rëndësishme që opinioni redaksional (editoriali, B. K.) të mos zëvendësohet nga lajmet, po aq sa ç'është e rëndësishme që përmes rreshtave të lajmeve të mos futet komenti i redaktorit".<sup>4</sup>

## PËRMBAJTJA

XIII. Editoriali . . . . .	203
XIII.1. Nocioni dhe qëllimi përmbajtjesor . . . . .	203
XIII.2. Tema e editorialit	204
XIII.3. Ngjyra politike e gazetës . . . . .	206
XIII.4. Struktura e editorialit . . . . .	207
XIII.5. Llojet e editorialëve . . . . .	210
XIII.5.1. Editoriali operativ . . . . .	210
XIII.5.2. Editoriali i përgjithshëm politik . . . . .	210
XIII.5.3. Editoriali popullarizues . . . . .	211
XIII.5.4. Editoriali i temës	212
XIII.5.5. Editoriali që s'është editorial . . . . .	214
XIII.6. Çështje të stilit . . . . .	215
XIII.7. Nga historia e editorialit shqip . . . . .	215


Qëllimi përmbajtjesor i editorialit është pozicionimi shoqëror, politik, moral apo publik i botuesit, në emër të gazetës, për një çështje të caktuar: për një ngjarje lajmore, për një proces ngjarjesh lajmore, por edhe për një proces politik, social, ekonomik, kulturor etj.

Editoriali dëshmon se mediet e konsiderojnë veten, dhe janë institucione me përgjegjësi publike. Nëse ndodhin ngjarje të pazakonshme lajmore, ose zhvillohen procese që ndikojnë drejtpërdrejt shoqërinë, politikën, ekonominë apo ndonjë fushë tjetër të rëndësishme sociale, media, duke ndërjerë peshën e përgjegjesisë publike që ka ndaj audiencës së vet, deklarohet përmes editorialit. Sado që media është neutrale dhe moderne, ajo ka përgjegjësi publike ndaj audiencës së vet, në radhë të parë, prandaj i orienton në raste të caktuara duke shprehur ideologjinë, bindjet dhe pozicionimet e veta përballë rrjedhave shoqërore. Pak a shumë është e njëjta përgjegjësi sikurse partitë që kanë ndaj votuesve të tyre, vetëm se këtu me një intensitet dhe në një shkallë më të ulët, sepse lidhja audiencë-media nuk është e formalizuar sikurse lidhja votues-parti.

### **XIII.2. TEMA E EDITORIALIT**

Tradicionalisht, editoriali ndërlidhet me zhvillimet kryesore në shoqëri. Gazetat dhe mediumet e tjera, duke kryer rolin e lajmësit apo të zëdhënësit të të gjitha strukturave të një shoqërie, si dhe duke qenë institucione me rol dhe interes të madh për shoqërinë, kanë komentuar dhe janë deklaruar duke marrë herë njëherë e herë anën tjetër në këto procese shoqërore. Prandaj, nuk mund të ketë ndodhur një ngjarje, një proces apo një ide e madhe politike, sociale, ekonomike apo thjesht njerëzore e gazetatat të mos e kenë trajtuar atë temë nga këndi i editorialit. Në këtë mënyrë, mediet, përveçse kryejnë misionin e informimit të gjithanshëm, edhe marrin pjesë aktive në jetën shoqërore, politike e ekonomike të vendit ku botohen.

Editoriali modern ka zgjeruar gamën e temave të cilat i trajton. Ai trajton një temë të ditës, në të cilën botuesi apo kryeredaktori ndjen të nevojshme të marrë një qëndrim të caktuar. Në të gjitha çështjet me interes të madh publik, sidomos në ato që kanë të bëjnë me shtyllat themelore të shoqërisë (politikat sociale, shëndetësore, paqja sociale, biznesi etj.), të demokracisë (në rast se demokracia e një vendi nuk mbrohet sa duhet, në rast se shkelen parimet e demokracisë), të ekonomisë (lëvizjet themelore ekonomike, fiskale, buxhetore etj.), të shtetit (parimet themelore mbi të cilat ndërtohet shteti etj.), botuesi shpreh qëndrimin e tij, për ta bërë atë sa më të kuptueshëm për lexuesin e tij. Rrjedhimisht, tema e editorialit nuk mund të jetë një çfarëdo teme. Botuesi i medias nuk do ta ndjente të nevojshme të deklarohej për një çfarëdo teme të parëndësishme. Vetëm temat e rëndësishme së madhe, në cilëndo fushë me interes për shoqërinë, vetëm ato tema që prekin interesa të gjëra shoqërore, ato janë tema që trajtohen në editorial.



A është ky synimi i editorialit?

Tema e trajtuar është aktuale, se editoriali nuk mund të trajtojë një temë që nuk është shumë aktuale. Për tema të kaluara (joaktuale) botuesi nuk do ta ndjente nevojën të deklarohet. Kështu, në editorialin e revistës *Klan*, të 9 shtatorit 2009, nën titullin *Pse s'na i dhanë vizat*, gazetari Alqi Kociko trajton problemin e mbetjes së Shqipërisë prapa në procesin e liberalizimit të vizave me Bashkimin Evropian që u bë e ditur ato ditë. *Kosova sot* në numrin e 5 nëntorit 2009, në editorialin *Abuzimet e fushatës*, trajton abuzimet që bëheshin nga partitë politike ato ditë të fushatës zgjedhore, ndërsa në numrin e 6 nëntorit 2009, në editorialin *Dyshimi për kufijtë*, trajtonte problemin e kufirit të Kosovës me Malin e Zi, nën dyshimin e humbjes së territorit të Kosovës të cilin e kishte shpallur një ditë më parë Lëvizja Vetëvendosje!

Aktualiteti i temës dhe rëndësia e temës e bëjnë editorialin mjaft shpesh që të ketë të njëjtën temë që trajton edhe kryeartikulli i

"Disa gazeta të mëdha kanë specialistë që paguhen vetëm për të shkruar editoriale. Te *Daily News* e Çikagos kjo dha shkas për një nga rrengjet më të bukura të gazetarëve. Gazeta, që njihet për tonet e larta moralizuese të editorialëve të saj, ftonte regullisht grupe lexuesish për t'i parë mjediset e punës. Duke e ditur që më parë orën e njerit prej këtyre takimeve, reporteri Juxhin Fild, më vonë poet, së bashku me një anëtar të stafit që shërbente si ciceron për lexuesit, kurdisën një plan. Me të hapur derën ku shkruhej "Editorialistët", ciceroni i prezantoi kryeinfiermeret e qytetit me shëmbëlltërynë e një njeriu që rrinte ulur në tryezë dhe hartonte një nga editorialët e devotshëm të gazetës. Ishte Fildi, i paruar e i shtrëmbëruar, veshur me uniformën e të dënuarit, lidhur me zinxhirë e gjyle. "Ky është një i besuar nga burgu lokal. Ka rënë për vrasje", shpjegoi ciceroni. "Kryeredaktori ynë, z. Stoun, është shumë dorështrënguar. Mendon vazhdimisht për shpenzimet e gazetës dhe shfrytëzoi ndikimin e tij për ta tërhequr një herë në javë këtë krijesë. Editorialist i lirë, e kuptoni? S'na kushton asnjë qindarkë".

Jay Robert Nash, në librin *Makers and Breakers in Chicago* (1985). Cituar sipas David Randallit, *Gazetari universal* (2003, botimi shqip).

gazetës. Kryeartikulli domosdo që trajton lajmin kryesor të ditës, e nëse ky lajm ka rëndësi të madhe për shoqërinë, atëherë edhe botuesi i gazetës ndjen të nevojës pozicionimin ndaj tij. Në marrëdhënien tema-mënyra e trajtimit të temës, në editorial nuk është në rend të parë e rëndësishme metodologjia e trajtimit të çështjes (sikur te artikulli analitik), por vetë qëndrimi dhe pozicionimi i botuesit për atë çështje dhe vetë tema e trajtuar. Kjo e përbën esencën e editorialit. Ai "duhet gjithnjë të thotë diçka, pra të mbajë një qëndrim".<sup>5</sup> Nëse një editorial i shkruar nuk ka një qëndrim të qartë, nuk ka një përgjigje për temën që trajton, është më mirë të mos botohet. Mallet e thotë shumë qartë e bukur: "Mos botoni artikuj redaksionalë (editorialë, B. K.) të tillë që do të përmblihdeshin në frazën: 'Kjo është një çështje tepër serioze që meriton studim'".<sup>6</sup>

Pozicionimi politik i botuesit në editorial e bën atë më të vlefshëm nëpër periudha të veçanta. Në kohë të vlimeve politike, në kohë të revolucioneve apo të ndryshimeve sociale, në kohë të krizave ekonomike apo morale, në raste të skandaleve politike apo qeverisëse etj., editoriali merr peshë më të madhe. Në kohë të qeta e paqeje editoriali humbet peshën e tij. Disa nga teoricienët e gazetarisë nuk e çmojnë shumë llojin dhe efektin e editorialit në gazetari. Poende, disa prej tyre, si Randallit, ironizojnë me të dhe gazetatat që praktikojnë tekstin e tij.<sup>7</sup>

Shkrimi i editorialit kërkon një mjeshtëri të madhe. I rëndësishëm është edhe procesi i të menduarit për temën dhe tekstin e editorialit: duhet menduar shumë se çfarë do të thoni dhe si do ta përkufizoni qëndrimin tuaj në editorial. Por shkrimi i tij duhet të jetë gjithnjë i thjeshtë, i pakomplikuar me argumente të gjata, por me argumente të kuptueshme dhe të shkurtra. "Përpiquni të shkruani sikur t'i drejtoheshit një personi të vetëm, një zyrtari, një pensionisti në rrugë, tezës suaj apo një djaloshi të zemëruar".<sup>8</sup>

Edhe një prirje është karakteristikë për editorialin: ai mëton t'u paraprijë dhe t'i parathotë temat, faktet, çështjet apo proceset për të cilat flet. Edhe pse editoriali nuk është tekst që ka për qëllim anticipimin e gjërave, autorët e tyre e bëjnë shpesh këtë, përkundër faktit se teoricienët e gazetarisë dhe gazetarët me përvojë rekomandojnë që të mos bëhet.

### XIII.3. NGJYRA POLITIKE E GAZETËS

Editoriali është teksti kryesor i gazetës vetëm në dy drejtime. Së pari, ai është fjala dhe pozicionimi i botuesit (pronarit, redaksisë)



ndaj temës së trajtuar, por botuesi aty merr rolin e institucionit, pra editoriali është fjala e medias si institucion dhe, si e tillë, meriton kujdes të veçantë. Së dyti, editoriali botohet në vendin e nderit në gazetë, apo jepet në minutazhet kryesorë në mediet audiovizuale. Ai botohet zakonisht si tekst njëkolonësh në anën e majtë apo në të djathtë e ballinës së gazetës, ose edhe në anët majtas-djathtas apo edhe në krye e në fund të faqes 2 e 3, por në të gjitha rastet ai është i kufizuar edhe grafikisht nga teksti tjetër i gazetës, në atë mënyrë që të bjerë shumë në sy dhe të kuptohet se është tjetër gazetari nga pjesa tjetër e gazetës. Edhe në rastin e parë edhe në të dytin rëndësia e editorialit merr karakter formal, përderisa teksti kryesor i medias, për nga përmbajtja e tij, mbetet kryeartikulli: derisa editoriali përmban qëndrimin e botuesit ndaj një teme, kryeartikulli përmban lajmin kryesor në 24-orëshin e fundit. Kështu, editoriali ka vendin e nderit, ndërsa kryeartikulli ka vendin kryesor në një gazetë.

Mirëpo, është një karakteristikë tjetër e editorialit e cila ia jep atij rolin parësor edhe përmbajtjesisht. Duke qenë se editoriali trajton vetëm tema që kanë të bëjnë me proceset kryesore të një shoqërie apo të një vendi, në të cilat tema botuesi duhet të marrë një pozicion të qartë e të prerë, editoriali ka një ngjyrim politik. Këtë ngjyrim ai ia jep edhe gazetës (apo cilësdo medie), duke e bërë edhe median me ngjyrë politike: nëse gazeta është e profilit të djathtë, editorialët e tij do t'i mbrojnë, para së gjithash, bizneset e mëdha; nëse gazeta është e profilit të majtë, editorialët e saj do të angazhohen për paqe e barazi sociale, e kështu me radhë; nëse gazeta është e një profili të caktuar social, për shembull feministe, editorialët do t'i mbrojnë me çdo kusht kërkesat, parimet dhe lëvizjet feministe e kështu me radhë. Dallimi kryesor midis medieve të majta, të qendrës e të djathta, midis medieve informative dhe bulevardeske, midis medieve të profileve të ndryshme sociale etj., përqendrohet pikërisht te editorialët dhe shumë më pak te tekstet e tjera. Edhe në rastet kur ndodh te tekstet e tjera ky përcaktim politik, ndodh vetëm në procesin e zgjedhjes së temës, po jo edhe në vetë tekstin gazetar. Ndërsa te editoriali, aty është vendi ku botuesi apo redaksia shpreh opinionet e veta politike, sociale, ekonomike...të majta, të qendrës, të djathta, të një profili të caktuar social, fetar, etnike etj.

Dallimi kryesor midis medieve të majta, të qendrës e të djathta, midis medieve informative dhe bulevardeske, midis medieve të profileve të ndryshme sociale etj., përqendrohet pikërisht te editorialët dhe shumë më pak te tekstet e tjera.

### **XIII.4. STRUKTURA E EDITORIALIT**

Struktura tekstore e editorialit është shumë e thjeshtë. Ai është një tekst i shkurtër, në të cilin gjërat thuhën shkurt e shqip, hyhet drejt e në temë, jepen një ose dy argumente për temën dhe jepet



**Struktura e editorialit**

Hyrja në temë

Argumenti

Qëndrimet-pozicionimet e autorit

qëndrimi (pozicionimi) i autorit ndaj problemit (apo vetëm emërohet problemi, pa një qëndrim të prerë), dhe me këtë pozicion të botuesit përfundon editoriali. Janë tri elemente përbërëse të tekstit:

1. Hyrja në temë (hyrja drejtpërdrejt në temë: kjo bëhet që në fjalinë e parë, gazetari na bind për rëndësinë e temës së trajtuar; mund të përdoren edhe tipa të tjerë të hyrjeve, si hyrja e vonuar, apo modele të ndryshme të hyrjeve, si hyrje me një fjalë të urtë, hyrje me një pyetje etj.);
2. Argumenti (autori jep një ose dy argumente kryesore për temën: mund të jenë argumente që japin një pozicionim të publikut për temën e mund të jenë edhe kundër-argumente, të cilat autori do t'i kundërshtojë në qëndrimet e tij);
3. Qëndrimet-pozicionimet e botuesit (botuesi jep pozicionimin e tij apo të redaksisë në lidhje me temën).

Ja një shembull i strukturës tekstore të editorialit:

**Ndëshkim apo llogaridhënie?**

Njëmbëdhjetë anëtarët e Gjykatës së Apelit të Shteteve të Bashkuara për *Ninth Circuit* me seli në San Francisko, kanë planifikuar për të dëgjuar të martën argumentet ligjore në një padi që përfshin akuza serioze të torturës.

Administrata e Presidentit Bush që përpjekur ta bllokojë këtë, duke e përshtatur si pjesë të fushatës së saj për të mbyllur të gjitha rrugët e llogaridhënies për politikën e saj të burgimit të pakontrolluar. Këtë herë, avokatët e Presidentit Obama do të bëjnë të njëjtat pretendime ekstravagante për fshehtësinë dhe fuqitë e ekzekutivit.

Pyetja e menjëhershme është, nëse njerëzit të cilët ishin dëmtuar nga politikën e presidentit Bush - në këtë rast pesë viktimat e "interpretimit të jashtëzakonshëm" dhe torturës - do të lejohen ditën e tyre në gjykatë ose do të heshtin para se çfarëdo dëshmie të jetë dhënë.

Gjykata duhet t'i rezistojë ftesës së ekipit të Obamës për të sakrifikuar parimet demokratike që të shmanget pamja e turpshme e atyre politikave dhe vendimeve, të cilat edhe zoti Obama vetë i ka dënua në mënyrë të përsëritur.

Administrata ka kërkuar procedimin *en banc* para trupit gjykues të zgjeruar, pasi një vendim nga një panel prej tre gjykatësve në prillin e kaluar hodhi poshtë argumentin se dega ekzekutive ka tagrin që ta heshtë padinë, sa herë që bëhet kërkesën emër të sigurisë kombëtare. Teoria e qeverisë, vërejnë pushtetarët, do të jetë "kordon efektivi përballë vështrimit të gjyqësorit ndaj të gjitha veprimeve sekrete, e imunitizon CIA-n dhe partnerët e saj nga kërkesat dhe kufizimet e ligjit."

Hyrja e drejtpërdrejtë në temë

Argumente për qëndrime të ndryshme ndaj temës

<p>Gjykata mund t'i bëjë një shërbim të madh publikut, nëse rri e patundur nga gjykimi dytësor i prillit, dhe ta lërë rastin të shkojë përpara. Po të mos i shpallë gjykata sjelljet në fjalë ilegale, asgjë nuk do ta pengojë asnjë administratë t'i arsyetojë ato vetëm si një e kaluar e bërë, dhe se rrëmbimi, burgosjet e fshehta, abuzimi dhe madje edhe torturat ishin krejtësisht të pranueshme, si përgjigje të shqetësimeve të sigurisë kombëtare.</p> <p>Rast pas rasti, administrata Obama ka përsëritur – dhe tepruar, në disa raste – se koha e Bushit është dizajnuar për të mbuluar veprimet e turpshme të kryera në emër të luftimit të terrorizmit dhe duke iu shmangur llogaridhënies për zyrtarët përgjegjës.</p>	<p>Qëndrime të autorit</p>
<p>Muajin e kaluar, për shembull, Departamenti i Drejtësisë ngriti një kërkesë në Gjykatën e Lartë kundër shqyrtimit të një padie nga viktimat e torturës.</p> <p>Kërkesa është arsyetuar se nuk kishte asnjë bazë për ankesat e ish-të burgosurve në Gjirin Guantanamo, pasi që, në kohën e burgimit të tyre, midis 2002 dhe 2004, nuk është vërtetuar (provuar) në mënyrë të vendosur se trajtimi i tyre ishte i paligjshëm.</p>	<p>Argumente shtesë</p>
<p>Ky mund të jetë argumenti më i egër që vjen nga ndonjë administratë. Por ai është edhe më zhgënjyes nëse vjen nga një që ka thënë se tortura është qartësisht e paligjshme.</p> <p>"Administrata e Bushit ka ndërtuar një kornizë ligjore për torturë," vëren Jameel Jaffer, i cili kryeson <i>American Civil Liberties Union's National Security Project</i>, "por administrata Obama po ndërton një kuadër ligjor për ndëshkim".</p> <p>Mbetet në gjykata që të përmbushin rolin e tyre kushtetues për të kontrolluar pushtetin ekzekutiv dhe për të siguruar llogaridhënien. Precedenti që do të vendos Gjykata Federale e Apelit për Ninth Circuit do të jetë kritik.</p>	<p>Përfundimet e autorit</p>
<p><i>New York Times</i>, publikuar më 14 dhjetor 2009  <a href="http://www.nytimes.com">www.nytimes.com</a></p>	

Titulli i editorialit është ose informativ ose vlerësues-pozicionues:

- Zgjedhjet para statusit
- Ilaçi i Brukselit
- Përqindja shqetësuese e votuesve
- Tre skenarë dhe një vlerësim
- Teoria dhe praktika e një koalicioni
- Fundi i vikend politikanëve
- Një ditë dhe dy epoka<sup>9</sup>

## XIII.5. LLOJET E EDITORIALËVE

Hamit Boriçi përkufizon tre lloje të editorialit: editorialin operativ, editorialin e përgjithshëm politik dhe editorialin propagandistik. Në aspektin strukturor këto editoriale nuk dallojnë, por në qëllimin përmbajtjesor po dhe, pikërisht mbi këtë bazë bëhet edhe veçimi i tyre. Ne do t'i përmbahemi këtij klasifikimi, por do të flasim edhe për dy prirje të reja editoriale: e para që shkon drejt krijimit të një tipi të ri të editorialit dhe, e dyta, një shfaqje pseudoeditorialiste. Duhet theksuar, po ashtu, se nuk është kjo e vetmja tipologji e editoriali: ka edhe të tjera, por më e përshtatshme, sidomos për nevojat e studentëve të gazetarisë, është kjo e Boriçit.

### XIII.5.1. EDITORIALI OPERATIV

#### Sipas Hamit Boriçit:

- Editoriali operativ
- Editoriali i përgjithshëm politik
- Editoriali popullarizues.

Në këtë lloj autori jep udhëzime se si duhet të vepohet për një çështje të caktuar: p.sh. autori trajton pozitën e vështirë të librit në tregun e Kosovës për shkak të çmimeve të mëdha dhe propozon të hiqet TVSh-ja në të gjitha prodhimet librore.

Ja se si e përfundon editorialin e saj, me titull *Abuzimet e fushatës*, gazeta *Kosova sot*, e datës 5 nëntor 2009:

Autoritetet e vendit duhet të distancohen nga akte të tilla dhe të kërkojnë ndjesë publike për shkeljet ligjore që bëhen nga zyrtarët qeveritarë. Mos distancimi inkurajon veprime të ngjashme edhe gjatë ditëve që kanë mbetur për të bërë fushatë deri në ditën e heshtjes zgjedhore, para 15 nëntorit. Nga ana tjetër, Ministria e Arsimit është dashur të tregohej më e rreptë në raport me përfshirjen e nxënësve në aktivitete politike. Por, si duket, të gjitha partitë politike po u konvenon nga pak kjo gjë, kështu që nuk po e bëjnë shumë të madhe dhe po vazhdojnë fushatën në të njëjtën mënyrë.

Autori i editorialit i udhëzon autoritetet e shtetit se si të sillen ndaj problemit të trajtuar.

### XIII.5.2. EDITORIALI I PËRGJITHSHËM POLITIK

Në këtë lloj autori trajton një temë të politike, shqyrton dhe anticipon veprime e procese të mundshme politike, duke u pozicionuar në raport me ato. Editoriali i mësipërm i *New York Times*-it, *Ndëshkim apo llogaridhënie?*, është i llojit të përgjithshëm politik. Si pamë, aty autori trajton një çështje juridike, e cila është e ndërthurur me politikën: a ka të drejtë qeveria amerikane, në emër të sigurisë kombëtare, t'i shkelë parimet themelore të demokracisë si, p.sh. ndalimi i burgimit të fshehtë, ndalimi i abuzimit dhe torturimit të të burgosurve, ndikimi i ekzekutivit në gjykatë etj. Pasi trajton këtë



temë, autori pozicionohet ndaj temës, pra merr një qëndrim, të cilin e afishon në editorial: nëse qeveria arrin t'i mbulojë me planin e sigurisë kombëtare ato veprime politikisht të turpshme, atëherë është rrezikuar themeli i demokracisë etj.

### XIII.5.3. EDITORIALI POPULLARIZUES

Në këtë lloj autori mbithekson një temë a një prirje publike të trasuar më herët, duke u dhënë zjarr apo duke i shuar ato. Kështu, për shembull, nëse qeveria zhvillon një politikë aktive për ruajtjen e mjedisit, botuesi i gazetës mund t'i japë mbështetje nismës përmes një editoriali në të cilin dëshmon se ajo nismë është e rëndësishme për shoqërinë. Në këtë lloj hyjnë edhe editorialët për festat e ndryshme, për përkujtimet apo për data të rëndësishme kombëtare, si janë editorialët për Ditën e Flamurit (28 Nëntor), për shpalljen e pavarësisë së Kosovës (17 shkurt 2008) etj. Ja një shembull i editorialit popullarizues:



#### Rituali

Të ulur para ekranit të vogël, shumica e kosovarëve, edhe këtë herë do t'ia mpijnë sytë programeve të mërzitshme të TV-ve kombëtare. Ishalla s'kanë përfshirë në skemën programore ndonjë telenovelë latine. Të njëjtat fytyra që na kanë ndjekur orë pas ore, të njëjtat këngë, të njëjtat personazhe, e njëjta rutinë, thua s'ka ndryshuar asgjë. Duke mos pasur zgjidhje tjetër për të festuar, banorët e UNMIK-ut (të paktën në letërnjoftim kështu deshifrohet) do ta rrethojnë sërish pas një viti tryezën historike, për të konsumuar ushqim të zgjedhur dhe muhabete pikante. Zakoni me siguri do të ruhet, pak raki për festë ia vlen. Edhe nëse teprohet në natën e fundit të vitit, falet.

Populli i thjeshtë i këtij territori të papërcaktuar ka me mijëra arsye për të ngritur dolli, sepse i ka mbijetuar edhe një viti të rëndë, 12 muajve mundimtarë, 365 ditëve të zorit, të vuajtjes, të territ. Të vetmit, të cilët s'kanë asnjë motiv për të festuar janë politikanët e Kosovës. Asnjë premtim i tyre s'është realizuar. Pavarësia s'erdhi. Jeta jonë u bë edhe më e vështirë, ndërsa e tyrja edhe më luksoze. Tryeza jonë e përditshme u "lehtësua", ndërsa e tyrja u mbush edhe më shumë. Në xhirollogaritë tona Viti i Ri s'do të gjejë as disa centë, në të tyret u depozituan miliona. Hendeku mes nesh dhe atyre u bë edhe më i thellë. Politikanët na bënë të kuptojmë se pakica e vërtetë e këtij vendi janë ata. Polarizimi i skajshëm i shoqërisë është meritë e pushtetarëve, lidhjeve të dyshimta me biznesin, korrupsioni, abuzimi me paratë e taksapaguesve. Ky minoritet i superpasur i shoqërisë formoi pashallëqe bren-

da pak muajsh, ndërsa shumica e qytetarëve mbeti e zhytur në pasiguri.

Megjithatë, shoqëria kosovare, pa kastën e saj politike, dëshmoi se është e denjë për shtetin. Ajo e kurseu veten nga protesta kundër mjerimit dhe hajnisë, nga rreziku i pazareve politike që bënë njerëzit e pushtetit në kurriz të Kosovës.

Për këtë arsye, njerëzit që sonte janë përreth tryezave familjare, kanë pse të festojnë. Të thjeshtët, të zhveshurit nga ofiqet, pushteti, partia, punëtorët, të papunët, studentët, e kaluan provën e madhe. Atë që s'e bënë politikanët, e bëri shoqëria në rrugën e saj të emancipimit dhe të durimit.

Gëzuar dhe ...pastë fund durimi!

*Kosova sot, e premte, 29,30,31 dhjetor 2006, 1 e 2 janar 2007*

Në cilëndo nga këto mënyra, editoriali është forma më e përshtatshme gazetare ku gazeta mund të marrë një qëndrim politik dhe ku propagandon atë qëndrim politik. Po ashtu, editoriali nuk mund të jetë një tekst gazetar në të cilin vetëm kritikohet apo kundërshtohet diçka apo dikush, sepse sikurse gazeta në tërësi, edhe editoriali si pjesë e saj paraqet jetën në përgjithësi, pra të mirat e të këqijat e saj, rrjedhimisht edhe ai duhet të jetë pasqyrim i jetës në gjerësinë e saj.

#### XIII.5.4. EDITORIALI I TEMËS

Në gjithë traditën e tij editoriali ka qenë tekst në të cilin botuesi është pozicionuar qartë dhe prerazi për një çështje. Në gazetarinë moderne shqiptare ka një prirje që e relativizon këtë traditë të editorialit: gjithnjë e më shumë mund të flasim për një formë të re të editorialit, të cilin do ta quajmë *editorial i temës*, e i cili nuk ka për qëllim pozicionimin e botuesit për temën, po vetëm ngritjen e temës. Ngritja e temës paraqet në vetvete një lloj pozicionimi të botuesit, sepse nga moria e temave ai po zgjedh një, pra po merr një pozicionim të tërthortë. Kështu, botuesi mund ta ngrehë temën e ngritjes së tatimit të vlerës së shtuar nga ana e qeverisë, pa marrë vetë një qëndrim të prerë se ka bërë mirë apo keq qeveria me këtë veprim. Vetë fakti se botuesi shkruan editorialin me atë temë, ka ndarë atë temë nga moria e temave të tjera të ditës, vetë ky fakt paraqet një diferencim të temës, pra botuesi po i jep rëndësi të veçantë, ai po merr një pozicion ndaj rëndësisë së temës. Ky tip i editorialit zakonisht shfaqet në temat politike, sepse botuesit e gazetave e kanë vështirë të marrin një qëndrim të prerë për të gjitha temat politike për shkak të dinamikës dhe ndryshueshmërisë së madhe të rrjedhave

politike, prandaj e konsiderojnë si më opurtune që të mos marrin një qëndrim të prerë apo një pozicion të qartë.

Në gazetarinë e sotme të Kosovës pothuajse është bërë rregull shkrimi i editorialëve pa një qëndrim të prerë për temën e trajtuar. Autorët e tyre kënaqen duke ngritur një temë, por nuk e kanë guximin e pozicionimit prerazi për temën. Ky model praktikohet zakonisht në editorialët e Zëri-t. Këto tekste gazetare përfundojnë në stilin: kjo çështje është një problem, pa të shohim se si do të zhvillohet ky problem e kjo, nëse rikujtojmë citatin e mësipërm të M. F. Mallet (shih pjesën e mësipërme për temën e editorialit), është në kundërshtim me korrektësinë e pozicionimit të qartë e të prerë në editorial.

Ja përfundimi i një editoriali të temës, në të cilin trajtohet lidhja e koalicioneve të interesit jopolitik në balotazhin e zgjedhjeve komunale të vitit 2009:

Vendi nga vjen ndotja e Kosovës (Kastrioti, sqarimi, B. K.), së bashku edhe me disa qytete e qyteza të tjera, si Klina, dëshmoi që koalicioni mes partive nuk nënkupton edhe koalicionin mes votuesve. Madje një koalicion i tillë në Obiliq, si pasojë e fjalëve të gojës për pazarllëqet duket se ndikoi që të fitojë LDK-ja. Pra, shpesh edhe është i dëmshëm.

Anash betejës së koalicionit qeverisës, më duket sikur fituesi më i madh i këtyre zgjedhjeve gjendet në Han të Elezit. Në fund të Kosovës u thye një tabu që nuk arriti ta thyej askush tjetër në Kosovë-fitoi një kandidat i pavarur.

Duket se Hani i Elezit, si komunë e re, po sjell edhe shumë të reja në Kosovë, një mentalitet të ri votues.

Zëri, "Belly Dance 2009" editorial i kryeredaktorit të gazetës, Astrit Gashi  
14 dhjetor 2009

Venerimi i një teme, por jo edhe pozicionim

Shikoni fjalinë përrbyllëse: "Duket se...". Këtu nuk ka pozicionim (nuk ka pasur as gjatë tërë editorialit), por vetëm paralajmërim i mundësive të reja.

Edhe pse e përkufizuar si lloj të veçantë të editorialit, megjithatë nuk e kemi evituar pyetjen nëse ky tekst është tip i editorialit apo dështim i autorëve në shkrimin e një editoriali të vërtetë? Nuk pretendojmë ta japim përgjigjen këtu, por pa marrë parasysh arsyet, ky tip i tekstit-editorial, për shkak të shfaqjes së shpeshtë e të gjatë në mediet shqipe, ka marrë tipare të editorialit të veçantë. Mund të pranojmë se shkrimi i tij nuk është gjithmonë dobësi e autorëve, por tendencë për krijimin e editorialit të temës. Në këtë pikë editoriali i temës përkon me kolumnën, e cila, po ashtu, ka një prirje për


hapjen e temave për diskutim publik. Ky editorial i temës dallon nga editoriali tradicional vetëm për mungesë të pozicionimit të botuesit ndaj çështjes së trajtuar. Botuesi kënaqet vetëm me faktin që ka ngritur një temë në rang të problemit me të cilin duhet të ballafaqohet shoqëria apo një strukturë e saj dhe me kaq e sheh të përfunduar punën e tij.

### XIII.5.5. EDITORIALI QË S'ËSHTË EDITORIAL

Në gazetarinë bashkëkohore, edhe në shqip, është duke u shfaqur një prirje për botimin e editorialëve të shkruar nga gazetarë, kolumnistë apo bashkëpunëtorë të gazetës. Këta editorialë botohen nën mbititullin "editorialë", ose Op-Ed (emërtim i krijuar prej dy nismëtareve të emërtimeve opinion dhe editorial) dhe luajnë rolin e editorialit. Botuesi me këtë fakt pranon qëndrimet dhe pozicionet e shprehura në tekst si të tijat, por autori i tekstit merr përgjegjësinë juridike për ato që ka shkruar. Po ashtu, botuesi në çdo implikim politik mund të tërhiqet dhe të thotë, "epo, ky nuk është qëndrim i gazetës sime!" Poende ka gazeta që thërrasin të shkruajnë editoriale edhe individë që nuk pajtohen shumë me politikën e gazetës, në raste të tilla gazeta kujdeset gjithnjë që në fund të tekstit "editorial" ta vërë shënimin se autori i këtij editoriali është aksh personi. Kështu është teksti i Fatos Lubonjës *Mbi kufirin detar dhe jo vetëm*, botuar në revistën Klan ([www.korrieri.com](http://www.korrieri.com)), në rubrikën Editoriale. Mirëpo, "editoriali" i Lubonjës ka një fillim ideal për një koment apo një kolumnë, e jo për një editorial:

Një lexues i shkrimeve të mijë më pyeste nëpërmjet internetit pse nuk jam prononcuar për punën e kufirit detar. E falënderoj që më dha rastin të shprehem për këtë çështje sepse, për të qenë i sinqertë, nuk kisha ndërmend të shkruaja pa ma kërkuar kush mendimin. Po pse nuk kisha ndërmend të shkruaja? Zakonisht heshtje të tilla nga shumica interpretohen si heshtje që flasin. Në këtë rast një heshtje e tillë mund të interpretohet se ky gazetar mund të jetë dakord me qeverinë apo se po konformohet. Edhe letra e lexuesit kishte një konotacion gati sikur më fajësonte që nuk kisha shkruar për humbjen e 370 km katror sipërfaqe ujore shqiptare.

Të këtillë janë editorialët e Ali Podrimjes, te Merxhan Avdylit etj. në gazetën *Infopress*. Kjo e fundit shkon aq larg sa për ta krijuar imazhin e gazetës liberale, porositë editorialë edhe prej individëve që janë larg politikave redaktuese të gazetës. Po kështu bëjnë edhe gazetatat me famë botërore.



Op-Ed mbizotërueshëm  
art i vitit, 2007 [http://www.  
nytimes.com/](http://www.nytimes.com/)



A janë këto tekste editoriale?

Vështirë që përmbushin qëllimin përmbajtjesor dhe strukturën tekstore të editorialit. Së pari për shkak të strukturës së tekstit, sepse këto tekste kryesisht janë komente të individëve për një çështje të caktuar. Së dyti, pozicionet e shprehura në tekst, pavarësisht nga mbititulli “editorial”, nuk janë qëndrime të gazetës, të redaksisë apo të botuesit, por qëndrime individuale.

Po pse e bëjnë këtë gazetatat?

Është thjesht çështje marketingu. Gazeta dëshiron të krijojë treg sa më të gjerë, pra rreth më të gjerë të lexuesve, dhe duke e shndërruar editorialin nga një zhanër në rubrikë, të cilën ua ofron një numri të caktuar të autorëve që s’kanë asgjë me gazetën dhe me redaksinë, për më tepër janë edhe larg politikave të gazetës, ajo përfiton më shumë lexues.

### **XIII.6. ÇËSHTJE TË STILIT**

Stili ligjërimit i editorialit është më i lartë se ligjërimi i zakonshëm gazetar, me disa premisa të stilit politik: gjuha ka funksion konativ, ndërsa teksti ka karakter propagandistik e popullarizues. Vetë tema e trajtuar dhe marrësi të cilit i dedikohet (shumica e marrësve nuk i lexojnë editorialët; vetëm ata me nivel kulturor mbi mesatar i lexojnë për ta parë pozicionimin e medias së caktuar rreth temave kryesore të shoqërisë) e bën stilin e editorialit të jetë më i lartë. Megjithatë, për shkak të shkurtësisë së tekstit, fjalitë janë shumë të shkurtra dhe paragrafët jo shumë të gjerë. Teksti i editorialit, edhe pse është e drejtë e pakufizuar e botuesit apo i redaksisë, nuk është tekst personal. Subjektiv-po, por jo personal.

Gjuha figurative mund të përdoret në titull, në hyrje dhe në përfundim të editorialit, por në masë të kufizuar, sepse shumësia e figurave në tekst të shkurtër e errësojnë kuptimin e tij. Janë shumë të përshtatshme frazeologjitë.

### **XIII.7. NGA HISTORIA E EDITORIALIT SHQIP**

Në gazetarinë shqiptare editoriali ka marrë famë në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Ai ka qenë i kultivuar edhe në gazetarinë e viteve ’30 të shekullit XX, por nuk ka qenë i njohur me këtë emër, por me emra si kryeartikull, artikull i redak-

sisë etj. Kjo është arsyeja pse edhe Boriçi e ngatërron editorialin me kryeartikullin: në një vend e njëjtëson kryeartikullin me editorialin e sotëm , ndërsa në një vend tjetër ai thotë se editoriali afrohet me kryeartikullin, por është tjetërsoj , ndërsa në një tjetër vend thotë se “editoriali e zëvendëson kryeartikullin, por nuk është tamam kryeartikull”. Por, editoriali dhe kryeartikulli ndryshojnë rrënjësisht. Kështu, më 12 shtator 2001 kryeartikujt e shumicës së gazetave botërore kanë qenë sulmet terroriste në Nju Jork, ndërsa editorialet kanë qenë pozicionimi i medieve ndaj kërcënimit terrorist për kulturën perëndimore.

## XIV. KOMENTI

## XIV.1. QËLLIMI PËRMBAJTJESOR

**K**omenti është një prej llojeve më të shpeshta të gazetarisë analitike. Fjala vjen prej latinishtes *commentarius* - procesverbal, përkujtues (është kalk i përkthyer nga greqishtja e vjetër e që kishte kuptimin e shënimeve zyrtare të zyrtarëve shtetërorë). Nisur nga vetë emërtimi, komenti është një lloj i tekstit gazetar në të cilin komentohet një çështje.

Presidenti amerikan Barak Obama paraqiti në Kongresin e ShBA-së konceptin e tij për reformën shëndetësore më 9 shtator 2009. Fjala e tij u prit me dyshime të mëdha, poende disa nga kongresistët republikanë e kundërshtuan ashpër. Xho Vilsoni nga Karolina e Jugut kishte thirrur “po gënjen” derisa presidenti fliste. Po atë ditë dhe të nesërmen mediet, bashkë me lajmin për reformën shëndetësore, e bartën edhe lajmin e sharjes së kongresistit Vilson. (Ky është lajmi.) Të nesërmen analisti Juxhin Robinson shkroi komentin me titull “Kështu nuk trajtohet një president!”, në të cilin e komenton, e interpreton dhe në fund jep mendimet e tij për sjelljen e kongresistit Vilson dhe të kongresistëve të tjerë republikanë gjatë fjalës së presidentit Obama. Ai e fillon artikullin me titullin gjykyes: “Nuk trajtohet kështu një president” dhe e përfundon duke i dhënë të drejtë plotësisht presidentit Obama në fillimin dhe në përfundimin e reformës shëndetësore në ShBA. Ky është komenti i Robinsonit për reagimin e kongresistit nga Karolina. Titulli i komentit të tij është ligjërim vlerësues: kështu nuk duhet të trajtohet një president! Autori jo vetëm komenton, por edhe interpreton e vlerëson.

Këto tri kategori të tekstit, komentimi, interpretimi dhe vlerësimi, e bëjnë komentin zhanër analitik. Qëllimi përmbajtjesor i komentit, përveç informimit, është edhe komentimi, interpretimi dhe vlerësimi i ngjarjeve lajmore ose i atyre ngjarjeve e fakteve që ndërliken në një mënyrë me lajmin, nga aspekti personal i komentuesit, me një tendencë për ta bindur marrësin. Pse janë të rëndësishëm komentimi, interpretimi dhe vlerësimi i gazetarit për ngjarjet lajmore dhe për ato që ndërliken me lajmet? Marrësi e merr lajmin dhe ai krijon një perceptim për informacionin që ka pranuar. Në shumicën e rasteve marrësi ngopet me kaq, por ka disa raste të tjera në të cilat ai nuk kënaqet me informacionin e marrë dhe kërkon edhe më tej ta kuptojë prapavijën e informacionit. Janë edhe dy arsye të tjera pse marrësi dëshiron të zhbirojë përtej informacionit parësor në lajm. Së pari, ngjarjet lajmore nuk ndodhin të vetme e

## PËRMBAJTJA

XIV. Komenti . . . . .	217
XIV.1. Qëllimi përmbajtjesor . . . . .	217
XIV.2. Tema e komentit	219
XIV.3. Elementet strukturore të komentit . . . . .	220
XIV.3.1. Titulli . . . . .	220
XIV.3.2. Hyrja: Paraqitja e temës dhe llojet e hyrjes . . . . .	221
XIV.3.3. Argumentet e temës . . . . .	225
XIV.3.4. Kundër-argumentet . . . . .	226
XIV.3.5. Interpretimet dhe përfundimet . . . . .	227
XIV.4. Një strukturë tjetër e komentit . . . . .	228
XIV.5. Ligjërimi konativ dhe çështje të tjera të stilit . . . . .	229
XIV.6. Nga historia e gazetarisë shqiptare . . . . .	230
XIV.7. Një shembull metodik për studentët: . . . . .	231
XIV.8. Analiza strukturore e një komenti: . . . . .	232



Obama: Reforma në shëndetësi



Joe Wilson, kongresmen republikan i Karolinës Jugore: "You lie!" ("Po gënjeni!")



Qëllimi përmbajtjesor i komentit, përveç informimit, është edhe komentimi, interpretimi dhe vlerësimi i ngjarjeve lajmore ose i atyre ngjarjeve e fakteve që ndërlidhen në një mënyrë me lajmin, nga aspekti personal i komentuesit, me një tendencë për ta bindur marrësin.

të shkëputura nga rrethanat sociale, përkundrazi shumica prej tyre janë rrjedhojë e një vargu të komplikuar ngjarjesh, veprimesh dhe konjunkturash të tjera sociale, politike, ekonomike dhe kulturore. Qoftë edhe një ngjarje lajmore e zakonshme, përsëri ka një varg lidhjesh të ndërthurura sociale: personi i ngjarjes ka një familje, një rreth shoqëror, ka ardhur nga diku apo ka qenë duke shkuar diku, ose në rastin më të skajshëm, nuk janë asnjë nga këto, vetë ngjarja, cilado që të jetë ajo, ka një ndërlidhje komplekse me shoqërinë. Marrësi, duke pranuar informacionin parësor të një lajmi, dëshiron të kuptojë se si ai informacion ndërlidhet me faktorë të tjerë socialë dhe me rrethanat sociale. Njeriu për nga natyra e tij është zhbirues dhe, pas çdo lajmi të pranuar, synon të kuptojë lidhje të tjera dhe refleksione të tjera të atij lajmi. Së dyti, marrësi mesatar nuk është në gjendje ta plotësojë kërkesën e vet për të ditur përtej lajmit, edhe nëse është një marrës mesatar, me një përgatitje akademike mesatare, por edhe nëse ka përgatitje të lartë akademike, përsëri ai ose nuk ka kohë t'i përcjellë rregullisht e hollësisht lajmet për t'i kuptuar deri në fund ato, ose edhe nëse e bën këtë, përsëri është i interesuar të ketë edhe një koment, një opinion, një interpretim a një vlerësim të dikujt tjetër për temën e interesuar. Në të gjitha këto raste, komenti ka atë qëllim përmbajtjesor: të komentojë e të interpretojë një ngjarje lajmore dhe faktorë të tjerë që ndërlidhen me të. Pra, interesimi i marrësit për të kuptuar më tej informacionin se çfarë po ndodh në prapavijë të lajmit, ose për të kuptuar se çfarë ndikimi ka një ngjarje lajmore në rrjedhat e mëtejme sociale, është nxitësi dhe gjeneruesi i këtij lloji zhanror analitik. Gazetari edhe në këtë rast është në shërbim të sqarimit e të kthjellimit të mëtejme të informacionit për interesat e publikut.



Secili ka një mendim a një koment të tij. Ata duhet të thuhet.



## XIV.2. TEMA E KOMENTIT

Në koment trajtohen tema të njohura për publikun. Nuk mund të jetë subjekti i komentit një temë krejt e panjohur. Në një rast të tillë komenti i synuar do të shndërrohej në lajm. Vetëm pasi të ketë një lajm për një ngjarje lajmore, gazetari fiton temën e tij për ta komentuar e, në anën tjetër, marrësi ka nevojë për një koment më shumë për atë ngjarje lajmore. Në shembullin e mësipërm Juxhin Robinson e shkruan komentin vetëm pasi ka pasur një lajm se si është kundërshtuar presidenti Obama në Kongresin amerikan. Prandaj gjithnjë tema kryesore e një komenti tashmë është e njohur për publikun, e ky i fundit interesohet jo për vetë temën, por për mendimin, komentin dhe interpretimin e gazetarit për atë temë.

Konstatimi i fundit na nxjerr te parimi që ka të bëjë me rëndësinë e temës: esenca e komentit nuk qëndron në zgjedhjen e temës me rëndësi të madhe dhe aktuale (sikur është rasti te kryeartikulli), por te mënyra e trajtimit të kësaj teme, veçanërisht aftësia e komentuesit për ta komentuar dhe ndërlidhur temën me faktorët që prekin interesin e shoqërisë. Në anën tjetër, sa do tema nuk e përcakton komentin, ajo nuk mund të jetë e parëndësishme dhe jo aktuale. Publiku nuk do të kishte kurrfarë interesi për komentin e një gazetari për një temë krejt të parëndësishme. Në anën tjetër, vetë gazetari nuk do të kishte kurrfarë motivi të komentonte një ngjarje krejt të pavlerë. Supozojmë sikur gazetari ta komentonte mungesën e një kapaku të pusetes në një rrugicë të qytetit.

Natyra gjenealogjike e temës së komentit është e dyllojshme:

- Tema që vijnë nga një ngjarje konkrete, nga një veprim a nga një situatë (egjiptianët filluan kryengritjen përmes demonstratave kundër regjimit të Hosni Mubarakut dhe gazetaret e komentuan nga aspekte të ndryshme, si komenti i Xhorxh F. Uillit me titull "Revolucioni i Egjiptit, fitore a humbje!"; Rregullatori i Energjisë ka ngritur çmimin e energjisë për 13 % dhe, duke qenë ky një veprim që mund ta prishë paqen sociale, për shkak të ndikimit të madh në financat e pakta të qytetarëve, nxitit shkrimin e shumë komenteve; dorëheqja e presidentit të Kosovës Fatmir Sejdiu në vitin 2010 nxitit komente të shumta gazetare se çfarë ndikimesh do të ketë në skenën politike në Kosovë dhe në Lidhjen Demokratike të Kosovës;
- Tema që lindin nga një koncept a nga një ide (ideja e bashkësisë ndërkombëtare për fillimin e bisedave "teknike" midis Kosovës dhe Serbisë në vitin 2010 nxitit shumë komente gazetare; raporti i Dik Martit, deputet zviceran në Këshillin e Evropës, me preten-

dimin për trafikim të organeve njerëzore gjatë luftës së Kosovës, u bë temë e dëshirueshme për shumë gazetarë e politikanë, e kjo rezultoi me një varg komentesh, si është edhe komenti i ish-ministrit britanik për Ballkan dhe anëtar i Parlamentit Britanik, Denis MekShejn<sup>15</sup>; ose komentet e shumta për imazhin e Kosovës pas zgjedhjeve të dëmtuara të 12 dhjetorit 2010 dhe pas raportit të Dik Martit etj.)

Mbi bazë të kësaj ndarjeje tematike janë krijuar dy lloje të komenteve:

- Komenti konkret (trajton një temë konkrete, tema që janë ngjarje dhe veprime praktike; p.sh.: Çka i sjell Kosovës vizita e ish-presidentit amerikan Bill Klinton?);
- Komenti i përgjithshëm (trajton një temë të përgjithshme, konceptuale etj; p.sh.: A duhet të mbahen zgjedhjet e parakohshme pas deklaratës së kryeministrit, se qeveria ka vështirësi në funksionim?).

Kështu, Enver Robelli shkruan komentin *Shtetet e vjedhësve të qengjave*<sup>16</sup> me temë marrëdhëniet BE-shtetet e Ballkanit, mbas publikimit të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2009. Tema e zgjedhur për këtë koment është e rëndësishme, sepse ai raport është një tregues neutral i shkallës së zhvillimit në parametrat themelore të një shoqërie. Ajo temë është e rëndësishme veçanërisht për Kosovën, sepse Kosova në atë raport kritikohet në shumë drejtime, sidomos për keqeverisje, për korrupsion, për ndërhyrje të qeverisë në media etj. Autori komenton se nuk është fajtor Raporti i Progresit i BE-së, as "mësuesi" Oli Ren "me shkop në dorë", por janë fajtores vetë shtetet e Ballkanit, përkatësisht elitat e tyre politike që e synojnë pushtetin jo për të qeverisur dhe udhëhequr popullin, por për të përfituar vetë dhe grupet e tyre të interesit. Pra, kjo lidhje e temës me shkollat qeverisëse në vendet e Ballkanit i krijon mundësinë autorit të shtrojë dhe ta komentojë një temë shumë interesante për publikun.

### **XIV.3. ELEMENTET STRUKTURE TË KOMENTIT**

#### **XIV.3.1. TITULLI**

Titulli i komentit, duke qenë komenti një mendim subjektiv i gazetarit, nuk mund të jetë neutral. Ai gjithmonë ka një mesazh të gazetarit e jo një informacion. Ai ka një ngarkesë informacioni dhe komenti. Ja disa tituj:

- Konkurs për pozita: President, Kryeministër, Kryeparlamentar<sup>17</sup> (koment për pazarllëqet për krijimin e qeverisë pas zgjedhjeve të 12 dhjetorit në Kosovë; titulli ironizon duke sugjeruar formulën e zgjedhjes);
- Kohë kur morali shndërrohet në mall<sup>18</sup> (koment për devalvimin e moralit politik rreth formimit të koalicioneve qeverisëse dhe bashkimeve të partive politike në Kosovë pas zgjedhjeve të 12 dhjetorit 2010; titulli është konstatim pezhorativ);
- Tërheqja nga lufta kundër drogës<sup>19</sup> (koment për dështimin e shumë qeverive të botës për të luftuar kundër drogës dhe kar-televe të drogës me sukses, duke theksuar suksesin e disa vendeve si Zvicra e Portugalia në këtë luftë; titulli sado që duket neutral, është vlerësues);
- Revolucioni i Egjiptit, fitore a humbje<sup>20</sup> (koment për kryengritjen në Egjipt; titulli shumë aludues në mundësinë që ky vrull i popullit egjiptian për demokraci të përfundojë me krijimin e një sistemi teokratik, si në Iran etj.);
- AAK e mbetur pezull<sup>21</sup> (koment për pozitën e pavolitshme dhe të pidentifikuar të AAK-së pas deklarimit se nuk do pa LDK-në të jetë pjesë e koalicionit me PDK-në; titulli tregon mendimin e autorit për këtë pozicion të AAK-së).

Në të gjithë këta tituj ka një ligjërim vlerësues, pavarësisht a është thënë vlerësimi hapur apo tërthorazi. Në secilin titull vlerësimi është i autorit të komentit.

Titulli i komentit është si brendi për një prodhim: ai nuk e bart informatën kryesore, por e paraqet shkëlqyeshëm thelbin e komentit. Kjo i bën gazetarët të përdorin frazeologji dhe figura të tjera stilistike për të goditur sa më mirë cakun: dmth. të lënë mbresë te lexuesi, në mënyrë që ai të mos e kalojë faqen tjetër pa e lexuar tekstin.

#### XIV.3.2. HYRJA: PARAQITJA E TEMËS DHE LLOJET E HYRJES

Hyrja në koment shërben për ta paraqitur temën. Nëse gazetari zgjedh modelin e hyrjes së drejtpërdrejtë, atëherë ai duhet ta paraqesë temën e tij në atë mënyrë që të arrijë dy caqe: e para, ta bindë marrësin se tema që komenton është e rëndësishme së veçantë, asi teme që ka ndikim në rrjedhat e mëtejme sociale etj.; e dyta, që në fillim ai duhet ta bindë marrësin ta vazhdojë leximin, pra duhet të zgjedhë modele fjalish, shprehjesh apo mendimesh të cilat e bindin

Titulli i fuqishëm!

**Konkurs për pozita: President, Kryeministër, Kryeparlamentar**

Titulli  
Hyrja  
Argumentet e temës  
Kundërgargumentet

Hyrje e drejtpërdrejtë  
Hyrje personale  
Hyrje me frazeologji a me fjalë të urtë  
Hyrje induktive  
Hyrje deduktive  
Hyrje me një shembull  
Hyrje e vonuar  
Hyrje me barsoletë  
Hyrje me një detaj  
Hyrje me një çështje interesante.

marrësin për ta ndjekur më tej komentin. Edhe pse gazetarët e mirë që shkruajnë komente të mira kanë një numër të konsiderueshëm të lexuesve të rregullt, pikërisht arritja e këtyre dy caqeve të mësipërme ka bërë që ata marrës ta ndjekin gazetarin nga komenti në koment. Fatos Lubonja e nis një koment të tij duke shprehur vendimin e tij për ta shkruar komentin të nxitur nga një lexues:



Një lexues i shkrimeve të mijja më pyeste nëpërmjet internetit pse nuk jam prononcuar për punën e kufirit detar. E falënderoj që më dha rastin të shprehem për këtë çështje sepse, për të qenë i sigurt, nuk kisha ndërmend të shkruaja pa ma kërkuar kush mendimin. Po pse nuk kisha ndërmend të shkruaja? Zakonisht heshtje të tilla nga shumica interpretohen si heshtje që flasin. Në këtë rast një heshtje e tillë mund të interpretohet se ky gazetar mund të jetë dakord me qeverinë apo se po konformohet. Edhe letra e lexuesit kishte një konotacion gati sikur më fajësonte që nuk kisha shkruar për humbjen e 370 km katror sipërfaqe ujore shqiptare.

Fatos Lubonja  
("Mbi kufirin detar dhe jo vetëm", [www.korrieri.com](http://www.korrieri.com))

Gazetari amerikan Farid Zakaria e nis komentin e tij "Britmat e Bibit" me një shprehje frazeologjike angleze, e cila të tërheqë për të parë se si do të përfundojë ajo punë e filluar:



Në marrëdhëniet ndërkombëtare sa herë që dëgjohet termi "ndërtimi i masave të sigurisë" jini të sigurt se dikush do të mundohet ta shkëlmojë një kënaçe në rrugë.<sup>22</sup>

Modelet e hyrjeve në koment janë të shumta, poende nuk mund të bëhet një tipologji e të gjitha hyrjeve, sepse duke qenë komenti një tekst personal deri në një farë mase, gazetari është i lirë gjithnjë të shpikë forma dhe modele të reja të hyrjes. Megjithatë, mund të diskutohen disa prej hyrjeve më të shpeshta.

**Hyrje e drejtpërdrejtë** (që në paragrafin e parë gazetari e paraqet temën të cilën e komenton):



Pikërisht kur rozët ndodhen në mes të mandatit të parë të pas tetë vjetëve të bluve dhe në fatin e tyre po ridëshmohet e zakonshmja e vërtetuar deri tani në dinamikën e çdo force politike në qeverisje, shenjat e rënies të energjisë së fillimit, njëri prej protagonistëve të tyre, ministër që bënte dhe shpërndante vazhdimisht foto me fëmijë, pensionistë dhe romë, e fitoi shumë bindshëm të drejtën për të administruar qytetin më të madh të të gjithë shqiptarëve.

Ylli Polovina  
"Erion Veliaj, ky ambicioz", Shqip, 14 Gusht 2015



Ka ca përpjekje për ta vizatuar Edi Ramën si diktator të rrezikshëm. Janë të moçme këto përpjekje. Datojnë qysh në kohët kur Partia Socialiste ishte në opozitë. Ndoshta edhe më përpara. E kanë burimin te studioja e Opinionit të TV Klanit, dhe te kolegët e mi, që e kanë frekuentuar shumë shpesh atë studio, mes të cilëve kanë rënë në sy Lubonja, Shkullaku, Çani (në mënyrën e tij), Bejtja, vetë Fevziu, deri diku Bushati. Dëgjohej shpesh ato kohë të lëshohej alarmi se "Rama është si Berisha, madje më keq se Berisha".

Mustafa Nano

"Z. Kryeministër, na thoni një fjalë për ekonominë!", *Shqip*, 5 Gusht 2015



Mustafa Nano  
Një nga komentuesit e shpesh-të shqiptarë

**Hyryja e vonuar me barsoletë** (në paragrafin hyrës tregohet një barsoletë e cila ka lidhje të drejtpërdrejtë me temën e komentuar; në shembullin e mëposhtëm barsoleta për mbytjen e bretkosës synon ta barasvlerësojë veprimin e qeverisë së Sali Berishës ndaj përmbytjeve në Shkodër në vitin 2010):

### Asnjë i vdekur, përveç Shkodrës!

Një gazetar i njohur i kohës së Millosheviçit në Beograd, në përpjekje për të portretizuar një shoqëri të traumatizuar nga fatkeqësitë dhe propaganda, sillte në fund të viteve '90 një shembull shumë ilustrues. "Nëse merrni një bretkosë dhe e hidhni në ujë të përvëlur, - thoshte ai, - ajo do kërcejë menjëherë nga uji dhe do të shpëtojë. Nëse doni ta vdisni, futeni në ujë të ftohtë dhe ngroheni ujin pak nga pak."

Pak a shumë kjo po ndodh me reagimin e qeverisë dhe publikut për fatkeqësinë në Shkodër, ku kryeministri po lavdërohet për një rrezik që nuk do ekzistonte pa qeverinë e tij dhe po hesht për një pasojë që po ashtu s'do të ishte, po të mos ishte administrata e tij.

Mero Baze,

TemAonline, 11 Janar 2010, [www.gazetatema.net](http://www.gazetatema.net)

**Hyryje me një detaj** (gazetari merr një detaj, i cili është përfaqësuesi më i mirë i temës që e trajton; në shembullin e mëposhtëm tema e komentit është dobësimi i veprimit të qeverisë së Edi Ramës, e cila nuk tregohet e aftë t'i ekzekutojë ligjet që vetë i harton):

Baret në Tiranë kanë nisur të vendosin sërish hapur, pa merkun e dikurshëm formal, tavllat e duhanit. Tani nuk ka më nevojë të pyesësh kamerierin nëse lejohet të pihet ndonjë cigare fshehurazi. Thjesht mund ta nxjerrësh paketën dhe ta nderësh cigaren e radhës pa u preokupuar fare. Askush nuk do të vijë të të kapë për xhakete. Ligji për duhanin është në fuqi, por ai shkelet hapur, në mes të kryeqytetit. Për pjesën tjetër të territorit, si zakonisht, s'ia vlen të vrasësh mendjen. Andej ka qenë dhe është tokë e askujt.

Skënder Minxhozi

"Nuk kanë fuqi as të shohin, as të dëgjojnë", *Shqip*, 5 Mars 2013





Enver Robelli  
Autor komentesh të guximshme



Aleksandër Çipa  
Një nga komentuesit më jemprehtë shqiptar

### Hyrje e vonuar me deduksion:

Është një ritual që përsëritet çdo vit. Një mësues me shkop në dorë, i njohur në opinion me emrin Olli Rehn, shfaqet para armatës së mediave në Bruksel dhe tregon çfarë nota kanë marrë vendet e Ballkanit në dymbëdhjetë muajt e fundit.

Enver Robelli  
"Shtetet e vjedhësve të qengjave", Koha ditore, 18 tetor 2009



### Hyrje me një fjalë të urtë:

"Hajduti i këndshëm keqas më grabit/ i bëhem shok në vend që ta padis". Ky është një distik i shumëpërmendur nga krijimtaria e Shekspirit. Por vlen për të karakterizuar raportet e bashkëjetesës në të njëjtën qeverisje të një LSI-sti të korruptuar dhe një socialisti të penguar për ta bërë këtë gjë. Në këtë qeverisje po spikat si në një marrëdhënie komike liria dhe privimi për të bërë korrupsion mes dy anëtarëve të së njëjtës qeverisje.

Aleksandër Çipa  
"Aleati i këndshëm, keqas më grabit...", Shqip, 11 Gusht 2015



### Hyrje me induksion (gazetari niset nga një fakt apo përvojë personale, për të ardhur në fund në një përfundim të përgjithshëm):

Në postën tëndë elektronike ka mbërritur mesazhi i një profesori të mirënjohur, rreth një artikulli që ke botuar së fundi. Deri këtu nuk ka asgjë të re, pasi sot komunikohet me të gjithë, nga akademikët zëmëdhenj zhytur në palimpsestet e shkencës e deri te fëmijët e vegjël plot kureshtje për botën. Ajo që të "befason" në këtë rast është se të shkruan një zotëri që i duhen vetëm sa gishtat e dorës vite për të kurorëzuar shekullin. Profesor Ismet Elezi, i lindur njëherësh me Kongresin e Lushnjës dhe pagëzimin e Tiranës kryeqytet, një nga titullarët e Drejtësisë shqiptare. Aktiv dhe i freskët si në djalërinë e tij të largët buzë Jonit. Dhe nuk është i vetmi i tillë, bile nuk kanë dalë nga skena dhe më të moshuar se ai. Profesori merret përditë me letrat, skedat, artikujt, botimet e fundit, siç e kemi vënë re dhe kur kemi qenë në shtëpinë e tij, çka ngjjet me të gjithë diturakët. Tema qendrore e studimeve të tij ka qenë shteti i së drejtës. 150 tituj në Bibliotekën Kombëtare mbajnë firmën e profesor Ismetit, punime në fushën e së Drejtës Penale dhe historisë së saj, studime, monografi, artikuj shkencorë, recensione etj. Ai është dhe autor i veprës së njohur "Kanuni i Labërisë" (2006).

Ndue Dedaj  
"Lisa të mëdhenj të shkencës", Shqip, 7 Gusht 2015



### XIV.3.3. ARGUMENTET E TEMËS.

Pasi është shtruar dhe paraqitur tema e komentimit, paragrafi (rrallë ndonjëherë më shumë se dy paragrafë) vijues përmban argumente dhe fakte që mbështesin temën e shtruar dhe fillon me analizën e këtyre argumenteve e fakteve. Argumentet dhe faktet mund të jenë të njohura për publikun dhe autori i sjell në tekstin e tij për ta shtruar bazën për kundër argumentet e tij. Argumentet e temës nuk i zgjedh autori sipas interesit të tij, por i zgjedh argumentet kryesore të temës me të cilat e argumenton ekzistimin e problemit ashtu si është.

Ja argumentet e temës së Skënder Minxhozit, “Nuk kanë fuqi as të shohin, as të dëgjojnë”:



Ky detaj në dukje anësor, është në fakt një ndër sinjalet e alarmit për një fenomen tejet më të madh e përfshirës. Qeverisja në Shqipëri ka hyrë në një fazë ku e ka të vështirë të pulsojë, të reagojë ndaj së keqes. Vidhen afresket nëpër kishat e vjetra, shteti thotë se nuk mund të vendosë nga një polic pranë çdo monumenti, rrezikon të bjerë mozaiku i Muzeut Kombëtar në qendër të Tiranës, sërish përgjigjja është e njëjta: s'kemi ç'bëjmë. Më tej akoma, vriten pafund shqiptarë e shqiptare nëpër rrugët e qyteteve e fshatrave, qeveria numëron të vrarët dhe ngre supet, shpërndahen diploma false që plasin si skandale edhe në shtypin e huaj, universitetet në fjalë vijojnë të qeta punën, grabiten edhe shinat e trenit për skrap, prapë nuk përgjigjet askush, plas korrupsioni në mes të ditës në të gjitha porët e shtetit, asnjëri nuk mban përgjegjësi, shiten hormone të ndaluara që e kthejnë mishin e qumështin shqiptar në bartës potencialë të sëmundjeve kancerogjene, institucionet e shtetit fshehin kokën si struci dhe ankohen, pasi Kosova “po na bën konkurrencë”. Komisionari evropian, Fyle, tha para tri ditësh, se mbajtja e një referendumi për tri ligjet e paaprovuara, shkon kundër skenarit që kishin ofruar vendet anëtare, për të gjetur zgjidhje kompromisi e për të shmangur tensionet politike. Para tij, ambasada amerikane ishte shprehur e tronditur, sesi mund të jepej pafajësi për persona me pushtet, për të cilët kërkoheshin 48 vjet burg nga prokuroria. Që të dy, edhe Brukseli, edhe Uashingtoni, mësuam e po mësojnë përditë se çfarë do të thotë të kesh të bësh me një qeveri që nuk është e aftë të reagojë për zullumet që shkakton rrugës.

Si shihet, Minxhozi ende nuk ka shprehur asnjë argument apo mendim të tij. Ai thjesht ka mbledhur argumentet më të rëndësishme, sipas tij, të cilat e paraqesin qeverinë Edi Rama në paaftësi për ta bartur barrën e ekzekutivit. Të gjitha këto argumente janë

publike, pra marrësi është i njoftuar me to. Por, me këtë renditje dhe me fillin kritik që e bën komentuesi ai e ka përgatitur bazën për t'i shkrehur kundërgargumentet e tij dhe në fund interpretimin e tij në bazë të kundërgargumenteve.

#### XIV.3.4. KUNDËR-ARGUMENTET

Pasi t'i ketë sjellë argumentet e temës, autori fillon analizën e tij të argumenteve të temës dhe sjell argumentet e tij, interpreton ato, duke shtruar kundërgargumente e kundërfakte.



Papërgjegjshmëria është një simptomë e rregullt e qeverisjeve që ndodhen në kurbën rënëse dhe që s'kanë më për t'u thënë ndonjë gjë shtetasve të tyre. E kemi parë këtë fenomen në mesin e viteve 2000, kur socialistët e lodhur e të përçarë, si në fabulën e ujkut me gomarin, kujtonin se ishin në një ëndërr të keqe dhe se nuk do t'i humbnin zgjedhjet e radhës. I humbën edhe zgjedhjet, edhe përkrahjen popullore, sepse nuk patën fuqinë dhe kurajën që të luftojnë të keqen që i kishte mbështjellë. Një panoramë identike po na shpaloset sot para syve. Qeveria aktuale po na tregon përditë se nuk ka fuqi as ta shohë, as të dëgjojë dhe aq më pak ta luftojë të keqen që e ka kapur atë dhe vendin për tyti. Katër zyrtarë të lartë të Policisë së Shtetit u shfaqën në foto, teksa pinin raki e hanin turshi me një person të cilin aktualisht e akuzojnë edhe ata vetë, si autorin e vrasjes së një kolegu të tyre. Që të gjithë dolën me vrap në media dhe dhanë variante të ndryshme për momentin e fotove dhe arsyen e prezencës së atij personi në tryezë. Vetë personi i akuzuar i përgënjeshtroi të gjithë, kur tha se nuk ishte rastësisht në atë tavolinë dhe se i kishte miq zyrtarët në fjalë. Pak orë më vonë, ministri i brendshëm doli e hodhi akuza të rënda për deputetë të opozitës, përfshirë aludimet për sëmundje të rënda ngjithëse si AIDS(!), por ç'është më skandalozja, zbuloi indirekt se opozita përgjohet e ndiqet gjatë gjithë ditës. Akrobacitë e Flamur Nokës ishin jo vetëm vështirësia e një zyrtari në hall, por edhe prova e radhës, se shtefi ka humbur sensin e masës dhe të orientimit.

Në këtë pjesë të komentit autori i shpalos argumentet e tij: ai konstaton se qeveria është në kurbën rënëse dhe se më nuk ka çfarë t'i ofrojë qytetarit, pastaj merr shembuj analogë për të dëshmuar këtë etj. Kjo është pjesa më e rëndësishme e komentit. "Interpretimi është procesi kryesor i komentit", thotë Boriçi.<sup>23</sup> Mënyra se si autori i interpreton këto fakte e kundërfakte, argumente e kundërgargumente, teza e kundërteza, do ta përcaktojë edhe përmbylljen e komentit.



Mënyra se si bëhen këto interpretime tregon edhe për shkallën e ngritjes kulturore, deri-diku edhe për orientimin politik të autorit.

#### XIV.3.5. INTERPRETIMET DHE PËRFUNDIMET

Mbyllja e komentit është një rrjedhojë logjike e interpretimit të argumenteve e fakteve nga ana e autorit. Autori, pasi ka analizuar dhe interpretuar faktet e rëndësishme që lidhen me temën e trajtuar, nxjerr përfundimet e tij, një apo më shumë, në fund të tekstit apo edhe në vende të tjera, e ato janë mesazhe të autorit për të ndikuar në mendjen e marrësit. Kjo është pika e dytë që e dallon komentin nga llojet e tjera gazetares, p.sh., nga artikulli analitik. Pra, autori i komentit e përmbyll tekstin me përfundimet, qëndrimet dhe sugjerimet e tij. Analiza e fakteve, argumentimi i tyre etj., pak a shumë është analoge me metodën e shkrimit të artikullit analitik, ndërsa dallimi qëndron te përfundimet që autori nxjerr në fund të tekstit. Derisa tek artikulli analitik ato përfundime janë rrjedhojë e drejtpërdrejtë e argumentimit të fakteve (pavarësisht nga përvoja empirike e autorit), te komenti këto përfundime identifikohen ekskluzivisht me përvojën empirike të autorit, e në opinionin publik ato pranojnë si të tilla - si qëndrime të autorit.

Ja përfundimet e komentit që po analizojmë:

Kësaj qeverie nuk i ka mbetur gjë tjetër, veçse të bëjë atë që në fakt Berisha e ka bërë që nga dita e parë që është ulur në poltronin e Kryeministrit: të merret me opozitën. Opozita e opozitës është faktikisht një fenomen mjaft i përhapur, si në jetën politike, ashtu edhe në atë mediatike. Përkundër sloganit "Fajin e ka Saliu" (që do të kishte kuptim në një masë të konsiderueshme të rasteve), dëgjohet dendur prej vitësh edhe slogani "Fajin e ka Rama". A thua se pozita dhe opozita janë dy realitete identike, që i dallojnë vetëm disa detaje të parëndësishme.

Në këta muaj kotësie qeveritare, kur shifrat nuk përputhen, kur kriza rëndon mbi financat e xhepat e shqiptarëve dhe kur imazhi i qeverisjes vlen sa një shami e përdorur, ashpërsimi fals i luftës me opozitën po rezulton si e vetmja "gjetje" për qeverinë tetëvjeçare, që sot s'ka ç't'i ofrojë më askujt. Përveç ministrave dhe zyrtarëve të lartë të saj, që në këto dy mandate shtuan vilat dhe majmën kontot bankare.



## XIV.4. NJË STRUKTURË TJETËR E KOMENTIT

Struktura e përmblytur e komentit.

Struktura e komentit të cilën e shqyrtuam më lart nuk është një dhe e vetme. Ka edhe një model tjetër të strukturës tekstore të komentit, që është e afërt me modelin e lajmit, *piramida e përmbysur*. Në këtë koment pjesa kryesore e tij, përfundimet, shkojnë në fillim të tekstit, e pjesët e tjera radhiten më tej si mbështetje për përfundimet dhe interpretimet:

1. Përfundimi i autorit (ndarja e pjesës më të madhe të buxhetit të Kosovës për asfaltimin e rrugëve duket e pëlqyeshme në shikim të parë për gjithsecilin. Do të dalim prej baltës shekullore. Por, kjo nuk është kurrfarë garancie se do të dalim edhe prej territ shekullor. Do të vazhdojmë të mbetemi në terr ose do të ndajmë miliona e miliona për të blerë energji me çmim shumë të shtrenjtë).
2. Argumentet e autorit (a është më i rëndësishëm asfalti apo energjia elektrike? Mungesa e energjisë i dëmton bizneset, i pengon shumë qytetarët dhe i dëmton edhe psikikisht, pastaj qeveria harxhon rreth 70 milionë euro në vit për blerjen e energjisë. Investimi i parave të buxhetit në gjenerimin e energjisë elektrike është shumë herë më i rëndësishëm e më profitabil sesa investimi në asfalt).
3. Argumentet e temës (po pse qeveria po bën të kundërtën? A ndërlihet ky investim me zgjedhjet? Sepse asfaltimi i rrugëve të fshatrave është projekt që duket menjëherë dhe sjell vota, ndërsa ndërtimi i një TC-ja është punë e gjatë).
4. Përforcimi i argumenteve të autorit dhe i përfundimeve të tij.



## XIV.5. LIGJËRIMI KONATIV DHE ÇËSHTJE TË TJERA TË STILIT

Ligjërimi në koment është brenda ligjërimit të gazetarisë analitike. Por, derisa komenti është komentim, interpretim dhe mendim i gazetarit për ngjarje lajmore apo për një proces, ligjërimi i tij është konativ, gjuhë që synon ta bindë marrësin. Në tekstin e mëposhtëm mund të shohim se si shfaqet konativiteti i gjuhës së komentit:

Politikanë të tillë, të cilët nuk ekzistojnë vetëm në Kosovë, por edhe në vende të tjera të Ballkanit, vetëm sa forcojnë skepticizmin e evropianoperëndimorëve kundër zgjerimit të BE-së. Paragjykimet ndaj Ballkanit janë të ngulitura thellë në kujtesën e njerëzve mes Berlinit dhe Parisit, Londrës dhe Vjenës. Poeti gjerman Goethe në „Faustin“ e tij shkruante: „Kur atje larg në Turqi / Popujt godasin njëri-tjetrin“. Karl Maxi e kishte quajtur Ballkanin „bërllok etnik“, ndërsa kancelari gjerman Otto von Bismarck – duke folur për këtë rajon – kishte kundërshtuar krijimin e shteteve të vogla etnike për „vjedhës të qengjave“. Në sytë e shumë perëndimorëve elitat politike në Ballkan ende përbëhen ose dominohen nga „vjedhësit e qengjave“. Për fat të keq, këtë paragjykim shpesh e mbështesin edhe disa politikanë të Ballkanit me sjelljet e tyre, me papërgjegjësi, mosdije, arrogancë, me keqpërdorim të mjeteve publike.

Enver Robelli

“Shtetet e vjedhësve të qengjave”, Koha ditore, 18 tetor 2009



Autori përdor pa hezitim cilësorin “të tillë” për politikanët në kuptimin pezhorativ; ai thotë se tipi i tillë i politikanit nuk është vetëm në Kosovë; ai nuk dyshon se paragjykimet për Ballkanin janë të vjetra dhe sjell dy citate, poende përdor një sintagmë poshtëruese “vjedhës të qengjave”, të cilën e kishte përdorur Bismarku kur kishte kundërshtuar krijimin e shteteve ballkanike e, në fund, përfundon se edhe sot në sytë e shumë perëndimorëve jeton ai kujtim i keq për ballkanasit dhe shqiptarët; problemi më i madh është se disa liderë ballkanas dhe shqiptarë po e ushqejnë këtë paragjykim. I gjithë ky ligjërime bëhet nga pozita dominuese e autorit, i cili flet si i gjithëdijshtëm dhe gjithëvendosës: marrësi nuk ka nevojë as të vërë në dyshim konceptet e autorit. Ndikimi në mendjen e lexuesit është qëllimi kryesor i autorit në koment. Ai i interpreton argumentet dhe krijon opinionin e tij të cilin e shfaq me një konativitet të theksuar. Autori synon ta bindë marrësin, e në variantin më të butë, ai i ofron një pamje më shumë për ngjarjet që trajton. Supozojmë se marrësi rri në një dhomë e cila ka vetëm një dritare dhe ai mund të vështrojë se çfarë po ndodh jashtë vetëm përmes saj; komenti është një

hapje e dritares së dytë, në mënyrë që marrësi të shikojë edhe nga ana tjetër se çfarë po ndodh. Ky ligjërim, sa do personal, e kufizon gazetarin në disa aspekte: p.sh. mund të përdoret një ironi e lehtë në koment, por në asnjë rast nuk duhet kaluar në stil polemike apo pamfleti. Në anën tjetër, konativiteti i gjuhës e shtyn gazetarin që të përdorë frazeologji të famshme, në mënyrë që audienca ta pranojë më lehtë opinionin e tij.

Ligjërimi ka edhe një ngjyrë personale. Autori krijon opinionin e tij dhe mundohet t'i bindë edhe të tjerët me këtë opinion, prandaj s'ka se si ky ligjërim të mos ketë ngjyrë personale. Personalizimi i gjuhës, i fakteve e argumenteve bëhet në masë, deri aty sa të mos e humbin objektivitetin. Në rast se objektiviteti i fakteve e i argumenteve luhatet, atëherë teksti nuk është më koment, mund të bëhet kolumnë.

Përdorimi i figurave në koment është më i dendur se në llojet tjera zhanrore analitike, sidomos në tituj, në paragrafët e parë dhe në përmbyllje. Teksti personal dhe figura stilistike gjithnjë janë të lidhura ngushtë. Ja disa shembuj të titujve figurativë të komenteve:

- Baltiku vlon, Egjeu ngrin (antitezë dhe metonimi; me këtë titull revista *The Economist* e komenton gjendjen e krizës financiare në Letoni dhe në Greqi në fillim të vitit 2010);
- Veriu nxeh Kuvendin e Kosovës (antitezë dhe metonimi);
- Recesioni i Madh nuk ishte arsye të ishte i madh (komenti i Riç Kalgard-it për krizën ekonomike të vitit 2009).

## **XIV.6. NGA HISTORIA E GAZETARISË SHQIPTARE**

Në historinë e gazetarisë shqiptare Boriçi e njëjtëson komentin me vështrimin (përdoreshin edhe forma të tjera emërtimesh, si: një e paravështruar politike, qyrje politike, këqyrje etj.). Vështrimi shqiptar shkruhet shkathët, kryesisht sipas skemës fakt-interpretim. Emërtimi vështrim, vëzhgim përdoret edhe sot jo shumë shpesh, për të shprehur atë formë të shprehjes gazetare që në terminologjinë moderne quhet koment.

Vështrimi (komenti) është mbase forma më e preferuar e gjithë gazetarisë tradicionale shqiptare. Këtë formë e kanë shkruar jo vetëm shkruer të rastësishëm, njerëz të kulturës, disa prej të cilëve kanë lënë gjurmët e tyre në kulturën shqiptare, por edhe emrat më të mëdhenj të kulturës e të jetës publike shqiptare. Vështrimi ka një strukturë të thjeshtë formale: nis me një fakt, pastaj autori argumenton gjerë e gjatë për atë fakt, duke e ndërthurur atë fakt me shumë fakte të

tjera dhe duke argumentuar edhe me shumë argumente të tjera, e duke përfunduar me një qëndrim, pikëpamje apo ide të prerë të autorit. Në aspektin e përmbajtjes vështrimi është i gjithanshëm, por mbizotërojnë vështrimet politike, ato që trajtojnë idenë kombëtare, kulturore, etnologjike etj.

Sot në gazetarinë shqiptare komenti është një prej formave më serioze të tekstit gazetar.

## XIV.7. NJË SHEMBULL METODIK PËR STUDENTËT:

Marrim një shembull. Zgjedhim temën e asfaltimit të rrugëve të Kosovës.

**Hyrja në temë.** E përkufizojmë qartë temën: sa rrugë planifikon qeveria të shtrojë në asfalt këtë vit e sa ka shtruar vitin e kaluar? Sa para të buxhetit të Kosovës ndahen për asfaltimin e rrugëve? Sa për qind e buxhetit është kjo ndarje?

**Argumentimi i temës.** Sjellim argumentet kryesore proqeveritare dhe antiqeveritare në këtë çështje. Mund ta citojmë ministrin apo një oponent të tij, por gjithsesi argumenti kryesor mund të jetë përcaktimi i qeverisë që një pjesë aq të madhe të buxhetit ta orientojë në asfaltimin e rrugëve. Pse e bën qeveria këtë?

**Argumentet e autorit.** Këtu autori fillon shoshitjen e argumenteve dhe kundërgjendjet e temës. Ai analizon, interpreton dhe përgjigjet në disa pyetje: a ka të bëjë me gabim të politikave qeveritare një ndarje kaq e madhe e buxhetit për asfaltimin e rrugëve, duke lënë anash kërkesat e tjera të shoqërisë?; a jemi ne ende një shoqëri që mund të caktojë një apo dy prioritete apo jemi ende në një gjendje emergjente dhe duhet ta ndajmë buxhetin proporcionalisht në shumë fusha?; a mos ka një prapavijë fushate zgjedhore në asfaltimin e rrugëve?; pse qeveria nuk po subvencionon bujqësinë (që është e rëndësishme së parë), apo mos nuk e bën këtë sepse aty nuk bien në sy investimet e saj?

**Përfundimet.** Pasi kemi analizuar argumentet e qeverisë dhe kemi sjellë pyetjet e argumentet tona bindëse, të cilat jo vetëm i kemi kundërshtuar me ato të qeverisë, por kemi hapur dilema të reja publike se mos qeveria nuk ka vizion politik për udhëheqje, por punon vetëm për interesin e saj në zgjedhjet e ardhshme, ne sjellim përfundimet tona: qeveria bën mirë (ose bën keq) për këtë e këtë arsye, kjo mund të ketë pasoja etj.

## XIV.8. ANALIZA STRUKTURE E NJË KOMENTI:

Era e ndryshimeve <sup>25</sup>	
<p>Qysh nga dita kur presidenti tunizian Ben Ali u përkul deri në atë pikë sa u thye në mes, e më pas ia mbathi nga vendi i tij për të gjetur strehë në Arabinë Saudite, pyetja që ngrihej nuk konsistonte edhe aq tek fakti se çfarë do të ndodhte më pas me Tunizinë, por nëse kryengritja popullore e atjeshme do të shndërrohej në një katalizator të pakënaqësive të mbledhura diku gjetkë. Ka afro dy javë që presidenti tunizian është përmbytur nga pushteti, e tashmë ka nisur të ravijëzohet përgjigja e pyetjes së parashtruar: nga Algjeria fqinje, nga Jordania, por më qartë e më në mënyrë më të përcaktuara, nga Egjipti.</p>	<p>Paraqitja e temës Modeli induktiv: nis me presidentin tunizian të përmbytur për të vazhduar me revolucionet arabe.</p>
<p>Protesta në qendër të Kajros, e cila nisi në mbrëmjen e së martës, u zhvillua normalisht gjatë ditës së mërkurë dhe u bë më rastësore në ditët e më-pasme të javës së shkuar, ishte e pazakontë për nga shkalla e përqendrimit kryesisht në kryeqytetin e vendit, por ka pasur demonstrata edhe në qytete të tjera të Egjiptit, përfshirë edhe qytetet që po rriten me shpejtësi pranë "Delta"-s, si dhe provincës së Asyutit, në jug të vendit. Një nga katër viktimat ishte ajo e Suezit.</p>	<p>Argumente të temës</p>
<p>Ashtu si edhe demonstratat e zhvilluara në Tunizi, edhe ato të Egjiptit ngjallën mjaft interes dhe shfaqën një shkallë të lartë të zemërimit popullore; ashtu si edhe në Tunizi, edhe në Egjipt protestuesit ishin kryesisht të moshës së re dhe i përkisnin gjinisë mashkullore, shtu këtu edhe faktin që përfshirja masive e shtresave të ndryshme të popullatës u mundësua dhe u bashkërendua kryesisht përmes mjeteve elektronike, internetit dhe telefonave celularë. Demonstruesit egjiptianë nuk kërkonin kurrfarë ndjese, ata marshuan dhe kërkuan fundin e presidentit Hosni Mubarak që kishte sunduar vendin përgjatë 30 viteve, duke u mbështetur në shembullin tunizian.</p>	<p>Argumente të temës në analogji midis Egjiptit dhe Tunizisë</p>
<p>Reagimi i autoriteteve egjiptiane nuk ndryshon aspak nga reagimi i cilitdo regjimi shtypës që ndihet i kërcënuar: nxorën në shesh trupat policore dhe forcat speciale. U vendos ndalimi i protestave të mëtejshme. U thirrën për ndihmë forcat në raste emergjencash. Mbetet për t'u parë se sa frytdhënëse do të jenë masat e ndërmarra. Sidoqoftë, ka diçka që nuk mund të zhbëhet më: është thyer tabuja – është sfi duar sundimi i Hosni Mubarakut - ndërkohë që mesazhit të lëshuar nga Tunizia i është vënë veshi nga çdo lloj shtrese shoqërore në vend.</p>	<p>Argumentet e autorit</p>
<p>I njohur si 'vendi lider i rajonit', Egjipti ka një popullsi prej 80 milion banorësh dhe vuan nga të njëjtat probleme ekonomike e demografike që shqetësojnë rajonin në tërësi. Nëse ky vend krenar, edhe pse të tronditur, do të lëvizë vendit, qoftë edhe duke u orvatur, nuk do të jetë vetëm Afrika e Veriut që do gjendet përballë ndryshimeve të thella, por edhe e gjithë Lindja e Mesme dhe përtej saj</p>	<p>Përfundimi i autorit: nëse Egjipti, si vend lider arab, bën revolucionin, ai do të shtrihet në gjithë Afrikën e Veriut dhe në Lindjen e Mesme</p>

## XV. ARTIKULLI ANALITIK (ANALIZA)

### XV.1. QËLLIMI PËRMBAJTJESOR


**A**rtikulli analitik, ose si përdoret në gjuhën e gazetarisë-analiza, është lloji bazik i gazetarisë analitike, në të cilin gërshetohen thellësisht dhe gjerësisht dy modele të ndryshme shkrimi dhe tekstesh: gazetaria dhe metoda të afërta me ato shkencore humaniste të hulumtimit e të analizës. Kjo lidhje ka rezultuar me një prej llojeve më të mira të tekstit gazetar, artikullit analitik (analiza), i cili është njëkohësisht edhe informim edhe analizë e rrethanave që kanë sjellë e që pasojnë një ngjarje lajmore. Lajmet që merr audienca janë lajme të pastra, shumë të shkurtra, vetëm informacion i pastër, pa asnjë hollësi, për rrethanat e ndodhjes së faktit objektiv. Sidomos në botën e gazetarisë elektronike (kompjuteri, televizioni) lajmet kanë prirje të shkurtohen deri në një fjali. Kjo është një arsye më shumë, thotë Dejvid Randall, që marrësi ka nevojë për interpretime të lajmeve, për shpjegime të ngjarjeve, pra ka nevojë për analizën dhe komentin e gazetarit: "Ai duhet të përcjellë kuptime e zhbirime të reja - një vështrim të ri për thelbin e gjërave".<sup>26</sup>

Bill Kovaçi dhe Tom Rosenstili në librin *Elementët e gazetarisë* (2001) kanë identifikuar si njërin prej kushteve për mbijetimin e gazetarisë interpretimin e ngjarjeve lajmore prej gazetarit. Saktësia e gazetarisë është detyrimi i parë i saj, thonë ata, mirëpo saktësia nuk qëndron vetëm në sjelljen e informatave "neutrale", "të balancuara" etj., por "t'i kuptosh faktet dhe t'i interpretosh ato".<sup>27</sup> Këtë detyrim të gazetarisë e përmbush gazetaria analitike, e artikulli analitik në mënyrën më të lartë.

Qëllimi përmbajtjesor i analizës është analizimi dhe shpjegimi i shkaqeve e i pasojave të një ngjarjeje lajmore, të një procesi apo koncepti me peshë sociale, të një rrjedhe të rëndësishme sociale, e të cilët nuk kanë natyrën e lajmit; analizimi dhe shpjegimi i rrethanave të ndodhjes së asaj ngjarje lajmore dhe i ndërlidhjes së saj me procese të tjera sociale dhe jashtë tyre. Në këtë qëllim përmbajtjesor, si shihet, fjalët kryesore janë *analizim* dhe *shpjegim*. Gazetaria, nga ana e saj, po edhe audienca nga ana e tij, nuk kënaqen vetëm me informimin se çfarë po ndodh, nuk mjaftohet as vetëm me tregimin e rrethanave në të cilat ka ndodhur një ngjarje lajmore (si te raporti), por depërton më në thellësi të gjërave që trajton: analizon pse dhe si kanë ndodhur ato dhe shpjegon natyrën e tyre dhe ndërlidhjen e tyre me procese të tjera sociale e më gjerë. Pra, analiza synon të zbulojë shkakun e ngjarjeve lajmore dhe logjikën e ndodhjes, sipas parimit

### PËRMBAJTJA

XV. Artikulli analitik (analiza) . . . . .	233
XV.1. Qëllimi përmbajtjesor . . . . .	233
XV.2. Tema dhe analizimi i saj . . . . .	235
XV.3. Struktura e artikullit analitik . . . . .	237
XV.4. Lloje të artikullit analitik . . . . .	243
XV.4.1. Analiza pasqyruese . . . . .	244
XV.4.2. Analiza problemore . . . . .	246
XV.5. Një shembull metodik për analizën dhe vendin e saj në gazetari (ushtrim për studentët) . . . . .	247
XV.6. Përgatitja teknike e artikullit . . . . .	249
XV.7. Nga historia e artikullit analitik shqip . . . . .	250



"Njeriu që mendon", skulpturë në Muzeun Rodin, Paris.



Qëllimi përmbajtjesor i artikullit analitik është analizimi dhe shpjegimi i shkaqeve e pasojave të një ngjarjeje lajmore, të një procesi apo koncepti me peshë sociale, të një rrjedhe të rëndësishme sociale, e të cilët nuk kanë natyrën e lajmit; analizimi dhe shpjegimi i rrethanave të ndodhjes së asaj ngjarjeje lajmore dhe i ndërlidhjes së saj me procese të tjera sociale dhe jashtë tyre.

shkak-pasojë, si dhe ndërlidhjen e atyre shkaqeve-pasojave dhe të atyre ngjarjeve me ngjarje të tjera të ndodhura apo të mundshme. Përveç analizës dhe shpjegimit, artikulli analitik ka edhe një qëllim tjetër përmbajtjesor: *anticipimin* e proceseve që ndërlidhen me temën e trajtuar. Tema e analizës është në proces, nuk është e përfunduar, prandaj gazetari e bën analizën jo vetëm për të shpjeguar pse ndodh ajo temë, por edhe për të paraparë, mbi bazën e analizës, edhe çfarë rrjedhojash mund të ketë ajo temë në ndodhje.

Në kuptimin zhanror, artikulli analitik është lloj gazetar në të cilin gërshetohen informata dhe analiza, lajmi (apo raporti) dhe analiza e tij. Kjo është përmbajtja e artikullit analitik: një lajm (apo disa lajme), një temë (apo disa syresh) dhe analizimi i saj/tyre, duke ardhur në përfundime të caktuara, si rrjedhojë e analizës dhe duke synuar *anticipimin* e proceseve, në mënyrë që t'u lehtësohet audiencave kuptimi i atyre ngjarjeve lajmore dhe atyre proceseve.

Gazetari duhet të pajiset me informacione të shumta për temën e tij, duhet ta analizojë logjikshëm atë informacion, duhet t'i njohë mirë rrethanat me të cilat ka marrëdhënie tema e tij, duhet të konsultojë njerëz që dinë për atë temë, të hulumtojë literaturë etj., pra është një varg i tërë veprimesh të lidhura të cilat mund t'i përballojë vetëm gazetari i përgatitur mirë me njohuri dhe me vullnet të fortë. Dhe meqenëse përmendëm shprehjen "gazetaria dhe metodat shkencore humaniste të hulumtimit e të analizës" dhe më poshtë do ta përdorim nocionin "analizë pro shkencore", duhet t'i sqarojmë shkurt këto shprehje, për të mos lënë mundësi të paqartësive.

Gazetaria praktike, pra shkrimi i lajmit, artikullit analitik, editoriali etj., nuk është shkencë, prandaj nuk përdoren asfare metodash shkencore aty. Por, në proces të hulumtimit të fakteve dhe të vërtetës, sidomos në artikullin analitik, gazetari shërbehet me disa metoda të cilat përdoren edhe në shkencat humaniste. Metoda e hulumtimit të opinionit publik, p.sh., është një prej tyre dhe kjo metodë përdoret gjerësisht në gazetari. Njësoj është edhe me teorinë e statistikave: një gazetar nuk do ta kryente detyrën e tij mirë nëse shkruan për rezultatin zgjedhor e nuk ka informacion për teorinë e statistikave. Gazetaria analitike nuk është e lidhur tërësisht me këto metoda, edhe pse rri shumë afër tyre. Gazetaria i thjeshtëson dhe i përshtat këto metoda shkencore për qëllimin e saj: njohjen e fakteve objektive me peshë publike dhe, mundësisht njohjen e rrethanave në të cilat ato krijohen dhe efektet që ato krijojnë. Dhe, e gjithë kjo, për t'ia bartur këto fakte audiencës, e cila është marrëse me një kulturë mesatare.

#### **Analizë proshkencore???**

Në proces të hulumtimit të fakteve dhe të vërtetës, sidomos në artikullin analitik, gazetari shërbehet me disa metoda të cilat përdoren edhe në shkencat humaniste.



## XV.2. TEMA DHE ANALIZIMI I SAJ

Tema e artikullit analitik mund të jetë e fushave të ndryshme me interes publik dhe e llojeve të ndryshme. Kështu, mund të trajtohet ndikimi i ushqimit në shëndetin e një populli, ose ndikimi i politikave sociale të presidentit të ShBA-së, z. Barak Obama, në politikat ideologjike të ShBA-së, ose ndikimi në politikat ekonomike të Kosovës i autostradës Vërmicë - Prishtinë etj. Zakonisht në një artikull analitik mbizotëron një temë, por ajo ndërlidhet me tema të tjera. Është e rëndësishme se tema e artikullit analitik nuk është vetë për vete një fakt i ri objektiv (sikur te lajmi). Po të ishte një fakt i ri objektiv, i rëndësishëm dhe me ndikim të madh... etj., ai do të ishte lajm e jo artikull analitik. Pra, artikulli analitik nuk e bën të tillë tema e trajtuar, por mënyra e trajtimit të temës. Gazetari trajton një temë (apo më shumë tema) me interes publik, por në mënyrën e trajtimit përdor në masë të madhe metodën analitike për zbërthimin e gjërave. Ai mbledh fakte, shifra, bën llogari, merr për bazë teza të mëhershme dhe i analizon ato, thirret në burime të rëndësishme shkencore, konsulton dokumente të rëndësishme dhe të gjitha këto rezultojnë me njohjen e thellë të temës që shqyrton dhe me nxjerrjen e përfundimeve në lidhje me temën e trajtuar. Natyrisht që në këtë hulumtim autori sjell të dhëna të reja, fakte të reja, të panjohura më parë për publikun, por të gjitha ato janë rrjedhojë e analizës së tij, e jo ngjarje lajmore të ndodhura më herët, por të panjohura. Këto të reja, pra, janë rrjedhojë e mënyrës së trajtimit të një teme publike. Kështu, Xhefri Saks (Jeffrey D. Saks) e fillon analizën e tij për rolin e ShBA-së në politikat globale klimatike:

Traktati i OKB-së kundër ndryshimeve klimatike, i nënshkruar në vitin 1992, i bënte thirrje botës që "të shmangej nga ndërhyrja e rrezikshme antropogjene në sistemin klimatik". Megjithatë, që nga ajo kohë, emetimi i gazrave që shkaktojnë efektin serra ka vazhduar që të rritet.

SHBA-ja është dëshmuar si shteti që ka respektuar më së paku këtë zotim, duke refuzuar që ta nënshkruajë Protokollin e Kyotos të vitit 1997 apo që të ndërmarrë ndonjë kontroll efektiv të lirimit të gazrave të tilla. Derisa po përgatitemi për samitin global të Kopenhagës, në dhjetor, ku do të zhvillohen negociatat për pasuesen e Protokollit të Kyotos, SHBA-ja po bëhet sërish epiqendër e shqetësimeve. Madje edhe tani politika amerikane mbetet tejte e ndarë sa u përket ndryshimeve klimatike- ndonëse presidenti Barack Obama ka mundësi të reja për ta tejkaluar këtë gjendje.<sup>28</sup>

Autori në këtë analizë trajton një çështje shumë mirë të njohur për opinionin publik: mosnënshkrimin e Traktatit të Kjosos nga

Artikulli analitik nuk e bën të tillë tema e trajtuar, por mënyra e trajtimit të temës.



**Jeffrey David Sachs** (lindur më 1954) është ekonomist amerikan dhe drejtor i Erth Institute në Universitetin e Kolumbias.




ana e ShBA-së dhe pasojat e këtij mosveprimi në klimën globale. Asgjë të re nuk ka në këtë temë. Të rejtat pasojnë gjatë analizës së autorit, për mëdyshjen e autorit se a do të ratifikohet traktati nga ana e Senatit amerikan apo administrata amerikane do të veprojë në vijën administrative për ta bërë fakt të kryer këtë nënshkrim, pa e kaluar fare nëpër senat etj. Le të përfundojmë: artikulli analitik nuk e ka peshën e vet të rejtat e panjohura që ia sjell marrësit, por të rejtat që rrjedhin nga analiza që autori ua bënë rrethanave të lidhura me një fakt objektiv dhe të përfundimet e atyre analizave.

Janë edhe disa veçanti të tjera që e karakterizojnë artikullin analitik:

- Artikulli analitik është lloj gazetar që përdor disa nga metodat shkencore humaniste të hulumtimit (por nuk është shkencë në kuptimin e ngushtë; ai shkruhet për lexuesit e shtresave të gjëra, të cilët mund të mos i kuptojnë faktet apo çështjet që trajtohen në artikull, por detyra e gazetarit është që ai ta shkruajë artikullin për ta kuptuar ata). Elementi i parë që e përcakton artikullin analitik është analiza e thellë dhe e gjerë, e afërt me analizat shkencore: është analizë e fakteve, e shfaqjeve, e proceseve, e ideve, e ngjarjeve apo veprimeve të individëve me ndikim dhe shpjegimi i tyre. Analiza nuk është subjektive, por e mbështetur në metodologjinë shkencore;
- Metodologjia e shkrimit të artikullit analitik ndërlihd artikullin e gazetës me artikullin shkencor dhe, rrjedhimisht, struktura e tij është një komponim i artikullit shkencor me tekstin e gazetës;
- Elementi i tretë i artikullit analitik është shpjegimi i temës në shqyrtim dhe nxjerrja e përfundimeve nga autori i analizës. Edhe shpjegimi nuk është subjektiv, por i mbështetur në procesin e analizimit dhe si rrjedhojë e tij. Edhe përfundimet e nxjerra nga autori nuk janë të ndikuara nga intuïta e përvoja personale empirike (si të komentit), por përfundime të argumentueshme shkencërisht ose logjikisht, pra objektive.
- Elementi i katërt është marrëdhënia e artikullit analitik ndaj temës që e trajton. Artikulli analitik i referohet një ngjarje lajmore ose jolajmore që është në proces ose që është gjenerator i një procesi në vazhdim. Edhe kjo marrëdhënie e dallon analizën nga komentit: komentit i referohet një ngjarjeje lajmore të saponodhur.

Duke qenë i një rëndësi kaq të madhe, shqyrtimi më detaj i tij bëhet i obligueshëm për çdo shkollë gazetarie dhe për çdo gazetar. Për shkak të thellësisë së depërtimit në temën e trajtuar dhe përfundimeve objektive që duhet të nxjerrë gazetari, artikulli analitik është një prej formave më të vështira të shkrimit gazetar, prandaj

diskutimi për strukturën tekstore të tij paraqet rëndësi të madhe. Shkrimi i një artikulli analitik të mirë nuk është punë e lehtë. Autori duhet të pajiset me informacione të shumta për temën e tij, duhet ta analizojë logjikshëm atë informacion, duhet t'i njohë mirë rrethanat me të cilat ka marrëdhënie tema e tij, duhet të konsultojë njerëz të kyçur në atë temë, të hulumtojë literaturë etj., pra është një varg i tërë veprimesh të lidhura të cilat mund t'i përballojë vetëm gazetari i përgatitur mirë me njohuri dhe me vullnet të fortë.



### XV.3. STRUKTURA E ARTIKULLIT ANALITIK

**Paraqitja e temës (ekspoze).** Artikulli analitik ka një strukturë të tillë ku hetohet qartë natyra e tij gazetaresk shkencor. Ai fillon me paraqitjen e temës (*ekspoze*), e cila është hyrje në temën e cila do të trajtohet. Ekspoze mund të jetë një lajm i mëhershëm, një temë e trajtuar apo edhe e patrajtuar më parë, një veprim apo një qëndrim politik, apo në një fushë tjetër shoqërore, me kusht që kjo temë të ketë rëndësi publike. Aty autori paraqet faktet e njohura për temën e tij, argumentet e deriatëhershme dhe kundërshtitë e deriatëhershme për atë temë. Me këtë hyrje autori jo vetëm përgatit lexuesin për temën në shqyrtim, por edhe përgatit bazën ku do ta bëjë analizën e tij, përgatit argumentet e tezave që do t'i shqyrtojë.


Struktura e analizës:

- Hyrja (paraqitja e temës, ekspoze)
- Historia e temës (prapavija, background)
- Analizimi
- Interpretimi dhe shpjegimi
- Përfundimet (dhe anticipimet).

Kjo pjesë duhet të jetë sa më e shkurtër dhe sa më e qartë, duke i dhënë shumë kuptueshëm faktet, argumentet dhe rrethanat kryesore në të cilat mbështetet tema e trajtuar.

**Historia e temës (prapavija, background).** Mbasi ta ketë bërë këtë ekspozë, autori trajton shkurt edhe *historinë e temës* që e shqyrton, atë që të lajmi quhet “prapavijë apo sfond (background)”. Tema e shqyrtuar ka një histori, të cilën lexuesi duhet ta dijë, në mënyrë që të përgatitet më mirë për t’i pranuar përfundimet që do të nxjerrë autori. Përveç kësaj, historia e temës shërben edhe si argument më shumë për domosdonë e shqyrtimit të temës së tillë. Pse një temë e caktuar është e rëndësishme për opinionin publik? Pse tema e zgjedhur prek interesin e lexuesit? E trajtuar kështu, parahistoria e temës në fakt është edhe prapavija e saj, por edhe ftesë për lexuesin në rëndësinë e temës. Nëse vazhdojmë me shturjen e strukturës tekstore të analizës së mësipërme të Xhefri Saksit, historia e temës është dhënë menjëherë pas paraqitjes së temës (ekspozë):

Një vit pas traktatit të vitit 1992, Bill Clinton ishte munduar që ta miratonte tatimin mbi energjinë, i cili do t’i kishte ndihmuar SHBA-së që ta ulte varësinë mbi burimet nga fosili të lëndëve djegëse. Ky propozim jo vetëm që kishte dështuar, por pati rezultuar me pasoja politike. Kur u miratua Protokollin e Kyotos më 1997, Clinton as që e dërgoi atë në Senatën amerikanë për ratifikim, pasi që e dinte se ky dokument do të refuzohej. Presidenti amerikan, George W. Bush, po ashtu nuk e pranoi Protokollin e Kyotos më 2001 dhe nuk bëri faktikisht asgjë rreth ndryshimeve klimatike gjatë presidencës së tij.



Tema e analizës është mosnëshkrimi i Traktatit të Kjosës nga ana e SHBA-së. Në paragrafin e mësipërm autori tregon historinë e temës, pra atë që ka ndodhur rreth temës deri në momentin kur ai e bën analizën e tij. Natyrisht kjo histori e temës nuk është histori, por është thelbi i temës i trajtuar deri më atëherë, apo argumente të

deriatëhershme rreth temës në shqyrtim. Ajo që veçohet është fakti se këto argumente nuk janë të autorit, por argumente të të tjerëve të cilat autori i ka pasur në parasysh. Derisa një temë ekziston publikisht, kjo do të thotë se ka pasur një apo më shumë trajtime të saj të mëhershme, së paku ka pasur një informacion për të. Gazetari nuk mund t'i anashkalojë ato informacione. Nuk duhet anashkaluar edhe faktin se jo gjithmonë analizat trajtojnë tema të njohura. Gazetarët mund edhe të krijojnë tema të reja: gazetari kap një informacion dhe mbi të krijon një temë të re publike. Për shembull: vërshimi i lumit Sitnica, që është një fakt i përsëritshëm për vite e dekada, mund ta çojë gazetarin te hulumtimi i shkaqeve; një prej shkaqeve është edhe derdhja e fundërrinave të ngurta nga termocentrali Kosova B, të cilat fundërrina e mbushin shtratin e lumit dhe, rrjedhimisht, uji del jashtë tij, duke vërshuar gjithandej dhe duke krijuar dëme të mëdha në ekonomitë bujqësore të fshatarëve që jetojnë e punojnë përreth lumit. Fakti i dytë është i panjohur për publikun dhe analizimi i tij të sjellë në përfundimin se Korporata Energjetike e Kosovës vite të tëra u ka krijuar dëme banorëve të Fushë-Kosovës.

**Analiza.** Vetëm pas kësaj pjese autori vjen te esenca e artikullit analitik, pra te puna e vet atij: *analiza*. Autori duhet t'i analizojë faktet, argumentet dhe rrethanat e temës në shqyrtim, duke u mbështetur në metodologji të sakta dhe në lidhjen logjike shkak-pasojë. Kjo është pika më nevalgjike e artikullit analitik, është thembra e Akilit e gazetarit. Në këtë pikë gazetari mund të dalë fitues apo humbës. Nëse në analizën e tij ai nuk niset nga dëshirat, nga intuita dhe përvoja empirike, por në bazë të analizës sa më të saktë e më shkencore, ai mund të dalë i suksesshëm. Konkretisht, nëse gazetari është i interesuar, p.sh., ta politizojë temën dhe kapet pas një fakti apo argumenti dytësor, i cili i shkon atij përshtati për ta argumentuar qëllimin e tij dhe "harron" fakte e argumente më të rëndësishme, kjo mund të quhet analizë e dështuar apo subjektive. Në gazetarinë shqipe në Kosovë pas viteve nëntëdhjetë ka pasur një ngufatje të tmerrshme të opinionit publik me "artikuj analitikë" të shkruar kështu, mbi bazë të intuitës, dëshirës apo interesave politike të autorit a grupit politik që ai simpatizon. Analiza ka për qëllim zbulimin e së vërtetës për temën e shqyrtuar, mohimin (apo edhe pohimin) e opinionit të deriatëhershëm për atë temë, apo nëse tema nuk ka qenë e njohur, sensibilizimin e opinionit publik me rëndësinë e temës në shqyrtim, por në asnjë rast nuk është mbrojtje e një interesi individual, grupor e të ngjashme.

Gazetari mund ta përdorë cilëndo nga metodat e analizës. Ai vetë gjykon atë më të përshtatshmen. Mund të bëjë një analizë induktive apo deduktive, apo hulumtim të opinionit publik, apo një prej formave silogjiste etj. Me rëndësi është që temën në shqyrtim

ta kalojë në sitën e analizës proshkencore.

Ja si Xhefri Saksi bën analizën e mosnënshkrimit të Protokollit të Kjotos nga ana e ShBA-së:



Ekzistojnë disa arsye për mosveprimin amerikan, si rezultat i ideologjisë dhe i injorancës shkencore, mirëpo pjesa më e madhe e tyre mund të përmbliidhen në një fjalë: thëngjilli. Hiç më pak se 25 shtete prodhojnë thëngjill, i cili jo vetëm që gjeneron të ardhura, vende pune dhe burime nga tatimet, mirëpo siguron edhe një pjesë të madhe jo proporcionale të energjisë së tyre. Lirimi i dyoksidit të karbonit për kokë banori në shtetet amerikane të pasura me thëngjill zakonisht është më i lartë sesa mesatarja në nivel amerikan. Pasi që luftimi i ndryshimeve klimatike më së shumti ka të bëjë me heqjen e varësisë nga thëngjilli, shtetet amerikane të pasura me thëngjill posaçërisht po u druhen pasojave ekonomike të një gjëje të fillë.

Sistemi politik amerikan po ashtu paraqet probleme të natyrës së veçantë. Për ratifikimin e një traktati nevojitet mbështetja e 67 nga 100 anëtarë të Senatit, një pengesë pothuajse e pakapërcyeshme. Partia Republikane, me 40 ulëset e saj në Senat, thjesht është e mbushur me ideologji që nuk e lënë të ofrojë vota të mjaftueshme për ta kapërcyer pragun e 67-s. Për më tepër, Partia Demokratike ka senatorë nga shtetet e pasura me thëngjill dhe naftë, të cilët ka pak gjasa të mbështesin ndonjë aksion vendimtar. Ideja e administratës amerikane këtë radhë është që t'i shmanget nevojës për 67 vota, të paktën në fillim, duke u fokusuar në legjislacionin e brendshëm, e jo në traktat. Në bazë të Kushtetutës amerikane, për miratimin e një ligji amerikan (për dallim nga traktatet ndërkombëtare) nevojitet një shumicë e thjeshtë si në Dhomën e Përfaqësuesve, ashtu edhe në Senat. Sigurimi i 50 votave për ligjin kundër ndryshimeve klimatike është pothuajse i garantuar. Mirëpo kundërshtarët e ligjit mund ta zvarrisin procedurën, gjë që mund të marrë fund vetëm nëse 60 senatorë mbështesin procedimin e ligjit për votim. Në të kundërtën, ligji i propozuar mund të "vritet", madje edhe nëse e ka mbështetjen e shumicës së thjeshtë. Një gjë e tillë mund t'i ndodhë Ligjit amerikan kundër ndryshimeve klimatike.

**Interpretimi dhe shpjegimi.** Qëllimi themelor i shkrimit të një analize është interpretimi dhe shpjegimi i fakteve dhe proceseve që ndodhin në lidhje me lajmin. Vetëm pakica e audiencave ka kohën e duhur apo përgatitjen për t'i kuptuar të gjitha veprimet e politikanëve e të qeverive, të bizneseve apo të shërbimeve të ndryshme sociale, apo të çfarëdo dukurie sociale. Nëse ka apo nuk ka një rritje të dhunës në shkollat e mesme të kryeqytetit të Kosovës, kjo është një temë që



duhet ta analizojë një gazetar, sepse qytetari i zakonshëm nuk mund ta ketë këtë informacion dhe, si pasojë, as të ketë një pikëpamje. Por, pse ndodh kjo rritje e ndjeshme e dhunës, këtë nuk mund ta analizojnë shumica e individëve qoftë për shkak të mungesës së kohës, qoftë për shkak të mungesës së informacionit plotësues, qoftë për shkak të përgatitjes së tyre intelektuale. Atëherë gazetari merr detyrën e tij për ta analizuar, interpretuar dhe për ta shpjeguar arsyen dhe rrethanat e shtimit të ndjeshëm të dhunës nëpër shkolla. Audiencia pret nga gazetari analizën e fakteve, interpretimin dhe shpjegimin tyre. Pra, audiencia pret nga gazetari që ai t'u shërbejë disa ide, mendime, komente apo, thjesht, disa supozime të mundshme të tij në raport me temën e trajtuar. Audiencia nuk i pranon ato ide, analiza e shpjegime të gazetarit si diçka të cilave duhet t'u besojë a priori, por ama si një mundësi e ndryshme e pikëpamjes dhe e interpretimit, po.

Që të tri këto procese logjike (analizë, interpretim dhe shpjegim) janë të pandashme, sepse nuk ka analizë pa interpretime e shpjegime dhe nuk ka interpretim e shpjegim pa një analizë paraprake. Po ashtu, që të tri këto procese janë personale, janë procese mendore të gazetarit, por ai i bën ato me vegla pak a shumë shkencore. Esenca e analizës, interpretimit dhe shpjegimit të ngjarjeve lajmore dhe procesit të ndërthurjes së tyre është fakti se ato duhet t'i japin audiencës një pikëpamje të re për temën apo ngjarjen e trajtuar. Këto interpretime, shpjegime dhe analiza e ndihmojnë audiencën ta kuptojë më mirë thelbin e gjërave, pasi përvojën e saj ajo e krahason dhe e argumenton me atë të gazetarit në analizë dhe kjo e stabilizon pikëpamjen e saj përfundimtare për ato ngjarje lajmore dhe procese.

Jo gjithmonë ndodh që analiza dhe interpretimi e shpjegimi të jenë strukturalisht të ndara në një analizë. Kjo do të thotë se ekziston A (analiza) dhe I (interpretimi) në një artikull analitik, mirëpo jo domosdoshmërisht A është e ndarë në disa paragrafë dhe I në disa të tjerë vijues. A dhe I mund të jenë në të njëjtit paragrafë nëse autori analizon dhe interpreton në të njëjtën kohë, si në analizën e Xhefri Saksit.



Milazim Krasniqi  
Analist i rjedhave politike  
dhe gjeostrategjike rajonale



Sigurimi i 60 votave paraqet një tatëpjetë të madhe që duhet të kalohet. Analistët politikë e dinë se votat do të varën nga ideologjitë individuale të senatorëve, nga skemat e votimit nëpër shtete dhe rëndësia që ka thëngjilli në ato shtete. Bazuar në këta faktorë, një hulumtim i kryer kohë më parë parasheh 50 vota demokrate "Po" dhe 34 vota republikane "Jo", duke i lënë në lojë edhe 16 vota të tjera. Dhjetë nga shtetet që nuk dihet si mund të votojnë janë demokrate, kryesisht të pasura me thëngjill, derisa gjashtë janë republikane që ka gjasa të votojnë për presidentin dhe shumicën demokrate.



Deri para pak kohësh shumica besonin se Kina dhe India do të ishin pengesat e vërteta të negociatave për ndryshimet klimatike. Megjithatë, Kina ka paralajmëruar një numër iniciativash të mëdha në teknologjitë solare, të erës e bërthamore, për ta reduktuar lirin e gazrave të dëmshme. India, për të cilën tashmë një kohë të gjatë druhej se do të ishte prishëse e planeve, ka deklaruar se është e gatshme të miratojë një plan shtetëror veprimi, që parasheh një trajektore drejt energjisë së ripërtëritshme.

**Përfundimet.** Pas analizës dhe interpretimit të fakteve autori vjen në fazën kur nxjerr përfundimet. Përfundimet duhet të jenë rezultat i analizës së fakteve, duhet të jenë përmbyllje e disave nga idetë dhe faktet kyçe të temës së trajtuar. Këto përfundime nuk mund të jenë përfundime të pastra shkencore, sepse artikulli analitik, sado që shërbehet me metodologji shkencore, ai është vetëm një tekst gazetar, e gazetaria bëhet për marrësin mesatar, si thamë më lart. Pra, përfundimet e artikullit analitik nuk kërkojnë besueshmëri absolute, por duhet të jenë përfundime të autorit, të nxjerra nga analiza e fakteve, përfundime që zbërthejnë temën e trajtuar dhe orientojnë marrësin në pasojat e atyre fakteve.

Ja si e përfundon analizën e tij Xhefri Saks:

Këto aksione e vënë SHBA-në nën presion të shtuar për të vepruar. Derisa shtetet në zhvillim po e shfaqin gatishmërinë e tyre për të arritur një marrëveshje globale, a mundet Senati amerikan që të bëhet pengesa më e madhe e botës? Obama ka në dispozicion mjete për ta futur SHBA-në në grupin botëror që u ka shpallur luftë ndryshimeve klimatike. Së pari, ai është duke negociuar marrëveshje anësore me senatorët problematikë, për ta zbutur ndikimin ekonomik mbi shtetet e thëngjillit dhe për t'i rritur investimet amerikane në hulumtim e zhvillim. Së dyti, ai mund ta urdhërojë Agjencinë për Mbrojtjen e Ambientit që të vërë kontrolle administrative mbi fabrikat e thëngjillit dhe prodhuesit e automjeteve, madje edhe nëse Kongresi nuk e miraton ligjin e ri. Rruga administrative mund të dalë më e rëndësishme sesa ajo legjislative. Politika e Senatit amerikan nuk duhet t'i fshehë faktet: Amerika ka vepruar në mënyrë të papërgjegjshme që nga nënshkrimi i Traktatit klimatik, më 1992. Ajo është shteti më i madh dhe më i fuqishëm, mirëpo është sjellë në mënyrë të papërgjegjshme, si ndaj qytetarëve të saj, ashtu edhe ndaj botës e gjeneratave të ardhshme. Madje edhe senatorëve të shteteve të pasura me thëngjill duhet t'u vijë turp. Natyrisht se shteteve të tyre u duhet ndihmë shtesë, mirëpo interesat e ngushta nuk duhen lejuar që ta vënë në rrezik të ardhmen e planetit. Ka ardhur koha që SHBA-ja t'i bashkohet komunitetit botëror.



Anticipimi (parathënia) nuk është dhunti, por analizë logjike dhe praktike!



Disa autorë shkojnë një hap më tutje: bëjnë anticipimin (*prognozat*) për të ardhmen e temës dhe rrethanave që lidhen me të, për pasojat e mundshme etj. Edhe kjo pjesë e artikullit analitik është shumë sfiduese për gazetarët. Njeriu, prej natyrës së tij, dëshiron t'i anticipojë e parathotë gjërat, prandaj kjo natyrë e nxit edhe gazetarin të parathotë gjithë atë që ndjenjë. Por, ky mund të jetë gabimi i madh i tij i radhës. Ai duhet t'i parathotë vetëm ato përfundime që ka nxjerrë mbi bazën e analizës së deriatëhershme. Këtu, madje, ai duhet t'i ikë edhe përvojës së tij empirike. Kjo përvojë i shërben atij për të depërtuar në prapavijë të temës, në thellësinë e saj, por jo edhe në nxjerrjen e përfundimeve. Kështu e përfundon analizën e tij për protestat sociale në Greqi, në dhjetor të vitit 2008, gazetari shqiptar Aleksandër Çipa:



Shqipëria si vendi me afinitet fizik me Greqinë, gjendet në ditët e veta elektorale. Te ne nuk ka krizë politike dhe është shumë mirë që e kemi lënë pas këtë mundësi. Por tek ne, në raportet mes politikës dhe qytetarit, në raportet mes qeverisjes dhe shërbimit, kemi një krizë evidente. Administrimi në këtë vend është i eklipsuar prej amatorizmit, sikundër drejtësia është e paforcë për ndëshkimin e padrejtësisë dhe korrupsionit. Trishtimi që të jep paturpësia dhe fshehja e pasurimit përmes pushtetit, na kanë dhënë të gjithëve shijen se jemi në kohën e paturpësisë. Paturpësia e gjatë në kohë, gjithësesi rikthen cilësira makiaveliste, sepse e bëjnë edhe më të dukshme sëmurjen e demokracisë, por bëjnë prezente instinktet e qytetarit. Këto cilësira, kur kapërcehet masa dhe shkelen kufijtë e saj, i manifeston qytetari, deri edhe si protestues dhe fitues i ndryshimit real. Me atë që ndodhi këto ditë në Athinë dhe gjetkë, grekët e fituan një ndryshim, ndonëse është herët të themi se cilin.<sup>29</sup>

Ky përfundim është një parashikim i rrjedhës së gjërave, mbi bazë të analizës së një shembulli të ndodhur në fqinjin jugor të Shqipërisë.

## XV.4. LLOJE TË ARTIKULLIT ANALITIK

Hamit Boriçi ndan artikullin analitik në dy lloje: artikulli analitik pasqyrues dhe artikulli analitik problemor. Dallimi themelor midis këtyre dy llojeve qëndron në thellësinë e shqyrtimit të temës, në gjerësinë e përdorimit të metodave shkencore të hulumtimit dhe në përfundimet e nxjerra nga autori në fund të analizës.



Në anën tjetër të spektrit të njerëzve të frustruar nga dy partitë kryesore shqiptare janë ata që argumentojnë se të presësh deri sa individi më i fundit të jetë emancipuar, do të thotë të ecësh me hapin e më të dobët. Ndërkohë, sugjerojnë ata, ndryshimet duhet të vijnë nga më të përparuarit, qofshin ata edhe të paktë.

Ky grup njerëzish shpreson që një udhëheqës energjik e karizmatik të marrë nismën për krijimin e një force të re dominante politike, bërthama e së cilës të përbëhet nga intelektualë me arsimim e mentalitet perëndimor.

Sipas tyre, vetëm një forcë e tillë do të ishte e aftë të shëronte plagët e rënda që kanë mbërthyer qeverisjen në Shqipëri gjatë 18 vjetëve të fundit. Dhe përderisa një forcë e tillë akoma nuk ka dalë në skenën politike shqiptare, ata, njësoj si partizanët e ndryshimeve në mentalitet, rijnë larg procesit politik. Dhe pyetja është se cila palë ka të drejtë. Fatkeqësisht, përgjigjja e kësaj pyetje nuk mund të kënaqë asnjërën nga palët - e drejta ndodhet diku në mes të distancës që i ndan ato.

Ata që thonë se e meritojmë qeverinë që kemi kanë një farë të drejte - po të zhbirilohen thellë shqiptarët që kritikojnë kreun e qeverisë aktuale, shëmbëlltyra të tij mund të gjenden brenda mijëra e mijëra syresh.

Dhe këta shqiptarë punojnë sot ose do të punojnë nesër diku në një zyrë, të cilën e përdorin ose do ta përdorin për të marrë mitë, për t'i bërë favore të pamerituara të afërme ose të njohurve të tyre dhe për të shkëmbyer favore abuzive me zyrtarë të tjerë.

Por a duhet që ekzistenca e kësaj prirje të theksuar kah korrupsioni e klientelizmi ndër shqiptarët t'i dekurajojë ata që dëshirojnë ndryshime thelbësore në qeverisje? A duhet që ata ta fokusojnë vëmendjen vetëm kah ndryshimi i mentalitetit shqiptar?

Ndryshimi i mentalitetit është pa dyshim formula më e sigurt për arritjen e ndryshimeve thelbësore në qeverisje, por edhe më e ngadalta.

Dhe meqenëse është e ngadaltë, kushdo që dëshiron një qeverisje më të mirë nuk duhet të rrijë larg zhvillimeve politike aktuale. Pasiviteti politik, bazuar në arsyetimin se vlen të votosh vetëm kur ndryshimet në mentalitetin shqiptar të kenë krijuar kushtet për daljen e një alternative që ta meritojë votën, është thjesht joracional për kushtet aktuale.

Argumente  
ekzistuese  
për temën

Përfundime  
(ide) të  
gazetarit

<p>Në skenën politike shqiptare ekzistojnë alternativa qeverisëse relativisht më të mira se aktualja, të cilat nuk duhet të neglizhohen nga njerëzit që besojnë se çdo popull e meriton qeverinë e vet.</p> <p>Dhe ato nuk duhet të neglizhohen sepse, edhe në qoftë se nuk meritojmë një qeveri si të Finlandës, për shembull, nuk kemi pse të pranojmë një qeveri që kryesohet nga udhëheqësi më i papërgjegjshëm e ndoshta më i korruptuari ndër të gjithë udhëheqësit politikë aktualë.</p> <p>Po ata që besojnë se meritojmë një qeveri shumë më të mirë se çdo qeveri që mund të ofrojnë udhëheqësit aktualë çfarë duhet të bëjnë? A veprojnë drejt ata kur injorojnë alternativat aktuale dhe e mbajnë shpresën e tyre pothuajse ekskluzivisht në daljen e një Uashingtoni shqiptar?</p> <p>Dalja e individëve të tillë të fuqishëm në skenën e historisë së një populli nuk është diçka që ndodh shpesh. Në fillim të shekullit të kaluar, një individ i tillë, Ahmet Zogu, në moshë fare të re, doli në krye të shtetit shqiptar dhe e ktheu atë nga një territor kaotik e krejtësisht të përçarë në një shtet funksional. Ndërkohë, nuk ka kurrfarë garancie se, edhe në fillim të këtij shekulli, do të dalë në skenën politike shqiptare një udhëheqës i aftë për të sjellë ndryshime dramatike të së njëjtës magnitudë në qeverisje.</p> <p>Por, edhe po ta kemi atë fat, nuk mund të pritet që niveli i qeverisjes t'i afrohet shumë shpejt atij të shteteve të konsoliduara demokratike - një udhëheqës i mirë ka nevojë edhe për udhë-ndjekës të mirë.</p> <p>Duke mbajtur parasysh gjasat e vogla të daljes në skenën politike shqiptare të një udhëheqësi që do të sillte ndryshime rrënjësore në qeverisje, të gjithë ata që janë në pritje të tij bëjnë mirë të hedhin një sy nga çfarë e sotmja ofron. Të njëjtën gjë duhet të bëjnë edhe ata që presin ndryshimin gradual të mentalitetit shqiptar.</p> <p>Dhe të dyja palët bëjnë mirë ta fillojnë që sot analizën e alternativave që ofrohen në tregun politik. Ndërsa në fund të analizës, bëjnë mirë ta ndajnë mendjen për të mbështetur alternativën më të mirë qeverisëse, pavarësisht nga largësia prej të përkryerës.<sup>31</sup></p>	<p>Përfundime shtesë</p>
--	--------------------------

#### XV.4.2. ANALIZA PROBLEMORE

Nuk ndalet vetëm me pasqyrimin e temës, por shkon tutje, bën zbulimin e ndodhjes së saj, pse ka ndodhur një problem, si ndërlidhet ai problem me problemet e llojit të tij, si ndërlidhet problemi me shoqërinë në përgjithësi, cilat janë pasojat e tij dhe cilat janë


mundësitë e shoqërisë për ballafaqimin me të. Autori fokusohet në një temë, por ai përdor laboratorin shkencor të një hulumtuesi për të ardhur deri te zbulimet e tij dhe te përfundimet.

Analiza problemore “...është rezultat i një shqyrtimi analitik në një shkallë relativisht të dukshme”.<sup>32</sup> Pra, në analizën problemore tri janë karakteristikat themelore: analiza e thellë e temës, shpjegimi i saj dhe nxjerrja e përfundimeve nga ajo analizë. Një shembull të analizës problemore e shqyrtoam më lart, *Politika klimatike e ‘Mbretit tëhëngjill’* e Xhefri Saksit.

## **XV.5. NJË SHEMBULL METODIK PËR ANALIZËN DHE VENDI I SAJ NË GAZETARI (USHTRIM PËR STUDENTËT)**

Nëse bëjmë një krahasim me raportin dhe komentin, artikulli analitik është lloj gazetar më i gjerë se raporti dhe se komenti. Artikulli analitik fillon aty ku përfundojnë raporti dhe komenti. Raporti paraqet informacione për rrethanat e ndodhjes së një fakti objektiv (që është tema apo ideja e lajmit) dhe rrethanat shkakore dhe sociale në të cilat ndërlidhet ai fakt objektiv. Ndërsa komenti paraqet ngritjen e një ngjarjeje lajmore në nivel të temës së rëndësishme për publikun dhe opinionin apo pikëpamjen e gazetarit për atë temë. Artikulli analitik fillon me analizën e thellë të rrethanave që kanë shkaktuar dhe me pasojën e asaj ngjarjeje lajmore, me zbrëthimin e tyre në gjerësi (lidhje me rrethana të tjera) dhe me përfundimet që autori nxjerr nga analiza dhe zbrëthimi i tillë. Nëse i shikojmë këto lloje të tekstit në një rend shkallësh, dukja do të ishte kështu:

1. Shkalla e parë: lajmi (informon për një fakt objektiv);
2. Shkalla e dytë: raporti (zgjeron lajmin (dhe lajmet e tjera që ndërlidhen me të parin) dhe rrethanat e ndodhjes së atij fakti objektiv si dhe ndërlidhjen e tyre me rrethanat shkakore e sociale);
3. Shkalla e tretë: komenti (diskuton rreth ngjarjes lajmore me qëllimin përfundimtar komentimin e ngjarjes nga gazetari);
4. Shkalla e katërt: artikulli analitik (analizon deri në thellësi shkaqet, faktorët dhe pasojat e ndodhjes së atij fakti objektiv, duke sjell autorin përfundime që rrjedhin nga kjo analizë).
  - a. Analiza pasqyruese (thellësia e analizës mjaftohet vetëm sa për ta pasqyruar temën e trajtuar);
  - b. Analiza problemore (thellësia e analizës është maksimale, aq sa lejon natyra e gazetës së përditshme, përjavshme apo përmuajshme).



Bajram Kosumi, *Tipologji dhe zhanër* (2013)

Të marrim një temë dhe të shohim si mund të trajtohet në shkallë të ndryshme e në zhanre të ndryshme gazetare. Për shembull, tema e huliganizmit dhe e dhunës së rritur në shkollat e mesme të kryeqytetit mund të pasqyrohet në disa mënyra:

Lajmi	Teksti i parë: Informata për një rrahje që ka ndodhur në shkollën X. Dy grupe nxënësish janë rrahur midis tyre, por ajo që ka rënë në sy është ndërhyrja edhe e personave të tjerë, të cilët nuk janë nxënës të shkollës.
Raporti	Teksti i dytë (i mëvonshëm): tregon detajet e rrahjes së nxënësve. Ai nxjerr në shesh (sipas të dhënave të policisë) se personat e tjerë të ndërfutur në rrahje, të cilët nuk janë nxënës të shkollës, janë nxënës të shkollave të tjera të kryeqytetit. Zënka nuk ka të bëjë me çështje të shkollës. Autori ka hulumtuar edhe në dy shkolla të tjera dhe alarmon se zënka të tilla që përfundojnë në rrahje, poende dhe me pasoja, nuk është një dukuri e rrallë për shkollat e kryeqytetit.
Komenti	Teksti i tretë (i mëvonshëm) konstaton se huliganizmi në shkolla nuk është një dukuri e rrallë, por një shfaqje që përsëritet dhe tashmë është shndërruar në problem të vërtetë që kërkon një zgjidhje të shpejtë sa nuk ka marrë një përfundim tragjik.



Analiza pasqyruese	Teksti i katërt (i mëvonshëm): sjell të dhëna të drejtorisë së arsimit të komunës dhe të shefit të policisë. Ato shifra janë alarmuese: dhuna në shkollat e kryeqytetit është në rritje e sipër; mesatarisht, në javë ndodh një rrahje grupore e nxënësve dhe tri rrahje individuale; në disa prej tyre ndërhyjnë edhe nxënës të shkollave të tjera; dhuna në shkolla nxitet edhe prej huliganëve të qytetit të cilët në disa shkolla nuk pengohen të hyjnë brenda oborrit të shkollës; ka shfaqje edhe të dhunës së arsimtarëve ndaj nxënësve. Në fund autori alarmon për këtë dukuri që kërcënon zhvillimin normal të procesit mësimor.
Analiza problemore	Teksti i pestë (i mëvonshëm): shqyrton informatat e policisë dhe të drejtorisë së arsimit të kryeqytetit, duke i krahasuar ato me të dhënat për dhunën në shkollat e kryeqytetit në pesë vjetët e fundit. Autori nuk interesohet për rastet e veçanta të dhunës, por në bazë të analizës së fakteve e të dhënave arkivore, në bazë të një ankete të bërë me nxënës para tre vjetëve për arsyet e dhunës në shkolla, në bazë të analizave të OJQ-së "Arsimi modern" të publikuara në dy broshura, po edhe në bazë të disa burimeve të tjera të rëndësishme, mundohet t'i gjejë arsyet e rritjes së dhunës në shkollat e kryeqytetit. Autori arrin me sukses t'i identifikojë disa faktorë që ndikojnë në rritjen e dhunës, si mungesa e sigurimit fizik të objekteve shkollore, mungesa e kontaktimit të arsimtarëve me nxënës edhe jashtë orës mësimore, mosinteresimi i prindërve për anët e tjera të jetës së fëmijëve të tyre në shkollë, përveç notave, lejimi nga ana e komunës e disa bizneseve që të zhvillohen pranë objekteve shkollore (në një rast një kazino është ngjitur me oborrin e shkollës!) etj. Në fund autori nxjerr disa përfundime për nevojën e angazhimit të policisë, të personelit arsimor, të vetë prindërve dhe të drejtorisë së urbanizmit të kryeqytetit, në mënyrë që të zvogëlohet dhuna në shkollat e kryeqytetit.

## XV.6. PËRGATITJA TEKNIKE E ARTIKULLIT

Artikulli duhet të përgatitet teknikisht për botim në atë mënyrë që edhe përgatitja teknike ta ndihmojë marrësin për ta kuptuar temën e shqyrtuar. Artikulli duhet të plotësohet me foto, me harta, me karikatura, me skica, me plane të ndryshme etj. Në anën tjetër ai mund të plotësohet me mbititull, me titull, me nëntitull me mestituj (në redaksitë e gazetave këto punë zakonisht i bën redaktori), e të gjithë këta tituj duhet të përmbajnë një prej veçantive bazike të artikullit. Po ashtu, artikulli mund të plotësohet me antërfajlla të cilët korrespondojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi me temën në shqyrtim.

Artikulli analitik mund të plotësohet me mbititull, me titull, me nëntitull me mestituj (në redaksitë e gazetave këto punë zakonisht i bën redaktori), me antërfajlla të cilët korrespondojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi me temën në shqyrtim, me fotografi, me diagramë apo imazhe të tjera argumentuese etj.

# XV.7. NGA HISTORIA E ARTIKULLIT ANALITIK SHQIP

Në historinë e gazetarisë shqiptare artikulli është një prej formave më të kultivuara. Sidomos në shtypin e Rilindjes Kombëtare çmohej si formë e lartë e shprehjes gazetare. Përmbajtja kryesore e artikullit në shtypin shqiptar historik ishte ideja kombëtare dhe zhvillimi i saj deri te krijimi i kombit të lirë shqiptar. Në përgjithësi, tematika e gazetarisë shqiptare të Rilindjes Kombëtare përkonte me tematikën e letërsisë së romantizmit shqiptar, vetëm se tekstet gazetare dallojnë nga ato letrare në format e shkrimit dhe në ligjësitë e shkrimit. Artikulli tradicional shqiptar kishte për bazë një informacion, i cili pastaj komentohej dhe përfundonte me zbërthimin e pikëpamjes së autorit për çështjen në diskutim. Po ashtu, artikulli nuk fillonte domosdo me një lajm. Mund të fillonte me një temë nga aktualiteti dhe autori i zbërthente pikëpamjet e tij. Kështu, në artikullin *Si qeveriset Shqipëria*?<sup>23</sup> autori nuk fillon nga një lajm i ri, por nga premtimi që kishte dhënë në artikullin e mëhershëm për të rrefyer se si qeveriset Shqipëria. Një pjesë e madhe e teksteve të traditës gazetare shqiptare të emërtuara Letra mund të radhitën te artikulli, sepse edhe në përmbajtje po edhe në strukturim janë artikuj gazete.



## XVI. KRYEARTIKULLI

### XVI.1. ÇËSHTJE TË IDENTITETIT ZHANROR

**K**ryeartikulli trajtohet më shumë si rubrikë gazete sesa si lloj zhanror, nisur nga fakti se kryeartikulli dallohet nga një tekst tjetër gazete vetëm për shkak të vendit kryesor që ka në gazetë, pra është një tekst i botuar në ballinë, menjëherë nën titullin e gazetës. Praktikant gazetarë dëshmojnë se në ballinën e një gazete botohet lajmi kryesor brenda 24 orëve të fundit, por shpeshherë, kur 24-orëshi nuk sjell lajme të rëndësishme të madhe, në ballinë zënë vend edhe zhanre të tjera të tekstit, si raport, analizë, intervistë, një deklaratë, e në gazeta me ngjyrim të fortë ideologjik mund të jetë edhe komenti e të ngjashme. Nëse brenda 24 orëve të fundit ka ndodhur një lajm i rëndësishëm të madhe, natyrisht që ai botohet në vendin kryesor të ballinës së gazetës dhe kështu e merr rolin e kryeartikullit, por nëse nuk ka një lajm të tillë, por ka një raport për një lajm të rëndësishëm të para 24 orëve, atëherë ai raport zë vendin kryesor në ballinë dhe luan rolin e kryeartikullit. Mbas shpalljes së rezultateve zgjedhore, një analizë për koalicionet e mundshme merr rol të madh, prandaj mund të botohet në vendin kryesor të ballinës dhe të funksionojë si kryeartikull. Më gusht 2015 bëri bujë mediatike lajmi i aksidentit fatal, i ndodhur më 30 korrik në fshatin Lekaj të Kavajës, me ç'rast shoferi Kosta Taçi, biznesmen, lëndohet rëndë, ndërsa bashkudhëtarja e tij, njëkohësisht edhe bashkëpunëtore e tij biznese, Bujana Bushi, vdes si pasojë e shokut traumatik (sipas raportit të mëvonshëm policor). Të afërmit e viktimës akuzojnë publikisht për vjedhje të gjësendeve të vlefshme të cilat i kishte me vete viktimën në çastin e aksidentit (100 000 euro dhe stoli ari disa mijë euro). Ky pohim i familjarëve nxiti dyshime të mëdha për një komplot dhe vrasje dhe mediet shqiptare për disa ditë rresht e rezervuan kryeartikullin për këtë ngjarje lajmore: si kryeartikull botohej deklarata e burrit të viktimës, pastaj të nesërmen deklarata e vëllait të saj, rastin tjetër një intervistë e vëllait të shoferit të aksidentuar, rastin tjetër vetë intervista e shoferit, rastin tjetër raporti i mjekëve ligjorë etj.

#### PËRMBAJTJA

XVI. Kryeartikulli. . . . .	251
XVI.1. Çështje të identitetit zhanror. . . . .	251
XVI.2. Vendi i kryeartikullit në gazetë. . . . .	254
XVI.3. Rëndësia e temës. . . . .	255
XVI.4. Aktualiteti i temës	256
XVI.5. Kryeartikulli e krijon gazetën. . . . .	257
XVI.6. Gjerësia e trajtimit të temës . . . . .	257
XVI.7. Struktura e kryeartikullit . . . . .	258
XVI.8. Shkrimi i kryeartikullit . . . . .	260
XVI.9. Nga historia e gazetarisë shqiptare .	260

Në ballinën e një gazete botohet lajmi kryesor brenda 24 orëve të fundit. Ai quhet kryeartikull. A është, pra, kryeartikulli rubrikë apo zhanër?

**PUBLIKOHEN PAMJET E PARA TË AKSIDENTIT KU HUMBI JETËN ...**[www.panorama.com.al](http://www.panorama.com.al) › Argument

*Në vendin e ngjarjes vihen re automjeti me të cilin udhëtonte **Bujana Bushi** së bashku ... që na ndiqni dhe ju ftojme të vazhdoni të jeni pjesë e **Panorama Online**.*

**AUTOPSIA, BUJANA BUSHI VDIQ NGA SHOKU TRAUMATIK | GAZETA ...**[www.panorama.com.al](http://www.panorama.com.al) › Flash

*Gruaja 32-vjeçare **Bujana Bushi**, e cila humbi jetën në aksidentin rrugor mes Kavajës...*

**ZBARDHET DËSHMIA E BIZNESMENIT NË POLICI: KU DO T'I MERRTE ...**[www.panorama.com.al](http://www.panorama.com.al) › Aktualitet

*Bujana Bushi ishte e punësuar pranë kompanisë sime si ekonomiste.*

**AKSIDENTI MISTERIOZ/BIZNESMENI TAÇI: BUJANA NUK MË THA SE ...**[www.panorama.com.al](http://www.panorama.com.al) › Kronike**PAMJE NGA AKSIDENTI (DJATHTAS) VIKTIMA BUJANA BUSHI.**

*Zhdukja e 100 mijë eurove pas aksidentit, xhaxhai i 32 ...*

[www.panorama.com.al](http://www.panorama.com.al) › Në fokus

*Familjarët e 32- vjeçares **Bujana Bushi**, gruas që humbi jetën në aksidentin e ... Në një intervistë për gazetën "Panorama", ai thotë se mbesa i kishte ato para për...*

**EKSKLUZIVE/ MJEKU I URGJENCËS: PLAGËT E BUJANËS NGA ...**[www.panorama.com.al](http://www.panorama.com.al) › Kronike

*Në një intervistë për gazetën "Panorama", mjeku Spanishi sqaron procedurat ... Vajza në fjalë, që më pas u identifikua me emrin **Bujana Bushi**, ka ardhur në...*

**EKSKLUZIVE/MJEKU I URGJENCËS: 20 MINUTAT E FUNDIT TË BUJANËS ...**[www.panorama.com.al](http://www.panorama.com.al) › Lajmi i Fundit

Disa nga tituj e gazetës *Panorama*, kryesisht të botuar në ballinë, në vendin e kryeartikullit. Titujt janë nxjerrë nga kërkimi në [Google.com](http://Google.com). me të njëjtin intensitet kanë botuar kryeartikuj të gjitha gazetetat ditore (edhe ato digjitale) të Tiranës.

Në të gjitha këto raste, dhe në të tjera të ngjashme, një lajm, një raport, një analizë etj., luajnë rolin e kryeartikullit. Nëse është vetëm kështu, atëherë kryeartikulli nuk ka një strukturë të veçantë tekstore

dhe nuk ka një qëllim të vetin përmbajtjesor, prandaj edhe nuk është zhanër gazetar, por rubrikë gazete. Mirëpo, trajtimi i këtyllë është i njëanshëm. E vërteta është se kryeartikulli mund të jetë lajm, fotolajm, raport, intervistë, analizë, koment etj., por edhe kur është lajm e raport ai dallon prej lajmeve e raporteve të tjera brenda gazetës jo vetëm për shkak të vendit që zë, por edhe për shkak të rëndësisë së temës që trajton, aktualitetit të temës dhe për shkak të gjerësisë së trajtimit të saj. Këto tri elemente më shumë e vënë në dyshim trajtimin e artikullit vetëm si rubrikë gazete. Në origjinë kryeartikulli ka qenë vetëm rubrikë, por me kalimin e kohës ai ka marrë edhe disa veti të pëlqyeshme vetëm për tekstin që botohet në ballinën e gazetës, prandaj edhe duhet të trajtohet si një tekst që ka disa tipare të zhanrit. Ne do ta trajtojmë kryeartikullin si zhanër gazetar, të bindur se kryeartikulli nuk mund të përkufizohet vetëm si rubrikë ose vetëm si zhanër. Duke shqyrtuar katër elementet karakteristike të tij, një prej të cilëve është karakteristikë e rubrikës dhe tri janë karakteristika zhanrore, kryeartikulli mund të paragjykohet si një tekst gazetar me natyrë multimediale, që ka karakteristika edhe të rubrikës, edhe të zhanrit.



### Aksidenti në Kavajë, akuza: Çantën e kemi ne!


4 Gusht 2015

## Shqip

**Prokuroria:** I kemi të gjitha sendet. Regjimet pas aksidentit me vdekje të 33-vjeçares

**Aksidenti** – Policia e Tiranës sqaron se aksidenti ka ndodhur në 30.07.2015, në aksin rrugor Kavajë-Rrogozhinë, pranë kryqëzimit të fshatit Lekaj

**Familjarët** – Të afërmit e 33-vjeçares, por edhe ish-bashkëshorti pohojnë se nuk kanë dijeni për shumën prej 100 mijë eurosh që kishte Bujana Bushi me vete



Shefi i qarkullimit rrugor të Kavajës dhe 4 punonjës të të njëjtit sektor janë pyetur nga Policia e Tiranës, në lidhje me pretendimin e familjarëve të një të aksidentuare me vdekje se kanë humbur 100 mijë euro që ndodheshin

në çantën e saj. Nga ana tjetër, Prokuroria e Tiranës thotë se të gjitha sendet që u gjetën në vendin e ngjarjes ndodhen në Prokurorinë e Kavajës. Policia pretendon se kanë nisur



hetimet lidhur me pretendimet dhe akuzat e familjarëve të Bujana Bushit, 33-vjeçares e cila mbeti viktimë e një aksidenti më 30 korrik, në aksin Kavajë-Rrogozhinë. Fillimisht, janë pyetur katër punonjësit e Policisë Rrugore të Kavajës, të cilët ndodheshin në vendngjarje ditën e aksidentit, si dhe është marrë deklarimi i shefi të qarkullimit rrugor. Ndërkaq, mësohet se efektivët e policisë kanë mohuar se ditën e aksidentit të kenë konstatuar para në mjetin tip "Benz", me të cilin po udhëtonte viktimja. Ata kanë deklaruar se kanë administruar sende personale të viktimës, por jo para. Policia e Tiranës sqaron se aksidenti ka ndodhur në 30.07.2015, në aksin rrugor Kavajë-Rrogozhinë, pranë kryqëzimit të fshatit Lekaj. Kosta Taçi, duke qarkulluar me mjetin tip "Benz" me targa AA 837 GH, pas ndërprerjes së rrugës nga motori drejtuar nga Fatmir Bekshiu, u përplas me një mjet tjetër që po udhëtonte në sensin e kundërt të rrugës. Sipas policisë, është paraqitur vëllai i shtetasit Kosta Taçi, të cilit iu dorëzuan edhe sendet personale që gjendeshin në makinë. Shtetasi A.A, vëllai i drejtuesit të mjetit mori me vete edhe çantën e viktimës. Më pas kjo çantë me procesverbal iu dorëzua prokurorit të çështjes. Nga ana tjetër, burimet e prokurorisë thonë se sendet personale që ndodheshin në makinë, tashmë ndodhen te prokurori i çështjes, por pa specifikuar çantën me 100 mijë euro. Policia thotë nga ana e saj se sendet personale do të merren pas vendimit të prokurorisë.

## XVI.2. VENDI I KRYEARTIKULLIT NË GAZETË

Editoriali e ka vendin e nderit në ballinë, por vendin kryesor e zë kryeartikulli.

Kryeartikulli e ka vendin kryesor në gazetë. Editoriali e ka vendin e nderit, por vendin kryesor e zë kryeartikulli. Nëse bëhet një kra-

Te Kosova sot shihet se si qëndrojnë pranë editorialit dhe kryeartikulli. Ani pse editoriali ka vendin e parë në ballinë, vendin kryesor e zë kryeartikulli me titullin *Qeveria tenton t'ua mbyllë gojën bizneseve*, i cili, përveç mbititullit, titullit, nëntitullit dhe kreut, pjesën tjetër e ka në faqen 6.

KOSOVA SOT

[www.kosova-sot.info](http://www.kosova-sot.info)  
18  
VJET  
LEJUESHMERI  
PANGJESHMERI  
BEJLESHMERI  
LIDHERE E GAZETAVE NË KOSOVË

SHTUNË, 12 MARS 2016, QMIMI 0.40 E, VITI XVIII, NR. 5959
THEMELUES: RUZHDI KADRIU

EDITORIALI

Bizneset, si plaçkë e oligarkëve të pushtetit

Vendimi më i ri i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik të Kosovës e lustron edhe një herë politikhën armiqësore dhe të dëmshme, që ndjek Qeveria aktuale ndaj sipërmarrjes private në vendin tonë. Po të ishte një Qeveri, që ka vullnet për t'i indhimuar bizneset të ndershëm, që paguan tatime me rregull, punëson dhe mban familje të tëra, KRRPP-ja jo vetëm që nuk do ta dhjetëfishonte tarifën e një ankesë, por do ta hiqte fare. Fundja, përse bizneset duhet të pagojnë për një ankesë që kanë ndaj padrejtësive, që u bëhen në procedurat e prokurimit publik? Ky organ bashkë me OSHP-në janë institucione publike, që paguhen nga buxheti i shtetit, pra nga para të taksa-paguesve kosovarë, qytetarët dhe bizneset. Përse u dashka që sërish të takohen në këtë rast kompanitë private? Është shumë e qartë se një vendim i tillë i komitetit që është detyrues...

VENDIMI SKANDALOZ I KOMISIONIT RREGULLATIV TË PROKURIMIT PUBLIK

# Qeveria tenton t'ua mbyllë gojën bizneseve

Rritja e çmimit të aksesës ua pamundëson ushtrimin e së drejtës kushtetuese



Vendimi i KRRPP-së për rritjen e çmimit të aksesave të bizneseve ndaj vendimeve të OSHP-së nga 500 euro në 5000 euro nga njohësit e kësaj fushe, deputetë opozitarë dhe nga bizneset është vlerësuar të jetë një tendencë e pushtetit që t'ua mbyllë gojën bizneseve vendore, të cilat nuk do të mund të ankojnë ndaj vendimeve të padrejta

hasim me organizimin institucional, editoriali është si një kryetar nderi, ndërsa kryeartikulli si një shef ekzekutiv. Teksti botohet në pjesën më të madhe të ballinës, zakonisht nuk botohet i tëri në ballinë, e pjesa e mbetur vazhdon edhe në faqen tjetër, ose në të tretën. Zakonisht, teksti plotësohet me fotografi, me antërfajlla, me harta apo me diagrame etj.

Duke u vënë në ballë të gazetës, kryeartikulli fiton një tendencë: është përzgjedhje e kryeredaktorit. Nga moria e ngjarjeve ai ndan një temë dhe e vë në ballë të mediumit, pra i jep temës rëndësinë parësore, e kështu ai ka mundësinë të ndikojë më shumë opinionin publik. Zgjedhja e kryeredaktorit është vendimtare për kryeartikullin. Zgjedhja është e lehtë në rastet kur ka një lajm shumë të rëndësishëm. Por, në rastet kur nuk ka lajme tepër të rëndësishme, atëherë zgjedhja është më e vështirë, sepse kryeredaktori duhet të zgjedhë nga moria e temave të zakonshme një që mund të jetë kryeartikull. Nëse ai ka “nuhatje” për ta zgjedhur temën vërtet më të rëndësishme të ditës, kryeartikulli ka gjasat reale të jetë i realizuar mirë. Natyrisht kjo nuk e mohon punën e gazetarit (apo gazetarëve që punojnë në një kryeartikull) por, para së gjithash, vendimtare është përzgjedhja e temës.

Nëse një ngjarje e zgjedhur për kryeartikull nga kryeredaktori, apo nga redaktori e humbet vlerën gjatë ditës? Nëse ndodh një ngjarje tjetër më e rëndësishme e ditës? Thjesht, kryeredaktori ndërron mendimin dhe e vë në ballinë ngjarjen e re. Është e mundshme (e kjo zakonisht ndodh kështu) që deri në çastin e fundit kryeredaktori nuk është përcaktuar përfundimisht për kryeartikullin. Sigurisht ai ka në mendje ndonjërin prej artikujve të atij numri, por ende nuk e ka marrë vendimin përfundimtar, sepse pret deri në çastet e fundit të gjitha zhvillimet për t’u bindur se s’ka asgjë të re. Mund të ndodhë që në çastet e fundit një redaktor ia sjell një lajm apo një raport të gazetarit, i cili mund të jetë kryeartikulli. Dhe kryeredaktori përsëri e ndërron mendjen dhe e poston në ballinë lajmin e raportin e porsaardhur.

### XVI.3. RËNDËSIA E TEMËS

Me përshkrimin e situatave kur kryeredaktori përcaktohet për kryeartikullin, ne adresuam varshmërinë e njëqind për qind të kryeartikullit nga rëndësia e temës që trajton. Kryeartikulli trajton një temë vetëm të rëndësishme së parë. Kësisoj, kryeartikulli është artikulli më i rëndësishëm i ditës, i trajtuar thelbësisht e gjerësisht nga gazeta. Tema e kryeartikullit nuk mund të jetë një çfarëdo teme

Kryeartikulli trajton një temë vetëm të rëndësishme së parë. Kësisoj, kryeartikulli është artikulli më i rëndësishëm i ditës, i trajtuar thelbësisht e gjerësisht nga gazeta.



e ditës, cilido lajm apo cilido raport. Redaktori zgjedh një temë e cila për një apo një tjetër aspekt merr rëndësi parësore në një ditë të shoqërisë. Pra, tema mund të jetë me motive të ndryshme, po ajo që kërkohet për kryeartikull është rëndësia parësore e asaj teme. Temën e kryeartikullit nuk e dallojnë përmbajtja apo motivi, por rëndësia e tyre. Natyrisht se temat efemere nuk mund të marrin asnjëherë rëndësinë parësore për shoqërinë, prandaj redaktorët kujdesen për gjetjen e temës së vërtetë për kryeartikullin. Ndërsa temat më të shpeshta që marrin rëndësi parësore janë temat që prekin thellë interesin njerëzor: aksidente të rënda, vrasje të rënda, fillime të konflikteve e të luftërave, pasoja të rënda sociale apo ekonomike, vendime dhe të bëma më të rëndësishme të pushtetit etj.

Në rëndësinë e temës, kryeartikulli është i afërt me editorialin: nëse tema është dominuese për shoqërinë, ajo mund të jetë njëkohësisht edhe temë editoriali (botuesi pozicionohet ndaj saj) edhe temë kryeartikulli (marrësi informohet gjerësisht për të).

Në rëndësinë e temës, kryeartikulli është i afërt me editorialin: nëse tema është dominuese për shoqërinë, ajo mund të jetë njëkohësisht edhe temë editoriali (botuesi pozicionohet ndaj saj), edhe temë kryeartikulli (marrësi informohet gjerësisht për të). Për shembull: gazetat kanë botuar kryeartikuj me informacion të zgjeruar për djegien e objekteve doganore në Hyrjet 1 dhe 31 të kufirit verior të Kosovës me Serbinë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës (17 shkurt 2008), ndërsa në të njëjtën kohë botuesit kanë shkruar editorialët rreth djegies së atyre objekteve doganore. Por, kryeartikulli dallon thelbësisht nga editoriali: editoriali shfaq një qëndrim politik të botuesit, ndërsa kryeartikulli është informacion dhe analizë e fakteve që kanë sjellë deri te një pasojë e caktuar dhe nuk ka pozicionim, edukim dhe asgjë që ka te editoriali.

## XVI.4. AKTUALITETI I TEMËS

Karakteristika e dytë e kryeartikullit është aktualiteti i temës që ai trajton. Tema e kryeartikullit duhet të jetë domosdoshmërisht aktuale. Zakonisht ai është lajmi kryesor i gazetës. Ashtu si nuk mund të ketë një lajm të vjetër në gazetë, nuk mund të ketë edhe një kryeartikull me temë joaktuale. Artikulli analitik, editoriali, komenti, kolumna etj., mund të trajtojnë tema më pak aktuale, ndërsa kryeartikulli synon të trajtojë tema vetëm të 24 orëve të fundit, ose tema që kalojnë 24 orët, por janë shumë të rëndësishme dhe ende në proces. Edhe këtu vlen e njëjta rregull si për lajmin: mund të ketë një kryeartikull me temë të vjetër, vetëm nëse ajo temë është e rëndësishme së parë dhe ka qenë e panjohur për opinionin publik, ose është ende në proces të ndodhjes apo në proces të jehonës së pushuar.

Tema e kryeartikullit duhet të jetë domosdoshmërisht aktuale.

## XVI.5. KRYEARTIKULLI E KRIJON GAZETËN

Duke qenë lajmi apo tema kryesore e gazetës, kryeartikulli, është edhe kryetrari i saj, ai i jep audiencës jo vetëm lajmin kryesor të gazetës, por edhe ngjyrimin e saj, tonin e saj, prirjen apo orientimin e saj. Sado që gazetat të jenë neutrale, orientimi i tyre ideologjik, politik apo profili social e profesional e ndikon edhe kryeartikullin. Si kemi parë më herët, te editoriali kjo është jo vetëm e lejueshme, por edhe e kërkueshme: profili apo orientimi politik, social a profesional i gazetës shfaqet në editorial. Ndërsa te kryeartikulli kjo nuk është e kërkueshme, por është deri-diku e natyrshme, sepse kryeartikulli, duke informuar, raportuar, analizuar etj., i jep gazetës edhe ngjyrën dhe tonin e vet. Kështu, një demonstratë e punëtorëve nuk do të mund të paraqitet njësoj si në një gazetë me prirje djathtiste dhe në një gazetë sindikaliste. Dy gazetat me identitet ideologjik në Tiranë, *Rilindja demokratike* (organ i Partisë Demokratike të Shqipërisë) dhe *Zëri i popullit* (organ i Partisë Socialiste të Shqipërisë) sjellin në botimet e 22 janarit 2011 kryeartikuj skajshmërisht të kundërt në lidhje me protestat e një dite më parë, të shndërruara në protesta të përgjakshme. Në kryeartikullin e *Rilindjes demokratike* informohet për puçin e dështuar të Edi Ramës dhe Co, ndërsa në kryeartikullin e *Zërit të popullit* informohet për krimet e Sali Berishës mbi qytetarët e pafajshëm (vrasja e tre demonstruesve nga ana e Gardës Kombëtare). Natyrisht, në shembullin e fundit kemi të bëjmë me gazeta partiake, me ç'rast secila ka për qëllim realizimin e qëllimit të partive që prezantojnë e jo realizimin elementar gazetar: informimin. Njësoj ka ndodhur edhe me raportimin e medieve të Kosovës për demonstratat e dhunshme të opozitës në Prishtinë më 27 janar 2015: RTK-ja raportonte për dhunën e demonstruesve ndaj policisë, ndërsa KTV-ja për dhunën e policisë ndaj demonstruesve. Pavarësisht nga ky shembull i skajshëm, kryeartikulli bart në vete një ngjyrim redaksional të gazetës dhe atë ngjyrim i jep gjithë numrit të gazetës. Kjo është karakteristika e tretë e kryeartikullit.

Kryeartikulli i jep audiencës jo vetëm lajmin kryesor të gazetës, por edhe ngjyrimin e gazetës së asaj dite, tonin e saj, prirjen apo orientimin e saj.

## XVI.6. GJERËSIA E TRAJTIMIT TË TEMËS

Karakteristika e katërtë që e dallon kryeartikullin është gjerësia e trajtimit të temës. Në kryeartikull autori jo vetëm informon marrësin për një lajm të ri, por edhe shpjegon, sjell detaje, madje autori fut edhe ndonjë koment të tij për procesin e ndodhjes që trajton. Si u tha më lart, autori mund të fusë edhe elemente tjera tekstore e jo tekstore në kryeartikull, si antërfajll, fotografi, hartë, dokument zyrtar, diagram etj. Është e rëndësishme që audiencia të pranojë jo

Gazetari mund të fusë edhe elemente të tjera tekstore e jotekstore në kryeartikull, si antërfajll, fotografi, hartë, dokument zyrtar, diagram etj.

vetëm informatën për faktin objektiv, por edhe rrethanat e gjera të ndodhjes së faktit objektiv.

Mund të ndodhë që pjesa e kryeartikullit në ballinë të jetë vetëm pjesë e vogël nga tërësia e kryeartikullit, ndërsa pjesa që botohet në faqet e brendshme të gazetës të ketë edhe një faqe, por edhe dy, e në situata të jashtëzakonshme edhe më shumë. Kështu, ditën që mbahen zgjedhjet në një vend, gazeta do t'ua kushtojë kryeartikullin zgjedhjeve. Në ballinë do të fillojë teksti i kryeartikullit, ndërsa në brendi mund t'i kushtohen disa faqe të gazetës vetëm kësaj ngjarjeje. Në situata të jashtëzakonshme, për shembull në aksidente ajrore, ose në raste tërmetesh, faqet e brendshme të lidhura me kryeartikullin rriten, varësisht prej pasojave të aksidenteve. Në kësi rastesh kryeartikulli është një raport i gjerë apo një artikull analitik i gjerë, me të cilin ndërliidhen edhe artikuj të tjerë brenda gazetës. Por, kjo nuk është një rregull: nuk do të thotë që kryeartikulli nuk përmbillet vetëm në ballinë. Mund të ketë një lajm të rëndësishë parësore, të mos jetë shumë i gjerë dhe të botohet si kryeartikull.

Në aktualitetin e temës dhe në gjerësinë e trajtimit të saj kryeartikulli është i afërt me lajmin dhe raportin. Me lajmin është i afërt sepse informon, me raportin është i afërt sepse shpjegon rrethanat e ndodhjes së faktit objektiv, por dallon prej tyre sepse analiza e rrethanave të ndodhjes së faktit objektiv e mbizotëron informacionin, pra është pjesë e gazetarisë analitike.

## XVI.7. STRUKTURA E KRYEARTIKULLIT

Nëse kryeartikulli është lajm, ai ka strukturën e lajmit; nëse është analizë, ai ka strukturën e analizës; nëse është një lajm i jashtëzakonshëm, por për të cilin nuk ka shumë informata, ai mund të jetë një kryeartikull i shkurtër; nëse është raport, ai ka strukturën tekstore të raportit etj.

Duke qenë kryeartikulli tekst me natyrë multimediale, me elemente zhanri dhe rubrike, tekst që përmban elemente të gazetarisë informative dhe të gazetarisë analitike, ai nuk mund të ketë një strukturë fikse dhe të artikuluar e të dallueshme qartë. Kështu, nëse kryeartikulli është lajm, ai ka strukturën e lajmit; nëse është analizë, ai ka strukturën e analizës. Megjithatë, mund të dallohen disa elemente të fuqishme strukturore që janë të përbashkëta për të gjithë kryeartikujt dhe pikërisht këto elemente mund të përkufizohen si dominuese në strukturën e kryeartikullit.

Elementi i parë i strukturës është **titulli i fuqishëm**. Secili tekst gazete synon një titull të jashtëzakonshëm, mirëpo titulli i kryeartikullit duhet të jetë thellësisht nxitës për audiencën. Ai është kryetitulli i gjithë gazetës. Ai është titulli që e tërheq lexuesin në gjithë gazetën. Atë rol që e ka titulli për lajmin, e ka titulli i kryeartikullit për krejt numrin e gazetës. Secili numër i gazetës është i identifikuar parësisht me titullin e kryeartikullit.

Elementi i dytë është **informata kryesore**. Një kryeartikull mund të ketë shumë informacion, por njëri prej tyre është kryesori, boshti i tij. Nuk ka kryeartikull pa një informatë bosht, pra pa një fakt objektiv i panjohur për publikun, ose i njohur vetëm sipërfaqësisht.

Elementi i tretë është **tregimi për rrethanat** e ndodhjes së lajmit kryesor. Kështu, në të gjithë kryeartikujt e gazetave për tërmetin e Dibrës në tetor të vitit 2008, informacioni kryesor ka qenë rreth vetë tërmetit, ndërsa rrethanat shpjeguese kanë qenë edhe shumë informacione të tjera për të mbeturit pa shtëpi, për të lënduarit, për rolin e Kryqit të Kuq, për angazhimin e qeverisë shqiptare, shkrime krahasuese me tërmetin e viteve gjashtëdhjetë të shekullit XX etj.

Elementi i katërt, më i rëndësishmi (me titullin, informatën kryesore dhe shpjegimin e rrethanave të ndodhjes së lajmit, teksti do të mund të ishte raport) **analizimi dhe shpjegimi i rrethanave** të ndodhjes së lajmit dhe ndoshta edhe **përfundimet e autorit**.



Titulli i fuqishëm  
Informata kryesore  
Tregimi për rrethanat  
Analizimi dhe shpjegimi i rrethanave  
Përfundimet e autorit.

Kjo strukturë e kryeartikullit është në përputhje me përmbajtjen e tij gjysmë informacion, gjysmë analizë. Të gjitha këto elemente strukturore nuk mund të gjenden te çdo kryeartikull. Për shembull, elementi i fundit (analizimi dhe shpjegimi i rrethanave, ose edhe

përfundimet e autorit) nuk është i pranishëm në rastet kur kryeartikulli është lajm i shkurtër. Megjithatë, duhet përmbajtur parimit: një kryeartikull i mirë duhet t'i ketë elementet e mësipërme strukturore.


## XVI.8. SHKRIMI I KRYEARTIKULLIT

Shpeshherë shkrimi i kryeartikullit kërkon punë ekipore. Ka tema të cilat nuk mund t'i mbulojë një gazetar. Redaktori shpërndanë gazetarët në vende të ndryshme dhe të dhënat e tyre i bashkon në kryeartikull.

Zakonisht shkrimi i kryeartikullit lidhet me kryeredaktorin ose me ndonjë nga redaktorët. Sikurse botuesi që ka editorialin ku shpall qëndrimin e tij politik për një çështje, një shfaqje apo një fakt, edhe kryeredaktori ka kryeartikullin përmes të cilit e tërheq vëmendjen e audiencave dhe e orienton në atë çështje për ta konsideruar edhe ai, audienca, si kryeçështje. Kjo nuk do të thotë se kryeartikullin e shkruan kryeredaktori. Atë e shkruan gazetari, me sugjerimet e redaktorit apo kryeredaktorit, por mund të ndodhë edhe që redaktori apo kryeredaktori i japin rëndësinë e madhe një teksti tashmë të shkruar nga gazetari dhe e vendosin si kryeartikull.

Shpeshherë shkrimi i kryeartikullit kërkon punë ekipore. Ka tema të cilat nuk mund t'i mbulojë një gazetar. Redaktori i shpërndanë gazetarët në vende të ndryshme dhe të dhënat e tyre i bashkon në kryeartikull. Por, edhe kur nuk ka nevojë për shpërndarje të gazetarëve, duke qenë kryeartikulli pjesa më e rëndësishme e gazetës, kërkon bashkëpunim të pjesës elite të gazetës si, p.sh., për të gjetur një fotografi, për një diagram, një hartë, një deklaratë, apo të ngjashme.

## XVI.9. NGA HISTORIA E GAZETARISË SHQIPTARE



"Hylli i Dritës", botuar nga Gjergj Fishta

Në gazetarinë shqiptare kryeartikulli ka një histori të mirë të zhvillimit. Pothuajse të gjitha gazetatat, pavarësisht nga koha kur dilnin, kishin kryeartikujt e tyre. Kryeartikulli publikohej pothuajse në çdo numër të gazetës. Ndonjëherë botohej edhe pa titull, ndonjëherë pa autor, ndonjëherë me autorësi redaksionale etj. Kryeartikulli botohej në krye të gazetës dhe zakonisht aty rriheshin tema të rëndësishme nga e gjithë fusha e politikës, shoqërisë dhe e kulturës kombëtare. Ndërsa në strukturë është i ngjashëm me vështrimin (komentin). Zakonisht ata janë shkruar nga botuesit e gazetës, ose nga emrat e fuqishëm të një gazete. Kështu *Hylli i Dritës* në kryeartikull boton tema të rëndësishme së madhe, si tema të filozofisë dhe idesë kombëtare. Ernest Koliçi boton ligjëratën *Qytetnimi Shqiptar*<sup>34</sup>, ndërsa Pater Anton Arapi O. F. M. boton shkrimin *Ideologji Shqiptare*.<sup>35</sup>

## XVII. KOLUMNA

XVII.1. ÇËSHTJE TË NOCIONIT  
DHE TË IDENTITETIT ZHANROR

**K**olumna është zhanër i ri gazetar, i krijuar në 20 vjetët e fundit të shekullit XX. Më herët fjala kolumnë është përdorur vetëm në kuptimin e rubrikës. Fjala vjen nga latinishtja *columna* - shtyllë. Në antikë *columna* është quajtur teksti në të cilin fjalët janë shkruar nga njëra në anën tjetër të papirusit, duke lënë anash hapësirë të lirë (margjiina, ledhore), kështu që teksti i shkruar është dukur sikurse shtyllë. Edhe sot në gazetari fjala kolumnë ka kuptimin e një shtylle teksti në gazetë apo në libër. Nga ky kuptim praktik është krijuar edhe lloji i tekstit gazetar. Mirëpo, kolumna asnjëherë nuk është liruuar tërësisht nga kuptimi i emërimit origjinal: edhe sot ajo qenëson midis zhanrit dhe rubrikës. Kolumnist quhet secili autor që ka një marrëveshje me një gazetë dhe bën tekste të rregullta në intervale të caktuara kohore, kryesisht komente, për atë gazetë. Nga ky prizëm kolumna është rubrikë e jo zhanër. Dilema në është kolumna rubrikë apo zhanër është e diskutueshme në teorinë e gazetarisë. Në traditën anglishtfolëse të gazetarisë kolumna është vetëm rubrikë personale e një autori i cili trajton tema sipas përzgjedhjes dhe mënyrës së tij. Pikërisht fjalët e fundit “sipas përzgjedhjes dhe mënyrës së tij” e bëjnë këtë tekst të marrë disa veçori që janë karakteristike vetëm e saj, dhe mu këtu hapet diskutimi nëse ajo është edhe zhanër. Këto veçori e bëjnë atë të anojë kah zhanri gazetar. Duhet të theksohet se dysia rubrikë-zhanër për kolumnën zhvillohet edhe varësisht praj praktikave gazetare të vendeve të ndryshme. Në një studim të tij Đorđe Obradović ka analizuar 200 kolumna të botuara në gazetatat kroate dhe vjen në përfundim se kolumna nuk është zhanër, por vetëm rubrikë, sepse në të gjitha rastet e analizuara ajo ka qenë ose raport, ose polemikë, ose analizë apo ka qenë cilido lloj tjetër gazetar i njohur, po në asnjë rast nuk ka qenë lloj më vete.<sup>36</sup> Ka rubrika gazete të cilat quhen kolumna, ndërsa në aspektin tematik e zhanror janë tema të ndryshme ditore: këshilla me mjekun, ditarë të individëve të ndryshëm, memoare, humoreska, komente etj.

Prandaj nuk mund të injorohet kjo natyrë e dyfishtë e kolumnës: ajo është edhe rubrikë gazete (në rastet kur në të botohen lloje të tjera gazetare), por është edhe lloj zhanror, si do të shohim në vazhdim, sepse ka disa karakteristika që janë të veçanta për të. Diskutimi për rubrikën e kthen temën te organizimi teknik dhe te menaxhimi

## PËRMBAJTJA

XVII. Kolumna. . . . . 261

XVII.1. Çështje të nocionit dhe të identitetit zhanror . . . . . 261

XVII.2. Personalja dhe publikja (statusi i tekstit dhe qëllimi përmbajtjesor). 263

XVII.3. Konstatime personale . . . . . 264

XVII.4. Hapja e temave dhe zbulimi i temave të reja . . . . . 267

XVII.5. Tekst i afërt me publicistikën . . . . . 268

XVII.6. Përfundime subjektive dhe konceptuale 269

XVII.7. Lidhja me emrin e autorit. . . . . 270

XVII.8. Çështje teknike 271

Më shumë se për çdo tekst tjetër gazetar, është shumë vështirë të argumentohet se kolumna është zhanër e jo rubrikë. Ajo ka qenë fillimisht vetëm rubrikë, mirëpo me kalimin e kohës ajo rubrikë ka marrë disa karakteristika të veçanta për të dhe kështu i është afruar zhanrit. Edhe sot mendimi nuk është i prerë: shumica e gazetarëve kolumnën e quajnë rubrikë. Por, a është vërtet ashtu?



i medies, prandaj ne nuk do ta ndjekim atë formë të kolumnës. Ne do të koncentrohemi në tiparet zhanrore të kolumnës.

### Cartas

Las cartas deben dirigirse a [cartas@pulsid.cl](mailto:cartas@pulsid.cl). El diario se reserva el derecho de seleccionar, extractar y titular los correos publicados.

#### Protocolo de acuerdo

Un protocolo de acuerdo suscrito entre algunos partidos de gobierno y de la oposición ha dado luz a una reforma de la reforma tributaria. Si bien algunos aspectos se mantienen, se han efectuado ciertas modificaciones que, según algunos analistas, mejoran el proyecto original. Otros han indicado que este sigue siendo malo, pero fue un poco mejorado. El economista John F. Due señala que "los tributos deben ser establecidos de forma tal que los costos efectivos de recaudación lleguen a un mínimo en función de los recursos para percibir los impuestos, así como también deben ser mínimos los inconvenientes directos causados a los contribuyentes por el pago de los impuestos".

Por su parte, en el libro "Tributación para el desarrollo" de Arellano y Corbo, se considera que una reforma del sistema tributario chileno debería considerar ciertos criterios, entre los que podemos destacar la simpleza, que debería velar por la equidad horizontal y vertical, y que -en la medida de lo posible- todas las fuentes de

ingreso deberían enfrentar la misma estructura tributaria. Queda la duda si la reforma tributaria cumple con los criterios antes señalados, porque al contribuyente se le dan opciones de elegir el sistema tributario (esto ya genera confusión), y una misma actividad y similares montos de rentas, pueden tributar de formas distintas. La cuestión será quién toma la decisión del sistema tributario al que se acogerá la empresa. Será motivo de discusión e incluso de posibles conflictos, puesto que los efectos de un sistema pueden favorecer a algunos socios o accionistas, pero no a todos. La coexistencia del sistema de rentas para pymes y el de rentas presuntas, tergiversa la equidad horizontal y vertical, incluso las diferencias de montos que se fijan en UF; para la presunción de rentas en las actividades de minería, transporte y agricultura, la tergiversación aún más. Tal vez "fue un mejoramiento del proyecto de ley", pero si bien la lectura del proyecto original no haría destacar nuestro sistema tributario en la simpleza, la reforma de la reforma lo aleja un poco de ese criterio.

Juan Cantillana  
Gerente  
Crowe Horwath

Reforma y convenio 169  
Señala el Convenio 169 de la OIT, en su artículo 6°, que se debe realizar el proceso de

#### Se Opina

● "Estamos a favor de la Integridad territorial de todos los estados, que es completamente distinto a que las regiones se vuelvan independientes y se organicen ellas".  
**Canciller alemana, Angela Merkel, sobre situación de Cataluña.**

● "Reafirmamos la certeza de los argumentos jurídicos e históricos con los que hemos llevado adelante la demanda y somos muy optimistas".  
**Álvaro García Linera, vicepresidente Bolivia.**

● "A largo plazo, la política monetaria ultraexpansiva plantea riesgos para la estabilidad financiera".  
**Jens Weidmann, presidente del Bundesbank.**

● "Yo pediría un período de silencio a los actores vinculados con esto. Creo que las declaraciones que hemos recibido estos últimos días han sido extraordinariamente desafortunadas [...] incluyendo al ministro".  
**Presidente del PS, Osvaldo Andrade, por reforma educacional.**

consulta cada vez que se prevean medidas legislativas o administrativas que puedan afectar a los pueblos originarios en forma directa. Dicha consulta debió haberse realizado en forma previa a la tramitación de la reforma educacional, respetando los principios de buena fe y mediante un procedimiento apropiado, tal como lo señala el actual reglamento de consulta.

La Presidenta Michelle Bachelet ha invocado la consulta indígena para excusarse del nulo avance de sus propuestas en esta materia, señalando que no enviaría el proyecto que crea el Ministerio de Asuntos Indígenas sin antes realizar la consulta indígena. No hay duda que la reforma de la educación es tanto o más importante que un Ministerio de Asuntos Indígenas, puesto que es la educación el factor que más influye en el desarrollo de los pueblos y que precisamente nos afecta en forma directa, sobre todo en cuanto a la preservación de nuestra cultura, lengua y cosmovisión. Así las cosas, no se ha visto un ánimo del gobierno de llamar a consulta a los pueblos originarios en este tema. Esto anula completamente el derecho de participación de los pueblos originarios. ¡Aún estamos a tiempo de corregir la situación!

Hans Curamil Antúñir  
Coordinador políticas públicas  
Fundación Chile Intercultural  
Temuco

Shembulli i një kolumnë në gazetë



Emërtimi i Kolumnës sipas kolonës, ashtu edhe siç faqoset në një gazetë



## XVII.2. PERSONALJA DHE PUBLIKJA (STATUSI I TEKSTIT DHE QËLLIMI PËRMBAJTJESOR)

Kolumna është një trajtim subjektiv (analizë subjektive apo personale) i temave, me qëllim për t'i bërë ato tema publike, për t'u dhënë rëndësi të madhe publike, apo për të tërhequr vëmendjen e opinionit publik apo të dikujt tjetër, apo për t'i stigmatizuar çështjet e caktuara. Nga ky përkufizim përgjithësues duhet të dallojmë dy karakteristikat më të rëndësishme të kolumnës: personalen dhe publikën.

Kolumna është tekst krejtësisht subjektiv dhe personal, pa një ligjësi shkrimi në rang rregullash, në të cilin autori trajton një apo më shumë se një temë, duke i analizuar ato dhe rrethanat e ndodhjes së tyre apo të rrjedhëve të tyre, jep përfundimet e tij për çështjen e trajtuar, por mund edhe të mos japë, përdorë një ligjërim akademik apo një ligjërim satirik, apo i pleksë që të dy këto ligjërime dhe, e gjithë kjo është përcaktim dhe stil shkrimi i vet autorit. Pikërisht kjo mungesë e rregullave e paragjykon karakteristikën e parë të kolumnës: shkrimi i saj i nënshtrohet bindjes, qëllimit dhe zotësisë shkruese të autorit, pra është shkrim krejt personal. Secili shkrim është prodhim subjektiv, por autori diku është më i kufizuar e diku më i lirë për të shprehur atë që analizon, interpreton, mendon dhe argumenton. Në këtë lloj, kjo liri është shumë e madhe: ai mund të fillojë shkrimin në mënyrat më paradoksale të mundshme, po edhe përfundimet mund të jenë paradoksale. Mund të përdorë stile të ndryshme ligjërime: mund të përdorë stilin ligjërimit gazetar, po aq sa edhe stilet ligjërimit letrar, shkencor, bisedor, të shkujesur etj. Fjala dhe fjalia në këtë lloj nuk lidhen domosdo me informatën, sikurse të shumica e llojeve të zhanrit analitik dhe informativ: fjala mund të ketë shumë kuptime, dhe ky është njëri qëllimi i saj, krahas informimit.

Ja se si Kim Mehmeti e fillon kolumnën e tij *Mjaft doktoruam, le të mësojmë pak!*:

Njeriu i paarsimuar sheh qartë dhe njih vetëm vetveten dhe gjerat rreth tij, gjysmë i arsimuari nuk e sheh vetëm atë që shikon por edhe hijet që i duken se ecin pranë tij, ndërsa i arsimuari i mirëfilltë nuk e lodh shikimin me gjërat që ka pranë vetes, por donë t'i sheh largësitë, jeton me bindjen se gjithmonë do mbetet vetëm një nxënës që duhet të mësojë. Por, mes këtyre tri kategorive, ekziston edhe një grup tjetër i të arsimuarve, një lloj i ri i tyre që e pollën dy dekadat e demokracisë, e numri i të cilëve u rrit në përmasa të turpshme mes shqiptarëve të Maqedonisë: shkencëtarët me tituj doktorësh e magistrash e që këto tituj i morën duke

Kolumna është një trajtim subjektiv (analizë subjektive apo personale) i temave, me qëllim për t'i bërë ato tema publike, për t'u dhënë rëndësi të madhe publike, apo për të tërhequr vëmendjen e opinionit publik apo të dikujt tjetër, apo për t'i stigmatizuar çështjet e caktuara.

Personalja dhe publikja.





Kim Mehmeti  
Një nga komentuesit e shpesh-  
shhtë shqiptar

mbrojtur temat shkencore në vendkalimin kufitar të Qafë - Thanës. Aty ku "mentorët" nga përtej kufirit ua sillnin diplomat, e kandidatët e tyre ua dorëzonin punimet shkencore të shkruar në bardhësitë e dhjetëra monedhave evropiane me ngjyrë të kuqe.

[www.kimmehmeti.com](http://www.kimmehmeti.com)

Kim Mehmeti bën një hyrje sentenciale në fjalinë e parë, ndërsa në fjalinë e dytë jep gjykimin e tij personal, me çka edhe e hap temën e trajtuar. Në të dy fjalitë, teksti është tejet personal. Në këtë tekst ka një informacion (shpërdorimi i titujve shkencorë nga "kandidatë" nga Maqedonia, të cilët blihen me para në vendkalimin kufitar të Qafë Thanës etj.), por ky informacion nuk është i tipit gazetar (si do të dukej ky informacion po të ishte lajm?). Ky informacion është i trajtuar vetëm si fakt publicistik.

Publikja është karakteristika e dytë e kolumnës, dhe kjo karakteristikë paraqet qëllimin përmbajtjesor të saj: teksti personal bëhet për një qëllim të gjerë publik, jo si çdo tekst tjetër gazetar që shërben për ta informuar publikun, por kolumna ka për qëllim imponimin në publik të temës së trajtuar, ose tërheqjen e vëmendjes së audiencave në temën e trajtuar, ose edhe rangimin e temës në prioritetet sociale apo politike. Kolumna nga ky aspekt është një bashkëbisedim i gjerë midis individit dhe audiencës. Audiencia dëgjon analizën personale të autorit dhe krijon opinionin e vet për atë analizë personale (varet a do të bindet apo jo?). Audiencia këtu nuk është një marrës pasiv, përkundrazi, ajo është aktive sepse kolumna tenton ta ndikojë opinionin saj dhe ta lëvizë në një drejtim ose, thjesht, ta mbushë me ide që ai vetë t'i artikulojë dhe të lëvizë. Kolumna është tekst konativ dhe audiencia ka një rol aktiv në këtë konativitet.

### XVII.3. KONSTATIME PERSONALE

Kolumna është, nga aspekti i trajtimit tematik, një konstatim apo varg konstatimesh të autorit, të cilat ai i argumenton sipas parametrave të tij, pa pasur nevojë t'i vërë në kandar me argumentet e të tjerëve. Këto konstatime janë a priori, pra nuk janë rrjedhojë e një analize paraprake. Natyrisht, autori argumenton këto konstatime, por ato i bën a posteriori. Ndryshe është në koment ku një konstatim është rezultat i një procesi të argumentimit e të analizimit. Kjo është karakteristika e tretë e kolumnës. Kështu, shohim në kolumnën e Shinasi Ramës, *Donkizhotizmi i rremë si zgjidhje politike*<sup>37</sup> një varg konstatimesh personale, të cilat ai i argumenton nga prizmi i tij dhe me parametra të tij. Ai e quan elitën politike donkizhotë dhe sançopanca dhe argumenton pse ata janë të tillë, por nuk lodhet se çfarë mendojnë të tjerët.



Shinasi Rama  
Një nga komentuesit e njohur  
shqiptar



Një ndër paradokset e spikatura të tranzicionit është se kur vjen puna tek objektivat politike, në sipërfaqe, paria e Tiranës është sjellë e po sillet si Don Kishoti, hidalgoja i rënë nga vakti i Servantesit. Në emër të një dashurie imagjinare për Dylqinjën e Tobozës, dhe duke ndjekur kodin kalorsiak, në dy udhëtimet e tij Don Kishoti bëri një numër veprimesh që i binin krejtësisht kundër realitetit e racionalitetit. Don Kishoti shihte atë që nuk ishte, mendonte atë që nuk duhej menduar, e përdorte si standard sjelljeje pikërisht atë që nuk i shërbente as atij e as njerëzve që ai kërkonte t'i ndihmonte. Mbrapa Don Kishotit shkonte Sanco Pança, katundari praktik të cilit Don Kishoti i kishte premtuar se do ta bënte sundimtar të një ishulli. Edhe pse Sanco Panca e shihte se Don Kishoti kishte lajthitur, shpresa se do të bëhej guvernator dhe i pasur e bënte t'i toleronte marrëzitë e hidalgos.

Nga ana e tij, Don Kishoti mendohej të ishte fisnik i vërtetë duke u sjellë si i tillë, në gjendje absurde. Ky është thelbi tragjik i bëmave të tij. Nga ana e vet, paria e Tiranës sillet si Don Kishoti, sepse është duke ndjekur një objektiv politik të paarritshëm. Mirëpo, ka një dallim thelbësor midis Don Kishotit dhe individit tipik pjesëtar të parisë së Tiranës. Dallimi është se paria e Tiranës po e ndjek objektivin e vetëcaktuar e të paarritshëm politik me ngulm e deri në absurditet, sepse ashtu i shërben asaj dhe çka është më keq, ajo i krijon vetë situatat absurde në të cilat i duhet mandej për të vepruar. Pra, Donkishotizmi i saj është një zgjidhje dinake politike. Ky është thelbi kriminal i sjelljes së saj. Donkishotizmi i parisë së Tiranës është i rremë. Don Kishoti duhet të na dhimbset, të ndiejmë keqardhje për të e t'i ofrojmë mbështetje. Parinë e Tiranës duhet ta urresh, ta kesh frikë, dhe të distancohesh sa më shumë prej saj.

Çka është edhe më keq, edhe Sançot tanë janë ndryshe prej prototipit të tyre. Sançot e shumtë, kalemxhinjtë, afaristët e shkruarit e panumërt që i shërbejnë parisë së Tiranës, si katundarët tanë praktikë ose individët me mendësinë e katundarit praktik, i shkojnë mbrapa parisë, sepse e dinë se është e vetmja mënyrë për të mbushur xhepat e tyre e për të mbijetuar në dekadencën e absurdit të Bllokut. Mirëpo, ndërsa presin që të mbërrijnë tek ishulli i tyre imagjinar, gjatë rrugës ato nuk lenë gjë pa bërë, pa vjedhur, pa shpifur e pa grabitur, dhe mbrapa vetes ato lenë një shkretëtirë të llahtarshme morale vlerash. Mendësia sunduese është mendësia e këtyre dallaverexhinjve që mendojnë vetëm e vetëm për kuletën e vet.

Paria e Tiranës po ndjek me insistencë objektivat e saj reale të mbështetura në interesat e saj të ngushta, dhe kështu e përforcon pushtetin e saj politik, ekonomik e mbi mendësinë e shoqërisë që krijohet nga shqytarët e saj të shumtë në të gjitha fushat. Me mjete të fuqishme në duart e saj, paria e Tiranës po e krijon realitetin ku ajo do të veprojë. Aty ku nuk

ka mullinjtë ere, ajo i ndërton vetë një herë mullinjtë e erës dhe mandej i sulmon ato. Të huajt e kanë kuptuar se ky është një teatër absurd, aq më keq sepse paria ia ka dalë që të bindë njerëzit se absurdi i jetës që ajo ka ndërtuar dhe që u ka servirur atyre është real.

Në udhëtimin e saj të parë, në emër të një dashurie imagjinare për sistemin e komunizmit, paria e atëhershme dhe e tashme sunduese si dhe Enver Hoxha, ndërtoi një shtet shumë të fortë, por thelbësisht terrorist. Shqiptarëve iu premtoi se do të hanin me lugë floriri dhe mandej e mbylli duke thënë 'bar hamë e parimet nuk i shkelim.' Mirëpo të gjithë kohën e mbajti pushtetin me dorë të hekurt dhe i bëri njerëzit të hanin edhe bar. Që të mos ta teprojmë, të themi se hanin byrek me hithra e shumica dërmuese, hanin bukë misri me ujë e sheqer. Në fund e gjetëm veten me një shoqëri të përçudnuar, të amoralizuar e të imoralizuar. Disa herët e disa më vonë, e kuptuan se e gjitha kishte qenë një mashtrim i paskrupullt. Në emër të komunizmit e të marksizëm-leninizmit, në atë vend u krijua një situatë absurde, imagjinare, e pajetueshme. Edhe ato që dënoheshin me vdekje linin si deklaratë të fundit, 'të rrojë socializmi shkencor'. Mirëpo nga kjo situatë absurde, të vetmit që dolën shëndoshë e mirë ishin pjesëtarët e parisë. Dhe jo vetëm aq. Tashmë ato ishin të transformuar në europianë soji e në kapitalistë me dije. Këtu fillon edhe udhëtimi i tyre i dytë me objektivin e ndërtimit të një shoqërie sërish absurde, por gjithnjë në shërbim të tyre. Ato donin të ndërtonin shoqërinë që u shërbente më mirë interesave të tyre. Këtu nisi edhe udhëtimi tjetër i saj me Sanço të tjerë e të transformuar. Në udhëtimin e saj të dytë, tash jemi në mes të rrugëtimit që për të nuk duhet të përfundojë ndonjëherë. Në emër të një dashurie imagjinare të shqiptarëve për kapitalizmin, për Europën, për europianizmin e shqiptarëve e me radhë, paria e Tiranës ka ndërtuar një shtet tejet të kriminalizuar dhe në thelb po aq terrorist sa edhe shteti i mëparshëm. Ndoshta ky është një shtet edhe më shumë se terrorist se këto të vrasin pa të prekur. Këto i lënë njerëzit të vdesin vetë, të vshken në mes të rrugës e të mjerimit, të vetëvaren në litar ose të pinë bar miu e në të njëjtën kohë merren me ditë të tëra me aventurat intime të një këngëtareje që vetëm për të kënduar nuk di. Mullinjtë e erës janë të panumërueshëm dhe historia shumë e pasur e Kryeministrit të tanishëm dhe mulliri i erës i radhës, 'qeveria e integritimit' ia kalon imagjinatës së Servantesit që kur erdhi në trojet tona u ndal, nga halli, deri në Ulqin. Edhe këto që iu premtuan shqiptarëve një herë 'çekun e bardhë', mandej 'integrimin euroatlantik,' diçka jo-ekzistente, e tani 'integrimin europian' e si po vjen puna, realisht po përfundojmë me 'integrimin post-otoman.' Edhe në këtë rrugëtim të radhës, paria e Tiranës ka hyrë e ka mbetur në rrugën e 'bar hamë e parimet nuk i shkelim'. Duke u mbështetur në anën më të ndyrë e më të kriminalizuar të

shoqërisë, para sunduese ka krijuar një situatë absurde ku diskursi politik, objektivat e shpallura, gjendja reale dhe sjellja e saj dhe e Sançove të saj janë krejtësisht të papajtueshme njëra me tjetrën. Përshtypja është krijuar se jemi duke hyrë në Europën e Bashkuar, në mos nga dera, nga dritarja, kontrabandë dhe se hyrja është iminente, kur para është e vetëdijshme, shumë e vetëdijshme, që ai objektiv është njëlloj si shkuarja në komunizëm. Shpresa se shteti shqiptar do të integrohet në Bashkimin Europian është një përrallë e pastër politike, demagogji e paskrupullt dhe një objektiv politik pa asnjë shpresë realizimi edhe për shumë, shumë kohë të mira. Po edhe pse gjërat duhet të lihen të ecin në rrjedhën e vet, gjithçka e ka një fund. Pyetja më e frikshme është se çka do të gjejmë në fund të këtij rrugëtimi, çfarë ndjesie përçudnimi kemi për të përjetuar, çfarë mangësie vlerash morale, njerëzore, e mendësie do të ketë ajo shoqëri që do çlodhet nga gërmadhat e radhës? Një gjë është e sigurt. Edhe pse Don Kishotët tanë do të treten në histori, mullinjtë e tyre të erës do të vazhdojnë të rrotullojnë mendjet e njerëzve.

Ky konstatim personal, apo varg konstatimesh, është thelbi i kolumnës. Ky fakt, më shumë se gjithçka e dallon atë nga komentit. Edhe në kolumnë ka një analize të temës, argumentim të tezave, sikurse në koment. Por, megjithatë, ajo mbisundohet prej konstatimeve a priori personale.

## **XVII.4. HAPJA E TEMAVE DHE ZBULIMI I TEMAVE TË REJA**

Në kolumnë është e rëndësishë parësore që autori të hapë tema të reja, të nxisë tema për diskutim publik, të hetojë detaje të rëndësishme që kanë rol të madh në shoqëri dhe ato detaje t'i trajtojë e t'i bëjë tema publike, apo edhe të marrë qëndrime ndaj temave aktuale që trajtohen në opinion publik. Kolumnistët zakonisht u ikin temave të mëdha publike (trajtimi, ta zëmë, i çështjeve diplomatike apo i interesave gjeostrategjike të një shteti) në favor të detajeve, në dukje të vogla, por që lidhen, asocionojnë apo rrjedhojnë në tema të mëdha. Kështu, një gabim i një diplomati, që është një detaj, mund të nxjerrë në diskutim parime dhe politika të larta për diplomacinë e një vendi. Hetimi dhe trajtimi i këtyre detajeve është mjeshtëria e madhe e kolumnistëve. Nëse një autor mund të nxisë debat publik për temat që trajton, atëherë ky është një tregues i suksesit të tij. Kolumnistët e mirë, poende, fillojnë tekstet e tyre prej gjërave të thjeshta, praktike, prej atyre që i vërejnë të gjithë, e për të përfunduar,

Nëse një autor mund të nxisë debat publik për temat që trajton, atëherë ky është një tregues i suksesit të tij.

si rrjedhojë, te temat e mëdha. Mund ta fillojë tekstin nga pluhuri në tavolinat e kafeneve në sheshet kryesore të Prishtinës:



Çdo mëngjes ulem ta pi kafën në njërin nga dhjetëra kafenetë e Sheshit Nëna Terezë. Dhe gjithmonë përsëritet e njëjta histori: robat më pluhurosën. Sa do kamerierët i fshijnë tavolinat para se të ulesh, përsëri do të bëhet pluhuri... Ai pluhur vjen prej rrugëve anësore. Në ato rrugë anësore, të pa shtruara, verës të mbytë pluhuri. Vetëm 15-20 metra larg sheshit kryesor të kryeqytetit të Kosovës. Ndërsa kryetari i Prishtinës çdo ditë bën deklarata për ecuritë e politikës së madhe të Kosovës ...

Ky tekst, shihet qartë, nuk do të flasë deri në fund për pluhurin e tavolinave, por për mosaftësinë e politikanëve për të qeverisur dhe ekzekutuar ligjet, e këtë mungesë mundohen ta fshehin pas frazave bombastike për politikën nacionale, interesat strategjike, strategjitë afatgjata e përralla të tilla. Hapja e temave të reja të vogla dhe bërja prej tyre tema të mëdha publike është një masë vlerësuese për kolumnistin: është i mirë ai që ka arritur të krijojë sa më shumë tema publike. Kjo është karakteristika e katërt e kolumnës. Edhe në rastet kur gazetarët trajtojnë tema të mëdha, kryesorja në to është përfundimi e jo vetë trajtimi i temës.

## XVII.5. TEKST I AFËRT ME PUBLICISTIKËN

Duke qenë autori i lirë në zgjedhjen e teknikës së shkrimit dhe të mjeteve shprehëse, kolumna në këtë pikë përkon me publicistikën: autori është i lirë të zgjedhë edhe tema që nuk përbëjnë një informatë, tema që mund të jenë të njohura në publik apo nuk kanë ndonjë rëndësi parësore për opinionin publik. Ai mund të përziejë stile të ndryshme e ligjërime të ndryshme. Ai ka një liri shkrimi të ngjashme me lirinë poetike. Kjo përmasë publicistike e kolumnës është karakteristika e pestë e saj. Por, kolumnistët e shfrytëzojnë këtë liri në masë, sepse qëllimi i tyre nuk është shkrimi i një eseje, ku mund t'i shfaqin deri në pafundësi mendimet e konceptet e tyre filozofike, sociale apo politike, po është një shkrimi i një teksti që duhet të komunikojë me audiencat dhe ato, audiencat, duhet të reagojnë ndaj tij. Në këtë rast, audiencia është kufiri ngushtues i kolumnistit: ai shkruan kolumnën që ta bindë audiencën për rëndësinë e një problemi.

Kolumna e ka edhe një pikë tjetër afrie me publicistikën: ligjërimin satirik. Edhe pse është lloj i gazetarisë analitike, autorët shpesh i shkruajnë tekstet e tyre në stilin ligjërimor satirik dhe,

Kolumna është e afërt me publicistikën: autori është i lirë të zgjedhë edhe tema që nuk përbëjnë një informatë, tema që mund të jenë të njohura në publik apo nuk kanë ndonjë rëndësi parësore për opinionin publik. Ai mund të përziejë stile të ndryshme e ligjërime të ndryshme. Ai ka një liri shkrimi të ngjashme me lirinë poetike.

duke përqeshur, banalizuar, ironizuar dhe shpërfytyruar një temë, një fenomen apo një individ, arrijnë ta japin gjykimin e vet. Kim Mehmeti që në shkrimin e temës e përdor një ironi paradoksale:



Dhe kështu, shqiptarët e Maqedonisë sot kanë aq shkencëtarë sa do mjaftonin për t'u kompletuar me kuadër arsimorë e shkencorë të gjitha institucionet shkencore e universitare të Ballkanit Perëndimorë.

Ose:

Shqiptarët e Maqedonisë sot kanë në çdo lagje nga dy-tre doktorë shkencash dhe nga dhjetëra magjistra, kështu që mbase ka ardhur koha që të fillojnë të mësojnë, ka ardhur koha që disa nga këta shkencëtarë t'u kthehen librave të shkollës së mesme sa të mos duket aq qartë se janë prodhim i "katedrave" të shitblerjes së diplomave në Qafë të Thanës, Bllacë e Deve-Bair.

Ka autorë që shkojnë edhe më larg në këtë shpërfytyrim, pra skajohen edhe më kah letërsia: shkruajnë kolumna me rimë, kryesisht me rima shpërfytyruese e ironizuese, si bën Behxhet Shala.

## XVII.6. PËRFUNDIME SUBJEKTIVE DHE KONCEPTUALE

Në kolumnë nuk kërkohet (as nuk ndalohet) që autori të japë përfundime, sugjerime apo qëndrime të veta. Edhe kjo është zgjedhje e autorit. Përvoja është e larmishme. Por, nëse i bën përfundimet, ai ka liri të interpretimit dhe të nxjerrjes së përfundimeve nga analiza e fakteve publike. Sikurse në koment, autori këtu shtron çështjen për diskutim, argumenton dhe kundërgargumenton, ngre tezat dhe kundërtezat, mirëpo interpretimi dhe përfundimet janë krejtësisht nga prizmi subjektiv. Përfundimet mund të mos jenë të argumentuara shkencërisht, por kjo nuk prish punë sepse ato duhet të jenë përfundime dhe qëndrime të autorit për temën e trajtuar. Pra, janë përfundime konceptuale, pjesë e vizionit të autorit.

Pse themi se nuk prish punë edhe nëse përfundimet nuk janë të argumentuara shkencërisht? Sepse qëllimi i kolumnës nuk është argumenti shkencor, por koncepti i autorit. Duke qenë se autorët janë emra me autoritet publik, publiku interesohet në veçanti për mendimet, për komentet, për konceptet dhe për analizat e tyre ndaj fakteve, proceseve dhe zhvillimeve të ndryshme sociale e politike. Prandaj kolumnisti as që interesohet se a janë të vërtetueshme apo

Përfundimet konceptuale kanë kuptimin e gjetjes së një rrugëdaljeje nga problemi i trajtuar, është një koncept i autorit se duhet parë temën e trajtuar.



jo përfundimet e tij: është e rëndësishme që përfundimet të jenë koherente në vetvete dhe një pikëshikim subjektiv (i ndryshëm nga publiku) për temën e trajtuar.

Kështu, përfundimet në kolumnën e cituar të Kim Mehmetit janë përgjithësisht stigmatizuese:



Nuk ka dyshim se shqiptarët e Maqedonisë mirë bëjnë që i përkushtohen shkollimit, që bëjnë çmos të kompensojnë të humburën. Por në ndërkohë, duhet ta kuptojnë se e humbura nuk kompensohet nëse nuk ke arsimim të shëndosh. Shqiptarët e Maqedonisë kanë nevojë për fakultete në çdo lagje të tyre, që të shërojnë varrën nga e kaluara socialiste, por jo institucione arsimore ku partitë i punësojnë të paafitit e tyre, jo institucione ku kryesuesit e partive i kontrollojnë universitetet nëpërmjet "komisarëve partiakë". Sepse nëse vazhdon ky proces, shqiptarët e Maqedonisë do bëhen populli i vetëm që do ketë më shumë doktorë shkencash e magjistra se sa të arsimuar me shkollim të mesëm.

Ky përfundim është koherent me temën e trajtuar (marrja e diplomave false nuk e ndihmon arsimimin, por e shtyn më tej analfabetizmin) dhe një pikëpamje subjektive të autorit (shqiptarëve në Maqedoni nuk u duhen doktorë të tillë).

## XVII.7. LIDHJA ME EMRIN E AUTORIT

Kolumna është mjaft e përhapur në gazetarinë moderne. Duke pasur një liri zgjedhjeje të temës, liri përdorimi të stileve ligjërimore dhe liri strukturimi të tekstit, krijohet përshtypja se mund të shkruhet lehtë. Por, nuk është ashtu. Shkrimi i saj lidhet zakonisht me emra të njohur të gazetarisë po edhe të jetës publike, politike e kulturore. Gjithmonë është më vështirë të shkruash kur ke mundësi të pakufishme të zgjedhjes së temës, të stileve ligjërimore e të strukturimit sesa kur ke të paracaktuar fushën e temave (si, p.sh., lajmet), stilin ligjërimit (p.sh. stil gazetari) dhe nëse ke të paracaktuar strukturën e ndërtimit të tekstit (p.sh. sipas modelit të piramidës së përmbysur). Është më vështirë për një fotograf të ri ta bëjë fotografi nëse redaktori i thotë "bëje sot një fotografi për numrin e nesërm", sesa kur i thotë "shko në Tregun e Gjellbër dhe bëje një fotografi nga aktivitetet tregtare". Në rastin e dytë gjërat mund të mësohen më lehtë, ndërsa në rastin e parë vetëm autorët që kanë përvojë të madhe dhe rezultate të mirënjohura mund t'ia dalin me sukses. Kjo ndodh edhe me kolumnën: shkruesit e tyre janë njerëz me autoritet në gazetari apo në një veprimtari publike, njerëz që kanë

Shkrimi i kolumnës lidhet zakonisht me emra të njohur të gazetarisë po edhe të jetës publike, politike e kulturore. Gazetat merren vesh me emrat e famshëm që të shkruajnë për to për ta rritur namin e gazetës. Në rastet kur arrihet ky pajtim, gazeta rezervon një hapësirë për kolumnën e personit të famshëm.

krijuar besim në opinionin publik me gjykimet e tyre për rrjedhat shoqërore, kulturore e politike. Ky autoritet i arritur më parë është garancia që një redaksi t'ia besojë dikujt shkrimin e kolumnës.

Duke qenë kolumna një dialog individi-audienca (publiku), këtë dialog nuk mund ta bëjë secili individ, as secili gazetar. Nuk mund t'i lejohet secilit individ apo gazetar që ta "bindë" publikun për rëndësinë e një teme, apo ta bindë për një qëndrim të tij për temën e trajtuar. Domsodo, kolumnisti, pavarësisht se si i trajton temat, vetë fakti se ai është kolumnist tregon për përvojën e tij të pasur. David Randalli e mbyll kapitullin "Gazetarët e kolonës" (ku mund të përfshihet edhe kolumna) me vetëm një fjali: "Cilido që ka arritur deri aty sa të marrë një kolonë, ose ai nuk ka nevojë për këshilla, ose ka një un (në mos e pastë do ta fitojë së shpejti) që nuk e lë të këshillohet".<sup>38</sup>

## XVII.8. ÇËSHTJE TEKNIKE

Nga ana teknike, redaksia ose botuesi bëjnë marrëveshje paraprake me autorë të caktuar për shkrimin e kolumneve. Zakonisht ajo botohet një herë në javë dhe botohet gjithmonë në të njëjtin vend, me të njëjtin tip shkronjash, në mënyrë që lexuesi të mësohet ku ta gjejë autorin e preferuar dhe shkrimin e tij. Por, ka raste kur ajo shkruhet edhe më shpesh apo edhe më rrallë. Zakonisht botimi i saj shoqërohet edhe me fotografinë e autorit dhe me emrin e tij të shkruar nën fotografi, ndërsa autorë të zhanreve të ndryshme, p.sh. satiriku turk Aziz Nesin në tekstet e tij satirike të përkthyer në shqip pati vënë në vend të fotografisë një karikaturë ku ai paraqitet me gjuhën kaktus. Kolumna ka mbititullin e përhershëm, i cili përsëritet në çdo tekst të ri të kolumnës, ndërsa vetë teksti ka një titull të vet. Mbititujt zakonisht janë subjektivë, ekstravagantë, paradoksalë, të atillë që e vejnë gjithnjë në dilemë lexuesin: çka fshihet pas këtij kuptimi?

Gjithë ky shabllonizim bëhet për një qëllim: lexuesi të lidhet sa më shumë me autorin e preferuar. Nëse ju keni në një gazetë, ditën e shtunë, në faqen tetë, në anën e majtë të faqes, dy shtylla të kolumnës së autorit X. Y., me një mbititull sfidues, e ilustruar edhe me fotografinë e autorit, dhe e gjithë kjo përsëritet një vjet, dy vjet e më shumë, ju tashmë e keni shtyrë audiencën që ta mësojë përmendësh këtë fakt, dhe nëse ajo e pëlqen atë autor, sapo ta blejë gazetën do të hapë te faqja tetë për ta parë imazhin që ua keni përcjellë me vite (në të kundërtën, e nëse nuk e pëlqen autorin, do të ngutet ta mbikalojë atë faqe, pa e hapur).



## XVIII. INTERVISTA

### XVIII.1. NOCIONI DHE QËLLIMI PËRMBAJTJESOR

**F**jala intervistë në shqip ka hyrë nga italishtja *intervista* - bashkëbisedim (angl.: *interview* - bisedë.), me rrënjë nga latinishtja. Intervista është një prej llojeve të gazetarisë analitike, e realizuar nga biseda që zhvillon gazetari (në rolin e pyetësit) dhe bashkëbiseduesi i tij, njeri i rëndësishëm apo i specializuar në një fushë të caktuar, apo një person tjetër (ai që jep përgjigjet, folësi). Qëllimi përmbajtjesor i saj është analitik dhe informativ: intervistat bëhen me ekspertë të ndryshëm për të ndriçuar më shumë, për të analizuar dhe kuptuar prapavijën e ngjarjeve lajmore, por edhe për të marrë informata nga persona të ndryshëm. Ka disa intervista që janë tërësisht informative: shërbejnë vetëm për të mbledhur dhe transmetuar informata. Megjithatë, shumica e tyre janë informacion plus analizë, pra zhanër analitik. I intervistuari është subjekti i intervistës, ndërsa gazetari është nxitësi i bisedës, ai që në një masë të madhe e orienton bisedën, ai që e di se cili është interesi i opinionit publik në çështjen e trajtuar dhe e orienton bisedën rreth atij interesi. Intervista nuk është thjesht një “bashkëbisedim” si dëgjohet shpesh. Gazetari e pyet të intervistuarin jo si partner në një debat, por si një i interesuar për të nxjerrë sa më shumë informacion prej tij në lidhje me çështjen e trajtuar.

*“Të pyesësh dikë si gazetar ka vetëm një qëllim: të mbledhësh informacion.”<sup>39</sup>*

Por, gazetari synon edhe më shumë se kaq në një intervistë. Përmes pyetjeve të tij dhe sidomos përmes përgjigjeve ai synon të rikrijojë në tërësi ngjarjen lajmore apo temën për të cilën flitet në intervistë. Intervista është një bashkëbisedim, por me bashkëbisedues jo të njëjtit qëllim: njëri ka për qëllim të nxjerrë informacione, tjetri ta bindë opinionin publik në ato që thotë. Qëllimi përmbajtjesor i intervistës është pikërisht kjo: një: informimi i plotë, i gjithanshëm dhe i drejtpërdrejtë i audiencës për ngjarjen lajmore apo temën e trajtuar nga ana e një pjesëmarrësi, i cili është vëzhgues apo njohës i mirë i temës së trajtuar; dhe, dy: analizimi, komentimi dhe shpjegimi i ngjarjes lajmore apo temave të trajtuara në bisedë. Si e tillë, intervista ka elemente të komentit e të analizës, vetëm se është e realizuar në dialog midis gazetarit dhe folësit. Gazetari pyet “në emër të lexuesit”.<sup>40</sup> Formalisht, ai bën pyetjet në emër të medias që përfaqëson, por përmbajtësisht ai pyet në emër

### PËRMBAJTJA

XVIII. Intervista . . . . .	273
XVIII.1. Nocioni dhe qëllimi përmbajtjesor . . . . .	273
XVIII.2. Tema . . . . .	274
XVIII.3. Struktura e intervistës . . . . .	275
XVIII.3.1. Hyrja . . . . .	275
XVIII.3.2. Pyetjet . . . . .	277
XVIII.3.3. Lloje të pyetjeve . . . . .	278
XVIII.4. Përmbyllja e intervistës . . . . .	284
XVIII.5. Lloje të intervistave . . . . .	285
XVIII.5.1. Llojet e intervistave sipas mënyrës së realizimit të tyre . . . . .	285
XVIII.5.2. Llojet e intervistave sipas qëllimit përmbajtjesor dhe qëllimit hulumtues . . . . .	289
XVIII.6. Përgatitja e gazetarit për intervistë . . . . .	298
XVIII.7. Tri parakushte për një intervistë të suksesshme . . . . .	299
XVIII.8. Autorizimi i tekstit . . . . .	299
Përfundim për intervistën . . . . .	300

Qëllimi përmbajtjesor i saj është analitik dhe informativ: intervistat bëhen me ekspertë të ndryshëm për të ndriçuar më shumë, për të analizuar dhe kuptuar prapavijën e ngjarjeve lajmore, por edhe për të marrë informata nga persona të ndryshëm.

Gazetari e pyet të intervistuarin jo si partner në një debat, por si një i interesuar për të nxjerrë sa më shumë informacion prej tij në lidhje me çështjen e trajtuar.

Gazetari pyet “në emër të lexuesit”

të interesit publik. Kësisoj, gazetari ndikon në krijimin e opinionit publik përmes përgjigjeve që merr nga i intervistuari. Prandaj ai duhet t'i formulojë pyetjet e atilla që të marrë përgjigje përkatëse, të cilat mund të ndikojnë në opinionin publik.

Ja se si gazetari Blendi Fevziu i shtron pyetjet dhe merr përgjigjet e shkrimtarit Ismail Kadare:



**Blendi Fevziu:** Çmimi Princi i Asturias me shume se te vlera e tij, apo tek prestigji, është edhe një porte shume e rëndësishme për te hyre ne letërsinë ose për t'u përkthyer ne boten ispanike. Sa prezent jeni ju ne këtë bote?

**Kadare:** Unë jam shume i botuar ne bote, prej gati 40 vitesh, qe ne fillim, pas Francës, kane qene disa shtete evropiane qe kane botuar veprën time. Spanja ka qene një nder te parat dhe me tej, ka botuar Gjermania, Anglia, SHBA, Spanja etj.

**Blendi Fevziu:** Si ka qene reagimi i kritikes dhe i publikut ne Spanje?

**Kadare:** Te them te drejtën nuk e kam ndjekur ne mënyrë te detajuar, ka qene përgjithësisht si kudo ne Evrope...

**Blendi Fevziu:** Shume e çuditshme, meqenëse ju me përmendet vendet te cilat botuan te parat, Franca, Gjermania, Anglisht, SHBA, Spanja, te gjitha vende qe ne fund te viteve '60, kur ju keni botuar ne perëndim, ishin vendet me armiqësore me Shqipërinë komuniste te asaj kohe...

**Kadare:** Po absolutisht po.

**Blendi Fevziu:** Nuk përbente një problem kjo për ju?

**Kadare:** Problem qe ende s'kuptohet nga një gjë unikale qe një shkrimtar nga vendi me i ashpër stalinist, komunist, deri ne Evrope si te thuash, reaksionare, tipike për mendimin tone, për mendësinë tone. Ne Evrope qe një përzgjedhje, Shqipëria ishte armike, s'kishte as marrëdhënie diplomatike, veç Francës.


(TV Klan, 29.10.2009, [www.tvklan.al](http://www.tvklan.al))

## XVIII.2. TEMA

Në intervistë mund të trajtohen të gjitha temat që janë preokupim i një shoqërie, por në veçanti trajtohen tema nga fusha të rëndësishme, si nga politika, nga qeverisja, nga ekonomia dhe biznesi, nga letërsia dhe artet etj. Me vetë faktin se gazeta është përcaktuar për një intervistë me një folës të caktuar për një temë të caktuar nënkuptohet se tema e zgjedhur për t'u biseduar duhet të ketë një rëndësi të madhe për shoqërinë.

## XVIII.3. STRUKTURA E INTERVISTËS

Intervista ka një strukturë të veçantë organizimi të bisedës: ka hyrjen (mbititulli, titulli, nëntitulli), pyetjet (bashkë me nënpyetjet, replikën dhe përgjigjet) dhe përmbylljen.



### XVIII.3.1. HYRJA

Jo të gjitha intervistat kanë hyrje të gjerë: mjaftohen vetëm me titull dhe fillojnë drejt me pyetje e përgjigje. Në disa të tjera praktikohet hyrja e plotë. Hyrja ka funksionin e ndërmjetësisimit midis intervistës dhe audiencës. Ajo është si një urë lidhëse: e përgatit audiencën se çka do të gjejë në intervistë. Prandaj ajo ka një rol të rëndësishëm, sepse në shumë raste audiencia e lexon vetëm këtë hyrje dhe në bazë të saj vendos se a do ta vazhdojë leximin e intervistës apo jo. Ajo duhet ta japë në formë të rezymuar, varësisht në cilin lloj përdoret, folësin, temën e diskutuar dhe rëndësinë që ka tema për marrësin.

Varësisht nga përmbajtja e hyrjes, dallohen katër lloje: hyrja portret, hyrja tematike, hyrja rezymuese dhe hyrja e kombinuar.

Hyry portret  
Hyry tematike  
Hyry rezymuese  
Hyry e kombinuar

**Hyry portret.** Është hyrje në të cilën gazetari ia paraqet publikut personin që do ta intervistojë, portretin e tij, të dhënat e rëndësishme biografike, me theks ato që lidhen me temën që do të trajtohet në intervistë, ose rezymon gjithë biografinë e tij në pak fjali. Ja një hyrje portret nga intervista me artistin Mirush Kabashi:



AlbaniaNews takoi Artistin e Merituar, Mirush Kabashi, i ftuar nderi i Festivalit të Kulturave në Ravena, në mbrëmjen e dedikuar Shqipërisë. Kabashi, aktor mjaft i njohur për publikun shqiptar, ka luajtur mbi 100 role në teatër e mbi 20 në filma. Gjatë vitet të fundit ka vënë në skenë dy monodrama "Apologjinë e vërtetë të Sokratit" dhe "Zoti Ibrahim dhe lulet

e Kuranit". E intervistuar për të na folur mbi motivet që e shtynë të zgjidhte këto dy vepra të letërsisë botërore, shoqërinë shqiptare dhe gjendjen e teatrit në Shqipëri.

**Alban Trunçu**

30 qershor 2009, <http://www.albanianews.it/>

**Hyrja tematike.** Është hyrje në të cilën gazetari nxjerr thekse nga ato që ka thënë folësi, nxjerr pjesët kryesore apo deklaratimet në çështjet kryesore.



### Ka dilema për komisionin "ad hoc"

Ish-anëtari i komisionit shtetëror për shënjimim e vijës kufitare me Malin e Zi, Ali Lajçi, ka thënë se themelimi i komisionit "ad hoc" të ekspertëve ndërkombëtarë, që do ta vlerësojnë procesin e demarkacionit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi, është dashur të ketë në përbërje edhe ekspertë vendorë.

<http://www.epokaere.com/sq/Intervista/Ka-dilema-për-komisionin-ad-hoc>

**Hyrja rezymuese.** Është hyrje në të cilën gazetari rezymon temën që do ta diskutojë me folësin, jep arsyen pse do ta diskutojë atë temë, rëndësinë e saj për opinionin publik, çka pret nga folësi.



### Bashkim Shehu në një rrëfim për letërsinë dhe burgun

Adoleshenca dhe kohët e rinisë kanë qenë ndoshta ndryshe për Bashkim Shehun. për vetë historinë e familjes së tij, ai pati mundësi të njihje nga afër "shkëlqimin" e bllokut komunist, dhe kohë më pas të shihte "fytyrën" tjetër të tij që ishin kohët e burgut

Gazeta Shqip, 7 Janar 2013

**Hyrja e kombinuar.** Është hyrje në të cilën gazetari kombinon tri format e mësipërme të hyrjeve: paraqet bashkëbiseduesin, përshkruan temën e bisedës dhe jep një theks nga biseda. Në intervistën e cituar të Blendi Fevziut në *TV Klan*, të botuar të nesërmen në *Koha jonë* (30.10.2009, [www.kohajone.com](http://www.kohajone.com)), gazetari përdor hyrjen e kombinuar:



Shkrimtari më i njohur shqiptar në vend dhe botë, rrëfëhet për herë të parë me detaje, për fillimin e viteve '90 kur vendosi të lërë Shqipërinë. Në intervistën ekskluzive dhënë gazetarit Blendi Fevziu në Paris, për emisionin "Opinion" të Tv Klan, Kadare detajon ditët që i paraprinë vendimit, hezitimet e mëvonshme dhe vendosmërinë për ta ndërmarrë hapin, vetëm pas kthimit nga SHBA te Ramiz Alisë dhe bllofin e tij atje. Tregon si u takua me Presidentin Bush, letra që i dërgoi dhe ndalet në diskutimet e shumta ndërkombëtare për vendin e shqiptonjave. Pse mendon se Shqipëria është populli kan-



didat në Evropë, për të zënë vendin e hebrenjve dhe nga vjen racizmi ndaj shqiptarëve. Kadare shpreh dhe mendimin për myslimanët shqiptarë dhe shpjegon pse ata janë korpus kryesor i shtetit shqiptar.

### XVIII.3.2. PYETJET

Pyetjet janë element qenësor i një interviste. Marrëdhënia pyetje-përgjigje nuk është mekanike (intervista në një rast të tillë do të ishte tejet e dobët!). **Intervista është më shumë se pyetje-përgjigje.** Kjo është aq thelbësore për intervistën, sa me këtë thënie autorët e librit *Manual për gazetarët e Europës Qendrore dhe Lindore* e kanë titulluar kapitullin për intervistën. Sado që folësi me përgjigjet e tij është subjekti i intervistës, megjithatë pyetjet ndikojnë thelbësisht në orientimin e intervistës e në një farë shkalle edhe në orientimin e përgjigjeve. Nëse folësi, p.sh., vëren se gazetari nuk është përgatitur dhe nuk e njeh temën për të cilën flasin, në shumicën e rasteve ai do të japë përgjigje sipërfaqësore, dhe e kundërta. Gazetari duhet t'i kushtojë kujdesin maksimal përgatitjes së pyetjeve, që ato të jenë thelbësore dhe ta përfshijnë gjithë temën e trajtuar. Por, sa do që të përgatitet gazetari, është vështirë që ai t'i shtrojë të gjitha pyetjet e tij, sipas renditjes së tij, në bisedë. Kjo për arsye se biseda, për dallim nga pyetjet e parapërgatitura, është e gjallë, dinamike, dhe nxjerr në sipërfaqe tema e motive të tjera, të cilat nënkuptojnë pyetje e nënpyetje të tjera.

Gazetari, pasi t'i ketë përgatitur pyetjet, duhet të përgatitet edhe për dy qasje të tjera. *Së pari*, të përgatitet apo të jetë i vëmendshëm për daljen në sipërfaqe të temave të reja, në mënyrë që të mos i lërë ato t'i ikin, por të bëjë ndonjë pyetje shtesë lidhur me to, duke u kujdesur që të mos e humbet fillin e temës së tij. *Së dyti*, gazetari nuk mundet dhe nuk duhet që gjatë intervistës t'i lexojë pyetjet e përgatitura më herët. Nëse gazetari u përmbahet në mënyrë të rreptë pyetjeve të shkruara, ato do të imponojnë përgjigje të shkëputura (të cilat nuk ndërliken mirë njëra me tjetrën) dhe do të rezultojë me diskontinuitetit të shqyrtimit të temës apo të temave të synuara prej tij dhe folësit. Gazetari mund të përgatisë disa pyetje të rëndësishme, për ta orientuar bisedën në kahen e dëshiruar, por në rrjedhën e bisedës ai duhet të jetë pjesëmarrës aktiv. Ai nuk duhet të harrojë për asnjë çast se nga pjesëmarrja e tij në bisedë varet në masë të madhe edhe cilësia e intervistës. Gazetari e orienton intervistën, prandaj pjesëmarrja e tij aktive në bisedë është parakusht për intervistë të suksesshme. Kjo dmth. se një pjesë e madhe e pyetjeve që ai i bën të intervistuarit duhet të jenë rrjedhojë e asaj që bisedohet aty.

Për gazetarin intervista është më shumë se pyetje-përgjigje.

Pyetjet duhen përgatitur para intervistës. Por, jini i kujdesshëm për tema të reja të cilat mund të dalin gjatë intervistës!

Intervista nuk është një bisedim mekanik, por një bashkëbisedim i gjallë. Poende, intervista nuk është një bisedë hetuesi, në të cilën gazetari pyet e i intervistuari përgjigjet. Intervista është bashkëbisedim intelektual i dy personave për një temë të caktuar, të cilët kanë për detyrë ta zbërthejnë temën e diskutuar për marrësin.<sup>41</sup> Gazetari e ka për detyrë ta nxisë të intervistuarin që të flasë sa më hapur dhe sa më qartë. Për ta mbërritur këtë, ai duhet të krijojë besim tek i intervistuari, besim për nivelin intelektual të shqyrtimit, përndryshe i intervistuari mbyllet në guaskën e tij dhe intervista dështon. E ky besim krijohet, parësisht nëse gazetari vetë bën pyetje thelbësore dhe inventive dhe e hap bisedën për shqyrtim.

### XVIII.3.3. LLOJE TË PYETJEVE

**Pyetje të hapura dhe pyetje të mbyllura.** Mencher dallon dy lloje të pyetjeve në një intervistë: *pyetje të hapura dhe pyetje të mbyllura*. Pyetjet e hapura janë ato pyetje që nuk kërkojnë një përgjigje të drejtpërdrejtë, konkrete dhe në lidhje shkakore me temën e trajtuar në intervistë. Pyetja e parë e një gazetari mund të jetë krejt e parëndësishme për temën e tij (*ç'ju ka shtyrë të merreni aktivisht me politikë?* mund ta pyesni një ministër, të cilin keni shkuar ta intervistoni për një projekt të caktuar), mirëpo ato praktikohen për ta çliruar folësin prej shtrëngesave të ndryshme dhe ta përgatisë për bisedë. Mund të ndodhë që krejt intervista të bëhet me pyetje të hapura, në stilin: *çfarë mendoni ju për rrjedhat e përgjithshme politike në vend? Çfarë mendimi keni për nismën e re të aksh organizate...?* Zakonisht, intervista vetëm me pyetje të hapura nuk praktikohet shumë sepse shndërrohet në intervistë afirmative, në mos në marketing për të intervistuarin.

Ja pjesë të një interviste me pyetje të hapura me këngëtareng Ingrid Gjoni:

#### **Si nis një ditë për Ingrid Gjonin?**

Një ditë e imja nuk është e njëjtë me ditët e tjera, pasi unë vetë nuk kam një punë stabël. Çdo ditë është e ndryshme dhe e larmishme, por unë mundohem vazhdimisht që në ditët që nuk kam shumë impenjime të krijoj mundësi për takime pune apo për çaste dëfrimi.

#### **Meqenëse jemi në prag të fillimit të sezonit veror 2009, cilat janë surprizat që keni rezervuar për publikun?**

Surpriza e parë do të jetë gjatë natës finale të TOP Fest 6 më datë 10 maj, ndërsa më vonë unë do të dal me një videoklip të ri, i cili do të bëjë bujë.

Pyetje e hapur: Cilat janë sukseset tuaja?



### Meqenëse jemi dhe në çelje të fushatës elektorale, për kë parti do të këndonin më shumë?

Unë do të këndoj më shumë për atë parti që do të më ofrojë më shumë të ardhura.

[www.celebritete.com](http://www.celebritete.com)

Pyetjet e mbyllura janë ato pyetje që nuk lënë shteg për çfarëdo përgjigje, por kërkojnë përgjigje konkrete, e duke qenë se gazetari nuk do çfarëdo përgjigje, por përgjigje konkrete, atëherë këto pyetje janë pyetjet e vërteta. P.sh.: **Pse nuk e biseduat në takim edhe çështjen e Hidrocentralit të Zhurit?** është një pyetje që kërkon përgjigje konkrete. Pyetjet e mbyllura zakonisht nuk bëhen në fillim të intervistës, përjashtimisht kur gazetari ka marrëdhënie miqësore me folësin, apo kur folësi është person i rëndësishëm së lartë publike (president, kryeministër etj.) dhe gazetari nuk ka në dispozicion shumë kohë për manovrim.

**Pyetjet aktive dhe pyetjet pasive.** Pyetjet aktive janë pyetje që nisin tema, probleme, ide dhe e shtyjnë folësin drejt tyre. Këto janë pyetje të mbarsura me përplot informacione, që bartin më vete një sfond të gjerë informatash, rrethanash e njerëzish. Zakonisht këto pyetje fillojnë me pjesët pyetëse *pse?* *si?* dhe *qysh?* Këto pyetje nxisin bisedën, nxisin debat, e ky është qëllimi i çdo gazetari në intervistë.

Pyetjet pasive janë ndryshe, ato bëhen vetëm sa për t'i mundësuar folësit të japë një përgjigje. Zakonisht fillojnë me pjesët pyetëse *çka?*, *sa?*, *kur?* dhe *kush?* Si shihet, pjesët pyetëse nuk përmbajnë në vete ndonjë premtim për përgjigje inventive e interesante, për përgjigje të gjalla që mund të jenë të mbushulluara me informacione, me ide e me tema të reja. Në secilën prej tri pyetjeve, folësi mund të japë vetëm nga një përgjigje të shkurtër. Përgjigjet në këto pyetje zakonisht përfundojnë me vetë përgjigjen, pra nuk mbajnë në vete asgjë më shumë.

Një intervistë e bërë vetëm me pyetje pasive (pyetje që kërkojnë vetëm informacion dhe përgjigje që japin ose mohojnë informacion) zakonisht nuk mund të jetë e suksesshme, përveç kur është intervistë kundërshtuese. Arsyeja e mospjesëmë qëndron te mungesa e analizës apo komenteve të folësit: nëse gazetari bën pyetje pasive (*çka?*, *kur?* dhe *kush?*) dhe folësi jep përgjigje pasive, dhe intervista do të dukej përafërsisht kështu:

- *Çka ndodhi dje?*
- U mbajt takimi.
- *Kur?*
- Në ora 10.
- *Kush morri pjesë?*
- Ishin të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Pyetje e mbyllur: Cilat projekte kapitale i keni financuar vitin e kaluar?

**Pyetjet aktive:** Pse? Si? Qysh?  
**Pyetjet pasive:** Çka? Sa?  
Kur? Kush?

Ja një pjesë e intervistës së revistës *Shqip* me pjesëtarin e estradës e të kulturës italiane, shqiptarin Ilir Shaqiri:



**Shqip: Vini shpesh në Shqipëri?**

**Ilir Shaqiri:** Në Shqipëri do kthehesha edhe çdo muaj po të kisha mundësi, por realisht kam shumë punë dhe nuk vij edhe aq shpesh. Janë bërë dy vjet pa ardhur. Më mungon pa masë Shqipëria. Më mungojnë miqtë që kam aty, njerëzit, dashuria e tyre. Jo se nuk e kam dashurinë e njerëzve këtu, por unë jam shqiptar dhe më mungon vendi im. Në fakt sa herë që kthehen nga Shqipëria miqtë e mi, Klejdi, Ambeta, Oni, i them "hajdeni e më tregoni". Mblidhemi në shtëpinë time dhe i pyes se "si ishte në Tiranë, çfarë ndodhte në Shqipëri, çfarë kanë bërë, kë kanë takuar, etj, etj..." Ata nga ana e tyre më ftojnë sa herë të vij me ta: "Hajde, më thonë, se është shumë bukur, hajde se kalohet mirë, do kënaqemi, etj". Unë e di se në Shqipëri kalohet shumë mirë dhe ajo më mungon, por vërtet që kemi pasur shumë angazhime, pastaj Emily është e vogël, vetëm katër vjeç dhe nuk dua që ajo të lodhet nga udhëtimi i gjatë dhe qëndrimi larg shtëpisë. Familja ime, prindërit e mi jetojnë në një provincë afër Romës dhe unë nëse vij në Shqipëri, vij për të takuar miqtë dhe të afërmit e tjerë. Më mungon Shqipëria dhe uroj të vij sa më shpejt.

**Shqip: Përveç baletit që e keni pasion dhe profesion, çfarë gjëje tjetër ju tërheq?**

**Ilir Shaqiri:** Hobi im është peshkimi, mikrob i vjetër ky që kam dhuratë nga im atë. Sa herë që vij në Shqipëri, menjëherë udhëtoj drejt luginës së Divjakës, Patokut, ose në Shëngjin, Velipojë, Porto Palermo... Nuk kam lënë pëllëmbë të bregdetit të Shqipërisë pa shkelur... Mblidhemi me një grup miqsh dhe shkojmë të peshkojmë. Shkojmë në Divjakë, tek një vend ku shkonte gjithmonë i madhi Kadri Roshi dhe kjo gjë më emocionon shumë.

**Shqip: Si është një ditë pushimi për ju?**

**Ilir Shaqiri:** Gjithmonë është një pushim aktiv dhe jo pasiv. Luaj me Emily, sistemoj bahçen që kam para shtëpisë, shkoj për peshkim, shkruaj ndonjë gjë për shfaqjet që përgatisim në shkollë. Mund të bëj gjëra nga më të ndryshmet. Asnjëherë nuk më pëlqen të zë cepin e divanit dhe të fle meqë jam pushim...

([www.shqipal.com](http://www.shqipal.com))

Pyetjet pasive kanë një rol të madh në një rrethanë tjetër në intervistë. Ato shërbejnë shumë mirë për t'i mbushur zbrazëtirat që krijohen gjatë intervistës në përgjigjet e folësit. Folësi, gjatë përgjigjeve të tij, harron ndonjë detaj, nuk e thekson ndonjë çështje të cilën e ka pyetur gazetari, apo është i pavëmendshëm në ndonjë detaj, nuk përmend ndonjë datë a vend duke besuar se është e vetëkuptueshme, ose në ndonjë mënyrë tjetër krijon ndonjë zbrazëti, atëherë gazetari

ndërhyn me pyetje pasive, p.sh. kur ka ndodhur kjo?; ku ka ndodhur kjo?; çka është kjo që po e përmendni? etj.

**Pyetje paragjyquese (nxitëse).** Një lloj tjetër i pyetjeve, që janë mjaft shtytëse, janë pyetjet paragjyquese, ose sikur paragjyquese. Gazetari me këtë pyetje bëhet sikur po merr një qëndrim dhe e pyet bashkëfolësin se a mendon edhe ai ashtu? Gazetarja Anila Basha e gazetës Intervista, kështu e pyet ish-kryeministrin e Shqipërisë, z. Aleksandër Meksin:

Pyetje paragjyquese (nxitëse):  
A nuk mendoni se qeveria ka humbur mbështetjen?

**Intervista:** A nuk mendoni se në këto pesë vjet humbjet ishin më të mëdha se sukseset?

**Meksi:** Po si ke humbur? Si humbe më shumë se sa kishe? Madje nuk ke dalë as zero, sepse vishesh e ha më mirë se vite më parë. Ka edhe shumë që kanë dalë të fituar.<sup>42</sup>



Jo gjithmonë pyetjet paragjyquese sjellin përgjigje të dëshiruara:

**Independent:** Ju mendoni se janë krijuar dy struktura paralele?

**Meksi:** Unë them se nuk ka asnjë strukturë.

(Intervistë e Blendi Fevziut me Aleksandër Meksin,  
Gazeta Independent, 10 maj 1997).



**Pyetje hipotetike.** Pyetjet hipotetike janë shumë të dashura për gazetarët. Ata i përdorin shpesh, edhe pse në dukje ato janë jo shumë bindëse. Nëse gazetari i thotë një pretendenti për ministër: le të supozojmë se do të bëheni ministër i Arsimin, çfarë do të bëni në vitin e parë të qeverisjes?, kjo vërtet duket jobindëse (po i jep hapësirë folësit të flasë për gjërat që nuk kanë ndodhur, mbase edhe nuk mund të ndodhin!), mirëpo kjo vetëm në shikim të parë. Nëse këto pyetje përdoren në vendin e duhur dhe ndaj personit të duhur, ato mund të rezultojnë të suksesshme, së paku në dy drejtime. Së pari, folësi nga pozita e tillë flet më sh lirë (ai po flet sikur të ishte ministër, por ai nuk është ministër!) dhe më shpengueshëm, e kjo mund të sjellë informacionin e dëshirueshëm. Së dyti, pyetja e tillë është nxitëse në vetvete, e bën të flasë më shumë folësin. Gazetarja e sipërpërmendur vazhdon ta pyesë Aleksandër Meksin me një pyetje të tillë hipotetike:

**Intervista:** Nëse do ta kishit edhe një herë karrigen e kryeministrit, çdo të bënit më tepër?

**Nënpyetjet dhe replika.** Nuk ndodh gjithmonë (madje rrallëherë ndodh) që folësi ta japë përgjigjen e plotë në një pyetje të gazetarit. Nuk është e udhës që gazetari t'i thotë folësit "keni harruar pa u përgjigjur në këtë pjesë të pyetjes". Në raste të tilla duhet bërë nënpyetje. Ajo bëhet ose për ta rikujtuar folësin se ka harruar pa u përgjigjur në tërë pyetjen,



ose kur folësi i ka ikur përgjigjes së plotë, ose kur folësi ka përmendur një fakt apo një informacion të ri dhe gazetari dëshiron ta dijë për çka është fjala. Në të gjitha rastet nënpyetja duhet të formulohet ashtu që të duket se është pyetje e re e jo përsëritje e pyetjes së mëparshme.

Replika është një mjet ndihmës për intervistën, në mënyrë që një ide apo një fakt i trajtuar gjatë bisedës të theksohet edhe më shumë. Gazetari ka të drejtën ta pyesë të intervistuarin me theks të veçantë, me theks kundërshtues për një çështje të biseduar. Gazetari nuk e bën këtë replikë për ta kundërshtuar paraqitjen e të intervistuarit, por vetëm sa për ta nxitur që ai edhe një herë ta theksojë mendimin e tij për çështjen në fjalë. Përndryshe gazetari nuk duhet të marrë një anë, i nxitur nga mendimet e tij, të folësit apo të një rrethi tjetër, qoftë politik, ekonomik apo tjetër. Audiencia interesohet për mendimet e të intervistuarit, ndërsa nga gazetari pret shkathësinë për ta futur të intervistuarin nëpër dyert e përgjigjeve sa më qartë e sa më hapur.

Janë disa forma pyetjesh të cilave gazetari duhet t'u shmanget shumë. Disa prej tyre do t'i trajtojmë edhe këtu.

**Pyetjet e gjata**, të cilat janë më shumë se pyetje, në kuptimin që janë komente të gazetarit, nuk sigurojnë intervistë të suksesshme.

*"Gazetaria nuk njeh asnjë shembull ku të ashtuqajturat pyetje me marifet ose të zgjatura të kenë dhënë rezultat."*<sup>43</sup>

Asnjëherë nuk duhet harruar faktin se gazetari është nxitësi i bisedës dhe nuk është i thirrur të komentojë përpara folësit. Po ashtu, folësi është i zgjedhur, është ekspert në fushën për të cilën flet, gjë që nuk mund të thuhet për gazetarin dhe, në çastin kur gazetari bën pyetje të gjata me komente, ai ia jep folësit mundësinë që t'i vërejë gabimet e gazetarit në komente. Dhe së treti, nëse e keni ftuar në intervistë folësin që të komentojë, mos komentoni ju, lëreni atë të komentojë.

Ja një pyetje e gjatë dhe, natyrisht, një përgjigje e shkurtër:

**Blendi Fevziu:** Të rikthehem edhe një herë në një pikë shumë interesante. Do të doja të kthehesha tek Princi i Asturias, por po e kaloj në kohë. Meqenëse folëm për mënyrën se si ju erdhët dhe u botuat fillimisht në Francë, dhe me pas se si filloi një karrierë e juaja në perëndim, pasi nisi nga Franca. Sot jemi pothuajse katër-pesë ditë nga 19 vjetori i largimit tuaj nga Shqipëria dhe vendosjes në Paris. Një veprim i cili radikalizoi krejtësisht lëvizjet në Shqipëri dhe dërgoi pastaj në lëvizjet e dhjetorit, dhe ndryshimin e sistemit në Shqipëri. Si e morët vendimin për të qëndruar në Francë, në tetor të vitit 1990?

**Kadare:** Nuk ka qene i menjëhershëm. Ishte më i gjati i shtrirë në kohë. Vendimi ishte marrë në fillim të vitit 1990. Unë kam pasur një korrespondencë me Ramiz Alinë, e cila është botuar. Atje duket krejt qartë...



**Pyetjet retorike** janë pyetjet të cilave gazetari duhet t'u ruhet edhe më shumë. Këto janë pyetje të cilat nënkuptojnë apo sugjestojnë përgjigjen. Nocioni është marrë prej figurave letrare: pyetja retorike është një pyetje në të cilën rri përgjigjja (Pse mba mëri? S'e mar dot vesh,/ Përse s'më flet si njëherë? (Naim Frashëri). Në gazetari pyetja retorike mund të mos e ketë përgjigjen brenda, por ta sugjerojë fuqishëm. Efekti i saj është negativ sepse nuk merr një përgjigje të mirë prej folësit (mund të merrni përgjigjen e dëshiruar ose jo, por jo atë të duhurën) dhe mund të krijojë një ndarje midis gazetarit dhe folësit (ai mund të mendojë se gazetari po përgatit një të papritur derisa po insiston ta ketë përgjigjen sipas masës së tij!).

Kështu, gazetari i revistës Klan i bën pyetje retorike rektorit të Universitetit të Tiranës, z. Shezai Rrokaj:



**Klan:** A keni ndonjë pakënaqësi ndaj shtetit dhe qeverive, si Rektor i UT?

**z. Rrokaj:** Shteti duhet të ketë parasysh këtë gjë: Të mos hapë Universitete kur bëhet fjalë për fushatë elektorale. Të mos risë numrin e pranimeve sa herë që vihet përballë një kolapsi social, pa menduar për të shtuar as pedagogë dhe as godina. Shteti duhet ta konsiderojë universitetin si partner dhe jo vasal të tij. Në asnjë qeveri nuk duhet të ndodhë kjo. Universitetet janë identiteti i kombit. Qeveritë të mos presin se universitetet do t'i lehdatojnë. Është e pamundur! Politika duhet të mësojë shumë nga universitetet dhe duhet të mbështetet shumë tek ato. Nuk mund ta bëjnë strategjinë e zhvillimit të këtij vendi, cilado lloj politike qoftë ajo, me çfarëdo lloj donacionesh, pa u mbështetur tek truri i këtij vendi.

**Klan:** Megjithatë, edhe universitetet duhet të kenë fajet e tyre në këtë mes...

**Rrokaj:** Sigurisht që edhe universiteti ka fajet e tij. Çfarë fajesh ka? Është shumë i mbyllur. Ka shumë ujëra, ka një informacion të tepërt dhe jo selektiv. Nuk ka komunikim, nuk ka kërkim, por ka vetëm mekanizëm, përsëritje, lodhje. Nuk është një universitet i integruar në shoqëri. Pra, është i mbyllur brenda një akademizmi gati shterpë. Duhet të integrohet në sfidat që ka ky vend, në zhvillimin e rajonit. Nuk mjafton që qeveria të kujtohet që të na integrojë. Duhet të jemi ne ngacmues për t'u integruar. Kjo është sfida jonë. Nuk e kemi ende! (...)

**Klan:** Mendoni se qeveria ose ministria e Arsimit do të reagojë pas kësaj proteste?

**Rrokaj:** Jam fort i bindur se qeveria do të reagojë ndaj protestës tone. Dhe shpresoj të jetë kështu sepse ka ardhur koha që ne të marrim në dorë, me atë idealizmin tonë që na ka karakterizuar, pronën publike.

([www.revistaklan.com](http://www.revistaklan.com))



E vetmja pyetje të cilën gazetari nuk duhet ta bëjë kurrë- është pyetja e keqe! Ja një e tillë për presidentin e Republikës, z. Hashim Thaçi:

Zoti Thaçi, zgjedhja juaj në postin e presidentit të ri të Kosovës, ishte në fakt një kronikë e paralajmëruar nga Ju. Ju uroj dhe dëshiroj mbarësi në të gjithë punën tuaj te mëtejshme. Por, ndërsa jo të paktë ishin ata që besonin se do të kishte një përfundim të tillë, ju ishit i qetë dhe kurajoz. Edhe në sallën e parlamentit ishit nga të paktët që ruajtët qetësinë dhe sigurinë. Në të vërtetë, për ata që ju kanë njohur prej vitesh, kjo është një karakteristikë juaja. Por, për tej saj, njerëzit duan të dinë se ku mbështetej qetësia juaj?

<http://www.gazetadita.al/ekskluzive-hashim-thaci-presidenca-ime/>

Gazetarja e pyet deputeten e Parlamentit Evropian e cila vëzhgoi zgjedhjet lokale në Kosovë më 15 nëntor 2009:

**Kosova sot:** Po populli i Kosovës, si ju duk?  
**Doris Pak:** Ah, populli...populli ishte i lumtur, doli në numër të madh në votime...

(Kosova sot, 17 nëntor 2009)



Nuk mund të pritej, pothuajse në asnjë rrethanë, që deputetja evropiane Pak të shprehte ndonjë mendim tjetër për popullin e Kosovës.

**Pyetjet klishe** janë pyetje të cilat praktikohen në çfarëdo situatë. Nëse e pyetni një këngëtare të re që sapo ka fituar vendin e parë në një koncert "a keni emocione?", në asnjë rast nuk do të merrni ndonjë përgjigje përmbajtjesore.

*"Ta pyesësh dikë që sapo ka përjetuar një fatkeqësi të madhe 'Si ndihesh?', kjo do të thotë të provokosh, në rastin më të mirë, një përgjigje klishe ose një refuzim të prerë për t'u përgjigjur pyetjeve të tjera. E si mund të ndihet njeriu që sapo ka humbur birin e vetëm në një aksident ajror? I drithëruar?"<sup>44</sup>*

Pyetja e fundit që duhet ta shmangë gazetari, për aq sa të jetë e mundur, është **pyetja në të cilën përgjigjja është me "po" e "jo"**. Kjo pyetja e fundit mund të bëhet vetëm në rast se gazetari dëshiron një pohim të qartë ose një mohim të qartë të folësit.

Një çështje e pa zgjidhur e pyetjeve në intervistë është komentimi në pyetje nga ana e gazetarit. A mundet gazetari të japë komentet e veta në pyetje? Në parim jo, sepse gazetari është pjesë e intervistës vetëm për të pyetur e jo për të komentuar. Por, në disa raste, kur pyetja ka nevojë të formulohet më mirë, gazetari mund të bëjë komente. Mirëpo, në asnjë rast vetëm sa për të dhënë mendime e tij.

## XVIII.4. PËRMBYLLJA E INTERVISTËS

Përfundimi i intervistës është një pjesë e rëndësishme e strukturës së saj ndërtimore. Ajo duhet të përfundojë me një mendim thelbësor për temën e trajtuar. Përfundimi duhet të tingëllojë si vula apo si nënshkrimi i një dokumenti, si kryemesazhi i një komenti. Përfundimi aq sa është aftësi e të intervistuarit, po aq është edhe aftësi e gazetarit. Fundja, bisedën nuk e përmbyllë i intervistuari, por gazetari që e ka të drejtën e caktimit të kohës së kur duhet të përmbyllet intervista. Pra, gazetari pret çastin kur i intervistuari thotë një mendim thelbësor, ose e shtyn të intervistuarin drejt një deklarimi të tillë dhe, në atë çast e përmbyllë intervistën. Përfundimi i interv-

Pyetja në të cilën përgjigjja është me "po" e "jo": këto pyetje janë kuptimplota vetëm kur ju duhet një pohim a mohim i prerë i të intervistuarit. Në rastet e tjera, më mirë të mos bëhen.

istës nuk mund të jetë një marrëveshje e dy bashkëbiseduesve, në kuptimin: "hajt, po e përfundojmë tash bisedën". Nëse përfundimi është i rëndësishëm, ai mund të mbahet më shumë në mend nga marrësi se sa tërë intervista. Prandaj gazetarët e mirë, më shumë se për fillimin, e lodhin mendjen e tyre për përfundimin e intervistës.

## XVIII.5. LLOJE TË INTERVISTAVE

Ka disa lloje të intervistave dhe disa mënyra të klasifikimit, varësisht prej kriterit bazik që përdoret për klasifikim. Kështu, sipas mënyrës si realizohet intervista, dallojmë: intervista e drejtpërdrejtë, intervista e përfolur, intervista e tërthortë, intervista e shkurtër dhe format e veçanta të intervistës në tryezë dhe dialogu sokratian. Sipas përmbajtjes dhe qëllimit hulumtues që ka, dallojmë: intervista informative (intervista e lajmit), intervista portret, intervista afirmative, intervista analitike, intervista polemizuese dhe intervista emocionale. Do t'i trajtojmë shkurtimisht këto lloje të intervistave, pavarësisht prej faktit se, sikurse për lajmin, ka dallime midis intervistës së printuar dhe asaj të shikuar, mirëpo dallimi i fundit është dallim empirik e jo zhanror. Do ta trajtojmë edhe anketën, si një lloj të intervistës së gjerë, e cila rrjedh nga anketa si metodë hulumtuese, por që dallon në disa elemente qenësore nga ajo.

### XVIII.5.1. LLOJET E INTERVISTAVE SIPAS MËNYRËS SË REALIZIMIT TË TYRE

**Intervista e drejtpërdrejtë.** Prej natyrës së saj intervista është një bashkëbisedim i drejtpërdrejtë i dy e më shumë personave. Ky bashkëbisedim nuk është i balancuar, sepse në njërën anë janë pyetjet (nënpyetjet, replikat), në anën tjetër janë përgjigjet. Përgjigjet janë subjekti i intervistës. Një pyetje ka një përgjigje. Edhe në publikimin e saj intervista ka pyetje e përgjigje. Kjo bisedë përbën intervistën e drejtpërdrejtë. Transmetimi në radio apo në televizion i një bisede të drejtpërdrejtë (live) është intervistë e drejtpërdrejtë. Është lloji më i vështirë i intervistës, sidomos kur është e drejtpërdrejtë, sepse aty mundësitë e improvizimit janë shumë të vogla, për gazetarin dhe për folësin. Prandaj për një intervistë të drejtpërdrejtë duhet përgatitje më e madhe. Kur intervista e drejtpërdrejtë bëhet për gazetë, ajo duhet të incizohet në kasetofon apo me mjete të tjera teknike dhe pastaj të bartet originalisht në letër. Në rast se gazetari

Intervistat klasifikohen sipas dy parimeve:

1. Llojet e intervistave sipas mënyrës së realizimit të tyre;
2. Llojet e intervistave sipas përmbajtjes dhe qëllimit hulumtues (qëllimit përmbajtjesor).

Llojet e intervistave sipas mënyrës së realizimit të tyre:

- Intervista e drejtpërdrejtë
- Intervista e përfolur
- Intervista e tërthortë (jo e drejtpërdrejtë).
- Intervista e shkurtër
- Dialogu sokratian
- Intervista e tipit "tryezë e rumbullakët".

bën seleksionim të asaj çfarë ka thënë folësi, ai duhet të merret vesh me folësin paraprakisht.

**Intervista e përfolur.** Pasi bëhet biseda me folësin, ajo bisedë nuk transmetohet drejtpërdrejt në formë pyetje-përgjigje, por përfillet prej gazetarit. Vende-vende gazetari komenton rrethanat, në pjesën më të madhe komenton thëniet e folësit, në një pjesë jep edhe citate të folësit. Kjo është intervista e përfolur. Gazetari në këtë lloj merr një rol më të madh ndaj folësit, në krahasim me intervistën e drejtpërdrejtë. Ai duhet të ketë kujdes se çka do të zgjedhë nga ato që ka folur folësi, sepse ai nuk do të botojë gjithë atë që folësi ka thënë (kjo është arsyeja pse ai shkruan intervistë të përfolur e jo të drejtpërdrejtë). Po ashtu, ai duhet të ketë kujdes se çfarë do të shtojë vetë në tekstin e intervistës (hyrja, hapjen e temave, fjalitë e ndërmjetme dhe ato ndërlidhëse - ato që lidhin motivet e temat e intervistës, apo një deklaratë të folësit me tjetrën, përmbylljen etj.).

Ja një shembull i intervistës së tërthortë:

Bisedë me drejtorin ekzekutiv të "Israel Film Fund", Katriel Schory	Mbititull
<b>Rrëfimi është kapitali i filmit</b>	Titull
<i>Përgjatë një dekade eksperiencë me kineastë, Schory ka pasur rastin të njihet me regjisorë entuziastë e të shohë se si një film me buxhet të vogël mund të arrijë suksese të mëdha. "Mund të bëjmë gjëra të mëdha me buxhet të vogël. E gjitha varet nga pasioni ynë, sepse vendet tona ofrojnë rrëfime interesante, e ne duhet t'i gjejmë ato. Kapitali i atyre që bëjnë filma është vetë rrëfimi", ka thënë ai.</i>	Nëntitull
<i>Prishtinë, 5 dhjetor.</i> Katriel Schory ka dhjetë vjet që qëndron në krye të "Israel Film Fund". Megjithëse e kishte sprovuar veten edhe në regji, ajo që e tërhiqte ishte përkushtimi ndaj profesionit të producentit.	Paraqitja e folësit
Përgjatë një dekade eksperiencë me kineastë, Schory ka pasur rastin të njihet me regjisorë entuziastë e të shohë se si një film me buxhet të vogël mund të arrijë suksese të mëdha.	
Ai "shkel" për herë të parë Kosovën me ftesë të organizatorëve të festivalit ndërkombëtar të studentëve të teatrit dhe të filmit "Skena UIP". Si mysafir i festivalit Schory të shtunën ka mbajtur edhe një ligjëratë, përmes së cilës ka rrëfyer për veçantinë e të qenit regjisor si dhe ka dhënë udhëzime, prej të cilave ai beson se mund të finalizohet me sukses një punë.	Citim i tërthortë
Në një bisedë për "Kohën ditore", drejtori ekzekutiv i Fondacionit Izraelit të Filmit (Israel Film Fund), ka folur për punën e tij si regjisor e producent, si dhe ka shpjeguar ecurinë e fondacionit që ai drejton.	
Bazuar në bagazhin artistik dhe ato që ka parë deri tani, Schory thotë të ketë vërejtur një gjë esenciale: "Edhe me një buxhet të vogël mund të bëhen gjëra të mëdha. E gjitha varet nga pasioni ynë, sepse vendet tona ofrojnë rrëfime interesante e ne duhet t'i gjejmë ato", ka shpjeguar ai. "Më e rëndësishmja për një regjisor është të gjejë idenë, kapitali i film-bërësve është rrëfimi, dhe ne jemi gjuetarë rrëfimesh", ka shtuar ai.	Deklarim i intervistës

Megjithëse "Israel Film Fund" është krijuar para tridhjetë vitesh, Schory ka dhjetë vjet që është inkuadruar në të, pasi që më herët kishte pasur fatin të njihej për së afërmi edhe me "zanatin" e regjisorit. "Kam dhjetë vjet që jam në këtë fondacion. Më herët kam qenë regjisor, por mendja, qenia dhe karakteri im më drejtonin të bëhesha producent dhe të bëja disa gjëra njëkohësisht", ka thënë Schory.  
(...)

*Elvira Berisha, Koha ditore, 6 Dhjetor 2009*

Citim i drejtpërdrejtë

Komente të gazetarit

**Intervista e tërthortë (jo e drejtpërdrejtë).** Ekziston edhe një lloj i intervistës në të cilën biseda nuk zhvillohet drejtpërdrejt, edhe pse në botim të saj ajo duket se është e drejtpërdrejtë. Kjo realizohet përmes pyetjeve me shkrim të përgatitura nga gazetari dhe përgjigjeve me shkrim nga ana e folësit. Gazetari dhe folësi nuk janë në të njëjtin vend kur zhvillohet intervista. Folësi i merr pyetjet dhe ulet në tavolinën e punës në shtëpi apo në zyrë dhe përgatit i për ngadalë përgjigjet. Intervista e tillë në vetvete nuk përmban asgjë të keqe, por rrezikon ta humbet dy gjëra: një, e humbet gjallërinë dhe spontanitetin e bisedës (karakteristikë kjo thelbësore për çdo intervistë); dhe, dy, e humbet mundësinë e marrjes me tema të reja që mund të dalin gjatë zhvillimit të saj. Ky lloj i intervistës praktikohet për tema të cilat është më vështirë të elaborohen me të folur bisedor e të drejtpërdrejtë. Në rastet e tilla, gazetari dhe i intervistuari humbin diçka nga vlera e intervistës në favor të sjelljes së fakteve e argumenteve sa më të mjaftueshme e më të organizuara përpara lexuesit. Nëse në një intervistë trajtohet një çështje e filozofisë, një teori e re letrare apo cilado çështje teorike, atëherë mund (jo obligueshëm!) të përdoret edhe forma me shkrim e intervistës, por temat nga jeta e përditshme, ato nga politika, nga kultura, nga jeta publike etj., ato kurrë nuk është mirë të praktikohen në tjetër formë, përveç si bashkëbisedim i drejtpërdrejtë.

**Intervista e shkurtër.** Në fund të fundit, çdo bisedë e drejtpërdrejtë midis gazetarit dhe një personi tjetër, e cila transmetohet në një medie, është një intervistë. Përveç intervistave për të cilat folëm deri më tash, është një formë e shkurtër e intervistës e cila praktikohet më shumë e më gjerë në media. Kjo është intervistë e improvizuar (Boriçi e quan *intervistë e lirë, e improvizuar*)<sup>45</sup>, që bëhet aty për aty, zakonisht në raste të rëndësishme për një fushë apo për një rreth njerëzish. Në një ngjarje sporti, gazetari mund ta marrë opinionin e disa personave për ngjarjen, duke u shtruar atyre një, dy, tre e më shumë pyetje, dhe ato t'i bartë në medie bashkë me raportin për ngjarjen. Këto intervista, prandaj, praktikohen gjerësisht, sidomos në gazetarinë moderne, pothuajse në të gjitha llojet e gazetarisë informative dhe analitike, por edhe në publicistikë, për ta argumentuar temën, ngjarjen apo idenë që trajton gazetari. Duke qenë

të improvizuara, në këto intervista as gazetari e as i intervistuari nuk kanë kohë të parapërgatiten. Fati i intervistës kryesisht varet nga gjeturia e të intervistuarit për t'i zgjedhur aty për aty fjalët dhe mendimet që do t'i thotë.

**Dialogu sokratian.** Është edhe një lloj tjetër i intervistës, i cili nuk bëhet ekskluzivisht për median dhe i cili nuk trajton tema për mesataren e marrësit. Ky lloj i intervistës bën të kundërtën: trajton tema të larta, teorike apo empirike, të natyrave të ndryshme, por kryesisht filozofike, politike, arti, letërsie, apo edhe tema të biografisë së njerëzve me nam, dhe botohen si libra të veçantë, por edhe në media. Për ta emërtuar këtë lloj do të shërbehemi me dialogët e njohur të Platonit, të cilët i bën Sokrati, prandaj do ta quajmë dialogu sokratian. Në dialogët e tij, Platoni (Sokrati) trajton gjithë temat më të rëndësishme të filozofisë, të moralit, të religjionit, të artit, e deri te temat nga jeta e përditshme. Aty nuk ka një raport gazetar-folës, por ka një marrëdhënie pothuajse të barabartë Folësi 1 dhe Folësi 2 (apo më shumë folës këta të fundit). Njëri prej folësve (mundet cilido) merr rolin e nxitësit të bisedës, prandaj teknikisht në dialogun e Sokratit ai shërben vetëm si mjet për të argumentuar folësi kryesor ligjëratën e tij. Mirëpo, edhe pse merr atë rol teknik, jo gjithnjë ai pyet vetëm sa për ta nxitur bisedën: shpesh ai merr rolin e partnerit të barabartë në dialog.

Ky lloj i intervistës praktikohet me njerëz të shquar. Dialogu i tillë është ose një shqyrtim teorik ose një biografi e një njeriu të shquar. Të tilla janë në shqip: libri i Ismail Kadaresë *Dialog me Alain Bosquet* (1996), libri i Ismail Kadaresë dhe Ukshin Hotit, *Bisedë përmes grilash* (2000), ndërsa nga kultura evropiane janë shumë libra të njohur, midis tyre libri i J. P. Ekerman *Bisedë me Gëten* (1836 dhe 1848). Se librat e tillë mund të jenë të famshëm na tregon edhe vlerësimi i Fridrih Niçes (Friedrich Nietzsche) për librin e Ekermanit dhe Goetes: ai është libri më i mirë gjerman që ekziston.

**Intervista e tipit "tryezë e rrumbullakët".** Një formë tjetër e dialogut, e bisedës apo edhe e intervistës, është ajo që bëhet në një tryezë me shumë folës. Gazetari merr rolin e pyetësit dhe nxit bisedën duke shtruar pyetje, ndërsa pjesëmarrësit në tryezë, dy e më shumë, përgjigjen. Mund të ketë disa folës, por jo më shumë se pesë apo gjashtë, sepse atëherë rrezikohet kontinuiteti i bisedës, ndërsa tryeza merr formën e një interviste me grup personash. Biseda, sado që nxitet nga gazetari, nuk mbetet vetëm në kufijtë e pyetje-përgjigjeve të gazetarit me pjesëmarrësit, por merr formën edhe të një bisede të gjallë midis vetë pjesëmarrësve. Pikërisht kjo e bën më të suksesshme një intervistë tryeze. Zakonisht këto intervista (biseda) organizohen për shqyrtime nga shumë kënde të çështjeve me in-

teres publik. Prandaj redaksia zgjedh pjesëmarrësit e tryezës në atë mënyrë që secili prej tyre të përfaqësojë një mendim ndryshe nga të tjerët, e kjo e shton invencionin e bisedës, por edhe përfaqëson interesa të gjëra të shoqërisë.

Intervista e tryezës zgjon interesim mjaft të madh te marrësi, sidomos kur është e realizuar në televizion. Prandaj, ky lloj i intervistës është duke marrë formën, gjithnjë e më shumë, të llojit të intervistës televizive.

Një shembull i intervistës në tryezë është emisioni “Pa rrotulla” i Milaim Zekës në RTK, i udhëhequr nga Edlira Qefalija, me temë: “Dhuna nëpër shkollë”. Në emision kanë marrë pjesë një nxënës, një profesor dhe një psikologe. Tema është ndërlidhur me një aksident të rëndë në një shkollë të mesme në Ferizaj, më 6 shtator 2010, me ç’rast një nxënës ka qëlluar me revole një nxënës tjetër dhe janë plagosur tre persona.<sup>46</sup>

### XVIII.5.2. LLOJET E INTERVISTAVE SIPAS QËLLIMIT PËRMBAJTJESOR DHE QËLLIMIT HULUMTUES

**Intervista informative (e lajmeve).** Mencher dallon dhe përkufizon intervistën e lajmeve.<sup>47</sup> Të tjerë gazetarë përdorin edhe nocionin *intervista informative*<sup>48</sup>, i cili më mirë i shkon gjuhës shqipe. Ky lloj i intervistës ka në qendër të interesimit një informacion, i cili përmes intervistës zgjerohet më shumë, zbardh disa fakte dhe jep disa detaje, të cilat marrësi nuk i ka gjetur në lajm apo në raport. Kështu, gazetaret kanë trajtuar temën e mungesës së gjelbërimeve në qytetin e Prishtinës, ndërsa një intervistë me kryetarin e një nisme civile që merret me çështjet mjedisore do ta elaboronte deri në detaje problemin. Pyetje të mundshme për këtë intervistë do të ishin:

- Sa parqe të vogla janë brenda qytetit?
- Sa shkatërrohet gjelbërimi ekzistues dhe cilët janë faktorët e dëmshëm?
- Si mund të zgjidhet ky problem?

Ja një intervistë informative:

Llojet e intervistave sipas përmbajtjes dhe qëllimit hulumtues (qëllimit përmbajtjesor):

- Intervista informative (e lajmeve)
- Intervista portret
- Intervista afirmative
- Intervista analitike (intervista tematike)
- Intervista polemizuese
- Intervista emocionale



## Rama: Nëna ime, gruaja më e bukur që kam pasur mundësi të njoh

Kryeministri Edi Rama, në një intervistë të dhënë për gazetën gjermane "Der Freitag", ka reflektuar dashurinë për nënën e tij, duke e cilësuar si gruan më të bukur që ka pasur mundësi të njoh.

- Përshëndetje z. kryeministër. Shefi juaj i protokollit na tha se pothuajse nuk kishim kohë fare për intervistën. Për këtë arsye po e heq listën me pyetje që kisha për të bërë dhe po ju kërkoj vetëm fjalë kyçe ose fjali të shkurtra, dy ose tre fraza maksimumi. Jeni dakord me këtë lloj interviste?  
Pse jo. Mirë, e provojmë kështu.

- Fjala e parë kyçe është: nënë.  
Nëna ime?

- Po, nëna juaj.  
Gruaja më e bukur që kam pasur mundësi të njoh.

- Babai juaj?  
Dikush që kishte bindje të ndryshme nga të miat, por më lejoi në të njëjtën kohë të isha i ndryshëm nga ai.

- Basketbolli?  
Fokusi është në shpirtin e ekipit. Ne kemi nevojë për lojtarë që të jemi të suksesshëm. Kjo doktrinë është jashtëzakonisht e rëndësishme për politikën, sepse në një parti apo edhe për të udhëhequr një vend, dikush duhet të mbështetet në një ekip të mirë.

- Çfarë roli keni luajtur?  
Playmaker.

- Rezultati më i mirë?  
Kur arrija më shumë pikë se një kundërshtar më i mirë në karrierën time. Kemi luajtur kundër Turqisë. Megjithatë kemi humbur.

- Kuzhina shqiptare?  
Gatime siç duhen. Është një nga më të shijshmet në botë.

-Pjata shqiptare e preferuar?  
Çdo gjë e gatuar nga gjyshja ime.

-Dhe pjata juaj e preferuar?  
Kuzhina e gjyshes sime ishte unike. Në të nuk kishte të mirë dhe të keqe.

Vëreni: të gjitha pyetjet kërkojnë informacione të reja



- Shqipëria: e korruptuar, kriminale dhe e prapambetur.

Këta janë stereotipa të panevojshëm. Shqipëria nuk është një vend fatkeq. Është një vend shumë alegro dhe me shumë diell, me një mikpritje të madhe dhe me shumë vende të bukura. Në të njëjtën kohë Shqipëria ofron shumë resurse njerëzore dhe natyrore. Ka ndryshuar komplet në 25 vitet e fundit.

- Të mësosh nga Shqipëria?

Në vendin tonë tolerohet çdo besim. Shqipëria është një shembull se si praktikimi i tolerancës është i mundur.

- Refugjatët shqiptarë?

Një mrekulli për ata që i presin. Ashtu si emigrantët, shqiptarët kanë demonstruar atë që mund të bëjnë kur kushtet politike dhe ekonomike janë në favor të tyre.

- Nuk janë emigrantët një humbje për vendin tuaj?

Jo, sepse historia ka treguar se emigrantët përdorin vendin prithës njëlloj si vendalinjtë. Por, natyrisht që populli ynë ka të drejtë për një funksionim më të mirë të gjërave dhe mundësi më të mëdha se ato që kanë aktualisht.

- Veriu i Evropës apo jugu?

Pa dyshim që nuk ka një mentalitet jugor dhe verior. Ne jemi ne meridian.

- Ku është ndryshimi?

Zakonisht thuhet se gjermanët jetojnë për të punuar ndërsa mesdhetarët punojnë për të jetuar. Është si një shkëndijë e së vërtetës.

- Mesdhe apo Ballkan?

Jemi njëlloj.

- Europa?

Një preket vizionar, por që për momentin po kalon vështirësi të mëdha.

- Përse vështirësi?

Mungon një projekt strategjik.

- Në ç'mënyrë?

Pa Shtetet e Bashkuara të Europës në këtë kontinent do të ketë vetëm humbje.

- Pse?

Trupit total i mungon një pjesë. Diçkaje të përgjithshme kurrë të mirë.

- Angela Merkel?

Aktualisht i vetmi person që mund të ngrejë Europën.

- Aleksandar Vucic

Një djalosht i jashtëzakonshëm.

- Serbia?

Një armik i këndshëm

- Kosova?

Territor dhe shpirt shqiptar.

- Droni në Beograd?

Një argëtim i keq dhe pa shije.

- Shqipëria e Madhe?

Një mit i dalë mode nga një kohë e shkuar.

- Politika kundër artit?

Politika është lufta ime. Arti, dëshira dhe lutje. Kjo nuk i përzen, por i plotëson.

- Shtëpitë e lyera në Tiranë?

Ajo është një politikë ngjyrash. Me bukurinë mund të bësh gjithçka.

- Kryebashkiaku i vitit 2004?

Ky çmim më ka bërë krenar, sepse ishte një homazh për punën e bërë në Shqipëri.

- Ngjyrat e Edi Ramës?

Çfarë do të thotë?

- Cilat janë ngjyrat e preferuara?

Ngjyrat janë përkufizimi im për jetën. Në këtë drejtim janë të nevojshme dhe i përdor të gjitha.

- Artistët që të kanë goditur?

Paolo Uccello. Rembrandt. Paul Klee. Marcel Duchamp.

- Pikturon kalendar?

Lutjet e mia.

- Kryeministër?

Një privilegj i madh. Të zgjidhesh kështu është një mirënjohje shumë e madhe që të jep populli. Në anën tjetër është një përgjegjësi e madhe.

- Baba?

Vlen të thuhet se djali apo vajza kanë të drejtë të kundërshtojnë apo prezantojnë një opinion ndryshe.

- Basket, Art, Politikë: keni pasur sukses në të gjithë botën?  
Si ta përkufizoj suksesin? Suksesi është një gjë shumë relative.  
Shpresoj të jetoj një jetë të mirë. Ai është sukses për mua.

- Defektet e tua?  
Kam qenë dhe jam keq në matematikë.

- Feja?  
Katolik.

- Më shumë nuk doni të thoni?  
Po. Vetëm katolik.

- Shqipëria pas 10 vitesh?  
Në BE do të ishte parashikimi më i dukshëm. Dua të bëj një përfaqje tjetër. Ëndërroj një shqiptar që është mirë dhe zhvillohet pozitivisht. Shoh një vend që lufton për më të mirën dhe jo një vend të mërzitshëm.

- Edi Rama pas 10 vitesh?  
E imagjinoj veten në një studio me artistë, filozofë, dizajner.. si një ishull të izoluar. Kjo është ëndrra ime.

Agjencia e Lajmeve Sof News

<http://fax.al/read/news/2045166/10682573/rama-nena-ime-grua-ja-me-e-bukur-qe-kam-pasur-mundesite-te-njoh>

**Intervista portret.** Edhe këtë lloj të intervistës e dallon dhe e përkufizon edhe Mençeri.<sup>49</sup> Intervista ka në qendër të interesimit një person, i cili dallohet nga rrethi në një fushë të caktuar dhe gazetari dëshiron t'ia paraqesë publikut. Një letrar i ri që ka marrë një shpërblim vjetor në letërsi dhe gazetari bën një intervistë me të për ta paraqitur atë dhe veprën e tij të shpërblyer para publikut. Pyetjet që bëhen në intervistën e tillë janë të tipit të hapur, që i lënë mundësinë folësit të shprehet më lirshëm dhe afirmojnë rezultatin e tij.

Por, ka intervista portret edhe për një personazh me emër të keq. Ka intervista portret me një kriminel, me një të arratisur nga burgu etj. dhe, në raste të tilla, gazetari duhet eliminuar qasjen afirmative dhe të kthehet në bazën e tij neutrale - njeri që bart një informacion te marrësi.

Ja një intervistë portret:



### Kur muzika është profesion

Aktualisht jam duke përgatitur një album me orkestruesin Jeton Haxhija dhe së shpejti do ta realizoj një video-klip të njëjës nga këngët që do të vë edhe në album

Laokont Bytyçi nuk është më emër i ri në estradën e muzikës popullore shqipe. (...)

**ZËRI:** Si ishte fillimi i angazhimit Tuaj në fushën e muzikës?

**BYTYÇI:** Me muzikë kam filluar të merrem që nga moshë e fëmijërisë, ku jam angazhuar nëpër festivale dhe koncerte të ndryshme, të cilat edhe më kanë frymëzuar që të merrem edhe më shumë me muzikë.

E kam pasur gjithmonë në zemër dhe dua të jap maksimumin tim në këtë fushë.

**ZËRI:** A e konsideroni muzikën si profesion apo...?

**BYTYÇI:** Patjetër, që muzikën e konsideroj si profesion, sepse marr dhe shpenzoj për muzikën, kështu që e kam profesion.

**ZËRI:** Çka presin adhuruesit e muzikës suaj në të ardhmen?

**BYTYÇI:** Aktualisht jam duke përgatitur një album...(...)

Vjollca Tytyni, Zëri, 4 Dhjetor 2009

**Intervista afirmative.** Është intervistë që si qëllim parësor ka afirmimin e një teme apo të një personi. Zakonisht ky lloj përdoret në raste festash për ngjarje të rëndësishme politike apo historike. Kështu, në njëvjetorin e pavarësisë së Kosovës ka pasur disa intervista me personalitete të rëndësishme të pavarësisë së Kosovës, e temë e atyre bisedave ka qenë vetë pavarësia. Në të gjitha ato intervista gazetari ka pasur një qëllim afirmativ për punën që është bërë për pavarësinë e Kosovës. Këto intervista gjithmonë janë me një pikëpyetje etike në fund! Jo që nuk duhet të ketë edhe intervista të tilla, por mundësia e korrupsionit moral të gazetarit, të folësit, të mediumit ku botohet intervista e deri edhe te marrësi që e lexon apo shikon e dëgjon atë intervistë, është shumë më e madhe se te çdo lloj tjetër gazetar: në emër të një ideje të madhe, aty servohen interesa parciaisë e të imta. Në favor të kësaj hamendjeje është edhe fakti se ky lloj i intervistës përdoret dendur në mediet që janë të dëgjueshme ndaj qeverisë. Jo rrallë ndodh që kryeministri, presidenti, ministrat etj. të kenë intervista afirmative. Zakonisht intervistat e tilla fillojnë me pyetjet afirmative: cilat janë të arriturat tuaja (të ministrisë apo qeverisë suaj) brenda kësaj periudhe? Dhe përfundojnë me pyetjen edhe më shumë afirmative: cilat janë planet tuaja (të ministrisë apo qeverisë suaj) për të ardhmen?

Ja një shembull të intervistës afirmative e gazetës Bota sot, 11.8.2009:



**Bota Sot:** *Z. Ministër, meqenëse jeni mjek me profesion, por që në këto 20 vjet të fundit merreni me politikë. Sa keni arritur ta "shëroni" gjendjen në shëndetësinë e Kosovës?*

**A. Gashi:** Jo vetëm si politikan, por edhe si profesor në Universitetin e Prishtinës dhe si mjek që kam filluar karrierën time në Drenas, e deri te ballafaqimi i fuqishëm si Dekan me soldateskën serbe, për këto 20 vite kujtoj shumë suksese të cilat më bëjnë të ndjehem mirë. Unë jam i përkushtuar për ligj dhe parime, nuk i heshti as nuk ju bëj lak vështrësive, por as nuk e zbukuroj realitetin. E kam gjetur shëndetësinë në gjendje të papranueshme. Kemi ndërmarrë veprime të menjëhershme dhe kemi heq nga rendi i ditës furnizimin me insulinë, mënjanimin e konfliktit të interesit në farmaci dhe mënyrës së importit të barnave, lehtësime maksimale për barnat e vendeve të UE, ShBA, Kanadasë, Japonisë dhe Zvicrës, ndryshimet rreth përgjegjësisë të inspektorateve me raporte ditore, licencimet në pajtime ligjin, fuqizimin maksimal të ligjshmërisë duke mbikëqyr të gjitha segmentet, aktivitetet për ndryshimet në ligje, në duzina të udhëzimeve administrative dhe vendime për ngritjen e cilësisë, sasisë së furnizimeve dhe aktiviteteve ditore për të shmangur "kolapset" e vazhdueshme në institucione të cilat punonin sot për nesër.

Deklarimi ynë se janë në krizë keqbërësit është ende aktual. Puna jonë ka bërë që ata të kenë vend tejet të ngushtuar në sistemin publik shëndetësor dhe përpiqemi që ta ngushtojmë veprimin e tyre edhe më tej, andaj, konsiderojmë se sukseset e vazhdueshme drejt shërimit të shëndetësisë janë evidente.

[www.mshgov-ks.org](http://www.mshgov-ks.org)

**Intervista analitike (intervista tematike).** Intervista analitike (ose tematike) bëhet për të analizuar një temë të caktuar apo për të interpretuar më thellë fakte të cilat tashmë dihen, por mungon analiza e tyre. Disa e quajnë edhe intervista interpretuese, ndërsa mund të quhet edhe intervista tematike. Nëse tema ka një interes publik, shkencor, kulturor, etik etj., gazetari bën një intervistë me njohës të temës dhe qëllimi i tij është analiza e temës, në mënyrë që ajo të njihet edhe prej opinionit publik. Shfaqja e postmodernizmit në letërsinë shqipe, p.sh., mund të jetë temë e një interviste të tillë. Gazetari që bën intervistën duhet ta njohë temën dhe folësin më shumë se në rastet e intervistave të tjera.

Pyetjet e zakonshme në këtë lloj të intervistës duken kështu:

- Si mendoni ju se qeveria duhet të menaxhojë me ndarjet buxhetore sipas sektorëve të caktuar?

- A munden, sipas jush, institucionet publike dhe ato private të kulturës të ngritin interesimin e qytetarit të Kosovës për librin?

Edhe pse jo gjithmonë lexohen me ëndje (nganjëherë tema mund të mos jetë shumë nxitëse për marrësin, herëve të tjera edhe nëse është nxitëse, tema mund të jetë e vështirë për marrësin mesatar). Megjithatë, ky lloj i intervistës është i rëndësishëm.

Ja një pjesë e intervistës së gazetares Arbana Vidishiçi me analistin James Hooper:



**RADIO EVROPA E LIRË:** Zoti Hooper, kohët e fundit, ka diskutime mbi mundësinë e përfshirjes së Ballkanit në Bashkimin Evropian deri në vitin 2014. Sa janë reale pritjet e këtilla dhe çfarë ndikimi mund të ketë një qasje e këtillë në vendet që aspirojnë anëtarësimin?

**JAMES HOOPER:** Nëse me këtë nënkuptohet përfshirja e të gjitha vendeve të Ballkanit, kjo mund të ndodhë vetëm nëse BE-ja zbut standardet e saj.

Unë nuk mendoj se Kosova ka probleme me përmbushjen e standardeve. Por, nëse evropianët i zbusin standardet dhe ia mundësojnë Serbisë anëtarësimin, atëherë dërgohet një mesazh i qartë.

Serbia nuk mund t'i përmbushë standardet e tashme, prandaj e vetmja mënyrë për ta futur Serbinë brenda, është nëpërmjet zbutjes së standardeve. Ajo çfarë dëshiron Serbia, është t'i gëzojë të gjitha përfitimet nga anëtarësimi, pa pasur nevojë të paguajë çmimin. Serbia në esencë është e pareformuar që prej kohës së Millosheviqit. Ende ekziston mafia e njëjtë, ende ekzistojnë nacionalistët e njëjtë...

Evropa mund të mendojë - dhe ky është një iluzion i saj - se ka në duar shkopin magjik për të gjitha problemet e politikës së jashtme, duke krijuar mundësi të ndryshme për anëtarësimin e të gjithëve.

Unë do t'ia tërheqja vërejtjen Bashkimit Evropian: Prisni derisa të merrni vesh se ç' do të ndodhë me një Serbi hipernacionaliste brenda BE-së!. Nëse serbët nuk duhet të reformohen dhe të ecin përtej nacionalizmit të tyre, duke e njohur Kosovën, atëherë si do të duket BE-ja me Serbinë brenda saj, me një vend vërtetë nacionalist?!

[www.evropaelire.org](http://www.evropaelire.org)

**Intervista polemizuese.** Në çdo intervistë gazetari mund të bëjë replika ndaj përgjigjeve të folësit, si kemi parë më lart. Mirëpo, nëse gazetari e merr këtë rol shumë hapur dhe pyetjet e tij janë pothuajse në kundërshtim të gjithnjëshëm me folësin, atëherë kemi të bëjmë me një lloj të veçantë të intervistës, atë polemizuese. Duhet thënë shumë çart: gazetari polemizon e kundërshtohet me folësin mbi argumente të interesit publik, por nuk mund të nxitet për kundërshti

mbi argumente të bindjes së tij personale. Thjesht, ai nuk mbron aty qëndrime dhe interesa personale, por qëndrime dhe interesa publike. Zakonisht kjo polemikë mund të bëhet në intervistat analitike, aty ku trajtohen tema që kërkojnë nivel të lartë shqyrtimi, kështu që gazetari nuk është thjesht në rolin e një pyetësi, apo të një prijësi të bisedës, por mbron qëndrime (ose bëhet sikur mbron qëndrime) që kundërshtohen me tezat e folësit. Pyetje të zakonshme në këtë lloj të intervistës mund të jenë:



- Ju keni deklaruar se shtimi i pagesës së TVSH në Kosovë nga 15 në 16 % rrezikon të prishë paktin e mirëkuptimit social. Ku mundet vetëm 1 % ta prishë paktin e mirëkuptimit social?

**Intervista emocionale.** Është lloj i intervistës që shërbehet me emocionet e folësit për të arritur një qëllim të vet atij, folësit, ose në lidhje me të. Zakonisht përdoret në raste të tragjediave të ndryshme, për të cilat fajtor është njeriu (p.sh. tragjedia e Gërdecit i ka shtyrë gazetarët të bëjnë intervista emocionale me viktimat e tragjedisë, në mënyrë që opinioni publik të bëjë presion mbi qeverinë që të japë llogari për tragjedinë), ose për të arritur qëllime më të gjera sociale (p.sh. mbledhja e ndihmave humanitare për vendet e varfra i shtyn gazetarët të bëjnë intervista emocionale me njerëz të varfër) etj. Zakonisht në këto intervista pasqyrohet ana e dhimbshme e ngjarjes apo e personit, në mënyrë që ajo anë t'i ndikojë të tjerët.

Është jashtë kodit moral shfrytëzimi i këtyre intervistave për interesa të tjera, politike apo jopolitike, të individit apo të një grupi.



Ardita: "Zoti ma fali sërish jetën"<sup>51</sup>

Ardita Thaçi është 18 vjeëarja që mundi të shpëtojë nga aksidenti tragjik. "Zoti ma fali sërish jetën. Jam me fat që jam gjallë", shprehet ajo duke rënkuar në shtratin e spitalit, në dhomën nr. 7 të katit të tretë të Repartit të Traumatologjisë. Ndërsa flokët i ka akoma të përbaltur dhe fytyrën të përgjakur. Gjimnazistja nga Malisheva është shumë e tronditur. Mendimet në kokë i vijnë të turbullta. Ndiën dhembje gjithandej në trup. Duart i ka të mpiara dhe buzët e nxira dhe të thata. Rrobat e saj të përgjakura akoma qëndrojnë në fundin e dhomës së spitalit, ndërsa ajo rënkon dhe papritur sytë i mbushen me lotë. Pranë saj vijnë kosovarët e tjerë të cilët kanë mbërritur në spital sapo kanë mësuar për ngjarjen, edhe pse nuk e njohin personalisht. Ndërsa doktorët e vizitojnë në çdo moment. Në dhomën e saj janë të shtrura edhe dy gra të tjera, të cilat me ëmbëlsinë e tyre prej nëne i qëndrojnë pranë, pasi prindërit akoma nuk kanë mundur t'i vijnë nga Kosova.

**TanPortal:** A e mbani mend kur jeni përplasur?

**Ardita:** Kemi qenë në afërsi të Urës së Bicajve në Fushë Arrëz.



Ne ishim në autobusin e dytë. Shumica prej nesh ishim në gjumë kur është përplasur autobusi.

*TanPortal:* Çfarë ndodhi?

*Ardita:* Nuk e di. Ishte një përplasje shumë e fortë dhe më pas nuk mbaj mend asgjë.

*TanPortal:* Kë e ke poasë afër?

*Ardita:* Shoqen time, Arditën.

*TanPortal:* Dini gjë ku është ajo?

## XVIII.6. PËRGATITJA E GAZETARIT PËR INTERVISTË

Ne sapo folëm për rolin e gazetarit në intervistë dhe vërejtëm se ai nuk ka një rol pasiv, si mendojnë shumë gazetarë (i intervistuari merr përgjegjësinë për ato që thotë, pra, pse të lodhem kot unë?!), përkundrazi ka rol shumë aktiv. Intervista nuk është një punë e lehtë, prandaj zakonisht intervistues të suksesshëm janë gazetarët më të mirë e më me përvojë. Gazetari duhet të përgatitet mirë, të ketë informacion të mjaftueshëm për temën që do të trajtojë, për personin me të cilin do të bisedojë dhe për rëndësinë e temës në opinionin publik.

*“Një intervistë mund të dështojë për shumë arsye, por dështimi është thuajse i sigurt në rast se reporteri nuk përgatitet. (...) Rrjedhimisht, reporterët duhet që në radhë të parë të lexojnë ç’është shkruar për të intervistuarin (apo për çështjen që hetohet)”<sup>52</sup>*

Gazetari nuk mund të ketë informacionet që ka bashkëbiseduesi për temën që bisedojnë (mos harroni: bashkëbiseduesi duhet të jetë njeri i rëndësishëm në një fushë, apo ekspert i një fushe!), por gazetari duhet të jetë i informuar me informacionet që kërkon publiku për temën që do të bisedojnë. Gazetari nuk mund të shkojë në intervistë me mendimin se *do ta fillojë bisedën me pyetjen e parë që i bie në mendje*. Njësoj, paraprakisht e dështuar do të ishte edhe intervista së cilës gazetari i qaset: *do ta filloj pa të shohim se çka do të dalë nga kjo punë!*

*“Para se të fillosh me pyetjet duhet të kesh një ide të saktë për thelbin e informacionit që kërkon të marrësh nga burimi”<sup>53</sup>*

Gazetari duhet të përgatitet mirë sepse ai ka detyrën që me bashkëbiseduesin ta zbërthejë dhe ta shpjegojë temën e trajtuar, deri në atë masë sa publiku ta kuptojë esencën dhe proceset që lidhen me atë temë. I intervistuari mund të ketë interes ta zbërthejë temën, mundet edhe të mos e ketë këtë interes, zakonisht ndodh që ai i bishtnon temës, e ndonjëherë ka interes t’i fshehtë informacionet për temën e trajtuar. Prandaj ai duhet të përgatitet që ta kryejë këtë detyrë.

Teoricienë të gazetarisë deri edhe te organizata të ndryshme të gazetarëve kanë hartuar këshilla të ndryshme për një intervistë të suksesshme. Kështu International Center for Journalists ka lansuar në internet dhjetë kushte për intervistën e suksesshme. Po kështu kanë vepruar edhe autorët e librit *Manual për gazetarët e Europës Qëndrore dhe Lindore*.

## XVIII.7. TRI PARAKUSHTE PËR NJË INTERVISTË TË SUKSESSHME

Nga kjo që u tha më sipër, ne vijmë në përfundimin, të njohur nga studiuesit e gazetarisë, se janë përkufizuar tri parakushte për të qenë një intervistë e suksesshme:

- zgjedhja e temës,
- zgjedhja e të intervistuarit, dhe
- formulimi i pyetjeve.<sup>54</sup>

Ne tashmë folëm për këto tri parakushte. Ajo që duhet të theksohet është fakti se që të tri këto parakushte varen nga gazetari: edhe zgjedhja e temës që duhet të ketë rëndësi të madhe për publikun, edhe zgjedhja e të intervistuarit i cili duhet të jetë njeri i rëndësishëm në një fushë apo ekspert i një fushe, apo edhe njeriu i qëlluar në çastin e duhur, po edhe formulimi i pyetjeve, qëllimi i të cilave duhet të jetë zbardhja e fakteve për temën në shqyrtim. Nisur nga kjo, edhe një herë mund të përfundojmë se roli i gazetarit, përkundër perceptimit në praktikën gazetare, është shumë i rëndësishëm në një intervistë.

## XVIII.8. AUTORIZIMI I TEKSTIT

Një praktikë tjetër me të cilën ndeshet gazetari është autorizimi i tekstit të intervistës për gazetë. Bisedën gazetari e incizon në magnetofon ose e shkruan në letër me stenogram dhe prej aty e nxjerr në letër. Gazetari ka të drejtën edhe të redaktimit të bisedës, dmth. nuk nxirret në letër e gjithë ajo që është folur gjatë bisedës (nëse biseda është e incizuar në diktafon, në laptop apo në telefon). Kjo ka sjellë deri te "*e drejta*" e të intervistuarit që ta autorizojë intervistën para se të botohet. Kjo dmth. i intervistuari e lexon intervistën para se të botohet, për t'u bindur se gazetari ka transkriptuar gjithë atë që ai ka thënë, apo nëse ka ndërhyrë në tekst. Në një rast të tillë, i intervistuari nuk gëzon të drejtën për të ndërhyrë në tekst apo për të

Tri parakushte për një intervistë të suksesshme:  
- zgjedhja e temës  
- zgjedhja e të intervistuarit dhe  
- formulimi i pyetjeve.

Hamit Boriçi, *Gazetaria 2*.

ndërruar pjesë të tij. Kjo konsiderohet si një ndërhyrje në rrjedhën e intervistës. Por, një praktikë e tillë bëhet vetëm nëse paraprakisht ka një marrëveshje midis gazetarit dhe të intervistuarit.

Në praktikë ka mjaft tendenca për të "korigjuar" një informacion të dhënë përmes autorizimit të tekstit. Kjo nuk është e drejtë as frytdhënëse. Nëse folësi ka thënë një herë se në orën 4 e 15 minuta nuk ka qenë në vendin e ngjarjes, këtë fakt nuk mund ta ndërrojë në çfarëdo autorizimi të tekstit.

Në mendimin gazetar ka qëndrime skajshmërisht të ndryshme për këtë çështje: prej tyreve që besojnë se e drejta për autorizimin e tekstit është e drejtë e folësit e deri tek ata që janë kundër çfarëdo autorizimi të tekstit. David Randall e sulmon ashpër një praktikë të tillë. Ai beson se nuk duhet lejuar asnjë autorizim të tekstit nga ana e të intervistuarit. Ai flet për intervistimet për një lajm apo raport e jo për intervistën si lloj analitik, por besoj se vlen e njëjta gjë si për të parën edhe për të dytën: "Të lejosh një person të jashtëm për gazetën t'i hedh një sy ngjarjes para botimit, kjo jo vetëm që e grish atë për censurim ose presion mbi gazetarin që të ndryshojë përshkrimin e saktë, por i krijon edhe idenë se një praktikë e tillë është e drejtë dhe e zakonshme. Me të mësuar se ngjarja mund të shihet para botimit, të gjithë do të vrapojnë t'i hedhin një sy".<sup>55</sup>

## PËRFUNDIM PËR INTERVISTËN

Në përfundim të shqyrtimit për intervistën duhet të theksohen edhe tri karakteristika të saj:

*Së pari*, mund të bëhet edhe një klasifikim i intervistave mbi kriterin e përkatësisë sociale e juridike të të intervistuarit. Kështu, teoricienët dallojnë intervistën me fëmijët, intervistën me dëshmitarët e gjykatave e të ngjashëm, intervistën me kriminelët, intervistën me viktimat etj. Ky klasifikim i intervistës më shumë ka të bëjë me punën praktike të gazetarit sesa me zhanret gazetare, mirëpo studiuesit e gazetarisë gjithnjë duhet të jenë të vëmendshëm edhe në këtë klasifikim.

*Së dyti*, intervista është një prej formave më demokratike të gazetarisë. Boriçi thotë:

*Intervista për vetë natyrën e saj është lloj shkrimi demokratik. Në të njerëzit bëjnë të ditura botërisht pikëpamjet e tyre, shkëmbejnë mendime lirshëm pa kufi e cak.*<sup>57</sup>

Mbase, përveç në cilësinë që ofron ajo, në besueshmërinë që krijon, edhe fakti se ajo është mundësi për artikulum të drejtpërdrejtë, pa pengesa dhe pa kufij, të mendimeve, të ideve e të fakteve të ndryshme, ndikon në rolin e rëndësishëm që është duke marrë intervista në medien bashkëkohore.

Duke qenë se intervista është paraqitje e drejtpërdrejtë e fakteve, e ideve dhe e shfaqjeve të ndryshme të shoqërisë njerëzore, pastaj është e gjallë (në radio, në televizion dhe në internet), por edhe fjalë e drejtpërdrejtë (në gazetë), ajo është një prej formave më të besueshme të zhanrit gazetar. Në medien bashkëkohore është duke u rritur vrullshëm roli i intervistës, aq sa jo vetëm që nuk mund të paramendohet një numër i gazetës pa një intervistë, poende intervista është duke zënë gjithnjë e më shumë faqet e një gazete. Qendrat e mëdha informative, si CNN, BBC etj. kanë krijuar rubrikat më të suksesshme pikërisht me intervista. Intervista është duke zënë një vend kryesor në zhanret e gazetarisë.

*Së treti*, intervista konsiderohet prodhim edhe i gazetarit edhe i të intervistuarit (folësit). Ka gazetar që mbledh intervistat kryesore të tij dhe i boton në një libër. Ka të tjerë, jo gazetarë, por folësit e intervistave, të intervistuarit, që i mbledhin intervistat e tyre dhe i botojnë në një libër. Të parët (gazetarët) e bëjnë për të dëshmuar zotësinë e tyre për të udhëhequr një bisedë të mirë. Të dytët (të intervistuarit) e bëjnë për të dëshmuar ato që kanë thënë, sepse ato që kanë thënë janë mendime të tyre dhe ato janë subjekti i intervistës.



## XIX. ANKETA (WOX POP)

### PËRMBAJTJA

XIX. Anketa (Wox Pop) 303

**F**jala vjen nga frëngjishtja: *enquete* - hetim. Anketa konsiderohet si një lloj i veçantë i intervistës<sup>58</sup>, edhe pse, pak a shumë në të njëjtin format, përdoret edhe si metodë hulumtuese në shkencat sociale. Në hapësirat anglishtfolëse përdoret edhe nocioni *Wox Pop* (nga latinishtja: *vox populi* - fjala e popullit, ajo që mendon populli). Anketa është një intervistim i shumë personave në një apo dy-tri pyetje. Gazetari shtron një (më së shumti dy-tre) pyetje dhe me të njëjtën pyetje merr përgjigje prej disa personave. Kuvendi i Kosovës e diskuton Projektligjin për koncesione dhe gazetari vendos të pyesë individë të ndryshëm se çfarë mendojnë për koncesionet. Del në rrugë dhe pyet kalimtarët se a është i nevojshëm një ligj i tillë. Anketa duhet ta paraqesë mendimin e publikut ashtu si është, pra nuk i jepet e drejta gazetarit që të ndërhyjë në përgjigjet dhe në cilësinë e saj në çfarëdo forme.

Në anketë gazetari, për dallim nga intervista, nuk interesohet parësisht për cilësinë e përgjigjes së të anketuarit, por për zgjedhjen e modelit për anketim dhe për qartësinë e pyetjeve. Intervista është bashkëbisedim cilësor, ndërsa anketa është një pyetje-përgjigje sasiore. Derisa qëllimi përmbajtjesor i intervistës është informimi, analizimi dhe shpjegimi deri në detaje i temës së trajtuar, qëllimi përmbajtjesor i anketës është informimi sasior për mendimin e shumë individëve rreth temës së trajtuar. Pra, gazetari, me të edhe audiencat, interesohen në anketë për anën sasiore të përgjigjeve. Në këtë pikë anketa përkon me hulumtimin e opinionit si metodë shkencore sociologjike.

Ka disa lloje të anketave që përdoren në gazetari. Sipas mënyrës si realizohet ajo, dallohen:

- anketa me kupon (kuponit me pyetje botohet në gazetë, lexuesi e pret, e mbush dhe e poston përsëri në gazetë);
- anketa me telefon (redaksia angazhon gazetarët që ulen dhe thërrasin njerëzit me telefon dhe u bëjnë pyetje);
- anketa në rrugë (redaksia angazhon gazetarët në rrugë t'u bëjnë pyetje kalimtarëve të rastit);
- anketa me grupe të caktuara njerëzish (redaksia shpërndan 100 pyetësorë të cilët i mbushin në shtëpitë e tyre 100 persona) etj.
- anketa përmes internetit;
- anketa në rrjetet sociale.

Ka edhe shumë forma të tjera të anketave. Por, teoricienë dhe gazetarë me përvojë nuk preferojnë asnjërën prej këtyre modeleve të anketës. Melvin Mençeri thotë se modeli më i mirë i anketës është *anketa në shtëpi*.<sup>60</sup> Në këtë rast, puna më e rëndësishme në një anketë është ta zgjidhni modelin e anketës, pra të përgjigjeni në pyetjet se

*vox populi* - fjala e popullit  
(në kuptimin populli flet).

ku do ta bëni dhe si do ta bëni? Nëse bëni anketën në një lagje të pasur apo të varfër, në një rrugë ku shëtisin gratë, apo në një shtëpi pleqsh, në një shkollë fillore apo në një fakultet etj. kjo do të ketë efekte thelbësore në përgjigjet e anketës. Zgjedhja e modelit duhet të përshtatet me pyetjet e anketës. Nuk mund të keni një përgjigje korrekte në pyetjen se *a besojnë njerëzit në zana e shtojzovalle* nëse e bëni anketën në shtëpinë e pleqve ose në një mjedis intelektual. Nëse doni të dini për opinionin publik për qeverisjen, ju duhet të zgjidhni të anketuar nga të gjitha shtresat e shoqërisë, numerikisht në proporcion me shumësinë e asaj strukture në shoqëri.

Në shoqërinë digjitale, anketa në shtëpi duket diçka tepër klasike dhe e mërziqshme. Anketimi në rrjetet sociale është shumë më i thjeshtë dhe shumë më i lehtë. Por, e ka thembrën e Akilit: sa mund t'u besohet anketimeve online në rrjetet sociale?

Nga ana tjetër, mund të klasifikohen dy lloje të anketave, sipas mënyrës si bëhen pyetjet. E para është **anketa me pyetje të mbyllura** e që përgjigjet duhet të jenë me *"po"*, *"jo"* dhe *"nuk e di"* (i/e pa përcaktuar). Te kjo anketë është e rëndësishme që pyetjet të jenë krejtësisht të sakta, të kuptueshme plotësisht dhe pa kuptime të dyfishta apo pa ekuivok. E dyta është **anketa me pyetje të hapura**, me ç'rast pyetjet i lënë të anketuarit hapësirë të përgjigjet më gjerësisht se te anketa e parë. Një shembull i mirë i këtij tipi të anketës është "Hajt pak" e KTV-së, një emision me kamerë në rrugë ku pyetën qytetarët e rastit për probleme të ndryshme sociale.

Ja një shembull i anketës:

<p>Anketa e ditës</p> <p><b>A besoni në objektivitetin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë?</b></p> <p><i>Qytetarët besojnë në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës. Ata mendojnë se do të ketë paanësi të GjND, sepse Kosova ka mjaft fakte për të mbrojtur pavarësinë e saj.</i></p> <p><b>Lulzim Morina:</b> I besoj Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës. Besoj se do të ketë paanësi nga GjND-ja. Mendoj se Kosova ka plotësuar disa kriteret para se të bëhej shtet. Besoj se pavarësia e saj është e pacenueshme dhe drejtësia do të fitojë.</p> <p><b>Zenel Ramadani:</b> Konsideroj se nuk do të mohohet e drejta për pavarësi, kur dihet se tashmë Kosovën e kanë njohur ndërkombëtarisht shumë vende. Kosova ka argumente të mjaftueshme për të mbrojtë të drejtën për pavarësi, prandaj edhe Gjykata Ndërkombëtare do të vendosë në favorin tonë.</p> <p><b>Sani Berisha:</b> Mendoj se Gjykata Ndërkombëtare e Hagës do të veprojë sipas drejtësisë sepse ka fakte. Është bërë punë shumëvjeçare, sakrificë, por mbi të gjitha Kosovën e kanë njohur edhe shumë vende dhe kjo nuk mund të mohohet. Çdo vend ka të drejtë për të vetëvendosur.</p> <p><b>Naile Luta:</b> Gjykata Ndërkombëtare e Hagës do të punojë drejt sepse ka fakte për të dëshmuar se Kosova ka merituar pavarësinë. Populli ka sakrifikuar shumë, madje janë plotësuar edhe standardet dhe se ka mjaft fakte për të dëshmuar se Kosova ka merituar pavarësinë.</p> <p style="text-align: right;"><i>Kosova sot, 2 Dhjetor 2009</i></p>	<p>Komentet e gazetarit</p>
--	-----------------------------



## XX. DOSJA

## XX.1. NOCIONI DHE QËLLIMI PËRMBAJTJESOR

**F**jala dosje ka hyrë në shqipe prej frëngjishtes *dossier* - deng shkresash e dokumentesh për një person a një ngjarje; ka edhe kuptimin e dy kapakëve brenda të cilëve mbahen shkresa të një natyre. Sot ka të njëjtin kuptim dhe përdoret gjerësisht, si në polici, në politikë, në administratë, në biznes etj. Në traditën policore dosja ka kuptimin përmbledhje shkresash e dokumentesh me elemente biografike për një person a për një ngjarje. Në gazetari fjala ka hyrë nga diskursi policor, por ka marrë tjetër kuptim: dosja gazetares është tekst i gjerë, shumëdimensional, me shumë vija rrëfimi, përmban të dhëna, fakte, elemente, dokumente, fotografi, dëshmi, deklarata etj. për një ngjarje lajmore, për një ngjarje historike, për një person, për një temë apo një shfaqje tjetër me interes publik. Vetë origjina e fjalës nga një objekt ka lënë gjurmë edhe në kuptimin teorik të dosjes: dosja është trajtuar si rubrikë gazetares e jo si zhanër. Ka gazeta që kanë titullin "Dossier", ka rubrika që titullohen "Dossier", në uebfaqe gjeni mjaft "dossier" për tema të ndryshme, por vështirë të gjeni një përkufizim zhanror të nocionit "dossier".

Duke qenë dosja një shfaqje mjaft e përhapur në gazetari, duke qenë vetë teksti i tillë mjaft interesant për lexuesin, ajo është kultivuar si tekst mjaft serioz dhe në gazeta serioze. Me zhvillimin e saj ka marrë disa elemente e karakteristika të përhershme, të cilat e mundësojnë trajtimin e saj si zhanër gazetar.


Qëllimi përmbajtjesor i dosjes është i dyanshëm: së pari, dosja mëton të zbulojë fakte, të vërteta, ngjarje apo individë nga e kaluara e largët apo e afërt, në mënyrë që ta plotësojë mozaikun e njohurive të audiencave bashkëkohore për të kaluarën, për një temë, një ngjarje apo një personazh; së dyti, dosja synon ta zbulojë botën e brendshme të historisë, shpirtin, mendimet dhe ndjenjat e individëve të rëndësishëm të historisë, apo të pjesëmarrësve në ngjarje të rëndësishme historike, si në revolucione, në luftëra, në lëvizje politike, fetare e sociale etj. Që të dy këto synime e krijojnë qëllimin përmbajtjesor të dosjes dhe e bëjnë atë të rëndësishme edhe për gazetarinë bashkëkohore. Mu për këtë qëllim përmbajtjesor dosja çmohet si tekst shumë serioz gazetar, gazetat dhe revistat i kushtojnë rëndësi të madhe, e shkruajnë gazetarë të aftë dhe të profesionalizuar apo edhe ekspertë të fushave të ndryshme, dhe po për këto arsye edhe audiencia është gjithmonë e interesuar për dosjen.

## PËRMBAJTJA

XX. Dosja . . . . .	305
XX.1. Nocioni dhe qëllimi përmbajtjesor . . . . .	305
XX.2. Struktura e përbërë (mozaik) dhe teksti bazik i dosjes . . . . .	306
XX.3. Faktografia . . . . .	308
XX.4. Tema e dosjes . . . . .	310
XX.5. Komete të autorit . . . . .	311
XX.6. Planifikimi i dosjes . . . . .	312
XX.7. Autori apo autorët? Gazetari apo gazetarët? . . . . .	313



Kuptimi i parë i fjalës "dossier".

Memoaret *Dossier K.* e shkrimtarit Imre Kertész (Hungari, 1929), fitues i Çmimit Nobel për Letërsi në vitin 2002.

## XX.2. STRUKTURA E PËRBËRË (MOZAIK) DHE TEKSTI BAZIK I DOSJES

Sado që dosja nuk ka rregulla për një strukturë të qëndrueshme tekstore (si e kanë shumica e zhanreve dhe llojeve gazetare informativë dhe analitikë), megjithatë ajo ka një strukturë të veçantë të tekstit, e cila mund të përkufizohet si ndërlidhje e lirshme e llojeve të ndryshme zhanrore në një tërësi unike. Ka një ndërlidhje të tekstit me fotografinë, me kopjen e një dokumenti, me të dhënat zyrtare, me antërfajll, me një fjalë, struktura e dosjes është një ndërlidhje e pjesëve të ndara e të shkëputura të temës që trajtohet, por që mund të qëndrojnë si një entitet dhe të krijojnë një tërësi të re. Këtë do ta quajmë **strukturë të përbërë**, ose **strukturë mozaik**.

Struktura e përbërë ose mozaik është karakteristika e parë e dosjes. Dosja nuk është një zhanër i pastër gazetar, por një ndërlidhje e disa zhanreve e llojeve në një tërësi funksionale gazetare. Në një dosje mund të ndërlidhen lajmi, raporti, udhëpërshkrimi, intervista, faktet historike, statistika të tjera, të dhëna policore, çështje të politikës e të interesave gjeostrategjike, biografi të individëve dhe fate të grupeve shoqërore, me një fjalë dosja është në vetvete një konglomerat i llojeve gazetare dhe, si e tillë, ajo përmban në vete shumë elemente të shumë zhanreve e llojeve të gazetarisë, zhanre të tjera jogazetare, si ditarë, letra epistolare, poezi apo ndonjë zhanër tjetër letrar etj., elemente të shkencës, të letërsisë dhe nga jeta publike, me një fjalë, çfarëdo teksti, i cilitdo zhanër apo format mund të organizohet në një tërësi të quajtur dosje gazetar, nëse është në funksion të njohjes së më të mirë të temës së trajtuar. Nuk mund të ketë dosje pa këto lloje të ndryshme të gazetarisë të bashkuara në një tërësi. Mund të ketë rrëfim udhëpërshkruesi, apo elemente reportazhi, mund të ketë disa antërfajlla brenda dosjes, mund të ketë disa fotografi, mund të ketë portrete individësh dhe biografite të tyre, mund të ketë citate nga librat apo nga njerëz të gjallë, mund të ketë dialogë, mund të ketë gjuhë metaforike, mund të ketë fleshlajme, mund të ketë një intervistë etj., por ato të gjitha duhet të lidhen ndërmjet tyre në atë mënyrë që t'i japin tërësisë funksionalitetin unik, si dosje. Struktura e dosjes, si shihet, është heterogjene në kuptimin e elementeve përbërëse zhanrore, është e tipit përbërës, pra mozaik. Sikurse struktura e gurëve gëlqerorë, të cilët janë të përbërë prej shtresave të ndryshme, për dallim nga gurët vullkanikë, të cilët janë të përbërë prej një pjese unike. Ashtu edhe dosja është e përbërë prej shumë elementeve, prej shumë zhanreve e llojeve gazetare, por ajo ka një strukturë lidhjeje ndërmjet të gjitha këtyre pjesëve të saj dhe pikërisht ky fakt e bën atë lloj zhanror, dhe pikërisht ky heterogjenitet është vetia më karakteristike e dosjes.

Këto shtresa të llojeve të ndryshme gazetare nuk ndërlihen midis tyre vetvetiu. Dhe po të mos ishin të lidhura ato nuk do të përbënin një tërësi unike, por një grumbull jounik. Mund të grumbulloni brenda dy kapakëve shkrime të ndryshme të gazetës, dokumente të ndryshme, fotografi, ndonjë shënim etj., dhe ju keni bërë një dosje administrative, por jo një dosje gazete. Dosja gazetare ka një lidhje të brendshme tejprtej. Është **teksti bazik**, është rëfimi themeltar, është teksti bazament ajo forca tërheqëse që mban rreth vetes pjesët përbërëse të dosjes. Çdo dosje ka një tekst bazik, ai që përbën bërthamën e dosjes, dhe rreth tij mund të ndërtohen edhe tekste të tjera, lloje të ndryshme tekstesh e zhanresh gazetare dhe jogazetare, po gjithnjë teksti bazik përbën fillin e rëfimitin e gjithë dosjes. Teksti bazik është homogjen dhe unik në vetvete. Ai ka një fillim dhe një përfundim. Heterogjeniteti i dosjes, i krijuar prej formave e llojeve të ndryshme gazetare, mbizotërohet nga homogjeniteti i tekstit bazik. Nuk mund të ketë dosje pa një tekst bazik (ashtu si nuk mund të ketë dosje pa lloje të ndryshme gazetare në një tërësi). Teksti pa këto lloje të ndryshme gazetare mund të jetë raport, fejtton etj., por jo dosje, ashtu sikurse teksti pa tekstin bazik mund të jetë grumbull faktesh po jo dosje.

Nuk ka një rregull se cili element gazetar apo cili lloj gazetar duhet të mbizotërojë në një dosje. Kjo i mbetet afinitetit dhe përcaktimit të vetë autorit. Dhe autori e bën këtë përcaktim varësisht nga faktet që disponon. Nëse një gazetar përgatit një dosje për ish të burgosurit politikë shqiptarë në burgjet jugosllave, nuk mund t'u ikën, p.sh., poezive që kanë shkruar të burgosurit, ose letrave që kanë dërguar në shtëpi, vizatimeve apo këngëve që kanë kënduar, pastaj dokumenteve gjyqësore dhe të cilat ruajnë dënimet e tyre, nuk mund t'u iket familjeve të tyre dhe vizitat që ata kanë bërë, nuk shmangen dot fjalimet politike në forumet më të larta jugosllave kundër tyre etj., mirëpo në themel të një dosje të tillë, teksti bazik i saj, do të duhej të ishte një rëfim për jetën e tyre me një pikë nisëse dhe përfunduese. Të gjitha të tjerat luajnë rolin e elementëve shtesë, por teksti bazik është trari që i mban të lidhura për vete pjesët e tjera.



Teksti bazik në dosje është sikurse teksti në imazhin e mësipërm: ka disa fjalë që e mbizotërojnë tekstin dhe sapo t'i hedhim sytë i vërejmë. Ka edhe fjalë të tjera për të cilat nuk jemi të vëmendshëm menjëherë.



Një pamje e cila mund të krijojë idenë e dosjes: copa gazetash të cilat flasin për vdekjen e poetit amerikan Edgar Allan Po



Kulla e Sali Manit, në Bujan të Shqipërisë, aty ku u mbajt Konferenca e Bujanit



Libri *Letra nga burgu: libri i censuruar* (2004), i përgatitur nga Merxhan Avdyli e Bajram Kosumi, i cili përmban letrat e 39 të burgosurve politikë shqiptarë pas revolucionit të vitit 1981, e të cilët vuajtën vite të gjata burgime nëpër burgjet e Jugosllavisë. Shumica e këtyre të burgosurve kanë lënë gjurmë të dukshme në historinë e re të Kosovës: disa janë heronj, disa dëshmorë, e disa kanë udhëhequr Kosovën apo procese të rëndësishme të Kosovës. Të gjitha letrat e pëmbledhura në këtë antologji kanë kaluar procedurën e censurimit në administratën e burgut, prandaj edhe libri e ka nëntitullin "Libri i censuruar". Kjo ua shton edhe më shumë vlerën letrave dhe librit.

### XX.3. FAKTOGRAFIA

Karakteristika e dytë e dosjes është faktografia. Si në asnjë zhanër tjetër gazetar, në dosje duhet të ketë fakte që argumentojnë të dhënat e gazetarit apo të dhënat e personazheve të dosjes si dhe fakte që ilustrojnë të dhënat, qoftë edhe të zakonshme, të dosjes. Faktet mund të jenë të të gjitha llojeve: fakte historike, fakte policore, fakte politike etj., varësisht nga tema që trajtohet edhe gama e fakteve ndryshon. Gazetari i gjen dhe i sjell faktet në dosje dhe bën komentimin e tyre, për ta krijuar kuptimin sa më të plotë për temën që trajton. Faktet marrin rol sepse dosja shkruhet për një temë për të cilën pak a shumë audienca ka një informacion, prandaj gazetari duhet të sjellë fakte të reja dhe të sjellë dokumente, fotografi, harta etj. që ilustrojnë të dhënat e dosjes. Për këtë arsye autorët e dosjeve janë pothuajse gjithmonë gazetarë me përvojë të madhe, asi që dinë ku të hulumtojnë dhe ku të kërkojnë informacione. Nëse kemi të bëjmë me një dosje historike aty marrin rol parësor faktet historike, kryesisht të panjohura sa duhet ose të panjohura fare nga lexuesi. Natyrisht që aty do të ketë deklarata të historianëve, fotokopje të dokumenteve të ndryshme historike, por të gjitha këto janë fakte materiale të cilat gazetari duhet t'i kërkojë e t'i gjejë dhe t'i interpretojë. Kështu p.sh., nëse gazetari përgatit dosjen për Konferencën e Bujanit, faksimilja e deklaratës së Bujanit do të ishte e domosdoshme. Ose, nëse shkruan një dosje për demonstratat e vitit 1981, atëherë ai duhet të gjejë fotografi nga demonstratat, fotografi të organizatorëve, biografite e heronjve të rënë në demonstrata, letrat që kanë shkruar të burgosurit nga burgjet etj.

Gazetari apo shkencë? Roli kaq i madh i fakteve të bën të dyshosh në cilësinë zhanrore të dosjes: a është dosja tekst gazetar apo shkencë? Autori i dosjes, sikurse një historian, interesohet për faktet historike, për arkivat, për shfletimin e shtypit të vjetër, për hulumtimin e dosjeve të policisë e të gjykatave etj., por ai nuk mjaftohet vetëm me faktet e vërtetuara empirike sikurse historia. Ai i përdor faktet historike dhe kapërcen përtej tyre, interesohet edhe për botën subjektive, për aspektin emocional të personazheve të tij, për ndijimet dhe cilësinë e përjetimeve (dhimbjeve apo gëzimeve) të tyre, e këto të fundit nuk paraqesin asnjë rëndësi për historianin. Nëse një historian trajton vdekjen e Napoleon Bonapartës, ai interesohet për rrethanat, për vendin, për kohën dhe për mënyrën se si vdes Bonaparta. Ndërsa gazetari trajton në dosje vdekjen e Bonapartës, përveç fakteve historike, ai interesohet për përjetimet e fundit të Bonapartës, e ka ditur apo jo ai se do të vdesë i helmuar nga vera, apo ka qenë vërtet i helmuar nga vera, është pajtuar apo jo me atë vdekje, ka qenë e rëndë, e papërballueshme apo e tmerrshme ajo vdekje etj.



Nga kjo që u tha për interesimin e një historiani dhe të gazetarit në dosje, nxjerrim dy përfundime. Së pari, autori i dosjes, krahas një fakti shumë të rëndësishëm historik, mund ta sjellë një deklaratë krejt emocionale të një personazhi, një përjetim krejt subjektiv të personazhit tjetër dhe kjo e largon dosjen nga historia dhe e kthen në truallin e pastër të gazetarisë. Kështu, në diçiturë të faksimiles të Rezolutës së Bujanit gazetari mund të vërë një deklaratë të ndonjë personi që e ka përjetuar atë Rezolutë, në të cilën ai thotë: "Ah! Sa gëzim patëm kur u miratua rezoluta!" Për këtë fjali historiani nuk interesohet, ndërsa në dosje pikërisht kjo fjali dhe të tjera si këto kanë peshën kryesore dhe shprehin kuptimin themelor të dosjes. Së dyti: në dosje trajtohen edhe çështjet nga e kaluara për të cilat historia nuk interesohet, për personazhe e tema me të cilat nuk merret historia, apo për detaje të çfarëdo natyre të cilat mbesin jashtë kopertinave të cilësdo histori. Te shembulli i Bonapartës, në dosje mund të trajtohet fakti se çfarë vere ka qenë ajo të cilën e ka pirë Bonaparta dhe që është helmuar etj., fakt ky krejt i parëndësishëm për historianin.

## The Death of Napoleon Bonaparte: A Critical Review of the Cause

J. THOMAS HINDMARSH and PHILIP F. CORSO



**N**APOLEON Bonaparte died on the island of St. Helena on 5 May 1821, aged fifty-one years, from carcinoma of the stomach, probably complicated by hematemesis. Eight physicians attended the autopsy: Drs. Francesco Antommarchi, Archibald Arnott, Francis Burton, Walter Henry, Matthew Livingstone, Charles Mitchell, George Rutledge, and Thomas Shortt. Three reports of their postmortem findings have survived. Francesco Antommarchi, an anatomist and pathologist, observed that:

The stomach appeared at first site in a perfectly healthy state; no trace of irritation or phlogosis [inflammation] and the peritoneal membrane exhib-

Lajmi për vdekjen e  
Bonapartës

Derisa dosja ka nevojë të madhe për fakte, gazetari duhet t'i përvishet gazetarisë hetuese, gazetarisë së saktë dhe disa metodave shkencore për t'i mbledhur materialet. Nuk mund të ketë dosje të mirë pa hulumtim të thellë dhe pa fakte të rëndësishme. Hulumtimi i fakteve, qofshin historike apo të aktualitetit, gjurmimi nëpër dosje të policisë, nëpër gjykata, shfletimi i literaturës për temën në shqyrtim, gjetja e fotografive origjinale etj., të gjitha këto janë vegla pune të një historiani, apo të një sociologu që bën një hulumtim. Kjo është e vërtetë.

Por ky fakt nuk e bën dosjen histori. Ky fakt, si pamë, e ofron dosjen me historinë, por në të njëjtën kohë e mban në distancë. Gazetari në një pjesë të punës vepron si historian, por nuk mjaftohet me të qenët historian, sepse ai nuk gjurmon rindërtimin e fakteve historike, por prezantimin e një ngjarjeje apo të një personaliteti nga e kaluara para audiencës bashkëkohore. Puna e historianit për gazetarin në dosje është vetëm një pjesë e punës dhe e prodhimit të tij.

Mund të shtrohet edhe pyetja e dallimit ndërmjet dosjes dhe fejttonit, duke qenë se edhe fejtoni trajton tema të ngjashme nga historia. Dallimi është i qartë: fejtoni trajton cilëndo temë historike apo nga aktualiteti në rrjedhën e saj kronologjike si një rrëfim të pashkëputshëm dhe qëllimi përmbajtjesor i saj është vetëm popullarizimi i temës, ndërsa dosja mund ta trajtojë të njëjtën temë dhe ta pasurojë rrëfimin me elemente të tjera gazetare dhe jogazetare në një strukturë të dekompozuar dhe qëllimi i saj përmbajtjesor është popullarizimi i temës dhe hulumtimi i fakteve të reja rreth asaj teme, apo edhe mbyllja e dyshimeve të mbetura nga historia në lidhje me atë temë.

## XX.4. TEMA E DOSJES

Nuk ka një rregull se cilat tema mund të trajtohen në dosje. Por janë disa parakushte të cilat bëjnë të mundshme një klasifikim të mash për dosjen. Së pari, një ngjarje apo një personalitet pa ndikim nuk mund të jenë temë e dosjes. Së dyti, një temë apo një personalitet krejtësisht i panjohur për opinionin publik nuk mund të jetë temë e dosjes. Kjo e fundit mund të jetë një aferë, një zbulim apo një tekst që zë faqen e parë të gazetës, por jo një dosje. Zbulimi i një planeti të ri të ngjashëm me tokën që kanë proklamuar astronomët amerikanë në vitin 2009 nuk mund të jetë temë e dosjes. Së treti, tema që është shumë e njohur nuk mund të jetë temë e dosjes. P.sh., tema "Si u shpall pavarësia e Kosovës" nuk mund të jetë temë e dosjes. Por, nëse gazetari sjell fakte interesante, për të cilat historia nuk interesohet (në çfarë letre u shkrua Deklarata e Pavarësisë?, me çfarë penë nënshkruan deputetët?, çfarë biseduan deputetët paradite në pritje të çastit historik? etj.), atëherë ai mund ta trajtojë këtë temë në dosje, vetëm se në aspektin e dytë, në atë për të cilin nuk interesohet historia. Dhe, së katërti, tema që nuk paraqet interes publik nuk mund të jetë temë e dosjes. Zbulimi i një formule për një lëndë kimike që përdoret në industrinë e poliesterit nuk mund të jetë temë e dosjes. Nëse bashkojmë mohimet e mësipërme për të bërë një pohim të përgjithshëm, atëherë mund të përfundojmë se:

*tema që trajtohet në dosje duhet të jetë ngjarje apo personalitet i rëndësishëm për shoqërinë apo për historinë; duhet të jetë ngjarje a personalitet për të cilin publiku di, por nuk ka informacion të plotë dhe, së fundi, tema apo personi paraqesin interes publik.*

Po ashtu, nuk ka një rregull në zgjedhjen e motiveve tematike: dosja mund të trajtojë tema nga cilado fushë e aktivitetit njerëzor, por më të shpeshta janë temat nga e kaluara historike, politike, etnike, fetare etj. Mbizotërojnë edhe temat sociale, tema nga luftërat, nga konfliktet, tema për problemet e një shoqërie, por edhe tema të jashtëzakonshme për një person të rëndësishëm.

Në dosje autori e trajton temën e tij në tërë gamën e saj, në tërë gjerësinë dhe thellësinë e saj. Ai sjell të dhëna nga aktualiteti i temës, por s'ndalet me kaq: sjell të dhëna edhe nga historia e temës dhe i trajton ato gjerësisht. Në një dosje autori jep gjithë të dhënat që ai i konsideron të domosdoshme për lexuesin si dhe mendimet e komentet e tij për cilindo fakt që sjell. Por, ai nuk jep vlerësimin përfundimtar për temën që trajton: ai jep vetëm tërësinë e temës, në mënyrë që lexuesi ta shohë ndërlikueshmërinë e saj dhe ta krijojë përshtypjen dhe vlerësimin e tij për temën duke pasur parasysh këtë ndërlikueshmëri të vetë temës.

Zakonisht në dosje trajtohen tema të së kaluarës. Ndodh që trajtohen tema që vazhdojnë që nga e kaluara, por ende nuk kanë përfunduar. Kështu, mund të bëni një dosje për gjakmarrjen të shqiptarët, një zakon ky shumë i lashtë, por që ende funksionon në shoqërinë gjysmëmoderne shqiptare. Por, si kemi thënë në fillim, një ndodhi krejt e re nuk mund të jetë temë e dosjes, sepse para se të jetë dosje ai është lajm, raport etj.

## XX.5. KOMENTE TË AUTORIT

Duke qenë dosja një ndërlidhje e shumë llojeve gazetare, kjo i mundëson autorit që edhe ai të jetë i pranishëm në tekst. Autori mund të jetë i pranishëm për t'i komentuar dhe interpretuar të dhënat që sjell, mund të jetë i pranishëm për të treguar se si ka ardhur deri te të dhënat (nëse kjo paraqet interes), për të dhënë ndonjë përfundim të tij apo, thjesht, dosja mund të jetë një rrëfim në vetën e parë. Ky element i fundit e afron dosjen me gazetarinë letrare. Ndërsa komentimi i fakteve dhe interpretimi i tyre që bëhet nga ana e gazetarit e lidh dosjen me gazetarinë analitike.

Ja se si Gazmend A. Baku e fillon dosjen "Shkëlqimi dhe rënia e 'oxhaqeve'"<sup>60</sup>:

Autori mund të jetë i pranishëm për t'i komentuar dhe interpretuar të dhënat që sjell, mund të jetë i pranishëm për të treguar se si ka ardhur deri te të dhënat (nëse kjo paraqet interes), për të dhënë ndonjë përfundim të tij apo, thjesht, dosja mund të jetë një rrëfim në vetën e parë.





“Të pasurit, bejlerët e agallarët ishin gjakpirësit e popullit”, mbaj mend se na mësonte mesuesja e historisë në 8-vjeçarë, “por populli, me në krye Partinë e shokun Enver, ua shtypën kokën”. Mësuesja e mjerë ishte e detyruar të na citonte variantin zyrtar të historisë (propagandës), të sajuar sipas porosive të udheheqësit. Por, jfare ishin këta bejlerë, pashallarë dhe shtresa e pasur në përgjithësi, që u përmbys në agim të rendit të ri? Përgjigja e kësaj pyetje nuk është e lehtë dhe as mund të ezaurohet me një shkrim. Sidoqoftë, ne do të provojmë duke u nisur nga më larg. Në shekujt XII-XIII dhe më pas, janë të përmendura familjet e mëdha dhe të fuqishme, katolike, të Skurajve, Topiajve, Kastriotëve, Balshajve, Muzakajve, etj. Pinjollë nga këto familje fisnike qeverisën për shekuj trojet tona, dhe luajtën një rol të lavdishëm, në luftën kundër pushtuesve turq. Me rënien e Shqipërisë nën pushtetin osman, këto familje fisnike tretën në errësirën e historisë dhe, një shtresë e re fisnike u ngrit, aty këtu, ndoshta, edhe me pasardhës të këtyre familjeve.

Autori mund të jetë edhe personazh i dosjes. Natyrisht, jo i kohës së temës së dosjes, por si shkruer i dosjes. Ja se si gazetari i sipërpërmendur Bakiu e ndërfitë veten në ngjarjet e dosjes së tij:

Jo pak bejlerë e pashallarë shqiptarë, në saje të lidhjeve, shërbimeve dhe zotësisë së tyre, arritën të fitojnë pozita drejtuese në Perandorinë Osmane. Kjo do të bënte, që para do kohësh, një turk të më thonte, gjysmë me shaka dhe gjysmë seriozisht, se “nuk ju kemi sunduar ne ju, por ju ne”.

## XX.6. PLANIFIKIMI I DOSJES

Planifikimi i dosjes duket një punë teknike, por nuk është e tillë. Planifikimi më tepër ka të bëjë me strukturën sesa me çështjet teknike. Zakonisht dosja është një tekst i gjatë, mund të jetë deri në disa faqe gazete, dhe ky tekst i gjatë duhet strukturuar mirë, elementet që janë jashtë tekstit bazik duhen strukturuar mirë në mënyrë që ato (elementet) të kenë midis tyre përpjesëtim dhe të mos kundërshtohen me tekstin bazik. Se ku vendoset një dialog, një letër, një faksimile fakti, një intervistë e shkurtër, fotografia, apo një faksimile gazete, kjo është detyrë e autorit për ta strukturuar dosjen.

Mund ta ketë këtu një ndikim edhe redaktori, i cili mund të ndërhyjë në këtë strukturim, duke e konsideruar këtë si punë teknike dhe redaktoriale por, pavarësisht nga kjo, ky strukturim është thjesht çështje e strukturës së dosjes, pra çështje e zhanrit dhe jo një punë teknike dhe redaktoriale.

## XX.7. AUTORI APO AUTORËT? GAZETARI APO GAZETARËT?

Dosja mund të ketë një apo më shumë autorë. Zakonisht ka më shumë autorë, sepse si kemi parë deri më tash, duke qenë një tekst i gjerë dhe shumë serioz, i mbushur me fakte dhe elemente të ndryshme tekstore, është më lehtë që atë ta punojnë më shumë se një autor. Autorët mund të punojnë ndaras në pjesë të ndryshme të dosjes (njëri hulumton në arkivin e policisë, p.sh. e tjetri mbledh deklarata të personave të ndryshëm), por në fund i unifikojnë të dhënat e tyre në tekstin unik.

Ja një dosje e revistës “Klan”, shkruar nga Albert Kotini ([www.revistaklan.com](http://www.revistaklan.com)), për vrasjen e Hasan Prishtinës. Kjo është një prej vrasjeve më të turpshme në historinë shqiptare, e bërë nga njerëzit e mbretit të Shqipërisë, z. Ahmet Zogu. Historia i di fare mirë hollësitë e vrasjes, edhe pse nga disa historianë është krijuar një gjurmë dyshimi duke e paraqitur këtë vrasje thjesht si një rivalitet të egër midis dy politikanëve. Edhe autori i dosjes niset nga kjo tezë.





## XXI. LETRA NGA LEXUESIT

### PËRMBAJTJA

XXI. Letra nga lexuesit 315

XXI.1. Letrat e lexuesve 315

XXI.2. Letra e hapur . 316

### XXI.1. LETRAT E LEXUESVE

**K**ëtë lloj teksti Boriçi e quan “letra në redaksi”. Trajtohet si lloj më vete, i cili ka lindur nga praktika e bashkëpunimit të gazetave me lexuesit e tyre. Gazetat kanë pasur përherë interes të informohen edhe për opinionin e lexuesve, qoftë për vetë gazetën, qoftë edhe për probleme të ndryshme shoqërore, politike, morale, kulturore apo administrative. Ato kanë hapur faqet e tyre dhe kanë botuar aty letra të tilla. Me kohë shkrimi i këtyre letrave është pasuruar me larmi të madhe temash dhe është shndërruar në lloj të mëvetësishëm gazetar. Letra e tillë shkruhet nga cilido lexues i gazetës, pavarësisht nga profesioni, nga statusi shoqëror apo kulturor. Ajo trajtohet si letër private, e hapur për publikun, në të cilën shkruesi trajton cilëndo çështje nga jeta publike, por edhe nga jeta private e deri edhe te tema akademike e teorike, por me kusht që tema e tillë të ketë rëndësi për opinionin publik.

Letrat e tilla publikohen nga disa në një faqe ose në një pjesë të faqes së gazetës, me një mbititull të përbashkët: letra nga lexuesit, letra nga publiku, letra në redaksi etj. Nëse letra e tillë ka një përmbajtje më të lartë e më të thellë se përditshmëria, disa gazeta i botojnë ato në rubrika “më prestigjioze” të quajtura “opinione”. Secilës letër redaksia mund t’ia vërë edhe nga një titull, i cili duhet ta shprehë esencën e letrës. Redaksia kryen detyrën e saj në zgjedhjen e letrave që do të botohen. Ajo hulumton, në radhë të parë, temat me interes për publikun. Nëse letra trajton një temë të rëndësishme, por nuk është shkruar në nivelin e pranueshëm, redaksia kontakton autorin dhe i kërkon ta korrigjojë, ose cakton një gazetar i cili bashkë me autorin e rishkruajnë letrën. Në rast se letra e caktuar nuk botohet, është mirë, për prestigjin e gazetës, t’ia kthejë një përgjigje autorit. Pavarësisht nga botimi, nga redaktimi, nga adresimi etj., gazeta nuk mban përgjegjësi për letra të tilla. Disa gazeta, për të evituar çfarëdo keqkuptimi, në krye apo në fund të rubrikave të tilla e vënë distancimin: “Opinionet e paraqitura në këtë rubrikë nuk janë të redaksisë”. Para botimit, redaksia duhet të interesohet për vërtetësinë e fakteve të shkruara në letër. Nëse në letër prezantohen fakte të paqëndrueshme dhe gazeta e boton atë letër, kjo rrezikon gazetën ta humbasë besimin e lexuesve, por nuk tërheq pas vetes përgjegjësi juridike.

Ani pse letra i drejtohet redaksisë së gazetës, në fakt adresa e vërtetë e letrës është audienca dhe ndikimi qoftë i opinionit publik

apo i një grupi të veçantë a institucioni të veçantë. Ky edhe është qëllimi përmbajtjesor i kësaj letre: informimi i publikut me një temë, një çështje a një ngjarje e cila është e panjohur për të, ose njoftimi i publikut me mendimet, veprime apo ndonjë nismë të një grupi social. Karakteristika themelore e strukturës së kësaj letre është: thjeshtësia e paraqitjes së temës dhe fakteve që argumentojnë qëndrimet e shkruarit.

Sado duket pa ndikim, në të vërtetë letrat e tilla, kur janë të nivelit të lakmuar, e ngjallin shumë kureshtjen e lexuesit dhe e rritin rejtingun e gazetës. Por, ndodh krejt e kundërta nëse gazeta boton letra të tilla me tema pa peshë publike. Kjo është arsyeja pse gazetat jo vetëm botojnë, por edhe nxisin lexuesit, ndonjëherë edhe “lexuesit e veçantë”, për të shkruar letra të tilla.

## **XXI.2. LETRA E HAPUR**

Letra e hapur padyshim është forma më autoritative e letrave nga lexuesit. Është e tillë sepse në të trajtohen zakonisht çështje të rangut më të lartë publik, si: tema nga politika, nga qeverisja, tema aktuale nga kultura e artet, apo tema për shfaqje shoqërore që lënë gjurmë në shoqëri. Po ashtu, janë autoritative edhe për shkak të autorit: zakonisht autorë të letrave të hapura janë persona me ndikim në shoqëri, kryesisht ata të shoqërisë civile dhe të botës së kulturës.

Tema e këtyre letrave nuk është e kufizuar: mund të jenë edhe tema nga jeta private, me kusht që motivi i trajtuar të mos jetë mesatar, por të jetë i veçantë. Nuk ka një rregull në mbarështrimin e strukturës së letrës së hapur, por në ligjërimin e vet ky tekst është ligjërim kundërshtues, polemizues, refuzues por edhe këshillues. Kjo për arsye se letra e hapur edhe shkruhet për të kundërshtuar, për të refuzuar apo për të shfaqur një mospajtim publik, në njëerë dhe, për të këshilluar apo udhëzuar dikë se si duhet vepruar apo nuk duhet vepruar, në anën tjetër. Zakonisht kjo bëhet për ngjarje apo për koncepte politike me ndikim në shoqëri, e të cilat kanë përkrahës të shumtë, ose në rastin më të shpeshtë kanë përkrahës qeverinë, një parti politike apo një institucion tjetër. Kundërshtari është i aq i fortë sa që individi nuk gjen tjetër rrugë të kundërshtimit vetëm përmes deklarimit publik, përmes tendencës publik për të parandaluar, kundërshtuar apo diskredituar veprimin apo konceptin kundërshtar. Ky edhe është qëllimi përmbajtjesor i këtyre letrave: kundërshtimi ose diskreditimi i një ngjarjeje, koncepti, individi të fuqishëm apo një grupi të fuqishëm publik.

Qoftë për shkak të temës, të autorit apo edhe të ligjërimit polemist, letrat e tilla lexohen me interesim të madh dhe komentohen në opinionin publik, mund të nxisin edhe reagime të tjera të personave të tjerë, mund të ngjallin debat publik.

Në kulturën shqipe janë shkruar mjaft letra të hapura, sidomos në fillimshkullin dhe në fundshkullin XX. Duke qenë një letër e hapur, demokratike, që sjell mendimin e personave nga populli, natyrisht në periudha të medias së shtypur e të kontrolluar nga pushteti, ky lloj i shkrimit nuk zhvillohet në rrethana të tilla. Të njohura në Kosovë janë letrat e hapura polemiste të Rexhep Qosjes me intelektualë serbë që i shërbenin pushtetit në Beograd, pas vitit 1981.

[Letters to the Editor](#)

**THE U.S. SHOULD TAKE A LEADING ROLE IN THE EUROPEAN MIGRANT CRISIS**

August 30, 2015, at 7:47 PM

Regarding the Aug. 28 front-page article "[Decayed bodies found in truck](#)": As European leaders struggle to deal with the immigrant crisis, why can't the United States step up and lead? This nation was founded by immigrants who had enough of life under a tyrant. Now, much of the Middle East sees us as tyrants.

Our naval fleet could pick up thousands of people and take them to safety, away from the ravages of war and terrorism, and bring them here. We could build refugee camps to house them initially. We could weed out the bad actors. We could motivate people all over the country to sponsor groups who would relocate to their areas. What we would get in return is gratitude. That would make it harder for Islamic extremists to portray the United States as the enemy.

It will cost money, yes. It would have cost money in the early 1940s to bring millions of Jews to the United States when they were being "relocated" by the Nazis. But it would have been the right thing to do. For those who see "immigrant" as a dirty word — those who forget that almost all of us once were immigrants to this land — look at it this way: The world is a dangerous place, and much of it hates us now. How much do we already spend on national defense? This would make us safer. What price shall we put on that?

Robert G. Brown, Lovettsville

### Lexime të mëtejme:

1. Sally Adams & Wynford Hicks, *Interviewing for Journalists*, Routledge, 2005 (First published 2001).
2. Melvin Mencher, *Shkrimi dhe raportimi i lajmit*, (kapitulli 14 dhe 15, fq. 315-361.)
3. Hamit Boriçi, *Gazetaria 2*, (kapitulli VII).
4. Paul Chantler and Peter Stewart, *How to win friends and interview people?*, (Basic Radio Journalism (Focal Press), Posted on [bbctraining.com](http://bbctraining.com).)
5. *Ten Tips for a better Interview*, (International Center for Journalists, October 2, 2007, [www.icfj.org](http://www.icfj.org).)
6. *15 këshilla për intervistë*, (Manual për gazetarët e Europës Qendrore dhe Lindore, redaktuar nga Malcolm F. Mallet, Dituria, 2003, fq. 16-17.)
7. Greg McLachlan, *20 Tips for beter Interviewing*, (version elektronik).
8. Analiza e Noam Chomsky-t **Towards a Second Cold War?** për luftën ruso-gjeorgjiane në Oseti dhe pasojat e ndikimi i saj në rendin botëror. [www.counterpunch.com](http://www.counterpunch.com). Analiza është botuar edhe në KOHA DITORE, 16 shtator 2008, nr. 4045.
9. Eduard Zoloshnja, *Qeveri e merituar?*, 11/11/2009, Shekulli, [www.shekulli.com.al](http://www.shekulli.com.al)
10. Aleksandër Çipa, *Duhet kahu tjetër*, në [www.albinformacion.com](http://www.albinformacion.com)
11. Arbër Vllahu, *Vendosja e EULEX-it ende në dilemë*, [www.BBCalbanian.com](http://www.BBCalbanian.com)
12. Malcolm Haslett, *Ka ndryshim Abhazia nga Kosova?*, [www.BBCalbanian.com](http://www.BBCalbanian.com)
13. *Hapja e arkivave në ish vendet komuniste*, Pa autor, [www.BBCalbanian.com](http://www.BBCalbanian.com)

## BIBLIOGRAFIA (KAPITULLI III)

### LIBRA DHE ARTIKUJ TË CITUAR:

- Boriçi, Hamit, *Gazetaria 2: probleme të mjeshtërisë dhe format e pasqyrimit publicistik*, SHBLU, Tiranë, 2004.
- Kovach, Bill & Rosenstiel, Tim, *Elementët e gazetarisë: çfarë duhet të dinë gazetarët dhe çfarë duhet të kërkojë publiku*, ISHM, Tiranë, 2009 (botim i parë 2001).
- Manual për gazetarët e Europës Qendrore dhe Lindore*, "Dituria", 2003, grup autorësh, edituar nga Malcolm F. Mallette.
- Meksi, Aleksandër, *Përmes fjalës së tij*, Shtëpia botuese Luarasi, Tiranë, 1997.
- Mencher, Melvin, *Raportimi dhe shkrimi i lajmeve*, WCB, botim i pestë, fq. 106-108.
- Obradović, Đorđe, "Kolumne nisu novinski rod", *Medianali*, Vol. 2, No. 3, Veljaca 2008, fq. 13-38, në [www.hrcak.srce.hr/medianali](http://www.hrcak.srce.hr/medianali)
- Paul Chantler and Peter Stewart, *How to win friends and interview people?*, (Basic Radio Journalism (Focal Press), Posted on [bbctraining.com](http://bbctraining.com).)
- Randall, David, *Gazetari universal*, ISHM, Tiranë, 2003.
- Rečnik književnih termina*, Nolit, Beograd, 1992.



**ARTIKUJ GAZETASH DHE EMISIONE TË CITUARA:**

- Aleksandër Çipa, *Duhet kahu tjetër*, në [www.albinformacion.com](http://www.albinformacion.com)  
*Drita*, Sofje, nr. 97. 1 shkurt 1908, autori: Lap Matrallozi. Cituar nga *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, vëllimi I, 1879-1908, Tiranë 1971, fq. 79-82.
- Eduard Zaloshnja, "Qeveri e merituar?", 11/11/2009, *Shekulli*, [www.shekulli.com.al/](http://www.shekulli.com.al/)  
*Express*, 10 shkurt 2011.  
*Express*, 12 janar 2010.  
*Express*, 9 mars 2010.  
*Hylli i Dritës*, 1934, nr. 6. fq. 265-272.  
*Hylli i Dritës*, vjeta VIII, nr. 1, kallnduer 1932, fq. 1-4.  
Jeffrey D. Sachs, "Politika klimatike e "Mbretit thëngjill", *Koha ditore*, e enjte . 22 tetor 2009  
*Koha ditore*, 10 shkurt 2011.  
*Koha ditore*, 10 shkurt 2011.  
*Koha ditore*, 10 shkurt 2011.  
*Koha ditore*, 18 tetor 2009.  
*Koha ditore*, 27 shkurt 2009.  
*Kosova sot*, 10 shkurt 2011.  
*Kosova sot*, 10 shkurt 2011.  
RTK, emisioni "Pa rrotulla", 12 shtator 2010.  
*The Independent*, botuar edhe në *Express*, 2 shkurt 2011.  
*The Wall Street Journal*, 8 February 2011, Denis Mac Shane, "Smearing Hashim Thaci".  
[www.gazeta-shqip.com](http://www.gazeta-shqip.com), më 18.11.2009.  
[www.TanPortal.com](http://www.TanPortal.com), 14 tetor 2004.  
[www.revistaklan.com](http://www.revistaklan.com)

## Shënime

- 1 *Koha ditore*, 27 shkurt 2009.
- 2 *Express*, 12 janar 2010.
- 3 *Express*, 9 mars 2010.
- 4 *Manual për gazetarët e Europës Qendrore...*, red. nga M. F. Mallet, Dituria, 2003, fq. 70.
- 5 *Manual për gazetarët e Europës Qendrore dhe...*, red. nga M. F. Mallet, Dituria, 2003, fq. 70.
- 6 *Manual për gazetarët e Europës Qendrore dhe...*, red. nga M. F. Mallet, Dituria, 2003, fq. 70.
- 7 Ja një rast i tillë, i Jay Robert Nash, në librin *Makers and Breakers in Chicago* (1985), cituar këtu sipas David Randallit, *Gazetari universal*, fq. 199:  
 "Disa gazeta të mëdha kanë specialistë që paguhen vetëm për të shkruar editorialë. Te *Daily News* e Çikagos kjo dha shkas për një nga rregjet më të bukura të gazetarëve. Gazeta, që njihej për tonet e larta moralizuese të editorialëve të saj, ftonte rregullisht grupe lexuesish për të parë mjediset e punës. Duke e ditur që më parë orën e njerit prej këtyre takimeve, reporteri Juxhin Fild, më vonë poet, së bashku me një anëtar të stafit që shërbente si ciceron për lexuesit, kurdisën një plan. Me të hapur derën ku shkruhej "Editorialistët", ciceroni i prezantoi krye-infermieret e qytetit me shëmbëlltëyrën e një njeriu që rinte ulur në tryezë dhe hartonte një nga editorialët e devotshëm të gazetës. Ishte Fildi, i paruar e i shtrembëruar, veshur me uniformën e të dënuarit, lidhur me zinxhirë e gjyle. "Ky është një i besuar nga burgu lokal, ka rënë për vrasje", shpjegoi ciceroni. "Kryredaktori ynë, z. Stoun, është shumë dorështrënguar. Mendon vazhdimisht për shpenzimet e gazetës dhe shfrytëzoi ndikimin e tij për ta tërhequr një herë në javë këtë krijesë. Editorialist i lirë, e kuptoni? S'na kushton asnjë qindarkë."
- 8 *Manual për gazetarët e Europës Qendrore dhe ...*, red. nga M. F. Mallet, Dituria, 2003, fq. 72.
- 9 Të gjithë titujt janë marrë nga gazeta *Zëri* në periudhën shtator 2007-shkurt 2008.
- 10 Boriçi, *Gazetaria 2*, fq. 209.
- 11 Boriçi, *Gazetaria 2*, fq. 77.
- 12 Boriçi, *Gazetaria 2*, fq. 206.
- 13 Boriçi, *Gazetaria 2*, fq. 208.
- 14 *Kosova sot*, 10 shkurt 2011.
- 15 *The Wall Street Journal*, 8 February 2011, Denis Mac Shane, "Smearing Hashim Thaci".
- 16 *Koha ditore*, 18 tetor 2009.
- 17 *Koha ditore*, 10 shkurt 2011.
- 18 *Koha ditore*, 10 shkurt 2011.
- 19 *Koha ditore*, 10 shkurt 2011.
- 20 *Kosova sot*, 10 shkurt 2011.
- 21 *Express*, 10 shkurt 2011.
- 22 "...ta shkelmojë një kënaçe në rrugë", frazeologji në anglisht që dthth. punë e nisur dhe e papërfunduar.
- 23 Boriçi, *Gazetaria 2*, fq. 215.
- 24 Boriçi, *Gazetaria 2*, fq. 78.
- 25 Koment i *The Independent*, botuar edhe në *Express*, 2 shkurt 2011.
- 26 David Randall, *Gazetari universal*, fq. 197.
- 27 Bill Kovaç dhe Tom Rosenstiel në librin *Elementët e gazetarisë* (2001), botim shqip 2010, fq. 57.

- 28 Jeffrey D. Sachs, "Politika klimatike e "Mbretitit thëngjill", *Koha ditore*, e enjte . 22 tetor 2009
- 29 Aleksandër Çipa, *Duhet kahu tjetër*, në [www.albinformacion.com](http://www.albinformacion.com)
- 30 Boriçi, *Gazetaria 2*, fq. 221.
- 31 Eduard Zaloshnja, "Qeveri e merituar?", 11/11/2009 , *Shekulli*, [www.shekulli.com.al/](http://www.shekulli.com.al/)
- 32 Boriçi, *Gazetaria 2*, fq. 222.
- 33 *Drita*, Sofje, nr. 97. 1 shkurt 1908, autori: Lap Matrallozi. Cituar nga *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, vëllimi I, 1879-1908, Tiranë 1971, fq. 79-82.
- 34 *Hylli i Dritës*, vjeta VIII, nr. 1, kallduer 1932, fq. 1-4.
- 35 *Hylli i Dritës*, 1934, nr. 6. fq. 265-272.
- 36 Đorđe Obradović, "Kolumne nisu novinski rod", *Medianali*, Vol. 2, No. 3, Veljaca 2008, fq. 13-38, në [www.hrcak.srce.hr/medianali](http://www.hrcak.srce.hr/medianali)
- 37 [www.gazeta-shqip.com](http://www.gazeta-shqip.com), më 18.11.2009.
- 38 David Randall, *Gazetari universal*, ISHM, 2003, fq. 201.
- 39 David Randall, *Gazetari universal*, fq. 61.
- 40 *Recnik knjizevnih termina*, NOLIT, Beograd, 1992, fq. 292.
- 41 Duke qenë se gazetaria, sa do objektive, gjithmonë është, dhe në radhë të parë, përvojë subjektive, edhe në këtë temë ka mendime të ndryshme. Autorët e librit *Manual për gazetarët e Europës Qendrore dhe Lindore* (fq. 14.) shprehen se gazetari duhet që më herët të përgatisë pyetjet për bashkëbiseduesin dhe ta mbajë letrën në dorë gjatë bisedës, jo për ta lexuar, por në rast se ngatërrohet gazetari, e përdorë atë si përkujtues.
- 42 Cituar sipas Aleksandër Mexi, *Përmes fjalës së tij*, Shtëpia botuese Luarsasi, Tiranë, 1997, fq. 266.
- 43 David Randall, *Gazetari universal*, fq. 62.
- 44 David Randall, *Gazetari universal*, fq. 65.
- 45 Boriçi, *Gazetaria 2*, fq. 180.
- 46 RTK, emisioni "Pa rrotulla", 12 shtator 2010.
- 47 Mencher, 318.
- 48 Paul Chantler and Peter Steëart, *How to win friends and interview pople?*, (Basic Radio Journalism (Focal Press), Posted on [bbctraining.com](http://bbctraining.com)).
- 49 Mencher, 318.
- 50 Paul Chantler and Peter Steëart, *How to win friends and interview pople?*, (Basic Radio Journalism (Focal Press), Posted on [bbctraining.com](http://bbctraining.com)).
- 51 [www.TanPortal.com](http://www.TanPortal.com), 14 tetor 2004.
- 52 *Manual për gazetarët e Europës Qendrore dhe Lindore*, red. nga M. F. Mallet, Dituria, 2003, fq. 14.
- 53 David Randall, *Gazetari universal*, fq. 61.
- 54 Boriçi, *Gazetaria 2*, fq. 176; *Recnik knjizevnih termina*, NOLIT, Beograd, 1992, fq. 292.
- 55 David Randall, *Gazetari universal*, fq. 125.
- 56 Shih më gjerësisht Paul Chantler and Peter Stewart, *Basic Radio Journalism*.
- 57 Boriçi, *Gazetaria 2*, fq. 183.
- 58 Boriçi, *Gazetaria 2*, fq. 181.
- 59 Melvin Mencher, *Raportimi dhe shkrimi i lajmeve*, WCB, botim i pestë, fq. 106-108.
- 60 [www.revistaklan.com](http://www.revistaklan.com)



- |  |                           |
|--|---------------------------|
| XXII. Gazetaria letrare (Publicistika) | XXX. Fejtoni (nënfletra)  |
| XXIII. Reportazhi (raporti letrar)     | XXXI. Kozeria             |
| XXIV. Fotoreportazhi                   | XXXII. Recensionit        |
| XXV. Karikatura                        | XXXIII. Bibliografia      |
| XXVI. Udhëpërshkrimi                   | XXXIV. Eseja              |
| XXVII. Udhërrëfyeti (guida)            | XXXV. Skica               |
| XXVIII. Polemika                       | XXXVI. Portreti (profili) |
| XXIX. Pamfleti                         | XXXVII. Shënimi           |

## Gazetaria letrare

4  
PJESA



## PËRMBLEDHJE

**N**ë këtë kapitull shtjellohet zhanri publicistik ose gazetaria letrare. Në fillim diskutohet për marrëdhënien gazetaria-publicistika-letërsia, e pastaj takimi i gazetarisë me letërsinë, arti i faktit. Diskutohet për qëllimin përmbajtjesor dhe strukturën e tekstit gazetar në këtë gazetari. Më tutje, shtjellohen elementet letrare të cilat gazetaria i merr prej letërsisë, si dhe çështje të tjera si: origjinaliteti në publicistikë, imagjinata dhe e vërteta, gazetaria letrare dhe letërsia dokumentare, tendenca dhe tipikja në gazetarinë letrare. Në fund të këtij diskutimi teorik për gazetarinë letrare është vënë një tabelë krahasuese, në pikat më të rëndësishme, midis shkencave humaniste (filozofia, sociologjia...) - publicistikës-letërsisë.

Në vazhdim shtjellohen lloje të veçanta zhanrore të kësaj gazetarie, si: reportazhi (raporti letrar), fotoreportazhi, karikatura, udhëpërshkrimi, udhërrëfyesi (guida), polemika, pamfleti, fejttoni (nënfleta), kozeria, recensionit, bibliografia, eseja, skica, portreti (profili) dhe shënimi.





## XXII. GAZETARIA LETRARE (PUBLICISTIKA)

### NJË PËRKUFIZIM TEORIK

#### XXII.1. GAZETARIA, PUBLICISTIKA DHE LETËRSIA

**G**azetaria dhe letërsia takohen në një pikë dhe prodhojnë disa zhanre të veçanta të tekstit gazetar, të cilat quhen me emrin përmbledhës publicistikë ose gazetari letrar. Ky është përkufizimi i përgjithshëm dhe i pranueshëm në teorinë e gazetarisë. Mirëpo, si do të shohim më poshtë, gazetaria ashtu si takohet me letërsinë, njëjtë takon edhe etikën, politikën, sociologjinë e filozofinë etj., por nuk prodhon zhanre e lloje të tjera gazetare. Kështu, në një koment mund të trajtohet një çështje politike apo sociologjike, një çështje kulturore apo etike etj., por komentit vazhdon në të gjitha rastet të mbetet koment, pra një zhanër gazetar analitik. Ndërsa aty ku gazetaria takohet me disa elemente të letërsisë, prodhon zhanre të reja gazetare: për shembull, reportazhi është tekst gazetar që raporton për një ngjarje, njësoj sikurse raporti, por dallon në faktin se informimin e bën duke u shërbyer edhe me gjuhën e letërsisë. Si shihet, diskursi gazetar është i aftë të absorbojë tematika të ndryshme pa e ndryshuar esencën e vet, ndërsa në çastin kur ky diskursi absorbon diskurse të tjera, në këtë rast nga diskursi letrar, prodhon zhanre të reja gazetare. Pra, takimi i gazetarisë me letërsinë nuk është në fushën tematike, por në fushën gjuhësore, në aspektin stilistik dhe diskursiv. Si do të shihet, në tematikë jo vetëm që nuk bashkëveprojnë, përkundrazi, kundërshtohen: gazetaria trajton vetëm tema të vërteta, ndërsa letërsia është imagjinatë.

Në këtë kapitull trajtohen ato ligjësi dhe ata faktorë që ndikojnë në marrëdhënien gazetar-letrari dhe, si rrjedhojë, rezultojnë zhanre e lloje të reja zhanrore gazetare. Më thellësisht, do të shqyrtohet vetë ky zhanër e këto lloje zhanrore. Më drejt, këtu i bie të shqyrtohet se cilat elemente i merr gazetaria nga letërsia për të prodhuar zhanre të reja gazetare? Këto zhanre të reja quhen me emrin **gazetari letrar**, por edhe me emrin tjetër **publicistikë**. Asnjëri prej këtyre dy emrave nuk janë deri në fund konsistentë, por ne duhet të mësohemi, sikur edhe në raste të tjera kur është fjala për gazetarinë si art dhe si dije, me përdorimin e fjalëve, nocioneve e të termave jokonsistentë deri në fund. Nga aspekti teorik emërtimi gazetar letrar është më i

#### PËRMBAJTJA

XXII. Gazetaria letrare (publicistika) . . . . .	327
XXII.1. Gazetaria, publicistika dhe letërsia . . . . .	327
XXII.2. Gazetaria dhe publicistika: qëllimi përmbajtësor i publicistikës . . . . .	329
XXII.3. Arti i faktit . . . . .	330
XXII.4. Elementet që gazetaria i merr prej letërsisë . . . . .	332
XXII.5. Struktura tekstore e gazetarisë letrare . . . . .	335
XXII.6. Imagjinata dhe e vërteta (fiction dhe fact) . . . . .	335
XXII.7. Originaliteti . . . . .	337
XXII.8. Publicistika dhe nonfiction literature . . . . .	337
XXII.9. Tendenca e tekstit publicistik . . . . .	338
XXII.10. Tipikja dhe e veçanta . . . . .	339
XXII.11. Përfundim . . . . .	339


**Journalism  
Is Literature  
In A Hurry.**

**Matthew Arnold** (1822 – 1888), poet dhe kritik kulturor anglez: "Gazetaria është letërsi e bërë për ngut."

Gazetaria dhe letërsia takohen në një pikë dhe prodhojnë disa zhanre të veçanta të tekstit gazetar, të cilat quhen me emrin përmbledhës publicistikë ose gazetari letrar.

Gazetari letrar  
Publicistikë  
Nonfiction literature

saktë, qoftë edhe vetëm për shkak se përmban të dy elementet e këtij zhanri: edhe gazetarinë edhe letërsinë. Mirëpo, nëse thellohemi më tej, dalin probleme përkufizuese si, për shembull, mbiemri “letrar” që ka një kuptim shumë më të gjerë sesa ajo që gazetaria merr prej letërsisë. Po kaq i pasaktë, në mos më shumë, është edhe emërtimi publicistikë, i cili në etimologji ka kuptimin e bërjes publike (kultura masive) dhe përdoret shpesh për çfarëdo botimi gazetar.



Ciceroni: Quo usque tandem abutere, Catilina, patientia nostra? (Deri kur, Katalin, do ta keqpërdorësh durimin tonë?)

Publicistika trajtohet si zhanër i mëvetësishëm i gazetarisë, me disa lloje, si reportazhi, eseja, pamfleti, polemika, nënfleta, udhëpërshkrimi etj. Shkrimi i disa prej këtyre teksteve është mjaft i vjetër dhe në origjinë pjesërisht takohen edhe me gjeografinë, me moralin, me fenë dhe me letërsinë, që nga kultura antike, nëpër Mesjetë e deri më sot. Librat antikë të gjeografisë dhe të historisë kanë pjesë të ngjashme me atë që ne sot quajmë publicistikë, ndërsa fjalimet e Ciceronit edhe sot janë shembuj të mrekullueshëm të gojtarisë dhe të tekstit publicistik. Nga Mesjeta janë të njohur pamfletet fetare dhe udhëpërshkrimet si ai i Marko Polos. Mirëpo, publicistika në kuptimin e sotëm ka lindur në fund të shekullit XVIII dhe në fillim të shekullit XIX, në radhë të parë mbi punën e enciklopedistëve francezë. Ata ishin intelektualë të mëdhenj dhe që artikullimin e tyre intelektual e bënëin përmes trajtimit të çështjeve e të ideve shoqërore, politike, kulturore dhe ekonomike, por në të gjitha këto forma artikulli ata kishin parasysh ndikimin në mendjen e lexuesit, qytetarit mesatar francez. Nga aspekti i ndikimit, tekstet e enciklopedistëve ishin tendencioze. Nga aspekti i edukimit, tekstet e enciklopedistëve ishin iluministe. Nga aspekti i stilit, tekstet e enciklopedistëve ishin eseistike, me tone polemike dhe me formë letrare. Të gjitha këto karakteristika të tekstit të enciklopedistëve janë bartur dhe janë ruajtur në tekstin e sotëm publicistik. Në tre shekujt e fundit, penat më të mëdha të kulturës euro-perëndimore kanë shkruar këtë apo atë lloj publicistik, duke e ngritur tekstin publicistik thujse në degë më vete të artikullimit intelektual e politik.

Duke qenë se publicistika është një formë e artikullimit intelektual midis gazetarisë dhe letërsisë, ajo i takon të dyja, edhe gazetarinë edhe letërsinë. Para se të diskutojmë për gjinitë e publicistikës duhet folur për natyrën e publicistikës dhe dallimin e saj nga gazetaria tjetër, në njërin, dhe nga letërsia, në anën tjetër.

## XXII.2. GAZETARIA DHE PUBLICISTIKA: QËLLIMI PËRMBAJTJESOR I PUBLICISTIKËS

Publicistika është gazetari sepse, sikurse ajo, bazohet në informim dhe në informimin, si dhe në rrethanat e ndodhjes së një lajmi (gazetaria informative dhe ajo analitike). Karakteristika e parë themelore që e ndërlidh tekstin publicistik me gazetarinë është informimi i marrësit për një ngjarje, një histori, një aktivitet, një të papritur, pra për një lajm. Derisa në lajm, në raport, në analizë apo në koment natyra e informimit të publikut është më e lidhur për të rejat e fundit, për ato që sapo kanë ndodhur apo kanë ndodhur jo shumë larg, mirëpo publiku ka nevojë ende t'i kuptojë më thellë. Në publicistikë informimi është i lidhur jo me vetë të rejat që sapo kanë ndodhur, por edhe me të reja më të largëta dhe për të reja pranë të cilave jetojmë por nuk i shohim. Kështu, publicistika trajton ngjarje lajmore jo domosdo të reja, por ngjarje lajmore nga prapavija (beckgrandi). Po ashtu, gazetaria është e lidhur pa kusht me faktet e vërteta dhe me interpretimin objektiv të tyre. Në gazetarinë analitike i mundësohet gazetarit në disa lloje zhanrore t'i shprehë mendimet, komentet dhe interpretimet personale për ngjarjet lajmore. Ndërsa publicistika bën një hap përtej gazetarisë (përtej lajmit dhe komentimit e analizimit të rrethanave të ndodhjes së lajmit): ajo merret me diskutimin e rrethanave të ndodhjes së ngjarjeve lajmore dhe lidhjen e tyre shkak-pasojë në shoqëri nga prizmi personal. Aty ku fillon shqyrtimi subjektiv i fakteve dhe i rrethanave të ndërlidhjes së lajmit me shoqërinë dhe idetë e saj, aty fillon publicistika. Porsa autori ta bëjë hapin tjetër përtej raportit dhe artikullit analitik, ta vazhdojë shqyrtimin përtej lajmit dhe sqarimit të fakteve e rrethanave të tij, aty ku zë fill mendimi, konceptimi dhe diskutimi për idetë që krijojnë atë ngjarje lajmore, apo për pasojat që krijon ajo ngjarje lajmore, aty fillon teksti publicistik. Nëse një grup votuesish nuk ka marrë pjesë në votime, poende është prononcuar kundër votimeve, ky fakt mund të trajtohet nga gazetari si lajm, si reportazh radioteleviziv, si koment etj., por në të gjitha këto tekste fakti do të venerohet nga aspekti i lajmit dhe i analizës së rrethanave që kanë sjellë deri te ai fakt. Por nëse autori vazhdon hapin tjetër, përtej lajmit hap diskutimin për motivet e mosmarrjes pjesë të një strukture të shoqërisë në votime, për domethënien e këtij fakti në demokraci, për nevojën e klasës politike për t'u marrë me arsyet e atij grupi etj., atëherë autori ka kaluar kufijtë e gazetarisë informative dhe po shkel në territorin e tekstit publicistik, edhe pse ende nuk shkruan publicistikë. Mund të bëjmë një përkufizim të gjerë: derisa gazetaria (informative dhe analitike) është një informim dhe analizë për ngjarjen lajmore, diskutimi i mëtejshëm (moral, social,

Publicistika trajton ngjarje lajmore jo domosdo të reja, por ngjarje lajmore nga prapavija (beckgrandi).

Aty ku fillon shqyrtimi subjektiv i fakteve dhe i rrethanave të ndërlidhjes së lajmit me shoqërinë dhe idetë e saj, aty fillon publicistika. Duhet vetëm edhe gjuha e letërsisë.

filozofik, politik, kulturor etj.) i ngjarjes lajmore dhe lidhjes së saj me idetë e shoqërisë del një hap jashtë kufirit të gazetarisë. Por, me kaq ende nuk e kemi bërë përkufizimin e plotë të publicistikës. Do ta bëjmë në vazhdim.

Ky hap i dytë i autorit ende nuk është “pikëtakim me letërsinë”, pra ende nuk e bën atë tekst publicistik. Kjo sepse konceptimi, mendimi dhe diskutimi i fakteve, i të rejave, i ngjarjeve lajmore dhe i ideve të shoqërisë nuk janë parësisht kategori e as tematika të ligjërimit letrar. Diskutimi i këtyre temave dhe vetë diskursi i diskutimit ka të bëjë para së gjithash me etikën, me filozofinë, me politikën, me shkencat juridike, me sociologjinë etj., me një fjalë me shkencat humaniste. Diskutimi i një fakti objektiv nga aspekti i ideve, për shembull diskutimi i ligjit për trashëgiminë, ka të bëjë parësisht me etikën, me sociologjinë dhe me shkencat juridike. Diskutimi i ndikimit të letërsisë në kulturimin dhe edukimin e masave ka të bëjë me etikën, me sociologjinë dhe me filozofinë. Pra, nëse keni shkruar një tekst në të cilin keni diskutuar miratimin e ligjit për trashëgiminë dhe atë ligj e keni shqyrtuar nga aspekti juridik, etnik, tradicional, etik etj., ju nuk keni bërë një tekst gazetar, por nuk keni bërë as një tekst publicistik. Mbase, mund të jetë ai tekst një analizë (gazetari analitike) apo një artikull shkencor etj., por jo publicistik, edhe pse keni plotësuar njërin prej kushteve të publicistikës: keni bërë një hap përtej informimit dhe keni diskutuar idetë për atë ligj. Pra, nuk mjafton vetëm ky hap i dytë që një tekst të bëhet publicistik. Jo çdo diskutim i ideve në lidhje me një lajm krijon publicistikën. Ose, diskutimi i Ligjit Penal të Kosovës nga aspekti i dënimit të personave që bëjnë krimin më të rëndë, vrasjen, nuk është gazetari informative apo analitike, por nuk është as publicistikë (e mund të jetë një analizë juridike etj). Pra, publicistika fillon të lindë aty ku kapërcehet gazetaria informative e ajo analitike dhe ku fillon diskutimi për idetë që kanë rezultuar apo ato që pasojnë atë lajm, por që të konstituohet publicistika duhet funksionalizuar edhe një faktor tjetër, e ai faktor tjetër është gjuha e letërsisë. Nëse gazetari e bën këtë diskutim me mjete letrare dhe e shtjellon si një strukturë letrare, atëherë ai tekst është publicistika, të cilin po e diskutojmë.

### ***XXII.3. ARTI I FAKTIT***


Në zhanrin publicistik diskutimi përtej lajmit dhe komentit apo analizës nuk bëhet sikur bëjnë moralistët, filozofët, sociologët, politologët apo secila shkencë tjetër humaniste, por realizohet me gjuhën e letërsisë dhe në struktura të ngjashme me letërsinë. Kjo

ndërlidhje quhet **art i faktit**. Pjesa e parë "art" paraqet anën letrare, pra gjuhën e letërsisë, ndërsa pjesa e dytë "fakt" paraqet gazetarinë, informatën që bart teksti gazetar. Bashkimi i artit (letërsia) dhe faktit (gazetaria) rezulton me publicistikën. Në tekstin publicistik ka gjuhë të letërsisë, gjuhë që ka një strukturë dhe leksik e shprehësi letrare. Ajo përmban në vete figura stilistike, shprehësi të të gjitha llojeve, kuptime metonimike e alegorike, metafora, organizim tingullor dhe çdo mjet tjetër shprehës letrar që përdoret në gjuhën e letërsisë. Derisa, si kemi parë, në gazetarinë informative e në atë analitike, gjuha ka vetëm një rol, ta bartë mesazhin, në publicistikë, sikurse në letërsi, gjuha ka më shumë se një rol, dhe ajo gjithmonë ka një e më shumë konotacione. Në gazetarinë informative dhe analitike gjuha ka funksion preferencial dhe konativ, ndërsa në publicistikë gjuha ka funksion estetik.

Gjuha e letërsisë është faktori kyç i publicistikës dhe, njëkohësisht, faktori që e lidh gazetarinë me letërsinë. Si do të shohim në vijim, në këtë lidhje ka edhe një sërë faktorësh të tjerë që barten nga letërsia në gazetari. Me këtë konstatim mund ta plotësojmë përkufizimin e qëllimit përmbajtësor të gazetarisë letrare (publicistikës): gazetaria letrare ka qëllim përmbajtësor bartjen e lajmit dhe krijimin e kënaqësisë estetike të marrësi në këtë proces të bartjes. Kështu, derisa gazetari shkruan një reportazh, ai, përveç se informon, na krijon edhe kënaqësinë estetike të përjetimit të ngjarjes së tij apo të personazheve të tij, duke përshkruar natyrën, karakteret, bukuritë dhe shëmtitë e jetës etj. dhe, në këtë proces, ai përdor një gjuhë të letërsisë për ta ndikuar marrësin me efekte gjuhësore.



**Art i faktit:** "art" paraqet anën letrare, pra gjuhën e letërsisë, ndërsa "fakt" paraqet gazetarinë, informatën që bart teksti gazetar. Bashkimi i artit (letërsia) dhe faktit (gazetaria) rezulton me publicistikën.



*The Art of Fact / A Historical Anthology of Literary Journalism, edited by Kevin Kerrane & Ben Yagoda (1997)*

Gazetaria letrare (publicistika) ka qëllim përmbajtësor bartjen e lajmit dhe krijimin e kënaqësisë estetike të marrësi në këtë proces të bartjes.

#### **Art apo informatë?**

Shkrimi i parë i njohur deri më tash në historinë e qytetërimit njerëzor: shkrimi sumero-akadian Kuneiform.



#### Art apo informatë?

Hieroglifë egjiptiane në një varrezë.



## XXII.4. ELEMENTET QË GAZETARIA I MERR PREJ LETËRSISË

Elementet që gazetaria i merr prej letërsisë:

- Figurat stilistike
- Motivi dhe lajtmotivi
- Përshkrimi (deskripcioni)
- Rrëfimi (narracioni)
- Dialogu
- Monologu
- Personazhet
- Bota emocionale e personazheve

Në tashmë përmendëm gjuhën e letërsisë si dhe disa elemente të tjera të cilat gazetaria i merr prej letërsisë për ta prodhuar gazetarinë letrare. Këto elemente të tjera janë: përshkrimi, rrëfimi, dialogu, monologu, personazhi.

**Figurat stilistike.** Gjuha e letërsisë krijon shprehësi të fortë kur artikullohet me figura stilistike. Edhe në gazetarinë analitike (shumë rrallë edhe në atë informative) mund të përdoren në masë shumë të kufizuar figura stilistike, ndërsa në gazetarinë letrare ato përdoren shumë dendur, në cilëndo pjesë strukturore të tekstit. Përdoren figurat tingullore (këto janë më të rralla në tekstin gazetar), figurat e fjalëve, figurat sintaksore dhe figurat e kuptimeve.

**Motivi dhe lajtmotivi.** Motivi është tërësia më e vogël e një veprimi apo ngjarjeje në një rrëfim apo përshkrim. Lajmi nuk ka motiv, pra ka një informatë, ndërsa reportazhi ka disa motive: nëse reportazhi ka një personazh dhe fatin e tij jetësor për temë, secili episod i jetës së tij është një motiv. Ndërsa lajtmotivi është motivi kryesor i cili i ndërlidh të gjitha motivet e tjera: në shembullin e mësipërm për fatin e një personazhi, vetë fati i personazhit është lajtmotivi.

**Përshkrimi (deskripcioni)** është riprodhim gjuhësor i natyrës dhe qenieve në gjendjen e tyre statike. Ka përshkrim të jashtëm (fizik) dhe të brendshëm (karakteret, shpirtëror etj). Në tekstin publicistik që të dy këto përshkrime kanë rol të rëndësishëm. Në pjesën më të madhe të tekstit autori përshkruan ose rrëfen, përveç kur përdor dialogun. Përshkrimi është faktik dhe nuk bën të jetë imagjinar. Gjuha



mund të jetë më shumë apo më pak e figurshme, më lehtë apo më vështirë e kuptueshme, mund të jetë një gjuhë e ftohtë e fakteve (stil i ftohtë), por në të gjitha rastet duhet të jetë gjuhë letërsie. Përshkrimi për kah natyra është statik: përshkruhet natyra apo gjendjet e tjera ashtu si janë, në qetësi, pa lëvizje, ashtu si i sheh syri në një çast. Përshkrimi kuptohet në përgjigjen e pyetjes: çka po sheh?

**Rrëfimi (narracioni).** Rrëfimi (apo tregimi, kallëzimi) është riprodhim gjuhësor i ngjarjeve të ndodhura apo i atyre që ndodhin në çastin e folësit, në gjendjen e tyre dinamike. Rrëfimi i një ndodhie, i një ngjarjeje, i një historie etj. bën që një person, rrëfimtari (tregimtari, kallxuesi, narratori) u tregon të tjerëve një ndodhi të cilën ai e di e të tjerët nuk e dinë. Rrëfimi kuptohet në përgjigjen e pyetjes: çka ka ndodhur? Rrëfimi për kah natyra e tij është dinamik, pra ai paraqet ngjarjet në lëvizje, në ndryshim. Njësoj si përshkrimi, edhe rrëfimi duhet të jetë faktik e jo imagjinar.

**Dialogu** është një formë tjetër e formësimit të ligjërimit që ndërhysh në përshkrim dhe në rrëfim. Autori mund të japë dialogë të personazheve të tij, në vend se të përshkruajë apo të rrëfejë. Dialogët e gjallë, që bartin në vete tendosje emocionale apo informacion të madh, vetëm e rrisin vlerën e tekstit. Dialogu, sikurse në çdo prozë, edhe këtu ka rol në dinamizmin e ngjarjes dhe në paraqitjen e karakterit të personazheve. Besohet se Ernest Heminguej është bërë shkrimtar i mirë sepse në letërsi ka përdorur fjali të shkurtra gazetarë dhe dialogë të përditshëm të denjë për tekste gazetarë.

**Monologu** është formë personale e formësimit të ligjërimit: personazhi (mund të jetë edhe gazetari) bisedon me veten, mendon me veten, e pyet veten apo i përgjigjet vetes. Edhe në tekstin gazetar sikurse në letërsi, autori mund të krijojë monologje të personazheve të tij, pa u frikësuar për rrezikun e fiksionit.

**Personazhet** janë vetëm të artit (të letërsisë, të filmit, të pikturës etj.). Vetëm artisti e ka të drejtën të krijojë një personazh. Mirëpo, këtë të drejtë e kanë huazuar edhe gazetarët në tekstet e gazetarisë letrare: ata krijojnë personazhet e tyre por, për dallim prej letërsisë, personazhet gazetarë janë gjithmonë realë, të vërtetë, karakteristikë, të tipizuar mirë e në përputhje me veprimet e tyre, por edhe kur ka shpërputhje midis veprimeve dhe karakterit të personazhit autori duhet ta shpërfaqë këtë fakt. Duke rrëfyer jetën e një njeriu, duke përshkruar fizikun e tij dhe botën e tij shpirtërore, gazetari krijon prej tij personazh.

**Bota emocionale e personazheve.** Derisa gazetari merr të drejtën që në gazetarinë letrare të krijojë personazhe, vetiu e merr edhe të drejtën t'i krijojë karakteret e këtyre personazheve, përndryshe ata



Kali dhe Pegasi  
Realiteti dhe imagjinata.  
Personi dhe personazhi.

nuk do të shquheshin si të tillë. Pra, gazetari krijon edhe botën e brendshme, shpirtërore e emocionale të personazheve të tij, ngjashëm me atë çfarë bëjnë shkrimtarët me personazhet e tyre. Në parim, gazetari në lajm nuk ka të drejtën ta rikonstruktojë botën e brendshme të personave. Ta supozojmë mospërputhshmërinë që krijon teksti i lajmit nëse gazetari shton aty se në momentin e aksidentit shoferit i vajti mendja te fëmijët dhe u dëshpërua se po i linte të vetëm! Por, në gazetarinë letrare kjo gjë është e mundshme: gazetari flet edhe për botën e brendshme të personazheve të tij, por gjithnjë duke u mbështetur te parimi i së vërtetës. Pra, nuk mund të imagjinojë fakte e ngjarje të pavërteta, si bëjnë shkrimtarët, për ta karakterizuar botën e brendshme të personazheve të tij.

1



Dy figura në të cilat mund të shihet stili, efekti stilistik dhe marrëdhënia realitet-figurë. Në figurën 1. Shihet aligatori i stilizuar i Amerikës Veriore në logon e programit të riciklimit Paper Gator: shihni ngjyrën e gjelbër dhe pllakat në formë të drejtkëndëshit në gjithë boshlin kurrizor. Në figurën 2. shihet aligatori i vërtetë amerikan (Alligator mississippiensis); vini re se nuk ka as ngjyrë të gjelbër dhe as një rresht të drejtkëndëshave mbi kurrizin e vet. (burimi: <http://palaeo-electronica.org/content/component/content/article/128-321/277-rock-art-dinosaurs-figures>).



## XXII.5. STRUKTURA TEKSTORE E GAZETARISË LETRARE

Për dallim nga strukturat tekstore gazetare, ato letrare janë gjithmonë të reja. Secili autor, në secilin rast kur shkruan, krijon një strukturë letrare. Kjo ka të bëjë me originalitetin e tekstit letrar. Asnjëherë nuk është e mirë një poezi e cila është shkruar si kopje apo duke pasur për bazë një model tjetër të ngjashëm. Si kemi parë më herët, nuk qëndron kështu me lajmin: një gazetar mund të bëhet i mirë nëse në shkrimin e lajmit ndjek shembullin e lajmeve të shkruar mirë më herët. Por nuk ndodh asnjëherë që një gazetar të shkruajë një reportazh të mirë duke ndjekur shembullin e një reportazhi të ngjashëm. Në gazetarinë letrare, njësoj si bën shkrimtari i letërsisë, sa herë gazetari shkruan tekstin krijon struktura të reja tekstore. Pra, në këtë gazetari nuk mund të flitet për modelin e një teksti, edhe pse do të shohim më vonë se recensionin, për shkak të disa shtërngimeve jashtëtekstore, synon ta përsërisë veten edhe në strukturën tekstore. Megjithatë, në përgjithësi, në gazetarinë letrare nuk ka një strukturë fikse të tekstit, edhe pse ka elemente të cilat ndikojnë në këtë strukturë (si, për shembull, ndikimi i kronologjisë në shkrimin e udhëpërshkrimit).

Në gazetarinë letrare, njësoj si bën shkrimtari i letërsisë, sa herë gazetari shkruan tekstin krijon struktura të reja tekstore.

## XXII.6. IMAGJINATA DHE E VËRTETA (FICTION DHE FACTION)

Po çka e dallon publicistikën nga letërsia, nëse kemi konstatuar se edhe publicistika, sikurse letërsia, përdor gjuhën letrare dhe shtrihet në struktura letrare?

Pasi theksuam ku dallon publicistika prej gazetarisë, ku ajo dallon prej moralit e filozofisë, duhet të themi edhe ku dallon prej letërsisë: në publicistikë shkruhet për ngjarje të vërteta, bartet lajmi, i cili nga origjina është fakt objektiv, ndërsa letërsia është krijim, sajim apo fantazi e autorit dhe nuk do të thotë se duhet të jetë e vërteta empirike. Publicistika është fakt, ndërsa letërsia është sajim (imajinatë, përftesë). Publicistika është shikim (ose trajtim) letrar i fakteve reale. Në fakt, këtu po flitet për dallimin midis *letërsisë artistike* dhe *letërsisë joartistike (letërsi dokumentare)*, apo si shprehet kjo në kulturën anglishtfolëse *fiction literature* dhe *nonfiction literature*. Këto nocione gjithnjë e më shumë po marrin karakter të përgjithshëm teorik e letrar. Nocioni i anglishtes mund ta argumentojë më lehtë dallimin për të cilin po flasim. *Fiction* shpreh diçka që nuk është me

Ky kufi midis publicistikës dhe letërsisë është i vërtetë dhe i fortë, dhe nuk mund të kalohej pa pasojë: Gazetaria shkruhet mbi faktet, ndërsa letërsia mbi imajinatën.

Stefën Randall Glass (1972) ishte ylli në ngritje në revistën *The New Republic*, por në vitin 1998 u zbulua se 27 prej rreth 41 artikujve të tij të botuar ishin bazuar në imagjinatë e jo në fakte reale. Gjatë tre vjetëve të tij si gazetar ai shpiku burimet, ngjarjet, citimet dhe emrat e personazheve të tij në reportazhet që shkroi për revistën. Pas zbulimit të skandalit dhe largimit të tij nga revista dhe nga gazetaria, Glass pati një histori rënieje, i ballafaquar me një opinion publik që e quante si mashtrues e si gënjeshtar. Në vitin 2003 ai botoi romanin autobiografik *Tregimtari (The Fabulist)*, i cili po ashtu u prit me ironi e skepsë. Po në vitin 2003 u shfaq filmi *Pasqyra e thyer (Shattered Glass)*, e që aludon edhe në "Glasin e thyer" që kishte për temë skandalin e ngritjes së Stefën Glass-it dhe rënien e *The New Republic*. Regjisor i filmit qe Billy Ray, ndërsa Hayden Christensen luajti rolin e Glass-it. Ky film është shfaqur edhe në rrejtin kabllor të Kujtesës, i përkthyer në shqip, me emrin "Të vërteta dhe gënjeshtër".

të vërtetë, diçka që është e sajuar, e përfutur në mendjen e njeriut, ndërsa *nonfiction* është e kundërta, ajo që nuk është sajim, trillim, fantazi, përftesë, pra ajo që i takon botës empirike dhe është fakt objektiv. Duke u rikthyer te publicistika dhe te letërsia, kjo e fundit shkruan për gjëra që nuk do të thotë se duhet të jenë të vërteta të botës empirike (mimesisi, sipas përkufizimit të Aristotelit), ndërsa në publicistikë shkruhet me mjete letrare por për gjërat e vërteta nga realiteti empirik. Publicistika, sikurse *nonfiction literature*, është art i fakteve (*art of facts*). Ky kufi midis publicistikës dhe letërsisë është i vërtetë dhe i fortë, dhe nuk mund të kalohet pa pasoja. Reporterit për çështje gjyqësore në gazetën parisienne *L'Echo de Paris*, Gaston Lui Alfred (1868-1927), u bë i famshëm pasi vendosi ta përdorte trillimin në zgjidhjen e krimeve të vërteta. Por, kjo ia ndërroi përjetësisht profesionin: ai u bë romancier dhe shkroi romane aventuriere.<sup>1</sup>



“Një ditë me shi”. Ku dallon gazetaria prej letërsisë? Marrëdhënia midis imagjinatës dhe të vërtetës. ([www.photoshop-website.com](http://www.photoshop-website.com)).

## XXII.7. ORIGJINALITETI

Një çështje kontradiktore në tekstin gazetar është origjinaliteti, ajo që në letërsi shquhet si qasje personale si ndaj temës ashtu edhe ndaj gjuhës që përdor një shkrimtar. Është përmendur tashmë se në lajm nuk synohet origjinaliteti, përkundrazi, studentët e gazetarisë mësohen ta shkruajnë lajmin sipas një modeli që ua përgatit profesori. Kur gazetari fillon ta shkruajë lajmin ai nuk e vendos gishtin tregues në tëmth e të mendojë “me cilën fjali ta nis lajmin?”, sepse ai tashmë e ka të qartë, edhe para se të fillojë të shkruajë, se çka do të përmbajë fjalia e parë e lajmit, pra kreu i tij. Aty nuk kërkohet kurrfarë origjinaliteti, përkundrazi gazetari i ri kopjon modelin e gazetarit të mirë e me përvojë. Por, ndryshe është në gazetarinë letrare: të shkruash një reportazh sipas një modeli të një reportazhi tjetër, kjo është rrugë e sigurt për dështim. Këtu gazetari sa herë fillon të shkruajë, vë gishtin tregues në tëmth dhe mendohet një kohë të mirë se me çfarë fjalie të fillojë e si të fillojë? Çdo fjali që e shkruan jo vetëm duhet të jetë origjinale, por duhet synuar ta krijojë origjinalitetin e tij, të gazetarit, në atë mënyrë që marrësi ta njohë reportazhin dhe autorin prej këtyre fjalive.

Në disa lloje zhanrore të tjera të gazetarisë letrare nuk kërkohet origjinaliteti kaq i lartë i tekstit. Te udhëpërshkrimi kërkohet origjinalitet më relativ, sepse disa prej strukturave tekstore, p.sh. kronologjia e rëfimit dhe përshkrimit, janë obligative për çdo udhëpërshkrim. Ndërsa te recensionin kërkohet një shkallë edhe më e vogël e origjinalitetit.

## XXII.8. PUBLICISTIKA DHE NONFICTION LITERATURE

Para se t'i përkufizojmë edhe përbërësit e fundit strukturorë dhe përmbajtësorë të publicistikës duhet bërë edhe një veçim. Ne u shërbyem me nocionet e anglishtes *fiction* dhe *nonfiction literature*, duke barazuar publicistikën me *nonfiction literature*. Në të vërtetë ne vetëm bëmë një krahasim dallues të publicistikës nga letërsia, mirëpo asgjë më shumë, sepse publicistika dhe *nonfiction literature* nuk janë të njëjta, edhe pse janë shumë të afërta. Në teorinë e letërsisë nuk ka një emër të qëndrueshëm për *nonfiction literature*: Velek e emërton edhe si “forma kalimtare të letërsisë”<sup>2</sup> dhe ai dallon romanin (ka origjinë te tregimet e vërteta, dokumentare) nga romansa (ka origjinë nga epi); Dykro-Todorov në *Fjalorin e shkencave të ligjëritimit* thonë se krejt letërsia nuk është *fiction*<sup>3</sup>; në shqipe përdoret shprehja letërsi

Duhet të përfundojmë se publicistika është krahu më letrar i gazetarisë ndërsa letërsia *nonfiction* është krahu më gazetar i letërsisë, dhe këto dy veprimtari janë si kushërinj midis tyre, por nuk janë të një gjaku.



Edhe *nonfiction literature* edhe publicistika dallojnë thelbësisht nga letërsia sepse që të dyja flasin për gjëra, për njerëz, për ngjarje dhe për vende të vërteta (*fact*) e jo për një botë të sajuar (*fiction*), si bën letërsia.

joartistike (për dallim nga letërsia e pastër, artistike) dhe shprehja letërsi dokumentare. Kjo letërsi dallon nga letërsia artistike (*fiction*) vetëm për faktin se flet për gjëra të vërteta, për njerëz të vërtetë, për ngjarje të vërteta dhe për vende të vërteta. Është e njohur letërsia epistolare, letërsia e memoareve dhe e ditarëve, letërsia oratorike (predikimet) etj. Letërsia epistolare ka qenë mjaft e zhvilluar në kulturën latine. Edhe veprat teorike janë shkruar në formë të letrave. Kështu ka bërë Horaci (Kuint Horac Flaku, 65-8 p. K.) me veprën e njohur *Arti Poetik (Epistula Ad Pisones)*, të cilën më vonë Kuintiliani e quajti *Ars Poetica*, e cila është një letër dërguar dy bijve të familjes Pizoni. Edhe në shekujt XVIII e XIX është zhvilluar kjo letërsi, te enciklopedistët francezë dhe romantikët në përgjithësi. Në letërsinë shqipe, përveç te romantikët, është zhvilluar edhe në kohën moderne, në fund të shekullit XX, me emrin **letërsi epistolare nga burgu**.

Edhe *nonfiction literature* edhe publicistika dallojnë thelbësisht nga letërsia sepse që të dyja flasin për gjëra, për njerëz, për ngjarje dhe për vende të vërteta (*faction*) e jo për një botë të sajuar (*fiction*), si bën letërsia. Po cila është marrëdhënia midis publicistikës dhe letërsisë dokumentare (*nonfiction literature*)?

## XXII.9. TENDENCA E TEKSTIT PUBLICISTIK

Tendenca e tekstit publicistik

Publicistika si zhanër gazetar është i ri, ashtu si është e re krejt gazetaria: zhvillohet së pari me enciklopedistët francezë, në shekullin XVIII. Ata shkruanin artikuj gazetash dhe ese në të cilët trajtonin tema nga kultura, politika, morali dhe filozofia. Ajo që i karakterizon këto tekste është tendenca e qartë dhe e fortë e tyre: kjo gazetari - letërsi bëhej për të ndikuar fuqishëm në mendjet, në bindjet, në kulturën dhe në moralin e njerëzve. Edhe në shekullin XIX e XX e kanë zhvilluar këtë formë të shkrimit romantikët dhe marksistët. Pra, kjo gazetari - letërsi trajtonte këto tema nga dy aspekte themelore: nga aspekti i informimit dhe nga aspekti i interesit pragmatik. Në shumë njësi të librit *A Philosophical Dictionary* (1764) të Volterit (François-Marie Arouet) shohim një shembull tipik të publicistikës: aty bartet informacioni dhe bëhen shqyrtime teorike rreth fenomeneve shoqërore e shkencore, ndërsa në të njëjtën kohë, si e tregon vetë titulli i librit, ai hartohet për arsye pragmatike, për të ndikuar në njohuritë e lexuesve. Pikërisht në këto dy pika, pra në bartjen e informatës dhe në përmbajtjen për nevoja pragmatike (këtu hyn edhe tendenca e fortë e këtij teksti), dallohen midis tyre publicistika dhe letërsia *nonfiction*. E para, publicistika, nuk mund të ekzistojë pa këto dy arsye, ndërsa e dyta, letërsia *nonfiction*, humbet vlerën po të mbështetet në këto dy arsye.

Duhet të përfundojmë se publicistika është krahu më letrar i gazetarisë, ndërsa letërsia *nonfiction* është krahu më gazetar i letërsisë, dhe këto dy veprimtari janë si kushërinj midis tyre, por nuk janë të një gjaku. Por nuk ka një kufi të prerë midis vetë këtyre dyjave, publicistikës dhe *nonfiction literature* (letërsia joartistike). Herë-herë dhe disa lloje të tyre trajtohen njësoj prej studiuesve.

Publicistika është krahu më letrar i gazetarisë, ndërsa letërsia *nonfiction* është krahu më gazetar i letërsisë, dhe këto dy veprimtari janë si kushërinj midis tyre, por nuk janë të një gjaku.

## XXII.10. TIPIKJA DHE E VEÇANTA

Për dallim nga gazetaria, në publicistikë nuk shkruhet për çfarëdo fakti, informate e lajmi, por vetëm për faktin, informatën e lajmin tipik, atë që është përfaqësues, qoftë ai tepër i rëndësishëm apo vetëm një detaj i pavërejtur nga të tjerët. Duke qenë në një shkallë më shumë se informim, duke qenë përtej lajmit, diskutim i ideve e mendimeve për lajmin, ai nuk mund ta trajtojë thjesht çdo fakt, informacion apo lajm, por vetëm ato që shprehin një mendim, dukuri apo proces tipik. Kështu, vrasja e një njeriu është fakt objektiv për lajmin, kronikën, reportazhin etj. Edhe nëse krimineli është vrasës serik, nuk ndryshon asgjë: ai është fakt objektiv për lajmin. Por, nëse edhe një vrasje është pasojë apo pjesë e një fenomeni shoqëror, për shembull politik, racor, biznesor, atëherë ai lajm është temë e mirë për tekstin publicistik, sepse në një rast të tillë hapën dyert e shqyrtimit moral, filozofik, politik dhe letrar të temës. Mirëpo, të njëjtat fjalë mund të thuhën edhe për të veçantën: në gazetarinë letrare shkruhet për të veçantën, për atë që nuk është përfaqësuese e llojit. Për shembull: fati i njeriut që mendon se zbulon gjëra të reja të cilat publiku nuk i kupton (ngjashëm si personazhi i Markesit te *Njëqind vjet vetmi*). Kjo temë është interesante për reportazh, por nuk është aspak tipike, përkundrazi, është shumë e veçantë. Mund të përfundojmë se për gazetarinë letrare janë të preferueshme temat e motivet që janë tipike si dhe ato që janë të veçanta.

Tipikja dhe e veçanta

## XXII.11. PËRFUNDIM

Publicistika është letërsi e lidhur me jetën e përditshme, me njerëz konkretë, me ngjarje konkrete dhe me kohën konkrete. Ajo lidhet me letërsinë sepse shkruhet si letërsi, por dallon nga letërsia sepse lidhet me gjëra e njerëz konkretë e të vërtetë. Pikërisht në këtë pikë dallon edhe prej shkencës (filozofia, sociologjia, etika): shkenca studion faktet, dukuritë e fenomenet e përhershme, ndërsa publicistika faktet, dukuritë dhe fenomenet e përkohshme. Diskutimi i mendimeve dhe ideve për lajmin, për ngjarjet e vërteta, në struktura dhe me mjete letrare, kjo është publicistika, ose gazetaria letrare.

Publicistika është letërsi e lidhur me jetën e përditshme, me njerëz konkretë, me ngjarje konkrete dhe me kohën konkrete.



Klasifikimi tabelor i ngjashmërive dhe dallimeve midis shkencës, publicistikës dhe letërsisë

Shkenca (filozofia, sociologjia...)	Publicistika	Letërsia
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fakt</li> <li>2. Studion fakte, dukuri, fenomene të përhershme.</li> <li>3. Krijon ligjësi e rregulla.</li> <li>4. Argumentet vërtetohen në realitetin empirik.</li> <li>5. Është sistematike (studion dukuritë në tërësinë e tyre).</li> <li>6. Nuk trajton ngjarje as personazhe.</li> <li>7. Teksti kërkon besueshmëri të plotë dhe rishqyrtim të plotë të secilit fakt.</li> <li>8. Ekzakhtëzim teorik e praktik i realitetit objektiv.</li> <li>9. Trajton fenomene.</li> <li>10. Teksti ka një kuptim dhe lexuesi kupton vetëm atë kuptim.</li> <li>11. Teksti nuk krijon mundësi interpretimi. Marrësi pajtohet ose jo me të.</li> <li>12. Është komunikim me individin.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Art i faktit</li> <li>2. Shqyrtion fakte, dukuri, fenomene të përkohshme.</li> <li>3. Sugjeron.</li> <li>4. Argumentet vërtetohen mbi përvojën dhe dijen e autorit, pa marrë parasysh përfundimet e të tjerëve.</li> <li>5. Nuk është sistematike. Studion vetëm një aspekt apo disa sosh të një dukurie.</li> <li>6. Trajton ngjarje e personazhe ekskluzivisht të vërteta (nonfiction literature).</li> <li>7. Teksti ka tendencë të fuqishme (konativiteti).</li> <li>8. Njohje politike e shoqërore e realitetit.</li> <li>9. Trajton tipiken faktike.</li> <li>10. Tejkuptimi (konotacioni, figura...)</li> <li>11. Ligjërimin e zgjedh autori.</li> <li>12. Lexuesi ka liri në interpretimin e tekstit publicistik.</li> <li>13. Është komunikim me publikun.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Art i imagjinatës</li> <li>2. Nuk shqyrtion, por krijon një botë të re.</li> <li>3. Lexuesi nxjerr përfundimet.</li> <li>4. Krijon fakte, dukuri, fenomene që janë tipike për shoqërinë, ose edhe kur s'janë për shoqërinë, janë tipike për individin.</li> <li>5. Krijon fakte, dukuri, fenomene të përhershme, apo që veprojnë në një gjatësi të madhe kohore.</li> <li>6. Krijon ngjarje e personazhe të imagjinuara, apo sipas shëmbëllimit nga realiteti.</li> <li>7. Teksti nuk ka tendencë.</li> <li>8. Njohje estetike e realitetit.</li> <li>9. Tipikja përgjithëse dhe tipikja individuale.</li> <li>10. Tejkuptimi (konotacioni, figura...)</li> <li>11. Ligjërimin e zgjedh autori.</li> <li>12. Lexuesi ka liri në interpretimin e tekstit letrar (me tendencë që të rritet roli i tij në interpretimin e tekstit letrar.</li> <li>13. Është komunikim individual dhe publik.</li> </ol>

## XXIII. REPORTAZHI (RAPORTI LETRAR)

**F**jala reportazh është një prej atyre që mund të krijojë probleme në interpretim. Në fjalorët anglisht e frëngjisht ajo ka të njëjtin kuptim me raportimin në shqip: akti dhe procesi i raportimit. Fjala vjen prej frëngjishtes *reportage*: **report** (me tregu diçka që ka ndodhur apo që ke parë) + **age** (prapashtesë franceze që u jep emrave masë apo kuptim abstrakt, si *voujage*, *courage* etj.). Ndërsa në shqip (edhe në disa gjuhë të tjera) nocioni reportazh ka marrë kuptimin e atij zhanri që në anglisht, në frëngjisht e në gjermanisht quhet **raporti letrar**. Ne do ta përdorim nocionin reportazh për shkak të përdorimit tradicional të këtij nocioni në shqip, duke e dalluar qartë nga raporti: raporti është raportim i drejtpërdrejtë për një lajm vetëm përmes gjuhës së fakteve dhe me qëllim të shpjegimit faktik të lajmit, ndërsa reportazhi është përshkrim i njerëzve, i ngjarjeve, i vendeve dhe i gjërave të vërteta në mënyrë letrare dhe sipas përjetimit të reporterit. Në gjuhë të tjera reportazhi cilësohet letrar për ta dalluar nga *raporti gazetar* (nganjëherë edhe në shqip përdoret *reportazhi radioteleviziv*, në kuptimin e raportit).

### XXIII.1. QËLLIMI PËRMBAJTJESOR I REPORTAZHIT

Reportazhi është zhanër i gazetarisë letrare në të cilin raportohet për ngjarje, ndodhi, histori, për personazhe apo për vende të ndryshme duke përdorur gjuhën e letërsisë. Dallimi midis reportazhit dhe raportit është shumë i dukshëm. Kur raportohet për një aksident komunikacioni, do të ishte e pazakonshme të fillohet kështu teksti:

*Në një ditë të majit dielli po shkëlqente për bukuri në rrugët dhe sheshet e vogla të mëngjesit në Prishtinë. Tashmë qytetarët e hershëm po iknin në punët e tyre, ndërsa ata të ngeshmit ishin ulur në kafenetë e bukura bri rrugëve e shesheve dhe po rrufisnin kafet e para. Në atë mëngjes të bukur maji, një benz goditi një makinë tjetër dhe la të vdekur drejtuesin dhe bashkudhëtarin e tij...*

Por, ky tekst paradoksal do të ishte shumë i zakonshëm në një reportazh për fatin e keq të personazhit. Dallimi këtu qëndron te paradoksi midis vdekjes si akt tragjik dhe bukurisë së natyrës. Ky paradoks është gjuha e letërsisë dhe vetë ligjërimi letrar. Kjo gjuhë e letërsisë e dallon thukhtë reportazhin nga raporti. Qëllimi përmbajtjesor i reportazhit është që të informojë për një ngjarje, ndodhi, histori, për personazhe apo për vende të ndryshme dhe në këtë proces të informimit ta krijojë edhe efektin e kënaqësisë estetike të marrësi.

### PËRMBAJTJA

XXIII. Reportazhi (raporti letrar) . . . . .	341
XXIII.1. Qëllimi përmbajtjesor i reportazhit . . . . .	341
XXIII.2. Gazetari në vendin e ngjarjes: përjetimi subjektiv . . . . .	342
XXIII.3. Detaji është shpirti i reportazhit . . . . .	343
XXIII.4. Dramaciteti: pa dramë nuk ka reportazh! . . . . .	344
XXIII.5. Tema e reportazhit . . . . .	344
XXIII.6. Ndërtimi strukturor i reportazhit . . . . .	344
XXIII.7. Nata e parë . . . . .	345
XXIII.8. Reportazhi shqip . . . . .	346

Qëllimi përmbajtjesor i reportazhit është që të informojë për një ngjarje, ndodhi, histori, për personazhe apo për vende të ndryshme dhe në këtë proces të informimit të krijojë edhe efektin e kënaqësisë estetike të marrësi. Për këtë qëllim gazetari përdorë të gjitha mjetet gjuhësore të letërsisë të cilat nuk kundërshtohen me të vërtetën e faktit gazetar.

Për këtë qëllim gazetari përdor të gjitha mjetet gjuhësore të letërsisë të cilat nuk kundërshtohen me të vërtetën e faktit gazetar. Këtë përkufizim të mjeteve gjuhësore të letërsisë duhet sqaruar edhe pak. Metafora e metonimia nuk janë në kundërshtim me të vërtetën e faktit gazetar, përkundrazi, kur janë të goditura mirë, ato e sforcjnë të vërtetën e faktit gazetar. Mirëpo, hiperbola e litota mund të jenë ndonjëherë në kundërshtim me të vërtetën e faktit gazetar. Për shembull: nëse gazetari thotë për personazhin e tij “nuk ka qenë as njëherë të vetme në kontroll te mjeku” (litotë për: ka qenë shumë rrallë), apo nëse thotë “ka qenë një mijë herë në kontroll te mjeku” (hiperbolë për: ka qenë shumë shpesh), nuk është shumë e sigurt se këto dy fjali janë në pajtim me të vërtetën gazetare, rrjedhimisht duhet pasur kujdes në përdorimin e tyre dhe të figurave të tjera stilistike të cilat nxisin kundërshti me të vërtetën e faktit gazetar.

Reportazhi qenëson si paraqitje letrare e ngjarjeve, vendeve e personazheve të vërteta, të cilat paraqesin çastet më të rëndësishme të një ndodhie a procesi apo tiparet më karakteristike të njerëzve. Autori i reportazhit shfrytëzon mjetet letrare, si përshkrimin, karakterizimin, dialogun, figurshmërinë etj., për të paraqitur një ngjarje apo një personalitet. Si shihet, janë dy anë themelore të reportazhit: lajmi (fakti, dokumenti) dhe letërsia (mënyra e paraqitjes).<sup>4</sup> Kështu, reportazhi është edhe informim, por edhe përshkrim a rrëfim letrar i ngjarjes, edhe përjetim subjektiv i asaj ngjarje. Reporterit mund të shkruajë një temë në raport dhe për të njëjtën të shkruajë një reportazh, por për dallim nga raporti, në reportazh ka përjetim subjektiv të temës dhe përshkrim letrar.

Në esencë, dallimi midis këtyre dy llojeve është te masa e informacionit dhe te masa e literaritit që bart reportazhi. Nëse mbizotëron informacioni atëherë kemi të bëjmë me raportin gazetar, ndërsa nëse mbizotëron literariteti në paraqitjen e informacionit atëherë kemi të bëjmë me raportin letrar (reportazhin). Nëse në një reportazh mbisundon fuqishëm literariteti mbi informatën, reportazhi anon shumë kah letërsia, saqë disa forma të tij më shumë përkufizohen si letërsi sesa si publicistikë.

## **XXIII.2. GAZETARI NË VENDIN E NGJARJES: PËRJETIMI SUBJEKTIV**

Nëse reportazhi është përjetim subjektiv i ngjarjes, gazetari duhet të jetë i pranishëm në vendin e ngjarjes për ta shkruar reportazhin. Njëjtë sikur te raporti, autori nuk mund ta shkruajë raportin pa qenë

Në esencë, dallimi midis raportit dhe reportazhit është te masa e informacionit dhe te masa e literaritit që bart reportazhi. Nëse mbizotëron informacioni atëherë kemi të bëjmë me raportin gazetar, ndërsa nëse mbizotëron literariteti në paraqitjen e informacionit atëherë kemi të bëjmë me raportin letrar (reportazhin).

i pranishëm vetë në vendin e ngjarjes. Ndërsa lajmi shkruhet edhe pa lëvizur nga tavolina e kompjuterit. Derisa raporti informativ shkruhet duke qenë drejtpërdrejt në vendin e ngjarjes, mu në çastin kur ndodh ngjarja apo sapo ka përfunduar ngjarja, apo edhe një kohë më vonë (por më së largu të nesërmen për reporterët e gazetave!), reportazhi (raporti letrar) mund të shkruhet në komoditetin e dhomës së punës, në tavolinë pune, pasi të keni kaluar një ditë të lodhshme në një fshat ku keni hulumtuar ngjarjen lajmore, e cila ka mundur të ndodhë edhe shumë më herët. Duke qenë vetë pjesë e vendit të ngjarjes, gazetari flet me aktorët e ngjarjes, identifikohet me vende e personazhe etj., atëherë ai zakonisht bëhet edhe vetë pjesë e reportazhit, bëhet personazh i reportazhit, rrëfen edhe për veten, se si e ka përjetuar ngjarjen dhe atë përjetim të tij e bart edhe në tekst. Pra, ai mund të flasë edhe për veten si personazh-narrator:



Nuk mund t'u besoja syve! Me të vërtetë po ndodhte diçka e tillë? Çfarë mund të bëja?

"A keni ndonjë burrë me vete?" - pyeta njërën nga gratë e vjetra.

"Jo jemi vetëm fëmijë dhe gra. Nuk e dimë se ku jemi. Kemi 8 ditë dhe 8 net në rrugë."

"Ejani me mua" – u thashë, pa e ditur se ku do t' i çoja.

"Ejani me mua", - u thashë, pa e ditur se ku do t' i çoja. John C. Acree dhe Kastriot Islami, Ç'ndodh kur ndodh diçka?/ Grupi Shqiptar i Mënxhimit të Emergjencës dhe Emergjencës e Refugjatëve Kosovare e 1999-s.

Në këtë pjesë autori edhe rrëfen, por edhe është vetë personazh i reportazhit.

### XXIII.3. DETAJI ËSHTË SHPIRTI I REPORTAZHIT

Përshkrimi apo rrëfimi i detajit është karakteristika më e rëndësishme e reportazhit. Ngjashëm me raportin informativ (kemi thënë se detaji është shpirti i raportit) reportazhi pa detajin nuk ka kurrfarë vlere. Autori zgjedh ato detaje që nuk hyjnë në grumbullin e fakteve (në raport lypen këto detaje të fakteve), por mund të paraqesin gjendje emocionale, fizike apo sociale të ngjarjes. Autori i një raporti informativ nuk merret me ndjenjat e personazhit të ngjarjes, apo me rrezet e diellit, apo me përjetimin e vet në ato qaste kur bisedon me një dëshmitar të ngjarjes, por të gjitha këto janë detaje të rëndësishme për reportazhin (raportin letrar). Pikërisht këto detaje krijojnë vlerën e reportazhit. Këtu hyn në punë vështrimi i hollë i gazetarit: ne mund të shohim çdo ditë një plak i cili tret pleqërinë bashkë me një qen në një qoshe të Sheshit "Nëna Terezë" në Prishtinë dhe të mos na bëjë asnjë përshtypje, por nëse gazetari shkruan një reportazh për fatin e tij, depërton në botën e brendshme të tij, atëherë ne do të befashemi se si nuk e kemi vërejtur më herët në atë dritë plakun.

Përshkrimi apo rrëfimi i detajit është karakteristika më e rëndësishme e reportazhit.

## XXIII.4. DRAMACITETI: PA DRAMË NUK KA REPORTAZHI!

Reportazhi duhet të ketë dramë. Mund të jetë dramë e ngjarjes, dramë e personazhit apo dramë e peizazhit. Drama, sikurse në letërsi, është pikë e kthesës, mundësisht paradoksale. Pikërisht drama dhe paradoksaliteti i krijon personazhet edhe në jetën e përditshme edhe në letërsi. Një personazh, një ngjarje apo një visore pa dramë nuk është interesant. Një fshat i tërë i lënë shkret është një dramë. Një shkollë fillore me vetëm një nxënës është një dramë. Jeta e vetmuar e një personazhi është një dramë. Nëse detaji është shpirti i reportazhit nga aspekti stilistik, drama është shpirti i raportit nga aspekti tematik.

## XXIII.5. TEMA E REPORTAZHIT

Tema e reportazhit nuk është e kufizuar në përmbajtje. Mund të shkruhet për cilëndo temë, të madhe apo të vogël, margjinale apo në qendër të vëmendjes së publikut, për një person të panjohur, apo për një autoritet publik. Mund të botohet në një faqe gazete, në një pjesë të faqes, por edhe në vazhdime (atëherë merr karakteristika edhe të fejttonit). Edhe pse nuk ka ndonjë rregull për tematikën e reportazhit, një parim vlen gjithmonë: tema e panjohur, paradoksale, e papritur për lexuesin e zakonshëm, është gjithmonë më afër suksesit se një cilado temë tjetër. Reportazhi për një ditë pune të një presidenti mund të jetë i suksesshëm, sepse lexuesi dëshiron të dijë detaje nga puna e presidentit dhe beson se ato mund t'i gjejë në një reportazh. Por, reportazhi i viteve '84 e '85 të shekullit XX për jetën e izoluar për dyzet vjet të një familjeje ruse në xhunglën e Siberisë pati pushtuar shtypin evropian, sepse pat qenë temë e papritur, aq shumë e pazakonshme sa që dukej edhe e pabesueshme. Në bazë të tematikës që trajton, ka reportazhe për fatet njerëzore, reportazhe-peizazhe (përshkrim i natyrës e i visoreve të saj), reportazhe sociale etj.

Në bazë të tematikës që trajton, ka reportazhe për fatet njerëzore, reportazhe-peizazhe (përshkrim i natyrës e i visoreve të saj), reportazhe sociale etj.

## XXIII.6. NDËRTIMI STRUKTOROR I REPORTAZHIT

Në aspektin strukturor të ndërtimit të tekstit dhe të idesë reportazhi është shumë më afër letërsisë sesa gazetarisë. Autori është i lirë ta zgjedhë strukturimin që ai dëshiron. Çdo reportazh krijohet

mbi një motiv kryesor (lajtmotiv), e i cili ndërlidhet me një sërë motivesh të tjera. Motivi është tërësia më e vogël e një veprimi apo ngjarjeje në një rrëfim apo përshkrim. Gazetari nuk ka një kufizim se çfarë temash mund të trajtojë në reportazh. Janë të mira temat të cilat nuk paraqesin lajm, por janë të papritura, ose për të cilat marrësi di në përgjithësi, por nuk e njeh esencën dhe detajet. Për shembull, varfëria është temë e njohur për marrësin në Kosovë, por një ditë jete e një familje të varfër, kjo nuk është temë e njohur për marrësin, prandaj ai e mirëpret një reportazh me atë motiv.

Përshkrimi, rrëfimi, dialogët e monologët, personazhet dhe vetë gazetari janë pjesë të strukturës tekstore të reportazhit, marrëdhënien e të cilëve e rregullon gazetari, gjithnjë sipas fakteve të vërteta. Personazhet e reportazhit dhe bota e tyre e brendshme janë pikë themelore: pa ta reportazhi mund të jetë vetëm një peizazh apo një prozë letrare. Personazhet janë jeta e gjallë e reportazhit dhe autori duhet të kujdeset që ata t'i karakterizojë saktë, sikurse personazhet e një romani. Personazhet duhet të jenë gjithmonë realë, të vërtetë, karakteristikë, të tipizuar mirë e në përputhje me veprimet e tyre, por edhe kur ka shpërputhje midis veprimeve dhe karakterit të personazhit autori duhet ta sipërfaqësojë këtë fakt. Një prej pikave kritike të reportazhit është pikërisht realizimi i mirë i personazheve: realizimi i dobët i tyre ia ul vlerën më shumë se asgjë reportazhit, dhe e kundërta. Në aspektin sasior, ka reportazhe të shkurtra dhe të gjata, por kjo nuk trajtohet si tipologji. Është thjesht çështje e qasjes së gazetarit ndaj tekstit apo edhe e natyrës së temës.

## XXIII.7. NATA E PARË

*E treguar nga Qemal Elezi nëpërmjet një përkthyesi në prefekturën e Kukësit*

Ishte ora rreth 11.30 dhe sapo kishim përfunduar një mbledhje. U nisa për në shtëpi për të parë fëmijët e mi dhe pashë se rreth 55 njerëz po qëndronin në shtëpinë time. Ata ishin shpërndarë gjithandej; në korridor, në shkallë etj. Duhet t' i strehoni ata për të mos i lënë të lageshin në shi. Vendosa të kthehesha në zyrë por, sidoqoftë, gjumi nuk mund të më merrte. Po binte shi dhe asfalti përpara prefekturës ishte mbushur disa centimetra me ujë. Pashë një grup fëmijësh dhe disa gra të vjetra jashtë në rrugë. Një grua po qëndronte në shi me një fëmijë në krah, ndërsa disa fëmijë të tjerë ishin fshehur poshtë fustanit të saj duke u ruajtur nga shiu. Nuk mund t'u besoja syve! Me të vërtetë po ndodhte diçka e tillë? Çfarë mund të bëja?

Personazhet e reportazhit dhe bota e tyre e brendshme janë pikë themelore: pa ta reportazhi mund të jetë vetëm një peizazh apo një prozë letrare.

### Një fotografi që nxit në botë dhembjen për refugjatët kosovarë



Fotografi e Carol Guzy, fituese e katërfishtë e çmimit prestigjioz për Gazetari, Pulitzer. Fotografia është bërë në vitin 1999 në Kukës. Në foto është foshnja dyvjeçare Agim Shala, në Kampin e Refugjatëve në Kukës dhe familja e tij e ndarë. Guzy kështu e ka përshkruar këtë rast: "Më 3 maj telat me gjemba ndanin një familje nga Prizreni. Të ardhurit e rinj prisnin jashtë derisa të vendosnin tendat. E merrnin fëmijën dhe e kthenin vetëm për ta puthur".



"A keni ndonjë burrë me vete?" - pyeta njërën nga gratë e vjetra.

"Jo, jemi vetëm fëmijë dhe gra. Nuk e dimë se ku jemi. Kemi 8 ditë dhe 8 net në rrugë".

"Ejani me mua", - u thashë, pa e ditur se ku do t' i çoja.

Nuk duhej t' i lija në shi. Nuk mund të shikoja sa veta ishin në këtë grup. Ndërsa po ecnim u ktheva. Dukej si karvan i vogël. Vajtëm në pallatin e sportit. Kosovarët nuk kishin fuqi as të ngjishnin shkallët. Vajta brenda, por ai ishte i mbushur plot me refugjatë të tjerë. Nuk kishte vend. U ktheva te grupi. Përfundimisht munda t' i numëroj ata. Ishin 23 fëmijë dhe 8 gra të vjetra. Ata ishin të uritur, por unë nuk kisha ushqim për ta. Vajta tek dyqani i bukës dhe bleva ca bukë. Kur u ktheva disa fëmijë po qanin.

"Ju do të jeni të sigurt", - u thashë, ndërkohë shtova: "Mos qani dhe ejani pas meje!"

I dërgova në shtëpinë time dhe i rrasa dhe ata me të tjerët në korridor. Ata ishin aq të lodhur sa gjumi i zuri para se ta ndizja cigaren. Bukën që ua kisha dhënë e kishin akoma në dorë.

(John C. Acree dhe Kastriot Islami, Ç'ndodh kur ndodh diçka?<sup>5</sup>)

## XXIII.8. REPORTAZHI SHQIP

Reportazhi u lërua dendur edhe në gazetarinë tradicionale shqiptare. Ai ka karakter informativ, por qëllimi i tij është njësoj sikur i krejt gazetarisë së Rilindjes Kombëtare: çlirimi dhe ngritja e kombit të ri modern shqiptar. Në përmbajtje ai është ose përshkrim i një ngjarjeje të rëndësishme, ose udhëpërshkrim me një qëllim të caktuar politik apo social. Kështu *Fiamuri Arbërit* botonte më 1883 një reportazh për ngjarjet rreth Lidhjes së Prizrenit me titull "Vrasja e Mehmet Ali Pashës" me një gjuhë të gjallë e faktografike.<sup>6</sup> Por reportazhi nuk kufizohet vetëm me tema kombëtare e politike, por edhe me ato sociali e ekonomike, si bën autori anonim në reportazhin e shkurtër, por interesant, "Mnashi", i cili trajton ngritjen dhe rënien e interesimit të shkodranëve për pëlhurën e mnashit.<sup>7</sup> Ka në gazetarinë shqiptare reportazhe mjaft të bukura, sidomos ato që trajtojnë punët njerëzve që sot historia u jep vend të merituar në altarin e kombit. Kështu është me reportazhin "Nji trimëri si e pleqve të moçim".<sup>8</sup>



## XXIV. FOTOREPORTAZHI

**F**otoreportazhi me reportazhin kanë të njëjtën marrëdhënie që kanë ndërmjet tyre fotolajmi me lajmin. Fotoreportazhi është një reportazh i bërë përmes fotografive të gazetarit: në vend të fjalës flet vetë fotografia. Dallimi me fotolajmin është se në fotoreportazh paraqitet jo vetëm një çast, si në fotolajm, por rrëfëhet apo përshkruhet një ngjarje, një situatë apo një histori përmes fotografive. Kjo do të thotë se gazetari përgatit një sërë fotografish të ndërlidhura midis tyre. Në secilën fotografi ka një tekst (diçiturë) që shpjegon fotografinë, ndërsa të gjitha bashkë krijojnë imazhin mbresëlënës për ngjarjen, situatën apo historinë që tregojnë. Marrëdhënia midis dy elementeve të fotoreportazhit, fotografisë dhe tekstit, është hierarkike: teksti është në shërbim të fotografisë. Teksti vetëm e shpjegon fotografinë, për ta orientuar marrësin më drejt në fotografi, apo për të dhënë ndonjë element shtesë pa të cilin fotografia do të kuptohej mangët. Si rregull vlen parimi: sa më pak tekst fotoreportazhi është më i mirë.

Gazetat dhe revistat me famë botërore u kushtojnë hapësirë gjithnjë fotoreportazheve. *Natonal Geographic* (vol. 197. No 2, February 2000) ka publikuar fotoreportazhin “Eyewitness/ Kosovo” të gazetares Alexandra Boulat, i cili përcillet me një tekst hyrës në të cilin Boulat shpjegon me fjalë fotoreportazhin e saj, i cili përmban disa fotografi të cilat tregojnë tmerrin e luftës dhe dhunën që kanë ushtruar forcat militare dhe paramilitare serbe kudo në Kosovë.

Efekti që krijon fotografia te marrësi është shumë i madh, për dy arsye: e para, ajo të ofron situatën origjinale, pa ndërmjetës, nuk është rrëfim i narratorit, por prerje e një episodi të ngjarjes, apo është narracion i drejtpërdrejt - pa narrator, *live*; së dyti, ajo i lë hapësirë marrësit që vetë ta krijojë tërësinë e ngjarjes, kjo do të thotë se fotoreportazhi nxit fantazinë e marrësit më tepër se reportazhi që ai vetë ta imagjinojë tërësinë e ngjarjes, situatës apo të historisë që bartin fotografitë e tij. Ky element i dytë e përmbush qëllimin përmbajtjesor të fotoreportazhit: të informojë duke krijuar kënaqësi estetike.





## XXV. KARIKATURA

## PËRMBAJTJA

XXV. Karikatura. . . . 349

**K**arikatura është një prej zhanreve më dinamike të gazetarisë. Ajo paraqet një temë (një situatë, një personazh apo një ngjarje) përmes vizatimit, por nga aspekti komik i temës. Nga këtu vjen edhe emri i saj: nga italishtja *caricare*-ngarkim, që do të thotë ngarkim i vizatimit deri në tepri me elementin më të theksuar të temës. Për shembull, karikatura e një personi bëhet duke theksuar deri në tepri një element karakteristik të fizikumit të atij personi, apo një devijim të fizikumit të tij, ose duke paraqitur deri në tepri një anë karakteristike të tij.

Karikatura shërben kryesisht për të thumbuar, ironizuar e satirizuar ngjarje, persona apo situata të ndryshme. Zakonisht ajo përbëhet vetëm prej vizatimit, por është edhe karikatura tjetër që përcillet prej një teksti të shkurtër, i cili është në shërbim të vizatimit. Koha ditore në çdo numër të saj boton një karikaturë të autorit Jeton Mikullovc, kryesisht pa tekst. Ndërsa Agim Qena botoi për vite me radhë në të përditshmen Rilindja, pas luftës së Kosovës edhe në RTK, karikaturën-strip "Tafë Kusuri", me katër personazhe kryesore: bashkëshortët Tafa e Hava dhe fëmijët Luli e Hana. Zakonisht karikatura përbëhej prej tri pjesëve, përmes të cilave bartet mesazhi i karikaturës.

Karikatura është zhanër hibrid: përbëhet nga vizatimi (mënyrë e shprehjes figurative), nga informatat që përcjell (gazetari) dhe nga mesazhi satirik e argëtues (gazetari argëtuese). Ajo me njërin këmbë është në gazetarinë letrare e me tjetrën në gazetarinë argëtuese. Megjithatë, për shkak të mbizotërimit të vizatimit dhe të efekteve të tij, ajo rri më afër gazetarisë letrare dhe qëllimi përmbajtjesor i saj është bartja e informatave duke e kënaqur estetikiisht marrësin dhe duke e argëtuar.



Karikaturë për shkrimtarin e famshëm satirik turk Aziz Nesin: burokratët qeveritarë e kanë vënë në litar satirikun dhe ai rri mbi librat e tij; presidenti turk Bylent Exhevit kënaqet së qeshuri duke lexuar librat e tij, mirëpo çdo libër i tërhequr për lexim, Nesin-i ia shtrëngon litarin.



## XXVI. UDHËPËRSHKRIMI

Është një prej gjinive më të vjetra tekstore dhe më me ndikim. Është shkruar me të njëjtin pasion e fuqi si në antikë, në Mesjetë e ashtu edhe në kohën e romantizmit. Nuk mund të vërtetohet saktësisht në ka lindur udhëpërshkrimi prej letërsisë apo një pjesë e letërsisë ka lindur prej udhëpërshkrimeve, por dihet saktësisht se epi *Odisea* i Homerit është një ep që këndon për rrugën e gjatë 12 vjet të Odiseut, gjatë së cilës ai e njuh botën. Dihet se romani udhëpërshkrues dhe ai aventurier kanë lindur prej udhëpërshkrimeve faktike. Edhe sot nocioni udhëpërshkrim gjallon në dy kuptime: si publicistikë dhe si letërsi. Letërsia që lidhet me temën e përshkrimit të udhëtimeve, romani udhëpërshkrues, romani aventurier etj., është prej letërsive më të kultivuara. Ky është udhëpërshkrim fiktiv (letrar) dhe jo faktik. Të tillë libra ka shumë: *Komedia Hyjnore* (1321) e Dante Aligerit është përshkrim i rrugës nëpër botën e përtejme, *Don Kishoti* i Servantesit (1547-1616) është një histori tragjikomike e udhëtimeve, *Udhëtimet e Guliverit* (1726) e Jonathan Sviftit është përshkrim i udhëtimit të Guliverit në katër botë të ndryshme, e një udhëpërshkrim filozofik-imagjinar është edhe *Candidi* (1759) i Volterit e shumë e shumë vepra të tjera me autoritet të madh në kulturën perëndimore, e në kohën e re deri te *Baudolino* (2000) i Umberto Ekos.

Ndryshe nga letërsia që përshkruan udhëtimet, është zhvilluar edhe gjinia publicistike e udhëpërshkrimeve, e cila shpesh trajtohet edhe si letërsi dokumentare (*nonfiction literature*), pra një letërsi që bazohet në tregime, përshkrime dhe në fakte të vërteta. Ky lloj publicistik ka lindur nga udhëtimet e njerëzve nëpër vende të ndryshme dhe nga shkrimet që kanë lënë ata. Para se të diskutohet më tej rreth këtij lloji zhanror, duhet bërë dallimin e qartë midis udhëpërshkrimit si zhanër i gazetarisë letrare, në njërën anë dhe tri zhanreve të tjera që kanë të bëjnë ose mund të ndërlidhen me temën e përshkrimit të udhëtimeve:

- letërsia e përshkrimit të udhëtimeve (epet e romanet e udhëpërshkrimeve e ato aventuriere);
- përshkrimit të gjeografëve të vjetër (Straboni, p.sh.);
- librat guida.

Për dallim nga letërsia e përshkrimit të udhëtimeve, udhëpërshkrimi publicistik është faktik; për dallim nga përshkrimi gjeografik, udhëpërshkrimi publicistik nuk është shkencor; për dallim nga librat guida, udhëpërshkrimi publicistik shkruhet për secilin lexues e jo si libra guida vetëm për turistët.

## PËRMBAJTJA

XXVI. Udhëpërshkrimi.	351
XXVI.1. Qëllimi përmbajtjesor i udhëpërshkrimit .	352
XXVI.2. Faktet dhe udhëpërshkrimi . . . . .	353
XXVI.3. Literariteti i udhëpërshkrimit . . . . .	354
XXVI.4. Udhëpërshkrimi shqip . . . . .	355



Pullë postare e Marokos, në kujtim të 700-vjetorit të **Ibn Battutah** (**Muhammad Ibn Battuta**) (25 shkurt 1304-1368 ose 1369). Ai ka qenë mysliman berber (Maroku), filozof dhe një prej udhëtarëve më të mëdhenj të të gjitha kohëve. Udhëtimet e tij i ka botuar me emrin **Rihla** (Udhëtimet).



Marco Polo (Republika e Venedikut 1254-1324) nuk ka qenë evropiani i parë që ka udhëtuar në Kinë, por është i pari që ka lënë shënime detaje dhe ka botuar librin *Il Milione* nga këto udhëtime, e i cili libër ka inspiruar shumë udhëtarë të tjerë në Evropë, midis të cilëve edhe Kristofer Kolombon.

**Travelogji** (ang. *travel*+ greq. *logia*).

Krahas travelogjisë përdoren edhe nocionet *Travelogy Literature* dhe *Itinerary Literature*.

Udhëpërshkrimi publicistik është i vjetër, ende përpara se të ekzistonte shtypi. Udhëtari grek Pausanias (rreth 150-180 e.r.) shkroi librin *Përshkrimi i Greqisë*, i cili është një përshkrim letrar i fakteve. Në Mesjetë është i njohur libri i udhëpërshkrimeve të Marko Pollos (1254-1324) *Il Milione*. Ndërsa, gjatë historisë, pothuajse të gjithë emrat e mëdhenj të kulturës, sidomos të kohës së re, mbas “zbulimit” të botës, kanë shkruar udhëpërshkrime. Janë bërë të famshme ato të emrave të dalluar në një fushë tjetër, si Samuel Johnsonit (1709-1784), Charles Dickensit (1812-1870), J. W. Goethe me *Udhëtime italiane* (1816) etj. Në shekullin XIX udhëpërshkrimi bëhet zhanër shumë i kërkuar nga lexuesi evropian. “Kategoria e historisë, gjeografisë, udhëtimeve (udhëpërshkrimeve, plotësimimi, B. K.), në rritje të plotë, përbën rreth 10 % të totalit të botimeve në vitet 1812.”<sup>9</sup>

Në fjalorët më të rëndësishëm botërorë, si në *Encyklopedia Britanica*, ka hyrë një nocion që shpreh këtë lloj publicistik: **travelogji** (ang. *travel*+ greq. *logia*). Krahas travelogjisë përdoren edhe nocionet *Travelogy Literature* dhe *Itinerary Literature*.



Rruga që bëjnë Marko Pollo dhe Ibën Battuta.

## XXVI.1. QËLLIMI PËRMBAJTJESOR I UDHËPËRSHKRIMIT

Në botën bashkëkohore duket sikur ka rënë interesimi për udhëpërshkrimin, mbase për shkak të revolucionit informativ, i cili i mundëson njeriut ta njohë botën (ose ta krijojë iluzionin e




njohjes?!) skaj më skaj edhe përmes filmit në televizion, apo edhe në kompjuter. Kush ka parë e nuk është magjepsur me aventurat udhëpërshkruese të Bear Gryllsit, të filmuara, udhëpërshkrime subjektive dhe më të skajshmet që mund të realizohen në shiritin filmik? Në udhëpërshkrimet televizive ka një gërshetim të përkryer midis fotografisë së gjallë dhe rrëfimit subjektiv të autorit. Autori rrëfen perceptimet e tij në një tekst unik dhe, krahas tekstit, kamera jep pamje që ndërlidhen me rrëfimin e autorit. Duke parë udhëpërshkrime të këtilla, pamje të gjalla të botës në të gjitha përmasat e saj, të krijohet përshtypja se udhëpërshkrimi i shkruar është para vdekjes. Sidomos pas lansimit të programeve 3D hartografike, përmes të cilëve nga kompjuteri mund të hulumtosh pjesë të ndryshme të globit. Udhëtimet virtuale në 3D të krijojnë me të vërtetë ndjesinë se po e jeton një botë tjetër brenda kompjuterit tënd. Por, a është e vërtetë se po shuhet udhëpërshkrimi? Ndoshta po! Është fakt se edhe në kohën më të re autorë të ndryshëm janë duke bërë emër me udhëpërshkrime, si Kira Salak (lindur 1971), e cila ka bërë karrierë duke udhëtuar dhe duke shkruar për vendet e vizituara e duke i botuar ato shkrime në *National Geographic*, pastaj në dy libra: *The Cruellest Journey: 600 miles to Timbuktu* (2004) dhe *Four Corners: A Journey into the Heart of Papua New Guinea* (2001). Por, edhe Kira Salak ka shkruar udhëpërshkrime për vende të panjohura shumë prej publikut dhe, ky është fakti se zbulimi i botës cep më cep do ta marginalizojë deri në shuarje udhëpërshkrimin.

## XXVI.2. FAKTET DHE UDHËPËRSHKRIMI

Udhëpërshkrimi është përshkrim dhe rrëfim kronologjik i visoreve, i njerëzve dhe ngjarjeve, si dhe i temave që lidhen me një rugëtim. Karakteristika e parë e tij është informacioni i ri që sjell për një pjesë të botës. Kjo dikur ka pasur një efekt më të madh. Atëbotë zbulimi i botëve të reja, i popujve dhe i kulturave të reja ka ngjallur të njëjtat emocione sikur sot hulumtimi i planetëve të reja dhe i formave të tjera të jetesës së mundshme në kozmos. Kjo ide ka nxitur imagjinatën për një botë të re, e kjo ide ka vepruar deri në shekullin XX, kur besohet se ajo që ka ekzistuar mbi sipërfaqen e tokës tashmë është zbuluar. Udhëpërshkrimi sjell të dhëna të plota, fakte, njerëz, kultura, mendime, visore, emra e deri edhe gjëra fantastike (kujto Marko Pollon), të cilat marrësi nuk i ka njohur më parë ose ka pasur një gjysmë informacion.

Një përgjigje më shumë në favor të konstatimit se ende nuk ka përfunduar historia e udhëpërshkrimit lidhet me faktet e reja që



Shënime dore të Kristofor Kolombos në dy faqe të botimit latin të *Il Milione*.

Udhëtimet virtuale në 3D të krijojnë me të vërtetë ndjesinë se po e jeton një botë tjetër brenda kompjuterit tënd. Atëherë, a është e vërtetë se po shuhet udhëpërshkrimi? Ndoshta po!



Esenca e udhëpërshkrimit është paraqitje e së resë, por kjo "e re" nuk është vetëm gjeografi, vetëm një tokë e panjohur. Ajo është edhe **perceptim i ri i botës** për të cilën flet autori.

duhet t'i sjellë një udhëpërshkrim dhe mungesën e atyre fakteve (sepse bota është zbuluar dhe më s'ka fakte të reja!). Esenca e udhëpërshkrimit nuk është, si mendohet lehtësisht, vetëm sjellja e një bote të re apo një visore të re te marrësi. Pa dyshim se esenca e udhëpërshkrimit është paraqitje e së resë, por kjo "e re" nuk është vetëm gjeografi, por është edhe **perceptim i ri i botës** për të cilën flet autori. Ju mund të bëni një udhëpërshkrim të mirë për Prishtinën dhe lexuesin ta keni prishtinas, nëse perceptimi juaj për Prishtinën është i ri. Prandaj në shkrimin e udhëpërshkrimit autori duhet të mendojë më shumë për të krijuar atë "perceptim të ri". Udhëpërshkrimi i V. S. Naipaul *India: A Wounded Civilization* (1977), nisur nga një udhëtim nëpër Indi, nuk sjell asnjë botë të re para lexuesit, por është përsiatje për fatin në zhdukje të një kulture dhe është një prej udhëpërshkrimeve më të përmendura.

Është edhe një fakt tjetër që e bën udhëpërshkrimin gjithnjë të ri. Ai fakt është detaji. Nëse udhëpërshkrimi ka detaje të bollshme, atëherë ai është i freskët, pavarësisht se mund të jetë i shekullit XXI, tashmë kur nuk ka mbetur asgjë pa u zbuluar në tokë. Mund të shkruani një udhëpërshkrim për Nju Jorkun, për Pekinin apo për Najrobin, me kusht që ta keni syrin dhe mendjen e mprehtë për të vërejtur detaje të cilat asnjë nga udhëpërshkruesit e mëhershëm të atyre vendeve nuk i ka vërejtur. Aftësia e udhëpërshkruesit është te gjetja e detajit paraqitës, edhe këtu vlen parimi: sa më pak fjalë e sa më shumë kuptime të tyre. Sa më shumë detaje karakterizuese aq më i mirë është udhëpërshkrimi. Perceptimi i ri i botës, i njerëzve dhe i kulturave të ndryshme, në njërin dhe, detaji i ri, në anën tjetër, japin shpresë se udhëpërshkrimi mund të ekzistojë edhe më tutje.

### XXVI.3. LITERARITETI I UDHËPËRSHKRIMIT

Karakteristika e dytë e udhëpërshkrimit është literariteti i tij. Ai është art i peizazhit, art i përshkrimit të popujve e të kulturave të ndryshme, art i karaktereve të njerëzve e të popujve por, para së gjithash, është art i gjeografisë. Ligjërimi është i gjallë, plot emociione e të papritura, i rrëfyer kryesisht në veten e parë nga vetë autori, si përjetim subjektiv i botës që e rrethon. Duke qenë nga aspekti strukturor një formë e thjeshtë e lineare (përshkrim kronologjik i vendeve, njerëzve dhe kulturave), udhëpërshkrimi nuk mund të krijojë efekt të madh si letërsi. Efekti i temës dhe i motiveve që sjell gjithnjë e mundin literaritetin e tij. Përmbajtja, motivet që përshkruhen, ato janë thelbi i udhëpërshkrimit, ndërsa literariteti, bashkë me strukturën ndërtimore të tekstit, mbetet nën hijen e

Efekti i temës dhe i motiveve që sjell udhëpërshkrimi gjithnjë e mundin literaritetin e tij.

përmbajtjes. Nga aspekti i strukturës, po të shërbehemi me një metaforë, udhëpërshkrimi mund të quhet kronikë e gjeografisë.

Sasia e literaritetit nuk është e njëjtë në çdo udhëpërshkrim: disa sjellin më shumë fakte e të dhëna të tjera për rrugët kah kalonjë, ndërsa disa sjellin edhe një shtresë të gjerë të literaritetit për ato rrugë. Udhëpërshkrimi nuk është vetëm shifra, apo interesim i veçantë shifror, statistikor, shkencor etj., por është përjetim dhe interpretim i botëve të tjera, të ndryshme nga ajo në të cilën autori jeton. Nga kjo, faktet që sjell një tekst, të dhënat, emrat e shifrat etj., nuk e bëjnë atë tekst udhëpërshkrim. Atë e bëjnë të tillë përjetimi dhe rrëfimi i përjetimit për botët e ndryshme.

Përshkrimi në këtë lloj është në vetën e parë, kryesisht në kohën e kaluar (*dolëm nga qyteti dhe bëmë një ditë rrugë deri në Mirditë*), por ka udhëpërshkrime edhe në kohën e tashme (*dalim nga qyteti dhe bëjmë një ditë rrugë...*), ose në të tashmen historike (*dolëm nga qyteti dhe bëjmë një ditë rrugë...*). Zakonisht ai shkruhet si rrëfim (narracion), por ka edhe të atillë që shkruhen edhe në formë të ditarit, e ka edhe në formë të letrave drejtuar një personi: autori në vend të kapitujve të librit, shkruan letra për një person të dytë dhe aty përshkruan rrugëtimin e tij. Nga tipi i ligjëratës udhëpërshkrimet shkruhen kryesisht si tregim i gjatë, por ka raste kur shkruhet si ese, si është *Candidi* i Volterit ose libri që përmendëm më sipër i V. S. Naipaulit.

Janë edhe dy elemente tjera të rëndësishme për udhëpërshkrimin e që duhen përmendur: rëndësia kulturore e historike dhe rëndësia didaktike e gjeografike e tij. Udhëpërshkruesit kanë takuar popuj të rinj e të ndryshëm, kultura të reja e të ndryshme nga e tyrja dhe, udhëpërshkrimet e tyre gjithmonë kanë rëndësinë në këtë drejtim. Ato kanë mbetur materiale të rëndësishme të historisë së njerëzimit. Në anën tjetër, hartat e para të botës janë bërë, deri vonë, përmes rrugëtimit: gjeografët kanë marrë veglat me vete dhe janë nisur rrugëve për të përshkruar dhe vizatuar gjeografinë e botës. Nga ky aspekt, udhëpërshkrimet kanë karakter didaktik sepse mësojnë lexuesin (marrësin) me visore, me fakte dhe me pamje të reja e të ndryshme të botës.


## XXVI.4. UDHËPËRSHKRIMI SHQIP

Në historinë e gazetarisë shqiptare udhëpërshkrimi është kultivuar shumë. Kështu janë tri reportazhet e Faik Konicës: Shqipëria e Mesme, Shqipëria e Sipërme dhe Shqipëria e Veriut-problemi i guvernimit të saj, të cilat janë shkruar midis udhëpërshkrimit dhe komentit.<sup>10</sup>



## XXVII. UDHËRRËFYESI (GUIDA)

**O**rigjinalisht fjala *guidë* tregon një a më shumë persona që udhëheqin një grup turistësh në një vend, e të cilët janë njohës të mirë të atij vendi. Zakonisht *guidat* kanë shërbyer nëpër male e bjeshkë, vende këto të rrezikshme për turistin e paregjur, por kanë shërbyer edhe nëpër qytete, sidomos nëpër vendet e dalluara historike etj. Turistët angazhojnë guidët për t'i udhëhequr nëpër vende të caktuara, qoftë për shkak të mosnjohjes së terrenit, qoftë për shkak të rrezikshmërisë së terrenit apo për shkak të njoftimit me të dhëna të rëndësishme për vendin. Guida tregon për gjërat më interesante të vendit të vizituar, për monumentet kulturore, për historinë apo për ndodhi të tjera të rëndësishme. Fjala ka hyrë në përdorim nga anglishtja mesjetare, e ardhur aty nga frëngjishtja e vjetër "witan" në kuptimin "show the way" (sheh rrugën). Emërtimi *guida* tashmë është internacional, por në shqip mund të përdoret saktë edhe emërtimi *udhërrëfyes*. Nga aktiviteti i këtyre udhërrëfyesve ka lindur një zhanër i gazetarisë letrare.



### PËRMBAJTJA

XXVII. Udhërrëfyesi (guida) . . . . .	355
XXVII.1. Lindja e udhërrëfyesit dhe qëllimi përmbajtjesor i tij . . . . .	358
XXVII.2. Tipa të udhërrëfyesve . . . . .	358

Ballina e *Albania and Kosovo Blu Guide* e James Pettiferit, botim i tretë, 2001, Londër. Libri u përkthye dhe u botua edhe në gjuhën shqipe në vitin 2003



## **XXVII.1. LINDJA E UDHËRRËFYESIT DHE QËLLIMI PËRMBAJTJESOR I TIJ**

Ky zhanër quhet guida apo udhërrëfyes, sipas emrit të udhëheqësve të fushatave turistike. Këta janë libra udhërrëfyes. Përmbajnë të dhëna të shumta për faktet esenciale në një vend apo rajon turistik. Udhërrëfyesit kanë filluar të shkruhen në Mesjetën e mesme, në dhe rreth botës arabe. Qysh në shekullin IX, për interesa të gjahtarëve të thesareve e të artefakteve, si dhe për interesa të alkimistëve të ndryshëm e të gjahtarëve të Egjiptit të lashtë etj., aventurierët arabë kanë shkruar libra udhëzues se si të arrihet deri te thesaret. Këtu zë fill zhanri që më vonë do të konsolidohet si guidë (udhërrëfyes).

Guidat moderne kanë filluar të shtypen në Angli dhe në Gjermani. Guidat e Karl Baedekerit në Gjermani (1835) dhe të John Murrayt III në Angli (1836) kanë qenë shumë të popullarizuara, të ndërlidhura me udhëpërshkrime dhe janë përdorur deri në shekullin XX. Mbas Luftës së Parë Botërore, sidomos mbas të Dytës, është rritur numri i librave guide. Ato i shkruajnë autorë të ndryshëm, që nga udhëtarë të pasionuar e deri tek ushtarët që kanë marrë pjesë në luftëra dhe kanë mbajtur shënime, ndërsa pas luftës rikthehen në ato vende dhe i shkruajnë guidat e tyre. Me revolucionin informativ është krijuar mundësia edhe për guidat elektronike.

Guidat shkruhen për turistët. Ky është thelbi i saj, që e dallon nga aspekti i përdorimit. Ajo përmban detaje nga gjeografia e një vendi, shënime për qytetet, për vendet turistike, për lumenjtë, liqenet, për teatrot, shtëpitë e shëndetit, madje sjell detaje të sakta për numrat më të rëndësishëm të telefonit (të policisë, të spitalit etj.), jep shënime të gjëra për qeverisjen, për kulturën e banorëve të atij vendi, për ushqimin dhe gjellët e mira tradicionale, për historinë e tij, për prirjet etnike e kulturore etj. Me një fjalë, gjithçka që mund t'i interesojë apo i duhet në rast nevojë një turisti në një vend të huaj, atë përmban guida (udhërrëfyesi). Po ashtu, librat guide botojnë harta të vendeve të ndryshme, fotografi të shumta, shënime statistikore etj.

## **XXVII.2. TIPA TË UDHËRRËFYESVE**

Duke qenë se guida është një udhërrëfyes për interesa të turistëve, ajo u përshtatet atyre deri në fund, qoftë për nga qëllimi i përdorimit apo nga fusha të caktuara në të cilën përqendrohet. Nga aspekti i përdorimit librat guide mund të jenë të orientimeve të ndryshme,




që nga paraqitjet serioze deri te guidat argëtuese e relaksuese për një turist. Ndërsa është shumë më e zhvilluar ndarja e guidave sipas fushave të ndryshme të interesimit. Kështu, ka guidë kulture, guidë për turizmin ekstrem, guidë për trashëgiminë kulturore, guidë fotografike të një vendi, guidë të vendeve sportive, guidë gjahu etj. Secila prej këtyre guidave është e përcaktuar posaçërisht në fushën e vet dhe sjell të dhëna për atë fushë, qoftë në një vend, apo në një rajon të caktuar. Kështu, guida e gjahut është e mbushur me fakte për gjahun në një vend apo në një rajon, për mundësitë e gjahut, për ligjet e gjahut të atij vendi, për shoqatat e gjahut, për shtazët që gjuhen dhe plot e përplot të dhëna të afërta me gjahun.

**Blu Guide.** Në mesin e tipave të udhërrëfyesve më e njohura është bërë *Guida Blu*. Janë udhërrëfyes me të dhëna për artin, kulturën dhe arkitekturën e një vendi. Libri i parë *Blue Guide* u botua më 1918, *London and its Environs*, nga vëllezërit skocezë James dhe Findlay Muirhead. Emrin *Blue Guide* e ka marrë rastësisht, vetëm sa për ta dalluar nga kopertina e kuqe e guidave të famshme të gjermanit Karl Baedeker (1801-1859). Blu guidat më të njohura janë: *Blue Guide Greece* e Stuart Rossiterit (1923-1982); *Blue Guide Rome and Environs* (1971), *Florence* (1982), *Venecie* (1980) të Alta Macadamit etj. Në shqip është e njohur guida *Albania* (1997) e Agim Nezës dhe *Blu Guida Shqipëria dhe Kosova* (botim i tretë 2001) e James Pettiferit.

**Seria Bradt.** Emri *Blu Guide* tregon se tipizimi i tyre nuk ka të bëjë me përmbytjen apo me strukturën, por me një fakt rastësor. Një fakt anësor ka krijuar tipin e *Guidave Bradt* (Bradt Travel Guide). Kjo është një seri guidash të cilat e kanë marrë emrin prej themelueses së serisë Hilary Bradt (lindur 1941). Është seri e guidave ekzotike, si *Guida për Zanzibarin* (shtatë botime), *Guida për Etiopinë* (pesë botime), *Guida për Shqipërinë* (botim i tretë, 2008) e Gillian Gloyerit, *New Zealand Wildlife* (2009) e Julian Fitterit, *100 Animals to see before They Die* (2007) e Nick Garbut dhe Mike Unwinit etj.

Sot ka shumë botues që kanë krijuar seritë e tyre të guidave. Ne përmendëm vetëm një prirje ekzotike të një serie (Bradt), jo pse këto seri të veçanta krijojnë zhanre të veçanta, por vetëm sa për t'i pasur parasysh prirjet e botuesve për klasifikimin e guidave.

Në botën bashkëkohore shumë më të kërkuara vazhdojnë të jenë guidat turistike kulturore të qyteteve apo të shteteve të ndryshme. Në shqip janë të njohura guidat turistike verore të cilat i ka çdo qytet bregdetar shqiptar, e të cilat u hyjnë në punë pushuesve plazhistë. Mirëpo gjithnjë e më shumë ka interesim prej qyteteve të vjetra historike për shkrimin e guidave moderne për trashëgiminë shekullore të tyre.





## XXVIII. POLEMIKA

**E**mërtimi polemikë është i frëngjishtes (*polemique*) dhe vjen prej *polemikos* (*polemos*) nga greqishtja e vjetër, e që do të thotë luftë. Polemika si koncept dhe praktikë shprehjeje ka ardhur në gazetari nga jeta publike, politike dhe nga letërsia. Në parim polemika është praktikë dhe art i kundërshtive e i kontroverseve, debat i ashpër deri edhe te ndeshja e dy e më shumë koncepteve për një çështje letrare, filozofike, politike etj., e shprehur në media apo në publik, me ç'rast njëra palë mbron me zjarr tezat e saj dhe sulmon edhe më me zjarr tezat e kundërshtarit. Nga ky konceptim është krijuar edhe forma publicistike e shprehjes që, po ashtu, quhet polemikë.

Polemika është një tekst i shkurtër apo i gjatë, mund të jetë edhe një libër, i shkruar zakonisht në prozë, në të cilin autori u kundërvihet vendosmërisht tezave, mendimeve, argumenteve të një personi apo grupi individësh, për t'i mohuar ato, në mënyrë që t'i pohojë tezat, mendimet dhe argumentet e tija. Kjo është vetëm njëra anë e polemikës. Për t'u zhvilluar një polemikë, zakonisht (por jo domosdoshmërisht) janë dy persona apo dy grupe që polemizojnë midis tyre. Atë që bën ana e parë, e bën edhe ana e dytë, vetëm se në drejtim të kundërt.

Historikisht, edhe pse polemika ka qenë e njohur edhe më herët, si formë e veprimit intelektual-kritik është themeluar në debatet polemike të apologetëve kundër heretikëve gjatë krishterimit të hershëm, në të cilat sulmonin dhe mohonin doktrinat heretike heterodokse, në njërin dhe mbronin prejardhjen e shenjtë të Krishtit dhe autoritetin e Kishës e të fesë. Polemika është karakteristike, në radhë të parë, e njerëzve që kanë një qëndrim filozofik kundërshtues ndaj pothuajse gjithçkaje në jetën shoqërore e publike, apo edhe e atyre temperamenteve të njerëzve të cilët nuk mund të qëndrojnë pa kundërshtuar publikisht atë që ata e shohin si të keqe, të prishur, të kalbur dhe të cilën duhet luftuar. Po ashtu, polemika zhvillohet edhe si rrjedhojë e aktivitetit publik të individëve të ndryshëm, apo si rrjedhojë e angazhimit të një grupi apo të një shoqërie për ideale të tjera politike, filozofike e sociale. Gazetaria polemiste mori hov në kohën e Revolucionit Francez. Atëherë, mediet në përgjithësi u shndërruan në armë politike.<sup>11</sup> Polemika dhe llojet e afërta me të (si pamfleti, kozeria etj.) u bënë shtyllat e medias. Në kulturën perëndimore shumë emra të mëdhenj kanë shkruar vepra të polemikës: Volteri, Hajne, Marks, Prust etj.

## PËRMBAJTJA

XXVIII. Polemika . . .	361
XXVIII.1. Qëllimi përmbajtjesor i polemikës . . .	362
XXVIII.2. Struktura tekstore . . . . .	363
XXVIII.3. Fakte të tjera të rëndësishme për polemikën . . . . .	364
XXVIII.4. Polemika shqip	365

Polemika është praktikë dhe art i kundërshtive e i kontroverseve, debat i ashpër deri edhe te ndeshja e dy e më shumë koncepteve për një çështje letrare, filozofike, politike etj., e shprehur në media apo në publik, me ç'rast njëra palë mbron me zjarr tezat e saj dhe sulmon edhe më me zjarr tezat e kundërshtarit.

Polemika nuk është vetëm një grumbull fjalësh. Para së gjithash, është një grumbull argumentesh dhe bindjesh.




## XXVIII.1. QËLLIMI PËRMBAJTJESOR I POLEMIKËS

Qëllimi përmbajtjesor i polemikës është gjetja e së vërtetës midis dy mendimeve të ndryshme e të kundërta.

Polemika konsiderohet si “luftë e ideve” për shkak se ajo gjithnjë është kritikë e drejtpërdrejtë në zbërthimin e ideve, ndërsa forca e saj dhe besueshmëria e saj nuk bazohet në efektet verbale (si te pamfleti), por në argumente, në logjikë dhe në gjuhën bindëse. Pra, polemika është debat i gjallë, i rreptë e kundërshtues, i dy individëve apo dy grupeve njerëzish, të cilat kanë ide e mendime të ndryshme për të njëjtën temë. Ata polemizojnë jo për ta diskredituar e shkatërruar njëri-tjetrin, por për të argumentuar të drejtën e tyre. Qëllimi përmbajtjesor i polemikës është gjetja e së vërtetës midis dy mendimeve të ndryshme e të kundërta. Që të ndodhë kjo, polemistët mundohen të gjejnë argumente bindëse e të përdorin një gjuhë bindëse.



Ismail Kadare (1936): Identiteti shqiptar?



Rexhep Qosja (1936): Identiteti shqiptar?

Polemika e fundit e madhe shqiptare ka filluar midis dy emrave të mëdhenj të letërsisë bashkëkohore: Ismail Kadaresë dhe Rexhep Qosjes. Duke folur për identitetin shqiptar modern, Ismail Kadare në vitin 2006 botoi sprovën *Identiteti evropian i shqiptarëve*, në të cilën, ndër të tjera, thotë se shqiptarët janë pjesë e trungut evropian, prandaj edhe në identitetet e tjera, në radhë të parë në atë fetar, duhet të njëjtësohen me Perëndimin, pra me krishterimin. Rexhep Qosja, në librin *Realiteti i shpërfillur (Vështrim kritik mbi pikëpamjet e Ismail Kadaresë për identitetin shqiptar)*, (2006), i kundërvihet kësaj teze duke thënë se shqiptarët, edhe pse janë trung evropian, për shkak të fatit historik (sundimit pesëqindvjeçar osman) kanë marrë shumëçka nga kultura osmane e islame, prandaj nuk mund t'i heqin ato e as nuk duhet të synojnë t'i heqin. Mbi këto dy teza është zhvilluar një polemikë e madhe, e cila ka përfshirë jo vetëm dy autorët e përmendur, por edhe dhjetëra autorë të tjerë, dhe janë botuar disa libra me pjesë të kësaj polemike, duke e shndërruar këtë polemikë në një debat të gjerë publik dhe kombëtar. Përveç librave të Qosjes, më i njohuri ndër ta është libri i historianit shqiptar Kristo Frashëri, *Identiteti kombëtar shqiptar dhe çështje të tjera* (2006).

## XXVIII.2. STRUKTURA TEKSTORE

Duke kërkuar argumente të vërteta dhe duke tentuar të përdorë një gjuhë të saktë, polemika krijon një afri me trajtesën shkencore. Po ashtu, polemika ka një strukturë të organizuar teksti, pak a shumë të ngjashëm me një trajtesë shkencore. Ajo ka hyrjen (autori paraqet arsyen e polemikës), ka objektin (autori paraqet tezat e kundërshtarit dhe temën e polemikës), ka kundër-argumentet ose antitezën e tij (i dërrmon argumentet e kundërshtarit) dhe ka përfundimet (triumfi i konceptit të autorit). Natyrisht se kjo strukturë nuk është e ngrirë, ajo mund të ketë digresione të ndryshme, gjuhësore apo tematike, por kjo strukturë është një kornizë brenda së cilës mund të qëndrojë çdo polemikë. Kështu, fjalimi i Ciceronit kundër Katelinin, sado që hyn drejt e në temë, megjithatë fjalja e parë: *Quosque tandem Catelino abutere patientima nostram?* (Deri kur, Katelin, do ta keqpërdorësh durimin tonë?) është hyrje në parashtresën e objektit të polemikës. Kjo fjali është e njohur si pyetje akuzë dhe ka kuptimin: Katelini ka bërë aq të këqija, dhe ai nuk po ndalet; ne (Senati i Romës) mund ta ndalojmë, por ne po e durojmë; por, ka ardhur momenti kur nuk duhet ta durojmë më etj.

Ku dallon polemika nga trajtesa shkencore? Janë dy çështje themelore:

1. Gjuha e polemikës nuk është shkencore, sado ajo ka një lidhje me gjuhën akademike. Ajo është gjuhë e publicistikës, e afërt me ligjërimin letrar.
2. Argumentet e polemistëve nuk do të thotë se janë plotësisht shkencore, pra lejohet një interpretim subjektiv i argumenteve.

**Gjuha e polemikës.** Gjuha e polemikës është elementi më i rëndësishëm i saj. Është pikërisht gjuha ajo që e veçon polemikën nga një artikull shkencor. Ajo është gjuhë me tendencë maksimale, gjuhë me mision të caktuar, aspak neutrale, gjuhë e ashpër dhe triumfuese, në të njëjtën kohë edhe cinike, përbuzëse e ironizuese. Gjuha e polemikës nuk bart një mesazh, por shumë mesazhe përnjëherësh, shumë kuptime përnjëherësh. Ajo është gjuhë e përdorur për goditje dhe jo për komunikim elementar, është pra gjuhë në rolin e armës. Prandaj edhe polemika vjen prej një fjale greke që do të thotë luftë: ajo është luftë idesh që bëhet me shpatën, me shtizën, me pushkën apo me topin e gjuhës.

**Stili.** Stili i polemikës ka një rëndësi të veçantë. Argumentet e polemikës janë thelbi i çështjes, mirëpo mënyra se si shprehen ato argumente, stili i shprehësisë së tyre është fakti që e bën të suk-

sesshme apo të pasuksesshme një polemikë. Të qenët e suksesshme për polemikën do të thotë të qenët e pranueshme për marrësin. Prandaj, stili i polemikës, sado ajo është si një artikull i argumentuar shkencërisht, nuk është stil akademik as shkencor, por një stil letrar, i shprehur me fjalë bukur tingëlluese e me shumë kuptime. Sa më shumë fjalë, më shumë kuptime, por semantikë e zbërthyeshme për marrësin mesatar, sukcesi i polemikës është më i sigurt. Sukcesi i polemikës, si shihet, nuk varet vetëm nga plotësia e argumenteve dhe nga aftësia e autorit për ta argumentuar të kundërtën, por edhe nga fuqia dhe thellësia semantike e fjalëve dhe e fjalive të saj. Prandaj polemistët janë të prirë të përdorin shprehje, formulime, frazeologji e fjali që kanë pasur më herët një sukses, apo me të cilat është mësuar marrësi për shkak të përdorimit të shpeshtë. Fjalë, frazeologji dhe fjali popullore, apo të ndonjë autori tjetër të njohur, apo ato latine janë të zakonshme në stilin e polemikës.

Pavarësisht nga fjalë e fjali tradicionale apo të autorëve të tjerë të famshëm, stili i polemikës duhet të jetë gjithnjë origjinal, i një autori. Autori duhet ta krijojë stilin e tij polemist dhe tekstit e gjuhës së tij t'ia japë vulën e tij. Kjo, e jo vetëm emri i tij firmosur në fund të polemikës, e bën polemikën vepër të tij. Polemika, më shumë se çdo lloj tjetër i publicistikës, është e lidhur me shpirtin dhe me karakterin e autorit. Përgjigjja është te përdorimi i gjuhës. Polemisti përdor stilin emocional të të argumentuarit, i jep fjalës ngarkesë emocionale më shumë se në të folurit bisedor, e kjo do të thotë se në stilin e tij ligjërimit e bart botën e tij të brendshme më shumë se në ligjërimit e tjera. Në polemikë identifikohet vetë autori dhe bota e tij e brendshme.

### **XXVIII.3. FAKTE TË TJERA TË RËNDËSISHME PËR POLEMIKËN**

Shumë autorë nisin ta shkruajnë polemikën, por përfundojnë në pamflet, mu për shkak të mosnjohjes së metodologjisë, stilit dhe gjuhës së polemikës, e që në thelb zbërthehet si mungesë e argumenteve e tezave për të polemizuar, si mungesë e aftësisë për përdorimin e gjuhës polemiste. Ata nisin në fushëbetejën e argumenteve dhe përfundojnë në bunkerin e ofendimeve, të sharjeve dhe të diskreditimit të individit. Në vend të debatit të ashpër të ideve të kundërta, teksti shndërrohet në ofendim për individin.

Edhe te polemika emri i autorit ka një domethënie të madhe. Nëse hyn në polemikë një emër me autoritet në fushën e tij, ky është

një parakusht për polemikë të suksesshme dhe gazeta i lë vend të rëndësishëm kësaj polemike. Por nëse ky emër me autoritet ka për kundërshtar një tjetër emër me autoritet, atëherë redaktorët janë të sigurt që tirazhi i gazetës do të rritet dhe mundohen ta stimulojnë polemikën dhe i japin vend të rëndësishëm në gazetë.

Polemika zakonisht nuk përfundon me një tekst. Ajo është një rragatë e gjatë e që, varësisht nga koha kur botohet gazeta, mund të jetë ditore apo javore. Është shumë më praktike polemika javore, sepse në një numër boton personi A polemikën e tij e në numrin tjetër boton personi B, kështu që marrësi ka mundësi çdo javë ta ketë një polemikë në gazetë, ndërsa autorët kanë dy javë kohë për ta përgatitur polemikën e radhës. Ka raste (shumë rrallë) kur polemika përfundon me një përfundim të përbashkët të autorëve, por shumë më shpesh ndërhyjnë vetë redaksia duke ndërprerë polemikën (redaksia deklaron se për këtë ose atë arsye, zakonisht merret si shkas "rënia e nivelit të polemikës", nuk do të botojë më atë polemikë), e ndonjëherë ajo përfundon me ndërprerje të njëanshme (njëri autor deklaron se nuk dëshiron ta vazhdojë polemikën për shkak se kundërshtari i tij ka humbur busullën, ka rënë nga niveli intelektual etj.).


Polemika botohet në gazeta, varësisht nga tema apo interesi që paraqet ajo, apo varësisht edhe nga autori i saj, redaktorët i japin faqen e merituar. Mund të botohet edhe në vazhdime, po edhe si libër. Shumë autorë përmbledhin gjithë polemikat e tyre, pavarësisht prej kohës kur janë shkruar, apo prej temave të trajtuara, dhe i botojnë në libër të veçantë.

## XXVIII.4. POLEMIKA SHQIP

Në gazetarinë shqiptare nuk bëhet gjithnjë i qartë dallimi midis polemikës dhe pamfletit. Hamit Boriçi në librat e tij, të cilat përdoren si tekste mësimore për studentë në universitet, flet vetëm për pamfletin, duke nënkuptuar brenda tij edhe polemikën, apo duke e nënkuptuar polemikën si tip ligjërimi të shumë zhanreve gazetare e jo si zhanër më vete. Mirëpo ky dallim ekziston katërcipërisht në polemikë dhe në pamflet dhe, e vërteta është se në praktikën gazetare shqiptare kjo ndarje ka ekzistuar gjithnjë. Teksti i Frang Bardhit (1606-1643) *Gjergj Kastrioti i Epirit, i quajtur përgjithësisht Skënderbe, vetë princi i fuqishëm e i pathyeshëm i Epirit, i kthehet popullit dhe vendit të tij* (Venedik, 1636) është një polemikë e dorës së parë, por në asnjë mënyrë nuk mund të quhet pamflet. Ndërsa teksti i A. Z. Çajupit (1866-1930) *Klubi i Selanikut* është një pamflet i pastër, por jo edhe polemikë.



Është i madh numri i shkrimtarëve dhe i autoriteteve të tjera publike që kanë shkruar polemika. Frang Bardhi mund të merret si baba i polemikës shqiptare, por të gjithë emrat e mëdhenj të kulturës shqiptare kanë shkruar polemika. Më të njohur janë Faik Konica (1876-1942), Fan Noli (1882-1965), Mihal Grameno (1872-1931), Gjergj Fishta (1871-1940), Ismail Kadare, Rexhep Qosja etj.



## XXXIX. PAMFLETI

**E**mërtimin pamfleti e ka marrë nga një formë e poezisë amatore latinisht e shekullit XII, e quajtur në latinisht *pamfletus* (prej *pamphilus*), frëngj. *pamphilet*, ang. *pamphlet*-trakt, fletushkë (me rrënjë nga greqishtja *panphilo*-i dashur prej të gjithëve). Edhe pse nocioni është i ri, rrënjët e pamfletit duhen kërkuar te folësit e famshëm të botës antike, si Demosteni, Ciceroni etj. Fjalimet e rrepta, lakonike, por me shprehësi të madhe të këtyre dy folësve, përmenden edhe sot në literaturë, ndërsa fjalë e shprehje të tyre janë të freskëta edhe pas më shumë se njëzet shekujve. Në këtë rreptësi dhe mprehtësi të fjalimeve të këtyre folësve të antikës duhet kërkuar shembullin e pamfletistëve të shekullit XVIII, atëherë kur lindi pamfleti.

Në fillimet e tij pamfleti nuk kishte karakter ofendues, por gjithnjë ishte një kritikë e rreptë për një individ të caktuar apo për një proces të caktuar dhe gjithmonë ishte një armë e fortë në luftën politike e shoqërore. Për shkak të ashpërsisë së kritikës pamfletistët kanë qenë shpesh të ndjekur, poende të dënuar me vdekje. Qysh në ligjin e parë të shkruar në XII Tabelat është paraparë dënimi me vdekje për përqeshësit e romakëve. Volteri ka qenë i ndjekur prej Francës për shkak të pamfleteve të tij të guximshëm. Volteri ishte një prej pamfletistëve të mëdhenj francez, edhe pse vetë ka thënë: Njerëz të ndershëm, që mendojnë, janë kritikuesit; smirëzi janë satirikët, ndërsa të zvetënuarit shkruajnë pamflete.<sup>12</sup>

Pamfleti u kultivua me të madhe në epokën e renesancës. Në Gjermani ishte i njohur humanisti Fon Ullbrih Gulten (1488-1523), në Itali Pjetro Aretino (1492-1556), në Angli Uiljam Kobet (1762-1835), në Francë, përveç Volterit, ishte i njohur edhe Zhan Pol Marat (1743-1793). Ndërsa publicisti francez Pol Kurje (1772-1825) shkroi librin *Pamflet për pamfletët* (1824), në të cilin përpunoi mjeshtërinë e kritikës satirike, veçanërisht të pamfletit.



### DE L'HORRIBLE DANGER DE LA LECTURE



OUX, Jousouf Cherébi, par la grâce de Dieu, moufti du Saint-Empire ottoman, lumière des lumières, élu entre les élus, à tous les fidèles qui ces présentes verront, sottise et bénédiction.

Comme ainsi soit que Saïd Effendi, ci-devant ambassadeur de la Sublime-Porte, vers un petit état nommé Frankrom, situé entre l'Espagne et l'Italie, a rapporté parmi nous le pernicieux usage de l'imprimerie, ayant consulté sur cette nouveauté nos vénérables frères les cadis et imans de la ville impériale de Stamboul, et surtout les faïris

## PËRMBAJTJA

XXXIX. Pamfleti . . . . .	367
XXXIX.1. Qëllimi përmbajtjesor i pamfletit . . . . .	368
XXXIX.2. Karakteristika strukturore e gjuhësore e pamfletit . . . . .	368
XXXIX.3. Letërsia pamfletistë . . . . .	369
XXXIX.4. Pamfleti shqip	370

*De l'horrible danger de la lecture* e Volterit, përmbledhje e eseve dhe e pamfleteve, në të cilat denoncon intolencën, paragjykimet, supersticionin, censurën, vendimet arbitrare të disa autoritare etj. Ky pamflet është një përmbledhje e ideve të iluminizmit.



## XXXIX.1. QËLLIMI PËRMBAJTJESOR I PAMFLETIT

Pamfleti edhe sot kultivohet me të madhe. Ai është tekst publicistik, kritikues (shpesh edhe ofendues) për një individ, një grup apo për një proces shoqëror, me qëllim të hapur për ta stigmatizuar e diskualifikuar, apo për ta pamundësuar ndonjë veprim politik, shoqëror, religjioz, letrar etj. Nga ky qëllim përmbajtjesor i tij kuptohet lehtë se pamfleti nuk është një tekst fisnik gazetar, por një armë për qëllime politike, sociale apo të natyrave të tjera, dhe i cili e përdor gazetarinë vetëm si trampolinë lufte. Pamfleti botohet në gazetë si një tërësi, apo e ndarë në pjesë, por edhe si botim më vete. Kur botohet më vete ai merr formën e librit, ndërsa në traditë ka qenë e përcaktuar një masë e fundit prej rreth 80-faqesh për një pamflet. Shkruhet edhe si poezi, por më rrallë. Shpesh autorët mbesin anonimë apo shkruajnë me pseudonim, zakonisht në prozë, por shkruhet edhe në vargje.

## XXXIX.2. KARAKTERISTIKA STRUKTURE E GJUHËSORE E PAMFLETIT

Çka është e rëndësishme te shkrimi i pamfletit?

**Së pari**, gjuha e pamëshirshme kundër kundërshtarit. Pamfletisti jo vetëm nuk i vë kandar gjuhës, por ai priret që ta ngarkojë atë me sa më shumë kritika, sulme, ofendime, denigrime ndaj kundërshtarit, dhe krejt këtë me qëllim për ta denigruar kundërshtarin në sytë e opinionit publik.

**Së dyti**, argumentet e nevojshme. Pamfletisti zgjedh argumente të vërtetueshme, por ai nuk kufizohet vetëm me ato, ai përdor çfarëdo argumenti, logjik, teknik, të idesë, qoftë edhe krejt sipërfaqësor, për të është e rëndësishme që kundërshtarin ta paraqesë të padenjë në çdo aspekt, në atë profesional, njerëzor, moral etj.

**Së treti**, pamfleti nuk ka një strukturë të rregullt teksti: autori mund të nxjerrë tema të reja e t'u rikthehet të vjetrave, t'i rimarrë përsëri të mëparmet apo t'i lërë të papërfunduara, varësisht prej interesit të tij. Te pamfleti i gjatë, autorët mëtojnë të ndërtojnë tërësi më të vogla funksionale. Kjo bëhet duke u marrë veç e veç me ide të ndryshme, me ngjarje të ndryshme apo me persona të ndryshëm. Kështu, ai mund ta fillojë pamfletin me trajtimin e një ideje, ta përmbyllë atë dhe ta fillojë idenë tjetër, të tretën e kështu

deri në fund. Ose mund ta nisë me sulmet ndaj një personi, ta kryejë me të dhe ta fillojë me të dytin, me të tretin e kështu deri në fund.

**Së katërti**, stili i pamfletit është i ulët (sipas kuptimit tradicional të nocionit). Ligjërimi është kryesisht bisedor dhe i shkujdesur, pra shpesh përdoren fjalë fyese e sharje, të cilat mund t'i përballojë gjuha e shkruar. Natyrisht, ky ligjërim i shkujdesur nuk është i preferueshëm, poende e humbet besimin e marrësit, mirëpo autorë të ndryshëm nuk hezitojnë të përdorin edhe këtë ligjërim.

**Së pesti**, autori i pamfletit e bart autoritetin e tij te teksti i vet. Nëse ai ka një autoritet të mirë, teksti i tij pranohet dhe lexohet më mirë, dhe e kundërta. Edhe pse ka pamflete që janë shkruar pa emra të vërtetë, askush nuk e merr seriozisht një pamflet të një autori të paçmueshëm.

**Së fundi**, pamfleti merr rëndësi shoqërore sepse përdoret shpesh në luftërat politike e partiake dhe krijon jehonë të madhe për shkak të stilit të ulët dhe gjuhës së çliruar prej çdo ndalese. Kur njerëzit e mëdhenj përdorin sharje, apo kur një parti që pretendon pushtetin përdor goditje të ulëta ndaj qeverisë, apo kur shtypi i kontrolluar nga qeveria lanson fushata kundër kundërshtarëve të vet, apo kur shtypi i kontrolluar nga qendra të tjera politike lanson fushata kundër zyrtarëve të lartë, në radhë të parë kundër kryeministrit, presidentit etj., kjo gjithsesi krijon jehonë dhe njerëzit e përflasin, edhe ata që s'e lexojnë fare kënaqen me komentimin e tij. Poende këtë kënaqësi me këto fushata lexuesit e ndjejnë edhe përkundër faktit se edhe ata mund të dyshojnë se me të vërtetë aty nuk ka asgjë të vërtetë, por fakti që përfliten gjëra të zyrtarëve të lartë i bënë ata kureshtarë për të ditur se çka fshihet pas asaj tymnaje.

### XXXIX.3. LETËRSIA PAMFLETISTE

Shkruhet një lloj i letërsisë së angazhuar politike, e cila, për shkak të intensitetit e dendësisë së angazhimit dhe modelit pamfletist të realizimit, quhet letërsi pamfletiste. Ajo mund të jetë roman, poemë, ese letrar etj. dhe dallon nga pamfleti i zakonshëm në dy aspekte: është fiction e jo faction; është mbizotërim i ligjërimit letrar mbi atë gazetar. Në anën tjetër, është e ngjashme sepse edhe kjo letërsi nisët nga premisa politike e shkatërrimit të kundërshtarit. Në letërsinë shqipe janë të njohur teksti dramatik i Gjergj Fishtës *Gomari i Babatasit* (1923) dhe poema *Epopeja e Ballit Kombëtar* (1944) e Shefqet Musarajt etj.

## XXXIX.4. PAMFLETI SHQIP

Pamfleti është kultivuar shumë edhe në publicistikën shqiptare. Pamfleti shqiptar ka lulëzuar në periudhën e Rilindjes Kombëtare, por edhe midis dy luftërave botërore. Në periudhën e Rilindjes pamfleti është dominuar, nga ana e përmbajtjes, me stigmatizimin dhe diskreditimin e kundërshtarëve të idesë për krijimin e kombit të lirë e modern shqiptar, edhe pse janë trajtuar edhe çështje e individë jashtë kësaj fushe. Është i njohur pamfleti i A. Z. Çajupit (1866-1930) *Klubi i Selanikut*<sup>13</sup>, ai i Faik Konica (1876-1942) *Përgjigje një Sërbi*<sup>14</sup>, shumë tekste të Gjergj Fishtës etj. Në fund të shekullit XX në Prishtinë dallohen dy pamfletistë: Rexhep Qosja me *Morfologjia e një fushate* (1980) dhe Rexhep Hoxha me disa pamflete, si *Epo ku jemi?* (1971), *Urithi i verbër i Ezopit* (1979) etj.

## XXX. FEJTONI (NËNFLETA)

**E**mërtimi fejtton rrjedh prej frëngjishtes *feuilleton*, sipas *feuilleton* - fletë letreje, nënfletë. Së pari u duk në gazetën *Le Journal des Debats* në fillim të shekullit XIX, si një fletë e posaçme, ku përfshiheshin kronika të ndryshme si ato teatrore, të modës, të shërbimeve publike etj., të shkruara nga kritiku teatror francez Zhofro (1743-1814). Më pas fejttoni evoluon në tekst me përmbajtje të lehtë, atraktive dhe zbavitëse, bisedë e lehtë e llafosje, duke krijuar kështu edhe një formë të re shprehjeje gazetare, e cila u quajt *causerie* (frëngj. llafosje e pacipë, banalitete), e cila edhe sot zhvillohet me emrin e njëjtë, kozeri. Pastaj evoluon kah forma letraro-gazetare, si një tregim i shkurtër apo udhëpërshkrim, me gjuhë të lehtë, familjare, me stil të lehtë, por duke ruajtur reminishencat sentimentale e humoristike, prirjet sensacionale deri në skandalitet.

Më në fund, në shekullin XIX dhe fillimshkullin XX fejttoni evoluoi në një rubrikë të posaçme gazete, të quajtur fejtton, ku botoheshin tekste të lehta letrare, në vijim nga një numër në tjetrin. Kështu ka lindur edhe shumë i popullarizuar - romani në vazhdime. Në vitet 1830-1840 u bënë të famshëm fejttonet (romanet në vazhdime), pa ndonjë vlerë të madhe, të shkruara thjesht për argëtim dhe për nxitjen e fantazisë së lexuesve, sipas modelit "romani për katër qindarka" (1848), po të cilët rritën tejmasë tirazhin e medie. Në vitin 1836 gazeta franceze *Shekulli* botoi si fejtton romanin e Alexandre Dumas, *Kapiten Poli*. Risia e gazetës solli rezultate: shumë shpejt gazeta bëri pesë mijë abonentë të rinj. Në vitin 1859 dinastia Goncourt, aq e zellshme për gazetarinë, reagoi kundër praktikës së fejttonëve të pa vlerë, të cilët kishin si qëllim vetëm pasurimin e autorëve e të pronarëve të gazetave, por tashmë ishte vonë: stili i gazetarisë së verdhë kishte mbizotëruar, duke nisur me fejttonet e pavlerë.<sup>15</sup>

### XXX.1. QËLLIMI PËRMBAJTJESOR I FEJTTONIT

Më vonë, meqenëse fejttoni merrej me njëmendësinë dhe me faktet objektive, ai mori edhe karakterin e tekstit popullarizues, që trajton tema aktuale politike, shoqërore, shkencore, historike, kulturore e artistike. Duke krijuar vendin autonom në gazetë, karakterin e vet si tekst popullarizues, duke fokusuar temat që trajton, duke kulluar gjuhën dhe stilin, në shekullin XX fejttoni u konsolidua si lloj zhanror i gazetarisë, me të njëjtin qëllim përmbajtjesor: synon popullarizimin e temave të ndryshme nga e kaluar, rifreskimin e memories kolektive për ngjarjet e rëndësishme nga e kaluar, të

#### PËRMBAJTJA

XXX. Fejttoni (nënfleta)	371
XXX.1. Qëllimi përmbajtjesor i fejttonit . . . . .	371
XXX.2. Tema e fejttonit	372
XXX.3. Çështje të strukturës së fejttonit . . . . .	373
XXX.4. Çështje të stilit të fejttonit. . . . .	374
XXX.5. Fejttoni shqip . . . . .	374

Në shekullin XX fejttoni u konsolidua si zhanër: synon popullarizimin e temave të ndryshme nga e kaluar, rifreskimin e memories kolektive për ngjarjet e rëndësishme nga e kaluar, të cilësdo fushë tematike qofshin.

cilësdo fushë tematike qofshin. Edhe sot fejtoni ka të njëjtin kuptim dhe të njëjtën përmbajtje. Vetë emërtimi fejton, në shqip nënfhletë, i paragjykon fatin këtij zhanri: është pjesë gazete, pjesë e një faqeje, por e ndarë prej saj, si një pjesë e veçantë, e ndarë edhe fizikisht (me një vijë të plotë), e tipografohet me shkronja të llojit tjetër.

## XXX.2. TEMA E FEJTONIT

Kjo mëvetësi relative i mundëson fejtonit edhe mëvetësinë në trajtimin e temave. Temat e fejtoneve janë të larmishme. Kufizimi i parë është se temë e fejtonit nuk mund të jetë një lajm. Pra, tema duhet të jetë e vjetër, mund të jetë e panjohur ose jo e njohur sa duhet, por gjithsesi duhet të jetë e vjetër. Mund të jetë tema historike, por mund të jetë edhe temë subjektive, fati i një njeriu. Zakonisht edhe është e tillë tema e fejtonit: fati i një njeriu. Personazhi i fejtonit nuk mund të jetë një çfarëdo njeriu, por një që ka lënë gjurmë në histori, një që ka lënë gjurmë në shoqërinë dhe në rrethin e tij, një që ka pësuar një fat tragjik pa fajin e tij, një që ka sakrifikuar për të mirën e përgjithshme, një që ka flijuar jetën e tij për të mirën e përgjithshme, një që ka arritur suksese të jashtëzakonshme në një fushë të caktuar (një sportist kulminant, një violinist kulminant, një gazetar kulminant, një zbulues etj.), apo edhe një njeri me nam për të keq, një kriminel me nam etj., apo edhe tema të lehta nga estrada e nga shou biznesi. Fejtonet trajtojnë edhe tema që s'kanë të bëjnë vetëm me biografinë e një personi, por me fatin e grupeve të ndryshme shoqërore.

Një numërim i zbehtë i temave të fejtonit e mundësojnë përkufizimin më të mirë të temës së tij: fejtoni trajton fatin e individëve, të grupeve shoqërore, të ngjarjeve apo të veprimeve të individit apo të grupit, por edhe të popujve e të kulturave të lashta, të cilat, për shkak të largësisë kohore dhe mungesës së informacionit, krijojnë përshtypjen se po flasim për një grup shoqëror. Varësisht se çfarë temash trajtojnë, fejtoni mund të klasifikohet në: historik, kulturor, social, etnografik etj.

Sot mbizotërojnë fejtonet popullarizuese historike, ato që trajtojnë jetët e artistëve, të shkrimtarëve, apo të njerëzve të suksesshëm, por edhe që trajtojnë ngjarje të pazakonshme dhe fate të pazakonshme të individëve. Nënfhleta sot shkruhet me një gjuhë të gjallë, figurative, me stil subjektiv, por të besueshëm. Në gazetë ajo zakonisht botohet në faqet e fundit.

Fejtonistët më të njohur të kësaj forme janë G. E. Lesing, H. Hajne etj.

# XXX.3. ÇËSHTJE TË STRUKTURËS SË FEJTONIT

Në strukturën e tekstit fejtoni i përngjet një teksti historik. Elementi themelor është ai i kronologjisë kohore, pra rëfimi i ngjarjeve sipas kohës kur ato kanë ndodhur. Zakonisht, nuk bëhen kapërcime të këtij parimi kronologjik. Elementi i dytë strukturor është përcjellja e temës së fejtonit me elemente të tjera gazetare, si: fotografi, dokumente, faksimile, antërfajlla etj. Me këtë element strukturor, fejtoni është i afërt me dosjen.

Po ku dallon fejtoni prej historisë (shkencës) dhe prej dosjes?

Prej historisë e dallon i njëjti princip që e dallon publicistikën nga shkencën: historia trajton faktet objektive, ato më kryesoret dhe zhvillimet e përgjithshme; fejtoni trajton faktet objektive, por nga prizmi i një subjekti (personazhi i fejtonit, ngjarja apo fati i një populli apo i një kulture etj.) dhe interesohet edhe për detajet, për fatet individuale dhe për botën subjektive të personazheve të tij. Prej dosjes fejtoni dallon në dy pikë: një, dosja është tekst për ta zbuluar të vërtetën, ndërsa fejtoni është tekst për ta popullarizuar temën që trajton; dy, dosja trajton tema të panjohura sa duhet, ndërsa fejtoni tema historike.



Gazeta parisienne La Presse, 25 dhjetor 1836. Në fund të faqes teksti kufizohet me një vijë të trashë dhe një më të hollë, për të ndarë tekstin poshtë nga ai lart. Në krye të kësaj ndarjeje është vënë mbiitulli: Feuilleton. Këtu zë fill fejtoni si rubrikë. (Burimi: gallica.bnf.fr/Bibliotheque nationale de France)

## XXX.4. ÇËSHTJE TË STILIT TË FEJTONIT

Në çështje të stilit, të ligjërimit dhe të gjuhës, fejtoni dallon prej llojeve të tjera publicistike me neutralitet. Stili i tij është shumë afër ligjërimit bisedor dhe ligjërimit historik, pavarësisht se është ligjërimit letrar. Autori mund të përshkruajë e të rrëfejë, t'i shprehë mendimet e idetë e tij edhe përmes fjalëve me kuptime e tejkuptime, edhe përmes figurave, por gjithnjë stili i tij duhet të mbetet stil neutral, i cili qëllim kryesor ka komunikimin me marrësin. Gjuha e fejtonit i përshtatet ligjërimit rrëfyes (dëftorja, koha e kaluar) dhe nuk ka shumë ngarkesë emocionale. Struktura e tekstit, sado që mund të bëjë ndonjë kërcim në kohë, megjithatë i përmbahet një rrjedhe kronologjike: prej të vjetrës kah e reja.

Një formë e keqkuptuar e fejtonit haset shpesh në gazeta, e që është një tekst i gjatë, i ndarë në disa pjesë dhe pjesët botohen në vazhdimësi në një gazetë. Ka autorë të cilët librin e tyre historik, apo një analizë shkencore të një procesi shoqëror, e botojnë si fejtton. Gjithçka është në rregull me botime të tilla, por ama ato nuk janë fejtone, në kuptimin zhanror, sepse si pamë deri më tash, në gazetarinë e re fejtoni nuk është një rubrikë, por një lloj gjinor gazetar. Pra, vetë për vetë vendi në gazetë, i mbititulluar "fejton", nuk e bën një tekst fejtton. Fejtoni shkruhet me një temë si ato që përmendëm, me një stil neutral e një ligjërimit bisedor dhe shkencor, dhe botohet në vazhdimë.

## XXX.5. FEJTONI SHQIP

Në gazetarinë tradicionale shqiptare fejtoni është kultivuar relativisht shumë. Ka filluar të kultivohet, në formën që edhe sot e njohim, në fundshekullin XIX dhe në fillimshekullin XX. Gjejmë në gazetën *Shqipëria* të Bukureshtit tekstin në dy vazhdime me titull *Studim i shkurtër për lëvizjen shqiptare*<sup>16</sup>, i cili edhe në përmbajtje po edhe në strukturë është fejtton. Po përmendim edhe dy fejtone të tjera të kësaj periudhe: në gazetën *Drita*, në Sofje, fejtoni *Racat e tjera dhe raca pellazge*, autori: P. Raullasi (Petro N. Luarasi), nr. 89, 18 maj 1907; në gazetën *Zgjimi i Shqipërisë*, në Janinë, fejtoni *Fëmij'e varfërë*.<sup>17</sup>

Në dekadën e dytë dhe të tretë të shek. XX fejtoni ka një ngritje cilësore dhe sasiore. Në aspektin cilësor ai afrohet kah shkenca popullarizuese dhe kah veprimtaria publike në periudha të ndryshme historike. Vlen të përmenden fejttonet e çmuara të Atë Marin Sirdanit, si *Shqyphtarët e hartet*,<sup>18</sup> *Nji Rival i Skanderbegut*.<sup>19</sup>



## XXXI. KOZERIA

## PËRMBAJTJA

XXX. Kozeria . . . . . 375

**D**y publicistë francezë, Zhan Zhul Gabriel (1804-1874) dhe kritiku i njohur Sent Bevi (Ch. A. Sainte-Beuve, 1804-1869), mbahen për krijues të kozerisë. Emërtimi kozeri rrjedh prej frëngjishtes *causerie*- llafosje e pacipë, banalitet. U quajt kështu për shkak të stilit të lehtë e ligjërimit bisedor të kozerisë. Ajo është thjesht një ironizim, satirizim e përqeshje e një individi, grupi apo dukurie a veprimi publik.

**Qëllimi përmbajtjesor i kozerisë.** Mjeshtëria e shkrimit të saj është sjellë në aftësinë e autorit për të manipuluar me fjalë, qoftë edhe pa ndonjë përmbajtje, por që e mbështetin për muri objektin e synuar. Kështu kozeria krijon efekt verbal, lojë inventive fjalësh, duke goditur poentën e objektit të synuar. Është tekst tejet subjektiv dhe shkruesi i saj është i lirë t'i interpretojë faktet e objektit të synuar ashtu si dëshiron ai vetë, por gjithmonë duke i ironizuar e përqeshur ato. Por, kozeria nuk është tekst që të bën të qeshësh! Kozeria të bën të vajtosh duke qeshur! Qëllimi i kozerisë është të stigmatizojë një person, një veprim, një ide, një shfaqje apo një çfarëdo ngjarje tjetër të dëmshme për shoqërinë. Ajo synon jo vetëm ta trajtojë ironikisht, sa për të qeshur, por synon shkatërrimin e së keqes, duke e ironizuar dhe përqeshur deri në absurd, deri në kufijtë e skajshëm të ironisë.

**Arti i fjalës dhe tematika.** Elementi thelbësor i kozerisë është vetë fjala dhe jo mesazhi që bart fjala. Mund të thuhet gjëra të parëndësishme, por nëse thuhet bukur, me shije dhe me invencion, atëherë arrihet qëllimi i kozerisë. Fjalja: "Kryetari, nga vendi ku qe ulur, u foli të pranishmëve..." mund të shprehet në disa mënyra të afërta, por me shumë ngarkesë emocionale e me tejkuptime të ndryshme:

Kryetari, nga mbretëria ku qe ulur, u tha të pranishmëve...

Kryetari hodhi shikimin nga karrigia e tij e larë me vernik dhe u tha të...

Kryetari mbështeti kokën në karrigen e tij dhe me një bisht syri te të pranishmit, u tha...

Kryetari, i humbur në kolltukun e tij, u tha...

Kryetari, në karrigen e tij të Luigjit të XIV, u tha...

Kryetari u hodhi nga një gur nga atdheu i tij, tavolina dhe karriga...

Këto tejkuptime janë synim i kozerisë. Autori i saj nuk interesohet për dhënie e një mesazhi, por për dhënie e një tejkuptimi, për krijimin e kuptimeve të reja mbi kuptimin elementar të fjalës së tij dhe të tekstit. Në këtë drejtim kozeria është shumë më afër letërsisë sesa llojet e tjera publicistike.



Duke vlerësuar lart rolin e fjalës në kozeri, kjo nuk do të thotë se mund të ketë kozeri pa përmbajtje. Ajo ka një temë e një motiv, apo disa motive. Motivet e kozerisë janë kryesisht nga jeta publike, qoftë nëse është fjala për individë apo për ngjarje, nga fusha e kulturës apo politikës, nga fusha e sportit apo nga fusha e shkencës. E rëndësishme për të gjitha këto motive është se ato kanë një rëndësi publike dhe janë të pazakonshme. Elementi i parë përcaktues për temën e kozerisë është tema e pazakonshme: kjo është tema që s'e pret marrësi, po ende as është e ligjshme të ndodhë ashtu. Për shembull, dy deklarata krejtësisht të kundërta për të njëjtën temë nga i njëjti politikan, kjo është temë interesante për kozerinë. Elementi i dytë përcaktues nuk është vetë tema, por mënyra paradoksale e trajtimit të saj. Mënyra paradoksale dhe e pazakonshme e trajtimit të temës është mënyra e trajtimit që s'e pret marrësi. Elementi i tretë përcaktues është aktualiteti i temës. Kozeria trajton vetëm tema aktuale, ato nga jeta e përditshme dhe asnjëherë nuk trajton motive nga e kaluara, apo nga historia. Elementi i katërt është rëndësia për shoqërinë konkrete. Kozeria merret vetëm me tema e motive të shoqërisë së cilës i përket: nuk shkruan një autor nga Kosova kozeri me temë e motive kineze. Kjo për arsye të tonit satirik të kozerisë, i cili krijon efekt vetëm te marrësi që është në rrjedhë të një ngjarjeje, shfaqjeje, në rrjedhë të mendësisë së asaj shoqërie për të cilën shkruan autori i kozerisë.

Invecioni i autorit në kozeri nuk përqendrohet vetëm në krimin e tejkuptimeve por edhe në përgjigjet ndaj situatave absurde e qesharake që krijon trajtimi paradoksal i temës. Kështu, kur Nonda Bulka përqesh politikanët e viteve '20-'30 të shekullit XX, në premtimin zgjedhor të një politikani se "ne do t'ua ndërtojmë urën", kur publiku përgjigjet "por ne s'kemi lumë!", autori gjen përgjigjen më të mundshme skandaloze: "edhe lumin jua ndërtojmë". Në këtë pikë të fundit kozeria është e afërt me gazmoren (barsoletën). Por dallimi është shumë i qartë: qëllimi dhe roli i barsoletës është ta bëjë publikun të qesh, ndërsa qëllimi dhe roli i kozerisë është ta sulmojë kundërshtarin, ta shkatërrojë moralin, veprimin apo ngjarjen e trajtuar.



## Vendlindja Thërret sjellë operatorin e tretë të telefonisë mobile

Kuku News  
21:54 - 27 Mars, 2016

Drejtimesit e Fondit Vendlindja Thërret janë fituesit e tenderit për operatorin e 3-të të telefonisë mobile në Kosovë. Këtë vendim në heshtje ia ka konfirmuar Kukunews-it, Qeveria e Kosovës, sipas të cilëve, ky tender bënë thirrje për më shumë treg të lirë në Kosovë.

Edhe Vendlindja Thërret kanë heshtur rreth këtij lajmi por Kukunews merr vesh se ky operator i ri do të quhet "EkoThirrja" dhe do të jetë një prej operatorëve më të sofistikuar në Evropë.

Kukunews ka siguruar një dokument në të cilin tregohet se cilat risi do t'i sjellë ky operator.

"Operatori EkoThirrja do të jetë telefoni mobile dhe satelitore në të njëjtën kohë. Në këtë mënyrë përdoruesit e kësaj telefonie mobile do të kenë mundësi që të flasnin mes vete pa para me valë satelitore por nëse duan të shpenzojnë atëherë do të duhet të paguajnë me marka", thuhet në këtë raport ekskluziv.

Tutje thuhet se ky operator mobil do të ofroj edhe diçka që të gjithë në Kosovë dëshirojnë: këta numra nuk do të përgjohen.

"Vendlindja Thërret ka arritur marrëveshje me Policinë e Kosovës dhe të gjitha organet e tjera gjegjëse që hë për hë asnjë nga numrat tanë nuk do të përgjohen as nga FBI as CIA e as nga askush", thuhet në këtë raport.

Numrat do të kushtojnë nga 4 marka deri në 7 marka të gjermanit.

<http://www.insajderi.com/vendlindja-therret-sjelle-operatorin-e-trete-te-telefonise-mobile/>

**Kozeria shqipe.** Kozeria në shqip i përket shekullit XX. Janë disa autorë që në dekadën e dytë e të tretë të shekullit XX e kanë shkruar me sukses të madh kozerinë: Faik Konica (*Nga tryeza e kryetarit*, 1923)<sup>20</sup>, Mihal Grameno, Nonda Bulka, e ndoshta edhe Migjeni.





## XXXII. RECENSIONI

## PËRMBAJTJA

XXXII. Recensioni . . . 379

**F**jala vjen prej latinishtes *recensio*-matje. Sado është nocioni i njëjtë, recensioni gazetar dallon në thelb dhe në formë nga recensioni si fazë e kritikës së tekstit (tekstologjia).<sup>21</sup> Po ashtu, dallon edhe nga recensioni shkencor-zyrtar, i cili është vlerësim zyrtar, nga një grup i emëruar, për një vepër, për një punim shkencor, apo për një kandidat për titull akademik, apo për çfarëdo konkurrence tjetër kulturore e akademike.

**Qëllimi përmbajtësor i recensionit.** Recensioni është një prej formave më tipike letraro-gazetare: është letërsi dhe art sepse trajton tema kryesisht letrare ose të artit dhe i trajton sipas metodologjisë të kritikës letrare, ndërsa botohet në media dhe për informim të publikut. Ka raste kur autorë të ndryshëm botojnë edhe si libër më vete recensionet e botuara më herët në media, por librat e tillë nuk kanë ndonjë efekt letrar. Efekti i recensionit arrihet vetëm në media dhe botimi i tij në gazetë është njëkohësisht edhe realizim i tij i plotë: e njofton publikun me një vepër të re arti. Në natyrën e tij recensioni është një tekst kritik për një libër a një shfaqje arti, por për nevojat e konsumuesit të përditshëm të medias. Tema e recensionit është e kufizuar vetëm te veprat letrare, te ato të artit (teatër, kinema, pikturë, skulpturë, muzikë etj.) dhe te librat në përgjithësi.

**Karakteristika e parë** e recensionit është të qenët gjykim i parë dhe gjykim origjinal për një vepër letrare. Sapo del nga shtypi vepra, gazeta përmes recensuesit të saj ia prezanton atë libër lexuesit. Të qenët “i pari” nuk është thjesht një fakt kohor, por një fakt kulturor dhe letrar: recensuesi është vlerësuesi i parë publik. Ai nuk mund të shërbehet me mendime paraprake të autorëve të tjerë, sepse vetë është i pari. Së këndejmi, mendimet e tij për librin janë tërësisht origjinale. Të qenët “i pari” lidhet edhe me kohën. Recensioni bëhet, në aspektin kohor, sa më shpejt që është e mundur nga dalja e librit nga shtypi. Në këtë drejtim, detyra e recensuesit është të jetë lexuesi i parë i një vepre.

**Karakteristika e dytë** e recensionit është gjuha e tij: ajo duhet të jetë gjuhë rumbullake, gjuhë që nuk i përkufizon gjërat, idetë dhe shfaqjet e veprës prerazi, gjuhë që nuk tenton të jetë pohuese e mohuese, gjuhë që nuk i përcakton kristalisht idetë e veprës po as të autorit të recensionit. Mund ta përkufizojmë gjuhën e recensionit si gjuhë të kufizuar. Kjo ndodh për dy arsye: së pari, recensuesi nuk ka kohë të thellohet në vepër që të mund të japë qëndrime të prera (dhe nëse e bën këtë pa u thelluar, atëherë ai bëhet i pabesueshëm); së dyti, natyra e recensionit është informimi i publikut me një vepër dhe jo gjykimi përfundimtar i veprës. Pavarësisht nga kjo karakter-

Recensioni është një tekst kritik për një libër a një shfaqje arti, por për nevojat e konsumuesit të përditshëm të medias.

**Karakteristika e parë** e recensionit është të qenët gjykim i parë dhe gjykim origjinal  
**Karakteristika e dytë** e recensionit është gjuha e tij; ajo duhet të jetë gjuhë rumbullake  
**Karakteristika e tretë** është të qenët pasqyruar dhe paraqitës  
**Karakteristika e katërt** është të qenët i klishezuar  
**Karakteristika e pestë** është roli i recensionit në orientimin e publikut ndaj një vepre të caktuar dhe në krijimin e imazhit të mirë apo të keq për veprën.  
**Karakteristika e gjashtë** është autoriteti i recensuesit

istikë, recensuesit shpesh përmendin anët e dobëta të veprës, por edhe këtë e bëjnë për ta përgatitur lexuesin me këtë fakt e jo për ta vlerësuar përfundimisht veprën.

**Karakteristika e tretë** është të qenët pasqyrues dhe paraqitës. Thelbi i recensionit nuk është analizimi apo vlerësimi (edhe pse në recension nuk mungojnë as njëra as tjetra), por pasqyrimi dhe paraqitja. Recensionin bën pasqyrimin dhe paraqitjen e një vepre: përshkruan atë në dukjen fizike, në ndarje e nëndarje, kapituj e nënkapituj, sa faqe ka, po edhe shënime të tjera bibliografike. Po-ende, recensionin bën paraqitjen e përmbajtjes së veprës në mënyrë sinoptike, paraqitjen e ideve të veprës, letraritetin e saj etj. Detyra e recensuesit është, duke qenë lexuesi i parë i një vepre, t'ia prezantojë atë publikut, të tregojë si duket libri si prodhim dhe çka përmban ai. Duke qenë se ai nuk ka kohë ta analizojë librin thelbësisht e gjerësisht (botimi i recensionit lidhet me kohën) edhe paraqitja e tij nuk mund të jetë thelbësore e gjerësore. Ai bën thjesht një paraqitje sipërfaqësore, të gjithanshme, duke u kujdesur për të dhënë një apo dy ide që ta orientojë lexuesin se si të gjendet në libër.

**Karakteristika e katërt** është të qenët i klishezuar. Duke qenë tekst i shkurtër kritik, sipërfaqësor, i shkruar për një përdorim, modeli i shkrimit të recensionit është klishezuar mjaft shumë: recensionet e një autori i ngjajnë njëri-tjetrit si veja vesë. Mund të dallojnë vetëm sugjerimet për orientimin e lexuesit në libër, përndryshe karakteristikat tjera të recensionit përsëriten gjerësisht nga njëri të tjetri recension.

**Karakteristika e pestë** është roli i recensionit në orientimin e publikut ndaj një vepre të caktuar dhe në krijimin e imazhit të mirë apo të keq për veprën. Kjo karakteristikë është e mishëruar me recensionin. Nuk është e huaj për recensuesin të thotë se aksh vepra është e shkruar mirë apo keq, se ia vlen apo nuk ia vlen të blihet, se ia vlen apo nuk ia vlen të lexohet etj. Por, ky gjykim i prerë ka karakter marketingu dhe nuk është rrjedhojë e analizës.

**Karakteristika e gjashtë** është autoriteti i recensuesit. Duke qenë se recensionin shkruhet sa më shpejt pas daljes së librit nga shtypi, duke qenë se aty nuk ka analiza të thella dhe argumentime të tezave, duke qenë se edhe një apo dy ide që i jep recensuesi për ta orientuar lexuesin janë, më shumë sesa proces analitik, prodhim i intuitës së tij kritike, nami i recensionit lidhet shumë me autoritetin e recensuesit. Pra, recensionin është autoritar sepse vlera e tij lidhet me autoritetin paraprak të autorit të tij.

Recensionin zakonisht botohet te faqet e kulturës së një gazete. Zakonisht nuk është i gjatë, mund të zërë  $\frac{1}{4}$  e faqes së një gazete normale.

## XXXIII. BIBLIOGRAFIA

## PËRMBAJTJA

XXXIII. Bibliografia . . . 381

**E** është një formë më e shkurtër e tekstit të recensionit që quhet me disa emërtime: bibliografi, libra të rinj, shënime për libra etj. Dallon nga recensionit sepse është shumë më i shkurtër se ai, përjashton çfarëdo gjykimi të autorit për vlerën e veprës letrare, duke u kufizuar vetëm në paraqitjen e aspekteve fizike të librit, deri edhe te çmimi, lloji i kopertinave dhe lloji i letrës në çka është shtypur teksti. Bibliografia anon më shumë kah reklama e tregtia sesa kah letërsia. Është më e ngjashme me reklamën për një detergjent sesa me kritikën. Por, meqenëse ka ndikim në venerimin e proceseve kulturore, letrare e artistike, çmohet si lloj gazetar-letrar.

Në historinë e gazetarisë shqipe dy recensuesit më të vjetër e më të frytshëm janë Faik Konica (1876-1942) e Gjergj Fishta (1871-1940), të cilët kanë krijuar rubrikat e para për paraqitjen e librave, i pari në *Albania*, i dyti te *Hylli i Dritës*.








## XXXIV. ESEJA

Fjala vjen prej frëngjishtes *essai* - provë, sprovë, vështrim. Franca mbahet si djep i esesë: Mishel Ekem de Montenji (Michel Eyquem de Montaigne, 1533-1592) botoi tre libra, dy më 1580 dhe të tretin më 1588, të cilët i quajti Ese (Essais). Esetë e Montenjit kishin zënë fill “prej shënimeve gjatë leximit të librave, të cilat janë zhvilluar në mendime të shprehura me shumë subjektivizëm, herë pas here mendime autobiografike-psikologjike, për çështje të llojllojshme praktike, etike dhe shoqërore”.<sup>22</sup> Mirëpo, bashkëkohësi i Montenjit, filozofi, burrështetasi dhe shkrimtari anglez Frensis Bejkën (Francis Bacon, 1561-1626), i cili botoi librin *Ese ose këshilla qytetare dhe morale* (1597) konsideron se rrënjët e esesë duhen kërkuar te disa shkrimtarë latinë, si te Seneka (Lucio Aneus Seneka, rreth vitit 4 p. K.) dhe *Letra Lucilit* etj. Deri në shekullin XIX dhe XX Franca, sidomos Anglia, qenë vendet ku u lëvrua fuqimisht eseja.

Sot eseja ka një kuptim shumë më të gjerë sesa mund të artikulojmë në këtë rast. Mjafton të themi se në shkollat amerikane çfarëdo tekstesh që bëjnë nxënësit dhe studentët në shkencat humaniste quhet ese. Kjo nënkupton një tipologji të gjerë të esesë, sipas tematikës dhe sipas tipit të ligjëritimit. Megjithatë, dy duhet të jenë tipat bazikë të esesë: eseja me prirje shkencore dhe eseja me prirje letrare. Dallimi është vetëm në diskursin dhe në mënyrën e argumentimit: te tipi i parë diskursi është më shkencor dhe argumentimi është më akademik, te tipi i dytë diskursi është më letrar, ndërsa argumentimi është më personal. Ne do ta trajtojmë këtë tipin e dytë, esenë letrare.



## PËRMBAJTJA

XXXIV. Eseja. . . . .	383
XXXIV.1. Qëllimi përmbajtjesor i esesë . . . . .	384
XXXIV.2. Struktura tekstore e esesë . . . . .	385
XXXIV.3. Temat e esesë	386

Llafosjet e së hënës të Charl Ogyst Sent Bevit përmbajnë 640 ese kritike dhe biografike për tema letrare franceze dhe evropiane, të publikuara fillimisht një herë në javë, të hënën, në gazeta të ndryshme parisiane, gjatë mbi 20 vjetëve, prej 1849 deri më 1869. Esetë janë mbledhur dhe botuar në *Causeries du lund* (1851-'62) dhe në 13 vëllime *Nouveaux lundis* (1863-'70).

## XXXIV.1. QËLLIMI PËRMBAJTJESOR I ESESË

Eseja sot ka një formë tekstore të përfunduar që nga shekulli XIX, edhe pse për nga natyra e tij e hapur dhe subjektive, ai nuk mund të kornizohet e të klishezizohet. Poende, kjo natyrë e tij e bën të vështirë edhe përkufizimin e tij.

*“Duke qenë se gjithnjë rri pezull midis tri fushave të ndryshme, midis letërsisë, gazetarisë dhe shkencës, duke iu afruar ndonjëherë reportazhit e ndonjëherë skicës, tregimit të shkurtër dhe poezisë në prozë, e ndonjëherë përsëri artikullit shkencor dhe shqyrtimit, esenë është shumë vështirë ta përkufizosh, ndërsa fusha e tij nuk është qartë e përkufizuar”.<sup>23</sup>*

Eseja është në lidhje të kushtëzuar me tri forma të artikullimit intelektual: me letërsinë, me gazetarinë dhe me shkencën. Me letërsinë eseja ka të njëjtë gjuhën dhe stilin; me gazetarinë ka të përbashkët faktin, ndërsa me shkencën ka të përbashkët analizën dhe argumentimin.

Eseja është në lidhje të kushtëzuar me tri forma të artikullimit intelektual: me letërsinë, me gazetarinë dhe me shkencën. Me letërsinë eseja ka të njëjtë gjuhën dhe stilin; me gazetarinë ka të përbashkët faktin, ndërsa me shkencën ka të përbashkët analizën dhe argumentimin.

Me gjithë vështirësitë teorike, disa karakteristika të esesë janë të mirënjohura dhe përcaktuese për formën e esesë.

**Karakteristika e parë** është subjektiviteti i autorit. Esei shkruan për pikëpamjet e tij personale, për vështrimet e tij, për mendimet dhe supozimet e tij; ngre teza e antiteza personale në shqyrtimin eseistik dhe hap një vizion të ri për temën. Ai nuk obligohet nga të arriturat shkencore e teorike të paraardhësve të tij. Ai nuk ndjek një rrugë shkencore në vërtetimin e tezave të tij dhe përfundimet e tij ai nuk i quan shkencore dhe të përfunduara. Ai thjesht bën një provë në shqyrtimin e një çështjeje, duke e mbështetur metodologjinë e shqyrtimit në të arriturat e tij dhe në përvojën e tij. Nga kjo karakteristikë është nxjerrë edhe përkufizimi më i përafërt i esesë: Eseja është tekst i shkurtër në prozë, në të cilin paraqiten mbresat, përshtypjet, tundimet, pikëpamjet personale për një çështje të jetës, moralit, artit, shkencës etj.

**Karakteristika e dytë** e esesë është gjuha e saj. Eseja është fare pranë tregimit apo një proze letrare. Ajo ka një gjuhë figurative, të gjallë, eliptike, me tendenca sentencizimi. Gjuha e saj është e rrjedhshme, e këndshme në lexim, por jo zbatimëse në kuptimin humoristik. Ajo është stil i lartë i ligjërimit e mbushur me shprehje që bartin përvojën individuale apo gjithënjëzore, me formula e fjali sentencioze, të cilat ndikojnë fuqishëm në mendjen e lexuesit.

**Karakteristika e tretë** e esesë është liria hulumtuuese e shprehëse në të. Si në asnjë formë tjetër publicistike, esei është krejt i ha-

pur të shqyrtojë, prej problemeve më të mëdha të njerëzimit, deri edhe te një ofshamë e individit dhe t'i shprehë mbresat, pikëpamjet e vizionin e tij pa asnjë pengesë e kufizim. Këtu eseja përkon katërçipërisht me letërsinë, veçse dallon se eseja nisat nga një fakt real, qoftë ai fakt edhe një ide, apo një ofshamë, dhe përsiatë rreth tij, deri sa letërsia është një tregim fiktiv për një botë të tërë.

**Karakteristika e katërt** e esesë është struktura tekstore unike e çdo eseje. Nuk ka një rregull se si organizohet struktura tekstore e esesë. Kjo është e drejtë sovranë e autorit në çdo ese. Pavarësisht nga kjo mospasje e rregullave, në prapavijë të çdo eseje mund të vërehen konturat e zakonshme të ligjëratës: një hyrje, një paraqitje të temës me argumente dhe një përfundim. Ky rend i fshehur në prapavijë të esesë është vetëm skeleti i ligjëratës, i domosdoshëm edhe në ese, por nuk i jep asnjë veçanti esesë. Kjo mungesë rregullash në strukturën e tekstit e afron esenë me letërsinë deri në atë masë sa nuk hetojmë dallim tjetër, përveç dallimit bazik të fiction-it me faction-in. Pavarësisht nga të qenët unik i çdo eseje, nuk mund të pajtohem me degradimin e esesë deri në atë masë sa të përkufizohet si "tërësi paragrafësh", si bëjnë autorët e librit Si të shkruajmë ese.<sup>24</sup> Eseja gjithnjë është një tekst unik, i tërësishëm, natyrisht i përbërë prej paragrafëve por, jo thjesht një tërësi e paragrafëve, sepse ky përcaktim nuk është aspak i përkufizuar.

**Karakteristikë themelore** e esesë është **pika nisëse** (topika) e subjektit të esesë. Gjithmonë ka mundësi të pafundme për të nisur nga një pikë esenë, prandaj ku e fillon autori esenë e tij? Cila do të jetë fjalia, motivi apo ideja e parë? Këto pyetje e njëjtësojnë çështjen me letërsinë. Pse Homeri e ka nisur *Iliadën* me hidhërimin e Akil Pelidit? Kjo mjeshtëri për gjetjen e pikës nisëse, e cila është rezultat i invencionit të eseistit, përcakton suksesin apo mosesuksin e një eseje. Topika e esesë ka të bëjë me stilin e autorit e jo me strukturën.

Pika nisëse e esesë

## XXXIV.2. STRUKTURA TEKSTORE E ESESË

Struktura tekstore e esesë është e thjeshtë:

- hyrja (paraqet temën e esesë dhe tezat themelore të temës si dhe argumente të të tjerëve për temën);
- trungru i esesë (argumentimet e autorit; këtu mund të hyjnë edhe nëntemat dhe idetë që e përçojnë temën);
- përfundimet (rikonfirmimi i tezës).

Profesorët e shkrimit akademik kanë shkoqitur deri në detaje elemente të rëndësishme të strukturës së esesë, si: paragrafët dhe

llojet e tyre, përbërja e paragrafëve, mënyrat e hyrjes në ese, mënyrat e lidhjes së paragrafëve me njëri-tjetrin, mënyrat e rikonfirmimit të tezës në paragrafin e fundit, tipat e fjalive në paragrafë, tipat e paragrafëve, tipat e eseve etj., të gjitha këto të domosdoshme për secilin student, por që nuk mund të zënë vend këtu, sepse janë materie e shkrimit akademik.

### XXXIV.3. TEMAT E ESESË

Tema e esesë mund të jetë e llojllojshme. Ajo që është thelbësore për temën është lidhja e saj me shumë nëntema. Nëse tema është mendësia e robit, nëntema mund të shërbejë shembuj të ndryshëm empirikë ku hetohet mendësia e robit (servilizmi, nënshtrimi, mosaftësia e vendimmarrjes etj.). Një prej ideve që përçon temën mund të jetë personazhi i Samuel Beketit nga *Duke pritur Godonë*. Te argumentet autori mund të radhisë disa prej arsyeve që ai i heton në shfaqjen e një mendësie të tillë në sjelljet e njerëzve. Ndërsa përfundimet e esesë mund të jenë, po ashtu, të natyrave të ndryshme: mund të jenë didaktike, kritikuese, denigruese, përshkruese etj., varësisht nga prirja dhe interesi i autorit. Pavarësisht nga këto pjesë të strukturës së esesë, topika gjithnjë mbetet çështje e stilit dhe jo e strukturës, por ajo e ndikon edhe strukturën.


Edhe në të kaluarën edhe sot esenë e kanë lëvruar penat më të mëdha të një kulture. Eseja është si një privilegj i autoriteteve në inteligjencien e një populli, edhe pse mund të jetë shumë tundues edhe për shkrimtarët e papërvojë, mu për shkak të mospasjes së rregullave për shkrimin e tij, çka e bën të perceptueshëm si zhanër të lehtë për t'u shkruar. E vërteta është e kundërta. Edhe në shkrimin shqip eseja është kultivuar bujshëm. Rrënjët e esesë mund të kërkojnë te Pjetër Bogdani (rreth 1625-1689) në librin *Çeta e profetëve* (1675-1685). Janë dy eseistë të mëdhenj të traditës, ndikues edhe sot në shkrimin shqip, të cilët i dhanë formë esesë shqipe: Faik Konica (1876-1942) dhe Fan Noli (1882-1965). Ndër më të përmendurit ese të Konicës janë: *Shqipëria si m'u duk*, *Falsifikimi më kolosal në historinë e llojit njerëzor*, *The sweet power of music* etj. Ndër më të përmendurat ese të Nolit janë ligjëratat dhe introduktat e tij.

## XXXV. SKICA

**E**shhtë një formë e shkurtër publicistike, e cila trajton në vija kryesore dhe të përgjithshme, pa detaje, një motiv nga jeta e përditshme. Nuk ka të bëjë me lajmin dhe llojet e tij sepse nuk sjell një informacion të ri, por me një motiv, të cilin opinioni publik e takon çdo ditë, por nuk e heton, nuk e vëren. Një skicë për një lypës te Migjeni nuk bart asnjë informacion të ri te marrësit, sepse lypësi ka qëndruar në të njëjtin vend muaj, ndoshta vite të tëra, por nuk është vërejtur nga publiku, ose nuk është vërejtur në mënyrën se si e vëren autori i skicës.

Skica mund të ketë një subjekt të vogël, por mund edhe të mos ketë fare subjekt: mund të jetë përsiatje e autorit mbi një motiv jete. Kur ka një subjekt, ajo zakonisht shkruhet si një rrëfenjë e vogël apo si një tablo e rrëfyer. Ky lloj i skicës afrohet me tregimin e shkurtër. Kur nuk ka subjekt skica i afrohet më shumë prozës poetike.

Gjuha e skicës, sikurse edhe e formave të tjera të shkurtra gazeta-re, është më e kondensuar, më eliptike, nuk duron fjali të gjata e fraza, deri te edhe vetë teksti thyhet në atë mënyrë që merr një pamje midis poezisë dhe prozës.



Leonardo da Vinci, *The Vitruvian Man* (1485)

Skica nuk lidhet me kohën e me vendin e caktuar, nuk ndërlidhet me praninë a mospraninë e autorit aty. Ajo thjesht është si një fotografi e komentuar.

Në gazetarinë shqiptare skica është lëvruar fuqimisht, sidomos midis dy luftërave botërore, me autorë si M. Gj. Nikolla-Migjeni (1919-1938) dhe Nonda Bulka (1906-1972). Por janë të njohura edhe skicat e Faik Konicës (1876-1942).



## XXXVI. PORTRETI (PROFILI)

**F**jala vjen nga frëngjishtja *portrait*-i pikturuar.

Portreti është shkrim i shkurtër në prozë në të cilin autori paraqet një person të caktuar, e prezanton përmes syve të autorit, përmes përjetimeve të autorit ndaj atij personi. Autori nuk është një bartës, por ura që lidh detyrimisht personin e portretizuar dhe marrësin. Pa autorin do të shprishej trekëndëshi person-autor-marrës. Fjala portret vjen prej pikturës, por këtu nuk e ka kuptimin e vijëzimit fizik të portretit, por ekskluzivisht shpalimin e botës së brendshme të personit, edhe pse autorët përshkruajnë edhe fizikumin e personit, por edhe atëherë në interes të paraqitjes së botës së tij të brendshme.

Te portreti nuk është e rëndësishme paraqitja e plotë e personit, paraqitja e gjithë botës së tij, paraqitja e biografisë së tij etj. Autori piketon një apo disa pika themelore, më karakteristike dhe më paraqitëse për personin dhe ato i trajton. Portreti është përshkrim i mbryjtur me vështrimin psikologjik, estetik, historik dhe i shkrirë në tekst publicistik. Detaji është pika themelore e portretistit: ai gjen detajin më tipik, më karakteristik, një apo disa detaje, dhe mbi ato detaje e bazon shkrimin e tij. Detaji gjithmonë duhet të jetë i tillë që e paraqet karakterin e personit të portretizuar apo atë që dëshiron autori. Por, kjo nuk do të thotë se detaji i një luftëtari të shquar është arma e tij, apo diçka e lidhur me armën e tij. Në portretin e Isa Buletinit një gazetar anglez dallon marrëdhënien e tij me fëmijët e vegjël: ata i hipnin Isës në shpinë, në qafë, ia nduknin mustakët etj., e ai kënaqet me të vegjlit. Athua, ky detaj në portretin e Isa Buletinit është një përjashtim? Jo. Autori dëshiron ta paraqesë botën tjetër të luftëtarit e të prijësit të shquar shqiptar në fillimshkullin XX: botën njerëzore, ndjesinë më njerëzore, të ruajtur të gjallë e të freskët, përkundër viteve të gjata të Isa Buletinit të kaluara nëpër luftëra, të cilat zakonisht e barbarizojnë shpirtin e luftëtarit.

Zakonisht portreti shkruhet për njerëz që kanë bërë emër në një fushë të caktuar shoqërore. Por ka portrete edhe për njerëz të zakonshëm, në rastet kur autori dëshiron të japë një mesazh edhe për atë botë njerëzish. Si thamë më lart, portreti është shkrim i shkurtër, por shpesh ndodh të shkruhen portrete të gjata, një faqe të tërë, apo edhe më shumë, të gazetës. Ndodh kryesisht atëherë kur i portretuari është një personalitet i lartë, një president, një kryeministër, një shkrimtar i famshëm, një biznesmen i famshëm etj. Te portretet e gjata autori nuk jep vetëm disa vija të karakterit të personazhit të tij, por paraqet tërësinë e botës së tij, si dhe rrethanat e famës së tij.



## Zonja, Jo e Evropës

(profil i politikanës më të fuqishme në histori)



Ajo pëlqehet gjerësisht në Gjermani, por urrehet në vendet me probleme të eurozonës. Si figurë kryesuese e luftës kundër krizës financiare të rajonit, Kancelarja Angela Merkel është e detyruar të thotë: "Jo".

Ajo ka bllokuar dhënie borxhi, ka refuzuar propozime, kundërshtuar kërkesa, duke mbajtur në këmbë pjesën tjetër të Evropës. Për këtë, ajo ka marrë lëvdata në vendin e saj – ku e kanë quajtur "Mutti" (Mommy) dhe jashtë vendit ka krijuar antipati.

Fotot e saj të përpunuara, me brirë djalli dhe me mustaqe të stilit të Hitlerit, janë kthyer në pankarta të rregullta të protestave kundër kursimeve nëpër Evropë. Ajo ka marrë kërcënimi dhe bomba të dërguara me postë.

Ajo është femra e parë në Gjermani që zgjidhet Kancelare, dhe i pari person nga Gjermania Lindore që merr një post të fillë. Ajo është femra e dytë më e fuqishme në listën e revistës "Forbes", pas Barak Obamës. Është kritikuar vazhdimisht për pavendosmëri të gjatë dhe maturi.

59-vjeçarja është vajza e një ministri protestant dhe është rritur në një qytezë të vogël në pjesën komuniste të Gjermanisë. Ajo studioi fizikë para se të hynte në politikë si zëdhënëse e lëvizjes opozitare në Gjermaninë Lindore "Zgimi i Demokracisë", gjatë revolucionit.

Ajo hyri në parlament në zgjedhjet e para të bashkimit të vendin, duke mbajtur disa poste ministrore dhe u zgjodh lidere e opozitës para se të zgjidhej Kancelare në 2005-n. U rizgjodh në vitin 2009 dhe tashmë ka fituar dhe një mandat të tretë, sipas rezultateve paraprake të publikuara sot.

Popullariteti i Merkel është rritur akoma më shumë. Në korrik, popullariteti i saj sipas Institutit Forsa, ishte më i larti për të

gjithë liderët politik në Gjermani, ku 70% e votuesve thanë se, ishin të kënaqur me punën e saj.

Pavarësisht profilit të saj, relativisht dihet shumë pak për jetën e saj private. Mbiemri i saj që tashmë është kthyer në një markë politike, vjen nga bashkëshorti i parë i saj, Ulrich, të cilin e la pas katër vjetësh martesë.

Ndihmësit e saj të afërt thonë se, ajo kurrë nuk ulëret. Përkundrazi ajo përdor sarkazmën. Shumë biografi për të thonë se, është lidere pragmatike, që largon njerëzit që nuk ua ka më nevojën.

Ajo ka tmerr qentë dhe kuajt, pëlqen operat e Vagnerit, i kalon fundjavat në jashtë qytetit dhe shikon futboll – ndihet si tifozë e zjarrtë e kombëtares gjermane, ku shpesh i feston nga stadiumi fitoret e tyre.

Burri i saj i dytë, Joachim Sauer, është shkencëtar që qëndron larg kamerave sa më shumë të jetë e mundur. Çifti nuk ka fëmijë.

Merkel mund të bëhet liderja femër më e suksesshme në histori pavarësisht se ajo cilësohet "e kursyer, e ftohtë dhe e mërziqshme." Ajo do të jetë Kancelare e Gjermanisë deri në vitin 2016, dhe mund të bëhet liderja femër që ka mbajtur më gjatë pushtetin. Aktualisht rekordi mbahet nga Margaret Theçer, që ka mbajtur postin e Kryeministres në Britaninë e Madhe për 11 vjet.

*Florenc Stafa, 23 Shtator 2013*

<http://www.shekulli.com.al/p.php?id=31061>





**LEXIME TË MËTEJME:**

Richard Nordquist, Literary journalism,

<http://grammar.about.com/od/il/g/Literary-Journalism.htm>

**"100 Major Works of Modern Creative Nonfiction"**

<http://grammar.about.com/od/60essays/a/modnonfiction.htm>

1. Edward Abbey, *Desert Solitaire: A Season in the Wilderness* (1968)
2. James Agee, *Let Us Now Praise Famous Men* (1941)
3. Martin Amis, *Experience* (1995)
4. Maya Angelou, *I Know Why the Caged Bird Sings* (1970)
5. Russell Baker, *Growing Up* (1982)
6. James Baldwin, *Notes of a Native Son* (1963)
7. Julian Barnes, *Nothing to Be Frightened Of* (2008)
8. Alan Bennett, *Untold Stories* (2005)
9. Wendell Berry, *Recollected Essays* (1981)
10. Bill Bryson, *Notes From a Small Island* (1995)
11. Anthony Burgess, *Little Wilson and Big God: Being the First Part of the Confessions of Anthony Burgess* (1987)
12. Joseph Campbell, *The Hero With a Thousand Faces* (1949)
13. Truman Capote, *In Cold Blood* (1965)
14. Rachel Carson, *Silent Spring* (1962)
15. Pat Conroy, *The Water Is Wide* (1972)
16. Harry Crews, *A Childhood: The Biography of a Place* (1978)
17. Joan Didion, *We Tell Ourselves Stories in Order to Live: Collected Nonfiction* (2006)
18. Joan Didion, *The Year of Magical Thinking* (2005)
19. Annie Dillard, *An American Childhood* (1987)
20. Annie Dillard, *Pilgrim at Tinker Creek* (1974)
21. Barbara Ehrenreich, *Nickel and Dimed: On (Not) Getting By in America* (2001)
22. Gretel Ehrlich, *The Solace of Open Spaces* (1986)
23. Loren Eiseley, *The Immense Journey: An Imaginative Naturalist Explores the Mysteries of Man and Nature* (1957)
24. Ralph Ellison, *Shadow and Act* (1964)
25. Nora Ephron, *Crazy Salad: Some Things About Women* (1975)
26. Joseph Epstein, *Snobbery: The American Version* (2002)
27. Richard P. Feynman, *The Feynman Lectures on Physics* (1964)
28. Shelby Foote, *The Civil War: A Narrative* (1974)
29. Ian Frazier, *Great Plains* (1989)
30. Paul Fussell, *The Great War and Modern Memory* (1975)
31. Stephen Jay Gould, *Ever Since Darwin: Reflections in Natural History* (1977)

32. Robert Graves, *Good-Bye to All That* (1929)
33. Alex Haley, *The Autobiography of Malcolm X* (1965)
34. Pete Hamill, *A Drinking Life: A Memoir* (1994)
35. Ernest Hemingway, *A Moveable Feast* (1964)
36. Michael Herr, *Dispatches* (1977)
37. John Hersey, *Hiroshima* (1946)
38. Laura Hillenbrand, *Unbroken: A World War II Story of Survival, Resilience, and Redemption* (2010)
39. Edward Hoagland, *The Edward Hoagland Reader* (1979)
40. Eric Hoffer, *The True Believer: Thoughts On The Nature Of Mass Movements*(1951)
41. Richard Hofstadter, *Anti-Intellectualism in American Life* (1963)
42. Jeanne Wakatsuki Houston and James D. Houston, *Farewell to Manzanar*(1973)
43. Langston Hughes, *The Big Sea* (1940)
44. Zora Neale Hurston, *Dust Tracks on a Road* (1942)
45. Aldous Huxley, *Collected Essays* (1958)
46. Clive James, *Reliable Essays: The Best of Clive James* (2001)
47. Alfred Kazin, *A Walker in the City* (1951)
48. Tracy Kidder, *House* (1985)
49. Maxine Hong Kingston, *The Woman Warrior: Memoirs of a Childhood Among Ghosts* (1989)
50. Thomas Kuhn, *The Structure of Scientific Revolutions* (1962)
51. William Least Heat-Moon, *Blue Highways: A Journey into America* (1982)
52. Bernard Levin, *Enthusiasms* (1983)
53. Barry Lopez, *Arctic Dreams: Imagination and Desire in a Northern Landscape* (1986)
54. David McCullough, *Truman* (1992)
55. Dwight Macdonald, *Against The American Grain: Essays on the Effects of Mass Culture* (1962)
56. John McPhee, *Coming Into the Country* (1977)
57. Rosemary Mahoney, *Whoredom in Kimmage: The Private Lives of Irish Women* (1993)
58. Norman Mailer, *The Armies of the Night* (1968)
59. Peter Matthiessen, *The Snow Leopard* (1979)
60. H.L. Mencken, *A Mencken Chrestomathy: His Own Selection of His Choicest Writing* (1949)
61. Joseph Mitchell, *Up in the Old Hotel and Other Stories* (1992)
62. Jessica Mitford, *The American Way of Death* (1963)
63. N. Scott Momaday, *Names* (1977)
64. Lewis Mumford, *The City in History: Its Origins, Its Transformations, and Its Prospects* (1961)
65. Vladimir Nabokov, *Speak, Memory: An Autobiography Revisited* (1967)



66. P.J. O'Rourke, *Parliament of Whores* (1991)
67. Susan Orlean, *My Kind of Place: Travel Stories from a Woman Who's Been Everywhere* (2004)
68. George Orwell, *Down and Out in Paris and London* (1933)
69. George Orwell, *Essays* (2002)
70. Cynthia Ozick, *Metaphor and Memory* (1989)
71. Robert Pirsig, *Zen and the Art of Motorcycle Maintenance* (1975)
72. Richard Rodriguez, *Hunger for Memory* (1982)
73. Lillian Ross, *Picture* (1952)
74. David Sedaris, *Me Talk Pretty One Day* (2000)
75. Richard Selzer, *Taking the World in for Repairs* (1986)
76. Zadie Smith, *Changing My Mind: Occasional Essays* (2009)
77. Susan Sontag, *Against Interpretation and Other Essays* (1966)
78. John Steinbeck, *Travels with Charley* (1962)
79. Studs Terkel, *Hard Times: An Oral History of the Great Depression* (1970)
80. Lewis Thomas, *The Lives of a Cell* (1974)
81. E.P. Thompson, *The Making of the English Working Class* (1963; rev. 1968)
82. Hunter S. Thompson, *Fear and Loathing in Las Vegas: A Savage Journey to the Heart of the American Dream* (1971)
83. James Thurber, *My Life and Hard Times* (1933)
84. Lionel Trilling, *The Liberal Imagination: Essays on Literature and Society* (1950)
85. Barbara Tuchman, *The Guns of August* (1962)
86. John Updike, *Self-Consciousness* (1989)
87. Gore Vidal, *United States: Essays 1952-1992* (1993)
88. Sarah Vowell, *The Wordy Shipmates* (2008)
89. Alice Walker, *In Search of Our Mothers' Gardens: Womanist Prose* (1983)
90. David Foster Wallace, *A Supposedly Fun Thing I'll Never Do Again: Essays and Arguments* (1997)
91. James D. Watson, *The Double Helix* (1968)
92. Eudora Welty, *One Writer's Beginnings* (1984)
93. E.B. White, *Essays of E.B. White* (1977)
94. E.B. White, *One Man's Meat* (1944)
95. Isabel Wilkerson, *The Warmth of Other Suns: The Epic Story of America's Great Migration* (2010)
96. Tom Wolfe, *The Electric Kool-Aid Acid Test* (1968)
97. Tom Wolfe, *The Right Stuff* (1979)
98. Tobias Wolff, *This Boy's Life: A Memoir* (1989)
99. Virginia Woolf, *A Room of One's Own* (1929)
100. Richard Wright, *Black Boy* (1945)

## Shënime

- 1 Frederik Barbier, Catherina Bertho Lavenir, *Historia e medias nga Dideroi tek Interneti*, ISHM, Tiranë, 2004.
- 2 Rene Velek, Ostin Voren, *Teoria e letërsisë*, Rilindja, 1982, fq. 325.
- 3 Osvald Dykro & Zvetan Todorov, *Fjalori shkencave të ligjëritimit*, Rilindja, 1984, fq. 364.
- 4 H. Boriçi e përkufizon reportazhin duke e ndarë tri anët e tij: lajmi (kumti), dokumentimi i tij dhe forma letrare e paraqitjes së tij. (shih *Gazetaria 2*, fq. 272 dhe 277).
- 5 John C. Acree dhe Kastriot Islami, *Ç'ndodh kur ndodh diçka?/ Grupi Shqiptar i Menaxhimit të Emergjencës dhe Emergjencia e Refugjatëve Kosovarë e 1999-s*, Lester B. Pearson, 2000, Clementsport, fq. 47
- 6 FIAMURI ARBËRIT, Corigliano Calabro, nr. 1, 20 korrik 1883, shkrim i redaksisë. Cituar nga *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, vëllimi I, 1879-1908, Tiranë 1971, fq. 174-177.
- 7 BASHKIMI, Shkodër, nr. 8, 20 shkurt 1910. Cituar nga *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, vëllimi II, 1908-1910, Tiranë 1976, fq. 113
- 8 DRITA, Sofje, nr. 100. 15 maj 1908. Cituar nga *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, vëllimi II, 1908-1910, Tiranë 1971, fq. 217-222.
- 9 Frederik Barbier, Catherina Bertho Lavenir, *Historia e medias nga Dideroi tek Interneti*, ISHM, Tiranë, 2004, fq. 72.
- 10 DIELLI, Boston, i pari më datë 5, i dyti më datë 9 dhe i treti më datë 19 gusht 1922. Cituar sipas: Faik Konica, *VEPRA 3*, Botimet Dudaj, 2001, fq. 206-218.
- 11 Frederik Barbier, Catherina Bertho Lavenir, *Historia e medias nga Dideroi tek Interneti*, ISHM, Tiranë, 2004, fq. 62.
- 12 *Recnik knjizevni termin*, BIGZ, 1992, fq. 562.
- 13 RRUFJA, Egjipt, nr. 8, gusht 1909.
- 14 Faik Konica, *Përgjegje një Sërbi*, ALBANIA, 1904. Cituar nga F. Konica, *VEPRA 3*, Botimet Dudaj, fq. 123.
- 15 Frederik Barbier, Catherina Bertho Lavenir, *Historia e Medias nga Dideroi tek Interneti*, ISHM, Tiranë, 2004, fq. 89 dhe fq. 155, 156.
- 16 SHQIPËRIA, Bukuresht, nr. 1 (10 maj), nr. 2 (17 maj) 1897, pa autor. Cituar nga *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, vëllimi I, 1879-1908, Tiranë, 1971, fq. 87-89.
- 17 ZGJIMI I SHQIPËRISË, Janinë, shtypur në numrat 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70 dhe 71 të vitit 1910, me autor P. P. P. Cituar nga *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, vëllimi II, 1908-1910, Tiranë 1976, fq. 96-103.
- 18 HYLLI I DRITES, Atë Marin Sirdani, *Shqyptarët e hartet*, nr. 4, 7 (1921), nr. 2, 4, 11, 12 (1922), nr. 5 (1923).
- 19 HYLLI I DRITES, Atë Marin Sirdani, *Nji Rival i Skanderbegut*, nr. 7, 8, 9 e 12 të vitit 1932.
- 20 Faik Konica, *VEPRA 3*, Botimet Dudaj, fq. 272.
- 21 Njëra prej fazave të kritikës së tekstit (tekstologji), veçanërisht në përgatitjen e botimeve kritike të veprave të traditës. Përqendrohet në saktësimin e të gjitha burimeve të një vepre, në saktësimin e varianteve dhe në saktësimin e origjinalit, apo përcakton një burim. Shih: *Recnik knjizevni termin*, BIGZ, 1992, fq. 682.
- 22 *Recnik knjizevni termin*, Nolit, Beograd, 1992, fq. 202.
- 23 *Recnik knjizevni termin*, Nolit, Beograd, 1992, fq. 202.
- 24 Bardhyl Musai në bashkëpunim me: Elisa Qenamë, Entela Shqerra, Valbona Shqergjergji, *Si të shkruajmë ese/paragrafët, pyetjet dhe vlerësimi*, CDE - Qendra për Arsime Demokratik, Tiranë, 2007, fq. 109.



XXXVIII. Gazetaria argëtuese  
Entertainment - Infotainment

Gazetaria argëtuese

5  
PJESA



## PËRMBLEDHJE

**N**ë këtë kapitull shtjellohet argëtimi me gazetarinë e mediën dhe përdorimi i gazetarisë e medias për argëtim. Kjo është e rëndësishme sidomos në fillim të shekullit XXI, kur në shumë vende të botës ka shumë televizione ose medime të tjera të cilat deri në 90 % të kohës së tyre ua kushtojnë argëtimit. Emisionet më të shikuara në botë janë pikërisht këto emisione argëtimi. Në dinamikën e madhe të jetës moderne informative, tash kur truri i njeriut është thjesht i bombarduar me qindra-mijëra informata në ditë, gazetaria argëtuese po gjen gjithnjë e më shumë hapësirë në jetën e njeriut modern.

Në kapitull janë shtjelluar dy format kryesore të argëtimit përmes gazetarisë: entertainment dhe infotainment. Po ashtu, është shtruar pyetja se sa larg mund të shkohet në bashkëjetesën e gazetarisë e medieve me argëtimin? Përgjigjet në këtë pyetje ofrojnë një gamë të gjerë, prej tyreve më mohueset (si janë kritikantët e argëtimit me video-lojëra, me filma horrorë, me dhunën virtuale etj.) e deri te më pohueset (gazetaria argëtuese ofron të gjitha funksionet që ofron çdo gazetar). Duhet veçuar se për herë të parë në mendimin gazetar shqip po trajtohet si çështje teorike gazetaria argëtuese, edhe pse, si gjithkund tjetër, edhe këtu praktika ka ecur shumë më përpara teorisë: gjithnjë e më shumë po emetohen shou programe dhe spektakle si "reality show", "Ethet e së Premtes", "Voice of Albania" etj., ose "Klan Kosova" ka modeluar emetimin e lajmeve duke u shtuar atyre edhe nga pak humor e ironi, për qëllime argëtuese të audiencës.

Sado ky kapitull në aspektin sasior, por edhe në atë cilësor, nuk mund të krahasohet me kapitujt e tjerë të këtij libri dhe me tematikat e tyre, fakti që gazetaria argëtuese është trajtuar si zhanër i mëvetëshëm e ka rëndësinë e vet. Pikërisht në këtë kapitull u mbetet studiuesve të tjerë të gazetarisë, të medias dhe të tekstit gazetar, të hulumtojnë dhe të shkoqisin aspekte e parime të rëndësishme të gazetarisë argëtuese.






## XXXVIII. GAZETARIA ARGËTUESE

### PËRMBAJTJA

### XXXVIII.1. NJË PËRKUFIZIM TEORIK

**Q**endra për Hulumtim dhe Anketim e Universitetit të Ohajos bëri një anketim telefonik në vitin 2001 me shikuesit e TV shout *Kush do të bëhet milioner?*. 84.6 % e të anketuarve deklaruan se e kanë parë shoun.<sup>1</sup> Ky shou televiziv, i krijuar në Angli në vitin 1998 (emisioni i parë ka filluar më 4 shtator 1998 në ITV1), ndoshta është më argumentuesi për përhapjen e rrefeshme të emisioneve argëtuese televizive në gjithë botën. Ky emision argëtues sot transmetohet në mbi 100 vende të ndryshme të botës.<sup>2</sup> 83 % e çekëve e kanë shikuar serinë e parë në Republikën Çeke, ndërsa është i vetmi emision argëtues perëndimor të cilin e ka blerë rrjeti japonez Fuji.<sup>3</sup> Ngjashëm me *Kush do të bëhet milioner?* janë edhe emisionet argëtuese si *American Idol*, *Big Brother*, *X Factor* etj., të cilat prijnë dukshëm për shikueshmëri në të gjitha anketimet.

Në teorinë e medias këto emisione dhe shumë të ngjashme quhen gazetari argëtuese, ose edhe përdorim i medias për argëtim dhe kënaqësi. Gazetaria argëtuese është prodhim i medieve masive të shekullit XX, por e ndjek rrugën e argëtimit dhe të kënaqësive përmes medias që nga kulturat antike. Në parathënien e librit *Media Entertainment The Psychology of Its Appeal* (2000) redaktorët Dolf Zillmann dhe Peter Vorderer e përshkruajnë origjinën e argëtimit përmes medieve që nga kultura e lashtë egiptiane, te grekët e vjetër,



XXXVIII. Gazetaria argëtuese . . . . .	403
XXXVIII.1. Një përkufizim teorik . . . . .	403
XXXVIII.2. Entertainment	405
XXXVIII.3. Publiku . . . . .	406
XXXVIII.4. Qëllimi përm-bajtjesor i gazetarisë argëtuese. . . . .	407
XXXVIII.5. Infotainment	409
XXXVIII.6. Gazetaria argëtuese në gazetat e shtypura. . . . .	410
XXXVIII.7. Entertainment dhe infotainment . . . . .	412



Gazetaria argëtuese dhe fëmijët:  
Prindërit e tmerruar nga transmetimi i vrasjeve me armë, ndërsa fëmija thërret "Vriti ata! Vriti ata të gjithë!!!"

Duke u shndërruar gazetaria në argëtim, a do t'i humbë edhe funksionet e tjera sociale, sidomos pjesën më fisnike, informimin neutral dhe edukimin? Ose, e formuluar ndryshe, deri ku mund të bashkëjetojnë gazetaria e media me argëtimin? A ka një kufi? Dhe, ku është ai kufi?

te Mesjeta e deri te mediet masive. Ata trajtojnë disa lloje të gazetarisë argëtuese të kohës moderne, si: humori, komedia, drama, filmi horror, seksi, sportet, "talk-show", muzika, spotet muzikore, video-lojërat etj. Sot janë të famshme disa lloje, si: opera-sapun (Soap Opera), komedi si *Will & Grace*, ose *Sex and the City*, komedi-drama si *CSI: Miami*, ose *Law and Order*, TV-shou (Game Shows) si *Kush do të bëhet milioner?*, "reality shows" si Big Brother etj.

Me përhapjen e rrufeshme të gazetarisë argëtuese dhe të medieve që ofrojnë apo mund të përdoren për argëtim, njëkohësisht u përhap edhe frika nga argëtimi që ofrojnë mediet. A ndikon dhuna virtuale në krijimin e gjeneratave të dhunshme? A është "Facebook"-u humbje kohe? A është etike të informosh duke ironizuar dhe përqeshur personazhet e lajmeve? A po ndikon interneti në krijimin e individëve të vetmuar e egoistë? A është jeta virtuale e dëmshme për jetën reale? Të gjitha këto pyetje dhe të tjera dëshmojnë frikën historike të njeriut ndaj çdo mediumi të ri, në njërën anë, por edhe pyetjen etike se a është e preferueshme të përdoren mediet për argëtim, duke e futur kështu gazetarinë në një rrugë jo shumë të sigurt? Dhe në fund, duke u shndërruar gazetaria në argëtim, a do t'i humbë edhe funksionet e tjera sociale, sidomos pjesën më fisnike, informimin neutral dhe edukimin? Ose, e formuluar ndryshe, deri ku mund të bashkëjetojnë gazetaria e media me argëtimin? A ka një kufi? Dhe, ku është ai kufi?

Sipas Anne Cooper-Chen, *Kush do të bëhet milioner?* mund të ofrojë të gjitha funksionet e medieve masive, të përkufizuara prej Katz, Gurevitch dhe Haas (1973):

1. njohëse (*cognitive*): maja e informacionit nga përmbajtja e pyetjeve dhe e përgjigjeve,
2. ndjesore (*affective*): kënaqësia që krijohet gjatë lojës;
3. integrimi personal (*personal integrative*): forcimi i besimit me gjetjen e disa përgjigjeve të mundshme, të renditura nga 1 deri në 4, e ndoshta edhe mposhtjen e lojtarit në studio;
4. integrimi social (*social integrative*): kontakti me familjen dhe shokët duke përcjellë lojën së bashku ose duke folur për të më vonë; dhe
5. shtendosje (*tension release*): angazhimi në shou mundëson relaksim dhe harrimin e problemeve të ditës.<sup>4</sup>

Por, a mund të thuhet kështu për vide-lojërat me luftëra dhe vrasje? A mund të thuhet kështu për një "reality shou"? Në parathënien e librit të përmendur Anne Cooper-Chen thotë: Televizioni argëtues është pjesë kryesore - dhe pjesa çelës - e kulturës masive moderne, mirëpo akademikët priren për t'i studiuar lajmet, të vendit dhe të huajat. (...) Në Ekuador, për shembull, afër 90 % e kohës më të mirë (prime time) të programit është argëtuese e pastaj edhe informative.<sup>5</sup>

Në Ekuador, për shembull, afër 90 % e kohës më të mirë (prime time) të programit është argëtuese e pastaj edhe informative.


Tashmë ekziston një çarje në mendimin gazetar. Përdorimi i medias për kënaqësi dhe, më tej, përshtatja e gazetarisë me argëtimin ka krijuar dy anë të kundërta të gjykimit të kësaj çështje: disa pohojnë se kjo është rruga e drejtë e cila sjell fitime dhe kënaqësinë e publikut e të tjerët e shohin si një degradim të vlerave dhe të funksionit të gazetarisë në shoqëri.

## XXXVIII.2. ENTERTAINMENT

Është vështirë të përkufizohet kjo kulturë gazetare e ngatërruar me argëtimin, sidomos në kohën kur "lajmi i fortë" ka zbritur në nivelin e këngës apo valles 24-orëshe, si thuhet në *Encyclopedia of Journalism* (2009).<sup>6</sup> Entertainment ka kuptimin e argëtimit dhe si nocion gazetar nënkupton të gjitha ato tekste gazetare, të gjitha ato emisione radio-televizive, në veçanti të gjitha ato medie të cilat botohen apo emetohen me një qëllim përmbajtjesor: informimin dhe argëtimin. Në kulturën moderne ky nocion nuk lidhet vetëm për gazetarinë por edhe për artet e kulturën në përgjithësi: serialët komike televizive janë entertainment, po ashtu videot amatore humoristike (publiku amerikan e njih mirë shoun televiziv *America's Funniest Home Videos*), vallëzimi si *Dance with the Stars*, spotet muzikore, filmat horror, video lojërat, seksi e shumë e shumë zhanre të tjera multimediale, të cilat po marrin rol gjithnjë e më të madh në kulturën moderne.

Disa kritikë të artit po e konsiderojnë këtë kulturë si degradim, si rënie, si një hapësirë në të cilën gjithnjë e më pak ka profesionistë e gjithnjë e më shumë ka amatorë. Teknologjia digjitale informative e ka demokratizuar jashtëzakonisht shumë gjithë mjedisin e gazetarisë, të komunikimit dhe të kulturës mediale, mirëpo njëkohësisht ajo ka prodhuar edhe amatorët e gazetarisë e të komunikimit, të cilët përdorin mirë teknologjinë informative por nuk janë profesionistë në gazetari e në komunikim, ose janë gjysmë profesionistë, mirëpo duke qenë përdorues të mirë të teknologjisë imponohen në treg me produktet e tyre të dyshimta. Ueb Blogjet në internet këtu e kanë origjinën: amatorë dhe gjysmë profesionistë kanë botuar tekste të "nivelit të ulët" (kryesisht thashetheme ose skandale) për ta tërhequr vëmendjen te vetja. Por, sot ueb blogjet konsiderohen format i një shkalle relativisht të lartë dhe serioze. Emra të mëdhenj të gazetarisë e të kulturës kanë blogjet e tyre në të cilat botojnë tekstet e tyre. Ndoshta i njëjti fat e pret edhe gazetarinë entertainment: nga turbullirat e fillimit mund të stabilizohet dhe të prodhojë zhanre të qëndrueshme edhe ndaj kritikës.

A është media gjithçka për njeriun? Karikaturë e cila e paraqet median si ushqim për njeriun.



### XXXVIII.3. PUBLIKU

Gazetaria entertainment ka sjellë një faktor të ri në skenë: publikun. Pothuajse të gjitha emisionet e kësaj gazetarie zhvillohen me publikun si faktor në emision e jo vetëm si vëzhgues e statistikë. Kështu, për shembull, në emisionin *Kush do të bëhet milioner?* publiku ka një rol jo vetëm simbolik (duartrokitjet e tij), por ka ndikim edhe në rrjedhën e emisionit: ai ka të drejtë që secilit pjesëmarrës në lojë t'ia tregojë një përgjigje të saktë, duke e bërë këtë përmes votimit elektronik. Pjesëmarrësi është i lirë të vendosë se a do ta pranojë apo jo përgjigjen e publikut si të veten (në shumicën e rasteve publiku nuk gabon në gjetjen e përgjigjes së saktë), po kjo nuk do të thotë asgjë, e rëndësishme është që publiku mund ta ndihmojë atë që ta vazhdojë lojën. Roli i publikut është edhe më i theksuar në emisionet e tipit *X Factor*, *Amerikans Idol* etj. Në këto emisione publiku vendos se cili prej pjesëmarrësve do të largohet nga gara e cilët do të vazhdojnë, kështu deri në fund, poende edhe fituesin e garës e zgjedh publiku. Juria e cila formalisht zë vendin kryesor në emision, praktikisht nuk e ka atë pozitë: ata vlerësojnë dhe ndoshta mund të ndikojnë te votat e publikut, por kjo është vetëm gjasë, përndryshe ata janë vetëm dekor për ta krijuar seriozitetin e emisionit dhe të procesit të vlerësimit: "ata janë ose këngëtarë të famshëm ose muzikantë me akademi dhe ata dinë të vlerësojnë saktësisht" - ja, kjo i duhet emisionit për të krijuar te publiku opinionin se e gjithë kjo nuk është një lojë koti, por një emision i lartë ku është legjitim argëtimi i të gjitha strukturave të shoqërisë, nga rojtari e deri te presidenti. Ky model i votimit të publikut dhe i përcaktimit të fituesit përmes votës së publikut ka depërtuar edhe në emisione që konsiderohen shumë serioze, si është festivali konkurrues *Eurovizion*.

Duke pasur publiku një rol kaq të madh në emisionet e gazetarisë argëtuese, krijohet ura lidhëse midis emisionit dhe pjesës tjetër të publikut, atyre të cilët ndjekin televizionin nga shtëpitë e tyre. Nëse publiku i emisionit duket kaq i kënaqur dhe ka kaq shumë rol në rrjedhat të cilat përcaktojnë fatet jetësore të konkurruesve,

pse të mos jemi edhe ne pjesë e atij publiku? Kjo do të duhej të ishte, pak a shumë, pyetja të cilën e presin prej publikut anonim drejtuesit, financuesit dhe pronarët e medieve të cilat transmetojnë këso emisione argëtuese. Shkëlqimi i skenës si në përralla duhet t'i verbojë ata fanatikë që nuk e luajnë këmben nga shtëpia e tyre. Mirë, këto dy fjalitë e fundit përmbajnë ironi, por e vërteta është se këtu mund të funksionojë një prej parimeve të Dy Langëve<sup>7</sup>: audiencia që kishte qëndruar në shtëpi për ta përcjellë transmetimin e kthimit të gjeneralit Mc Artur në Çikago ishte dëshpëruar pse kishte qëndruar në shtëpi dhe nuk kishte dalë në rrugë për ta përjetuar atë ngjarje madhështore, pra emocionalisht dhe ideologjikisht ata ishin bërë më të manipulueshëm, ishin shndërruar në masë; ndërsa po ndodhte krejt e kundërta tek ai publik që kishte vendosur të dilte në rrugë e në sheshe për ta pritur Mc Arturin, ajo ishte dëshpëruar pa masë, kishte fishkëlluar dhe një pjesë e saj as që e kishte parë gjeneralin, prandaj e thyer ishte kthyer në shtëpi, pra emocionalisht dhe ideologjikisht ata nuk ishin manipuluar dhe nga një masë fillestare ishte shndërruar në publik. Pikërisht ky efekt i duhet gazetarisë entertainment: ta bindë dhe ta manipulojë atë pjesë të audiencës që rri në shtëpi dhe shikon televizionin, tek ata (publiku i sallës jashtë kamerave nuk është fare i rëndësishëm; mund të jetë që ata marrin mëditje për të prezantuar aty!) të krijohet përshtypja se kjo kulturë argëtimi është shpëtim prej vështirësive të jetës bashkëkohore. Ky përfundim i vë në pikëpyetje të gjitha pohimet se gjoja media masive dhe gazetaria argëtuese e kanë krijuar publikun dhe rolin e tij në media. Ky publik i krijuar është vetëm një masë e paguar për ta joshur publikun tjetër, atë që rri nëpër shtëpi dhe shikon televizion.



Në shouprogramet publiku paguhet se kur duhet qeshur e kur duhet duartrokatur. Një "dirigjent" rri prapa kamerës dhe ai u jep shenjën se kur duhet bërë njëri a tjetri veprim. Publiku para televizioneve, sipas formulës së Dy Langëve, krijon bindjen se gjithçka po shkëlqen!

## XXXVIII.4. QËLLIMI PËRMBAJTJESOR I GAZETARISË ARGËTUESE

Gazetaria argëtuese tashmë është bërë një fenomen apo një ortek botëror, i cili po tejkalon të gjitha parashikimet. Ky fenomen po studiohet nga shumë aspekte, që nga lloji zhanror e deri te ndryshimet gjinore, rajonale, fetare, racore etj., të cilat mund të studiohen ndaj qasjeve të audiencave në këto programe argëtuese. Analizimi i pyetjeve që bëhen në emisionet e *Kush do të bëhet milioner?* në vende të ndryshme na flet mjaft shumë për kulturat e ndryshme të atyre audiencave.<sup>8</sup>

Kjo gazetari ndërlihet kryesisht me televizionin dhe me kompjuterin për shkak të mundësive të mëdha që krijon pamja filmike mirëpo, në thelb, ajo është një zhanër i gazetarisë, krahas tre zhan-

reve tradicionale, në përputhje të plotë me dy faktorët tipologjikë zhanrorë: qëllimin përmbajtjesor dhe strukturën tekstore. Kjo e kthen temën te gazetaria e shkruar, sepse teksti qenëson si shkrim dhe si pamje. Ne mund ta përkufizojmë këtë gazetari si zhanër në gazetarinë e shkruar, aty ku edhe ka lindur, e pastaj ajo vazhdon të mbizotërojë në televizion dhe në gazetarinë e internetit.

Qëllimi përmbajtjesor i gazetarisë argëtuese është informimi dhe argëtimi i audiencës. Fjalëkryqi, për shembull, i plotëson të dy këto kërkesa të qëllimit përmbajtjesor: informon përmes përmbajtjeve të pyetjeve e përgjigjeve në to, ndërsa argëton, krijon kënaqësi, qoftë duke gjetur përgjigjet (e krijon vetëbesimin e përdoruesit të tij në aftësitë e tija), qoftë duke "humbur" kohën, pra duke harruar problemet e tjera, e kjo ndikon në shtendosjen e tij. Njësoj është edhe me horoskopin, me një humoreskë apo me një barsoletë, edhe pse këto të fundit nganjëherë përkrijnë edhe publicistikën. Njësoj është edhe me disa lloje të fiçërit, sipas traditës amerikane. Një fiçër për ndikimin e seksit në jetëgjatësinë e njeriut, ose për dietat kundër trashjes, ose për ushtrimet efikase për mospirjen e duhanit etj., është tekst njohës dhe argëtues, pra gazetari argëtuese. Vetëm këtu mund t'i fusim edhe faqet e mesme të disa gazetave shqiptare, pavarësisht si titullohen ato rubrika, si "Mesi i artë", "Rozë", "VIP" etj., e të cilat sjellin thashetheme për jetën e njerëzve të estradës dhe për njerëz të tjerë të famshëm, për dashuriçkat dhe ndarjet e shkurorëzimet e tyre, për ndejat e tyre, për udhëtimet e pushimet e tyre, sjellin fotografi për dukjen e tyre, kryesisht për dukjen e femrave të bukura etj. Të gjitha këto rubrika, tekste apo artikuj, veç e veç dhe bashkërisht, kanë një qëllim të përbashkët përmbajtjesor: informimin dhe argëtimin e audiencave. Ky qëllim përmbajtjesor dallon thelbësisht nga qëllimi përmbajtjesor i gazetarisë informative, asaj analitike dhe asaj publicistike.


Në anën tjetër, faktori i dytë tipologjik zhanror, struktura tekstore, e dallon këtë gazetari tej për tej nga cilado gazetari tjetër. Çfarë mund të themi për strukturën tekstore të fjalëkryqit, i cili në fakt më shumë është një tabelë e vijëzuar sesa një tekst? Çfarë mund të themi për një "lajm" argëtues për dukjen e javës së kaluar të Rihanës në një bar të Manhatanit? Çfarë mund të thuhet për strukturën tekstore të një fjale të urtë, apo për strukturën tekstore të një horoskopi? Të gjitha këto lloje dhe të tjera lloje të gazetarisë argëtuese kanë një strukturë tekstore krejtësisht të ndryshme nga tekstet e tjera gazetare. Disa prej tyre kanë një strukturë fikse (fjalëkryqi, fjalë të urta, horoskopi), ndërsa disa të tjerë kanë një strukturë më komplekse (disa lloje të fiçërit), e disa të tjerë një strukturë të përbërë prej fotografisë dhe fjalës (thashethemet për VIP).

Qëllimi përmbajtjesor i gazetarisë argëtuese është informimi dhe argëtimi i audiencës.



## XXXVIII.5. INFOTAINMENT

Infotaimnet është një nocion i ri, i përkufizuar si “program televiziv që paraqet informacion (si lajme) në një mënyrë që synon të jetë i këndshëm”, pra është zhanër i përzier, që ndërlikohet informimin dhe argëtimin. Sipas *Encyclopedia of Journalism* (2009) infotainment është krijuar për herë të parë në SHBA në vitet '80 të shekullit XX. Deri atëherë ka pasur një vijë të fortë ndarëse midis “lajmeve të forta” dhe “lajmeve të buta”, e këto të fundit janë trajtuar edhe si infotainment. Mirëpo me zhvillimin e teknologjisë informative në këtë periudhë, televizioni, kompjuteri dhe interneti, ndarja midis këtyre dy llojeve të lajmit vjen duke humbur në favor të “lajmeve të buta” dhe merr këmbë gazetaria infotainment. Në fillim të shekullit XXI infotainment përjeton një rritje të madhe.



Karikaturë që e paraqet presidentin amerikan Barak Obama duke u argëtuar me “lajmet e buta” televizive.

Janë dy faktorë që kanë ndikuar këtë rritje. Së pari, teknologjia informative e cila është sofistikuar aq shumë saqë ia jep mundësinë secilit përdorues t'i zgjedhë vetë lajmet se çfarë do të shohë. Kjo teknologji po vjen gjithnjë e më shumë duke u personalizuar, pra duke u bërë pjesë e pandashme e personit, ashtu si ka thënë McLuhan në vitin 1964, e me këtë personalizim përdoruesi mund t'i përcjellë lajmet në të gjitha situatat e mundshme dhe në të gjitha vendet e mundshme, e ai zakonisht e bën këtë kur i bie të rrijë kot, e në këto raste ai nuk është i interesuar të përcjellë “lajme të forta”, por më me dëshirë zgjedh “lajmet e buta”, ato të cilat e bëjnë të argëtohet dhe të informohet. Me demokratizimin e medieve që ka sjellë kjo teknologji informative ka marrë fund njëherë e përgjithmonë ekzistimi i një qendre (pronari, redaksia, bordi i televizionit,



kolegjiumi i redaktorëve etj.) e cila vendos se çfarë lajmesh duhet të ndjekë publiku. Tash publiku bën vetë zgjedhjen. Së dyti, tregu është faktori numër një që ka ndikuar në rritjen e infotainmentit. Në luftën për mbijetesë dhe për fitimin a parasë, e në tregun amerikan gazeta dhe secila medie është vetëm mall tregu e asgjë më shumë, gazetaria synon të përfitojë e të mbajë sa më shumë klientë. Ky fakt e ka shtyrë dhe po e shtyn gazetarinë në shumë aventura, e efekti i njërës prej këtyre aventurave është infotainment. Kryeredaktorët gjithmonë arsyetohen se këtë po e lyp publiku, prandaj ata vetëm po i përshtaten publikut. Por, në fakt, përzierja e lajmit me argëtim e me thashetheme është çështje e parimeve gazetar e jo e parimeve të tregut.<sup>10</sup>

Në tregun shqiptar të medias TV “Klan Kosova” e ka futur infotainmentin në jetë. Edicioni qendror i lajmeve në këtë televizion informon duke argëtuar dhe duke krijuar kënaqësi te publiku, duke i bërë ata të qeshin edhe me lajmin më serioz protokollar: (“sot kryeministrit nuk i ka qeshur fytyra...” fillon lajmi për një takim protokollar të kryeministrit; ose: “sot Nexhat Daci ndenji ulur shtrembër...”; ose lajmi për pjesëmarrjen e presidentes në një takim protokollar në TV “Klan” fillon me fjali të tipit “sot presidentja nuk u rehatua në karrigen ku ishte ulur” dhe vetëm pas dy-tri fjalive të tilla argëtuese jepet informata kryesore e lajmit). Në këto tekste është vështirë të dallohet kur gazetari synon të informojë e kur të argëtojë, duke krijuar dilema se mos është krejt kjo ironi me aktorët e ngjarjeve lajmore! Te këto lajme të TV “Klan”-it pjesa kryesore e lajmit përsëri mbetet informata, e argëtimi shërben vetëm për ta krijuar shijen e humorit dhe të argëtimit. Ndryshe nga TV “Klan”, “Radio Kosova” e ka emisionin *Metropol*, në të cilin ka fund e krye infotainment, por këtu argëtimi zë vendin e parë dhe vetëm pastaj lajmi. Emisioni *Metropol* i Berat Miftarit është më tepër emision argëtues sesa informativ, pra argëtimi mbizotëron lajmin.

## XXXVIII.6. GAZETARIA ARGËTUESE NË GAZETAT E SHTYPURA

Në gazetarinë e shtypur informacioni dhe argëtimi kanë bashkëjetuar, pra ka pasur tradicionalisht një gazetari argëtuese gjatë gjithë shekullit XX, porse vetëm në rubrika të veçanta, të dallueshme qartë prej “lajmeve të forta”. Kështu vazhdon edhe sot në këtë gazetari. Gazetat shqiptare në Kosovë zakonisht sjellin fjalëkryqin, i cili vendoset në faqet e fundit të gazetës. Disa nga gazetat kanë edhe rubrikat e humorit, në të cilat sjellin barsoleta të ndryshme. Të

herëpashershme janë edhe lojërat e ndryshme që e ushtrojnë trurin e njeriut, si: gjeni ndryshimet midis këtyre dy vizatimeve etj. Në këtë gazetari hyjnë edhe një pjesë e teksteve fiçër (artikuj të veçantë) si, për shembull, ata që trajtojnë se si duhet t'i kaloni pushimet më mirë etj. Pjesa më e madhe e karikaturave po ashtu bën pjesë këtu: kryesisht ato karikatura të cilat nuk bartin mesazhe të forta, por shërbejnë vetëm për argëtim. Kështu, në numrin përmbyllës të vitit 2013, gazeta *Koha ditore* ka vënë në ballinë një karikaturë e cila paraqet një makinë të klasit të mirë, me flamurin e Kosovës dhe me kapelën e Babadimrit, ndërsa shoferi me thesin e arnuar është vetë Babadimri. Kjo karikaturë është e mbizotëruar prej funksionit argëtues, prandaj nuk ka se si të trajtohet si gazetari informative (si kemi bërë për karikaturën në kapitullin e dytë të këtij libri), por e ka vendin këtu, në gazetarinë argëtuese. Ndërsa në tri faqe të tjera gazeta boton karikaturat e Jeton Mikullovcit, të cilat synojnë të bartin mesazhe të forta. E njëjta gazetë, po në këtë numër, një faqe të tërë ia kushton *Horoskopit të madh* për vitin 2014. Ndërsa nga artikujt e veçantë në këtë numër janë:

1. Termat më të kërkuar në Google në vitin 2013
2. 8 parashikime për sigurinë kibernetike për vitin 2014
3. 10 të veshurit më bukur në vitin 2013
4. Tregimet e mbinatyrshme të shekullit XIX
5. Teoritë shqetësuese dhe bizare të konspiracionit të cilat shokuan shumë njerëz
6. Çfarë i mban gjallë teoritë e konspiracionit
7. Pse do të bënin alienët tërë atë rrugë vetëm për ta pushtuar Tokën?
8. Stacionet e trenit që ndryshuan destinimin
9. Dhjetë zbulimet 'më negative' në histori
10. Laplandi- vendi i Babadimrit

Ky numër i *Kohës ditore* ka plot 15 faqe me fjalëkryqe (nga 160 faqe sa i ka numri). Edhe pse në vitet e fundit në shtypin shqiptar kanë depërtuar furishëm artikujt e veçantë, në *Koha ditore* në gazetarinë argëtuese ende mbizotëron bindshëm fjalëkryqi, një zhanër ky argëtues i gazetarisë tradicionale. Në gazetarinë tradicionale të shtypit gazetarisë argëtuese i është bërë favor në gazetat për fëmijë e të rinj. Ndoshta ky është shembulli më kuptimplotë edhe për gazetarinë argëtuese në përgjithësi: aty ka informatë dhe argëtim. Gazetarët synojnë t'i informojnë fëmijët dhe të rinjtë duke i argëtuar, pra kjo nuk ka të bëjë asgjë me blerjen e tregut dhe të klientelës, por me metodën didaktike.

## XXXVIII.7. ENTERTAINMENT DHE INFOTAINMENT

Në fund të diskutimit për gazetarinë argëtuese duhet të tërhiqet një vijë ndarëse: midis përdorimit të medieve për argëtim (entertainment) dhe midis prirjes së re gazetare për të informuar duke argëtuar (infotainment). Seriali komik *Kafeneja jonë* në thelb është zhanër dramatik (komedi). Ajo do të mund të shfaqej edhe në teatër, por në formatin ekzistues është përshtatur aq shumë për televizion, për kohën e shfaqjes, për vazhdimësinë dhe për audiencën pothuajse të përhershme dhe me këto tipare ajo është prodhim televiziv. Pra, *Kafeneja jonë* vetëm po e përdor televizion vetëm për të përhapur argëtim dhe, si i tillë, ajo është mall media, gazetari argëtuese. Njëjtë mund të thuhet edhe për video-lojërat, për filmat horrorë apo filmat për seks, për shou emisionet, si *Big Brother* etj. Ndërsa është krejtësisht ndryshe me një lajm të TV "Klan Kosovës" në të cilin gazetari ka ndërftuar elemente humori: e jep informacionin kryesor, por nën ombrellën e një humori të lehtë. Kështu, më datën 16 korrik 2015, gazetarja e RTK-së, Gentiana Begolli-Pustina, e nis kronikën për vizitën e papritur të kryeministrit të Shqipërisë Edi Rama në Prishtinë me këtë hyrje dhe këso fjali: "U kontrollua çdo gjë në veturat të cilat bëheshin gati për ta pritur kryeministrin shqiptar, Edi Rama..." (imazhi që transmetohej gjatë kësaj fjalie në kronikë ishte ky: një qen që kontrollon një makinë dhe policët që e bëjnë të njëjtën, duke mbajtur qenin për kapistre). "Pa asnjë paralajmërim ai po viziton Prishtinën..."

Njësoj, por më origjinalisht, TV "Klan" raporton edhe për ngjarjet më të rëndësishme. Më 27 nëntor 2012 në Shkup qe organizuar një prej manifestimeve qendrore të 100-Vjetorit të Pavarësisë së shtetit Shqiptar. TV "Klan" e fillon kështu raportimin për këtë ngjarje: "U ngritën në këmbë. Po përqafohen kryeministrat. Presin të shtrëngojnë duart edhe nga shokët e tyre..." (gjatë kësaj kohe transmetoheshin pamje të kryeministrave Sali Berisha e Hashim Thaçi dhe të liderit të shqiptarëve në Maqedoni Ali Ahmeti). Këto dy lloje zhanrore, entertainment dhe infotainment, janë shfaqjet dominuese në gazetarinë moderne argëtuese. Që të dy llojet janë në rritje të shpejtë dhe me ndikim të madh. Efekti i tyre ende nuk është matur. Kjo është, krahas gazetarisë së portaleve "online", pyetja më tunduese për teoricienët e gazetarisë e të medieve.

## Bibliografia e cituar

*Global Entertainment Media: content, audiences, issues*, Edited by Anne Cooper-Chen, Ohio University, Lawrence Erlbaum Associates, Publishers, 2005 Mahwah, New Jersey London.

*Encyclopedia of Journalism*, Christopher H. Sterling, general Editor, 2009, SAGE Publications, Inc.

Kurt Lang and Gladys Engel Lang, *The Unique Perspective of Television and its Effects: A Pilot Study*, in *American Sociological Review*, 18.

<http://www.itv.com/whowantstobeamillionaire/abouttheshow/>

<http://www.merriam-webster.com/dictionary/infotainment>

## Shënime

- 1 *Global Entertainment Media: content, audiences, issues*, Edited by Anne Cooper-Chen, Ohio University, Lawrence Erlbaum Associates, Publishers, 2005 Mahwah, New Jersey London, fq. 242.
- 2 <http://www.itv.com/whowantstobeamillionaire/abouttheshow/>
- 3 *Global Entertainment Media: content, audiences, issues*, Edited by Anne Cooper-Chen, fq. 237.
- 4 Po aty, fq. 238 dhe 242.
- 5 Po aty, fq. IX.
- 6 *Encyclopedia of Journalism* (2009), Christopher H. Sterling, general Editor, SAGE Publications, Inc.
- 7 Kurt Lang and Gladys Engel Lang, *The Unique Perspective of Television and its Effects: A Pilot Study*, in *American Sociological Review*, 18, Pp. 3-12. (cituar sipas Elihu Katz dhe të tjerët, *Tekste kanonike të kërkimit në media*, ISHM, Tiranë, 2009).
- 8 Shih, për shembull, disa prej pyetjeve në disa vende, në *Global Entertainment Media: content, audiences, issues*, Edited by Anne Cooper-Chen, fq. 238 dhe 241.
- 9 <http://www.merriam-webster.com/dictionary/infotainment>
- 10 *Encyclopedia of Journalism* (2009), Christopher H. Sterling, general Editor, SAGE Publications, Inc., fq. 755 (version elektronik).



## NË VEND TË PËRMBYLLJES: SFIDA TË REJA PËR GAZETARINË

Në fund të librit për zhanret gazetare, me keqardhje duhet të konstatojmë se nuk janë shqyrtuar të gjithë tipat e të gjitha zhanret e gazetarisë. Si duket, kjo as që do të mund të bëhet ndonjëherë. Gazetaria e përshtatur për telefonat mobilë, e cila imponohet në çdo kohë e në çdo vend të tokës, e të cilën përdoruesit po e përdorin si duhanin a kafenë, po tejkalon çdo parim mbi të cilin mund të vendoset një teori e gazetarisë. Nga ky prizëm, mësimi i llojeve zhanrore të gazetarisë, shkrimi dhe analiza e tyre, në shikim të parë duket si punë klasike ose si punë idealiste. Fakti kundërshtues, se sa do që të transformohet gazetaria, prapëseprapë gazetari duhet të ulet në kompjuter dhe ta fillojë tekstin e tij, lajm apo koment, sado i vërtetë, përsëri mbytet nën ritmin e ndryshimeve radikale të gazetarisë dhe të ligjësisë të saj. Në fund, prapëseprapë ky fakt, sado i marginalizuar, e thotë një të vërtetë të madhe: gazetari vetë nuk është një medium midis ngjarjes lajmore dhe audiencës, për arsyen e thjeshtë se gazetari nuk fotografon si një aparat fotografik, por mbledh fakte dhe ulet ta shkruajë tekstin gazetar. Kjo e bën atë të rëndësishëm. Derisa njeriu të mos mundet vetë, përmes një mediumi të përkryer, ta përcjellë çdo skutë të botës dhe të zgjedhë vetë se ku, çka dhe kur dëshiron të shohë diçka, pra derisa njeriu të ketë nevojë për gazetarin si një ndërmjetës me shpirt i cili ia tërheq vëmendjen njeriut që të fokusohet në këtë e jo në atë lajm, deri atëherë detyra e gazetarit do të jetë e rëndësishme dhe mësimi i llojeve zhanrore do të ketë rol të rëndësishëm në jetën e gazetarisë.

Këto ndryshime radikale në vetë procesin e gazetarisë kanë krijuar shfaqje të tjera të cilat ndërlidhen fuqishëm, tash dhe në të ardhmen, edhe me zhanret e gazetarisë. Në këtë përmbyllje do t'i diskutojmë disa prej këtyre shfaqjeve.

**Shfaqja e parë** është provuar tashmë: dëmtimi i përmbajtjes së tekstit gazetar në favor të shpejtësisë së informimit. Më nuk ka lajme të sigurta e të besueshme. Çdo lajm është a priori i pabesueshëm. Vetëm brenda pesë minutave mund ta ndryshosh lajmin e pabesueshëm dhe ta bësh më të besueshëm, ta zëvendësosh variantin e përgjysmuar me një variant më të plotë. Brenda një ore portalet "online" japin deri në pesë variante (plotësime të lajmit) të të njëjtit lajm. Audiencia që synon të informohet mirë duhet të lidhet me portalin dhe të përcjellë çdo postim gjatë 24 orëve. Lamtumirë ditë klasike kur ke marrë gazetën dhe je ulur në një kafene për t'i lexuar lajmet në të cilat ke mundur të besosh! Për të ekzistuar, portaleve

“online” u duhet një luftë e ashpër për klikime, prandaj ato bëjnë çmos për të qenë të parët që sjellin një lajm. Vetëm duke qenë i pari ata fitojnë shumë klikime dhe portalet e tjera detyrohen ta marrin lajmin prej Portalit Një dhe detyrohen të paguajnë e ta tregojnë burimin e lajmit, e kjo ia shton edhe më klikimet portalit një. Të jesh i pari tashmë është më e rëndësishme se të jesh i besueshëm.

**Shfaqja e dytë** është e ndërlidhur me atë që dikur është quajtur me kuptim pezhorativ *gazetari bulevardeske*. E thënë më thjesht, ky është dëmtimi i esencës së gazetarisë, e që është informacioni, në favor të reklamës, thashethemnajës dhe përfitimit material. Tashmë është e vërtetuar se publiku është shumë më i ndjeshëm ndaj thashethemeve, ndaj lajmeve të jashtëzakonshme, lajmeve bizare dhe lajmeve që kanë të bëjnë me privatësinë e njerëzve të famshëm, prandaj mediet, në përputhje me ligjet e tregut, ofrojnë ato përmbajtje që shiten më së miri në treg. Kështu, gazetaria e gjysmës së dytë të shekullit XX me hap radikal ka shpërfytyruar vetveten, duke u shndërruar nga një gazetari informative e analitike në një gazetari bulevardeske, në shtyp të verdhë, në gazetari të mbizotëruar me kotësia që nxisin kureshtjen e audiencës. Ndërsa në shekullin XXI, gazetaria e portaleve “online” e ka natyralizuar këtë tip të gazetarisë: shumica e lajmeve dhe e teksteve të cilat publikohen në këto portale janë të asaj kategorie që dikur është quajtur bulevardeske. Lajmet më të lexuara në këto portale janë pikërisht “lajmet” me tema si: të brendshmet e aktoreve të Hollivud-it, skandalet e personave të famshëm publikë, thashethemet për dashurinë dhe seksin e njerëzve të famshëm etj. Fundi i shekullit XX dhe fillimi i shekullit XXI e krijoi mbretërinë e gazetarisë bulevardeske.

**Shfaqja e tretë** lidhet me monopolin e informacionit. Tashmë është aksionare se kush e ka informatën e ka botën. Në historinë e medieeve ka pasur dy qendra të cilat janë akuzuar për monopol të informacionit: fillimisht janë akuzuar grupet e biznesmenëve që kanë financuar Hollivudin në mes të shekullit XX (Horkmajer, Adorno etj.) dhe herën e dytë janë akuzuar qeveritë (sidomos qeveritë diktatoriale ose autoritare të periudhës socialiste). Në fund të shekullit XX monopoli i informacionit është bërë problem shumë më i rëndë: u krijuan korporatat e mëdha mediale. Rasti më i mirë për studim është ai i magnatit të sotëm të medieeve, Rupert Murdok-ut.

Murdoku është nga Australia dhe drejtimin e parë të gazetës *Adelajde* e mori nga i ati, pronar, në vitin 1953. Ai ndryshoi titullin dhe konceptin e gazetës, duke e bërë “më popullor”, që dmth. më bulevardesk, duke u marrë me thashetheme dhe me dokrra të tjera kureshtarë dhe kështu e bëri të fuqishme gazetën e tij. Kjo i mundësoi që ai t’i blejë gazetat e tjera, duke i shndërruar edhe ato sipas të



njëjtin koncept, për të përfunduar në njërin prej tre magnatëve të mëdhenj të medias australiane. Kjo i mundësoi shtrirjen e investimeve në televizion dhe në aviacion. Pastaj ai kaloi investimet edhe në tregun botëror, sidomos në Angli, në fund të viteve '60, duke shndërruar gazeta e televizione të ndryshme botërore në gazeta e televizione bulevardeske. Kështu, nga një gazetë social-demokrate angleze si *The Sun*, ai bëri gazetë bulevardeske që merret me thashethemet e pallatit mbretëror britanik. Nëpërmjet uljes së çmimeve të gazetës (duke shtuar tirazhin dhe duke krijuar monopol), nëpërmes publikimit të rregullt të thashethemeve, me botimin e fotografive gjysmë të zhveshura të femrave të njohura (artiste, këngëtare etj.), ai arriti ta kontrollojë një pjesë të madhe të informacionit dhe të shtypit anglez. Në vitet '80 Murdoku pushton televizionet: së pari *Sky Television* në Angli e pak më vonë *Fox* në SHBA. Në SHBA blen edhe fondin e filmave të *XX-Century Fox* në Hollivud. Duhet theksuar se këto televizione kanë shtrirje shumë të gjerë: *Sky Television* transmeton në gjashtë kanale, ndërsa *Fox* transmetohet në 98 % të territorit amerikan dhe është një nga tre televizionet më të fuqishëm amerikan. Edhe në televizione, si në gazeta, ai realizoi të njëjtin koncept: zhduku emisionet informative dhe i zëvendësoi me filma, filma vizatimorë, me "reality show" etj. Në vitin 1993 Murdoku, në bashkëpunim me pronarët Bertelsmann të *Vox TV* të Gjermanisë, u hodhën në tregun e lindjes: blenë në Hong Kong për një miliard dollarë amerikanë kanalën satelitor "Star Tv" nga pronari Richard Li, i cili transmeton deri në 60 kanale televizive. Në fund të shekullit XX Murdoku prin edhe në gazetarinë e internetit.

Sot kompania e Murdokut quhet "News Corporation". Ka një pasuri prej disa miliardë dollarë, shpërndanë çdo ditë rreth 60 milionë kopje të gazetave dhe furnizon çerekun e njerëzimit me emisione televizive. Tash është mjaft e fuqishme sa të mos pranojë asnjë ndërhyrje të asnjë qeverie, derisa ka takime me liderët botërorë, duke përfshirë këtu edhe një takim me Barack Obamën në verën e hershme të vitit 2008, në "Waldorf-Astoria Hotel" në Nju Jork. Ai sot trajtohet si oligark i medias dhe mbisundon në gazetarinë e shtypur, në televizion, në film dhe në gazetarinë e internetit.<sup>1</sup>

**Shfaqja e katërt** lidhet me gazetarinë e internetit dhe, përtej kësaj, për gazetarinë qytetare. Shërbimet e gazetarisë së internetit fillimisht u bënë falas, pastaj u paralajmëruan disa herë pagesa për këto shërbime por, pa sukses. Ka një histori të vogël në këtë temë, derisa u krijua gazetaria qytetare. Si do që të jenë shërbimet e internetit, fakti se secili njeri i globit që ka një telefon digjital mund të incizojë pamje dhe të dërgojë informata në të katër anët e botës

1 Historia e Murdockut është marrë nga libri F. Barbier, C. Berho Lavenier, *Historia e medias*, fq. 288.

brenda disa sekondave, e ndryshon rrënjësisht fatin e gazetarisë. Vetëm paramendojini dy miliardë njerëz që kanë telefona digjitalë dhe gjatë 24 orëve dëgjojnë informacione të ndryshme “live” nga çdo cep i botës në çdo cep të botës! Dhe kjo nuk bëhet për para: bëhet thjesht nga kureshtja apo edhe nga një vetëdije e lartë për të informuar se çfarë po ndodh. Shumë ngjarje të rëndësishme janë zbuluar dhe informuar në këtë mënyrë. Kujtojeni bujën që patën shkaktuar informatat pamore të dhëna në RTK, kohë pas kohe, për dhunën e arsimitarëve në shkollat e mesme të Kosovës, të incizuar përmes telefonave digjitalë të nxënësve. Nëse të gjithë njerëzit informojnë “live” dhe janë të informuar “live” për gjithçka që ngjet në botë, atëherë ku mbetet kuptimi i gazetarisë, ku mbetet kuptimi i të mësuarit dhe të shkruarit të lajmit, të raportit, të komentit, të analizës, të esesë... etj?

**Shfaqja e pestë** lidhet me gazetarinë e tipit të portaleve “online”. Kjo shfaqje është e re, ende e pakconceptuar sa duhet, ende nuk ka një emër të qëndrueshëm. Portalet “online” kanë përparuar dhe janë bërë më ndikueset në gjithë gazetarinë për shkak të shpejtësisë së informimit dhe për shkak të qasjes së lehtë në to. Tashmë është pothuajse e pazakonshme që një lokal shërbyes, p.sh. një kafene, apo një stacion treni, të mos ketë valë WiFi. Sapo të ulesh për kafenë e mëngjesit, apo sapo të ulesh në taksi, e kyç telefonin në rrjetin WiFi dhe kontrollon lajmet në gjithë perandorinë e internetit pa paguar asnjë cent. Operatorët e telefonive ofrojnë me çmime të lira për shërbime të valëve WiFi me parapagim për çdo pjesë të vendit, ndërsa lokalet e ndryshme shërbyese (marketet, kafenetë, taksitë, restorantet, bibliotekat...) i ofrojnë këto shërbime falas, si një shpenzim për të tërhequr klientët. Njeriu udhëton ditën a natën me makinë dhe gjatë gjithë kohës përcjell se çka po ndodh në botë. E gjithë kjo teknologji e mundëson qasjen e përhershme, të lehtë dhe të lirë në internet. Portalet, ashtu si e kanë edhe emrin, janë dera e parë e internetit dhe e lajmit. Portalet ofrojnë shërbimet e tyre falas. Shpenzimet që do të duhej t’i paguanin përdoruesit e tyre i mbulojnë me reklama. Reklamën e arrijnë përmes shtimit të klikimeve të përdoruesve: sa më shumë klikime aq më i madh shansi për reklama të shumta e, plus kësaj, edhe një përqindje të fitimit të provajderit ku është i kyçur portali. Prandaj gjithnjë e më shumë ka oferta për përdorimin e valëve WiFi pa pagesë. Për një portal lajmor tashmë përdoruesi ka rol vetëm si klikues: portali nuk interesohet aspak a po informohet drejt apo jo audienca e tij, përkundrazi, ai interesohet të sjellë aso lajme që e zgjojnë kureshtjen e audiencave dhe e shtyjnë atë të klikojë. Me çastin e klikimit roli i audiencës merr fund: ajo e ka kryer misionin e saj. Në këtë mënyrë audienca është shndërruar në aset, pra nuk është fare audiencë, por aset financiar i

portalit. Kjo e bën portalin biznes dhe, me këtë, për herë të parë në historinë e gazetarisë, mediet janë bërë aleate me bizneset dhe me qeverinë dhe kanë hequr dorë nga aleanca me audiencat. Ky është ndryshim i skajshëm: nga një aleat i publikut, i audiencave dhe i njerëzve të pafuqishëm, media është shndërruar në aleat të bizneseve dhe të qeverisë. Nuk besoj se është revolucion. Është përmbytje.

Shpesh, duke biseduar me studentët për këto rrjedha të gazetarisë moderne, ua kam përkujtuar fatin e hidhur të retorikës dhe të sofistëve. Sikurse dikur sofistët që e shpërdoruan retorikën, një prej arteve më të çmueshme atëherë dhe sot, dhe ajo u shua, u ringjall, u nënçmua dhe përsëri po ringjallet, por kurrë më me atë shenjtërinë e parë, edhe sot duhet shtruar pyetjen se a mos po shpërdorohet gazetaria deri në atë masë sa ta rrezikojë misionin e vet të shenjtë?

Në të gjitha rastet dhe shfaqjet e reja në gazetari që diskutuam më lart, një rrjedhojë dallohet qartë: tradita e shkrimit dhe e tekstit gazetar vihet në pikëpyetje. A thua po ndryshon aq shumë gazetaria sa nuk ka nevojë për tekstin gazetar? Nuk ka nevojë për gazetarin i cili mbledh fakte dhe shkruan tekstin gazetar? Studentët e gazetarisë nuk kanë nevojë të mësojnë për teori dhe zhanre të gazetarisë? Të gjitha këto pyetje janë shqetësuese, për më tepër edhe sepse zhvillimi i teknologjisë informative është tej mase i shpejtë, e fati i gazetarisë ka qenë dhe është i ndërlidhur jetësisht me teknologjinë informative.

Por, mbi këtë pasiguri për gazetarinë, një gjë është e vërtetë: sado jemi pjesë e një revolucioni të madh gazetar, sado jemi para trilleve të reja të tregut gazetar, sado jemi në mesin e një përmbytjeje gazetare, shkrimi i lajmit, shkrimi i raportit, i komentit, i analizës, i esesë dhe i shumë e shumë llojeve e nënlojeve të tjera zhanrore, është produkt i mendjes së njeriut dhe atë produkt marrësi do ta kërkojë gjithnjë dhe, së fundmi, atë produkt nuk mund të prodhojë askush tjetër përveç mendjes së gazetarit. Pavarësisht nga çfarëdo revolucioni teknologjik, njeriu gjithmonë do të ketë nevojë të pashterueshme, të pakompensueshme dhe të pazëvendësueshme për të mësuar se çfarë mendon, çfarë ndjen dhe çfarë përjeton njeriu tjetër, në këtë rast gazetari. Ai nuk mjaftohet kurrë vetëm me fotografinë "live" të telefonit/kamerës digjitale, por i duhen edhe fjala, komenti, përshkrimi dhe sqarimi i gazetarit. Mediumi, sado është zgjatim i njeriut e, nganjëherë e zëvendëson edhe vetë njeriun (kujtoni robotët në vendet e punës në fabrika), përsëri e ka një thembër të Akilit: ai nuk mendon, nuk prodhon opinione dhe nuk sublimon mendimet e komentet e të tjerëve. Gazetari është një lloj mediumi, një ndërmjetës midis ngjarjes lajmore dhe audiencës por, për dallim nga mediumet e tjera, ka shpirt, ndjen, sublimon, ka mendim e opinion dhe me këto e plotëson kërkesën e pazëvendësueshme të audiencës.

Këtë revolucion medial duhet ta pranojmë kështu si është, pa u hamendur: duhet mësuar rrënjët dhe trupin e gazetarisë, sepse degët mund të bulojnë të reja, por edhe degët e reja të një peme janë në trupin e vjetër. Ashtu si e ka thënë McLuhani, format e reja të medieve krijohen nga ato të vjetrat. Format e bartjes së lajmit ndryshojnë varësisht nga një zbulim në teknologjinë e informimit, por gjithnjë ka nevojë për vetë tekstin, strukturat e tekstit e të përmbajtjes. Përfundimisht, mësimi për zhanret e gazetarisë, sado kjo një teori ende pa u përfunduar po kontestohet, është një prej bazave të gazetarisë mbi të cilën rrinë teksti, mësimi, edukimi dhe procesi i gazetarisë.

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

659.3(075.8)

070(075.8)

Kosumi, Bajram

Zhanret e gazetarisë / Bajram Kosumi. – Prishtinë :  
Artini, 2019. – 420 f. : ilustr. ; 24 cm.

**ISBN 978-9951-766-48-7**